5. Vendim nr. 1, datë 23.03.1998, Për shesh dhe Leje Ndërtimi për seksionin Rrogozhinë-Elbasan të Korridorit Lindje-Perëndim, Miratohet sheshi i ndërtimin me sip toke 46.7 ha që shpronësohet, nga e cila 35.3 ha tokë bujqësore dhe 11,4 ha tokë truall, Miraton lejen e ndërtimit.
6. Vendim nr.25 datë 23.03.1998, Për shesh ndërtimi për venddepozitimi dhe trajtimi të mbeturinave të ngurta urbane për qytetin e Elbasanit, Miraton sheshin e ndërtimin me sip. 4 ha në Komunën Bradashesh pranë Fabrikës së Çimentos.
7. Vendim nr.1, datë 26.01.2001, Për sheshin dhe lejen e ndërtimit për zgjerimin e nënstacioneve Elbasan 400KV dhe Elbasan 220KV, si dhe për linjën elektrike 220KV ndërmjet tyre, Miratohet.
8. Vendim nr. 4, datë 21.05.2001, Për studimin urbanistik të qendrës turistike në zonën turistike të Gjinarit në Qarkun Elbasan, Miratohet (sip 25,162 ha).
9. Vendim nr. 1, datë 21.08.2002, Për shesh dhe leje ndërtimi për rehabilitimin e rrugës Elbasan-Librazhd, Miratohet sheshi dhe leja e ndërtimit për rrugën me gjatësi 39.4 km dhe për të cilën duhen shpronësuar 81, 523 m² tokë.
10. Vendim nr. 6, darë 19.02.2003, Për detyrën e projektimit për studimin urbanistik të qendrës së qytetit të Elbasanit dhe vijën kufizuese të kësaj qendre, Miratohet.
11. Vendim nr. 1, datë 18.12.2004, Për miratimin e studimit urbanistik të qendrës së qytetit të Elbasanit, Miratohet sipas vendimit.
12. Vendim nr. 6, datë 07.05.2005, Për miratimin e Rregullores për zbatimin e studimit urbanistik të qendrës së qytetit të Elbasanit, Miratohet.
13. Vendim nr. 8, datë 07.05.2005, Për miratimin e vijës kufizuese dhe detyrës së projektimit për studimin urbanistik të zonës turistike kurative të Llixhave të Elbasanit, Miratohet.
14. Vendim nr. 1, datë 27.12.2005, Për miratimin e detyrës së projektimit për Planin e Përgjithshëm Rregullues të qytetit të Elbasanit, Miratohet me vërejtje sipas vendimit.
15. Vendim nr. 3, datë 14.08.2007, Për miratimin e projekt-idesë së përgjithshme të studimit për autostradën Tiranë-Elbasan (Vaqarr-Papër), Miratohet.
16. Vendim nr. 1/6, Për miratimin e vijave kufizuese të zonave/ vendbanimeve informale në Qarkun e Elbasanit
17. Vendim nr. 14, datë 13.01.2009, Ndryshim në studimin urbanistik të qendrës së qytetit të Elbasanit dhe rregullores në zbatim të tij, Miratohet.
18. Vendim nr.10, datë 21.07.2009, Detyrë projektimi për planin e studimit urbanistik pjesor të kodrës Krasta e Madhe, Elbasan, Miratohet.
19. Vendim nr. 34, datë 10.05.2013, Rivlerësimi i studimit urbanistik të qendrës së Elbasanit, Miratohet.
20. Vendim nr. 3, datë 27.05.2014, Leje zhvillimore komplekse për ndërtimin e stadiumit "Ruzhdi Bizhuta" në Bashkinë Elbasan, Miratohet, konfirmuar.
21. Vendim nr. 3, datë 30.07.2014, leje zhvillimore komplekse për ndërtimin e linjave të transmetimit të energjisë elektrike 110 kv, Banjë-Cërrik dhe 220 kv, Moglicë-Elbasan, me subjekt kërkues shoqërinë "Devoll Hydropower" Sh.a, për shoqërinë "Devoll Hydropower" Sh.a. Miratohet, konfirmuar.

22. Vendim nr. 3, datë 03.12.2014, leje ndërtimi për uzinën e prodhimit të ferrokromit, në Elbasan, Miratohet, konfirmuar.
23. Vendim nr. 2, datë 29.12.2014, Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin "Rafineri për prodhimin e bitumeve dhe nën-produkteve të naftës", në Elbasan me subjekt kërkues shoqërinë "R.B.H –Beline" sh.a., Miratohet, konfirmuar.
24. Vendim nr. 1, datë 27.01.2015, Për miratimin e lejes së ndërtimit për "Impiantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit dhe prodhimit të energjisë", me vendndodhje në Bashkinë Elbasan dhe subjekt kërkues shoqërinë koncensionare "Albtek Energy" sh.p.k., Miratohet, konfirmuar [9].

- **Para 1990-Studim i qendrave urbane (Plani Rregulluesi i Vitit 1942 dhe Plani Rregullues i Vitit 1983)**

Figura 7. Plani Rregulues i Bashkisë Elbasan, 1942



Burimi: Bashkia Elbasan, 2015

Figura 8. Plani Rregullues i Bashkisë Elbasan, 1983



Burimi: Bashkia Elbasan, 2015

- **Nxitja e Zhvillimit Rajonal Nëpërmjet Objektivave të Mjëvjeçarit**

Përgatitja e këtij raporti u mbështet nga Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe hartua nga Drejtoria e Koordinim-Zhvillimit, Këshilli i Qarku Elbasan me asistencë të Qendrës për Nxitjen e Zhvillimit Njerëzor (HDPC), në vitin 2002. Objektivi kryesor i kësaj nisme ishte lokalizimi i synimeve të treguesve të Objektivave të Mijëvjeçarit për Zhvillimin e Qarkut Elbasan dhe verifikimin e mundësisë të shndërrimit të tyre në instrumente nxitëse të zhvillimit të gjithanshëm rajonal dhe të mobilizimit të burimeve ekonomike e njerëzore në funksion të këtij zhvillimi.

- **Plani i Përgjithshëm Rregullues i qytetit Elbasan (2006)**

Ky plan u hartua si dokument kryesor për administrimin e territorit të bashkisë për 15 vitet në vazhdim. Plani i Përgjithshëm Rregullues është pjesë dhe instrument zbatimi i Strategjisë së Zhvillimit të Qytetit (Elbasan 2005-2020) dhe pasqyron objektivat e kësaj Strategjie në lidhje me çështjet e zhvillimit urban. Konceptet kryesore ky synon ky plan rregullues janë:

Zgjidhja e problemit të strehimit (përcakton zonat e reja të banimit, përfshin në proces legalizimin e banesave informale në periferi të qytetit duke propozuar përmirësimin e infrastrukturave në këto zona, promovon nismën e dokumentimit të tokës dhe ngritjes së bazës së të dhënave për territorin dhe sistemin vendor të informacionit dhe krijon mundësi për strehim social)


Rritja e cilësisë së jetesë së banorëve (propozon koeficientë të rinj urbanë me qëllim që të përmirësojë kushtet urbane në zonat e banimit duke nxitur sigurimin e hapësirave çlodhëse dhe rekreative, rikonceptimet dhe konsolidimet e zonave të ndryshme në qytet që sjellin rritjen e dendësisë me qëllim shfrytëzimin efecient-ekonomik të tokës dhe të infrastrukturave dhe shërbimeve publike)

Zhvillimin ekonomik të qytetit dhe rajonit të Elbasanit (Plani ka konceptuar shpërndarjen hapësinore të zonave me funksione ekonomike si dhe funksionet e lejuara për çdo zonë. Gjithashtu hartimi i skemës së rrjetit rrugor të propozuar bazohet në krijimin e një strukture të qartë të qarkullimit të njerëzve, mallrave dhe shërbimeve duke stimuluar kështu iniciativat ekonomike, lidhjen sa më të mirë të territoreve me rajonet përreth saj duke stimuluar fluksin e shkëmbimeve drejt qytetit dhe sidomos përgjatë akseve kryesore rrugore të propozuara. Plani prezanton rikonceptimin hapësinor bazuar në elementët promotor të qytetit dhe veçanërisht në nyjat/akset/fashat gravitacionale të qytetit si elemente gjeneruese të zhvillimit.)

Përmirësimin e kushteve të mjedisit dhe mbrojtjen e tij (në këtë Plan Rregullues përcaktohen qartë zonat ndotëse, duke rekomanduar një sërë ndërhyrjesh të ndryshme me karakter konservues, rikuperues etj. Propozohet shtimi i sipërfaqeve të gjelbra në qytet, duke synuar rehabilitimin e zonave të gjelbra të degraduara si p.sh. rasti i fashës së Shkumbinit, Manasderes, Zaranikës, etj., si dhe planifikimin dhe rikuperimin e zonave të gjelbra periferike me karakter park si p.sh., derdhjet e ujërave të zeza në hapësirat ujore, rikuperimi mjedisor i fushës së grumbullimit të mbeturinave në Park të Gjelbër, vendndodhja e impiantit të pastrimit të ujërave të zeza në perëndim të qytetit të Elbasanit etj.)

Krijimin e institucioneve të afta për menaxhimin dhe zbatimin e Planit (këto institucione duhet të organizohen dhe pajisen me kapacitete për zbatimin e planit dhe duhet të jenë të afta të koordinojnë ndërhyrjet e planit në nivel ndërvendor-zona e trajtuar nga plani.)

Figura 9. Plani i Përgjithshëm Rregullues i Qytetit Elbasan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN

- **Detyra e Projektimit të Planit të Përgjithshëm Rregullues të Bashkisë Elbasan, miratuara janar 2006**

Detyra e Projektimit është produkt i Bashkisë Elbasan i asistuar nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit. Kjo detyrë projektimi është dokument bazë dhe ligjor për hartimin e Planit Rregullues të Përgjithshëm. Objektivat kryesorë për hartimin e këtij materiali ishin:

- Grumbullimi dhe sistemimi i të dhënave për të paraqitur sa më saktë gjendjen ekzistuese të qytetit të Elbasanit
- Analiza e situatës ekzistuese mbi bazën e të dhënave të paraqitura
- Parashtrimi i udhëzimeve orientuese mbi zhvillimin perspektiv dhe zgjidhjen e problemeve kryesore urbane, të cilat do të merren parasysh gjatë fazës së hartimit të planit rregullues për periudhën 15-20 vjeçare.

Detyra e Projektimit paraqet problemet ekzistuese duke u mbështetur: në të dhënat urbanistike, të dhënat mbi infrastrukturat, të dhënat socio-ekonomike, të dhënat mjedisore dhe të dhënat të tjera të përgjithshme.

- **2006-2013 Studimi Pjesor i Qendrës**

Studimi pjesor i Qendrës ndahet në Zona Projekti, të cilat janë instrument bazë për studimin e rikualifikimit urban të qendrës së qytetit të Elbasanit. Këto zona të veçanta do të transformohen në mënyrë të tillë që të shërbejnë si pjesë referimi për zbatimin e projektit. Ndarja e qytetit në zona është bërë, në mënyrë që zbatimi i tyre të jetë individual dhe në kohë të ndryshme, por duke qenë harmoni midis tyre. Pra, pavarësisht ndarjes në zona dhe zbatimi në kohë të ndryshme bëhet fjalë për një projekt të vetëm. Normat kryesore që përcaktohen nga plani i rikualifikimit urban janë:

  - Skema projektuese
  - Parametrat e projektimit bashkangjitur skemës
  - Metoda për zbatimin e projektit të përcaktuara për çdo skemë në veçanti

- **Studim Urbanistik Pjesor, Zgjerimi i vijës kufizuese të ndërtimit në fshatrat: Bradashesh, Katund i Ri dhe Kusarth të Komunës Bradashesh, Elbasan (Prill 2007)**

Ky studim urbanistik i hartuar në vitin 2007 ka për qëllim zgjerimin e vijës kufizuese të ndërtimit në disa fshatra të komunës Bradashesh, përkatësisht në fshatrat Bradashesh, Katund i Ri dhe Kusarth. Zgjerimi i vijës kufizuese të ndërtimit propozohet për disa arsye, të cilat janë: zhvillimet e vrullshme politiko-ekonomike pas vitit 1990 kanë bërë që kjo zonë të pësojë rritje të popullsisë, ndaj propozimi për zgjerimin e vijës kufizuese është për të plotësuar nevojat për ndërtime të reja dhe njëkohësisht për të shmangur zhvillimin e pakontrolluar (ndërtimet të mos i lihen rastësisë). Sipërfaqja që propozohet të shtohet është 43 ha dhe pozicionohet përkrah rrugëve ekzistuese kryesore. Ky studim pjesor parashikon ndërtimin e rrugëve të reja 3 dhe 5m të gjëra, godina banimi kryesisht ndërtesa njëfamiljare të tipit 'vilë' (2-3 kate) me oborr të gjelbër, ndërtime social ekonomike (dyqanet, bare-restorante, punishtet e vogla artizanale), godina të shërbimit shëndetësor (të cilat do të jenë të nevojshme për shkak të rritjes së popullsisë), kopsht-çerdhe për fëmijët e ciklit parashkollor.

- **Plani Strategjik i Zhvillimit të Qytetit Elbasan (2010-2020)**

Plani Strategjik i Zhvillimit të Qytetit të Elbasanit përcakton objektivat e zhvillimit të qytetit për një periudhë 10-vjeçare dhe identifikon projektet konkrete kryesore për fusha të ndryshme. Qëllimi i hartimit të këtij plani është të krijojë vlera komunitare afatgjata, mbrojë dhe ruaj burimet ekonomike dhe të nxisë një cilësi jete më të lartë.


- **Strategjia e Zhvillimit Rajonal, Qarku Elbasan 2012-2016**

Ky projekt është financuar nga BE dhe realizuar nën asistencën teknike të PNUD-it, nëpërmjet projektit "Mbështetje e Integruar për Decentralizimin". Kjo është një strategji afatmesme, 5 vjeçare. Kjo strategji mbulon të gjitha fushat që kanë lidhje me të, pavarësisht se cili nivel qeverisjeje është përgjegjës kryesor për këto. Prioritetet e këtij dokumenti janë:

  - Forcimi i kapaciteteve të zhvillimit njerëzor për të zhvilluar rajonin
  - Zgjerimi i bazës produktive të ekonomisë rajonale
  - Zhvillimi i turizmit
  - Zhvillim i qëndrueshëm mjedisor dhe infrastruktura mbështetëse
  - Zhvillimi i njerëzve nëpërmjet arsimit

- Shëndeti publik dhe zhvillimi social
- Aksesi dhe ndërlidhja

Figura 10. Zonimi funksional në perspektivë



Burimi: Bashkia Elbasan, 2015

- **Plani i Menaxhimit Mjedisor (PMM), Segmenti Papër-Vidhas (2014)**

Ky studimi është fokusuar në aktivitetet e seksionit rrugor Vidhas-Papër, pjesë e rrugës kombëtare SH7, të identifikuar dhe të pranuar nga ARRSH. Segmenti sipas studimit është 7.8 km i gjatë. Pjesa e rrugës në shqyrtim duket të jetë e karakterizuar nga konflikti ndërmjet përdoruesve të motorizuar dhe atyre të pa-motorizuara rrugore.

- **Plani i menaxhimit për pyjet dhe kullotat e fshatit Gjergjan**

  Qëllimi i këtij projekti është ndëhyrja artificiale në grumbullin pyjor, në mënyrë që të rritet boniteti i tij. Ndërhyrjet e bëra janë të qëndrueshme dhe nuk cënojnë biodiversitetin optimal dhe multifunksionalitetin e këtij grumbulli. Objektivat që synon të arrij ky projekt janë:

  - Përmirësimi i bonitetit të grumbullit, nëpërmjet rritjes së parametrave dendrometrike dhe silvikulturale me përzgjedhjen e drurëve të së ardhmes dhe eleminimin e numurit të drureve për njësi sipërfaqje.
  - Sigurimi i qëndrueshmërisë së bidoviversitetit dhe zhvillimit duke stimuluar llojin dushk, duke ruajtur dhe përmirësuar florën barishtore e jetën e egër autoktone. Denësinë optimale të grumbullit në përshtathe me funksionin mbrojtës-prodhues-rekreativ.

- Sigurimi i të ardhurave financiare dhe tregu real dhe i organizuar e i monitoruar të produkteve që vlen nga pylli i dushkut dhe shfrytëzimi i tij tërësor social-ekonomik përfshirë edhe pushime masive të organizuara gjatë gjithë vitit.

Në territorin e Bashkisë Elbasan janë hartuar gjithashtu:

- **Studim për menaxhimin e pyjeve në komunat Shushicë, Gjinar, Papër dhe Gracen, Banka Botërore**
- **Strategjia nga ALCDF, komunat Shushicë dhe Funarë**

1.3 Pozicionimi strategjik dhe pikat e forta në territor

Bashkia Elbasan shtrihet në pjesën qendrore të Shqipërisë. Pas Reformës Administrative-Territoriale, të miratuar në maj të vitit 2014 Bashkisë së vjetër të Elbasanit i janë bashkuar edhe 12 njësi të tjera administrative. Aktualisht Bashkia Elbasan përbehet nga 13 njësi administrative, Bashkia e vjetër e Elbasanit, Komuna Bradashesh, Komuna Papër, Komuna Gjergjan, Komuna Labinot-Fushë, Komuna Labinot-Mal, Komuna Funarë, Komuna Gracen, Komuna Tregan, Komuna Shushuicë, Komuna Shigjan, Komuna Gjinar dhe Komuna Zavalin.

Sipërfaqja e Elbasanit është 872 km², nga 7,9 km² që ishte para Reformës Administrative-Territoriale, 2014. Pra sipërfaqja e bashkisë është rritur përafërsisht 110 herë. Ndryshimi i kufirit territorial është sfidë për bashkinë në zhvillimin e mëtejshëm të saj.


Tabela 1. Ndarja administrative e Bashkisë Elbasan

Bashkia	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Sipërfaqja (km²)[10]	Fshatrat/Qytetet në përbërje të tyre[11]
Elbasan	Qyteti Elbasan	Elbasan	22.2	Qyteti Elbasan
		Bradashesh	56	Bradashesh, Balëz Lart, Balëz Poshtë, Kusarth, Kozan, Karakullak, Letan, Rrilë, Shtemaj, Ulën, Katund i Ri, Fikas, Petresh, Shëmhill, Shijon, Reçan, Gurabardh
		Papër	102	Papër, Broshkë, Murras, Valas, Vidhas, Pajun, Bizhutë, Papër-Sallak, Vidhas-Hasgjel, Lugaj, Jatesh, Balldre, Ullishtaj
		Labinot-Fushë	49	Labinot-Fushë, Godolesh, Griqan i Sipërm, Griqan i Poshtëm, Xibrakë, Mengel
		Labinot-Mal	105.7	Labinot-Mal, Guri Zi, Sericë, Lamollë, Benë, Lugaxhi, Qafë, Qerret, Shmil, Dritas
		Gjergjan	27.9	Gjergjan, Bujaras, Gjonmë, Kështjellë, Kodër Bujaras, Muriqan, Thanë
		Gjinar	89.1	Gjinar, Lleshan, Valesh, Pashtresh, Derstilë, Lukan, Sterstan, Xibresh, Maskarth, Kaferr, Pobrat
		Gracen	56.8	Gracen, Plangaricë, Tërbaç, Bodin, Shingjin, Gjorm, Pajengë, Mamel, Dopaj

		Funarë	76.6	Branesh, Bixëlle, Prec e Sipërme, Cerujë, Korrë, Mollagjesh, Krrabë e Vogël, Prec e Poshtme, Stafaj
		Shushicë	106.6	Shushicë, Shelcan, Mlizë, Hajdaran, Fush-Bull, Vasjan, Polis i Vogël, Polis Vale, Vreshtaj
		Shirgjan	21.6	Shirgjan, Bathës, Bujqës, Jagodinë, Kuqan, Kryezjarr, Mjekës
		Tregan	57.4	Tregan, Blerimas, Bizhdan, Cikallesh, Gurisht, Kacivel, Kyçyk, Muçan, Shinavlash, Shilbatër, Trepsenisht, Tudan
		Zavainë	101.1	Zavalin, Seltë, Kamiçan, Joronishtë, Nezhan, Burrishtë

Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Figura 11. Pozicioni gjeografik i Bashkisë Elbasan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015


Bashkia Elbasan shtrihet në pozicion mjaft strategjik. Kufizohet nga rrugë të rëndësishme kombëtare. Largësia nga Aeroporti Nënë Tereza është 62.5 km, nga Port i Durrësit 83 km, nga pika kufitare e Qafë Thanës 65 km dhe nga pika kufitare e Kapshticës 150 km [12]. Nga pikëpamja e mjedisit, përshkohet nga lumenj të shumtë si Shkumbini, Manasdere, Papër, Gostrima dhe Zaranika. Qyteti dhe zona industrial (zona e ish-metalurgjikut) shtrihen

përgjatë luginës së Shkumbinit. Në territorin e Elbasanit ndodhen edhe zona të mbrojtura si Sopoti, Stravja dhe Kuturmani. Territori ka kryesisht karakter kodrinor-fushor. Duke qenë se shtrirja që ka kjo bashki është e madhe, ka larmi relievesh. Temperatura mesatare luhatet nga 6.7°C-11°C në janar, në 23.4°C-31.2°C në korrik, ndërsa shpejtësia e erës luhatet nga 1.2 m/s në verë. deri në 2.1-2.4 m/s në dimër.

1.3.1 Tendencat kryesore të zhvillimit të pas viteve `90të

Tendencat e zhvillimit në Bashkinë Elbasan kanë ndryshuar shumë pas viteve '90. Lëvizja e lirë e njerëzve bëri që popullsia të zhvendosej drejt qendrave urbane duke ndikuar në shtrirjen e qyteteve dhe shtimin e sipërfaqes së ndërtuar. Edhe në Elbasan ndodhi i njëjti fenomen: rënia e sistemit komunist solli ndryshime në aspektin ekonomik, territorial dhe mjedisor. Prirjet kryesore ekonomike para viteve '90 në Elbasan ishin të orientuara drejt industrisë së rëndë (Kombinati Metalurgjik, Kombinati i Përpunimit të Drurit, etj.) dhe zonat rurale, të cilat sot janë pjesë e bashkisë së re, më të orientuara drejt bujqësisë. Këto tendenca ndryshuan duke ia lënë vendin sektorit të shërbimeve dhe ndërmarrjeve të vogla e të mesme. Në këtë mënyrë u bë një kalim i menjëhershëm nga sektori shtetëror në mbizotërimit të plotë të sektorit privat. Zhvillimi ekonomik, krahas ndryshimeve demografike është kushtëzuar nga faktorë të tjerë që lidhen me perudhën e tranzicionit. Industria e rëndë, sektori kryesor, në të cilën mbështetej zhvillimi ekonomik, kaloi në sektor të fundit të zhvillimit ekonomik. Sektori që zuri vendin e parë në ekonominë e bashkisë ishte ai i shërbimeve dhe ndërmarrjet e vogëla e të mesme, që vazhdojnë të jetë edhe sot sektori kryesor ekonomik.

Figura 12. Fazat e zhvillimit të vendbanimeve në vite



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015


Rritja e popullsisë rriti presionin e zhvillimit urban. Përqendrimi i popullsisë në qytete solli nevojën e shtimit të ndërtimeve, të cilat u shtuan në shumë pak kohë duke ndryshuar tërësisht pamjen e qytetit. Presioni i lartë i zhvillimit, mungesa e reformës së planifikimit, mungesa e kontrollit të zhvillimit, rikthimi i pronës tek njerëzit dhe lëvizjet e lira ishin ndër faktorët kryesor që sollën pamjen që kemi sot në qytete. Në Bashkinë Elbasan u ndërtuan banesa individuale nga banorët që u zhvendosën duke krijuar e zonat informale. Në këto zona një problem kryesor ishte mungesa e infrastrukturës publike dhe fakti se shumë ndërtime u ngritën në toka bujqësore. Zhvillimi i vendbanimeve ka tre momente kohore të rëndësishme:

- Para viteve 1990,
- Deri në vitin 2007,
- Deri në vitin 2013,

Nga viti 1990 deri në vitin 2007 sipërfaqja e vendbanimeve në Bashkinë Elbasan të shtuara është 20,2 %, pra rritja e sipërfaqes së vendbanimeve në vit ka qenë përafërsisht 1,3 % në vit. Nëse krahasojmë shtimin e vendbanimeve deri në vitin 2007, vëmë re që në njësinë administrative Bradashesh dhe qytetin e Elbasanit ka më shumë vendbanime të shtuara, ndërsa në njësitë administrative Funarë, Gjinar, Gracen, Labinot Mal, Shirgjan, Tregan dhe Zavalin shtimi më i lartë i vendbanimeve është para viteve '90. Shtimi i vendbanimeve në periudhën 2007-2013 ka pësuar rënie krahasuar me shtimin e vendbanimeve nga viti 1991-2007.

Shtimi i popullsisë përveç rritjes së dendësisë në territoret ekëzistuese, kërkoi shtimin e territoreve të reja në zonën urbane. Krijimi i këtyre zonave të reja ka nevojë për ofrimin e shërbimeve dhe infrastrukturave të nevojshme.

Figura 13. Shtimi i sipërfaqes së ndërtuar 1990 - 2013



	Bradashesh	Elbasan	Funarë	Gjergjan	Gjinar	Gracen	Labinot Fushë	Labinot Mal	Papër	Shirgjan	Shushicë	Tregan	Zavalinë
2008-2013	175 485	407 647	12 877	130 707	40 623	11 445	67 355	37 229	53 158	225 057	172 916	56 877	5 171
Deri në 2007	6 788 216	5 742 482	400 635	1 101 098	255 637	277 517	866 861	334 168	1 522 206	1 271 856	1 361 389	295 891	134 543
Para '90	1 300 040	3 442 757	491 221	1 173 788	1 233 628	580 270	856 991	1 462 225	762 209	1 913 080	1 298 900	914 154	826 803

Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Ashtu siç u theksua më lart, presioni i zhvillimi gjatë periudhës së tranzicionit dhe papërgatitja e institucioneve qendrore dhe vendore për t'iu përgjigjur këtij zhvillimi nëpërmjet planifikimit solli zhvillim të pakontrolluar duke shkaktuar probleme mjedisore si dhe pamundësi për investime private dhe publike. Në vijim do të evidentohen një pjesë e problemeve, potencialeve dhe mundësive të Bashkisë Elbasan nëpërmjet analizave. Mbështetur në këto analiza janë përcaktuar projektet për zhvillimin e territorit të cilat mund të kapitalizohen nga bashkia apo palët private të interesuara që kanë interes të zhvillojnë jetën dhe biznesin e tyre në territor.


1.3.2 Policentrizmi

Shtrirja territoriale, dendësia e banimit, komunikimi për punë e shërbime dhe vazhdimësia e zonës së banuar në dy dekadat e fundit, e kanë klasifikuar Elbasanin (para ndarjes territoriale) si qendër aglomerati[13]. Elbasani, së bashku me katër njësitë vendore që e rrethonin atë para reformës territoriale (Bradashesh, Labinot Fushë, Shirgjan dhe Shushicë) krijojnë aglomeratin e Elbasanit. Të pesta këto njësi përfshihen aktualisht në Bashkinë e Elbasanit (e krijuar nga trembëdhjetë ish-njësi vendore) dhe përmbajnë 79% të popullsisë[14] së bashkisë pas reformës.

Ky lloj zhvillimi territorial, nëse shoqërohet edhe me disa parametra të tjerë morfologjikë e funksionalë (PBB, numri i udhëtarëve me transport publik, numri i studentëve, etj.)

përcakton llojin e modelit policentrik ose jo të territorit përkatës. Studimi i policentrizmit bazohet në rëndësinë e tij si objektiv i BE[15], fillimisht i prezantuar nga nga Perspektiva Evropiane e Zhvillimit Hapësinor (European Spatial Development Perspective-ESDP)[16] dhe më pas i zbërthyer në politikën e Bashkimit Evropian (BE) për zhvillim rajonal, në politikën e transportit, etj. Sipas këtyre dokumenteve, "sistemet policentrike janë më efikase, më të qëndrueshme dhe territorialisht më të balancuara se sa ato monocentrike, apo të shpërhapura" (ESDP, 1999)[17]. Këto sisteme sigurojnë ekonomi të shkallës, kohezion dhe mbrojtje të mjedisit. Për të studiuar policentrizmin në Shqipëri, Co-PLAN u bazua në hartën e 17 aglomerateve shqiptare të INSTAT, duke shtuar edhe informacionin (e prodhuar nga Censusi 2011) mbi lëvizjet ditore për në punë (baseni i punësimit[18]), e duke krijuar zonat funksionale urbane (ZFU).

Figura 14. Zonat Funksionale Urbane në Shqipëri




Burimi: INSTAT, 2011; Përgatit: Co-PLAN, 2015

Shtatë tregues të policentrizmit morfologjik u analizuan për çdo ZFU, dhe 7 tregues të policentrizmit funksional u përshkruan[19]. Treguesit e policentrizmit morfologjik u kombinuan në 3 indekse dhe këto të fundit u kombinuan në indeksin e policentrizmit. Në këtë këndvështrim, Shqipëria është tejet monocentrike sa i përket indeksit të madhësisë (97 nga 100) dhe të lidhshmërisë (72 nga 100), për shkak të përqendrimit të popullsisë dhe PBB-së (Prodhimi i Brendshëm Bruto) në ZFU-në e Tiranës dhe aksesueshmërisë së lartë të ZFU-ve Tiranë e Laç krahasuar me të tjerat. Por Shqipëria është policentrike (28 nga 100) sa i përket indeksit të vendndodhjes për shkak të shpërndarjes thuajse uniforme në të gjithë territorin të 17 qendrave. Pozicionimi i qendrave, edhe pse funksionalisht flasim për nivel të lartë monocentrizmi, është potencial në favor të mbështetjes së një zhvillimi policentrik në nivel vendi dhe duhet shfrytëzuar si i tillë.

ZFU-ja e Elbasanit nuk mbivendoset me ZFU-të fqinje si rezultat i pozicionimit të aglomeratit të saj, të faktit se në qarkun e madh të Elbasanit, kjo bashki është e vetmja qendër urbane/aglomerati sipas klasifikimit të INSTAT, të numrit të madh të bashkive me natyrë/tipologji rurale që e rrethojnë atë dhe të terrenit të thyer që nuk lejon shtrirjen e basenit të punësimit në thellësi të territorit. Kjo ZFU ka popullsi prej rreth 155,969 banorë ose rreth 51% të popullsisë së qarkut të Elbasanit. ZFU-ja zë rreth 60% të territorit të bashkisë, por banorët e Bashkisë së Elbasanit përbëjnë mbi 94% të popullsisë së ZFU-së. Ky fakt dëshmon për një nivel të theksuar monocentrizmi fizik (ai funksional do të zbërthehet në kapitujt në vazhdim të analizës së zhvillimit ekonomik). Nga ana tjetër, nëse shohim hartën e shpërndarjes në territor të vendbanimeve (Figura 12) vihet re se fusha e Cërrikut dhe ajo e Bradasheshit rrethohet nga një unazë lëvizjeje me shumë qendërsi banimi, me një përqendrim të theksuar në qytetin e Elbasanit. Sistemi vendor i vendbanimeve krijon një rrjetë policentrike me potencial të lartë për shkëmbim të funksioneve e shërbimeve, por ende të dobët ekonomikisht dhe nën ndikimin e rrezikut të lartë mjedisor (zona industrial e ish-Kombinatit Metalurgjik, Uzina e Ferrokromit, etj.)

Një tjetër analizë e realizuar është ajo e policentrizmit potencial, e cila tregon mundësinë e një rajoni për të qenë qendër interesi për investime e zhvillim, duke ndryshuar kështu hartën e zhvillimit policentrik e rajonal. Për këtë qëllim, për çdo qendër aglomerati/ZFU-je u vizatua izokroni 45-minutësh (duke bashkuar të gjitha pikat në hartë në të cilat mund të arrihet nga qendra për 45 minuta udhëtim me transport rrugor). Izokroni 45' përcakton hapësirën e lëvizjes së pranueshme ditore vajtje-ardhje për në punë. Çdo bashki është parimisht e interesuar të investojë brenda një hapësire të tillë për të shtuar infrastrukturat dhe shërbimet e për të rritur cilësinë e tyre, në funksion të ekonomisë së shkallës dhe zhvillimit ekonomik. Izokroni 45-minutësh i Elbasanit mbulon pjesën më të madhe të territorit të Elbasanit, shtrihet deri në Gramsh, mbulon thuajse të gjithë Cërrikun e Peqinin (në kufi me qarkun e Fierit) dhe zgjatet përgjatë Shkumbinit deri në Përrenjas. Ky është një nga izokronet me shtrirje më të madhe, por për të njëjtat arsye si për ZFU-në, ka mbivendosje vetëm me izokronin e Lushnjes dhe të Tiranës dhe kjo mbivendosje ndodh jashtë kufijve të Bashkisë së Elbasanit.

Figura 15. Mbivendosja e izokroneve 45'-Zonat e integrimit të mundshëm



Burimi: INSTAT, 2011; Përgatit: Co-PLAN, 2015

Analiza e policentrizmit (aktual e potencial) e paraqet Bashkinë e Elbasanit si një zonë relativisht qendrore nga ana morfologjike (popullsi dhe PBB), por ende periferike nga pikëpamja e policentrizmit potencial. Elbasani ka komunikim ditor të rregullt me Tiranën dhe flukse të konsiderueshme të lëvizjes shtrihen deri në Gramsh e Rrogozhinë, por pengesat natyrore që qëndrojnë mes tij dhe qendrave të tjera të aglomerateve pengojnë fuqizimin e qendërsisë si tipar të kësaj bashkie. Nga ana tjetër, tregues si numrit i studentëve, vlera e shtuar bruto, numri i hoteleve e numri real i lëvizjeve janë në vlera mesatare e të larta, çka përforcon faktin se pozicionimi jo shumë konkurrues (për momentin) mund të thyhet lehtësisht nga interesi i njerëzve për aktivitet ekonomik në Elbasan. Pengesat natyrore po ashtu mund të eliminohen përmes akseve të reja rrugore. Faktikisht, Elbasani ka mundur deri diku të eliminojë "mitin e rrugës" si faktori i vetëm në zhvillim, që do të thotë se investimi në infrastrukturë rrugore mund ta kthejë lehtësisht në një bashki shumë konkurruese edhe përtej rajonit të saj.

1.3.3 Pikat e forta në territor

Territori i Elbasanit përbëhet nga pjesë të ndryshme të cilat e bëjnë këtë bashki më atraktive. Pjesët apo elementët të cilët kanë ndikim më të madh, apo kanë veçori më dalluese, janë elementë të fortë në territor që krijojnë larmishmëri dhe i japin karakter territorit. Këto elemente mund të ndikojnë në formimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të vendbanimeve. Ata mund të shfaqen në forma apo situate që favorizojnë, apo orientojnë zhvillimin, duke

realizuar kështu ndikimin e tyre në territor. Shtrirja e tyre fizike dhe ndikimi në territor mund të jetë pikësor/qëndror (objekte apo elemente natyrore), por edhe në formën e fashave apo të zonave. Elemtët e tillë mund të jenë natyrorë, por edhe artificialë të krijuar nga veprimtaria njerëzore. Bashkia e Elbasanit ka shumë elementë, si natyror dhe artficialë, që paraqesin potenciale në territor, prandaj është i rëndësishëm evidentimi i tyre dhe i ndikimit që ato kanë.

Elementët e fortë natyrorë në bashki kanë të bëjnë me pejsazhin dhe pasuritë e shumta ujore. Këto përbëjnë një potencial interesant turistik, por kanë ndikim edhe në bujqësi apo fusha të tjera të ekonomisë. Ndër to mund të përmendim: Lumin Shkumbin dhe pasuritë e tjera ujore, Bysheku (zonë pjesazhistike), Rrapi Bezistanit, Zona e Llixhave që vizitohen çdo vit nga shumë njerëz, Gurra e Labinotit, Ulliri i qejfit, Gjinari, dhe Tregani janë zona me një bukuri të pasur natyrore dhe potencial të lartë turistik. Një zonë e një rëndësie të veçantë është edhe ajo e Dumresë (në Qarkun e Elbasanit dhe në kufi me Bashkinë me të njëjtin emër), e cila karakterizohet nga 56 liqene me origjine karstike, ku ndër kryesorët përmendim Liqeni i Merhoit, liqeni i Stefanit, Gjoli i degës, Cestijes Cepes, etj. Flora dhe fauna e kësaj zonë karakterizohet nga pyje natyrale, zambakët e liqeneve, shpezët si rosa apo patat, bajzat dhe mbi të gjitha pelikanët që tashmë pothuajse janë në zhdukje. Afërsia që ka kjo zonë me Bashkinë Elbasan sjell ndikim edhe në territorin që po analizojmë.

Elementët artificialë janë po aq të rëndësishëm në mënyrën e ndikimit në territor ashtu si elementët natyrorë. Ato janë krijuar nga veprimtaria njerëzore dhe mbartin edhe pjesën e identitetit kulturor dhe historik të zonës.

Për sa i përket elementeve historike, ajo që ka pasur më shumë ndikim është pikërisht *Via Egnatia*, e cila e ktheu këtë zonë në një pikë mjaft të rëndësishme (urë lidhëse midis Perëndimit dhe Lindjes). Gjithashtu rrugë të tjera bënin lidhjen Veri-Jug, duke e kthyer Elbasanin në një zonë të rëndësishme për kalimin e rrugëve. Për të mbrojtur këto rrugë, të cilat shtriheshin nëpër luginat e lumenjve, u ngritën mjaft fortifikime në majat e kodrave apo maleve, gjurmë të të cilave gjenden edhe sot, të tilla si: Maja e Shën Mërisë dhe Kalaja e Bodinit, Shkambi i Shënlliut, Kulla e Gracenit dhe Kalaja e Valëshit. Vlen të përmendet edhe stacioni *AD-Quintum* në Bradashesh. Fortifikimi të mëvonshme janë: Kalaja e Menglit, Kalaja në Shkëmbin Mbret, Kalaja e Gurit, Kalaja e Malit, Kalaja e Brejës, Kalaja e Valëshit, Kalaja e Kabashisht dhe e Dragotit si edhe Kalaja e Elbasantit, muret e të cilës gjenden në zemër të qytetit të Elbasanit, dhe e bën atë një nga lagjet më të rëndësishme të Elbasnait, e cila i jep karakter qytetit. Të gjitha këto pika të rëndëshishme historike përbëjnë një potencial të rëndësishëm turistik.

Një nga elementët që ka patur një ndikim të madh në identitetin e Bashkisë Elbasan është padyshim ish-Kombinati Metalurgjik, "Çeliku i Partisë", i cili ishte një nga veprat më të rëndësishme industriale në Shqipëri, i realizuar gjatë periudhës së regjimit komunist. Ky kombinat, sëbashku me ndërtime të tjera industrial si psh. Ish-Kombinati i Drurit apo Fabrika e Çimentos i kanë dhënë një karater industrial ekonomisë së Elbasanit. Ndonëse këto mund të përbëjnë një potencial të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë, kanë një ndikim aspakt të mirë në cilësinë e ajrit, tokës dhe ujit.

Pra Elbasani është një zonë mjaft e rëndësishme si nga ana ekonomike, natyrore, kulturore dhe historike. Elementet e rëndësishëm që gjenden në territorin e tij e bjën këtë bashki atraktive dhe i japin identitet qytetit dhe gjithë territorit të bashkisë.

1.4 Analiza e mjedisit dhe e problemeve mjedisore

1.4.1 Metabolizmi i territorit

Analiza e Metabolizmit trajton flukset në territor/qytet urban. Sipas Nenit 2 të VKM nr. 671 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", metabolizmi i territorit është një model që përdoret për identifikimin dhe analizën e flukseve të materialeve dhe energjisë brenda territoreve të caktuara. Ky model u ofron studiuesve një kuadër nëpërmjet të cilit të studiojnë ndërveprimet e sistemeve natyrore dhe njerëzore në rajone të caktuara. Flukset e analizuara janë: Fluksi i energjisë, fluksi i ujit, fluksi i ushqimit dhe fluksi i mbetjeve. Flukset analizohen nëpërmjet identifikimit të hyrjeve dhe daljeve për secilin fluks që merret në analizim. Hyrjet dhe daljet e secilit fluks krijojnë një tablo të plotë të mënyrës së funksionimit të territorit, duke evidentuar potencialet dhe burimet që e bëjnë territorin të funksionojë si një i tërë. Fluksi i energjisë dhe fluksi i ujit do të analizohen si fillim në nivel rajoni dhe më pas në nivel bashkie. Burimet e energjisë kanë ndikim dhe menaxhohen në rang kombëtar, pavarësisht territorit ku ndodhen. Uji që gjendet në një sistemin urban (uji që analizon fluksi i ujit), vjen nëpërmjet burimeve nëntokësore (që nuk i përkasin territorit të një bashkie nga ana administrative) apo burimeve sipërfaqësore, duke kaluar në disa sisteme të ndryshme urbane. Në këtë rast, kur kalon në sisteme të ndryshme urbane (rasti i lumenjve), sjell me vete edhe ndotje që merr gjatë rrugës. Burimet ujore, menaxhohen në nivel baseni ujëmbledhës dhe në nivel kombëtar.

- **Energjia në Rajon**

Rajon që përbëhet nga bashkitë: Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Lushnje, Peqin, Belsh, Cërrik, Patos, Mallakastër, Ura Vajgurore, Kuçovë, Berat, Gramsh, Elbasan, Përrenjas, Librazhd, Pogradec[20], ka burime të shumta energjie. Pjesa kryesore e energjisë që përftohet nga hidrokarburet në Shqipëri është e përqendruar në këtë zonë. Kompanitë që operojnë në këtë territor për nxjerrjen e naftës janë: ***Bankers*** (Patos-Marinëz), ***TransAtlatic*** (Ballsh, Cakran, Gorisht, Delvinë), ***Sherwood*** (Kuçovë), ***Transoilgroup*** (Visokë); ***Phoenix*** (Amonicë). Energjia e hidrokarbureve zë pjesë të rëndësishme. Po ashtu, energjia hidrike vazhdon të mbetet një nga burimet kryesore e energjisë.

Lumenj si Shkumbin, Osumi, Devolli përdoren për prodhimin e energjisë hidrike nëpërmjet hidrocentraleve të instaluar dhe atyre që po ndërtohen. Energjia hidrike, vazhdon të mbetet burim kryesor energjie për konsumatorët familjarë por edhe për bizneset industritë apo institucionet.


Burimet alternative të energjisë si dielli, era, energjia gjeotermale shfrytëzohen shumë pak. Potencialet që ka për t'u përdorur këto energji janë të mëdha. Energjia e erës ka potencial të përdoret në ultësirën perëndimore, Divjaka, Rrogozhina dhe Fieri (zona veri-perëndimore) mund të përdoret për prodhimin e energjisë.

Energjia diellore është potencial thuajse në të gjithë pjesën perëndimore të Shqipërisë. Rrezatimi arrin vlera nga 1,450 kwh/m² deri në 1,650 kwh/m² [21]. Numri i lartë i ditëve me diell është i favorshëm për prodhimin e energjisë diellore.

Energjia gjeotermale mund të shfrytëzohet nëpërmjet burimeve gjeotermale. Në Elbasan gjenden burime gjeotermale, temperatura e të cilëve arrin >80 °C. Përdorimi i kësaj energjie përveç efekteve pozitive, ka ndikim në mjedis dhe ekosistem, por nëse përdoren teknologjitë e duhura këto pasoja janë minimale. Nga përdorimi i energjisë gjeotermale

efektet më të shpeshta negative janë ndotja e ajrit (nga gazërat që çlirohen) dhe ndotja e tokës.

Figura 16. Harta e fluksit të energjisë në rajon




[22]Burimi: Co-PLAN dhe PLGP, 2015

- **Uji në Rajon**

Rajoni është i pasur më ujëra nëntokësore dhe sipërfaqësore. Ky territor përshkohet nga lumenj të rëndësishëm si Shkumbini, Seman, Devolli, Osumi, Vjosa dhe lumenj të më të vegjël. Pasuritë e mëdha ujore bëjnë që shfrytëzimi i tyre të jetë i lartë, në këtë zonë janë propozuar të ndërtohen pjesa më e madhe e HEC-eve

Shtresat nëntokësore ujëmbajtëse, akuifere ndërkokrrizore me përcjellshmëri të lartë uji, të cilat dallohen për një cilësi të lartë të ujërave nëntokësore, gjenden kryesisht në pjesën verilindore të këtij territori. Këto shtresa shfrytëzohen nëpërmjet burimeve për ujë të pijshëm apo përdorime të tjera. Shtresat nëntokësore, akuifere me porozitet karst-çarje dhe përcjellshmëri uji shumë të ndryshueshme shumë të lartë e të lartë, gjenden në zona të zhvilluara si qyteti i Elbasanit, qyteti i Kuçovës (zona urbane) dhe në pjesën jugperëndimore të Bashkisë Fier. Këto shtresa nëntokësore janë cenuara nga ndotja. Puset e përqendruara kryesisht në akuiferet karst-çarje ndikojnë në përçimin e ndotjes në shtresat nëntokësore.

Figura 17. Harta e fluksit të ujit në rajon (ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore)



[23]Burimi: Co-PLAN dhe PLGP, 2015

- **Analiza e Metabolizmit në Bashkinë Elbasan**

Analiza e metabolizmit të territorit në Bashkinë e Elbasanit merr në konsideratë disa faktorë kryesorë, që ndikojnë në flukset e energjisë, ujit, ushqimit dhe mbetjeve. Elbasani ka në sipërfaqe prej 872 m² dhe popullsi 144,382 banorë[24]. Flukset e analizuara në kuadër të analizës së metabolizmit janë: energjia, uji, ushqimi dhe mbetjet. Analizimi për secilën rrymë ndjek të njëjtën metodologji në parim, por për shkak të mungesës së informacioneve të caktuara, analiza pëson modifikime nga fluksi në fluks. Për të analizuar flukset janë vëzhguar hyrjet dhe daljet për secilin fluks, me qëllim të kuptuarin e problemeve mjedisore dhe humbjeve.

- **Fluksi i energjisë**

Fluksi i energjisë tregon sasinë e prodhuar dhe konsumin e energjisë në territorin e Bashkisë Elbasan. Ky fluks tregon edhe për energjinë potenciale që mund të përdoret, duke minimizuar në këtë mënyrë disa burime energjie të cilat kanë konsum më të lartë duke minimizuar në këtë mënyrë disa burime energjie të cilat janë të mbishfrytëzuara.

Potencialet energjetike dhe prodhimi i energjisë në territorin e Bashkisë Elbasan

Territori i Elbasanit shtrihet në një zonë me pasuri ujore, sipërfaqësore dhe nëntokësore. Për këtë arsye ka dhe një shfrytëzim të lartë të ujërave të lumenjve për prodhimin e energjisë hidrike. Gjithashtu, parashikohet që mbi Lumin Shkumbin të ndërtohen hidrocentrale të vegjël (>1MW) dhe hidrocentrale të mëdhenj (<50MW), që do të rrisin më shumë nivelin e shfrytëzimit të ujërave sipërfaqësore. Por prodhimi i energjisë nuk duhet kufizuar vetëm në energji hidrike, sepse ka potencial për t'u mbështetur edhe në energji të tjera alternative.

Elbasani ka potencial për të prodhuar energji gjeotermale, pasi në territorin e kësaj bashkie gjenden burimet termale të Kozani-8 dhe burimet e Lixhave të Treganit.

Territori i Elbasanit është pjesë e zonës gjeotermale Kruja, e cila shtrihet në rreth 180km dhe ka një gjerësi 4-5 km. Pusi Kozani-8, shtrihet 8km në veriperëndim të Elbasanit. Temperature e ujit që del nga një horizont në thellësinë 1,816-1,837m ka temperaturë që arrin deri në 80^0C. Fuqia që mund të insalohet është 2,070kW. Prurjet e përgjithshme janë 10.31l/sek, ndërsa faktori i kapacitetit termik 1.93 MWt. Burimet termale të Lixhave të Treganit kanë temperaturë dhe debite të larta, $(55\text{-}60)^0$C dhe prurje të përgjithshme përkatësisht 15 dhe 18 l/sek. (Frashëri, Çermak et al., 2004)[25].

Shqipëria ka një rrezatim diellor të konsiderueshëm për t'u përdorur si burim energjie. Elbasani ndodhet ndërmjet izolinjave 1,450-1,550 kW/m² në vit. Shpërndarja e mesatares ditore për rrezatimin global në stacionin meteorologjik të Elbasanit luhatet nga 1,615 në muaj (dhjetor) deri në 6,520 në muaj (korrik)[26]. Energjia diellore shfrytëzohet në nivel kombëtar 0.1% dhe shfrytëzohet për prodhimi e ujit të ngrohtë sanitar dhe në mënyrë individual me panele fotovoltaike[27].

Konsumi i energjisë dhe lloji i energjisë së përdorur për ngrohje

Energjia elektrike është një nga burimet primare të energjisë në Shqipëri. Për të llogaritur konsumin e energjisë për familje/vit jemi mbështetur mbi të dhënat e INSTAT, Censusi 2011 (Grid). Duke iu referuar numrit të banorëve që gjenden për çdo km² në të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan[28] dhe duke marrë parasysh që konsumi total i energjisë elektrike në Shqipëri për vitin 2011, është 2,587,907 MWh, mund të llogarisim sa energji elektrike konsumon mesatarisht një familje në vit.

Për vitin 2011, sipas INSTAT, numri mesatar i personave në një familje është përafërsisht 4 anëtarë. Numri i Njësive Ekonomike Familjare është **722, 600 familje** (Tabela 2). Konsumi mesatar i energjisë elektrike për familje në një vit është: Konsumi i energjisë elektrike nga familjet **(2,587,535)**/nr. e familjeve **(722, 600)** = Energjia elektrike që konsumon një familje për një vit **(3.6 MWh).** Për të gjeneruar energjinë e konsumuar për çdo km², shumëzojmë nr. e familjeve në atë sipërfaqe me vlerën mesatare vjetore të konsumit të energjisë elektrike.

Tabela 2. Rezultatet e Censusit të Popullsisë dhe banesave 2011

Popullsia banuese gjithsej	**2 821 977**
Numri gjithsej i Njësive Ekonomike Familjare	**722 600**


Burimi: INSTAT, 2011 (Censusi) dhe përpunime të autorëve

Tabela 3. Bilanci i Energjisë Elektrike, 2011

Emërtimi	**Energjia (MWh)**
Energji në dispozicion (Burimet)	**7,532,055**
Prodhimi neto vendas	4,057,089
Termocentrale	0
Hidrocentrale	4,057,089
Importi bruto (energji në marrje)	3,474,966
Eksporti bruto (energji në dhënie)	300,544
Konsumi i energjisë elektrike	**7,210,731**
Humbjet në rrjet	2,179,157
Familjet	**2,587,907**
Të tjera	2,443,667

Burimi: 2011 Censusi, INSTAT

Figura 18. Fluksi i energjisë në Bashkinë Elbasan



[29]Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Një sasi e konsiderueshme e energjisë së konsumuar shkon për ngrohje. Sipas të dhënave të INSTAT, burimi kryesor i energjisë së përdorur për ngrohje në qarkun Elbasan, nga njësi ekonomike familjare (NjEF), vazhdon të jetë energjia e përftuar nga drutë e zjarrit. 77% të NjEF-ve në qarkun Elbasan përdorin drutë e zjarrit për t'u ngrohur, ndjekur nga gazi (13%) dhe më pas nga energjia elektrike (7%)[30].


Tabela 4. Njësitë Ekonomike Familjare sipas llojit kryesor të energjisë së përdorur për ngrohjen e zonës urbane dhe rurale

ELBASAN

Lloji kryesor i energjisë së përdorur për ngrohje	Zona urbane dhe rurale		
	Gjithsej	Urbane	Rurale
Gjithsej	73,044	31,564	41,480
Dru	56,004	15,750	40,254
Energji elektrike nga rrjeti	4,883	4,646	237
Gaz	9,655	9,095	560
Lloj tjetër energjie(panel diellor, qymyr, naftë, etj.)	203	125	78
Pa ngrohje	2,299	1,948	351

Burimi: 2011 Censusi, INSTAT

Figura 19. Njësitë Ekonomike Familjare sipas llojit kryesor të energjisë së përdorur për ngrohjen e zonës urbane dhe rurale



Burimi: INSTAT, 2011 dhe përpunime të autorëve

- **Fluksi i ujit**

Fluksi i ujit tregon për bilancin e prodhimit të ujit nga burime sipërfaqësore dhe nëntokësore në territorin e Bashkisë Elbasan dhe sasinë e konsumit të tij. Uji përdoret për qëllime teknologjike, për pirje, *imbotilim (uji i mbushur në shishe)*, shpërndarje nëpërmjet rrjetit të ujësjellësit dhe përdorim nga banorët, bizneset, industritë, institucionet etj. Për të bërë një llogaritje të përafërt të sasisë së ujit që ndodhet në organizmin urban (në këtë rast,

territorin e Bashkisë Elbasan) mund të marrim sasinë totale të ujërave në territor (burime sipërfaqësore dhe nëntokësore) dhe sasinë e përdorimit të ujërave. Sasia ujërave nëntokësore llogaritet nga burimet që shfrytëzohen në territor[31].

Qyteti, zona industriale, zona ekonomike dhe tokat bujqësore, ku ndodhin zhvillimet më të mëdha shtrihen mbi shtresa nëntokësore ujëmbajtëse.


Ujërat sipërfaqësore zënë një sipërfaqe prej 22.7 km² në të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan[32]. Në ujërat sipërfaqësore të Elbasanit bëjnë pjesë lumenjtë Shkumbin, Zaranika, Papër, përrenjtë dhe degëzimet e tyre si dhe të gjitha kanalet ujitëse.

Territori i Elbasanit është i pasur me ujëra nëntokësore. Qyteti i Elbasanit, zonat ekonomike dhe industriale shtrihen mbi akuiferë me porozitet ndërkokrrizore dhe përcjellshmëri uji shumë të lartë-të lartë. Burimet e ujërave nëntokësore ndodhen kryesisht në këto shtresa nëntokësore. Edhe shpimet janë bërë në këto shtresa. Sasia e ujit që shfrytëzohet nga burimet ujore është 1441.1-2080.09 l/sek. (Harta Hidrografike, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar - SHGJSH)[33].

Për të kuptuar përdorimin e ujit nga qytetarët dhe bizneset, i referohemi studimit të sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe të largimit të ujërave të zeza. Nga të dhënat e marra nga ndërmarrja e ujësjellës-kanalizimeve, Bashkia e Elbasanit ka mbulim të mirë të shërbimit të ujësjellësit[34]. Të gjitha njësive administrative iu ofrohet shërbimi i ujësjellësit, përveç njësisë Funar, e cila nuk mbulohet me shërbimin e ujësjellësit. Në zonat që nuk ofrohet shërbimi i ujësjellësit, banorët e sigurojnë ujin nëpërmjet puseve individuale, burimeve ose krojeve malore. Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm UK Elbasan sha[35], shfrytëzon tre pellgje ujëmbajtëse nëntokësore, në Mengel, Krastë e Vogël dhe Frigoriferi. Sasia totale e ujit që shfrytëzohet nga këto pellgje është 910 l/sek, ku pellgu ujëmbajtës Mengel shfrytëzohet 63% (280 l/sek), pellgu ujëmbajtës Mengel shfrytëzohet 107% (385 l/sek) dhe pellgu ujëmbledhës Krasta e vogël shfrytëzohet 68% (325 l/sek)[36].

Për të llogaritur konsumin e ujit të pijshëm në nivel bashkie jemi mbështetur në të dhënat UK Elbasan dhe në të dhënat e INSTAT, Censusi 2011 (Grid) për popullsinë, numrin e banorëve për çdo km² në të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan. Konsumi mesatar ditorë i ujit të pijshëm për konsumatorët familjarë (banorë) është 100 litra/banorë/ditë[37].

Figura 20. Fluksi i ujit në Bashkinë Elbasan



[38]Burimi: Bashkia Elbasan, Valu ADD dhe Co-PLAN, 2015

- **Fluksi i ushqimit**


Fluksi i ushqimit analizon të dhënat për importin, prodhimin, përpunimin, konsumin, humbjen dhe eksportin e ushqimeve. Për sa i përket fluksit të ushqimit në Bashkinë Elbasan, analizojmë të dhënat bujqësore dhe blegtorale, që prodhohen në territor, pasi zënë një peshë kryesore në fluksin e ushqimit. Importet realizohen në nivel kombëtar dhe nuk ka shifra të sakta për përthithjen e tyre në nivel vendor. Të dhënat për përthithjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale janë në nivel qarku. Në këtë rast për të llogaritur fluksin e ushqimit mund të fokusohemi më tepër në të dhënat mbi produktet bujqësore dhe blegtorale si dhe infrastrukturat ndihmëse, siç janë pikat e grumbullimit dhe të përpunimit të këtyre produkteve, sasinë e produkteve që shkon në treg dhe sasinë e produkteve që shkon për eksport. Sipas të dhënave të Bashkisë Elbasan, në territorin e kësaj bashkie prodhohen bujqësore (kryesisht drufrutorë) dhe blegtorale që ndikojnë në zhvillimin ekonomik[39].

Tabela 5. Fluksi i ushqimit, prodhimet bujqësore dhe blegtorale në Bashkinë Elbasan

Përbërës Niveli I		Përbërës Niveli II	Prodhim	Njësia hapësinore	Burimi i të dhënave
Prodhim Bimor	Prodhimet e arave	Drithëra (ton)	6,490	Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan
		Perime (ton)	15,613	Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan
		Patate (ton)	4,833	Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan
		Fasule (ton)	583	Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan
		Bimë industriale (ton)	1,269	Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan
		Foragjere (ton)	107,125	Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan
	Prodhime në serra	Perime (ton)		Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan
	Drufrutorë	Pemë frutore (ton)	5,864	Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan
		Ullinj (ton)	1,899	Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan
		Agrume (ton)	985	Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan
		Rrush gjithsej(ton)	784	Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan
Prodhimi blegtoral	Prodhim blegtoral	Qumësht (ton)	50,212	Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan
		Mish (gjedhi, derri, shpendësh, ruminantësh të vegjël) (ton)	2,425	Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan
		Lesh (ton)		Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan
		Vezë (kokrra)	15,340,000	Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan
		Mjaltë (ton)	261	Bashkia Elbasan (61_njësi)	Bashkia Elbasan

Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Figura 21. Fluksi i ushqimit në Bashkinë Elbasan



[40]Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Toka bujqësore në Bashkinë Elbasan zë një sipërfaqe prej 17,600 ha, ndërsa zona natyrore, e cila mund të përdoret për mbjelljen e pemëve frutore, zë një sipërfaqe prej 62,900 ha[41]. Kjo tregon që Bashkia Elbasan ka territor të përshtatshëm për kultivimin e pemëve frutore dhe të perimeve të ndryshme.


Për të llogaritur fluksin e ushqimit janë përdorur të dhënat të INSTAT (prodhimet) dhe të dhënat e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit dhe Administrimit të ujërave (sasia që shkon në treg dhe eksport). Fluksi i ushqimit është realizuar vetëm për disa kultura, pasi të dhënat nuk janë të plota dhe nuk mund të kuptohen hyrjet dhe daljet. Sasia e produkteve që konsumohet (treg dhe eksport) është më e lartë se sasia e produkteve që prodhohen në territorin e Bashkisë Elbasan. Kjo ndodh sepse një pjesë e produkteve që konsumohen nuk prodhohen në territorin e Elbasanit. Arsye tjetër është se burimi i të dhënave është i ndryshëm. Prodhimet janë përcaktuar nga INSTAT, ndërsa të dhënat për treg dhe eksport janë marrë nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

Tabela 6. Prodhimet dhe konsumi (treg dhe eksport) për Qarkun e Elbasan

			HYRJE	POTENCIALET PRODHUESE	
Përbërës Niveli I		**Përbërës Niveli II**	**Prodhim**	**Treg**	**Eksport**
Prodhim Bimor	Prodhimet e arave	Drithëra (ton)	93,095		
		Perime (ton)	75,165	500,128	31,560
		Patate (ton)	31,756		
		Fasule (ton)	4,509		
		Bimë industrial (ton)	2,007		
		Foragjere (ton)	666,154		
	Prodhime në serra	Perime (ton)	5,522	56,924	13,170
	Drufrutorë	Pemë frutore (ton)	28,470	209,821	15,210
		Ullinj (ton)	14,833	60,960	1,850
		Agrume (ton)	1,666	15,370	260
		Rrush gjithsej (ton)	25,492	218,940	5,600
Prodhimi Blegtoral	Prodhim blegtoral	Qumësht (ton)	142,254	177,361	300,432
		Mish (gjedhi, derri, shpendësh, ruminantësh të vegjël) (ton)	17,100	33,818	-
		Lesh (ton)	391		
		Vezë (kokrra)	77,559,272	46,318,000	-
		Mjaltë (ton)	329	2,212	-


Burimi: INSTAT (Prodhimi) dhe MBZHRAU (Treg dhe Eksport) 2014, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Figura 22. Prodhimet Bujqësore (në kton), Bashkia Elbasan 2014




Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Figura 23. Prodhimet bujqësore në vitin 2014 (në kton), në Bashkitë: Elbasan, Lushnje, Fier, Berat dhe Kuçovë




Burimi: Bashkia Elbasan, Bashkia Fier, Bashkia Berat, Bashkia Lushnje, Bashkia Kuçovë, Përpunoi: Co-PLAN, 2015

Figura 24. Prodhimet bujqësore për periudhën 2012-2013-2014 (në kton), Qarku Elbasan




Burimi: INSTAT 2014, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Figura 25. Prodhimet bujqësore në vitin 2014 (në kton), në Qarkun: Elbasan, Fier dhe Berat




Burimi: INSTAT 2014, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Figura 26. Prodhimet blegtorale (në kton), Bashkia Elbasan 2014



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Figura 27. Prodhimet blegtorale në vitin 2014 (në kton), në Bashkitë: Elbasan, Lushnje, Fier, Berat dhe Kuçovë



Burimi: Bashkia Elbasan, Bashkia Fier, Bashkia Berat, Bashkia Lushnje, Bashkia Kuçovë, Përpunoi: Co-PLAN, 2015

- **Fluksi i mbetjeve**

Fluksi i mbetjeve analizon sasinë e mbetjeve që importohen, prodhohen, riciklohen dhe përpunohen. Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve urbane ofrohet për territorin e qytetit (Bashkia e Elbasanit para ndarjes territoriale). Edhe në këtë territor shërbimi ofrohen në nivelin 60-70%. Vend depozitimi i mbetjeve në Elbasan ndodhet 75 m larg brigjeve të Lumit Shkumbin në pjesën jugore të qytetit. Ky vend depozitim është klasifikuar si jo sanitar, mbetjet të cilat depozitohen aty janë mbetje të ngurta urbane, por edhe mbetjet të ngurta.


Në territorin e Bashkisë së Elbasan operojnë gjashtë kompani ricikluese. Kompania GDS sh.p.k operon në diferencimin dhe grumbullimin e mbetjeve të paketimit. Kompania KURUM, e cila ndodhet në Bradashesh, dhe Kompania Larti sh.p.k, riciklojnë metale. Një tjetër kompani, Gold Plus sh.p.k, grumbullon skrap. Në Bashkinë Elbasan operojnë edhe kompani për riciklimin e vajrave dhe nënprodukteve të tyre, Impuls-95 sh.p.k. dhe kompania Dritan Elezi, për përpunimin e mbetjeve të ndërtimit[42].

Për të llogaritur gjenerimin e mbetjeve urbane në territorin e Bashkisë Elbasan, jemi mbështetur sërish në rrjetin e INSTAT për të dhënat e popullsisë në çdo km². Sasia mesatare e mbetjeve që gjeneron një person në ditë është 0.7 kg[43]. Sasia më e madhe e mbetjeve të gjeneruara ndodh normalisht në zonat më të populluara, siç është qyteti i Elbasanit. Sasia e gjeneruar në zonën urbane të qytetit të Elbasanit arrin në vlerën 1,604-3,197 ton/vit për km².

Ndotja që iu shkaktohet ujërave nëntokësore nga mbetjet urbane është e lartë për shkak të depërtimit të lëngut të ndotur të mbetjeve nga vend depozitimi (jo sanitar) i vendosur pranë shtratit të lumit, pra në zonën ku akuiferi afrohet maksimalisht me sipërfaqen e tokës. Po ashtu, shpimet për puse dhe gropa septike në territor ulin nivelin e filtrimit të ndotjes para mbërritjes në shtresat nëntokësore dhe rritin ndotjen në ujërat nëntokësore.

Riciklimi i mbetjeve bashkiake (organike, druri, letre, kartoni, LD plastike, HD plastike, qelqi, produkte kauçuku) në territorin e Bashkisë Elbasan është përafërsisht 75 %, ndër të cilat peshën më të madhe e zënë mbetjet organike me 46.5%, 14.3% plastika dhe 13.4% letra. Procesi i riciklimit është i komplikuar për arsye se mbetjet nuk ndahen që në burim dhe nuk ka stimuj për realizimin e këtij procesi[44].

Figura 28. Fluksi i mbetjeve në Bashkinë Elbasan



[45]Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015


1.4.2 Mjedisi

- **Kushtet Gjeomorfologjike të territorit**

Njësitë gjeomorfologjike të territorit[46]

Sipërfaqja totale e Bashkisë Elbasan është 872 km². Territori i Bashkisë së re të Elbasanit dallohet për një relievi të larmishëm fushor, kodrinor dhe malor (Figura 29). *Njësia morfologjike fushore* shtrihet në një sipërfaqe të kufizuar, kryesisht përgjatë luginës së lumit Shkumbin. Siç ndodh në luginat e lumenjve, origjina e kësaj njësie fushore është kryesisht aluviale (prurje të dherave nga lumi) dhe gjerësia e saj arrin nga 1.5– 2km. Në këtë zonë shtrihet Fusha e Elbasanit dhe fushat përreth, të cilat përshkohen nga një rrjet i dendur kanalesh kulluese e vaditëse, si dhe nga përrenj fushorë të cilët derdhen në shtratin e lumit Shkumbin. Kjo zonë prek kryesisht Qytetin e Elbasanit dhe NjA-të Shirgjan, Gjergjan, Labinot Fushë, Bradashesh, dhe Papër. Drejtimi i rrjedhës së tij është nga lindja dhe juglindja në drejtim të perëndimit e veriperëndimit. Ky lumë, dhe në tërësi lumenjtë e Shqipërisë, në kohë shirash të bollshëm dalin nga shtretërit e tyre dhe përmbytin tokat bujqësore ku ata kalojnë.

Figura 29. Relievi në Bashkinë Elbasan



Burimi: SHGJSH, Bashkia Elbasan, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Njësia morfologjike kodrinore shtrihet në pjesën jug-perëndimore, perëndimore dhe veri-perëndimore të Bashkisë. Lartësia e kësaj zone arrin nga 10 deri në 700m mbi nivelin e detit dhe përfshin brezin e kodrave në jugperëndim-perëndim të rajonit të Elbasanit. Shpatet e kodrave e kodrinave të kësaj njësie morfologjike kanë pjerrësi nga 5 deri në 350 dhe drejtim-rënie të ndryshme. Shpatet shpesh janë të rrumbullakosur nga modelimi, i shkaktuar nga rrjedhjet ujore sipërfaqësore. Është pikërisht kjo njësi morfologjike e cila është prekur së tepërmi nga erozioni dhe fenomene shpati të tipit rrëshqitje të dherave. *Njësia morfologjike malore*zë pjesën lindore, veri-perëndimore në formë të një harku me dalje në drejtim të rrjedhës së lumit Shkumbin. Lartësitë më të theksuara gjenden në Zavalinë, Gjinar, Shushicë në jug dhe Labinot Mal e Funar në zonën veriore. Format morfologjike të kësaj njësie varen shumë nga përbërja litologjike e shkëmbinjve rrënjësore dhe në përgjithësi janë forma morfologjike të përcaktuara nga shkëputjet tektonike dhe format morfologjike karstike. Këto të fundit ndodhen gjenden në gëlqerorët e Prrenjasit - Qafë Thanë. Në këtë njësi morfologjike shpatet kanë pjerrësi nga 200 deri në vertikale. Në këto shpate shfaqen më së shumti fenomeni i rrëzimeve, por edhe ai i rrëshqitjeve shkëmbore. Shpatet përshkohen nga përrenj e përroska, të cilat në përgjithësi kanë karakter sezonal. Në përgjithësi, kjo njësi morfologjike është e pyllëzuar.

Zonimi Gjeoteknik i Shqipërisë

Relievi i larmishëm i vendit tonë me njësi fushore, kodrinore dhe malore krijon një peizazh natyror tërheqës dhe njëkohësisht, edhe të prirur ndaj rreziqeve natyrore për vetë përbërjen e tij. Si rezultat, në varësi të relievit, territori në vend dallohet për nivele të ndryshme qëndrueshmërie. Përveç një sipërfaqeje e cila zë rreth 10% të territorit kombëtar që është e qëndrueshme, pjesa tjetër e tokës është e paqëndrueshme. Kjo e


fundit shprehet nëpërmjet formave të ndryshme që SHGJSH i ka klasifikuar si më poshtë[47]:

- *Rënie shkëmbinjsh* (kryesisht në zona malore (në Alpe) dhe shpate gëlqerorë të zbuluara
- *Shembje* (kryesisht në zonat malore)
- *Rrëshqitje me rrokullisje* (në shpate me shkëmbinjve rreshporë ose molasës deltinore dhe shpatet prej konglomerati me pjerrësi > 45°dhe shpateve me drejtim të kundërt).
- *Rrëshqitje me zhvendosje* (prek shkëmbinjtë e fortë gëlqerorë ose shtresa rreshpore)
- *Rrjedhje, sidomos ato sipërfaqësore, në trajtën e laharëve* (në zonat malore të Shqipërisë me reshje vjetore 200mm, luginat me përrenj me pjerrësi të madhe (Elbasan, Përmet, Korçë etj.)

Duke u bazuar në karakteristikat e territorit lidhur me fenomenet e rrezikut gjeomorfologjik, SHGJSH ka përcaktuar zonimin gjeoteknik të Shqipërisë, sipas të cilit territori i vendit tonë ndahet në tre zona të qëndrueshmërisë natyrore (Figura mëposhtë)[48]:

- *Terrene të qëndrueshme* që mbulojnë 56.6% të vendit. Gjenden kryesisht në zona me shkëmbinj magmatikë efuzivë dhe intruzivë, gëlqerorë të epokave të ndryshme, dolomite, brecke dhe konglomerate me cimentin karbonatik, shkëmbinj metamorfikë dhe rreshpe. Brenda zonës njihen fenomenet e shkëputjes së blloqeve, rrëshqitjes e rrokullisje dhe/ose zhvendosjes.
- *Terrene relativisht të qëndrueshme*, që mbulojnë rreth 33.6% të territorit. Gjenden kryesisht në zona me përbërje shkëmbore konglomeratikë të suitës Luma, efuzivë sedimentarë, shkëmbinjve rreshporë, shkëmbinjëve evaporitë dhe molasave të konglomerateve ranore. Këto zona dallohen për rrëshqitje, ose rënie të tavaneve në zgavrat e nëndheshme
- *Terrene të paqëndrueshme* që zënë rrreth 9.8% të sipërfaqes së vendit. Këto janë terrene me përbërje të ndryshme shistesh, molasash e konglomeratësh ranore. Dallohen për rrëshqitjet rrokullisëse dhe me zhvendosje, si dhe për rrjedhjet e tokës.

Figura 30. Zonimi gjeoteknik i Shqipërisë



Burimi: PNUD[49], Shërbimi Gjeologjik Shqiptar[50], Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Në Bashkinë Elbasan, terreni është relativisht i qëndrueshëm në zonën qëndrore dhe jugperëndimore, me shkëmbinj magmatikë të lidhur në zonën e NJA-së Zavalinë, Shushicë dhe Labinot Mal, dhe i paqëndrueshëm në zonën veriore, e cila i përket territorit të NJA-ve Gracen, Bradashesh, Labinot Fushë, Funarë dhe Labinot Mal.

Rrëshqitja/ Rrëzimi i gurëve[51]

Rrëshqitjet e dheut janë një fenomen mjaft i përhapur në Qarkun e Elbasanit dhe në Bashki. Deri më sot, në rang qarku janë numëruar rreth 120 rrëshqitje (figura mëposhtë). Bazuar në hartën e zonimit gjeoteknik të Bashkisë, ky fenomen është i përhapur kryesisht në zonën ndërmjet Përroit të Zaranikës e Godoleshit, afër Majës së Munellës dhe në Pashtresh.Rrëshqitjet janë një fenomen shumë i zhvilluar dhe i përhapur në qark, për vetë përbërjen dhe karakteristikat fiziko-mekanike të formacioneve gjeologjike që dalin në qarkun e Elbasanit. Sipas SHGJSH-së, pothuajse rreth 85-90 % e tyre bien në flishe dhe 10-15% e rrëshqitjeve bien në shpate me formim tjetër gjeologo-litologjik.

Shkaqet kryesore të rrëshqitjeve [52] përfshijnë faktorë natyrorë gjeologjikë (ndërtimi gjeologji-klitologjia, pjerrësia e shpatit mbi 5-20°, struktura, tektonika, zona ose shpate që nuk rrihen nga dielli ku lagështira e vazhdueshme ka shkaktuar rrëshqitje. etj) dhe faktorë të jashtëm (përmbajtja e lartë e ujërave nëntokësore, rreshjet e dendura të shiut, ndërhyrjet e njeriut me ndërtime të ndryshme etj.). Kohët e fundit, rrëshqitjet janë theksuar për shkak të shpyllëzimeve të shumta. Shpeshherë, tokat pyjore janë shndërruar në bujqësore duke prishur kështu ekuilibrin natyror.

Figura 31. Rrëshqitjet në Bashkinë Elbasan



Burimi: SHGJSH, 2014, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Sipas studimeve të SHGJSH-së, Zona e Elbasanit[53] preket edhe nga ***rrjedhjet*** (rrjedhë tokë dhe rrjedhë shkëmbinjsh). Rrjedhat në sipërfaqe, në trajtën e laharëve (rrymave të baltës nga grimca të ngurta të paqëndrueshme të shpatit, që bëhen të rrjedhshme prej ujërave të përrenjve gjatë shtrëngatave të rënda me shi) mund të barten dhjetra kilometra larg. Rrëshqitjet dhe zhvendosjet mund të marrin formën e rreshqitjes së shkëmbinjve, rrëshqitjes së tokës dhe rrëshqitjes së blloqeve të dheut, fenomene që ndodhin kryesisht në zonën tektonike të *Krastë-Cukalit*[54]. Në zonat e paqëndrueshme të paraqitura në hartën e zonimit gjeoteknik të bashkisë më sipër, zonat e paqëndrueshme të territorit përbëhen nga lloje të ndryshme shistesh, molasash dhe në një përmasë më të vogël prej konglomeratesh ranore[55]. Për këto zona janë karakteristike rrëshqitjet rrokullitëse e me bartje, si dhe rrjedhje të tjera të tokës. Ndërhyrjet e njeriut kanë ndikim të fortë në prishjen e ekuilibrit tejet të brishtë në këto zona.[56]

Rrëzimet e gurëve ndodhin në zonat malore me shpate pjerrësia e të cilëve i kalon 75° sipas literaturës së shfrytëzuar deri më sot, dhe ku kemi vendosje të shkëmbinjve më të fortë mbi ata më të butë në profilin e shpatit, por edhe në shkëmbinj flishorë ky fenomen është shumë i zhvilluar. Situata të tilla pothuaj janë të shumta në zonat "Krujë", "Krastë-Cukal" dhe "Mirditë". Ky fenomen ndihmohet edhe nga zhvillimi i madh i tektonikave bllokore dhe ndrydhëse, të cilat e kanë copëtuar së tepërmi bazamentin shkëmbor si të territorit të Republikës së Shqipërisë ashtu dhe të qarkut si pjesë integrale e tij[57].


Erozioni dhe Vatrat e Erozionit

Erozioni mbetet një ndër problematikat kryesore pothuajse në të gjithë botën dhe, sigurisht, edhe në vendin tonë. Vetëm gjatë gjysmës së dytë të Shekullit të XX është llogaritur se

degradimi i tokës për shkak të erozionit ka përfshirë rreth 43% (ose 5 billion ha) të territorit në shkallë botërore[58]. Ndër shkaqet kryesore të këtij degradimi janë përdorimi i tokës nga njeriu për qëllime të ndryshme. Më konkretisht, faktorët që ndikojnë ndjeshëm në rritjen e erozionit janë kryesisht i) reshjet (dhe sidomos shirat e rrëmbyeshëm), intensiteti dhe shpërndarja e tyre luajnë një rol të rëndësishëm, ii) përbërja e tokës/shkëmbinjve (kapaciteti i infiltrimit dhe niveli i stabilitetit të strukturës së tokës), iii) pjerrësia (gjatësia dhe niveli i pjerrësisë), si dhe iv) bimësia ose shtresat bimore që mbulojnë tokën.

Edhe në Elbasan, erozioni ka qenë i pranishëm në të gjithë sipërfaqen e territorit dhe, për fat të keq, vazhdon të mbetet një ndër problematikat kryesore të tokës. Sipas SHGJSH-së[59], erozioni prek zona të tëra dhe është i llojit sipërfaqësor dhe fundor. *Erozioni sipërfaqësor* prek zona të mëdha flishore e argjilore. *Erozioni fundor* zhvillohet më së shumti në pikat e takimit të përrenjve e lumenjve me shpatet duke bërë thellim të shtretërve të lumenjve në kohërat kur ujërat lëvizin me shpejtësi të madhe.
Panorama tipike të erozionit takohen në të gjithë zonën kodrinore-malore të bashkisë në anën e djathtë të lumit Shkumbin, zonat ndërmjet Përroit të Papërit dhe Zaranikës të cilat prekin kryesisht NJA-të Papër, Bradashesh, Labinot-Fushë e Funar. Në pjesën jugore të Shkumbinit, erozioni prek NJA-të Zavalinë-Gjinar, dhe Tregan. Më së miri, këtë tregues e pasqyron harta e erozionit (Figura mëposhtë) e cila pasqyron erozionin e shtrirë në sipërfaqen e Bashkisë.[60]

Figura 32. Erozioni në Bashkinë Elbasan



Burimi: SHGJSH, 2014, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Sipas Emergjencave Civile të Bashkisë, rreziku tejet i lartë është në brigjet e Shkumbinit ku humbet rreth 500-800m^3 tokë/vit në 1,000 meter linear dhe në [61] zonat e mëposhtme:

- NjA Gjergjan: Muriqan

- NjA Funar: Bixëlle, Prec e Poshtme, Cerujë, Mollagjesh
- NjA Shushicë: Shelcan, Polis i Vogël, Polis Vale
- NjA Gjinar: Pobrat
- NjA Labinot Mal: Guri i Zi, Sericë, Labinot Mal
- NjA Labinot Fushë: Xibrak, Griqan, Godolesh

Është e rëndësishme të theksohet se shpyllëzimet e vazhdueshme dhe pa kriter gjatë viteve të fundit në territorin e Bashkisë (nga vitet 1980 e deri më sot) si dhe mungesa e praktikave të përshtatshme për menaxhimin e tokës kanë luajtur një rol parësor në shtimin e fenomenit të erozionit në territor.

Në zonat pyjore ose kullosore, erozioni ka ardhur si pasojë e keqmenaxhimit, mbishfrytëzimit të tyre, shpyllëzimeve ose dëmtimit të bimësisë së ulët (nën-pyllit). Është e rëndësishme të theksojmë se sekreti i pyjeve në mbrojtjen e tokës nga erozioni qëndron pikërisht në lënien të paprekur tësipërfaqes së tokës dhe të mbulesës së saj bimore. Kjo bën të mundur që bimësia, jo vetëm pyjet, të zhvillohet dhe të krijojë një mbulesë të të gjithë sipërfaqes. Ndryshe nga sa mendohet, nuk mjaftojnë vetëm drurët e lartë (pyjet) me rrënjët e tyre të thella që të mbrojnë pyjet nga erozioni. Është *tabani i tokës* (sipërfaqja) që mbron tokën nga erozioni. Në qoftë se sipërfaqja e tokës është e zbuluar, pikat e shiut që bien nga gjethet e pemëve të larta ushtrojnë presion të lartë mbi dherat e tokës duke e gërryer atë. Mbulesa e tokës me një shtresë bimore shërben si masë efikase për mbrojtjen e tokës nga erozioni. Për këtë arsye, bimësia e ulët nëpër pyje ka një ndikim të jashtëzakonshëm në mbrojtjen e tokës nga erozioni. Përveç shpyllëzimit e dëmtimit të bimësisë në pyje, shkak tjetër kryesor i erozionit është edhe hapja ose ndërtimi i rrugëve të reja, zhvillimi i verimtarive të ndryshme për shfrytëzimin e drurit (prerje, grumbullim, transporti me makina, shitje etj.) si dhe hapja e shtigjeve të ndryshme për aktivitetet argëtuesetë cilat nuk kanë munguar në vitet e fundit së bashku me rrugët për shfrytëzimin e minierave (guroreve). Hapja e rrugëve të reja në zona kodrinore, pa marrë masat e duhura, mund të shkaktojë humbjen e 100Mg/ha dhera të shkaktuara nga erozioni.[62]
Për sa i përket erozionit në tokat bujqësore të vendit tonë, rreziku potencial i erozionit konsiderohet mesatar dhe i lartë ndërsa në Qarkun e Elbasanit rreziku i erozionit është i lartë (erozioni në tokat bujqësore është trajtuar si seksion më vete në seksionin e Tokave dhe Bujqësisë).[63]
Bashkia ka shumë fshatra të vendosuranë terren kodrinor e malor, sidomos në zonën e maleve të Krrabës e Labinotit. Kultivimi i tokës së këtyre zonave krijon vetvetiu ***erozion*** të tokës nëse praktikat e kultivimit të saj nuk janë të qëndrueshme.
Për të kuptuar përmasat dhe shtrirjen e erozionit në territorin e Bashkisë, mjafton edhe të analizojmë vëllimin e rezervuarëve dhe digave që ndodhen brenda këtij territori. Nga një analizë e hollësishme e 11 rezervuarëve (Figura mëposhtë), është vënë re se pothuajse të gjithë rezervuarët kanë pësuar zvogëlim të volumit të tyre për shkak të erozionit. Diga e Gjuetisë ka humbur pothuajse 75% të saj e ndjekur nga Nezhan me 67%, Mlizë me 65% dhe Prapanikë me 50%.

Figura 33. Vëllimi i rezervuarëve/digave mbushur me erozion



Burimi: MBZHRAU, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Si rezultat i erozionit, mungesës së njohurisë se thelluar mbitokën dhe praktikave të keqmenaxhimit, apo braktisjes, në territorin e bashkisë vihet re degradimi i tokës. Nuk ka shifra lokale, por në rang vendi, vetëm erozioni dhe degradimi i tokave kanë çuar në humbjen e 5% të prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2014[64].

Përmbytjet

Vendi ynë është kërcënuar nga përmbytjet e lumenjve ndër vite. Sipas studimeve të Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (PNUD) të vitit 2003[65] informacionet e para rreth përmbytjeve në vend janë rregjistruar në vitet 1854-1871, periudhë gjatë së cilës kanë ndodhur 11 përmbytje. Përmbytjet kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme në vend. Megjithatë, përmbytja e viteve 1962-1963 konsiderohet përmbytja me ndikim më të madh. Lumenjtë e Drinit dhe të Bunës përmbytën fushat e Shkodrës dhe Zadrimës, lumenjtë Mat dhe Drin përmbytën fushën e Lezhës, lumi Ishëm përmbyti fushën e Thumanës, ndërsa lumenjtë Shkumbin dhe Seman kanë përmbytur fushat përreth tyre. Sipas llogaritjeve të asaj kohe, janë përmbytur gjithsej 70,000 ha tokë bujqësore duke shkaktuar dëme të mëdha në ekonominë e banorëve vendas.

Tabela 7. Zonat e përmbytura në dimrin e viteve 1962-1963

Zonat e përmbytura	Sipërfaqja e përmbytur (ha)	Kohëzgjatja (Ditë)
Bregu i Bunës (Fushat e Zadrimës së Shkodrës dhe të Lezhës)	18,575	22
Drini i Lezhës dhe Mati (Fushat ndërmjet të dy lumenjve)	3,122	10
Mati dhe Ishmi (Fushat ndërmjet të dy lumenjve)	5,825	7
Lumi Shkumbin (Fushat poshtë Rrogozhinës, në të dy anët e lumit)	6,896	7
Lumi Semani (Fushat në të dy brigjet e tij)	26,738	35
Lumi Vjosa (Fushat në të dy brigjet e lumit, poshtë Urës së Mifolit)	3,538	20

Burimi : Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, 2003, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Përmbytje të tjera të një shkalle të gjerë janë regjistruar në vitet 1970-71 dhe në vitin 2002. Në vitin 1970-71 ndikimet më të mëdha janë ndjerë në luginën e Vjosës. Lumi i Vjosës llogaritet të ketë përmbytur 14,000 ha dhe shkaktuar dëmtime dhe shkatërrime të argjinaturave, kanaleve ujitëse, urave, stacioneve të pompimit etj. Në shtator të vitit 2002, përmbytjet janë përsëritur duke mbuluar me ujë rreth 30,000 ha tokë bujqësore. Lumenjtë që dolën nga shtrati ishin lumi Erzen dhe, mbi të gjitha, degët kryesore të lumenjve Vjosë (Drinosi), Seman (Gjanica) si dhe përrenj të tjerë të vegjël (Gjadri, Përroi i Manatinës në Lezhë dhe Përroi i Zezës). Edhe pse mungojnë të dhënat, përmbytjet kanë vazhduar sërish (në vitin 2014-15) duke shkaktuar dëme të mëdha në vendet ku ato ndodhin.

Përmbytje nga lumenjtë kryesorë: Sipas një studimi të kryer nga Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara[66], rreziku më i madh i përmbytjeve në vendin tonë vjen nga sistemi lumor kryesor (lumenjtë e mëdhenj). Përmbytjet zakonisht janë të lidhura ngushtë me periudhën kur sasia e reshjeve është më e lartë në vend, e cila përkon me muajt nëntor-mars. Këto janë edhe muajt kur bien rreth 80-85% të reshjeve në vend.[67] Në përgjithësi, dhe sidomos në kohët e fundit, reshjet intensive janë të befasishme dhe dallohen për një kohëzgjatje për rreth 8-10 orë. Si rrjedhojë, lumenjtë kryesorë të vendit arrijnë kapacitetin e tyre maksimal deri në dalje nga shtrati duke përmbytur tokat përreth. Gjatë përmbytjeve, prurja specifike e lumenjve në vendin tonë luhatet nga 0.5-2.5 $m^3/s/km^2$.[68]

Tabela 8. Karakteristikat kryesore hidrologjike të pellgjeve ujëmbledhëse të lumenjve më të mëdhenj në vend

Pellgu ujëmbledhës	Sipërfa-qja (km^2)	Prurja specifike ($l/s/km^2$)	Prurja vjetore (milion m^2)	Raporti vjetor i prurjes së lagët/thatë (1)	Raporti 10-vjeçar i prurjes (2)	Aftësia mbrojtëse e rezervuarit (milion m^2)
Drini	19,582	35	11,110	5,7 (dhjetor/gusht)	13	2,700 (Fierza)
Mati	2,441	40	3,250	10 (dhjetor/gusht)	25	240 (Ulëza)
Erezeni-Ishmi	1,439	24-31	660	9-10 (janar,shkurt/gusht)	55	Nuk ka
Shkumbini	2,445	26	1,900	10,8 (prill-gusht)	24	Nuk ka
Semani	5,649	16	2,700	14,8 (shkurt,mars,gusht)	18	700 (Diga e Banjës)(3)
Vjosa	8,1	26	5,550	7,3 (shkurt/gusht, shtator)	21	Nuk ka

Burimi : PNUD, 2003, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

(1) Raporti midis prurjes në muajin më të lagët me atë në muajin më të thatë; 2) Raporti midis prurjes më të lartë dhe asaj më të ulët brenda një 10 vjeçari; 3) Rezervuar i papërfunduar

Përmbytje nga lumenjtë e vegjël dhe përrenjtë: Një karakteristikë e përmbytjeve në vendin tonë është se shpesh ato shkaktohen edhe nga lumenjtë e vegjël dhe përrenjtë, krysisht në luginat e Shqipërisë Veriore, Qendrore dhe Jugore. Studimet tregojnë[69] se lumenjtë e vegjël dhe përrenjtë që përmbyten në vend janë përrenjtë e Përmetit, Zaranikës e Manazderës në Elbasan, Manatisë, Lanës dhe Zezës si dhe lumenjtë Kiri, Tërkuza, Gjolja e Drinosi. Përrenj të tjerë, që përbëjnë rrezik të ndjeshëm, janë ai i Gjadrit, Drojës, i Korçës dhe i Vërdovës[70].

Tabela 9. Lumenjtë/përrenjtë e vegjël me prirje për përmbytje në basenet Shkumbin, Seman e Vjosë

Lumi ose Përroi	Rajoni / Zona e ndikimit
Përroi i Zaranikës	Qyteti i Elbasanit (pjesërisht)
Përroi i Manasderës	Rruga Elbasan-Librazhd
Lumi i Gjanicës	Qyteti i Fierit (pjesërisht)
Lumi i Drinosit	Qyteti i Gjirokastrës (pjesërisht) dhe rruga Tepelenë-Gjirokastër-Kakavijë

Burimi: PNUD, 2003, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Rreziku nga përmbytjet e sistemi kryesor lumor me rikthim 100 vjet në vend:

Vendi ynë rrezikon dëmtime të mëdha në rast se përmbytjet janë për periudhë rikthimi 50 vjet dhe 100 vjet. Nga studimet e kryera nga PNUD, pasojat janë pothuajse të papërfillshme (me ndikim të kufizuar ose pa pasoja) në rastin e përmbytjeve me rikthim në 50 vjet. Kjo, në rast se merren të gjitha masat për paradalimin e tyre (kur sistemi i pendave është i padëmtuar dhe instalimet e pompimit janë të gjitha në punë). Masa të tilla janë në gjendje të shmangin rreziqet që i kanosen Ultësirës Perëndimore.

Përmbytjet me rikthim në më shumë se 50 vjet duket se janë përmbytjet që kanë një ndikim më të fuqishëm në vend. Këto lloj përmbytjesh (të rikthimit me 100 vjet, p.sh.) mund të krijojnë të njëjtat kushte si përmbytja e vitit 1962-63. Shkalla e rrezikshmërisë nga këto përmbytje ndyshon nga zona në zonë. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se rajonet me rrezikun më të ulët të përmbytjeve në periudhë rikthimi 100vjet janë UltësiraPerëndimore, rajoni i Alpeve të Shqipërisë dhe Krahina Malore Juglindore.


Rrezikshmëria më e lartë e përmbytjeve paraqitet në pellgjet ujëmbledhëse të lumenjve Devoll dhe Osum, pjesën e poshtme të Shkumbinit, lumenjtë Drini i Zi, Mati, rajoni i Bregut të Detit dhe lumenjtë Kiri, Gjadri, Lesniqja, Gomisqja, Ishmi dhe lumenjtë e krahinave malore jugore dhe qëndrore të Shqipërisë, si Drinosi, Shushica etj. Në pjesët e tjera të vendit rreziku është më i ulët (Figura mëposhtë).

Tabela 10. Zonimi i rrezikut të përmbytjeve në Shqipëri për periudhë rikthimi 100 vjet

Shkalla e rrezikut të përmbytjes	Prurje e pikut specifik (PPS-$m^3/s/km^2$)	Sipërfaqja	
		Km^2	%
E ulët	<2	6,660	23,5
E mesme	2_3	11,433	40,3
E madhe	3_4	5,878	20,7
E lartë	4_5	2,837	10.0
E skajshme	>5	1,564	5,5
Totali		28,372	100.0

Burimi : PNUD, 2003, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Figura 34. Rrezikshmëria e përmbytjeve në vend për periudhë rikthimi 100 vjet



Burimi: PNUD, 2003, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Siç shihet nga grafiku i mësipërm, në pjesën më të madhe të territorit, rreziku i përmbytjeve në vend me rikthim në 100 vjet është i mesëm në 11,433 km^2 (40.3%) i ndjekur nga ai i ulët (23.5%, e më tej i madh (20.7%), i lartë (10%) dhe i skajshëm (5.5%). Duhet theksuar se të tre kategoritë e fundit me rrezik të lartë, të madh dhe të skajshëm që kanë ndikimin më të fuqishëm në vend përfshijnë 36.2% të territorit. Pra, Shipëria është vend tejet i rrezikuar nga përmbytjet ku vetëm 23.5% e territorit nuk kërcënohet nga pasojat e rënda të përmbytjeve. Në pjesën tjetër, është tejet e rëndësishme që planifikimi i territorit të bëhet duke patur parasysh pasojat e mëdha në rast përmbytjesh me kthim 100 vjet.

Rreziku nga përmbytjet e sistemi kryesor lumor me rikthim 100 vjet në Bashkinë Elbasan:


Për sa i përket Bashkisë së Elbasanit, përmbytjet parashikohen të shkaktohen nga lumi Shkumbin dhe kryesisht nga degët e tij.
Siç u theksua më sipër, përmbytjet me rikthim në 50 vjet janë të parashikueshme dhe, vetëm duke marrë masat e duhura, mund të shmangen pasojat e tyre. Kjo është vërtetuar paspërmbytjeve të vitit 1962-63 periudha kur dhe janë marrë masa për parandalimin e përmbytjeve të tilla duke dhënë rezultate të kënaqshme në parandalimin e pasojave të rënda në përmbytjen e viteve 1970-71. Sipas PNUD-it, pasvitit 1962-63, masat për parandalimin strukturor dhe kontrollin e përmbytjeve (duke përjashtuar digat) të ndërmarra në vend janë mbështetur në një periudhë rikthimi të ujërave nga përmbytjet prej 50 vjetësh. Këto masa përfshijnë rindërtimin dhe ngritjen e argjinaturave të reja në pjesën e poshtme të lumenjve kryesorë. Ndërkohë, nuk janë marrë masa për përmbytje me rikthim në 100 vjet. Për këtë arsye, vendi ynë nevojitet të planifikojnë zhvillimin e territorit duke patur parasysh ndikimet e përmbytjeve me rikthim në 100 vjet.
Fatmirësisht, sipas vlerësimit të rrezikut nga përmbytjet, Bashkia Elbasan nuk rrezikon përmbytje të llojit me rikthim në 100vjet siç ndodh në ish-rrethet Peqin, Kavajë e Lushnje në Qarkun Elbasan (Figura mëposhtë). Megjithatë, rekomandohet marrja e masave për parandalimin e përmbytjeve të shkaktuara nga degët e Shkumbinit që janë Zaranika dhe Manazderja.

Tabela 11. Pasojat e përmbytjes së Ultësirës Perëndimore për periudhë rikthimi 100-vjet dhe nevojat e fatkeqësisë sipas pellgjeve ujëmbledhëse në ish-Qarkun Elbasan

Lumi	Qarku	Rrethi	Nr.i fshatrave	Nr.i komunave	Nr.i ndërtesave	Sip. e ndërtimit (m^2)	Popullsia
Shkumbin			30	14	6599	513420	38052
	Elbasan	Peqin	2	1	294	22620	1433
	Tiranë	Kavajë	4	4	1550	97880	8105
	Fier	Lushnje	24	9	4755	392920	28514

Burimi : PNUD, 2003, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Figura 35. Harta e rrezikut të përmbytjes së Ultësirës Perëndimore me periudhë rikthimi 100 vjet



Burimi : PNUD, 2003, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016


Si përfundim, duke parë se parashikimet rreth ndikimit të përmbytjeve në vend janë kryer në vitin 2003, dhe se gjatë këtij 13 vjeçari regjimi i reshjeve ka ndryshuar duke çuar kështu në shpeshtimin e përmbytjeve dhe rritjen e ndikimit të tyre në territoret e bashkive, mendohet se pasojat e përmbytjeve me rikthim 50 ose 100 vjet të jenë edhe më të theksuara. Për këtë arsye, përveç marrjes së masave të duhura për parandalimin e përmbytjeve me rikthim 100 vjet, nevojiten edhe studime të reja më të përditësuara rreth përmbytjeve në vendin tonë në përgjithësi dhe në Bashkinë Elbasan në veçanti.

- **Burimet ujore dhe basenet**
    - Burimet ujore sipërfaqësore

Bashkia e Elbasanit ka një rrjet të pasur hidrik. Territori i Bashkisë së re përshkohet nga baseni i Lumit Shkumbin, i cili mbetet trupi ujor kryesor në Bashki. Shkumbini përshkon bashkinë e Elbasanit nga lindja në perëndim në një gjatësi prej 39km. Lumi hyn në bashki nga fshati Labinot, Shushicë, vazhdon ndërmjet fshatrave Mjekës e Bradashesh dhe Papër dhe del nga territori i bashkisë për të vazhduar në drejtim të Qytetit të Cërrikut. Lumi Shkumbin gjatë gjithë rrjedhës së tij konstatohet të ketë një furnizim nëntokësor të fuqishëm. Duke qënë se lugina e lumit Shkumbin mbledh ujërat e lartësive mbi 2000m të Valmares dhe Çermenikës, shpjegon edhe faktin që prurjen më të madhe e ka në muajt prill dhe maj, ku edhe lumi del nga shtrati, duke përmbytur tokat përgjatë bregut dhe gërryerjen e tyre, kryesisht në pjesën jugore të qytetit.

Brenda territorit të bashkisë, Shkumbini mbledh ujërat e një sërë lumenjsh të ndryshëm si Lumi i Garës që kalon në Labinot Fushë, Përroi Manazderja, Përroi Zaranika, Përroi i Baltëzës, Përroi i Kushes, Zalli i Papërit, të cilët ndodhen në anën e majtë të lumit. Shkumbini sjell me vete edhe ujërat e një numri të madh lumenjsh jashtë territorit të bashkisë (Lumit të Gjuraqit, vazhdim i degëzimeve Shmill dhe Shpell në degëzimin e tij djathtas, Zallit të Kostenjës (ish Lumi i Lunikut), degëzimi i mesit, dhe Zallit të Qarrishtes (ose Rrapunit). Ky i fundit bashkohet në veri me Zallin e Gjurait, afër Librazhdit. Pjesa jugore e bashkisë preket edhe nga degë të Lumit Devoll (Baseni i Semanit). Ky degëzim është Përroi i Zallit të Gostimës (ndërmjet Gostimës dhe Stermenit), dhe Zalli i Kaçivelit të cilët shërbejnë si degë ushqyese kryesore të Devollit. Përveç lumenjve, Bashkia ka edhe një numër liqenesh e rezervuarësh siç janë Liqeni i Treganit, ujëmbledhësi i Funarit dhe burimet termale në Tregan. Ndër rezervuarët dallohen tre ujëmbledhës në zonën e Funarit të rrethuar me kodra të veshura me pyje pishe. Në zonën e Funarit mund të përmendim edhe liqenet e Seferanit, Merhojes, etj[71]. Në Qarkun e Elbasanit[72] gjenden edhe disa burime ujërash termo-minerale si Llixhat e Elbasanit, pus-shpimi në Dëshiran dhe burimi i Holtës. Ruajtja, mirëmbajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i tyre nga Bashkia mund të sjellë fitime të mëdha për vendin në fushën e turizmit.

Figura 36. Lumenjtë dhe rezervuarët kryesorë në Bashkinë Elbasan



Burimi: SHGJSH, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Burimet ujore sipërfaqësore janë të rëndësishme për funksionet e tyre të përgjithshme (për ujitje, ujë industrial etj.) dhe mbi të gjitha, ato shërbejnë si burime ushqyese për ujërat nëntokësore jetike për furnizimin me ujë të bashkisë dhe të qyteteve përreth.

Gjendja e burimeve ujore spërfaqësore (problematika)

Në dy dhjetëvjeçët e fundit në vendin tonë, burimet ujore dhe kryesisht lumenjtë, janë shfrytëzuar për bujqësi, industri, për materialin e tyre inert dhe për sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe njëkohësisht, janë përdorur si kanale për derdhjen e ujërave të ndotura. Për më tepër, mungesa e planeve për mbrojtjen e lumenjve e shoqëruar me ndërhyrje pa kriter të njeriut në shfrytëzimin e tyre (shfrytëzimi i inerteve në shtratin e lumenjve, punimi i brezave të gjelbër mbrojtës etj.) ka përshpejtuar shumë procese natyrore gjeologjike në shtratin e lumenjve siç janë gërryerja e shtratit, erozioni anësor dhe sipërfaqësor i brigjeve, rrëshqitjet e tyre etj. të cilat kanë ndikuar ndjeshëm në përkeqësimin e gjendjes së tyre.[73]Si rrjedhojë, sot lumenjtë vuajnë pasojat e një keqmenaxhimi të gjatë që janë kryesisht *i) ndyshime në hidro-morfologjinë e lumenjve; ii) humbje të florës & faunës ujore, dhe iii) ndotje.*

Hidromorfologjia e lumenjve dhe ndryshimet e saj lidhen kryesisht me tipare fizike të një lumit të cilat janë kryesisht[74]: *morfologjia e kanalit* dhe *lloji i rrjedhës* (natyrale ose e modifikuar); *përbërja litologjike e shtratit* (lloji, sasia e përbërjes shkëmbore in shtrat);*struktura dhe stabiliteti i brigjeve* – mjaft e rëndësishme sepse tregon ndikimin që do të ketë lumi në gërryerjen e brigjeve dhe, si rrjedhojë, në sasinë e sedimentit që do të

përfundojë në lumë; *digat/pengesat* përgjatë rrjedhës, të cilat ndikojnë në ndryshimin e shpejtësisë së rrjedhës së lumit dhe largësinë e rrjedhjes së lirshme të ujit deri në largësinë në të cilën është në gjendje të trasportojë sedimentin; *bimësianë shtratin e lumit* (habitatet, biodiversiteti, bimët,etj); *brezi i bimësisë mbrojtëse përgjatë brigjeve, përdorimi i tokës në afërsi* (rreth 20 metra nga bregu) dhe *gjerësia e zonës me ndikim nga përmbytjet.*

Në vendin tonë, ndërhyrjet në lumenj janë të shumëllojshme, si në shtrat, ashtu edhe në ndryshimin ose zhvendosjen e mbulesës bimore; marrjen e materialeve inerte, rërë, zhavorr, gurë ose plisa; ndërtime afër lumenjve; hedhje apo depozitim i materialeve inerte që dalin nga prishja e objekteve ndërtimore; gërmime të ndryshme, si dhe veprimtari të tjera që prodhojnë mbetje; shkarkimi i ujërave të ndotura urbane e industriale të patrajtuara, veprimtari të cilat ndalohen me ligj. [75] Të gjitha këto kanë shkaktuar dëmtime të hidromorfologjisë së lumenjve që janë vërtetuar nga studime të ndryshme, ndër të cilat, edhe nga studimet e Shërbimit Gjologjik Shqiptar rreth thellimit të shtratit të lumenjve.

Me qëllim analizimin e gjendjes së lumenjve në vendin tonë dhe përcaktimin e shkallës së ndikimit të fenomeneve gjeologjike dhe ndërhyrjes së njeriut në shtratin e tyre, SHGJSH ka monitoruar[76] basenet e lumenjve në vend, ndër të cilët edhe Basenin/Pellgun e Lumit Shkumbin.


Pellgu i Lumit Shkumbin është monitoruar në tetë pika/profile monitorimi (Figura 37 dhe Tabela 13) për periudhën 2007-2016. Këto profile janë shpërndarë në Lumin Shkumbin (gjashtë pika) dhe dy pika në Përroin e Rrapunit dhe Përroin e Zaranikës, përkatësisht.

Tabela 12. Vendndodhja e profileve të monitorimit

Nr.	Lumi	Vendi i Profilit	Periudha e monitorimit
30	Shkumbin	Kalush	2011-15
31		Thanasaj	2011-15
32		Broshkë	2007-15
33		Ura e Peqinit	2011-15
34		Labinot	2007-15
35		Mirakë	2007-15
36		Përroi i Rrapunit	2007-15
37		Përroi i Zaranikës	2007-15

Burimi: SHGJSH, 2016, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Figura 37. Profilet e monitorimit të gjendjes së shtratit të lumenjve në Basenin e L. Shkumbin



Burimi: SHGJSH, 2016, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Siç vihet re në Figurën mësipër, Lumi Shkumbin ka patur ndryshime dinamike në shtratin e tij gjatë periudhës së monitoruar. Deri në vitin 2011, është vënë re fenomeni i ***erozionit vertikal*** drejt rrjedhës së tij të poshtme, një fenomen jo i zakonshëm në lumenjtë e vendit tonë. Përveç erozionit, në segmentë të ndryshëm të lumit, në forma dhe intensitete të ndryshme, është vënë re edhe ***prania e akumulimeve***.


Erozioni fundori cili shfaqet me ulje të shtratit të lumit vihet re në të gjitha pikat, me përjashtim të profilit të monitoruar në Kalush dhe në Përroin e Zaranikës ku vihet re akumulim materiali në shtrat. Më i theksuar është erozioni fundor është vënë re në Mirakë, në vitet 2007-2015 (-14.7cm ulje), i ndjekur nga segmenti i lumit në Labinot (-9.5cm) i monitoruar në të njëtën periudhë kohore, dhe në Kalush (-6.2cm), monitoruar nga viti 2011-2015.

Tabela 13. Ndryshimet totale (erozioni fundor/akumulimet) ndër vite në Lumin Shkumbin

Nr.	Lumi	Vendi i Profilit	Periudha e monitorimit	Ndryshimi Total (cm)	Ecuria deri 2015			Trendi 2011-2015		
					E	N	A	E	N	A
30	Shkumbin	Kalush	2011-15	-6.2	√				√	
31		Thanasaj	2011-15	-0.03	√				√	
32		Broshkë	2007-15	+25.6			√	√		
33		Ura e Peqinit	2011-15	-2.4	√				√	
34		Labinot	2007-15	-9.5	√				√	
35		Mirakë	2007-15	-14.7	√				√	
36		Përroi i Rrapunit	2007-15	-1.7	√				√	
37		Përroi i Zaranikës	2007-15	+31.7			√			√

Burimi: SHGJSH, 2016, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Figura 38. Thellimi i shtratit/akumulimet në shtratin e Lumit Shkumbin



Burimi: SHGJSH, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Për sa i përket akumulimit, ky fenomen është vënë re në Broshkë (me 25.6cm) dhe tek Përroi i Zaranikës (me 31.7cm).

Në përgjithësi, problematikat kryesore që janë vënë re gjatë monitorimit janë[77]:

- Ulje të shtratit për shkak të erozionit fundor (shkaktuar pjesërisht nga shfrytëzimi i inerteve në shtratin e lumit)
- Erozion të tokës bujqësore në sektorët Labinot, Shushicë, Ura e Cërrikut, Bishqem, Çengelaj, Peqin, Vashaj, Sinaballaj, Çermë, Bashtovë etj.
- Rrezikime të objekteve inxhinierike (ura mbrojtëse, argjinatura, rrugë, etj.) në Labinot Fushë, Bradashesh, Pajovë , Çermë, Rrogozhinë, Xibrakë etj. Ura e vjetër e Rrogozhinës është rrëzuar totalisht dhe pjesët e saj janë larguar
- Rrëshqitje apo rrëzime të brigjeve gjatë segmenteve të ndryshme
- Ulje të nivelit të ujërave nëntokësore në puset e ujit, stacione pompimi jashtë funksionit (nga 15, sot janë vetëm 5 në punë)
- Përmbytje në rrjedhën e poshtme të lumit në përgithësi, ndërsa gjatë vitit 2015 janë vënë re edhe përmbytje në pjesë të veçanta të rrjedhës së mesme
- Ndotje të ujit (nga inertet, ndotje baktereologjike të ujit etj.)
- Dëmtim të florës dhe faunës së lumit dhe të peizazhit lumor

- Ndikim në modifikimin e vijës bregore, spostime të grykëderdhjes dhe prurje të mëdha të inerteve të imta.

Dëmtime të zonës ripariane: Si rrjedhojë e mangësive në manaxhimin e lumit apo keqpërdorimit të brezit të tokave përgjatë tij, zona ripariane e lumit Shkumbin ka pësuar dëmtime të theksuara (është ngushtuar, mungojnë brezat e bimësisë së nevojshme - bimët e ulëta deri tek ato të larta - ose nuk ekziston tërësisht). Duke qenë se rrjedha e mesme dhe e poshtme e tyre përshkon toka bujqësore të kultivuara, në disa raste zona ripariane është kultivuar si tokë bujqësore. Kjo ka ndikuar tek pamundësia për të mbrojtur tokën nga prurjet e lumit (përmbytjet), dhe mosndalimin e shkëmbimit të ndotjes mes tokave bujqësore e zonave të banimit kundrejt lumit nga njëra anë dhe ujërave sipërfaqësore dhe akuiferit nga ana tjetër. Kjo është shumë e rëndësishme, duke ditur se akuiferi kokrrizor dhe me kapacitet të lartë ujëmbajtës, shtrihet veçanërisht poshtë qytetit të Elbasanit dhe fushave të Bradasheshit e Cërrikut.

Dëmtimi i sistemit lumor nga HEC-et: Pellgu i Shkumbinit është shfrytëzuar gjerësisht për prodhimin e energjisë elektrike nëpërmjet ndërtimit të HEC-ve. Në fakt, në pellgun e Shkumbinit deri më tani janë ndërtuar 7 HEC-e, ndërkohë që 7 të tjerë janë në ndërtim dhe 55 janë planifikuar për t'u ndërtuar (Tabela 14).

Tabela 14. HEC-et në Basenin e Lumit Shkumbin

Nr.	Emërtimi i HEC	Gjendja	Kapaciteti	Lumi
Në ndërtim				
1	Bishnica 2	ekzistuese	1-10MW	NN
2	Velçan	ekzistuese	1-10MW	Shkumbin
3	Sllabinjë	ekzistuese	1-10MW	Shkumbin
4	Stravaj 2	ekzistuese	1-10MW	Radicinë
5	Gizavesh	ekzistuese	1-10MW	Qarishta
6	Zgoshtë	ekzistuese	1-10MW	Qarishta
7	Qarishta	ekzistuese	1-10MW	Qarishta
Në ndërtim				
8	Stravaj 1	në ndërtim	1-10MW	Radicinë
9	NN	në ndërtim	1-10MW	Bushtrica
10	NN	në ndërtim	0-1MW	Bushtrica
11	NN	në ndërtim	0-1MW	Shebenik-Jabllanicë
12	Hotolisht	në ndërtim	10-50MW	Shkumbin
13	Rapuni 1	në ndërtim	1-10MW	Rapuni
14	Rapuni 2	në ndërtim	1-10MW	Rapuni
Planifikuar per t'u ndërtuar				
15	Peqin	i planifikuar	1-10MW	Shkumbin
16	Topcias	i planifikuar	1-10MW	Shkumbin
17	Labinot Mal	i planifikuar	0-1MW	Labinot Mal
18	Tervol Pishaj	i planifikuar	0-1MW	Holtë
19	Labinot Fushë	i planifikuar	1-10MW	Gurrës
20	Gostimë 1	i planifikuar	1-10MW	Gostimë
21	Gostimë 2	i planifikuar	1-10MW	Gostimë
22	Gur Shpat 1	i planifikuar	1-10MW	NN
23	Gur Shpat 2	i planifikuar	1-10MW	NN
24	Rapuni 3	i planifikuar	1-10MW	Rapuni

25	Librazhd 1	i planifikuar	1-10MW	Sheje
26	Librazhd 2	i planifikuar	1-10MW	Sheje
27	Librazhd 3	i planifikuar	1-10MW	Sheje
28	Spathar	i planifikuar	1-10MW	Shkumbin
29	Dragostunja	i planifikuar	1-10MW	Dragostunja
30	NN	i planifikuar	0-1MW	Shebenik-Jabllanicë
31	Quku-Vulcan 1	i planifikuar	0-1MW	Quku-Vulcan
32	Quku-Vulcan 2	i planifikuar	1-10MW	Quku-Vulcan
33	Bushtrica	i planifikuar	10-50MW	Bushtrica
34	NN	i planifikuar	1-10MW	Bushtrica
35	NN	i planifikuar	0-1MW	Bushtrica
36	NN	i planifikuar	0-1MW	Bushtrica
37	NN	i planifikuar	0-1MW	Bushtrica
38	NN	i planifikuar	0-1MW	Bushtrica
39	NN	i planifikuar	0-1MW	Bushtrica
40	NN	i planifikuar	0-1MW	Bushtrica
41	NN	i planifikuar	0-1MW	Bushtrica
42	NN	i planifikuar	0-1MW	Bushtrica
43	Qukës	i planifikuar	1-10MW	Shkumbin
44	Zall Tore	i planifikuar	1-10MW	Zall Tore
45	2A-D	i planifikuar	10-50MW	Shkumbin
46	Dunicë 2	i planifikuar	1-10MW	Dunicë
47	Dunicë 1	i planifikuar	1-10MW	NN
48	Osnati dhe Gradisht	i planifikuar	0-1MW	Osnati dhe Gradisht
49	Rapuni 3	i planifikuar	1-10MW	Rapuni
50	Orenja 1	i planifikuar	1-10MW	Orenja
51	Orenja 2	i planifikuar	1-10MW	Orenja
52	Funares Lunik	i planifikuar	1-10MW	NN
53	Zalli Lunikut	i planifikuar	1-10MW	Zalli Lunikut
54	NN	i planifikuar	0-1MW	Shebenik-Jabllanicë
55	NN	i planifikuar	0-1MW	Shebenik-Jabllanicë
56	NN	i planifikuar	0-1MW	Shebenik-Jabllanicë
57	NN	i planifikuar	0-1MW	Shebenik-Jabllanicë
58	NN	i planifikuar	0-1MW	Shebenik-Jabllanicë
59	NN	i planifikuar	0-1MW	Shebenik-Jabllanicë
60	NN	i planifikuar	0-1MW	Shebenik-Jabllanicë
61	NN	i planifikuar	0-1MW	Shebenik-Jabllanicë
62	NN	i planifikuar	0-1MW	Shebenik-Jabllanicë
63	NN	i planifikuar	0-1MW	Shebenik-Jabllanicë
64	NN	i planifikuar	0-1MW	Shebenik-Jabllanicë
65	NN	i planifikuar	0-1MW	Shebenik-Jabllanicë
66	NN	i planifikuar	0-1MW	Shebenik-Jabllanicë
67	NN	i planifikuar	0-1MW	Shebenik-Jabllanicë
68	NN	i planifikuar	0-1MW	Shebenik-Jabllanicë
69	NN	i planifikuar	0-1MW	Shebenik-Jabllanicë
70	NN	i planifikuar	0-1MW	Shebenik-Jabllanicë

Burimi: AKBN dhe Riverëatch.eu, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

HEC-et janë ndërtuar në trupin ujor Shkumbin (2 të ndërtuar, 1 në ndërtim dhe 5 planifikuar për t'u ndërtuar) dhe pothuajse në të gjitha degët e Lumit Shkumbin. Degët me numrin më të madh të HEC-eve janë Rrapuni me 4 HEC-e (2 në ndërtim dhe 2 të planifikuar), Shebenik-Jabllanicë me 19 HEC-e (1 në ndërtim dhe 18 të planifikuar) dhe Bushtrica me 12 HEC-e (2 në ndërtim dhe 10 të planifikuar). Degët me HEC-e shërbejnë si burim kryesor ushqyes për lumin Shkumbin. Njëkohësisht, ato shërbejnë edhe si burim i materialit zhavorror për këtë lumë.

Figura 39. HEC-et në Pellgun e Lumit Shkumbin



Burimi: Riverwatch.eu, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Lumenjtë janë shfrytëzuar për prodhimin e energjisë hidrike ndër vite. Në fakt, në vendin tonë energjia është pothuajse hidrike falë traditës që ka vazhduar në 50 vitet e fundit. Megjithatë, edhe pse HEC-et sjellin përfitime ekonomike dhe prodhim energjie, ato kanë ndikimet e tyre në mjedis dhe, në qoftë se nuk ndërtohen sipas parimit të përdorimit të integruar të burimeve ujore (që nënkupton përdorim i ujit duke patur parasysh edhe nevojat e sektorëve të tjerë të ekonomisë për ujë), rrezikojnë të shndërrohen në konflikte sociale.

HEC-et ndikojnë ndjeshëm në zhvillimin e një lumi. Ndër pasojat më të njohura, renditen ndikimi i drejtpërdrejtë në karakteristikat fiziko-kimike dhe biologjike të tij. Konkretisht, mund të përmendim:

- **trasformimin e rrjedhës së lumit në pjesën e sipërme të digës** nga një sistem natyror lumor në *system të një rezervuari artificial* me ujëra të ndenjura,
- **bllokimin e qarkullimit të peshqve** ose specieve të tjera ujore,
- **prishjen eekuilibrave e proceseve fizike dhe habitateve në rrjedhën pas digës**. Zakonisht, HEC-et dhe pritat e tilla, që nuk lejojnë kalimin e materialit zhavorror shkaktojnë prishjen e ekuilibrit të grykëderdhjeve duke shkaktuar erozionin detar, atë të ishujve, zonave pjellore të lumenjve dhe zonave të tjera kënetore,
- **ndryshimin e rrjedhës së lumit dhe të prurjeve të sedimentit zhavorror**, të trashë, në rrjedhën e poshtme të lumit me pasoja të rënda për deltat, florën e faunën, për faktin se jeta në lumë dhe përreth sistemit të lumit kushtëzohet dhe zhvillohet në varësi të rrjedhës dhe sedimentit,

- **grumbullimin e sedimentit pas digës**, që normalisht do të furnizonte ekosistemet në rrjedhën e poshtme. Kur një lumë nuk merr sedimente tëmjaftueshme, zakonisht tenton ta zëvendësojë atë duke gërryer brigjet e lumit e shaktuar thellim të shtratit,
- **thelimin e shtratit të lumit**, i cili ul edhe nivelin e ujit në akuifere.

Duke parë numrin e madh të HEC-eve që do të ndërtohen në Shkumbin dhe në degët e tij, mendohet se ndikimi në mjedis dhe në bujqësi në zonat përreth, mund të jetë i theksuar. HEC-et mund të sjellin zvogëlimin e rrjedhës së lumit, mjaft e rëndësishme për bujqësi në stinën e verës, ose pakësimin e sasisë së ujërave të disponueshme për ujë të pijshëm dhe sektorë të tjerë, edhe pse ky mbetet objekt studimi në të ardhmen. Vetëm një njohje e mirë e strukturës së digave, dhe sasisë së ujërave të rrjedhës së lumit që ato lënë me rrjedhje të lirë, mund të japë një pasqyrë të qartë të sasisë së ujit, që banorët do të mund të kenë në përdorim në rrjedhën e poshtme të digës (mbas digës) në të ardhmen.

Është shumë e rëndësishme të theksohet se lumi Shkumbin dhe degët e tij janë jetikë për zhvillimin e bujqësisë në Bashkitë nëpër të cilat kalon. Për këtë arsye, ndryshimi i rrjedhës së ujit apo pakësimi i sasisë së ujit që mund t'u shkojë fshatarëve për përdorim në periudhat e kultivimit nuk përbën më një problem vetëm mjedisor, por mbi të gjitha, një problem social që do të kërkonte zgjidhje të menjëhershme. Njëkohësisht, pakësimi i rrjedhës së lumit Shkumbin mund të çojë edhe në zvogëlimin e sasisë së ujërave të Akuiferit Quaternar të Elbasanit, i cili ushqehet nga lumi Shkumbin. Ky akuifer shërben si burim për furnizimin me ujë të popullsisë së bashkive të ndryshme (shih seksionin e ujësjellësit në Bashkinë Elbasan). Me pak fjalë, digat e HEC-eve, në rast së nuk janë planifikuar dhe nuk menaxhohen në mënyrë të qëndrueshme dhe të integruar, që garantojnë mosndryshimin e rrjedhës së lumit dhe sasisë së ujit si dhe përdorimin e ujit edhe për bujqësi për popullsinë e zonave përreth, mund të shkaktojnë probleme të mëdha mjedisore dhe sociale në Bashki, në të ardhmen e afërt.

Dëmtime të zonës ripariane: Si rrjedhojë e mangësive në manaxhimin e lumit apo keqpërdorimit të brezit të tokave përgjatë tij, zona ripariane e Semanit, Osumit e Devollit ka pësuar dëmtime të theksuara (është ngushtuar, mungojnë brezat e bimësisë së nevojshme - bimët e ulëta deri tek ato të larta - ose nuk ekziston tërësisht). Duke qenë se rrjedha e mesme dhe e poshtme e tyre përshkon toka bujqësore të kultivuara, në të shumtën e rasteve zona ripariane është *kultivuar si tokë bujqësore*. Gjatë brigjeve të lumenjve vihet re shembja/dëmtimi i brigjeve ose gërryerja e tyre, që ka rezultuar në humbje të sipërfaqes së tokës.

Figura 40. Dëmtime të brigjeve të lumit Shkumbin



Burimi: Arkiva Co-PLAN, 2016,

Ndotja nga karrierat për shfrytëzimin e gurëve gëlqerorë. Bashkia Elbasan është e pasur me gurë gëlqerorë, të cilëtjanë shfrytëzuar gjerësisht në vitet e fundit. Lejet e dhëna për shfrytëzimin e këtyre mineraleve në periusdhën 2001-2014 (tabela x) janë rreth 20[78]. Sipas lejeve të dhëna rezulton se sipërfaqa e territorit e shfrytëzuar për aktivitet minerar sipërfaqësor (për nxjerrjen e gurëve të ndryshëm) është 5.51km^2. Përveç prishjes së peizazhit, në rastet kur gërmimet janë sipërfaqësore, gëlqerorët ndotin mjedisin me retë e pluhurit që ngrenë gjatë aktivitetetit të tyre. Sipas SHGJSH-së, "reja e pluhurit që krijohet nga ky aktivitet ndot në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshme ajrin, ujërat sipërfaqësorë, tokat bujqësore". Më poshtë është sjellë tabela e plotë e aktiviteteve minerare gëlqerore në rrethin e Elbasanit, në harkun kohor 2001-2014 (Tabela mëposhtë). Nuk njihet numri i aktiviteteve të braktisura, që nuk janë më në veprim, dhe ku sipërfaqet e aktivitetit të të cilëve nevojitin ripërtëritje.

Tabela 15. Karrierat për shfrytëzimin e gurëve gëlqerorë në Bashkinë Elbasan

Nr.	Vendi	Data e	Lloji i mineralit	Km^2
1	Elbasan	13.06.2001	Gëlqeror	0.0580
2	Elbasan	21.12.2005	Gëlqeror	0.4370
3	Elbasan	21.12.2005	Argjilë	0.0466
4	Shushice	26.01.2009	Gëlqeror	0.0200
5	Letan	25.01.2010	Gëlqeror	2.1600
6	Elbasan	02.03.2011	Gëlqeror	0.1400
7	Elbasan	06.07.2011	Gëlqeror	0.0880
8	Elbasan	22.05.2012	Gëlqeror	0.1200
9	Elbasan	03.04.2013	Gëlqeror	0.3460
10	Elbasan	25.07.2013	Gëlqeror	0.0700
11	Elbasan	25.07.2013	Gëlqeror	0.1520
12	Elbasan	25.07.2013	Gëlqeror	0.0490
13	Elbasan	12.08.2013	Harcburgite	0.0580
14	Elbasan	06.09.2013	Gëlqeror	0.0260

15	Elbasan	27.03.2014	Gur dekorativ (ranor silicor)	0.3020
16	Elbasan	21.05.2014	Gëlqeror	0.0440
17	Elbasan	23.05.2014	Gëlqeror i mermerizuar	0.0860
18	Shushice	23.05.2014	Gëlqeror	0.0500
19	Elbasan	29.05.2014	Gëlqeror	0.0330
20	Elbasan	06.06.2014	Gëlqeror i mermerizuar	1.2200
Totali				5.51

Burimi: AKBN, 2015, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Ndotja: Gjatë 25 viteve të fundit, në vendin tonë dhe në Bashkinë Elbasan, lumenjtë janë përdorur edhe si vend-depozitime ose kanale të mbetjeve të ngurta ose të ujërave të zeza industriale dhe urbane. Në fakt, gjatë gjithë këtyre viteve, qytetet, që përshkohen nga lumi Shkumbin, e kanë shfrytëzuar këtë lumë për derdhjen e drejtpërdrejtë të ujërave të zeza urbane dhe rurale të patrajtuara në lumë duke e ndotur atë. Përveç ujërave të zeza, Lumi Shkumbin ka qenë vazhdimisht nën ndikimin e zonës industriale në Elbasan dhe industrive të tjera përgjatë brigjeve të tij. Si rrjedhojë, cilësia e ujërave të lumenjve është varfëruar ndër vite. Lumi është ndotur me produkte industriale, ujëra të zeza, produkte bujqësore etj.
Ndotja e monitoruar nga Co-PLAN/PLGP USAID: Duke patur si qëllim përcaktimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësore në disa lumenj të Shqipërisë Qendrore, dhe lidhjen e kësaj cilësie me përdorimin e tokës në territorin e bashkisë apo jashtë saj, Co-PLAN-i[79] kreu edhe monitorimin e cilësisë së ujërave të basenit të Shkumbinit, në 11 pika të tij. Disa nga pikat e monitorimit[80] dhe disa parametra kimikë[81] janë të përbashkët me monitorimet që kryen Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Për interpretimin e rezultateve janë marrë parasysh si standardet shqiptare, ashtu edhe direktiva të ndryshme të Bashkimit Europian.
Parametrat e monitoruar janë si më poshtë vijon:

- Parametra fiziko-kimikë: pH, tejdukshmeria, përçueshmeria elektrike, lënda e ngurtë pezull (TSS), lënda e ngurtë e tretur, oksigjeni i tretur, temperatura dhe nevoja biologjike për oksigjen
- Ushqyesit: $N\text{-}NH_4$, $N\text{-}NO_3$, $N\text{-}NO_2$, Sulfidet,
- Bakteria: bakteria koliform
- Metale të rënda: Plumb (Pb), Kadmium (Cd), Mangnez (Mn), Nikel (Ni), Zink (Zn), Bakër (Cu), Co, Krom (Cr), Mërkur (Hg), Arsenik (As), Barium (Ba), Brominë (Br)


Tabela 16. Pikat e monitorimit të Basenit Shkumbin

Pikat e Monitorimit	Lumenjtë	Vendndodhja e pikës së marrjes së mostrave të ujit
Shk.1	Shkumbin	Ne Propisht/Proptisht, Radokali i Poshtem
Shk.2		Qukes
Shk.3		Librazhd qytet
Shk.4	Rrapun	Lumi Rrapun
Shk.5	*Shkumbin*	*Ura Polis*
Shk.6		*Ura Cërrik (para Zaranikës)*
Shk.7		*Ura Cërrik (para Zaranikës)*
Shk.8		*Para Metalurgjikut (para Kushes)*
Shk.9		Ura Papër (para L. Papër)
Shk.10		Ura e Rrogozhinës (në Rrogozhinë)
Shk.11		Në Grykëderdhje

Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Pikat e monitorimit Shk. 5 tek Ura Polis, Shk. 6 tek Ura e Cërrikut, Shk. 8 përpara Metalurgjikut janë brenda kufinjve të Bashkisë Elbasan (Figura mëposht).


Figura 41. Harta e marrjes së kampioneve për vlerësim në lumin Shkumbin



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Nga monitorimi i kryer në Shkumbin u vu re se ujërat e lumit Shkumbin janë ***alkalinë*** (pH >7)[82] në të gjitha pikat e monitorimit, brenda dhe jashtë territorit të, gjetje kjo që përputhet me rezultatet e monitorimit të ujërave nga AKM[83].

Figura 42. pH i ujërave të Shkumbinit




	Shk. 1	Shk. 2	Shk. 3	Shk. 4	Shk. 5	Shk. 6	Shk. 7	Shk. 8	Shk. 9	Shk. 10	Shk. 11
Shkumbin_pH (boshti majtas)	62.50	106.25	50.00	75.00	95.00	55.00	50.00	50.00	37.50	52.50	162.50

Burimi: Co-PLAN dhe PLGP, 2015

Në lumin Shkumbin, ***thellësia e depërtimit të dritës*** nuk përbën problem sepse thellësia e lumit është e vogël pothuajse gjatë gjithë rrjedhës së mesme dhe të poshtme të lumit. Njëkohësisht, lumi ka ujëra të rrjedhshme, të cilat kanë aftësi të pastrohen me shpejtësi. Përçueshmëria elektrike është brenda parametrave mjedisorë (nën 500 µhos/cm)[84] me përjashtim të pikave 10-11 që përkojnë me segmentin lumor nga Rrogozhina deri në grykëderdhje, të cilat tregojnë vlera më të larta se normat e lejuara duke krijuar një mjedis të papërshtatshëm ujor për zhvillimin e biodiversitetit. Vlerat tregojnë qartë një lidhje të drejtpërdrejtë të përçueshmërisë elektrike me pH-in, ku ujërat bazikë kanë vlera brenda normave të lejuara mjedisore.

Vlerat e ***NBO_5***[85] janë brenda normës[86] në të gjitha pikat e monitorimit, rezultate të cilat ndryshojnë me gjetjet e AKM-së[87] vetëm për segmentin Toplias- grykëderdhje ku vlerat janë të një cilësie të tretë. Megjithatë, duke patur parasysh derdhjen e ujërave të zeza në lumë, vlerat e NBO_5 tregojnë qartë nevojën për ta analizuar këtë parametër në lidhje me faktorë të tjerë, që ndikojnë nëvlerat e këtij parametri në ujërat e lumenjve (vendndodhja e burimeve kryesore të ndotjes në lumë si industria, pikat e derdhjes së ujërave të zeza të zonave të banuara, përmbajtja e metaleve të rënda në ujë etj.). Prania e klorinës dhe metaleve të rënda në ujë ngadalëson, ose zvogëlon ndjeshëm NBO_5, sepse pengon aktivitetin e mikro-organizmave.

Figura 43. Vlerat e Nevojës Biologjike për Oksigjen dhe Oksigjeni i Tretur në Shkumbin




	Shk. 1	Shk. 2	Shk. 3	Shk. 4	Shk. 5	Shk. 6	Shk. 7	Shk. 8	Shk. 9	Shk. 10	Shk. 11	Standard
Oksigjeni i Tretur (mg/l)	8.85	8.10	8.39	7.95	8.35	10.20	8.75	10.87	7.95	7.42	8.89	4.00
NBO5 (mg/l)	0.32	0.34	0.25	0.12	0.22	0.80	0.80	0.90	0.64	0.64	1.28	6

Burimi: Co-PLAN dhe PLGP, 2015

Lënda e ngurtë pezull është <2 mg/l në të gjitha pikat e monitorimit, dhe shumë më e ulët se vlerat mjedisore[88]. Të njëjtën ecuri ndjek edhe lënda e ngurtë e tretur, por që ka vlera më të larta krahasuar me lëndën pezull. Kjo lidhet me burimet e lëndës së ngurtë të tretur që janë erozioni i tokës, mbetjet, ujërat e bardha, dhe gërryerja e brigjeve të lumit. Vlerat më të larta të lëndës së ngurtë të tretur vihen re në segmentin e lumit nga Ura e Rrogozhinës deri në grykëderdhje, dhe kjo mund të vijë si rezultat i grumbullimit nga rrjedha e mësipërme, por edhe nga gërryerja e tokës bujqësore.

Figura 44. Lënda e ngurtë pezull dhe e tretur në Shkumbin




	Shk. 1	Shk. 2	Shk. 3	Shk. 4	Shk. 5	Shk. 6	Shk. 7	Shk. 8	Shk. 9	Shk. 10	Shk. 11	Standard
Lënda e ngurtë e tretur (mg/l)	173	173	158	110	154	176	176	158	134	330	364	500
Lënda e ngurtë pezull (mg/l)	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	25

Burimi: Co-PLAN dhe PLGP, 2015

Shkumbini ka përmbajtje brenda normave[89] të lejuara të ***nitrateve*** ($N\text{-}NO_3$) dhe përmbajtje të lartë të ***nitriteve***[90] ($N\text{-}NO_2$) duke filluar nga Ura e Cërrikut deri në grykëderdhje. Përmbajtja e ***amoniakut*** ($N\text{-}NH_4$) paraqitet e lartë në Urën e Cërrikut, ndërkohë që në pikat e tjera të monitorimit përmbajtja është brenda normave të lejuara[91]. Ndërkohë, në rast se bazohemi në standardet e përdorura nga AKM[92], vlerat e nitrateve, nitriteve dhe amoniakut janë brenda normave të lejuara në të gjitha pikat e monitorimit, me përjashtim të pikës së Rrogozhinës, ku vlerat e amoniakut dhe nitriteve klasifikohen si të kategorisë së tretë (gjendje e moderuar). Krahasuar ndërmjet tyre, Shkumbini ka përmbajtje të lartë nitrati, të ndjekur nga amoniaku dhe nitritet. Azoti, së bashku me përbërësit e tij, është një ndër lëndët kryesore ushqyese për bimët dhe kafshët, por i mbipërdorur në bujqësi si pleh kimik dhe për shkak të derdhjeve industriale, të ujërave të zeza e të gropave septike, shkakton ndotjen e ujërave të lumenjve. Ndërkohë, sulfatet në Shkumbin janë në nivele të ulëta krahasuar me vlerat e lejuara[93]. Prania e sulfateve rritet gradualisht nga Kombinati Metalurgjik deri në grykëderdhje të Shkumbinit, edhe pse vlerat mbeten gjithmonë brenda normave.

Figura 45. Amoniaku, nitratet dhe nitritet në Basenin e Lumit Shkumbin



	Shk. 1	Shk. 2	Shk. 3	Shk. 4	Shk. 5	Shk. 6	Shk. 7	Shk. 8	Shk. 9	Shk. 10	Shk. 11
NH4 (mg/l)	0.12	0.12	0.08	0.13	0.17	0.96	1.02	0.25	0.13	0.32	0.05
NO2 (mg/l)	0.003	0.006	0.006	0.016	0.020	0.005	0.040	0.180	0.051	0.070	0.030
NO3 (mg/l)	0.230	1.400	1.700	0.130	1.600	1.200	0.280	0.390	0.150	0.240	0.370


Burimi: Co-PLAN dhe PLGP, 2015

Nivele të larta të ndotjes në Shkumbin hasen për sa i përket bakterieve koliforme dhe metaleve të rënda. Koliformet janë mbi nivelin e lejuar (200 Cfu/100ml)[94] në të gjitha pikat e monitorimit.


Rezultatet e monitorimit janë tregues të nevojës për monitorim të mëtejshëm të ujërave të Shkumbinit për të përcaktuar nëse ujërat e tij janë të përshtatshme për ujitje dhe not.

Metalet e rënda janë monitoruar në dy pika monitorimi (përpara Uzinës së Metalurgjikut dhe tek Ura e Paperit) të cilat janë në territorin e Bashkisë. Ujërat janë të ndotur me plumb (Pb), kadmium (Cd), nikel (Ni), arsenik (As), hekur (Fe), bakër (Cu), dhe krom (Cr)[95].


Figura 46. Metalet e rënda në Basenin e Lumit Shkumbin




	Shk. 8	Shk. 9	Standard
Pb (µg/L)	630	200	7.2
Cd (µg/l)	120	110	0.09
Ni (µg/l)	220	180	20



	Shk. 8	Shk. 9	Standard
As (µg/l)	2	2	1



	Shk. 8	Shk. 9	Standard
Fe (mg/l)	39	46	0.3




	Shk. 8	Shk. 9	Standard
Cu (mg/l)	0.10	0.25	0.04
Cr (mg/l)	0.05	0.05	0.002

Burimi: Co-PLAN dhe PLGP, 2015

Ndërkohë, vlerat e zinkut (Zn) dhe të arsenikut (Hg) janë brenda parametrave mjedisorë.

Figura 47. Metalet e Rënda në Basenin e Lumit Shkumbin



Burimi: Co-PLAN dhe PLGP, 2015

- Burimet e ndotjes së burimeve ujore sipërfaqësore

Urbanizimi i rajoneve të pozicionuara thuajse në brigjet e lumenjve me ujë të bollshëm e të rrjedhshëm, zgjerimi i metropoleve, zhvillimi i hovshëm i industrisë, i sektorit të bujqësisë dhe shumë aktivitete të tjera prodhuese industruiale ka shfrytëzuar ujrat e rrjedhshme sipërfaqësore si pritësin ideal të shkarkimeve, duke i ndotur ato. Sot, rreth 60% e popullsisë vazhdon të përdorë burimet natyrore[96] ndërkohë që pjesa tjetër është ndikuar nga ndotjet e grumbulluara dhe është e detyruar të orientohet nga konsumi i ujit të ambalazhuar. Fatkeqësisht, kjo gjendjeështë krijuar kryesisht për arsyen se në vendin tonë, mbrojtja e ujërave nëntokësore nga ndotja parashikohet në Ligjin nr. 111/2012,[97] por zbatimi i tij ne terren mbetet jo-efektiv.

Sot, burimet kryesore të ndotjes së lumenjve në territorin e Bashkisë janë të shumtë. Ndër ta përmenden shkarkiminet e drejtpërdrejta të ujrave të ndotura në sipërfaqe ujore *(pa iu nënshtruar proçeseve të pastrimit në impiantet e trajtimit të ujrave të ndotura),* përdorimi i zonave në brigjet e lumit për venddepozitime mbetjesh urbane e të ngurta (depwrtimi i shllameve dhe derdhjet aksidentale të mbetjeve të ngurta në ujrat e rrjedhshëm të lumit krijon drejtpërsëdrejti ndotje), shkarkime të ujrave të ndotura industriale, shfrytëzimi i shtratit të Shkumbinit për materiale inerte, shkarkimet dhe depërtimet e ujrave të përdorura në sektorin e bujqësisë drejtpërdrejt në lumë, shkarkimet e ujrave të larta në lumë, etj.

Secili prej burimeve të ndotjes ka një potencial specifik të ndotjes, i cili përshkon një shteg të caktuar gjatë shpërhapjes së tij në trupin ujor dhe, si përfundim, një mjedis pritës i cili bart këtë ndotje. Këtu vlen të theksohet, se pritësit kryesor të ndotjes së lumenjve janë deti Adriatik dhe më pak deti Jon. Për shkak të ndotjes së lumenjve, në deltat e lumenjve vërehen nivele të larta të ndotjes si nga cilësia e ujrave edhe nga mbetjet e ngurta.Efekti fillestar, që kanë këto ndotje të përmëndura më lartë,është dëmtimi i ekosistemit të ujrave të rrjedhshëm si dhe modifikimi i cilësisë së tyre në aspektin përmbajtësor të elementëve ushqyes. Konkretisht në Bashkinë Elbasan, ujrat sipërfaqësore të Lumit Shkumbin mbartin sasi të mëdha të ujrave të ndotura urbane të cilat shkarkohen sistematikisht nga Bashkia Librazhd, Bashkia Përrenjas por edhe nga NjA-të e Bashkisë Elbasan si Labinot Mal dhe Fushë.Më poshtëprezantohetnjë përmbledhje e shkurtër e burimeve kryesore të ndotjes së burimeve kryesore ujore (Lumit Shkumbin kryesisht) në Bashkinë Elbasan.

Ndotja nga venddepozitimet e mbetjeve urbane: Vend-depozitimi i vjetër i mbetjeve i cili përdorej deri para pak kohësh, paraqet probleme të mëdha lidhur me ndotjen e ujërave

të Lumit Shkumbin dhe rrezikimit të shëndetit të banorëve për arsye të ndryshme. Së pari, vend-depozitimi ndodhet buzë lumit Shkumbin, jo më tepër se *100m nga shtrati i lumit,* duke ndotur vazhdimisht ujrat sipërfaqësore të lumit Shkumbin si edhe Akufierin Quaternar të Elbasanit. Kjo për arsye se ky venddepozitim ndodhet në një zonë të papërshtatshme gjeologjikisht për vend-depozitim për shkak të territorit me shtresa gjeologjike me koeficient të lartë të depërtimit të ujrave nga sipërfaqja në akuifer. Duke patur si referencë hartat dhe raportet e SHGJSH-së[98], akuiferi, nga pjesa jugore e Elbasanit deri në afërsi të Cërrikut është me përbërje aluvionale (zhavorrore dhe poroze). Një terren i tillë bën të mundur depërtimin e shllamit të mbetjeve në ujërat e lumit Shkumbin dhe më tej në ujërat e Akuiferit të Elbasanit, i cili përdoret për furnizimin me ujë të popullsisë Elbasan dhe të zonave përreth. Me pak fjalë, lëndët toksike që çlirohen gjatë procesit të shpërbërjes së mbetjeve në këtë vend-depozitim depërtojnë drejtpërsëdrejti në ujrat nëntokësore të Akuiferit të Elbasanit duke rrezikuar shëndetin e popullsisë së zonës si dhe duke ndotur Shkumbinin dhe tokën përreth. Ndotja është edhe më e theksuar në kohë reshjesh, të cilat përshpejtojnë depërtimin e ujërave sipërfaqësore në Akuiferin e Elbasanit.

Ndotja nga shkarkimet e ujrave të ndotura urbane: Shërbimi i Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Bashkinë Elbasn, prej më se 25 vitesh, e ofron shërbimin e grumbullimit të ujrave të ndotura urbane në brendësi të hapsirave të banuara të Qytetit Elbasan si edhe në disa prej NjA-ve të saj (Figura në seksionin 1.7.2). Këto ujra të ndotura shkarkohen në ujrat sipërfaqësorë të Lumit Shkumbin dhe në përroin e Zaranikës pa asnjë trajtim paraprak veçse trajtimit biologjik shumë të kufizuar, që mund të realizohet në disa seksione të kanalit të hapur nga bimësia e rritur si pasoje e ujrave të eutrofikuar.

Në NjA-të e tjera shërbimi i grumbullimit të ujrave të ndotura nuk ofrohet. Si zgjidhje e përkohshme kanë qënë dhe vazhdojnë të mbeten gropat septike pa kushte teknike të mbrojtjes mjedisore dhe sanitare. Ujërat e ndotura shkarkohen më pas në rrjedhën më të afërt ujore ose, në disa raste, edhe në kanalet e hapura.

Kolektorët dytwsorw të lidhur me pusetat e shërbimit Ø300 – Ø600 prej betoni të parafabrikuar, shkarkojnë në 10 kolektorët kryesorë Ø800 – Ø1000, ku 7 prej tyre shkarkojnë drejtpërdrejt në lumin Shkumbin e pjesa tjetër në përroin e Zaranikës.

Në këtë sistem, siç raportohet nga vetë Bashkia Elbasan, ka mjaft seksione të dëmtuara ç'ka ka ndikuar në përkeqësimin e situatës mjedisore në ato zona ku ndodhin këto shkarkime të pakontrolluara. Gjithsej janë identifikuar mbi 19 pika shkarkimi (Figura në seksionin 1.7.2).

Impianti i trajtimit të ujrave të ndotura urbane ka si qëllim primar të tij "rehabilitimin" e cilësisë së ujrave të ndotur në ato nivele, ku impakti i tyre do të ishte sa më minimal për trupat ujore natyrorë pritës. Në Bashkinë Elbasan aktualisht një impiant i tillë po projektohet të ndërtohet në zonën e dampës ku edhe po zhvillohet projekti i vend-depozitimit të ri rajonal. Momentalisht, të gjithë elementët ndotës, që bartin këto ujra shkarkohen në lumenj për të sedimentuar e depërtuar më pas në akuiferë, ndërsa një pjesë flokulojnë me rrjedhën ujore drejt ujrave detarë të kripur.

Ndotja nëpërmjet dampave ekologjike/septike: Dampat ekologjike/septike në vendin tonë janë vend-depozitime specifike, ku depozitohen materialet e përdorura gjatëproceseve prodhuese të industrisë. Zona e Elbasanit, edhe pse ka një aktivitet të theksuar të industrisë së përpunimit të metalit, sipas lejeve të mjedisit të lëshuara nga Ministria e Mjedisit në

vitin 2014, nuk ka një dampë e cila të plotësojë kushtet teknike dhe higjieno-sanitare në të cilën mund të grumbullohen ujërat e prodhuara gjatë aktivitetit të përpunimit metaleve, së bashku me mbetjet e ngurta. Si rrjedhojë, supozohet se një pjesë e nënprodukteve të mbetjeve nga përpunimi i metaleve kanë përfunduar dhe përfundojnë sistematikisht në tokat ku janë pozicionuar këto dampa si dhe në ujrat e lumit Shkumbin, ç'ka provon edhe praninë e mtaleve të rënda në këtë lumë.

Ndotja nga shkarkimet industriale: Në Elbasan ushtrojnë aktivitetin e tyre biznese të ndryshme në fushën e ndërtimit, agro-ushqimore, industri përpunuese etj. Sipas legjislacionit në fuqi për manaxhimin e mbetjeve industriale, bizneset duhet të mbajnë regjistrin e mbetjeve të prodhuara. Megjithatë, situata lidhur me mbetjet industriale në Bashkinë Elbasan mbetet ende e paqartë dhe informacioni rreth këtij fluski mbetjesh nuk është lehtësisht i gjindshëm. Vlerësohet se Bashkia Elbasan prodhon në total rreth 117 ton mbetje në ditë prej të cilave paraprakisht është vlerësuar se 14% e tyre janë mbetje industriale, ose rreth 5,986 ton mbetje industriale në vit[99].

Një aspekt problematik[100] për ndotjen deri në Shkurt 2016 ka qënë mënyra e trajtimit të mbetjeve industriale dhe ndotjes nga shkarkimet në ujë dhe tokë nga kompania KURUM (tani ALBKROM). Shpeshherë, kushtet teknike të trajtimit të mbetjeve industriale, si edhe kushtet e lejes mjedisore, nuk zbatoheshin duke stokuar mbetjet industriale në afërsi të lumit.

Probleme të ndotjes së burimeve ujore përbëjnë edhe zonat e nxehta mjedisore[101]ku bëjn pjesë Ish-Uzina e shkrirjes së ferrokromit, e cila prodhonte 400,000m^3 mbetje industriale, Kompleksi Metalurgjik, i cili prodhon sasi të mëdha të metaleve të rënda dhe kimikateve toksike, dhe Ndërmarrja e Furnizimit Industri-Miniera në Balëz, ku prodhohen 30 ton Cianid(shihni seksionin e Zonave të Nxehta Mjedisore). Në Elbasan ndodhet gjithashtu Uzina e Lëndëve Plasëse, në fshatin Mjekës, edhe pse nuk është renditur si pikë e nxehtë, pasi ndikimi i saj në popullsi, në turizëm dhe në biodiversitet nuk përbën rrezik të lartë[102].Sipas AKM-së, lëndët plasëse janë në përqëndrim shumë të lartë në llumin e kanaleve të shkarkimit të ujërave industriale, (Figura mëposhtë) edhe pse përmbajtja e tyre ulet ndjeshëm në pikën e shkarkimit[103]. Mbetjet ushtarake industriale që dalin nga furrat ruhen brenda territorit të godinës, në pritje të depozitimit të tyre në vend-depozitime të përshtatshme që deri më tani mungojnë në vendin tonë. Si rrjedhojë, për aq kohë sa Shqipëria nuk ka një vend-depozitim të tillë, këto mbetje do të vazhdojnë të ruhen në territorin e uzinës[104].

Figura 48. Zona e ndotur e Kombinatit Metalurgjik, Elbasan



Burimi: ASIG, 2015, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Një burim tjetër i ndotjes industriale janë edhe *ndërrimi apo grumbullimi i vajrave të makinave*, të cilat mund të përdoren si lëndë djegëse. Ato lehtësisht mund të derdhen në tokë dhe në sipërfaqe,e më pas të përfundojnë në lumë duke dëmtuar biodiversitetin dhe ekosistemin.

Figura 49. Zgjerimi i vend-depozitimit në harkun kohor 2003-2015



Burimi: ASIG, 2015, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Ndotja nga aktiviteti i shfrytëzimit të materialit inert nga shtrati i lumenjve: Ndonëse ky aktivitet është trajtuar nga akte të ndryshme ligjore në funksion të mbrojtjes së territorit dhe mjedisit, siç mund të përmendim këtu Vendimin nr.1 Datë21/06/2006 "Reduktimin e shfrytëzimit të inerteve në shtretërit e lumenjve", vihet re se firmat ndërtuese qëoperojnë

në Republikën e Shqipërisë vazhdojnë edhe sot shfrytëzimin e inerteve nga shtretërit e lumenjve. Vlerësohet se 2,000km^2 inerte të shtretërve natyrorë të lumenjve në Shqipëri janë zhvendosur nga ekskavatorë për në lavatriçe, të cilat gjenden jo larg nga shtretërit e lumenjve.

Figura 50. Pasoja të fuqisë gërryese të Lumit Shkumbin nën prurje të fuqishme



Burimi: Akriva Co-PLAN, 2016

Siç edhe dallohet më lart në foto, shtrati i lumit që përshkon të gjithë Bashkinë Elbasan, i është nënshtruar aktivitetit intensiv të shfrytëzimit të inerteve dhe modifikimit të vazhdueshëm të shtratit të tij. Humbjet e biotës ujore, në këto raste, janë maksimale, të cilat shoqërohen më pas me ndryshim rrënjësor të cilësisë së këtyre ujrave dhe, në disa raste,ndikimi më i ndjeshëm është ai i erozionit për formimin e shtratit të ri (shih seksionin "Hidromorfologjia e lumenjve dhe ndryshimet e saj").Ky fenomen është i pranishëm si në Lumin Shkumbin, edhe në përroin e Zaranikës. Ndikimi i parë që prodhon aktiviteti i shfrytëzimit të inerteve lumore është turbullimi i ujrave nga përzjerja dhe nxjerrja e materialit inert. Shfrytëzimi i shtretërve të lumenjve ka sjellë edhe një ndikim tjetër mjaft të rëndë në bregdetin tonë, ku sasia e inerteve që shkarkohen në det është ulur me ritme të shpejta, duke i dhënë kështu lehtësi ujrave detarë të përparojnë drejt vijës bregdetare, për të tërhequr në thellësi materialin inert të ngurtë bregdetar.


Ndotja nga sektori i bujqësisë: Kimikatet e përdorura në këtë sektor (pesticidet, plehrat kimikë etj.)prodhojnë një nivel të konsiderueshëm ndotjeje e cila shkakton shqetësime në florë dhe faunë si pasojë e elementëve kimikeqë shpërbëhen në këto ujra. Ndotja shtohet në rast reshjesh, të cilat shpëlajnë tokën bujqësore dhe përfundojnë në burime ujore sipërfaqësore. Duke parë shtimin e sasisë së përdorur të pesticideve në bujqësi, me futjen e bujqësisë së shkallës në Fushat e Elbasanit dhe praninë e nitrateve në ujë (nga monitorimet e AKM-së dhe PLGP/USAID-it), mendohet se bujqësia është shndërruar edhe në burim ndotës për lumin Shkumbin.

- <u>Burimet ujore nëntokësore</u>

Qarku i Elbasanit ka një rrjet të pasur burimesh ujore nëntokësore (akuiferë). Akuiferët shtrihen në zona me përbërje të ndryshme gjeologjike. Si rrjedhojë, ata kanë kapacitet të ndryshëm ujëmbajtës.[105] Akuiferët përbëjnë burimet kryesore të furnizimit me ujë për

popullsinë, industrinë, bujqësinë dhe aktivitetet të tjera ekonomike në territorin e Bashkisë së re të Elbasanit dhe bashkive të tjera përreth.
Akuiferët kanë një shtrirje të gjerë në nënterritorin e bashkisë, edhe pse është e vështirë të përcaktohet me saktësi sipërfaqa e tyre për shkak të studimeve të kryera në nivel rajoni[106].

Figura 51. Klasifikimi dhe Sipërfaqja e Akuiferëve në Qarkun Elbasan (në %)



Burimi: SHGJSH, 2014, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Bashkia e Elbasanit përfshin akuiferët e mëposhtëm:

- Akuiferë me porozitet ndërkokrrizor (të shkrifët)
- Akuiferë me porozitet poro/çarje
- Akuiferë me porozitet çarje-karst
- Jo-akuiferët të cilët kanë porozitet të pamjaftueshëm për të lejuar qarkullimin e ujit nëntokësor në sasi të shfrytëzueshme

Akuiferët shërbejnë për furnizimin me ujë të popullsisë së bashkive të ndryshme (Bashkive të Elbasanit, Peqinit, Belshit dhe Gramshit), për industri, ujitje, etj. Më poshtë paraqitet një përshkrim i shkurtër i akuiferëve më të rëndësishëm për furnizimin me ujë të popullsisë në Bashkinë e Elbasanit e që janë i) akuiferët me porozitët ndërkokrrizor të shkrifët , ii) akuiferët me porozitet çarje-karst, dhe iii) akuifer me porozitet çarje.

Akuiferët me porozitet ndërkokrrizor të shkrifët: Akuiferi me porozitet ndërkokrrizor (të shkrifët) i cili është formuar nga grumbullimi i zhavorreve dhe materialeve të tjera nga Lumi Shkumbin dhe Lumi Devoll[107]. Në këtë akuifer dallohen disa zona të cilat ndahenndërmjet tyre për nga kapaciteti përcjellës i ujit. Këto zona janë:

- zona me ujë-përcjellshmëri shumë të lartë, e cila përfshin *Fushën e Elbasanit.* Kjo zonë shtrihet nga *Fushë-Labinoti deri në Papër*[108] dhe përfshin zonën midis kodrave të Krrabës në veri, kodrave të Sulovës në jug, masivit Ultrabazik të Shpatit në lindje dhe zonës kodrinore të Dumresë në jug-perëndim.
- zona me ujë-përcjellshmëri shumë të lartë - të lartë *(zona Vidhas – Bujqës)*
- zona me me ujë-përcjellshmëri mesatare dhe të ulët që përfshin *Fushën e Peqinit* dhe *Luginën e Devollit* (nga Gramshi deri në Dëshiran).

Ky akuifer ka lidhje hidraulike të mirë të ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore dhe rezerva uji të konsiderueshme për shfrytëzim. Drejtimi kryesor i lëvizjes së ujërave nëntokësorë përputhet me drejtimin kryesor të luginës së Shkumbinit, paralel me lumin. Ujërat nëntokësore ushqehen kryesisht nga *lumi Shkumbin* dhe drenohen në perëndim drejt Rrogozhinës-Karinë[109]. Sipas SHGJSH-së, nga ky akuifer furnizohen me ujë të pijshëm *Bashkia e Elbasanit, Peqinit, Belshit dhe Gramshit* nëpërmjet shpimeve.

Akuiferët me porozitet çarje-karst: Këto akuiferë lidhen me shkëmbinjtë karbonatikë ku përfshihen kryesisht depozitime gëlqerore. Dallohen ndërmjet tyre për përcjellshmërinë tepër të ndryshueshme. *Masivi karbonatik i Polisit* është një ndër këto akuiferë i cili shtrihet nga Llënga në jug, deri në afërsi të Librazhdit-Hotolisht në veri[110]. Këto akuiferë, për shkak të karstit kanë forma karstike shumë të zhvilluara (copëtime të theksuara, kreshta malore, pllaja të vogla, shpate të thepisura ose shpella, dhe forma akullnajore karstike). Në krahun lindor të Masivit të Polisit dalin një numër i konsiderueshëm burimesh si Burimi i Llëngës, Burimet e Radiçinës, Burimet e Bërzheshtës në Librazhd dhe Burimi i Gjurajt në Librazhd.

Krahu perëndimor i masivit ka një numër më të paktë burimesh. Ndër to dallohen Burimet e Vilës në Elbasan, Burimet e Gurrës së Sopotit, Burimet e Dardhës dhe Brezi i gëlqerorëve Mirakë-Jabllanicë. Burimi i Grigjanit që ka furnizuar rrethin e Elbasanit me ujë për më se tridhjetë vjet del 2.5 km në lindje-verilindje të fushës së Mengelit, në kuotën 200 m. Burimi i Byshekut (Shushicë) del në krahun e majtë të lumit. Ky burim shfrytëzohet për furnizimin e centralizuar të disa fshatrave dhe objekteve blegtorale.

Akuifer me porozitet çarje: Lidhen ngushtë me shkëmbinjtë kompaktë dhe të çarë ultrabazikë ku futen masivët ultrabazik të Shpatit dhe Shebenikut. Dallohen për kapacitet ujëmbajtës të ulët me burime që rrjedhin kryesisht gjatë dimrit, në periudhën e reshjeve dhe që kanë prurje të vogla. Burime të tilla janë burimi i fshatit Buzg-Librazhd, burimet rrëzë malit të Valamarës. Në masivin e Bukanikut dallohen burimet e fshatit Petresh-Gjinar në Elbasan.

- Problematikat e Pellgjeve Ujore Nëntokësore

Në 20 vitet e fundit, vendi ynë ka njohur një rritje të lartë të numrit të popullsisë, shtrirje të urbanizimit në zona dikur të pamundura, zhvillim të sektorit të bujqësisë dhe zhvillim e diversifikim të industrisë pothuajse në të gjithë territorin. Si rrjedhojë, kërkesa për ujë të pijshëm nga popullsia dhe për përdorim nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë (kryesisht bujqësia dhe industria) është shtuar duke ushtruar një presion të jashtëzakonshëm mbi lumenjtë dhe akuiferët[111].

Për më tepër, Bashkia e Elbasanit është zonë me veprimtari industriale të ndryshme, zhvillim të bujqësisë dhe urbanizim të vazhdueshëm, që kanë çuar në ndotjen e lumenjve kryesorë (Shkumbinit dhe degëve të tij). Ndotja e lumenjve ka sjellë si pasojë edhe ndotjen e burimeve ujore nëntokësore nëpërmjet dëpërtimit të ujërave të lumenjve nëpër akuiferë. Ndotja e akuiferëve, që shërbëjnë për furnizimin me ujë të popullsisë, përbën rrezik për shëndetin e njeriut dhe banorëve. Më poshtë paraqiten problemet kryesore të ujërave nëntokësore të Qarkut të Elbasanit (ndotja dhe mbishfrytëzimi) dhe në veçanti të Akuiferit Quaternar të Elbasanit me shtrirje përgjatë lumit të Shkumbinit.

Mbishfrytëzimi i ujërave/mungesa e njohjes së kapacitet ujor të shfrytëzuar: Akuiferët ndërkokrrizorë dhe me çarje-karst dallohen për një kapacit të lartë ujëmbajtës. Për këtë arsye, akuiferët shfrytëzohen për furnizim me ujë të pijshëm, industri dhe bujqësi, në mënyrë të ligjshme dhe të paligjshme[112]. Në vitet e fundit, shfrytëzimi i ujit të këtyre akuiferëve është bërë pa u bazuar në një plan manaxhimi, gjë që do të bënte të mundur shfrytëzimin e qëndrueshëm të tyre. Si rrjedhojë, ujërat e akuiferëve janë shfrytëzuar përtej kapacitetit furnizues. SHGJSH-ja[113]raporton se mbishfrytëzimi i akuiferëve në Qarkun e Elbasanit ka ardhur si rezultat i i) shtimit të kërkesës për ujë të pijshëm, industri dhe bujqësi

sidomos në në periudhën e thatë (qershor-shtator), kur burimet e ujërave nëntokësore janë në nivelet më minimale, ii) rritjes së numrit të shpimeve private ose ilegale për shfrytëzimin e ujit për bujqësi dhe industri, dhe iii) shfrytëzimit pa kriter të shumë shpimeve të vjetra dhe të reja të kryera në akuiferë me presion dhe iv) ritmeve të larta të urbanizimit në zonën fushore, sidomos në dy dekadat e fundit.

Vetëm në Bashkinë e re të Elbsanit, sipas llogaritjeve të bëra kohët e fundit,[114] për plotësimin e nevojave të popullsisë së bashkisë me ujë nëpërmjet pus-shpimeve, shfrytëzohet një sasi prej 2,875m^3 ujë/orë. Sipas studimeve të kryera kohët e fundit, kërkesa aktuale për ujë në bashki është 1,699m^3/orë. Pra, nga pus-shpimet ka një mbishfrytëzim total prej +1,176m3/orë. Mbishfrytëzimi është vënë re edhe në puse të veçanta si pus-shpimi i Frigoriferit, i cili përdoret për furnizimin me ujë të qytetit të Elbasanit. Ky pus-shpimin shfrytëzohet 107% (nga 385l/sec që është kapaciteti i tij mbajtës pompohen 410l/sec).

Megjithatë, shifrat e sakta të shfrytëzimit me ujë nuk njihen për arsye se një pjesë e mirë e popullsisë nuk mbulohet me shërbimin e furnizimit me ujë. Nga një total prej 76,792, rrreth 39% e popullsisë (30,330) nuk kanë rrjet furnizimi me ujë të pijshëm.

Zonat pa lidhje me rrjetin janë kryesisht zonat rurale dhe përfshijnë:[115]:

- *Komuna Bradashesh (*fshatratFikasi, Kozani, Recani, Rila, Shemhilli, Shtemaj, Ulem, Gura Bardhe) me një popullsi prej 3,075;
- *Komuna Funar (*Fikasi, Kozani, Recani, Rila, Shemhilli, Shtemaj, Ulem, Gura Bardhe) 3,044
- *Komuna Gracen (*Bodini, Dopaj, Graceni, Gjorme, Mamel, Pajenga, Plangarica, Shengjini, Terbaci) 2,657;
- *Komuna Gjergjan (*Bujaras, Koder Bujaras), 1,606;
- *Komuna Labinot Mal (*Guri i Zi, Labinot Mal, Lamolle, Serice, Bene,Lukaxhi, Qafa, Shmili) 3,995;
- *Komuna Labinot Fushe* (Griqani Siperm) 605;
- *Komuna Paper (*Bizhuta, Broshka, Mamurrasi, Papri, Pajuni, Vidhas Hasgjel), 3,641;
- *Komuna Zavalinë (*Burrishta, Kamicani, Nezhani, Selta) 1,467;

Mungesa e shtrirjes së rrjetit të ujit të pijshëm i detyron banorët që të gjejnë zgjidhje vetjake të cilat janë kryesisht hapja e puseve ose përdorimi i burimeve më të afërta të mundshme[116]. Këto burime apo pus-shpime, përveç se hapen pa u bazuar në studime të mirëfillta hidrogjeologjike, e bëjnë të pamundur llogaritjen dhe kontrollin e sasisë së shfrytëzuar të ujit të akuiferëve[117].

Siç u theksua më sipër, përveç furnizimit me ujë të pijshëm, ujërat e akuiferëve ndërkokrrizorë dhe karstikë shfrytëzohen edhe për industri dhe bujqësi. Për fat të keq këto akuiferë shfrytëzohen gjerësisht edhe në mënyrë të jashtligjshme[118]. Shfrytëzimi i akuiferëve do të shtohet edhe më tej po të kihet parasysh se në vitet e ardhshme, kërkesa për ujë do të rritet. Sipas studimeve të USAID-it, kërkesa për ujë parashikohet se do të shkojë në rritje deri në 13,938m3/orë në vitin 2030, gjë që do të çojë në shfrytëzim të mëtejshëm të akuiferëve[119].

Sasia e ujit, që shfrytëzohet për çdo akuifer nga industria, bujqësia dhe sektorët të tjerë të ekonomisë nuk njihet. Ndaj mbetet urgjente krijimi i një pasqyre ujore për akuiferet (hyrje dhe dalje të ujit) me qëllim shfrytëzimin e ujit të akuiferit në mënyrë të qëndrueshme.

Ndotja e akuiferëve (Akuiferi Kuaternar i Elbasanit): Në Bashkinë e Elbasanit, akuiferët ndërkokrrizorë dhe me çarje-karst të gjendur drejtpërdrejt nën vendbanimet urbane dhe zona industriale dhe bujqësore, janë shumë të ndjeshëm ndaj ndotjes mjedisore nga pus-shpimet për ujë, derdhja e ujërave të zeza, mbetjet e industrisë dhe ato urbane, si dhe aktiviteti bujqësor. Sipas SHGJSH-së[120], rreziku i ndotjes së Akuiferit kuaternar të Elbasanit me shtrirje përgjatë lumit Shkumbinështë i lartë si pasojë e mungesës pothuajse të plotë të mbulesës ekranizuese të shtresave ujëmbajtëse, sidomos *në Krastën e Madhe dhe të Vogël*, si pasojë e popullimit të zonës së mbrojtjes sanitare në të dy Krastat, dhe si pasojë e shkarkimeve indrustriale në zonën e *Vidhasit*[121]. Për këtë arsye, keqmanaxhimi i mbetjeve të ngurta, të lëngëta dhe i ujërave sipërfaqësore si dhe mosmarrja e masave për mbrojtjen e lumit Shkumbin nga ndotja, shkakton ndotjen e këtij akuiferi.

Monitorimet e kryera nga SHGJSH-ja dhe të raportuara nga AKM-ja[122] për vitin 2014[123] për cilësinë e ujërave të Akuiferit Kuaternar të Elbasanit, kanë nxjerrë në pah ndotjen e akuiferit me metale të rënda (Ni, Mn, Zn, Pb, Cu, Co, Cr) dhe përbërës të azotit (NH_4 dhe NH_2). Akuiferi dallohet edhe për përmbajtje të ulët oksigjeni dhe me ujëra të forta dhe shumë të forta, gjë që vërteton praninë e disa metaleve të rënda në sasi të konsiderueshme në akuifer. Përmbajta e metaleve të rënda arrin deri në përmbajtjen maksimale të lejuar (PML). Më poshtë paraqitet një përmbledhje e parametrave problematikë, të nxjerrë në pah gjatë monitorimit të AKM-së. Akuiferi dallohet për:

Tabela 17. Monitorimi i ujërave nëntoksore Elbasan

Parametrat	Përmbajtja në pika e monitorimit				Shënime
	Krastë e Madhe	Krastë e Vogël	Vidhas	Divjakë	
O_2	e ulët, nën normën e STASH-it				
$N\text{-}NO_2$	e pranishme në ujë				Nuk lejohet në ujë të pijshëm[124].
$N\text{-}NH_4$	brenda përmbajtjes maksimale të lejuar (PML)				
Fortësia e përgjithshme			uji i fortë alkalin		
Mg			mbi standardin[125]		
Cl			mbi normën e lejuar		(nën NML)
SO_4			mbi normën e lejuar		(por nën PML)[126]
Ni, Mn, Zn, Pb, Cu, Co, Cr, Cd			Përmbajtja luhatet		arrin deri në (PML)

Burimi: AKM 2014

Siç vihet re më sipër, në akuifer gjendet prania e përbërësve të azotit (nitritit NO_2 dhe amoniakut NH_4). Prania e amoniakut dhe nitriteve në akuiferin e Elbasanit tregon qartë edhe ndotje të ujërave nëntokësore nga bujqësia ose aktivitetet të tjera të njeriut. Bujqësia e kultivuar në zonat fushore përreth lumit Shkumbin (në Fushën e Elbasanit) ka çuar edhe në rritjen e përdorimit të plehrave kimike të pasura me azot, fosfor, sulfate etj., të cilat shpesh ndikojnë në ndotjen e drejtpërdrejtë të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore. Përbërësit e azotit dhe sidomos nitratet janë plehra kimikë që përfundojnë nëpër burime ujore si rrjedhojë e vetive të tyre lëvizëse të larta. Në këtë mënyrë, përdorimi i tyre në

mënyrë të papërshtatshme (në kohë me shi apo në sasi më të mëdha se nevojat e bimëve) çon në rrëshqitjen e tyre nga toka në ujë duke shkaktuar ndotjen e burimeve sipërfaqësore dhe, nëpërmjet tyre, edhe burimet nëntokësore të ujit.

Përveç azotit, në akuifer vihet re mungesa e oksigjenit dhe prania e metaleve të rënda si: Ni, Mn, Zn, Pb, Cu, Co, Cr, Cd. Edhe pse elementë si Mg, Cl, SO4, gjenden në kushte normale nëpër akuiferë në varësi të përbërjes së shkëmbinjve ku shtrihet akuiferi, mbetet shqetësues niveli i lartë i të gjitha mikroelemnteve:Ni, Mn, Zn, Pb, Cu, Co, Cr, Cd në Akuiferin Quaternar të Elbasanit, sidomos në pus-shpimet Vidhas dhe Divjakë. Këto mikroelementë gjenden në nivele të ndryshme të lejuara në akuifer, deri në përmbajtjen maksimale të lejuar. Duhet theksuar se nga mikroelementët e monitoruar, Pb, Cd, Ni dhe Cr janë lëndë kancerogjene. Prania e tyre në akuifer në nivelet e raportuara përbën rrezik serioz për shëndetin e banorëve që furnizohen me ujë nga ky akuifer e që janë banorët e qytetit të Elbasanit dhe Komunave Bradashesh, Papër, dhe Shirgjan. Kjo sepse në Bashkinë e Elbasanit, stacionet e pompimit të furnizimit me ujë të pijshëm të qytetit të Elbasanit (Mengel, Krastë e Vogël dhe Frigoriferi),127 dhe Komunave Bradashesh, Papër, dhe Shirgjan, furnizohen nga Akuiferi ndërkokrrizor i Elbasanit.128 Pus-shpimet përkatëse nga të cilat marrin ujë banorët e të gjithë territorit të Bashkisë së Elbasanit janë paraqitur në tabelën e mëposhtme (Tabela. 70 në kapitullin 1.7.2). Ujësjellësit me pus-shpime në brigjet e lumit Shkumbin që shfrytëzojnë ujërat e Akuiferit Kuaternar të Elbasanit janë UK Elbasan, Ujësjellësi Bradashesh – Balldren, Ujesjellesi Papër, Ujësjellësi Shirgjan-Lixhë-Tregan, Ujësjellesi Thanë. Pus-shpimet e këtyre ujësjellëse ndodhen në brigjet e Lumit Shkumbin.

Për shkak të rreziqeve që mund të paraqiten për jetën e banorëve nga përdorimi i ujit të këtij akuiferi në rast ndotjeje, rekomandohet monitorimi i tij me qëllim përcaktimin e ndotjes së trashëguar nga zona industriale dhe ndikimin në jetën e banorëve.

- Burimet e ndotjes së Akuiferit Quaternar të Elbasanit brenda Bashkisë

Burimet e ndotjes së Akuiferit të Elbasanit janë të shumta. Më poshtë paraqitet një përshkrim i shkurtër i burimeve kryesore të ndotjes.

Mungesa e zonave higjieno-sanitare: SHGJSH-ja përcakton mungesën e zonave higjieno-sanitare përreth pus-shpimeve, si një ndër shkaqet kryesore të ndotjes së akuiferëve. Këto zona mungojnë si përreth pus-shpimeve legale ashtu edhe përreth pus-shpimeve të jashtëligjshme. Pus-shpimet e ligjshmejanë të shumta dhe përdoren nga ujësjellësit e Bashkisë për furnizim me ujë të popullsisë dhe nga industria. Një numër i madh i tyre gjenden përgjatë luginës së Shkumbinit dhe pellgjeve ujëmbledhëse përkatëse. Siç është raportuar më sipër, rreth 39% e popullsisë së Elbasanit nuk furnizohet me ujë të pijshëm[129]. Uji sigurohet kryesisht nga vetë banorët, duke përdorur burimin më të afërt të mundshëm [130] ose nëpërmjet pus-shpimeve. Mbi këtë akuifer ndodhet edhe zona industriale e qytetit të Elbasanit me Kombinatin Metalurgjik dhe aktivitetet të tjera indutriale shumë afër tij. Numri i saktë i pus-shpimeve industriale të jashtligjshmenë këtë zonë, sasia e ujit që pompohet dhe gjendja e zonave higjieno-sanitare përreth pus-shpimeve industriale nuk njihet.

Ky shfrytëzim i ujërave nëntokësore në mënyrë jo profesionale, si dhe të pakontrolluar si nga popullsia ashtu edhe nga industria rrezikon i) uljen e prurjeve në stacione, si dhe ii)

prishjen e cilësisë së ujërave të këtij akuiferi duke rrezikuar seriozisht furnizimin me ujë të rrethit në tërësi[131]. Mbetet fakt se për asnjërin nga këto pus-shpime (individuale, të ujësjellësve apo industriale) pavarësisht nëse janë të ligjshme apo jo, nuk dihet nëse përreth tyre ka zona të mbrojtjes higjieno-sanitare. Mungesa e zonave higjieno-sanitare bën të mundur që e gjithë ndotja përreth pus-shpimeve të kalojë drejtpërdrejt në akuifer.

Tabela 18. Pus-shpimet për përdorim industrial në Akuiferin Kuaternar të Elbasanit

Komuna	Baseni ujëmbledhës	Emri i burimit	Prurja e lejuar l/s	Qellimi i përdorimit
Bradashesh	Shkumbin	Pusi i Laboratorit	4	Teknologjik
	Shkumbin	Pusi i letres	4	Teknologjik
	Shkumbin	Pusi i madh	4	Teknologjik
	Shkumbin	Pusi Furra	4	Teknologjik
	Shkumbin	Pusi Elektrik	4	Teknologjik
	Shkumbin	Pusi Oksigjen	4.8	Teknologjik
	Shkumbin	Pusi Çelik	4.8	Teknologjik
	Shkumbin	Pusi i Petezimit	4.8	Teknologjik
	Shkumbin	Burimi Bradashesh	20	Teknologjik
	Shkumbin	Pusi Ferrokrom	20	Teknologjik

Burimi: Ministria e Mjedisit, 2015

Ndotja e Akuiferit të Elbasanit nëpërmjet lumit Shkumbin: Një tjetër burim ndotjeje për Akuiferin e Elbasanit mbetet lumi Shkumbin. Ky i fundit ndotet nga shumë burime të ndryshme, ndër të cilat edhe nga derdhja e ujërave të ndotur në të. Sipas studimeve të kryera nga USAID-i[132], sistemi i kanalizimeve të ujrave të përdorura të qytetit të Elbasanit është i kombinuar. Kjo do të thotë se ky sistem grumbullon së bashku ujrat e reshjeve atmosferike dhe ujërat e përdorura nga qendrat e banimit. Sistemi shtrihet në të gjithë qytetin dhe ka gjithsej 10 kolektorë. 7 nga 10 kolektorët e qytetit shkarkojnë ujërat e përdorura drejtpërsëdrejti në lumin Shkumbin, ndërsa 3 në Perroin e Zaranikes, i cili me tej i derdh ato në Lumin Shkumbin. Të gjitha ujrat e përdorura shkarkohen në mjediset pritëse (në Lumin Shkumbin) pa asnjë trajtim paraprak.

Edhe ujërat e ndotura të zonave rurale të Bashkisë së Elbasanit përfundojnë në Lumin Shkumbin në të gjitha zonat ku e lejon relievi. Sipas USAID-it[133], zonat rurale nuk mbulohen nga sistemi i grumbullimit të ujërave të zeza. Zakonisht, shtëpitë e banimit kanë gropa septike në oborret e shtëpiave, të cilat nuk kanë asnjë standard tekniko-sanitar. Në rastet kur është e mundur, ujërat e ndotura largohen nga shtëpitë në kanale të hapura kulluese pranë shtëpive të tyre, edhe kjo në mospërputhje me ligjin për mbrojtjen e burimeve ujore dhe mjedisit[134]. Për fat të keq, nuk dihet se cilat nga këto kanale kanë lidhje të drejtpërdrejtë me lumin Shkumbin, dhe se në cilat zona ujrat e ndotura të zonave rurale ndikojnë në ndotjen e e ujërave të akuiferëve.

Deri më sot, në mungesë të impianteve të trajtimit të ujërave të zeza dhe atyre industriale, Shkumbini ka shërbyer si kolektor ujërash të zeza, të bardha dhe industriale. Për këtë arsye, ka shumë mundësi që Shkumbini të ketë ndotur edhe Akuiferin e Elbasanit. Një tregues i mundshëm i ndotjes së Akuiferit të Elbasanit nga Shkumbini është prania e përbërësve të azotit (NH_4, NO_2) dhe disa metaleve të rënda (Pb, Ni, Cd, Cu, Cr , Mn, Zn, Co) si në ujërat e Shkumbinit[135] ashtu edhe në ato të akuiferit[136]. Pb[137], Cd, Ni dhe Cr janë lëndë kanceroze për shëndetin e njeriut. Pb[138] përbën rrezik për shëndetin e fëmijëve sepse mund të

shkaktojë dëmtime të përhershme në sistemin nervor, si dhe sëmundje në veshka, zemër, dhe në sistemin riprodhues. Cd njihet si lëndë kanceroze[139] dhe shkakton sëmundje të zemrës, çrregullime në zhvillimin eorganeve, në sistemit tretës, nervor, dhe atë të frymëmarrjes etj. Ni[140] është klasifikuar si lëndë kanceroze për shëndetin e njeriut sepse dëmton sistemin kardiovaskular, imunitetin, rrugët e frymëmarrjes etj. Ndërsa Cr[141] (*chromium* ose krom) është klasifikuar si lëndë kanceroze për njeriun,[142] sepse në doza të larta, kromi dëmton sistemin imunitar, veshkat, dhe rrugët e frymëmarrjes.

Duke qenë se ujërat e lumit Shkumbin shërbejnë si burim për Akuiferin Quaternar të Elbasanit, dhe se rreziku i ndotjes së Akuiferit kuaternar të Elbasanit me shtrirje përgjatë lumit Shkumbin është i lartë[143], derdhja e ujërave të ndotura në Shkumbin përbën element ndotjeje të Akuiferit. Sipas Sipas SHGJSH-së[144], rreziku i ndotjes së Akuiferit kuaternar të Elbasanit me shtrirje përgjatë lumit Shkumbin është i lartë si pasojë e *mungesës pothuajse të plotë të mbulesës ekranizuese të shtresave ujëmbajtëse*, sidomos në Krastën e Madhe dhe të Vogël, si pasojë e *popullimit të zonës së mbrojtjes sanitare në të dy Krastat*, dhe si pasojë e *shkarkimeve indrustriale në zonën e Vidhasit*[145]. Për këtë arsye, keqmanaxhimi i mbetjeve të ngurta, të lëngëta dhe i ujërave sipërfaqësore si dhe mosmarrja e masave për mbrojtjen e lumit Shkumbin nga ndotja, shkakton ndotjen e këtij akuiferi.

Ndotja e shkaktuar nga mbishfrytëzimi i ujërave të akuiferit: Përveç mungesës së zonave higjieno-sanitare dhe ndotjes së lumit Shkumbin, SHGJSH-ja thekson se ndotja e ujërave të akuiferëve ndodh edhe për shkak të mbishfrytëzimit të ujërave të tyre. Ky mbishfrytëzim rrezikon të përkeqësojë cilësinë e këtij akuiferi për shkak se një veprim i tillë shton kripëzimin e ujit mbi normat e lejuara për pirje.

Ndotja e akuiferëve nga shfrytëzimi i inerteve lumore të Shkumbinit: Lumi Shkumbin është burimi kryesor që ushqen me ujë akuiferin e Elbasanit. Si rrjedhojë, përkeqësimi i cilësisë së ujit të lumit ndikon drejtpërdrejt në ndotjen e ujërave të akuiferit. Sipas SHGJSH-së,[146] shfrytezimi i zhavorreve të lumenjve dëmton rëndë burimet ujore, si nga ana sasiore, ashtu edhe cilësore sepse zvogëlon zonën e ushqimit të akuiferëve dhe prish regjimin e ujërave nëntokësore në zonat e gërrmimeve. Për fat të keq, në vendin tonë lumenjtë janë shfrytëzuar në të gjitha mënyrat e mundshme. Shkumbini është shfrytëzuar dhe vazhdon të shfrytëzohet vazhdimisht në mënyrë të ligjshme ose jo për materialin e tij inert në rrjedhën e të mesme dhe të poshtme. Deri më sot, janë 7 aktivitete të regjistruara që ushtrojnë veprimtarinë e tyre përgjatë lumit Shkumbin vetëm në territorin e Bashkisë nga fshati Labinot-Fushë deri në Bradashesh, me pasoja të rënda për akuiferin dhe bashkinë (përmbytje të zonave përreth lumit duke çuar në humbje të tokave bujqësore si dhe ndotje të ujërave të akuiferit për shkak të prishjes së ekuilibrave hidrogjeologjikë. Aktiviteteve të ligjshme i shtohen edhe ato të paligjshme, numri dhe vendndodhja e të cilëve mbetet e paditur.

Tabela 19. Vendndodhja e aktivitetetve të liçencuara për shfrytëzimin e inerteve lumore

Nr.	Vendi	Emërtimi i aktivitetit	x	y
1	Klos	Inerte lumore	4420641	4537729
2	Klos		4416850	4539675
3	Shirgjan		4418180	4549782
4	Shirgjan		4421323	4550354
5	Bradashesh		4422162	4551639

6	Lab-fushë		4427178	4554418
7	Lab-fushë		4434451	4558944

Burimi: SHGJSH

- **Ajri**

Cilësia e ajrit në territorin e Bashkisë Elbasan paraqitet me variacione të ndryshme, për arsye të përdorimit të tokës dhe kushteve gjeo-fizike të territorit. Gjendja e cilësisë së ajrit në qytet paraqitet relativisht e ndotur (Figura mëposhtë)[147], ndërsa në zonat malore, ajri është i një cilësie shumë të mirë.

Përgjatë periudhës mes viteve 2002 - 2015, AKM-ja ka monitoruar cilësinë e ajrit në qytetin e Elbasanit në mënyrë të përsëritur[148]. Monitorimet janë kryer zakonisht në tre pika, ku janë vëzhguar gjashtë tregues (SO_2, NO_2, Pb, O_3, LNP dhe PM_{10}).Nga të dhënat e publikuara nga AKM-ja mbi mesataret vjetore të elementëve kryesor ndotës në qytetin e Elbasanit, vihet re një ulje e ndjeshme për të gjithë elementet e matur (Figura mëposhtë). Megjithatë, disa elementë mbeten ende mbi normat e lejuara të përqëndrimit të tyre në ajër (Normat e BE-së dhe R.SH-së).Tepër shqetesuese paraqiten vlerat e përqëndrimit në ajër të LNP-së dhe PM_{10} (Figura mëposhtë) të cilët qëndrojnë me vlera mbi normat e lejuara nga BE-ja dhe normatshqiptare, për të gjitha vitet e monitoruara. Vlerat e përqëndrimit të O_3. SO_2, dhe NO_2 kanë pësuar një rënie të ndjeshme në vitet e fundit, duke arritur të qëndrojnë nën vlerën e lejuar nga BE-ja dhe normën shqiptare.

Tabela 20. Vlerat mesatare të treguesve të monitoruar

Viti	SO_2	NO_2	Pb	O_3	LNP	PM_{10}
2002	38.00	33.00	0.16	57.00	366.00	175.00
2003	29.00	29.00	0.24	76.50	335.00	147.00
2004	20.00	25.00	0.32	96.00	304.00	119.00
2005	27.00	33.00	0.00	26.00	268.00	120.00
2006	22.00	22.00	0.27	26.00	191.00	90.00
2007	19.00	24.00	0.31	95.00	216.00	103.00
2008	8.67	22.25	0.06	46.24	144.65	57.16
2009	14.41	23.98	0.05	-	-	51.39
2010	18.40	29.39	-	-	-	116.44
2011	15.5	22.6	-	72	204	89.7
2012	14	22.5	-	70	-	85
2014	17	32	-	18	-	46
2015	7	24	-	33	-	45
Norma R.SH[149]	20.00	40	1	40	140	40
Normat BE[150]	20.00	40	0.5	40	90	40


Burimi: AKM 2002 - 2015

Sipas AKM-së 2015, vlerat mesatare dhe maksimale të përmbajtjes së metaleve të normuar (Cr, Mn, Ni, Pb) në mostrat e PM_{10} në qytetin e Elbasanit janë mjaft të ulta krahasuar me normat shqiptare dhe ato të BE-së. Vlen për t'u theksuar se vlerat e disa elementeve të matur gjatë 2015 janë më të ulta se matjet që janë kryer vitet e mëparshme.[151]

Marrë si referencë të dhënat e mësipërme të cilat tregojnë se ka tejkalim të normave të elementëve ndotës në ajër, mund të themi se faktor në këtë situatë, krahas shkarkimeve në

atmosferë nga industritë, mjetet e transportit publik dhe privat si dhe nga ndërhyrjet infrastrukturore, është edhe mungesa e gjelbërimit dhe hapsirave për rekreacion të cilat kryejnë, ndër të tjera, edhe funksionin e filtrimit të ajrit të ndotur dhe prodhimin e sasive të vogla të O_2 me rëndësi në cilësinë e ajrit në qëndrat urbane. Hapësirat e gjelbra ose bimësia urbane, siç quhet shpesh në literaturë[i], ndikojnë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi në përmirësimin e cilësisë së ajrit. Konkretisht, bimësia urbane ndikon në uljen e ndotjes nëpërmjet thithjes së ndotësve në gjendje të gaztë nga gjethet e tyre.
Në tabelën e, sipërfaqja e gjelbër për banor në zonat urbane është më e vogël se standardi, edhe pse Bashkia ka hapësira të mjaftueshme për të arritur standardtet e nevojshme të gjelbërimit të përgjithshëm publik dhe gjelbërimit të veçantë. Gjelbërimi në nivel njësie strukturore është 1,83m^2/banorë kundrejt 2m^2 që është standardi (ISTAT). Një situatë e ngjashme paraqitet lidhur me gjelbërimin masiv (0.60m^2/banorë kundrejt 4 që është standardi) dhe me gjelbërimin rrugor, sheshet, brigjet ujore dhe zonat urbane. Vetëm në zonat periferike vihet re që sipërfaqa e gjelbër është ose i tejkalon standardet.

Figura 52. Vlerat mesatare të treguesve të monitoriuar 2002-2014



Burimi: AKM 2002 – 2015, Punoi: Co-PLAN

- <u>Burimet e ndotjes së ajrit</u>

Burimet kryesore të ndotjes në Bashkinë Elbasan janë automjetet në zonat urbane, industria, sektori i ndërtimit, urbanizimi dhe, me ndikim më të ulët, janë manaxhimi i mbetjeve dhe bujqësia.

Siç u theksua më sipër, burimet e ndotjes së ajrit janë të ndryshme (urbanizimi, mjetet e transportit, industria etj.). Megjithatë, në Bashkinë Elbasan, ndotja nga makinat dhe industria mbetet burimi kryesor. Më poshtë paraqitet një përshkrim i shkurtër i burimeve kryesore të ndotjes së ajrit në Elbasan.

Ndotja nga operatorët industrial të mëdhenj: në periferi qytetit të Elbasanit, në largësi prej 4-5 km vijë ajrore, ushtrojnë aktivitetin industrial dy operatorë të mëdhenj si, "KURUM Steel" dhe "Fabrika e Çimentos ECF", të cilët shkarkojnë sasi të mëdha pluhuri dhe gazi në ajër. Këto shkarkime, të favorizuara nga kushtet atmosferike, shndërrohen në ndotësit më të mëdhenj të qytetit të Elbasanit.

Duhet theksuar se aktiviteti i fabrikës së çimentos, pas ristrukturimt, lëndën e parë e merr të gatshme dhe nuk kryen më pjekje pasi klinkeri mbërrin i përpunuar nga Fushë Kruja. Kjo ndërhyrje në këtë fabrikë ka nxjerrë jashtë funksionit furrën dhe oxhakun, duke reduktuar kështu edhe sasinë e emetimeve nga kjo sipërmarrje.

Kompleksi Metalurgjik, 4 km në periferi të qytetit, konsiderohet një ndotës i mirëfilltë i ndotjes së ajrit në qyte. Në këtë zonë ushtrojnë aktivitetin disa kompani me karakter prodhimi kimik, të cilat shkarkojnë sasi jo të vogla në ajër të SO_2 dhe pluhurit.

Të gjitha këto aktivitete së bashku janë përgjegjëse për pjesën më të madhë të shkarkimeve të SO_2, Co, No_x, PM_{10} dhe $PM_{2.5}$ dhe LNP, të cilat kanë ndikime të mëdha negative mepërqëndrim të lartë, si në mjedis, ashtu dhe në shëndetin e njerëzve.

Në teritorin e Bashkisë së Elbasanit ushtrojnë veprimtarinë e tyre edhe dy fabrika të tjera, të cilat kontribuojnë në shkarkimin e ndotësve në ajër, të cilat janë Fabrika e Punimeve Karbonike dhe Fabrika e Tullave Refraktare,destinacioni i së cilës është kthyer në tulla ndërtimore. Masa që përpunon fabrika e karbonit është e natyrës së pekut, të marrë nga destilimi i katranit të koksit. Ky katran ka në përbërje të tij me qindra komponentë organik, ku spikasin ato me natyre fenolike dhe ato të natyrës benzopirenit (lëndë kancerogjene).


Nga studime të Bashkisë Elbasan rezulton së 83% e ndotjes së ajri vjen si pasojë e aktiviteteve të operatoreve të mëdhenj industrial. Ndërsa pjesa tjetër i takon mjeteve të transportit dhe bizneseve të tjera të qytetit.

Ndotja nga mjetet e trasportit: Sipas të dhënave të Bashkisë Elbasan, por edhe të raporteve të tjera nga AKM-ja, në Bashkinë Elbasan, ndikim të rëndësishëm në ndotjen e ajrit në mjedis, në territorin e Bashkisë, kanë mjetet e trasportit të cilat shkarkojnë në ajër një numër të konsiderueshëm gazrash të dëmshme. Ndër gazrat kryesore renditen:

- monoksidi dhe dioksidi i karbonit (CO dhe CO_2 përkatësisht),
- substancat sulfurike (SOx),
- lënda e ngurtë pezull e përmasave të ndryshme (PM_{10} dhe $PM_{2.5}$, kryesisht),
- THC (sasia totale e shkarkimeve në ajër të hidrokarbureve)
- përbërësit organikë të avullueshëm (VOC),

Sasia e ndotësve që makinat shkarkojnë në ajër është e konsiderueshme. Nga llogaritjet e Agjencisë Amerikane të Mjedisit, një makinë e tonazhit të vogël (makinat për transport njerëzish deri në 12 vendëshe) shkarkon rreth ***5 ton CO_2 në vit*** (4.7metric tons)[152]. Kjo shifër vlen për makinat e prodhuara mbas vitit 2008 dhe me teknologji të përparuar. Nisur nga këto shifra, llogaritja e sasisë së ndotjes për 1 litër lëndë djegëse paraqitet si mëposhtë.

Figura 53. Sasia e CO2 që shkarkohet në ajër për çdo litër benzinë e naftë



Lënda djegëse	Gallon	g Gallon	g Liter
Benzinë	1	8.887	2.347.70
Naftë	1	10.180	2.689.27


Burimi: US EPA, 2016; Përgatiti: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Sasia e ndotësve, që shkarkohet në ajër nga një makinë e vogël individuale/pasagjerësh, varet nga një sërë faktorësh që janë lloji dhe përmasat e makinës (makinë e vogël, autobuz urban, kamion etj.), mosha dhe kilometrazhi, lloji i lëndës djegëse që përdor, kushtet

atmosferike (shi apo diell etj.), gjendja e makinës, mënyra e drejtimit të makinës etj.[153] Në rast ndryshimesh të këtyre kushteve, shkarkimet në ajër shtohen. Por, duhet patur parasysh se llogaritjet e mësipërme janë bërë për makina me teknologji më të zhvilluar se një pjesë e mirë e automjeteve që përdoren në Shqipëri, dhe për cilësi më të mirë të lëndës djegëse (shih seksionin e mëposhtëm). Për rrjedhojë, sasia e gazrave të shkarkuara nga një makinë në Shqipëri mund të jetë më e lartë se shifrat e sjella më sipër.

Rritja e numrit të makinave: Numri i makinave ka ardhur duke u shtuar nga viti në vit në mënyrë të theksuar në rang vendi. Nëse në vitin 2000 numëroheshin rreth 55 makina /1,000 banorë, në vitin 2010 numri i makinave në Shqipëri arriti 120.8 makina për 1,000 banorë (Figura mëposhtë).[154] Ndërkohë, në Bashkinë Elbasan, numri i makinave i regjistruar është më i vogël se mesatarja kombëtare, 54 makina/1000 banorë (INSTAT 2011) ose rreth 7,830 makina në nivel Bashkie dhe 4,428 makina në Qytetin e Elbasanit. Numri i makinave në Bashkinë e Elbasan për vitet 2015-2016 mungon.


Figura 54. Numri i makinave në Shqipëri për 1,000 banorë ndër vite[155]



Burimi: Ministria e mjedisit dhe UNDP, 2016[156]

Ndërsa numri i makinave për banorë ka ardhur duke u rritur në mënyrë të theksuar në vend, numri i pasagjerëve që udhëtojnë me tren është ulur në mënyrë drastike (Figura mëposhtë). Nga statistikat e viteve 2005-2013,[157] ky numër ka pësuar rënie të ndjeshme.

Figura 55. Numri i pasagjerëve dhe tonazhi i mallrave që transportohen me tren në Shqipëri



Burimi: Ministria e mjedisit dhe UNDP, 2016[158]


Me rritjen e makinave, rritet edhe sasia e shkarkimeve në ajër të ndotësve. Në rastin e CO_2, në qoftë se do të marrim për bazë shifrën 5 ton CO_2 në vit/makinë, sasia e CO_2 e shkarkuar në ajër vetëm nga mjetet individuale të transportit (makinat familjare) ***në nivel bashkie***

është rreth 39,150 ton CO_2 /vit (7,830 automjete x 5 ton CO_2/automjet ne vit = 39,150ton/CO_2/vit) ndërsa në nivel ***qyteti 22,140 ton CO_2/vit***. Pra, 56.5% e sasisë së gazrave të dioksidit të karbonit shkarkohet vetëm në Qytetin e Elbasanit.

Në vitet në vijim, ekziston mundësia që ndotja nga mjetet e transportit të shtohet për arsye se numri i makinave dhe investimet e Qeverisë Shqiptare në ndërtimin e infrastrukturës rrugore (dhe jo në investime në zhvillimin e llojeve alternative si treni, etj.) po shtohen. Sipas Ministrisë së Mjedisit dhe UNDP-së, rreth 55% e investimeve publike të Shtetit Shqiptar kanë shkuar në infrastrukturë rrugore[159]. Ndërkohë, transporti hekurudhor është lënë pas dore edhe pse Shqipëria është angazhuar për përmirësimin e tij në vitet në vijim. Në vitin 2006, Shqipëria nënshkroi Aktin e Stabilizim-Asociimit, i cili nënkupton rindërtimin e hekurudhës sipas kodeve dhe standardeve të BE-së[160]. Megjithatë, fondet për zhvillimin e trasportit hekurudhor mendohet të përftohen nga donatorët.

Ndotja nga cilësia jo e mirë e lëndës djegëse: Në vendin tonë, lënda djegëse për mjetet e transportit nuk është e mirë dhe kjo është e dukshme edhe vizualisht. Për më tepër, është vërtetuar edhe nga Inspektorati Qendror Teknik. Në periudhën janar-shtator 2014, Inspektorati Qendror Teknik (sipas të dhënave të publikuar nga AKM-ja) ka monitoruar cilësinë e lëndës djegëse në vend, konkretisht të *naftës*[161], *benzinës dhe solar-mazutit*. Mostrat e analizuara për vlerësimin e cilësisë së ajrit janë marrë para zhdoganimit të lëndës djegëse dhe pas hyrjes në tregun e brendshëm shqiptar. Në total, janë analizuar 164 mostra, të ndara në tre grupe, 122 për naftën, 31 mostra për benzinën dhe 11 për solar-mazutin (Figura mëposhtë).

Figura 56. Numri i mostrave të analizuara të lëndës djegëse



Burimi: AKM (Inspektorati Qendror Teknik), Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN[162]

Rezultatet e monitorimit të lëndës djegëse për naftën dhe benzinën janë paraqitur mëposhtë[163]:

Figura 57. Rezultatet e monitorimit të cilësisë së lëndës djegëse në Shqipëri

Vlerat e Sulfurit	Lënda djegëse			
	Gazoil		Benzinë	
	Mostrat (numër)	Mostrat (%)	Mostrat (%)	Mostrat (numer)
11-15ppm	6	4.9	16.1	5
16-20ppm	2	1.6	19.4	6
20-50ppm	14	11.5	29.0	9
>50ppm	100	82.0	35.5	11
Totali	**122**			**31**


Burimi: AKM (Inspektorati Qendror Teknik)[164]

Për naftën, nga 122 mostrat e analizuara, 82% e mostrave (100 mostra) përmbajnë mbi 50ppm sulfur, 11.5% e tyre (ose 14 mostra) përmbajnë nga 20-50ppm, ndërsa 6.5% e mostrave (8 mostra) përmbajnë nga 11-20ppm. Në rastin e benzinës, nga 31 mostrat e analizuara, 35.5% e mostrave (11 mostra) përmbajnë mbi 50ppm sulfur, 129% e tyre (ose 9 mostra) përmbajnë nga 20-50ppm, ndërsa 3.5% e mostrave (11 mostra) përmbajnë nga 11-20ppm.

Në bazë të standardit EN 590 për naftën dhe EN 228 për benzinën, vlera kufi e lejuar e përmbajtjes së squfurit në naftë është *10 ppm*. Nga analiza e mostrave të benzinës dhe naftës rezulton se përmbajtja e sulfurit është mbi vlerën e lejuar në të gjitha mostrat. Ndryshimi ndërmjet naftës dhe benzinës qëndron vetëm në vlerat më të larta të shkaktuara në ajër. Nafta ka numrin e mostrave me përmbajtje më të lartë të sulfurit (82% kundrejt 35.5%). Përmbajtja e sulfurit ndryshon tendencë në rastin e grupimit 20-50ppm. Në këtë rast është benzina që ka numrin e mostrave me përmbajtje më të lartë squfuri (29% të mostrave të benzinës kundrejt 11.5 të gazoilit).

Si përfundim, në bazë të rezultateve të mësipërme rrjedh se të dyja llojet e lëndës djegëse që përdoren në vendin tonë (nafta dhe benzina) kanë përmbajtje të lartë të squfurit. Ndryshimi i vetëm qëndron në faktin se përmbajtja e squfurit në rastin e naftës arrin kufinj më të lartë se sa në rastin e benzinës (Figura mëposhtë).

Figura 58. Përmabjtja e squfurit në naftë dhe benzinë (numri i mostrave në %)



Burimi: AKM (Inspektorati Qendror Teknik), Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN[165]

Testime janë bërë edhe për Solar-Mazutin[166]. Të 11 mostrat e monitoruara rezultojnë me përmbajtje më të lartë squfuri (mbi 3%). Në bazë të standardit S SH UNI 6579, për analizimin e lëndës djegëse (gazoil), vlera kufi e lejuar e përmbajtjes së squfurit në gazoil


është < 3%. Mostrat e analizuara rezultojnë se përmbajtja e squfurit është mbi 3%. Si përfundim, mund të thuhet se lënda djegëse (nënproduktet e naftës) që shitet në tregun shqiptar është e një cilësie jo të mirë.[167]

Veç kësaj, në përgjithësi, në Shqipëri preferohet përdorimi i naftës përkundrejt benzinës, për shkak të kostove relativisht më të ulëta. Sipas të dhënave të publikuara në Manualin e Kontrollit, Mirëmbajtjes dhe Sigurisë së Automjeteve, përgatitur nga ECAT[168], në seksionin e shkarkimeve në ajër nga automjetet raportohet se *87% e automjeteve në vend përdorin si lëndë djegëse naftën* dhe *13% benzinën.*

Ndotja nga mosha e vjetër e mjeteve të transportit: Sipas Ministrisë së Mjedisit dhe UNDP-së, Shqipëria ka rreth 350,000 makina, pjesa më e madhe e të cilave janë makina të përdorura[169]. Me rritjen dramatike të numrit të makinave dhe mbi të gjitha të numrit të makinave të vjetra, trafiku në zonat urbane është tashmë një ndër shkaqet kryesore të ndotjes së ajrit.[170] Siç e theksuam edhe më parë, shkarkimet në ajër nga makinat shtohen edhe me rritjen e vjetërsisë së automjeteve për shkak se këto të fundit nuk arrijnë të bëjnë djegien e plotë të lëndës diegëse.

Sipas një studimi të kryer për automjetet në Tiranë, del se 36% e automjeteve me benzinë të prodhuara ***para*** vitit 1986 dhe 27% e atyre ***pas*** vitit 1986 shkarkojnë CO mbi normat e lejuara. Në rastin e automjeteve me naftë, pavarësisht nga viti i prodhimit, 39.7% e tyre i tejkalojnë normat e lejuara për koefiçentin K të tejdukshmërisë së lejuar, i cili është K 2.5.[171].

Figura 59. Numri i makinave (në %) që shkarkojnë CO e HC mbi vlerat e lejuara në ajër, sipas vitit të prodhimit



Burimi: ECAT 2008[172], Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN

Sipas Ministrisë së Mjedisit dhe UNDP-së, mjetet me benzinë çlirojnë sasi më të mëdha CO dhe HC në ajër në krahasim me mjetet me naftë. Nga ana tjetër, mjetet me naftë çlirojnë më shumë grimca prej karboni elementar, përbërës organikë të karburantit dhe vajra lubrifikante të motorit, sulfate të formuara nga squfuri i karbonit dhe gjurmë përbërjesh metalike. Përbërësit organikë, zakonisht përbëjnë 10-30% të grimcave totale. Por, në motorat e vjetër, përbëjnë deri në 90%. Ky është rasti tipik i Shqipërisë ku shumica e motorave diezel janë prodhime të vjetra dhe pa pajisje të sistemeve mbrojtëse.[173]

Ndotja nga sektori i ndërtimit: Sipas të dhënave nga Bashkia Elbasan, burim tjetër për ndotjen e ajrit janë edhe ndërtimet e reja në zona të ndryshme të qytetit, të cilat ndonëse janë të pajisura me VNM[174], ku përcaktohen qartë rregullat që duhet të ndjekin kantierët e ndërtimit, ndodh shpesh që punimet kryhen pa marrë masat e nevojshme dhe koha e

ndërtimit është më e gjatë se sa është planifikuar. Në shumë raste, zonat e banuara janë pre e pluhurit (PM_{10} dhe $PM_{2.5}$) në ajër të shkaktuar nga kantieret e ndërtimit të ndërtesave dhe të ndërhyrjeve në infrastrukturë.

Venddepozitimet e mbetjeve: është një burim i konsiderueshëm ndotës i ajrit, pasi nuk është në standardet e kërkuara teknike dhe higjieno-sanitare për depozitimin e mbetjeve. Depozitimi i mbetjeve kryesisht shkarkon në ajër gazin metan, i cili ka ka aromë të keqe dhe, në përqëndrim të lartë, është irritues dhe shkakton probleme në sistemin e frymëmarrjes dhe në sistemin nervor.

Sektori i bujqësisë: gjithashtu ka një kontribut të rëndësishëm në ndotjen e ajrit në territorin e Bashkisë, kryesisht në çlirimin e gazrave gjatë shpërbërjes së mbetjeve organike dhe plehut organik.

- Ndikimi i ndotjes në shëndetin e njeriut

Siç e pamë më sipër, makinat, industria etj., shkarkojnë në ajër një numër jo të vogël ndotësish me ndikim në shëndetin e njeriut. Ndër më kryesorët janë O_3, CO, CO_2, SO_x (SO_2), PM (PM_{10} dhe $PM_{2.5}$), Pb, VOC dhe O_3. Më poshtë sillet një përmbledhje e rreziqeve që i kanosen shëndetit të njeriut nga çdo ndotës në veçanti. Vlen të theksohet se nuk është studiuar ndikimi në shëndetin e njeriut i efekteve që vijnë nga ndërveprimi i ndotësve së bashku (pasojat akumulative/grumbulluese).

Monoksidi i karbonit (CO)[175]: Ekspozimi ndaj përqëndrimeve të larta të monoksidit të karbonit mund të shkaktojë probleme akute me frymëmarrjen, helmim, humbjen e vetëdijes, vdekje, humbje ekulibri, dhimbje koke, dobësim të muskujve, të përzjera dhe të vjella. Problem kritik ndaj ekspozimit të monoksidit të karbonit kanë gratë shtatëzëna tek të cilat mund të shkaktojë abort, të rrisë rrezikun e dëmtimit të fetusit, lindjen e foshnjës me peshë të ulët dhe dëmtim të sistemit nervor. Grupet më të ndjeshme ndaj helmimit nga monoksidi i karbonit janë fëmijët e vegjël, gratë shatëzëna,të moshuarit, njerëzit me anemi, njerëzit që vuajnë nga sëmundjet e zemrës dhe mushkërisë dhe përdoruesit e duhanit. Në afate të gjata, ekspozimi ndaj monoksidit të karbonit me vlera të ulta, mund të shkaktojë lodhje, dhimbje gjoksi, humbje të kujtesës, sëmundje të zemrës, dëmtim të sistemit nervor, simptoma gripi dhe probleme me lëkurën në rastet kur mund të ketë kontakt me monoksidin e karbonit në formë të lëngët.

Dioksidi i karbonit (CO_2)[176]: Dioksidi i Karbonit ne formë e tij të gaztë është asfiksues për arsye se vështirëson furnizimin normal të trupit me oksigjen gjatë frymëmarrjes, sidomos në hapësira të mbyllura. Ekspozimi në një mjdedis me përqëndrim të $CO_2 \geq 10\%$ mund të shkaktojë vdekje, humbje ndjenjash, apo marrje mendsh. Gjithashtu ekspozimi ndaj një përqëndrimi të lartë të CO_2 mund të dëmtojë zhvillimin e fetusit. Ekspozimi i vazhdueshëm ndaj CO_2, në përqindje më të ulët se 10% mund të shkaktojë problem me shikimin, bllokim të rrugëve të frymëmarrjes, dëmtimin e sistemit nervor qëndror, kontraktimin e muskujve, ngritjen e tensionit të gjakut. Gjithashtu ekspozimi mund të shkaktojë marrje mendsh, dhimbje të vazhdueshme koke, djersitje të vazhdueshme, lodhje, mpirje, humbje të kujtesës, të përziera, të vjella, depresion, probleme me lëkurën, djegie të syve dhe zhurma në vesh.

SO_2[177]: Ekspozimi afatshkurtër ndaj niveleve të larta të SO_2 në ajër mund të jenë të rrezikshme për jetën duke shkaktuar vështirësi në frymëmarrje dhe bllokim të rrugëve të

frymëmarrjes, sidomos për njerëzit me sëmundje të mushkërive. Ekspozimi afatgjatë ndaj niveleve më të ulta të SO_2 mund të shkaktojë bronkit kronik, emfizemë, sëmundje të frymëmarrjes dhe mund të përkeqësojë sëmundjet ekzistuese të zemrës.

Kur dioksidi i squfurit reagon me kimikate të tjera në ajër, formon grimca të vogla sulfate. Këto grimca mund të mblidhen në mushkëri gjatë frymëmarrjes dhe të shkaktojë rritjen e problemeve të frymëmarrjes dhe vështirësi në frymëmarrje. Ekspozimi afatgjatë ndaj grimcave sulfate mund të shkaktojë sëmundje të frymëmarrjes, madje edhe vdekje të parakohshme.

Të sëmurët me astmë janë shumë të ndjeshëm ndaj ekspozimit të dioksidit të squfurit, por edhe të njerëzit të cilët vuajnë nga sëmundjet e zemrës mund të përkeqësohen gjatë ekspozimit ndaj SO_2

PM (PM_{10} dhe $PM_{2.5}$)[178]: Është vërtetuar shkencërisht se përqëndrimet e larta të grimcave në ajër (PM_{10} dhe $PM_{2.5}$) paraqesin një kërcënim serioz për shëndetin e njeriut. Grimcat me diametër më të vogël në ajër shfaqin probleme të rënda në shëndet, pasi ato depozitohen në pjesët fundore të mushkërive dhe qëndrojnë aty për një kohë të gjatë ose depërtojnë në gjak. Ekspozimi në periudha të gjata ndaj lëndës së ngurtë në ajër shkakton rritjen e sëmundjeve të frymëmarrjes,ul funksionin e mushkërive, shkakton bronkit kronik, madje dhe vdekje të parakohshme për shkak të problemeve me frymëmarrjen. Grimcat e shkarkuara nga automjetet që përdorin lëndë djegëse diesel, janë vërtetuar të kenë ndikim në shtimin e mundësisë për t'u prekur nga kanceri.

Grupet e njerëzve më të prekur nga problemet shëndetësore që shkaktojnë grimcat janë fëmijët, të moshuarit dhe njerëzit që vuajnë nga sëmundje të mushkërisë dhe zemrës.

Pb[179]: Sipas Agjencisë Amerikane të Mjedisit, plumbi mund të jetë lëndë kanceroze për shëndetin e njeriut. Plumbi përbën rrezik për shëndetin e fëmijëve sepse mund të shkaktojë sistemin nervor në mënyrë të përhershme, dhe të shkaktojë sëmundje në veshka, zemër, dhe në sistemin riprodhues. Niveli i plumbit në gjak konsiderohet si shumë i rrezikshëm pavarësisht nga sasia e tij. Plumbi gjendet në formë inorganike si në lëndë djegëse, bojëra, kompjutera, bizhuteri, dhera dhe produkte të tjera, në miniera, që është edhe forma më e përhapur sot. Plumbi në trup merret nëpërmjet të ushqyerit apo frymëmarrjes.

VOC[180]: Ekspozimi afatgjatë ndaj komponimeve organike të paqëndrueshme mund të shkaktojë dëmtimin e mëlçisë, veshkave dhe sistemit nervor qendror. Ndërsa ekspozimi afatshkurtër mund të shkaktojnë probleme në sy, acarim të rrugëve të frymëmarrjes, dhimbje koke, marrje mendsh, çrregullime vizuale, lodhje, reaksione alergjike të lëkurës, vjellje, dhe dëmtim të kujtesës.

O_3: Ekspozimi ndaj përqëndrimit të lartë të Ozonit (O_3) mund të shkaktojë dëmtim të përhershëm të mushkërive, sidomos tek fëmijët, mushkëritë e të cilëve janë në zhvillim. O_3 mund të shkaktojë probleme me lindshmërinë dhe probleme gjenetike si dhe mund të rrisë mundësinë e dëmtimit të fetusit. Ekspozimi ndaj këtij gazi mund të përkeqësojë sëmundjet kronike të mushkërive, tëzvogëlojë sistemin imunitar, tëpërkeqësojë sëmundjet e astmës dhe ato të zemrës dhe shkaktojë depozitime të lëngëta në mushkëri, duke vështirësuar ndjeshëm frymëmarrjen. Simptomat fillestare të ndikimit të O_3 në shëndet fillojnë me irritimin e rrugëve të frymëmarrjes, shkaktimin e kollës si dhe ndjesi shqetësuese në fyt

dhe në gjoks. Futja e O_3 në organizëm nëpërmjet frymëmarrjes shkakton gjithashtu dhimbje koke, dhimbje stomaku, si dhe lodhje dhe të vjella.


1.4.3 Peizazhi, pyjet, zonat e mbrojtura dhe biodiversiteti

- **Pyjet dhe Kullotat**

Në vitin 206, fondi pyjor dhe kullosor kaloi në pronësi të Bashkisë Elbasan, me përjashtim të sipërfaqes së fondit pyjor e kullosor që është pjesë e territorit të zonave të mbrojtura (VKM nr. 433, datë 8/6/2016 "Për transferimin e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë").

Sot, Bashkia Elbasan ka në pronësi të saj 40,349.58 ha sipërfaqe pyjore, 7,075.75 kullosore dhe 5,768.91 ha sipërfaqe me bimë pyjore (Figura mëposhtë). Sipërfaqe të konsiderueshmë zënë tokat improduktive dhe ato djerr, përkatësisht 5,094.48 ha dhe 13,946 ha.

Figura 60. Përdorimi i pyjore e kullosore në Bashkinë Elbasan (në ha)[181]



Burimi: Bashkia Elbasan; Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Sipas të dhënave për shpërndarjen e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore në territorin e NJA-ve të Bashkisë Elbasan, dallohet qartë që NJA-të me sipërfaqe më të madhë të fondit pyjor është Zavalina e cila ka sipërfaqen më të madhe prej 3,131.76ha dhe NjA-të Papër me 2,605.35ha e ndjekur nga NJA Shushicë, Gjinar dhe Labinot Mal. NJA-të me sipërfaqe kullosore më të madhë janë Tregan dhe Zavalinë, përkatësisht 965.89ha dhe 676.55ha (Tabela mëposhtë). Duke analizuar me kujdes të dhënat vihet re që zona inproduktive me sipërfaqen më të madhe ndodhet në NJA-të Papër dhe Funar (901.25 dhe 415.00ha). NJA-të Gjinar dhe Zavalinë kanë në territorin e tyre edhe zona pyjore me status të mbrojtur me ligji (zona të mbrojtura) të cilat aktualisht menaxhohen nga AdZM Elbasan.

Figura 61. Përdorimi i territorit sipas zonave, Bashkia Elbasan

Nr	NjA/Komuna	Kategoria e përdorimit	Sipërfaqja (ha)	Totali (ha)
1	k/Gjinar	djerrë	45.85	8500.43
		inproduktive	444.15	
		kullotë	882.96	
		livadh	146.08	
		pyll	6532.28	
		tokë me bimësi pyjore	449.11	
2	k/Funar	djerrë	20.25	5546.55

		inproduktive	873.5	
		kullotë	163	
		livadh	78.75	
		pyll	3851.35	
		tokë me bimësi pyjore	539.95	
		ujore	19.75	
3	k/Gjergjan	kullotë	141.5	320.5
		pyll	122.5	
		tokë me bimësi pyjore	56.5	
4	k/Gostimë	inproduktive	6	187.18
		pyll	99.5	
		tokë me bimësi pyjore	81.68	
5	k/Grecen	inproduktive	430.6	4997.75
		kullotë	773.5	
		pyll	2841.9	
		tokë me bimësi pyjore	950.5	
		ujore	1.25	
6	k/Grekan	inproduktive	6.5	1220.35
		kullotë	116	
		pyll	913.75	
		tokë me bimësi pyjore	138.6	
		ujore	45.5	
7	k/Kajan	pyll	100.5	153.5
		tokë me bimësi pyjore	53	
8	k/Klos	kullotë	224	715.09
		pyll	378.29	
		tokë me bimësi pyjore	112.8	
9	k/Labinot Fushë	inproduktive	208.75	2659.15
		kullotë	104	
		livadh	66	
		pyll	2062.15	
		tokë me bimësi pyjore	218.25	
10	k/Labinot Mal	inproduktive	928.55	7077.16
		kullotë	635.25	
		livadh	145.75	
		pyll	4658.31	
		tokë me bimësi pyjore	708.8	
		ujore	0.5	
11	k/Mollas	inproduktive	17	2430.92
		kullotë	994.55	

		pyll	1116.55	
		tokë me bimësi pyjore	302.82	
12	k/Papër	inproduktive	901.25	4115.1
		kullotë	450.5	
		pyll	2557.85	
		tokë me bimësi pyjore	205.5	
13	k/Shalës	pyll	989.52	1211.01
		tokë me bimësi pyjore	221.49	
14	k/Shirgjan	kullotë	18.5	183.46
		pyll	69	
		tokë me bimësi pyjore	95.96	
15	k/Shushicë	djerrë	8.73	6013.17
		inproduktive	396.33	
		kullotë	647.8	
		livadh	55	
		pyll	4861.71	
		tokë me bimësi pyjore	43.6	
16	k/Tregan	inproduktive	94.63	3431.38
		kullotë	1044.1	
		pyll	2286.22	
		tokë me bimësi pyjore	6.43	
17	k/Zavalinë	djerrë	34.64	6382.06
		inproduktive	422.98	
		kullotë	490.09	
		livadh	119.06	
		pyll	4570.05	
		tokë me bimësi pyjore	740.91	
		ujore	4.33	
18	k/Bradashesh	inproduktive	347.75	2859.75
		kullotë	147.5	
		livadh	4.5	
		pyll	1858	
		tokë me bimësi pyjore	500.5	
		ujore	1.5	
19	Elbasan Qytet	djerrë	30	1146
		inproduktive	16.5	
		kullotë	177.5	
		livadh	134	
		pyll	445.5	
		tokë me bimësi pyjore	342.5	

TOTALI	**59150.51**

Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Në territorin e Bashkisë, një sipërfaqe prej 144,19ha e fondit pyjor wshtw me pronësi private. Nga sipërfaqja me pronësi private, 73.45ha ka funksion prodhues dhe përbëhet nga bimësi të llojit trungishte halore (Tabela mëposht). Problematikë e fondit pyjor në pronësi private qëndron në faktin që nuk mbarështohet në mënyrë të qëndrueshme. Nga përvoja të përgjithshme në rang vendi, fondi pyjor në pronësi private është shfrytëzuar përtej aftësive për ripërtëritje. Në shumë raste, nuk janë marrë masa për ripyllëzimin e këtyre zonave private, duke u shndërruar në sipërfaqe të zhveshura.


Figura 62. Sipërfaqja e pyjeve dhe kullotave me pronësi private në Bashkinë Elbasan (në ha)

Funksioni i pyjeve		Lloji i bimësisë së pyjëve		Forma morfologjike	
Prodhues	73.45	Trungishte	73.45	Fletorë	0.00
Mbrojtës	0.00	Cungishte	0.00	Halorë	73.45
Mbrojtës+prodhues	0.00	Shkurre	0.00		
Konservues	0.0				

Burimi: Bashkia Elbasan

Siç vihet re në tabelën e mësipërme, sipërfaqja më e madhe e fondit pyjor është shpërndarë në NJA-të Tregan, Zavalinë, Labinot Mal, Gracen dhe Gjinar. Nga krahasimi në hartë (Figura mëposhtë) i fondit pyjor të dokumentuar në hartat e 1984-1985 me ortofoton e vitit 2015 (*nga Google Imagery*) vërehet një tkurrje e konsiderueshme e sipërfaqeve pyjore në territorin e Bashkisë, rreth 34.3%, kryesisht në zonat ku është përqëndruar aktiviteti njerëzor.

Figura 63. Harta e Fondit Pyjor



Burimi: Drejtoria Rajonale e Shërbimit Pyjor Elbasan; Përgatiti: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Ndonëse analiza është kryer në GIS, vlen të merret parasysh ekzistenca e një marzhi të vogël gabimi pasi hartat e vjetra janë të një teknologjie të vjetër, lexueshmëria e legjendës dhe simbolikës është e vështirë si dhe mbivendosja/përshtatja me ortofoton e 2015, gjithashtu ka një marzh gabimi si pasojë e ndryshimeve në territor. Vizitat e vazhdueshme në terren dhe konsultat mes specialistëve të pyjores dhe banorëve/pronarëve mund ta zgjidhin këtë ngërç dhe të saktësojnë informacionin/analizën e mëtejshme.

Kushtet klimatike, hidrologjike dhe gjeomorfologjike në territorin e Bashkisë Elbasan kanë mundësuar rritjen e një larmishmërie drurësh. Ndër to veçohen ekualipti, pisha e butë, plepi, dafina dhe bliri pasi këta përbëjnë disa nga llojet që janë përshtatur më së miri në territorin e Bashkisë si dhe ndikojnë në përmirësimin e klimës që karakterizon këtë zonë. Ekualipti *(Ekualiptus globulus)* ndikon në përmirësimin e ajrit, pisha e butë *(Pinus pinea)* përmirëson ajrin dhe shton vlerat estetike të sipërfaqeve pyjore me kurorën e saj ovale si dhe është mjaft rezistente ndaj erërave, plepi *(Populus canadensis)* për pyllëzimin e brigjeve të lumenjve (zonave ripariane) pasi ndikon në mbrojtjen e tyre nga erozioni, dafina *(Laurus nobilis)* përmirëson cilësinë e ajrit dhe merr vlera ekonomike si bimë mjeksore si dhe bliri *(Tilia cordata)* për vlerat ekologjike që ka.

- Problematikat kryesore të fondit pyjor

Mungesa e invetarizimit periodik i fondit pyjor e kullosor: të dhënat rreth sipërfaqeve pyjore e kullosore në vendin tonë dhe në Bashkinë Elbasan bazohen në inventarin e fundit të këtij fondi i cili i përket viteve 1984-1985. Që nga regjistrimi i fundit, nuk ka patur përpjekje të reja për një inventar të përditësuar edhe pse me ligj parashikohet inventarizimi çdo dhjetëvjeçar. Si rrjedhojë, në vendin tonë dhe në Bashkinë Elbasan, të dhënat e inventarëve shpesh janë kontradiktore.

Humbja e sipërfaqes pyjore: Një ndër problematikat kryesore të pyjeve në Bashki është humbja e sipërfaqes pyjore në dy dhjetëvjeçarët e fundit. Nga inventarizimi i fundit i pyjeve në vitin 1984-85 deri në vitin 2015, del se Bashkia Elbasan ka humbur ose tjetërsuar një sipërfaqe të konsiderueshme të fondit pyjor (rreth 34.3% sipas analizës së realizuar nw GIS).

Prerja e pyjeve: Në territorin e Bashkisë janë vërejtur prerje të vazhdueshme të pyjeve për lëndë djegëse dhe për tregëtim tw lwndës drusore. Aktualisht, prerja e pyjeve është e ndaluar (Moratoriumi 10 vjeçar i pyjeve), ndaj zbatimi i moratoriumit është jetik për mbarështimin e pyjeve.

Djegia e pyjeve: Ashtu si në të gjithë vendin, edhe në Bashkinë Elbasan janë vwnw re raste të djegies së pyjeve (rasti i pyllit me pisha në afërsi të fshatit Polis i Vogël). Duke qënë një terren i thyer, kontrolli dhe ndërhyrja në raste zjarri është tejet i vështirë.


Tjetersimi i sipërfaqeve të fondit pyjor: Tjetërsimi i fondit pyjor në kullotë është një fenomen i cili praktikohet gjërësisht në vend, në rastet më të shumta ndodh fenomeni i zjarr-vënies e, më pas, kthimi në kullotë për bagëtinë.

- Pyjet dhe biodiversiteti në territor

Peizazhi është gjithçka që duket në territor mbi sipërfaqen e tokës dhe mund të studiohet në drejtimin estetik dhe dejtimin funksional që lidhet me shërbimet e ekosistemit. Të dyja këto drejtime janë të lidhura ngushtë me njëra-tjerën dhe në fakt, aspekti funksional ndikon

atë estetik. Në territorin e Bashkisë Elbasan peizazhi ndahet në pesë fasha (tipologji) kryesore: ***urbane, industriale, rurale, natyrore*** dhe ***ujore*** (Figura mëposhtë).


Tabela 21. Harta e tipologjive të Peizazhit (Fashat)



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016.

Krijimi i fashave peizazhistike në territorin e Bashkisë lidhet ngushtë me formacionet territoriale, hidrogjeologjinë dhe hidrografinë, si dhe pjerrësitë e terrenit. Megjithëse këta pwrbwrws kanë tipologji të ndryshme nga njeri-tjetri dhe gjenden në zona të ndryshme të territorit, parë në shkallë peizazhi ata përbëjnë një të vetëm, duke ofruar shumëllojshmëri peizazhistike brenda kufirit bashkiak.

Figura 64.Harta e tipologjive të peizazhit dhe fondi pyjor



Burimi: Drejtoria Rajonale e Shërbimit Pyjor Elbasan; Përgatiti: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Në këtë larmishmëri peizazhistike dallohet ***fasha natyrore,*** e cila është edhe fasha më e ndërlikuar në matricën peizazhistike. Kjo fashë karakterizohet nga sipërfaqe pyjore, fusha të hapura, korridore të gjelbëra apo ujore, zona tampon, zona ripariane, zemra e habitatit, ngastra, si dhe mozaikë. Po në këtë fashë përfshihet edhe sipërfaqja më e madhe e fondit pyjor dhe zonat e mbrojtura natyrore brenda territorit të Bashkisë. Gjithashtu, lehtësisht e dallueshme është edhe ***fasha rurale*** e cila karakterizohet nga toka bujqësore, toka të hapura të pozicionuara në mënyrë "informale", grupime pemësh/shkurresh, pemë të mbjella në rresht (vijë tampon) të cilat herë duken të mbjella nga njeriu e herë vetvetiu nga natyra, trupa ujorë (lumenj, kanale, rezervuare, etj.).

Ndonëse një fashë komplekse dhe me diversitet të larmishëm biologjik, për shkak të zhvillimit njerëzor në tërësi dhe bujqësor në veçanti, fasha natyrore shfaqet e fragmentuar në tërësinë e vet.

Tipologji tjetër peizazh-krijuese në Bashkinë Elbasan është ***fasha/njolla urbane*** ku peizazhi shpaloset në zona banimi dhe shërbimesh me një karakter ***formal***. Këtu, peizazhi karakterizohet nga pemë të mbjella afër njëra-tjetrës përgjatë akseve rrugore, pemë apo grupime pemësh zbukuruese, parqe si dhe zona tampon.

Peizazhi industrial shfaqet i pa ndashëm nga fasha urbane, me përjashtim të pjesës qëndrore të territorit, specifikisht në Njësinë Administrative Elbasan (Sipërfaqe ish-industriale dhe industriale). Ky peizazh ka po ashtu karakter ***formal*** ndonëse bimësia është më e rallë. Po ashtu, në krasitjen e paraqitjen e tyre i përkushtohet rëndësi zbukurimit, më tepër se sa funksionit dhe shërbimit mjedisor. Si në rastin e pemëve në peizazhin urban,


edhe këtu ato preferohen të jenë vendase dhe me kurorë të gjerë për të hijëzuar hapësira parkimi apo publike.

Fasha e fundit është ajo e ***sipërfaqeve ujore***, e cila karakterizohet nga të gjithë trupat ujorë sipërfaqësorë, duke përfshirë lumenjtë, rezervuaret, kanalet vaditëse, shatërvanet dhe zonat ujëmbajtëse sezonale. Peizazhi ujor mbizotwrohet nga lumi Shkumbin dhe degët e tij dhe rezervuarët në të gjithë territorin e Bashkisë.

- **Peizazhi**

Lisi, ose dushku siç quhet në disa treva shqiptare, ka qenë një pemë shumë e përhapur që formonte formacione të mëdhej pyjorë, ashtu si dhe sot. Për banorët Prehistorikë kjo pemë në jetën e përditëshme të tyre përbënte gjithçka, ishte vetë jeta e tyre (Sipas J. Diamond, 2002)

Figura 65.Harta peizazhistike dhe rrugët në Bashkinë Elbasan




Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016.

Ndonëse pjesë kryesore dhe e pandashme e peizazhit urban, ***rrugët*** ashtu si edhe sipërfaqet ujore, shtrihen në mbarë territorin e Bashkisë, duke krijuar "çarje" të tipologjive peizazhistike. Nga ana tjetër, ato krijojne edhe lidhje fizike e pamore mes tipologjive peizazhistike. Këto rrugë u përkasin kategorive të ndryshme nga madhësia, po ashtu edhe funksioni, por elementi i përbashkët dhe i pa ndryshuar mbetet peizazhi. Në hartën e peizazhit (Figura mësipër), rrugët shfaqen si "kanale" lidhëse pa trashësi të përcaktuar, apo kategorizim funksional. Pra, në vend të funksionit e lidhjes që ato krijojnë mes zonave, në analizën peizazhistike, ato karakterizohen vetëm nëpermjet imazhit që secila përcjell në fashën peizazhistike ku kalon.

- Elementet përbërëse të peizazhit

Figura 66. Harta e tipologjive të Peizazhit (Fashat)




Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Analiza Peizazhistike e qytetit të Elbasanit trajton një sërë komponentësh peizazh-formues, të cilët kategorizohen në:***urban***ë, ***industrial***ë, ***rural***ë, ***natyror***ëdhe***ujor***ë. Megjithëse këta komponentë kanë tipologji të ndryshme nga njeri-tjetri dhe gjenden në zona të ndryshme të territorit, parë në shkallë peizazhi ata shndërrohen në një të vetëm, duke ofruar shumëllojshmëri peizazhistike brenda kufirit bashkiak.

Në këtë larmi peizazhistike mbizotëron ***fasharurale***,e cila karakterizohet nga toka të hapura të pozicionuara në mënyrë "informale", grupime pemësh/shkurresh, pemë të mbjella në rresht (vijë tampon), të cilat herë duken të mbjella nga njeriu e herë në mënyrë spontane nga natyra, trupa ujorë (lumenj, kanale, rezervuare etj) dhe ***fasha natyrore,*** e cila është edhe fasha më komplekse në matricën peizazhistike. Kjo fashë karakterizohet nga sipërfaqe pyjore, fusha të hapura, korridore të gjelbëra apo ujore, zona tampon, zona ripariane, zemra të habitatit, ngastra, si dhe mozaikë. Po në këtë fashë përfshihet edhe sipërfaqja më e madhe e fondit pyjor dhe zonat e mbrojtura natyrore brenda territorit të Bashkisë Elbasan.

Figura 67. Harta e tipologjive të peizazhit dhe fondi pyjor



Burimi: Drejtoria Rajonale e Shërbimit Pyjor Elbasan, Përpunoi Co-PLAN, 2016

Ndonëse një fashë komplekse dhe me diversitet të larmishëm biologjik, për shkak të formacionit gjeologjik, zhvillimit njerëzor në tërësi dhe bujqësor në veçanti, fasha shfaqete fragmentuar në tërësinë e vet.

Dy tipologjitë e tjera peisazh-krijuese të Bashkisë Elbasan janë **fasha urbane**; ku peizazhi përbëhet nga zona rezidenciale dhe komerciale me një karakter "*formal*", i cili karakterizohet nga pemë të mbjella afër njëra-tjetrës përgjatë akseve rrugore, pemë apo grupime pemësh zbukurimi, parqe, si dhe zona tampon.


Peizazhi industrial i përafrohet atij *formal,* ndonëse bimësia është më e rallë dhe rëndësia në krasitjen e paraqitjen e tyre i kushtohet funksionitdekorues se sa atijndërveprues mjedisor. Si në rastin e pemëve në peisazhin urban, edhe këtu ato preferohen të jenë vendase dhe me kurorë të gjerë për të hijëzuar hapësira parkimi apo publike.

Fasha e fundit është ajo e **sipërfaqeve ujore**, e cila karakterizohet nga të gjithë trupat ujorë sipërfaqësor, duke përfshirë lumenjtë, rezervuaret, kanalet vaditëse, shatërvanet dhe zonat ujëmbajtëse sezonale. Peizazhin ujor e dominon veçanërisht lumi i Shkumbinitt dhe nëndegët e tij të shumta.

Ndonëse pjesë dominuese dhe e pandashme e peizazhit urban, **rrugët** ashtu si edhe sipërfaqet ujore shtrihen në mbarë territorin e Bashkisë duke krijuar "çarje" të tipologjive peizazhistike. Nga ana tjetër, ato krijojnë edhelidhje fizike e pamoremes tipologjive peizazhistike. Këto rrugë i përkasin kategorive të ndryshme për nga madhësia, po ashtu edhe për nga funksioni, por elementi i përbashkët dhe i pa ndryshuar mbetet peizazhi. Në

hartën më poshtë (*Harta Peizazhistike dhe Rrugët*), rrugët shfaqen si "*kanale*" lidhëse pa trashësi të përcaktuar apo kategorizim funksional. Pra në vend të funksionit, lidhja që ato krijojnë mes zonave, NjA-ve apo qyteteve, në analizën peizazhistike, karakterizohet vetëm nëpërmjet imazhit që secila përcjell në fashën peizazhistike nga ku kalon.

Figura 68. Harta Peizazhistike dhe Rrugët



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

- Elementet përbërës të peizazhit

Elementët e peizazhit natyror: Identifikimi i elementeve peizazhistike në fashën natyrore të territorit të Bashkisë Elbasan, ku pjesë e pandashme janë edhe sipërfaqet e Fondit Pyjor dhe të Zonave të Mbrojtura Natyrore, merr rëndësi të veçantë, pasi identifikimi dhe leximi i këtyre elementeve ndikon drejtpërsëdrejti në të kuptuarin e biodiversitetit lokal, potencialin e ekoturizmit si dhe gjendjen e fondit pyjor, përfshirë mbrojtjen e tij e të fashës natyrore në tërësi nga rreziqet natyrore dhe njerëzore. Elemente të peizazhit natyror që gjenden në territorin e Bashkisë Elbasan, si ***zonat ripariane***, ***korridoret***, ***kopshtet ujëmbajtëse*** etj., luajnë një rol të rëndësishëm edhe në krijimin e mikroklimës në zonat ku ato shtrihen. Zonat *ripariane,* të cilat natyrshëm shtrihen përgjatë trupave ujore si lumenj, përrenj, kanale dhe rezervuare parandalojnë erozionin ujor, krijojnë strehë dhe ofrojnë ushqim për gjallesat e ndryshme ujore e tokësore që frekuentojnë këtë mjedis, krijojnë mikroklimë të vetën, ofrojnë habitatin e nevojshëm për mbarështimin e këtyre specieve dhe mbrojnë burimet ujore nga derdhja e nutrientëve (ushqyesve me tepricë), që rezultojnë nga përdorimi i plehrave kimike dhe pesticideve në tokë bujqësore.

Figura 69. Zonë ripariane e zhveshur nga bimësia autoktone si pasojë e zhvillimit të bujqësisë



Burimi: ASIG, 2015

Rripat e gjelbër, korridoret dhe korridoret lidhës[182] marrin një rol po aq të rëndësishëm sa edhe zonat ripariane, pasi ato luajnë rolin e venave në peizazh duke ***lidhur*** parcelat, ngastrat, sipërfaqet ujore, apo matricat peizazhistike me njëra-tjetrën. Ato ofrojnë edhe ***vendkalime*** për specie të ndryshme, mbrojnë biodiversitetin lokal si dhe krijojnë ***barrierë*** natyrore për erën. Në territorin e Bashkisë Elbasan rripat e gjelbër, parcelat e lidhura dhe ato të ndara mbizotërojnë në peizazhin natyror. Ato ndahen në dy kategori; ***natyrore*** dhe ato ***të mbjella*** nga fermerët me bimë si robinja (Robinia Pseudoacacia), rrapi (Platanus), shelgu (Salix) dhe plepi i bardhë (Populus Alba), të cilët në pjesën më të madhe shtrihen përgjatë tokave bujqësore si elemente ndarës pronësie por edhe si pasojë e kushteve të krijuara për rritjen dhe zhvillimin natyror të këtyre bimëve në këto rripa të gjelbër dhe koridore.

Figura 70. Rrip i gjelbër me bimësi të ulët përgjatë një kanali vaditës




Burimi: ASIG, 2015

Korridorët, krahas rëndësisë peizazhistike që mbartin, karakterizohen nga shërbime të shumta ekologjike në përgjithësi të përhershme si strehimi, ushqimi e vendet e riprodhimit

për jetën e egër, por edhe ato të përkohëshme si vendkalimet dhe ushqimi sezonal, ndërsa korridoret lidhës të cilët janë në shkallë më të vogël ofrojnë shërbime ekologjike të përkohëshme ku shërbimi kryesor mbetet kalimi i jetës së egër nga një pikë në tjetrën. Korridoret (të mëdhenj dhe të vegjël, lidhës) shfaqen të copëzuar herë-herë në formë parcele apo ngastre.

Figura 71. Harta e elementeve peizazhistike



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016.

Elementët e Peizazhit Urban dhe Industrial: karakterizohen nga pemë të mbjella afër njëra-tjetrës përgjatë akseve rrugore ku llojet e tyre shfaqen të ndryshueshme sipas rrugës. Zgavrat ku këto pemë qëndrojnë gjithashtu të ndryshueshme nga një rrugë në tjetrën, disa janë me bordura të ngritura e disa pa bordura. Ndërkohë, pjesa më e madhe e përmasave të zgavrave të pemëve janë relativisht të vogla në raport me pemën. Grupime pemësh dekoruese apo në formë "ishulli" gjenden vetëm brenda hapësirave park apo lulishte dhe qëllimi është estetik e jo sipas funksionit dhe shërbimit mjedisor pasi "katet" e ndryshme të bimësisë mungojnë. Elementet urbane dhe industriale të forta/mbizotëruese apo edhe të padëshiruara shfaqen herë-herë në zona të ndryshme të qytetit. Zona tampon apo brezat e gjelbër pengues të erës dhe imazheve urbane apo industriale të padëshiruar ndodh në mënyrë spontane e të paplanifikuar. Pjesa më e madhe e sipërfaqeve parkim shfaqet e ekspozuar ndaj diellit pasi bimë gjethore për hijëzimin e këtyre hapësirave mungojnë. Gardhet e muret ndarës të pronave në disa zona janë mbi 2 metra të lartë dhe estetikisht "ngushtojnë" hapësirën e përbashkët si dhe ndjesia që ngjallin është ajo e mungesës së sigurisë.

Elementët e peizazhit ujor në tërësi dhe në veçanti ai lumor shfaqen të "fshehur" nga peizazhi urban. Bimësia "ripariane" mungon në pjesën më të madhe ndërkohë në pjesën tjetër përbëhet nga bimë të llojit bar dhe shkurre të ulëta. Ndërkohë, kur trupi ujor përshkon

fashën rurale dhe natyrore sërish humb një pjesë të konsiderueshme të zonës së tij ripariane si pasojë e tjetërsimit në tokë bujqësore dhe fenomenit gjeologjik të përshpejtuar si pasojë e prerjes së bimësisë në këto zona. Pra peizazhi ujor shfaqet si lidhës mes peizazhit rural dhe atij natyror.


- Rreziku ndaj elementëve peizazhistik

Peizazhi në territorin e Bashkisë Elbasan paraqitet i ndryshëm, në varësi të territorit dhe zonave ku mbizotëron aktiviteti njerëzor. Problematikat kryesore që has peisazhi në territorin e bashkisë kanë të bëjnë kryesisht me fragmentimin/copëzimin e peizazhit natyror, dhe mos-futjen e elementëve të peizazhit natyror në zonat urbane dhe në zonat me aktivitet industrial. Krahas problemeve në shkallë të madhe, vlen për t'u theksuar prania e problemeve me peisazhin urban e atë industrial, të cilët deri më tani nuk kanë gjetur një rrugë të përbashkët ndërthurjeje me atë natyror. Në qytet mbetet problem krijimi i një peizazhi të mirëfilltë urban, duke përfshirë të gjithë elementët e gjelbërimit, arkitektonikës, kopshteve, monumenteve kulturor dhe historike, të cilët së bashku do të krijonin një peizazh të ndërthurur dhe të pëlqyeshëm për qytetarët. Shpesh, praktikat e mira të peizazhit nuk ndiqen, apo përcaktohen si dytësore. Këto praktika janë spontane, ku zonat urbane dhe industriale kanë përdorur elementë të peizazhit në mënyrë rastësore, apo duke patur një orientim të lehtë mbi çështjen e dizajnit të peizazhit. Kryesisht, rrugët dhe sheshet kanë qënë pjesë e futjes së dizajnit të peizazhit, me mbjellje pemësh në formë lineare, duke ndjekur linja strikte, në rastet më të shpeshta, duke ndjekur konturet e infrastrukturës. Kjo është një mënyrë sigurisht jo universale në rregullimin dhe krijimin e peizazhit apo përdorimit të elementëve të tij në funksion të dekorit urban e më gjerë. Studimi i peizazhit në tërësi dhe elementëve të tij kërkon studime të thelluara duke analizuar të gjithë përbërësit e tij (planifikimi, arkitektuonika, historia, kultura, kultura bujqësore, natyra, bimësia lokale, e deri tek përbërësit më elementar si ndryshimi i ngjyrës së pemëve përgjatë sitinëve të vitit) dhe gjetjen e rrugëve të përbashkëta për ndërthurjen e pikave që mund të ndërthuren me njera-tjetrën për të krijuar një peizazh të pëlqyeshëm dhe funksional. Ndër rreziqet kryesore ndaj elementëve peizazhistike në territorin e Bashkisë Elbasan përmendim:

- Zhvillimi dhe zgjerimi i tokave bujqësore në tëresi të territorit dhe sidomos përgjatë trupave ujorë ka ngushtuar, copëzuar dhe zhveshur në mënyrë të theksuar zonat ripariane nga bimësia si në burime *Lentike* (liqenet dhe pellgjet) dhe *Lotike* (afër ujërave rrjedhëse, si lumenjtë dhe përrenjtë). Lumi Shkumbin shfaq dukshëm këtë fenomen. Bimësia lokale në to karakterizohet me bimësi si kallami, robinja (Robinia Pseudoacacia), rrapi (Platanus), shelgu (Salix), plepi i bardhë (Populus Alba) dhe shkurrja autoktone. Në sipërfaqet ku ka mbijetuar zona ripariane, shtresat përbërëse të saj si ajo e sipërme, e mesme dhe e mbulimit të tendës, rrallë gjenden të pandikuara nga aktiviteti njerëzor. Herë ka humbje të shtresës së mbulimit të terrenit në zonën e sipërme të tokës, e cila kryen filtrimin e ndotësve dhe të sedimenteve të derdhjeve sipërfaqsore dhe herë të shtresës së mesme të tendës në zonën bregore ku gjenden shkurret e larta dhe pemët të cilat nëpërmjet rrënjëve stabilizojnë anët e përroit. Si pasojë, nga një anë aktiviteti bujqësor ka dëmtuar zonën ripariane e, nga ana tjetër, erozioni lumor ka përparuar në dëm të tokave bujqësore duke gërryer brigjet, marrë tokë, shkaktuar përmbytje dhe shkarkuar sedimentet ujore mbi tokë.

- Përbërësit peizazh-formues si ai ***urban, industrial, rural, natyror*** dhe ***ujor*** të analizuar më sipër shfaqen në zona të ndryshme të territorit. Por, problematika mbetet e njëjtë si pasojë e ndërveprimit mes tyre. Në këtë kontekst vërehet një mospërputhje e elementëve peizazhistike në territorin e Bashkisë, duke mos u përdorur elementët peizazhistik në funksion të përmirësimit të tij
- Fragmentimi i zonave natyrore ka cënuar peizazhin natyror, duke e cunguar dhe ndaluar vijushmërinë natyrore. Kjo shfaq probleme krahas fragmentimit të habitateve dhe fragmentit pamor.
- Zonat e ndotura (hot-spot) të cilat janë të pranishme në territorin e bashkisë luajnë një rol të rëndësishmë në përkeqësimin e cilësisë peizazhistike të territorit

Figura 72.Harta e rrezikut ndaj elementeve peizazhistike



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Në hartën e rrezikut ndaj elementeve peizazhistike paraqiten të gjithë elementet e peizazhit të pranishme në territorin e Bashkisë Elbasan. Gjithashtu, në të njëjtën hartë paraqiten edhe rreziqet ndaj peizazhit në territor. Në hatë shikohet qartë zvogëlimi i zonës natyrore dhe fragmentimi i saj nga zhvillimi urban, industrial e bujqësor. Një element tjetër i rëndësishëm në këtë hartë janë edhe vatrat e nxehta mjedisore të cilat kanë ndikim negativ në zhvillimin e peizharit.

- **Zonat e Mbrojtura**

Zonat e mbrojtura përfaqësojnë territore tokësore, ujore, detare e bregdetare të caktuara për mbrojtjen e diversitetit biologjik, të pasurive natyrore dhe kulturore, bashkëshoqëruese, të cilat manaxhohen në rrugë ligjore dhe nëpërmjet metodave shkencore bashkëkohore[183].

Zonat e mbrojtura natyrore dhe turistike në vendin tonë janë konsideruar si pjesë tokësore dhe ujore të mbrojtura për shkak të shumëllojshmërisë biologjike të pasurive natyrore dhe

kulturore që ofrojnë. Këto zona mbrohen me ligj[184] dhe zënë rreth 16%[185] të teritorit të vendit.

Një territor i caktuar duhet të plotësojë të paktën një nga këto kritere:[186] i) të ketë diversitet të lartë të llojeve dhe/ose të habitateve, ii) të ketë dendësi të ulët të llojeve dhe/ose habitateve, iii) të ketë përfaqësueshmëri, iv) të ketë minimumin kritik të madhësisë së ekosistemit, v) të ketë natyralitet, trashëgimi dhe integritet, vi) të ketë vlera shkencore; vii) të karakterizohet nga prekshmëria ekologjike/llojet e prekshme, viii) të karakterizohet nga papërsëritshmëria/llojet endemike, ix) të mos rrezikohet nga ndërhyrjet e veprimtarive njerëzore, dhe x) të ketë mundësi për ruajtjen e jetës së egër.

Në vendin tonë, zonat e mbrojtura ndahen në 6 kategori (Tabela mëposhtë) të cilat janë përshkruar shkurtimisht në tabelën e mëposhtme.

Tabela 22. Kategoritë e zonave të mbrojtura sipas karakteristikave

Kategoria	Emërtimi	Karakteristikat
Kategoria I	Rezervë strikte natyrore/rezervat shkencor	Territore jo më të vogla se 50 ha, me vlera natyrore të veçanta, të formuara nga ekosisteme natyrore ose lehtësisht të ndryshueshme, që përfaqësojnë bioqendra dhe biokorridore me rëndësi kombëtare dhe rajonale, shpallen rezervë strikte natyrore.
Kategoria II	Park kombëtar	Territoret e gjera, zakonisht jo më të vogla se 1000 ha, unike për nga vlerat kombëtare dhe ndërkombëtare, një pjesë e madhe e të cilave janë ekosisteme natyrore, të ndikuara pak nga veprimtaria e njeriut, ku bimët, kafshët dhe mjedisi natyror, fizik janë të një rëndësie të veçantë shkencore dhe edukative, shpallen park kombëtar.
Kategoria III	Monument natyror	Monumenti Natyror përfaqëson një formacioni natyror (përfshirë edhe dru të veçantë), me sipërfaqe deri 50 ha, formacioni i veçantë gjeologjik dhe gjeomorfologjik, një depozitë mineralesh ose një habitat i një lloji të rrallë e të kërcënuar ose me rëndësi e vlerë të veçantë shkencore dhe estetike, shpallet monument natyror[187].
Kategoria IV	Rezervat natyror i manaxhuar/Park Natyror	Territoret që përfaqësojnë bioqendra dhe biokorridore me rëndësi rajonale e vendore ose zonat me bimë, kafshë, minerale e gjetje paleontologjike, veçanërisht të mbrojtura ose zonat që përdoren për qëllime studimore, edukative dhe kulturore shpallen rezervat natyror i manaxhuar (zonë e manaxhimit të habitateve dhe llojeve).
Kategoria V	Rezervat natyror i manaxhuar/ Peizazh i mbrojtur	Territoret më të mëdha se 1000 ha, me peizazh harmonik e të formuar mirë, me reliev të zhvilluar karakteristik, me larmi ekosistemesh, detare ose tokësore, me monumente historike, shpallen peizazh i mbrojtur.
Kategoria VI	Zonë e mbrojtur e burimeve të manaxhuara /zonë e mbrojtur me përdorim të shumëfishtë	Zonat që përfshijnë territore të gjëra e relativisht, të izoluara dhe të pabanuara, ku hyhet me vështirësi ose rajone që janë ende pak të populluara dhe që mund të jenë nën presion të vazhdueshëm për t'u populluar dhe përdorur më gjerësisht dhe kthimi i tyre për përdorim intensiv është i paqartë ose i papërshtatshëm, shpallen zona të mbrojtura të burimeve të menaxhuara.

Burimi: Ligji Nr 8906/.2002 Për Zonat e Mbrojtura, i ndryshuar me Ligjin Nr.9868/2008

- Manaxhimi i zonave të mbrojtura në vend

Kohët e fundit, Shteti Shqiptar ka bërë hapa të rëndësishëm përpara për zhvillimin e zonave të mbrojtura. Qeveria ka plotësuar më tej kudrin ligjor dhe institucional për manaxhimin e zonave të mbrojtura në vend. Shqipëria ka miratuar Ligjin Nr. 8906, dt. 06.06.2002, Për Zonat e Mbrojtura (i ndryshuar), i cili ka si qëllim kryesor shpalljen, ruajtjen, manaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të tyre. Një hap shumë i rëndësishëm në drejtim të manaxhimit të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura në vend është edhe miratimi i VKM-së Nr. 102 i datës 12.02.2015 i cili krijoi dhe përcaktoi funksionet e Agjensisë Kombëtarë të Zonave të Mbrojtura (AKZM) dhe të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdZM). AKZM-ja dhe AdZM-ja kanë përgjegjësi të drejtëpërdrejtë për manaxhimin e zonave të mbrojtura në vend, mbështetjen që i japin e Ministrisë për hartimin dhe zbatimin e politikave për zonat e mbrojtura, hartimin dhe zbatimin e planeve të manaxhimit dhe të veprimit, monitorimin, mbledhjen e informacionit dhe lajmërimin e organeve kopetente kur vërehen shkelje në zonat e mbrojtura.[188] Pas përpjekjeve të shtetit shqiptar për plotësimin e kuadrit ligjor dhe institucional, mund të themi që manaxhimi dhe administrimi i zonave të mbrojtura është qartësuar në kontekstin e përgjegjësive institucionale.

Në këtë fazë, AKZM-ja[189] ka hartuar Programin Strategjik afatshkurtër dhe afatmesëm 2015-2020 për manaxhimin e zonave të mbrojtura në vend. Qëllimi kryesor i këtij plani është përmirësimi i manaxhimit të ZM-ve sipas standarteve të BE-së, duke ruajtur dhe përdorur në mënyrë të qëndrueshmë burimet natyrore. Për më tepër, Qeveria ka marrë masa konkrete për zbatimin e ligjeve mbi zonat e mbrojtura dhe manaxhimin e tyre. AKZM-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, ka hartuar planet e manaxhimit për disa zona të mbrojtura (Plani i manaxhimit të Parkut kombëtar të Malit të Tomorrit, Divjakë- Karavasta etj.) dhe është drejt përfundimit të hartimit të planeve të manaxhimit[190] për zona të tjera. AKZM-ja e shtrin aktivitetin e saj në çdo qark nëpërmjet degës së saj rajonale (AdZM-të e qarqeve). AdZM-të kanë në fokus të tyre zbatimin e planeve dhe monitorimin e zonave të mbrojtura në teritorin e tyre të kompetencës (të qarkut përkatës) dhe bashkëpunimi më AdZM-të e tjera përkatëse kur zona e mbrojtur i kalon kufinjtë e qarkut. AdZM-të kanë një staf të caktuar në varësi të sipërfaqeve të zonave të mbrojtura që ndodhen në territorin e administruar prej tyre (disa punonjës në rastet e manaxhimit të një parku komëtar, që llogaritet të ketë një sipërfaqe të madhe kupërfshihen kryesisht specialistë monitorimi dhe disa roje).[191]

Me gjithë punën e mirë të bërë nga AKZM, zbatueshmëria e ligjit për zhvillimin dhe mbrojtjen e zonave të mbrojtura ende hasvështirësi. Mungesa e planeve të manaxhimit dhe mungesa e kapaciteteve për zbatimin e planeve të menaxhimit për disa zona mbetet ndër vështirësitë kryesore. Për kapërcimin e këtyre vështirësive, momentalisht AKZM-ja është duke bërë një punë të mirë në drejtim të rritjes së kapaciteteve lokale dhe plotësimit të stafit të nevojshëm për menaxhimin sa më të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura.

- Zonat e mbrojtura në Bashkinë Elbasan

Territori i Bashkisë së Elbasanit ka një reliev të larmishëm me fusha, lugina dhe kodra e male të larta. Ky reliev ka ndikuar në formimin e mikroklimave të ndryshme të cilat kanë krijuar mundësinë për zhvillimin e një flore e faune të shumëllojshme. Bashkia Elbasan ka

17 zona të mbrojtura[192] në teritorin e saj, të përbëra nga 14 monumente natyrore (Zonë e mbrojtur Kat. III) dhe 3 rezervate natyrore të manaxhuar (Zonë e mbrojtur Kat. V) të cilat janë renditur më poshtë.

Tabela 23. Zonat e mbrojtura në Bashkinë Elbasan

Emërtimi i ZM-së	Kategoria	Përshkrim i shkurtër	Rëndësia
Kategoria II – Park Kombëtar			
Shebeni - Jabllanicë[193]	II	Biodiversitet të pasur me endemizma dhe subendemizma	Shkencore, biologjike, ekologjike, ekonomik, kulturore, didaktike dhe turistike
Kategoria III – Monument Natyre			
Dushku i Lleshanit	III	Lartësia mnd: 1,000m Lartësia: 21m Diametri i trungut: 120cm Perimetri i trungut: 240cm Degë: 32 Perimetri i kurorës: 92m Mosha: 250 vjecar Ka qënë gjithmonë vendtakim për banorët.	shkencore (biologjike), didaktike, estetiko – turistike.
Pisha e Fushë Kuqes	III	Lartësia mnd: 920 – 1,000m Sipërfaqja: 2ha Lartësia e drurëve: 18-20m Diametri i trungjeve: deri në 38cm Mosha: 149 – 158 vjecare Sipërfaqe pyjore Pishë e zezë	biologjike, didaktike, estetiko- turistike dhe klimaterike
Dushku i Kishës Gjinar	III	Lartësia mnd: 900m Lartësia: 22m Diametri i Trungut 210cm Perimetri i trungut: 670cm Degë: 9 Perimetri i kurorës: 82m Mosha: 300 vjecar Lis i veçuar, me formë të rregullt, ka dëmtime të ndjeshme.	biologjike, didaktike, estetiko- turistike dhe klimaterike
Lisat e Pashtreshit	III	Lartësia mnd: 700m Lartësia: 16 – 18m Diametri i trungjeve: rreth 70cm Mosha: 200 – 250 vjecare Grup drurësh prej lisi në formë rrethore, në gjendje shumë të mirë	biologjike, didaktike, estetiko- turistike dhe klimaterike
Rrobulli i Zeleshnjës	III	Lartësia mnd 1,650 – 1,700m Sipërfaqja:1.5ha Lartësia e drurëve: 18-20m Diamerti i trungut: 35-40cm Mosha: 100 – 120 vjecar Gjendja: shumë e mirë	biologjike, didaktike, estetiko- turistike dhe klimaterike

Rrapi i Gurrës së Labinotit	III	Lartësia mnd: 820m Lartësia: 16m Diametri i trungut: 94cm Perimetri i trungut: 294cm Degë; 20 Perimetri i kurorës: 42m Mosha: 110 vjecar Gjendja; e mirë Dru rrapi i vecuar me kurrorë të rregullt	Pikë takimi për banorët, biologjike, didaktike, estetiko- turistike dhe klimaterike
Pylli aluvial i Shushicës	III	Mosha; 9-10vjecare Pyll aluvial, gjenden shoqërime bimësh higrofile mjaft të dendura dhe në gjendje natyrore.	estetiko- turistike dhe klimaterike
Rrepet e Byshekut	III	Lartësia mnd: 175m Sipërfaqja: 0,4ha Lartësia e drurëve: 18-22m Diametri i trungut: 50-87cm Mosha: 500-600 vjeçar Grumbuj drurësh prej rrapi të ruajtur në gjendje të mirë.	Pikë takimi për banorët, biologjike, didaktike, estetiko- turistike
Frashëri i Madh Polis – Valë	III	Lartësia: 20m Dru frashëri i zhvilluar mjaft mirë, i rrethuar nga shkurre shkoze.	Pikë takimi për banorët, biologjike, didaktike,
Llixhat e Hidrajt	III	Latrtësia mnd: 200m Temperatura: 400°C Këto burime termale përdoren për vetitë e tyre kuruese	Shkencore, didaktike, turistike, kurative
Mështekna e Zavalinës	III	Lartësia mnd: 1,000-1,170m Sipërfaqja: 7.5ha Mosha 130 vjeçare Lartësia e pemëve: rreth 16m Diametri i Trungut: 22cm Pyje mështekne, dëmtuar pjesërisht nga disa prerje të jashtëligjshme	biologjike, didaktike, estetiko- turistike dhe klimaterike
Mani i Zi i Joronishtit	III	Lartësia: 8m Diametri i trungut: 72cm Perimetri i trungut: 226cm Degë: 4 Perimetri i kurorës: 26m Mosha: 320 vjeçar Dru mani i veçuar	Pikë takimi për banorët
Burimi i Perroit të Kushes	III	Buron nga një lartësi pre 10-15 metrash nga disa ballkone shkëmbore	estetiko- turistike
		Kategoria V - Rezervat Natyror i Menaxhura	
Qafë Bushi	V	Sipërfaqja: 500 ha Lartësia mnd: 1,100 Paraqet vlera të një zonë me përfaqësim të gjërë të pyllit të dushkut, të florës dhe faunës së tij. Ka një shkallë relativisht të lartë dëmtimi	Mbrojtjen e peizazhit, biologjike, dhe zhvillimin e turizmit

Sopoti	V	Sipërfaqja: 300 ha Lartësia mnd: 1,600m Përbëhet nga pyje, kullota subalpine dhe alpine, liqene akullnajore, kanione, maja etj.	Mbrojtjen e peizazhit, biologjike, dhe zhvillimin e turizmit
Kuturmani	V	Sipërfaqja: 3,600ha Lartësia mnd: 1,100m Vlera e përfaqësimit të gjerë të pyllit të dushkut, florës dhe faunës së tij. Paraqet problematikë që lidhen me shfrytëzimin e tepruar.	Mbrojtjen e peizazhit, biologjike, dhe zhvillimin e turizmit

Burimi: SZHT, Bashkia Elbasan 2016 dhe AKZM 2016, Përpunoi: Co-PLAN

- Rezervat Natyror i Manaxhuar:[194]

Rezervatet Natyrore të Manaxhuara administrohennga AKZM-ja. Aktualisht, nuk ka informacion nëse këto zona janë të pajisura me plane manaxhimi. Sipas AKZM-së, këto zona kanë vëmendjen e vazhdueshme të autoriteteve lokale, AdZM-së Elbasan dhe NjA-së Elbasan, të cilat mbrojnë dhe kontrollojnë veprimtaritë brenda zonave të mbrojtura. AdZM-ja Elbasan ka përcaktuar disa punonjës për mbikqyrjen e rezervateve natyrorë të manaxhuar brenda Qarkut Elbasan.[195]

Qafë Bushi – Sipërfaqja aktuale e kësaj zone është 500ha në lartësinë deri në 1,100m mbi nivelin e detit, dhe pjesa perëndimore e tij përfshihet në territorin e Bashkisë Elbasan në NjA-nëLabinot Mal.Ndonëse kjo zonë është mëse e dëmtuar dhe e shfrytëzuar përtej kapacitetit, ajo paraqet vlera të një zone me përfaqësim të gjerë të pyllit të dushkut, të florës dhe faunës së tij. Kryesisht, është përdorur si rezervat për gjuetinë e derrit të egër (*sus scrofa*), lepurit, thëllëzës etj. Aktualisht, kjo zonë nuk ka një plan manaxhimi e përrrjedhojë zhvillimi i qëndrueshëm për këtë hapësirë mbetet sfidë për të cilën nevojitet punë konkrete.

Sopoti – Sipërfaqja e kësaj zone vlerësohet të jetë rreth 300ha me një lartësi maksimale deri në 1,600m mbi nivelin e detit, dhe pjesa perëndimore e tij përfshihet në territorin e Bashkisë Elbasan në NjA-në Zavalinë. Në këtë zonë ka një sërë habitatesh si: pyje, kullota subalpine dhe alpine, liqene akullnajore, kanione, maja etj.

Ky rezervat karakterizohet edhe nga shumë bimë endemike dhe subendemike, ku veçohet *Hypericum albanicum* dhe *Lilium albanicum*, si dhe kombinimi i pyjeve me ah dhe bredh, të vendosura në një terren pak të pjerrët.Aty hasim edhe kullotat alpine të bimësisë së çeltirave, të cilat i japin këtij territori një bukuri të veçantë natyrore e peisazhistike. Gjithashtu zona përbën edhe një bërthamë dhe biokorridor shumë të rëndësishëm për rruazorët e mëdhenj si ariun, rrëqebullin, dhinë e egër, kaprollin etj. Për fat të keq, edhe kjo zonë nuk ka një plan manaxhimi.

Kuturmani – Sipërfaqja e zonës është 3,600ha me lartësinë deri në 1,100m mbi nivelin e detit, ku vetëm një sipërfaqe të vogël në perëndim të tij përfshihet në territorin e Bashkisë Elbasan në NjA-në Labinot Mal. Zona është pjesërisht e dëmtuar dhe e tejshfrytëzuar, por ajo paraqet vlera të përfaqësimit të gjerë të pyllit të dushkut, florës dhe faunës së tij. Ai njihet si rezervati për gjuetinë e derrit të egër, lepurit, thëllëzës etj. Aktualisht, kjo zonë nuk ka një plan manaxhimi.

- Monumentet e Natyrës[196]

Monumentet e natyrës manaxhohen nga AdZM-ja Elbasan. Aktualisht, nuk ka një plan manaxhimi për monumentet e natyrës, edhe pse vazhdimisht kryhet monitorimi i gjendjes së tyre dhe merren masa për mbrojtjen e tyre. AdZM-ja Elbasan ka 19 punonjës që merren me manaxhimin dhe monitorimin e zonave të mbrojtura në tërësi.[197] Duhet shtuar, se edhe Bashkia e Elbasanit ka përgjegjësi për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit në territorin e saj. Prandaj lind nevoja që në të ardhmen, Bashkia të bashkëpunojë me AdZM-në Elbasan për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura.[198]

Dushku i Lleshanit ndodhet në në fshatin Lleshan, pranë rrugës për në Gjinar, në një lartësi rreth 1000m mbi nivelin e detit. Përfaqësohet me një dru lisi të veçuar, me formë të rregullt dhe në gjëndje të mirë. Lartësia e tij është rreth 21 m, diametri i trungut 120cm, perimetri i trungut 240cm. Ka 32 degë me një perimetër të përgjithshëm rreth 92 m. Mosha e tij është 250 vjeçare. Ka qenë gjithnjë si pikë takimi për banorët e fshatit. Vlerat e tij janë shkencore (biologjike), didaktike, estetiko – turistike.

Pisha e Fushë Kuqes ndodhet në fshatin Gjinar të NjA-së Gjinar, në lartësinë 920-1,000m mbi nivelin e detit. Përfaqëson një sipërfaqe pyjore pishe të zezë prej 2ha. Forma e sipërfaqes pyjore është trapezoidale. Përbëhet nga drurë të vjetër dhe të rinj, me lartësi 18-20m, ndërsa diametri i trungjeve arrin deri 38,5cm, mosha e tyre është 149-158 vjeçare. Ka vlera biologjike, didaktike, estetiko-turistike dhe klimaterike. Deri në fundin e viteve '80 ,aty funksiononte pika turistike e Gjinarit.

Dushku i Kishës Gjinar gjendet pranë kishës së fshatit Gjinar, 900 metra mbi nivelin e detit. Përfaqëson një dru lisi të veçuar, me formë të rregullt ombrellore dhe ka dëmtime të ndjeshme nga faktorët natyrorë, kryesisht nga shkarkimet atmosferike. Lartësia e tij është 22m, diametri e perimetri i trungut janë përkatësisht 210cm dhe 670cm. Ka 9 degë që formojnë kurorën me perimetër 82m. Mosha e tij është 300-vjeçare.

Lisat e Pashtreshit gjenden në pjesën lindje-juglindje të fshatit Pashtresh, të NjA-së Gjinar. Përfaqëson një grup drurësh prej lisi, në një sipërfaqe të vogël në formë rrethore. Drurët janë të rregullt, me trup të drejtë e të ruajtur relativisht mirë. Lartësia e tyre është 16-18 m, ndërsa diametri i trungjeve është rreth 70 cm. Lartësia mbi nivelin e detit është rreth 700 m. Kanë moshë 200-250-vjeçare. Pranë tyre është një kishë gati e rrënuar.

Rrobulli i Zeleshnjës gjendet pranë fshatit Zeleshnjë, NjA Gjinar, në lartësinë 1,650-1,700m mbi nivelin e detit. Përfaqëson një sipërfaqe pyjore 1.5ha rrobulli. Kjo zonë njihet edhe me emrin pylli i staneve të Verçës. Lartësia e drurëve është 18-20m, diametri i trungjeve është 35-40 cm, ndërsa mosha e tyre është 100-120-vjeçare. Aktualisht, këto pyje janë në gjendje të mirë dhe janë të rrethuar me livadhe dhe seksione pyjesh me pisha dhe ahe.

Rrapi i Gurrës së Labinotit ndodhet në pjesën perëndimore të fshatit Labinot Mal, në NjA-në Labinot Mal. Ai përfaqëson një dru rrapi të veçuar, me një kurorë të rregullt dhe ruhet në gjëndje të mirë edhe nga vetë banorët e zonës, kunë shumë raste ka shërbyer edhe si pikë takimi apo vend-pushimi për ta. Pranë rrapit ndodhet edhe burimi ujor karstik i Gurrës së Labinotit. Ai ndodhet në lartësinë 820mmbi nivelin e detit, me lartësi 16m, diametri i trungut është 94cm, ndërsa perimetri i tij është 294cm. Ka mbi 20 degë që

formojnë kurorën me perimetër 42m. Mosha e monumentit është 110-vjeçare. Vizitohet sipas degëzimit të rrugës kombëtare Elbasan - Librazhd, duke filluar nga Labinot Fusha deri në Labinot Mal.[199]

Pylli aluvial i Shushicës ndodhet përgjatë shtratit të lumit Shkumbin afër fshatit Shushicë në NjA-në Shushicë. Ky është një pyll aluvial, ku gjejmë shoqërime bimësh më tepër higrofile (shelgje, rapisht), mjaft të dendur dhe në gjendje natyrore. Si i tillë ka vlera të veçanta, edhe pse me moshë të re (rreth 9-10-vjeçare). Vizitohet duke marrë rrugën Elbasan Shushicë.

Rrepet e Byshekut ndodhen në NjA-në Shushicë, në të majtë të lumit Shkumbin, rreth 175mmbi nivelin e detit. Ato përfaqësojnë një grup drurësh prej rrapi në një sipërfaqe prej 0,4ha. Lartësia e drurëve është 18-22m, diametri i trungjeve është 50-87cm, por edhe më shumë, ndërsa mosha e tyre është 500-600-vjeçare. Pranë tyre ka burime me ujë dhe sistemime e rregullime në dobi të vizitorëve ditorë nga Elbasani etj. Pronësia është shtetërore dhe në përgjithësi gjendja e drurëve është e mirë. Ka drurë të dëmtuar nga faktorë natyrorë, nga mosha e madhe, por edhe zgavërime trungu, nga zjarret e vënë nga vizitorët e pakujdesshëm.

Frashëri i Madh Polis-Valë ndodhet në fshatin Polis Valë në NjA-në Shushicë. Ai është një dru me moshë të vjetër, mbi 20m i lartë, i zhvilluar mjaft mirë në mes të shkurreve të përfaqësuara nga shkoza. Vizitohet duke marrë rrugën Elbasan ose Librazhd-Polis-Val.[200]


Llixhat e Hidrajt, sot janë monument natyre dhe gjenden në pjesën e sipërme të përroit të Llixhave, rreth 200m mbi nivelin e detit në NjA-në Tregan. Këto janë burime termo-minerare, të cilat arrijnë temperaturën rreth 400^{0}C, dhekanë përmbajtje kripërash dhe gazrash të tretura në to. Këto ujra janë përdorur ndër vite për kurimin e sëmundjeve të *poliartritit, artritit, reumatizmës* etj. Kjo zonë është e përshtatur me shërbim hotelerie dhe shërbim të rregullt mjeksor. Gjatë këtyre 10 viteve të fundit mjediset janë shtuar dhe kushtet janë përmirësuar. Shumë pranë llixhave, ndodhet edhe pylli me dushqe, i cili është në gjëndje të mirë.

Mështekna e Zavalinës ndodhet në afërsi të fshatit Zavalinë në NjA-në Zavalinë në lartësinë 1,000-1,170m mbi nivelin e detit. Ajo ka një sipërfaqe 7.5ha me pyje mështekne, të cilat kanë një moshë 130-vjeçare. Lartësia e tyre është rreth 16m, diametri i trungut arrin deri 22cm. Është në pronësi të shtetit dhe ruhet ende mire, përveç disa prerjeve të paligjshme që janë kryer nga mesi i viteve '90.

Mani i Zi i Joronishtit ndodhet në qendër të fshatit Joronisht në NjA-në Zavalinë, i cili është një dru mani i veçuar. Askush nuk mban mend si është gjendur ai aty, por gjithnjë ai ka qënë vendi ku grumbulloheshin banorët e fshatit për takime, kuvende etj. Mani ka lartësi 8 m, diametër të trungut 72cm, ka 4 degë që formojnë kurorën ombrellore me perimetër 26m. Perimetri i trungut është 226 cm, ndërsa mosha është 320-vjeçare. Është në pronësi private dhe ruhet relativisht mirë. Vizitohet sipas rrugës Elbasan – Zavalinë – Joronisht.[201]

Burimi i Përroit të Kushesndodhet në fshatin Gjormë në Lindje të autostradës Tiranë-Elbasan. Uji buron nga një lartësi pre 10-15 metrash, nga disa ballkone shkëmbore dhe është i rrethuar me rrepetë ngjashme me Byshekun. Aktualisht nuk ka rrugë automobilistike.

Figura 73. Harta e zonave të mbrojtura, monumente natyrore / kulturore



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

- Problematikat kryesore të ZM-ve Elbasan

Prerja abusive e pyjeve ka një impakt të madh në prishjen e habitateve brenda zonave të mbrojtura.Zona e Polis-Stravaj, Kuturman dhe të tjera, paraqiten në shkallë të lartë të prerjeve abusive tëpyjeve.[202] Aktualisht, gjendja pritet të përmirësohen me ndalimin e prerjeve të pyjeve për 10 vjet, edhe pse ligji nuk e ka lejuar asnjëherë zhfrytëzimin e pyjeve brenda Zonave të Mbrojtura.

Rreziku i përhapjes së zjarreve është i pranishëm pothuajse gjatë gjithë sezonit të nxehtë, kryesisht në zonën e Kuturmanit, apo dhe në zona të largëta, të cilat paraqesinvështirësi për t'u kontrolluar.[203] Kryesisht, zjarret kanë qenë të qëllimshme nga praktika të gabuara që përdoren për hapjen e kullotave dhe tokave bujqësore.

*Gjuetia e paligjshme*është një problem aktualnë Shebenik – Jabllanicë, Polis-Stravaj dhe në zona të tjera të thella qëështë vështirë të kontrollohen.Gjuetia ndikon direkt në uljen e numrit të shpendëve dhe kafshëve, dhe shqetësimin e tyre.

Manaxhimi joefektiv i aktiviteteve turistike që kryhen në të gjitha zonat e mbrojtura, edhe pse në nivele të ulëta, lënë pas mbetje të ngurta, të cilat shpërndahen gjithandej (Gjinar, Shebenik-Jabllanicë, Byshek etj.).

Ndërtimi i HEC-eve, të cilët shfrytëzojnë ujin, duke e devijuar atë, ka sjellë probleme të shumta në habitatet e zonave të mbrojtura. Disa zona janë prekur nga ndërtimi i HEC-eve të vegjël, duke sjellë reduktimetëndjeshme në sasinë e ujit që rrjedh në gjendje tëlirë dhe furnizon ekosistemet natyrore në këto zona.

Aktiviteti i guroreve ka një impakt në ndryshimin e peizazhit dhe në dëmtimin e vetë habitatit, këtu përmendim aktivitetin e guroreve në Parkun Shebenik – Jabllanicë, por ka dhe zona të tjera në të cilat ushtrohet ky aktivitet.

Kullotja është prezente pothuaj në të gjithëZonat e Mbrojtura tëBashkisë Elbasanit.Ende nuk ka një studim se sa është kapaciteti i lejuar i këtyre zonave, kështuqëështë një problem i pastudiuar dhe i pazgjidhur.

*Erozioni*është një fenomen i pranishëm në zonat kodrinore malore, kryesisht erozioni i shpateve të zhveshura, apo në brigjet e përrenjve apo lumenjve, që kalojnë në zonat e mbrojtura.

Ndikimi që kanë patur, si prishja e rregjimit të ujrave në lumenj, gjithashtu edhe shpyllëzimet intensive, kanë rezultuar në një rritje të ndjeshme të aktivitetit erodiv kudo në Shqipëri, dheende nuk ka një adresim të saktë tëkëtij problemi ndaj edhe zgjidhja e këtij fenomeni mbetet të realizohet në një të ardhme ndofta të largët.

- **Biodiversiteti**
  - Biodiversiteti në Shqipëri

Sipas Ligjit nr. 9587/2006 "Për Mbrojtjen e Biodiversitet", me biodiversitet ose larmi biologjike nënkuptojmë shumëllojshmërinë e organizmave të gjallë të të gjitha llojeve, duke përfshirë, ndër të tjera, ekosistemet tokësore, detare dhe ekosistemet e tjera ujore, si dhe komplekset ekologjike, ku ato bëjnë pjesë[204]. Ky term përfshin shumëllojshmërinë brenda dhe ndërmjet llojeve dhe shumëllojshmërinë e ekosistemeve.

Shqipëria është një vend i vogël. Megjithatë, ajo dallohet për larmi të peizazheve dhe larmi biologjike[205], duke u radhitur në vendet e Europës që shquhen për biodiversitet të lartë. Pjesa e Ultësirës Perëndimore është më e rëndësishme nga pikëpamja e biodiversitetit dhe larmishmërisë së tij, e cila shtrihet përgjatë zonës bregdetare nga qyteti i Vlorës në jug e deri tek liqeni i Shkodrës në veri. Përveç faktit që kjo është një zonë bregdetare, Ultësira përshkohet nga lumenjtë kryesorë të vendit, të cilët rrjedhin nga lindja në perëndim. Vija bregdetare arrin gjatësinë 476km. [206] Zona veriore e vendit ka një reliev malor, i cilikarakterizohet nga diversitet i formacioneve shkëmborë që nga koha e Paleozoikut. Klima në Shqipëri përbëhet nga katër zona klimatike dhe 13 nënzona, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në biodiversitetin e pasur që ka vendi.[207]

Shqipëria ka një shumllojshmëri të ekosistemeve dhe habitateve. Në territorin e vendit gjenden ekosistemet detare, zonat bregdetare, lumenjtë, liqenet, shkurret me gjelbërim të përhershëm apo gjetherënëse, pyje halore dhe fletore, kullota alpine dhe subalpine, si dhe ekosistemet e larta malore. Larmia e ekosistemeve dhe habitateve në Shqipëri mundëson një larmi të lartë të llojeve të kafshëve dhe të bimëve që rriten në to. Në Shqipëri gjenden rreth ***7,233 taksone bimore***[208] (bashkë me fiernat, likenet, kërpudhat, myshqet dhe algat) dhe ***5,438 lloje kafshësh***[209] (përfshirë shpendë gjitarët, zvarranikët, insektet, peshqit etj.). Bimët me lule dhe algat mikroskopike janë grupi përfaqësues më i larmishëm dhe i pasur i llojeve të rradha, relike dhe endemike. Kjo për shkak të elementeve floristike të rajoneve.


Pyjet zënë rreth 33% të teritorit, ose 1,041,000 ha, ndërsa *kullotat* zënë rreth 15% të sipërfaqes së territorit (400,000 ha). Pyjet dhe kullotat kanë një larmi të llojeve dhe komuniteteve shtazore dhe atyre bimore.[210] Pyjet e larta strehojnë kryesisht gjitarët e

mëdhenj si ujku, rrëqebulli, ariu, dhia e egër, si dhe shpendë të ndryshëm të cilët janë të lidhur me jetesën në pyjet e virgjëra. *Liqenet* e mëdha të vendit dhe lagunat bregdetare janë vendbanimet më të rëndësishme për shpendët, veçanërisht për dimërimin e atyre migratore. Në këto hapësira, prej vitesh numërohen rreth 70 lloje shpendësh uji, të cilët përbëjnë një popullsi që arrin deri në 180,000 individë gjatë dimrit.[211] Shqipëria është edhe një kryqëzim i rrugëve të rëndësishme për shpendët migratore dhe insektet[212].

- Speciet e rrezikuara në Shqipëri

Në territorin e vendit gjenden rreth *91 lloje të kërcënuara speciesh në nivel global*. Në këtë listë përfshihen Pelikani kaçurrel (Crispus crispus), Breshka Shqiptare e Ujit (Pelophylax shqipericus) dhe Blini (Acipenser sturio), për të cilat Shqipëria është një vend i rëndësishëm.[213] Sipas IUCN-it,[214] 109 lloje kafshësh të grupeve të ndryshme taksonomike janë konsideruar si të kërcënuara. Lista e llojeve të bimëve të kërcënuara në vendin tonë e kalon atë të kafshëve, duke arritur shifrën 319 nga të cilat 76 janë të kërcënuara në formë kritike, 123 lloje konsiderohen në rrezik, dhe 120 lloje të përkeqësuara (Figura mëposhtë).

Figura 74. Numri i llojeve të florës dhe shpendëve të rrezikuar në Shqipëri



Burimi: Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit, 2016[215]. Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Lista e Kuqe e faunës dhe florës së egër është miratuar në dhjetor 2013, me Urdhër të Ministrit Nr. 1280, datë 20.11.2013. Llojet e mbrojtura të florës janë 402 nga 361 që ishin në Listën e Kuqe paraprake të vitit 2007. Llojet e mbrojtura të faunës janë 575, i njëjti numër me listën e vitit 2007.

- Biodiversiteti në Bashkinë Elbasan

Territori i Bashkisë Elbasan është i larmishëm, me terren fushor, kodrinor e malor dhe me lumenj e përrenj të shumtë. Elbasani përshkohet nga rrjedha e mesme e lumit Shkumbin dhe degët e tij të shumta si lumi i Gostrimës, lumi i Zaranikës, lumi i Kushes dhe Zalli i Papërit. Zona e Elbasanit, sipas ndarjes klimatike të Shqiperisë, bën pjesë në zonën mesdhetare kodrinore dhe nën-zonën mesdhetare kodrinore qëndrore. Larmia e formave të relievit dhe shtrirja e gjerë veri-jug e kësaj nënzone ndikojne në regjimin e elementëve klimatike dhe në biodiversitetin e pasur të zonës.

Bashkia Elbasan ka një sipërfaqë natyrore rreth 62,900 ha[216]. Në bashki gjenden edhe shumë monumente natyrore (si pemë të lashta), si dhe zona të mbrojtura si Sopoti, Stravaj dhe Kuturmani (zonat e mbrojtura janë trajtuar në një seksion më vete). Në territorin e

bashkisë dhe rrethinat, haset një numër i konsiderueshëm i llojeve të kafshëve dhe shpendëve, kryesisht gjitarët e medhenj dhe familja e rosave dhe thëllëza edhe pse numri total i specieve floristike dhe faunistike në bashki nuk njihet. Gjithashtu, territori i bashkisë shquhet për pasuri floristike, kryesisht në drurë të lartë, shkurre dhe bimë të kultivuara. Në brendësi të territorit hasen një sërë llojësh, duke filluar nga shkurret shqopa, shkoza, dhe deri tek dushqet, ahishtat, dhe kullotat alpine.

Numri i specieve floristike dhe faunistike, që gjenden në Bashki dhe habitatet e tyre, nuk njihet. Megjithatë, njihet përafërsisht numri i specieve në rrezik zhdukjeje (Libri i Kuq i Florës dhe Faunës Shqiptare, 2007) i cili shkon në 83 specie (rreth 10% e specieve në zhdukje në vend). Këto i përkasin kryesisht specieve të florës, insekteve dhe shpendëve.

Figura 75. Flora dhe Fauna e rrezikuar në Shqipëri dhe në Bashkinë Elbasan[217]

Flora dhe Fauna e Rrezikuar në Shqipëri dhe Bashkinë Elbasan[218]				
Kategoritë Taksonomike	Nr. Total i Specieve në vend	Nr. Specieve të rrezikuara në vend	**Nr. Specieve të Rrezikuara në B. Elbasan**	% Specieve të Rrezikuara në B. Elbasan
Kërpudha	800	16	**2**	13
Bimësi	3,228	363	**28**	8
Insekte	680	108	**23**	21
Peshq	311	61	**1**	2
Amfibë	15	15	**2**	13
Zvarranikë	37	37	**4**	11
Shpendë	330	120	**18**	15
Gjitarë	91	46	**5**	11
Totali	5,492	766	**83**	11

Burimi: Libri i Kuq i Florës dhe Faunës Shqipëtare, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

- Fauna në Bashkinë Elbasan

Zona e Bashkisë Elbasan është shumë e pasur me botë shtazore, e cila gjatë dy dekadave të fundit është dëmtuar si rezultat i gjuetisë së shfrenuar, ku shumë shpezë e kafshë të egra po shkojnë drejt zhdukjes. Kjo zonë popullohet nga specie si ariu, kaprolli, ujku, lepuri, dhelpra, kunadhe baldosa, thëllëza e fushës dhe e malit, rosat e egra turtujt, pëllumbat e egër dhe gugucët (e famshmja kumria e Elbasanit). Nga të dhënat rezultojnë të zhdukur derri i egër, dhia e egër, fazani, lejlekët, pelikanët etj.

Sipas Librit të Kuq të faunës së Shqipërisë, 53 specie të rrezikuara në shkallë vendi ndodhen në territorin e Bashkisë Elbasan. Disa nga këto specie janë gjitarë të mëdhenj, tek të cilët ndikimi i reduktimit të habitateve ka çuar në reduktimin e numrit të tyre, krahas dhe ndikimeve të tjera nga aktivitetet antropogjene si gjuetia, shqetësimi etj. Më të rrezikuarat janë specie të familjes së fluturave, shpendëve dhe gjitarëve.

Shkaqet kryesore, që rrezikojnë zhdukjen e specieve të faunës në territorin e Bashkisë Elbasan, janë tregëtimi i specieve të ndryshme, koleksionimi i disa lloje speciesh, kryesisht fluturave, prishja e habitatit, ndotja e habitatit, zhvillimi i bujqësisë dhe përdorimi i plehrave dhe kimikateve në masë të madhe, zhvillimi i turizmit, shqetësimi i habitatit, zgjerimi i zonave urbane, gjuetia e paligjshme, pakësimi i ushqimit, shqetësimi i vendit të folezimit, trafikimi i specieve të rralla, fragmentimi i habitateve, degradimi i pyjeve etj. Në vijim, shkaqet do të trajtohen më gjerësisht duke i analizuar specifikisht .

- Flora në Bashkinë Elbasan

Zona e Elbasanit ka pasuri të shumta natyrore, ku përfshihen lumenjtë, zona e mesme dhe e lartë malore, kodrat e ullinjve që rrethojnë qytetin, shkurret mesdhetare, pyjet gjethe gjerë, ato halore dhe përzierjet me kullota. Në Bashkinë Elbasan, për sa i përket " Zonave të Rëndësishme Bimore" gjendet zona Shpat-Polis.

Gjatë dy dekadave të fundit, zona është përballur me probleme të shumta si shpyllëzimet, prerja e ullinjve në pjesën verilindore të qytetit të Elbasanit, ndërtimet në zonat e gjelbëruara, si dhe urbanizimi i zonave të gjelbëra në brendësi të qytetit. Pas vitit 1997, janë prerë rreth 1,100 ha pyje me plepa, vërrinj, rrapa, shelgje, e të tjera lloje shumë rezistente ndaj ndotjes industriale dhe me ndikim në uljen e ndotjes. Ajo që ka mbetur sot është Pylli Aluvial i Shushicës, i cili ruhet si Momument Natyre. Më poshtë paraqitet gjendja e pasurive faunistike e floristike në NjA-të e Bashkisë Elbasan.

NjA-ja Funar: Biműsia natyrore përbëhet nga shkurre mesdhetare (shkozë, dushk) në jug dhe në pyjet e ahut në veri. Kjo zonë shërben për gjuetinë e kafshëve të egra sidomos të derrit të egër. *NjA-ja Gjinar:* Zona ka male që janë të veshura me pyje të ahut e të pishës, si pyjet e ahut të Skalatrës, të Bukanikut, Zavalinës, pishat e Gjinarit etj., që janë dhe zona gjuetie të kafshëve të egra si derri, kaprolli, lepuri, ariu. Maja më e lartë është ajo e Bukanikut (1831m).

NjA-të Labinot Mal, Papër, Shirgjan, Shushicë: burimet natyrore janë të mëdha si pyjet e ahut, të pishës, të dushkut e të shkozës. Në zonat e ulëta gjenden shkurret mesdhetare, të cilat edhe shfrytëzohen.

Sipas Librit të Kuq të faunës së Shqipërisë, rreth 30 lloje të rrezikuara në shkallë vendi ndodhen në territorin e Bashkisë Elbasan (Tabela mëposhtë). Dëmtimi i llojeve të ndryshmë të faunës vjen, kryesisht, si pasojë e mbledhjes së bimëve mjeksore si Çaji i Malit *(Sideritis raeseri,* Lulebasani*(Hypericum perforatum),* Bërsheni *(Juniperus foetidissima),* Trumza *(Satureja Montana)* etj.

Shkaqet kryesore që rrezikojnë zhdukjen e specieve të florës në territorin e Bashkisë Elbasan janë: dëmtimet humane të specieve në zhdukje, speciet në zhdukje, kullotja intensive, mbledhja e nënprodukteve të pyllit dhe bimëve mjeksore, praktika jo të mira të mbledhjes së bimëve mjeksore, prerja e pyjeve, zhvillimi i turizmit, zgjerimi i zonave urbane, ndryshimi i habitateve etj. Në vijim, do të trajtohen më gjerësisht disa nga këto problematika duke i analizuar specifikisht për çdo shkak të humbjes së florës në territorin e Bashkisë Elbasan.

- Problematikat kryesore të biodiversitetit në Bashki:

Gjendja e specieve të florës e faunës në territorin e bashkisë nuk është ndër më të mirat, kryesisht për shkak të ndërhyrjeve të njeriut në territor. Ndërhyrjet kryesore të njeriut me ndikim në biodiversitet janë renditur më poshtë:

- Zhvillimi industrial dhe pasojat e ish-aktiviteteve industriale, kanë qënë kontribuesit kryesorë të ndotjes së ajrit dhe ujit. Aktualisht, gjendja paraqitet më e stabilizuar, pasi industritë në territorin e bashkisë kanë ulur ndjeshëm kapacitetin e tyre prodhues.

- Urbanizimi: Kërkesa gjithnjë e në rritje për zona banimi, ku në dy dekadat e fundit kjo kërkesë është reflektuar në shtimin e zonave urbane informale dhe në shpërhapje, duke zënë sipërfaqe të zonave natyrore e bujqësore.
- Fragmentimi i habitateve nga ndërtimi i infrastrukturës rrugore apo i veprave të ndryshme ka çuar në fragmentimin e habitateve ose ndërprerjen e vazhdueshmërisë së zonave natyrore i cili vjen si rrjedhoje e ndërtimit të infrastrukturës në toka bujqësore e natyrore, pa marrë parasysh parimet e mbrojtjes së mjedisit (Figura mëposhtë). Kjo vihet re edhe nga një analizë e thjeshtë e përdorimit të tokës në Territorin e Bashkisë Elbasan. Fragmentimi në vetvete sjell zvogëlimin e sipërfaqes së habitatit të florës e faunës dhe izolimin e tyre në njësi të vogla habitati duke penguar lëvizjen e lirë të kafshëve të ndryshme. Autostrada Tiranë-Elbasan është një ndër veprat e tilla kryesore, që ka sjellë prerjen e zonës natyrore, duke mos lejuar lëvizjen e kafshëve në të gjithë habitatin. Gjatë gjithë gjatësisë së autostradës nuk janë ndërtuar ura ekologjike ose mjete të tjera, që shërbejnë për kalimin e faunës nga njëra anë në tjetrin në raste të tilla.
- Gjuetia e paligjshmeka pasur një ndikim të ndjeshëm në biodiversitet, gjë që ndihet edhe sot, pas dy viteve të ndalimit të saj (moratoriumi i gjuetisë). Për fat të mirë, moratoriumi është zgjatur edhe për 5 vite të tjera.
- HEC-et: Prodhimi i energjisë në territorin e Elbasanit nga HEC-et ka një ndikim jo të vogël në ndryshimin e rrjedhave të përenjëve të vegjël dhe pakësimin e sasisë së ujit të lënë për biodiversitetin. Si rrjedhojë, disa zona përballen me mungesën e ujit për bimët dhe kafshët e egra, sidomos në stinën e verës, gjë që mund të çojë në humbjen e specieve të ndryshme dhe rritjen e stresit tek pjesa tjetër në të ardhmen.
- Zhvillimi i bujqësisë së shkallës: Zhvillimi i bujqësisë, ka qenë kërcënimi kryesor ndaj biodiversitetit gjatë sistemit të shkuar (periudha e regjimit komunist), hapja e tokave të reja bujqësore, shpyllëzimi për këtë qëllim dhe përdorimi i kimikateve bujqësore. Aktualisht, ky mbetet një problem i trashëguar, edhe pse disa nga tokat bujqësore të përftuara nga tarracimet masive të viteve 1980-90, të cilat nuk u përdorën më për funksione bujqësore, po rikthehen në gjendjen e mëparshme natyrore. Sot, bujqësia ndikon ndjeshëm në biodiversitet, kryesisht nëpërmjet përdorimit të pesticideve dhe plehrave kimike në mënyrë të pakontrolluar, duke u kthyer në sektor ndotës, kryesisht për rrjedhat ujore.
- Shpyllëzimi ka qënë dhe mbetet një problem kryesor i prishjes së habitateve. Në dy dekadat e shkuara, krahas prerjeve për lëndë drusore dhe djegëse, shpyllëzime masive ndodhnin për hapjen e tokave bujqësore. Aktualisht, qeveria shqiptare ka vendosur një moratorium 10-vjeçar me qëllim ripërtëritjen e fondit pyjor në vend.
- Kullotja e bagëtisë, në përgjithësi ka një ndikim negativ në zhvillimin e bimësisë, kryesisht në bimët dhe shkurret e ulëta, të cilat shërbejnë si ushqim për bagëtinë. Në territorin e Elbasanit nuk ka një studim të mirëfilltë mbi kapacitetin mbajtës të kullotave. Si rrjedhojë, nuk dihet ndikimi i kullotjes në këtë zonë.
- Zhvillimi i turizmit, kryesisht në formën e vizitave ditore, në zonat natyrore të territorit të Elbasanit, ka një ndikim jo të vogël në ndotjen e këtyre zonave dhe shqetësimin e kafshëve apo shpendëve. Kjo ndodh kryesisht në ato zona ku guidat nuk zbatojnë

standardet e mbrojtjes së natyrës dhe nuk kanë informacion për zonat e caktuara, të cilat nuk duhen shqetësuar

- Peshkimi i pakontrolluar, kryesisht përgjatë lumit Shkumbin, ka ndikuar në uljen e numrit të popullatës së peshqve pa lënë pas edhe peshkimin në liqene apo rezervuarë, të cilët kanë tashmë një jetë natyrore të zhvilluar.

Në territorin e Bashkisë Elbasan mund të ketë edhe aktivitete të tjera, të cilat kanë ndikime më të vogla në biodiversitet ndër të cilat mund të përmendim mbledhjen e nënprodukteve të pyllit siç janë bimët mjekësore etj.

Shpallja e moratoriumit 5-vjeçar të gjuetisë dhe moratoriumit 10-vjeçar të pyjeve mendohet se do të mbrojë biodiversitetin në përgjithësi dhe do të shtojë numrin e specieve floristike dhe faunistike në territorin e Bashkisë.

Figura 76. Specie të faunës në rrezik zhdukjeje në Bashkinë Elbasan[219]

Emërtimi në Latinisht	Emërtimi në Shqip	Shkaqet e rrezikimit	Foto
Helix Lucorum	Kërmilli i Shkurreve	Tregtimi	
Helix Secernenda	Kërmilli Gëlqeror	Tregtimi	
Thymelicus Acteo	Okërverdha Aketon	Koleksionimi, prishja e habitatit	
Gonepteryx Cleopatra	Kleopatra	Koleksionimi, prishja e habitatit	

Tarucus Balcanicus	Ballkania	Mbikullotja, koleksionimi	
Iolana Iolas	Kaltëroshja e Madhe	Koleksionimi para vezëvendosjes	
Polyommaus Eroides	Flatrakaltra Bordurëzesë	Dëmtimi dhe prishja e habitatit. mbikullotja, koleksionimi.	
Libythea Celtis	Caracja	Koleksionimi dhe dëmtimi i habitatit	
Brintesia Circe	Çirça	Koleksionimi, tregtimi	
Neohipparchia Statilinus	Statilinia	Dëmtimi dhe prishja e habitatit dhe koleksionimi	
Hipparchia Alcyone	Gurishtorja	Ndotja dhe prishja e habitatit	

Charaxes Jasius	Dybishtakja Jasius	Koleksionimi	
Apatura Ilia	Apatura	Koleksionimi, prishja e habitatit	
Pandoriana Pandora	Pandora	Koleksionimi intensiv	
Azuritis Reducta	Admiralja Njollëbardhë	Dëmtimi dhe prishja e habitateve, koleksionimi	
Nymphalis Polychloros	Shumëngjyrshja	Dëmtimi dhe prishja e habitateve, koleksionimi	
Nymphalis Xanthomelas	Këmbëverdha	Dëmtimi dhe prishja e habitateve, koleksionimi	
Melitaea Cinxia	Cinksia	Dëmtimi dhe prishja e habitateve, koleksionimi	

Melitaea Trivia	Trivia	Dëmtimi dhe prishja e habitateve, koleksionimi	
Cinclidia Phoebe	Flutura e livadheve	Koleksionimi	
Mellicta Athalia	Athalia	Koleksionimi, prishja e habitateve	
Santurnia Pyri	Sypalloi i madh i natës	Koleksionimi intensiv	
Calosoma Sycophanta	Kalosoma Erëkeqe	Prishja e habitatit, bujqësia, plehërimi toksik	
Lucanus Cervus	Kacadrei	Prishja e habitatit, bujqësia, plehërimi toksik	
Purpuricenus Kaehleri	Kuqalashi Njollë Zezë	Prishja e habitatit, bujqësia, plehërimi toksik	

Cobitis Taenia Taenia	Mërenë e Zezë	Ndotja e mjediseve ujore, peshkimi me lëndë shpërthyese (eksploziv), kimikatet.	
Emys Orbicularis	Breshkuçje	Ndotja e habitateve, shqetësimi dhe dëmtimi	
Ophisarus Apodus	Bullari	Shqetësime dhe dëmtime fizike	
Elaphe Quaturlineata	Bolla me katër vija	Shkatërrim habitati, shqetësime dhe dëmtimi fizik	
Elaphe Situla	Gjarpri Laraman	Shkatërrim habitati, shqetësime dhe dëmtimi fizik	
Pernis Apivorus	Huta grenxë-ngrënëse	Gjuetia dhe shqetësimi i vënd-folezëzimit	
Neophron Percnopterus	Kali i Qyqes	Pakësimi i ushqimit, shqetësimi i vendeve të flozimit, gjuetia	
Circateus Gallicus	Shqiponja Gjarpër-ngërnëse	Pakësimi i ushqimit, shqetësimi i vëndeve të flozimit, gjuetia	

Accipiter Gentilis	Gjeraqina	Pakësimi i ushqimit, shqetësimi i vëndeve të flozimit, gjuetia	
Accipiter Nisus	Gjeraqina Shkurtes	Pakësimi i ushqimit, shqetësimi i vëndeve të flozimit, gjuetia	
Buteu buteo	Huta	Pakësimi i ushqimit, shqetësimi i vëndeve të flozimit, gjuetia	
Buteo Rufinus	Huta Bishtbardhë	Gjuetia e paligjshme, degradimi i habitateve, shqetësimi	
Aqulia Chrysaetos	Shqiponja e Malit	Trafikimi, gjuetia e paligjshme dhe shqetësimi	
Strix Aluco	Kukuvajka e pyjeve	Dëmtimi i folesë, shqetësimi	
Apus Apus	Dejka	Dëmtimi i folesë shqetësimi human	

Upua Epops	Pupëza	Gjuetia, tregtimi, Shqetësimi	
Jynx Torquilla	Qafëdredhësi	Gjuetia Sportive, shqetësimet nga njeriu	
Picus Canus	Qukapiku i Përhimë	Gjueti për balcamim, shqetësimi	
Picus Virdis	Qukapiku i Gjelbër	Gjuetia dhe shqetësime humane	
Densdrocopos Leucotos	Qukapiku Larosh	Shqetësime humane dhe gjuetia	
Parus Palustris	Trishtili i vogël	Dëmtimi dhe shqetësimi i habitateve	
Petronia petronia	Harabeli i Gurëve	Dëmtimi dhe shqetësimi i habitateve	


Loxia Cuvirostra	Sqepkryqi	Dëmtimi dhe shqetësimi i habitateve	
Plecotus austriacus	Lakuriqi i Natës veshgjatë i hirtë	Shqetësimet	
Tadarida Teniotis	Lakuriqi i Natës bisht-lirë	Shqetësimet	
Ursus Arctos	Ariu i Murrmë	Humbja dhe fragmentimi i habitatit natyror, gjuetia	
Meles Meles	Baldosa	Dëmtimi i habitateve, gjuetia	
Sus scrofa	Derri i egër	Degradimimi i dushkajave, gjuetia	

Burimi: Libri i Kuq i Faunës Shqipëtare, 2007, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Figura 77. Specie të florës në rrezik zhdukjeje në Bashkinë Elbasan[220]

Emërtimi në Latinisht	Emërtimi në Shqip	Rreziku	Foto
Leontopodium Alpinium	Ylli Alpin	Specie në zhdukie, bimë zbukuruese	
Atropa bella-donna	Helmarinë, duhan i egër	Dëmtim human, specie në zhdukje	
Camanula Tymphea	Lule-kambanë e Timfeut	Kullotje intensive	
Colchium autumnale	Luleshllinë	Mbledhja si bimë mjekësore	
Digitalis lanata	Luletogëzi leshtak	Veprimtaria antropike	
Dryopteris filix-mas	Fier mashkull	Mbledhja pa kriter	

Gentiana lutea	Rahaven	Mbledhja si bimë mjeksore	
Gymnospermium shqipëtarium	Lule helmi	Specie në zhdukje	
Hypericum perforatum	Lulebasani	Mbledhje pa kriter si bimë mjekësore	
Juniperus communis	Dëllinjë e zezë	Shfrytëzimi pa kriter.	
Juniperus foetidissima	Bërshen	Individë të rrallë, trajtimi si bimë mjekësore.	
Juniperus oxycedrus	Dëllinjë e kuqe	Shfrytëzim masiv human.	

Sambucus nigra	Shtog i zi	Mbledhja si bimë mjekësore	
Satureja Montana	Trumzë	Shkulje gjatë mbledhjes	
Sideritis raeseri	Çaj Mali	Shfrytëzimi intensiv po çon në zhdukjen e tij	
Valeriana officinails	Haraqinë mjekësore	Mbledhja si bimë mjeksore	
Viscum album	Veshtull	Mbledhja si bimë mjeksore	
Solenanthus scardicus	Solenatë e Sharrit	Prerja e pyjeve, ndyshime të habitatit	

Alyssum bertolonii	Sericë e Bertolonit	Veprimtaria antropike	
Carduus Micropterus	Freshkull flatravogël	Individë të rrallë	
Crepis Geracioides	Shmangë si kamaroshe	Individë të rrallë	
Geranium Dalmaticum	Kamaroshe Dalmate	Individë të kufizuar	
Malcolmia Illyrica	Malkomë Ilirike	Individë në zhdukje	
Pedicularis Brachyodonta	Pedikulare dhëmbëshkrutër	Individë në zona të kufizuara	
Trifolium Pilczii	Trifili i Picilit	Mbikullotja	

Festucopsis Serpentini	Festukops i serpentinës	Bimë serpentine endemike	
Genista Hassertiana	Gjineshtër e Hasertit	Bimë endemike	
Lactarius volemus	Lopëza	Produkt ushqimor	
Sarcodon Imbricatus	Dhëmbëza	Dëmtimi i habitateve	
Tulipa Sylvestris	Tulipan Pyjesh	Mblidhet si bimë zbukuruese	

Burimi: Libri i Kuq i Florës Shqipëtare, 2007, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN

- **Toka Bujqësore**

Sipas klasifikimit të *Census* 2011, Bashkia e Elbasanit ka Elbasanin si qendër me rëndësi kombëtare, 4 njësi vendore në periferi të aglomerateve (Bradashesh, Labinot-Fushë, Shirgjan dhe Shushicë), 3 njësi bujqësore mikse fushore (Gjergjan, Paper e Tregan), 1 njësi bujqësore mikse malore (Zavalin) dhe 4 njësi bujqësore malore (Funar, Gjinar, Labinot Mal, dhe Gracen).

Tabela 24. Ndarja e bashkive sipas sektorit ekonomik[221]

Kodi	Bashkia	Tipologjia	Sip. km^2	Banorë
12	Qyteti i Elbasanit	Qendër me rëndësi kombëtare	22.2	80,185
23	Bradashesh, Labinot Fushë, Shirgjan, Shushicë	Njësitë vendore në periferi të aglomerateve	233.2	34,432
44	Funar, Gjinar, Labinot-Mal, Gracen	Njësi vendore bujqësore malore	328.2	13,329
41	Gjergjan, Papër, Tregan	Njësi vendore bujqësore mikse fushore	187.3	14,784
42	Zavalinë	Njësi vendore bujqësore mikse malore	101.1	1,653
Totali			872	144,382

Burimi: CENSUS, 2011; Përgatiti: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Sipas Tabelës mësipër, të paktën 21% e popullsisë ka si aktivitet bazë bujqësinë, por shifra mund të jetë edhe më e lartë, nëse llogaritjet kryhen sipas deklarimeve të punësimit, e jo klasifikimit tipologjik të bashkisë.

Bashkia e Elbasanit nuk ka sipërfaqe të mëdha tokash bujqësore, që mund të shërbejnë për kultivimin intensiv të bimëve. Megjithatë, Bashkia përfshin një larmi të gjerë tokash në territorin e saj (fushore, kodrinore dhe malore), të cilat përdoren për prodhimin e***drithërave*** (grurit, misrit), pemtarisë, perimeve, vreshtarisë (rrushit) dhe blegtorisë (rritja e bagëtive të imta e të trasha si lopët, derri dhe dhentë). Bashkia dallohet edhe për ***ullishtat,*** të cilat janë një traditë e trashëguar ndërshekuj, sidomos në pjesën veriore dhe veri-perëndimore të qytetit, në territorin kodrinor të bashkisë, buzë përrenjve të Manazderes dhe Zaranikës. Kohët e fundit, Bashkia ka zhvilluar edhe ***turizmin malor*** dhe ka shtuar veprimtaritë e saj ekonomike lidhur me Llixhat, në Bashkinë e Treganit.

- Problematikat e Tokave Bujqësore në Elbasan

Erozioni i tokave bujqësore, shkarjet, shembjet: Bashkia e Elbasanit shtrihet në një zonë me reliev të larmishëm fushor, kodrinor dhe malor, ku zonat fushore janë të kufizuara përgjatë luginës së lumit Shkumbin, në Fushën e Elbasanit. Si rrjedhojë, duke qenë se një pjesë e mirë e tokave bujqësore shtrihen në reliev jofushor, ato janë të prirura ndaj erozionit, shkarjeve dhe shembjeve. Për sa i përket ***erozionit*** në tokat bujqësore, ndërsa në vendin tonë rreziku potencial i erozionit konsiderohet mesatar dhe i lartë, në Rrethin e Elbasanit konsiderohet i lartë.[222]

Tabela 25. Vlerësim teorik për nivelin e erozionit potencial në tokat bujqësore të Shqipërisë

Rrethet	Sip (Ha)	Indeksi i erodibilitetit				Indeksi i rrezikut potencial të tokës		
		Absol.	Rel.	Indeksi i erozionit të tokës	Indeksi i pjerrësisë	Absol.	Rel.	Vlerësimi
Lushnje	46,136	5.7	2	2	1.60	6.4	2	Mesatar
Elbasan	40,450	6.9	3	2	2.25	13.5	3	I lartë
Fier	60,674	6.7	3	3	1.68	15.1	3	I lartë

Burimi: AKM 2013

Bashkia ka shumë fshatra të ndodhura në terren kodrinor e malor, sidomos në zonën e NjA-ve Funar, Gjinar, Labinot-Mal, Gracen, e Zavalinë të cilat janë të ndjeshme ndaj erozionit. Shkaqet e erozionit në tokat bujqësore të kultivuara në Bashkinë e Elbasanit janë natyrore dhe të shaktuara nga ndërhyrjet e papërshtatshme të njeriut gjatë përdorimit të saj (keq-manaxhimi). Disa nga këto ndërhyrje mund të lidhen kryesisht me: i) kultivimin e tokave me pjerrësi të mesme e të theksuar, që rezulton në rrëshqitje, ndihmuar kjo dhe nga fenomene të motit; ii) mënyra e kultivimit të tokës bujqësore kodrinore në të njëjtin drejtim me pjerrësinë dhe me zhveshje totale të tokës gjatë plugimit; iii) djegia e mbetjeve të bimëve të kultivuara, si praktikë e thjeshtë për pastrimin e saj, por që shkatërron plehun organik dhe zhvesh tërësisht tokën nga bimësia që shërben si masë mbrojtëse për të; iv) tarracimi i papërshtatshëm i zonave kodrinore-malore me zhveshje të tokës etj. Në fakt, gjatë gjithë zonës fushore dhe kodrinore brenda territorit të bashkisë, në kohën e punimit të tokës, vihen re ngastra me tokë të punuar thellë dhe të zhveshur tërësisht nga bimësia. Kjo sepse në tokat bujqësore në Bashkinë Elbasan dhe pothuajse në gjithë vendin tonë, bujqit ose fermerët vazhdojnë të përdorin praktika bujqësore të paqëndrueshme si zhveshja e tokës nga bimësia e stinëve të mëparshme gjatë plugimit, pa marrë parasysh se një gjë e tillë e varfëron tokën dhe e shndërron atë në tokë të ndjeshme ndaj erozionit, në rastin më të parë të reshjeve me intensitet të lartë apo të stuhive të erës.

Tokat e rajonit të Elbasanit janë të rrezikuara edhe nga mundësitëe ***shkarjeve*** dhe ***shembjeve***[223], një formë e erozionit gjeologjik. AKM-ja identifikon si shkaqe të shkarjeve të tokës në Bashki relievin e thyer, reshjet, dëmtimin e bimësisë natyrore, braktisjen e tokave bujqësore etj. Për shkak të reshjeve dhe mungesës së manaxhimit të ujërave sipërfaqesore dhe nëntokësore, risku i shkarjeve të tokës mbetet i lartë[224].

Fatkeqësisht, ndërkohë që vendet e tjera kanë futur tashmë praktika kultivimi të konsoliduara për shmangien ose zbutjen e erozionit në toka bujqësore (si punimi i tokës duke e trazuar atë sa më pak, ruajtja e masës bimore të të mbjellave të mëparshme gjatë kultivimit, përdorimi i mbulesave bimore ndërmjet stinëve të kultivimit ose mbjellja e foragjereve apo e bimësisë që ushqen dhe forcon tokën ndërmjet bimëve të kultivuara me rreshta si pemtaria, vreshtaria ose ullishtet etj.), në vendin tonë mbetemi ende mbrapa. Si rrjedhojë, për shkak të erozionit, mungesës së njohurisë se thelluar për tokën dhe praktikave të keqmanaxhimit, apo braktisjes, në territorin e bashkisë vihet re degradimi i tokës. Nuk ka shifra lokale, por në rang vendi, vetëm erozioni dhe degradimi i tokave kanë çuar në humbjen e 5% të prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2014[225].

Gërryerja e tokës në brigjet e lumenjve:Gjatë viteve të fundit, në Elbasan mbetet i lartë edhe rreziku i gërryerjes së tokës në brigjet e lumit Shkumbin, i cili shoqërohet edhe me depozitime të ngurta gjatë përmbytjeve[226]. Dëmtimet në brigjet e lumenjeve janë rezultat i shfrytëzimit të materialeve inerte në shtretërit e lumenjeve, dëmtimit të objekteve mbrojtëse dhe dëmtimit të bimësisë përgjatë shtratit dhe mbushjes së shtratit të tyre me mbetje urbane. Të dhënat tregojnë se vlera mesatare e tokës së gërryer luhatet nga 0.5-0.8 ton/vit për çdo metër linear të shtratit të lumit të Shkumbinit[227]. Pra, humbjet përgjatë shtratit të Shkumbinit janë rreth 500-800 m^3 tokë në vit në një hapësirë prej 1,000 meter linear. Niveli i humbjes së tokës në brigjet e këtyre lumenjëve është i lartë ndëkohë që mirëmbajtja e lumenjve është anashkaluar. Gjendja rëndohet sidomos në rastet kur ka reshje të shumta e të rrëmbyeshme[228].

Zvogëlimi i sipërfaqes së tokës bujqësore për shkak të ndërtimeve të ndryshme: Gjatë 20-vjeçarit të fundit, vendi ynë ka njohur një shkallë të lartë ***urbanizimi,*** i cili ka ecur në kundërshtim me parimin e ruajtjes së tokës bujqësore. Pjesa më e madhe e ndërtimeve, edhe pse nuk kemi shifra të sakta është shtrirë në toka bujqësore, përgjatë luginës së Shkumbinit deri në dalje të tij në perëndim të territorit të Bashkisë.

Figura 78. Ndërtime në tokë bujqësore



Burimi: Arkiva, Co-PLAN, 2016

Humbje të tokës bujqësore parashikohet të ndodhin edhe me ***ndërtime veprash të mëdha,*** ndër të cilat përfshihen edhe ndërtimi i autostradave, impianteve të ndryshme për trajtiminin e ujërave apo për vepra të tjera të planifikuara në të ardhmen.

Ulja e rendimentit të tokave për shkak të përdorimit intensiv të saj:Sot, bujqësia në vendin tonë përballet me ndryshime të mëdha të sistemit bujqësor. Në zonat fushore, bujqësia po shndërrohet nga bujqësi familjare në bujqësi intensive (së paku për mënyrën e kultivimit dhe jo domosdoshmërisht për sipërfaqen e konsoliduar të tokës) që nënkupton i) kultivimin e tokës bujqësore përgjatë gjithë vitit me përdorimin e makinerive moderne e inputeve bujqësore të panjohura më parë si dhe ii) shtimin e kulturave bujqësore të reja.

Disa tregues të zhvillimit të bujqësisë së shkallës në tokat bujqësore fushore në vend janë rritja e numrit të fermave të pluguara me traktor dhe rritja e numrit të serave.

Tabela 26. Rritja e numrit të fermave të pluguara me traktor

Rritja e nr. fermave të pluguara me traktor					
Me traktor				Totali	
2011	2011 (%)	2012 (%)	2012	2011	2012
17,987	39	41	19,330	46,374	46,660

Burimi: Burimi i informacionit: Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave

Nga viti 2011 në vitin 2012, pra në harkun kohor të një viti, në vendi tonë ka një rritje prej 3% të fermave të pluguara me traktor. Ndërkohë në vend është shtuar sasia e plehrave kimike të përdorura, kryesisht të uresë (nga 6.9 në 11.5%) dhe diamond superfosfatit (nga 1.9 në 8.2%) në dhjetë vitet e fundit. Megjithatë, një fenomen që është vënë re në këto vite, është edhe ndryshimi i llojit të plehrave kimike të përdorura (kalimi nga superfosfati në diamond superfosfat), për të cilin nuk njihet arsyeja.

Tabela 27. Rritja e sasisë së përdorur të plehrave kimike në vend

Numri i fermave që përdorin plehra kimike				
Emërtimi	1998		2013	
Fermat që plehërojnë	372,507	%	%	342,083
Ure	25,875	6.9	11.5	39,228
Nitrat amoni	48,674	13.1	10.6	36,220
Diamond superfosfat	7,075	1.9	8.2	27,904
Superfosfat	42,428	11.4	5.8	19,729
Të tjera	-	0.0	1.0	3,406

Burimi: Burimi i informacionit: Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave

Zhvilimi i bujqësisë së shkallës ka ardhur për shkak se në këtë mënyrë garantohet rritja e prodhimtarisë e, si rrjedhojë, edhe e përfitimeve ekonomike. Megjithatë, duhet theksuar se bujqësia intensive kërkon njohje të thella të vetive fiziko-kimike të tokës të cilat ndihmojnë në përdorimin efiçient të saj (përdorimin e inputeve bujqësore, llogaritjen e përmbajtjes së metaleve të rënda, depërtimit të ndotjes nga toka në shtresat ujore nëntokësore, llogaritjes së sasisë së ujit të përdorur për ujitje, kohën e përdorimit etj.). Mungesa e njohjeve të tilla mund të çojë në degradimin e tokës dhe në ndotjen e mjedisit me kalimin e viteve, e sigurisht në rënien e prodhimit bujqësor dhe të zhvillimit ekonomik nga bujqësia.

Ndotja e tokës: Në Bashkinë e Elbasanit ndotja e tokës ka ndodhur në seksione të caktuara të territorit, kryesisht në zona industriale, në zonat e depozitimit të mbetjeve si dhe në zona të tjera. Si zona të ndotura, në Bashkinë Elbasan dallohetKombinati Metalurgjik i Elbasanit,pjesërisht në aktivitet edhe sot, Ndërmarrja e Furnizimit Industri-Miniera (NFIM), Ish-Fabrika e çimentos, vend-depozitimi i mbetjeve pranë Shkumbinit në jug të qytetit dhe vend-depozitime të tjera jashtë kushteve teknike dhe higjieno-sanitare të shpërndara në territorin e NjA-ve të ndryshme (për më shumë informacion, seksioni i Vatrave të Nxehta Mjedisore).

Kombinati Metalurgjik i Elbasanit është përcaktuar si një ndër 35 vatrat e nxehta mjedisore të vendit tonë[229] sepse mbart 400,000m^3 mbetje industriale të rrezikshme. Për përcaktimin e llojit të ndotjes dhe shtrirjen gjeografike të ndotjes, që ky kombinat ka shkaktuar në mjedis, janë kryer shumë studime[230] të cilat kanë arritur në përfundimin se në Kombinatin Metalurgjik, toka në brendësi dhe përreth Kombinatit është ndotur me metale të rënda si Cd[231], Zn[232], Cu[233] etj. Nga studimi i kryer nga Tota et al. në vitin 2007, rezulton se *ndotja me metale të rënda (Cd, Zn, dhe Cu) e tokës bujqësore përreth Kombinatit Metalurgjik*[234] *me rreze shtrirjeje 2-5km përreth Kombinati është e theksuar*. Toka bujqësore në Papër, Bradashesh dhe përreth Metalurgjikut është ndotur me Cr[235]. Një studim tjetër[236] ka monitoruar ndotjen e qytetit të Elbasanit në pika të ndryshme të qytetit për të parë largësinë në të cilën era ka trasportuar ndotjen nëpërmjet pluhurit. Sipas këtij studimi, për metalet e rënda si Cr[237], Ni[238], dhe Pb[239], ndikimi në mjedis është më i lartë nëpërmjet ajrit sesa tokës. Ndotja më e lartë me Cr është në zonën Veri-perëndimore ku ndodhet edhe Metalurgjiku. Vlerat më të larta të Fe gjenden në pjesën jugore, afër unazës së qytetit e cila shpjegohet me transportin e skorjeve të Fe-Ni nëpërmjet kësaj rruge. Të gjitha vlerat e Fe janë më të larta se standardet mjedisore. Toka është ndotur me Cr, Zn dhe Fe, ndërsa nëpërmjet ajrit është ndotur mjedisi me Fe[240], Mn[241], Zn, Cr, Ni dhe Pb.

Ndërmarrja e Furnizimit Industri-Miniera (NFIM) ndodhet në Balëz. Sipas raportit të UNECE-s[242], në të ruhen 30 ton cianur . Në Bashkinë e Elbasanit janë disa ***venddepozitime***, në të cilat depozitohen mbetjet e të gjitha llojeve, pa asnjë kusht higjieno-sanitar dhe teknik. Vend-depozitimet janë thjesht fusha të hapura. Ndër vend-depozitimet me ndikim më të theksuar në mjedis dhe në tokat bujqësore është ai i Shkumbinit i cili, fatmirësisht, është në proces rehabilitimi. Vend-depozitimet kontribuojnë në ndotjen e tokës, ajrit dhe të burimeve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore, në varësi të vendndodhjes së tyre specifike. Për fat të keq, shtrirja hapësinore e ndotjes së tokave përreth vend-depozitimeve nuk është përcaktuar, ose studiuar, gjë që përbën shqetësim të madh për popullsinë.

Industria e naftës: Përveç zonës industriale, përdorimi i tokës bujqësore për qëllime jobujqësore parashikohet edhe nga *industria e naftës* në të ardhmen. Sipas të dhënave nga Albpetrol, rajoni i Elbasanit është me perspektivë për kërkim-zbulim të naftës. Shpimet në strukturën e Diapirit Kripor të Dumresë (6 puse të thella kërkimi, si dhe shumë puse strukturore të cekëta) kanë treguar se kjo zonë është me perspektivë për rezerva hidrokarburesh. Si rrjedhojë, supozohet se edhe në territorin e Bashkisë Elbasan në të ardhmen mund të ketë puse kërkimore. Sipas Albpetrol, zona Paper-Kozan mund të shfrytëzohet me puse deri në veri të Diapirit Kripor të Dumresë. Kjo zonë është më e cekët se Dumrea dhe përcaktohet si zonë e gatshme për kërkime gazi dhe nafte. Sipas legjislacionit shqiptar, të gjitha depozitimet e hidrokarbureve, që ekzistojnë në gjendjen e tyre natyrore në shtresë, janë pronë ekskluzive eshtetit shqiptar, i cili përfaqësohet nga ministria përkatëse. Në bazë të kushteve të specifikuara në rregulloret e hartuara në përputhje me Ligjin nr. 7746, datë 28.7.1993 "Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)" i ndryshuar, një kontraktori mund t'i jepet e drejta për të hyrë dhe përdorur tokë publike, ose private për të kryer operacione hidrokarburesh nën marrëveshjen e hidrokarbureve, ku kontraktori është palë. Me pak fjalë, industria e naftës ka të gjitha të drejtat që të marrë në përdorim tokat bujqësore që nevojiten për veprimtarinë e saj. Kjo tregon për një konflikt të hapur mes përdorimeve të tokës, por edhe mes sektorëve ekonomikë të zhvillimit, ku në nivel politikash qeveria e përcakton bujqësinë si sektor kryesor të rritjes, dhe në nivel praktik e ka lënë të pambrojtur ndaj sektorit të naftës.

- **Ndryshimet klimatike dhe rreziqet**
    - Ndryshimet klimatike në Rajon

Në vendet e Europës Juglindore, përfshirë Shqipërinë, pasojat e ndryshimeve klimatike do të shprehen në forma të ndryshme si:

- njërritje e temperaturës me 1.7 – 3.5°C deri në vitin 2100,
- njëulje e sasisë së reshjeve dhe ndryshimtë regjimit të tyre (-3.84 deri në -18.13% deri në vitin 2100)[243].

Këto fenomene parashikohet të kenë pasoja të theksuara në zhvillimin e rajonit, sepse kanë mundësi të shkaktojnë ngritjen e nivelit të detit duke krijuar erozion detar, përmbytje, pakësimtë ujërave nëpër lumenj e liqene gjatë vitit dhe përmbytje në periudha të caktuara për shkak të shtimit të reshjeve me intensitet të lartë, ndryshimeve në stinën e kultivimit në bujqësi, ndryshim të habitateve, paksimnë numër dhe lloj të specieve, shtimtë llojeve të huaja invazive së bashku me rritjen e sëmundjeve infektive.[244]

Gjithashtu, probleme të shumta do të hasen në komunitetet lokale dhe ato rajonale që varen nga shërbimet që ofron ekosistemi, uji i pijshëm, karburanti, materialet për ndërtim dhe të korrat. Të gjitha së bashku do të kenë një ndikim të madh në mbajtjen e kushteve optimale të jetesës. Është fakt i rëndësishëm, që disa rajone të Europës Juglindore shtrihen në fushën e Europës e cilaështë zonë më e ndjeshme nga ndryshimet klimatike. Ndër pasojat më të theksuara të ndryshimeve klimatike, që parashikohet të ndodhin në rajon, renditen më poshtë:[245]

- Mungesa e ujit të pastër për shkak të uljes të sasisë së reshjeve dhe rritjes së temperaturave.
- Në zonat malore ku rritja e temperatures do të shkaktojë shkrirjen e shpejtë të akujve dhe dëborës parashikohet fryrja e rrjedhave të lumit dhe ndikimet zinxhir që rrjedhin nga kjo.
- Zonat bregdetare do të përballen me pasojat që vijnë nga rritja e nivelit të detit kombinuar me rritjen e rrezikut nga fenomene klimatike si stuhitë apo reshjet intensive.

    - Ndryshimet klimatike në Shqipëri

Siç u tha me lart, Shqipëria, duke qënë se shtrihet në Europën Juglindore, do të këtë pasoja të ndjeshme nga ndryshimet klimatike. Ndryshime kryesore që parashikohen janë[246]:

- Rritja e temperaturave
- Ulja e sasisë së reshjeve,
- Shtimi i fenomeneve ekstreme të motit
- Rritja e nivelit të detit[247].

Rritja e temperaturave: Bazuar në të dhënat e paraqitura në komunikimin e tretë që Shqipëria ka bërë për ndryshimet klimatike në tre skenare të përgatitur, tregohet një rritje e mundshme e temperaturës mesatare vjetore përgjatë viteve 2030, 2050, 2080 dhe 2100. Si temperaturë referencë është marrë temperatura mesatare e vitit 1990.

Tabela 28. Skenaret e parashikimit të rritjes së temperatures (Referuar Tem. Mes. 1990)


Stinët		Vitet		
	2030	2050	2080	2100
Vjetor	1.0 (0.7 to 1.2)	1.7 (1.3 to 2.2)	2.8 (2.0 to 3.5)	3.2 (2.4 to 4.1)
Dimër	0.8 (0.7 to 0.9)	1.2 (1.1 to 1.4)	2.0 (1.7 to 2.3)	2.4 (1.9 to 2.7)
Pranverë	1.0 (0.8 to 1.12)	1.5 (1.3 to 1.8)	2.6 (2.2 to 3.0)	3.1 (2.6 to 3.6)
Verë	1.6 (0.5 to 1.8)	2.5 (2.1 to 2.8)	4.3 (3.8 to 4.9)	5.3 (4.6 to 6.0)
Vjeshtë	1.0 (1.0 to 1.1)	1.6 (1.5 to 1.8)	2.8 (2.7 to 3.0)	3.5 (3.2 to 3.7)

Burimi: Ministria e Mjedisit 2016[248], Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Në skenaret e rritjes së temperaturës, në vitin 2050 parashikohet një rritje mesatare e temperaturës me 1.7°C dhe skenari maksimal 2.2°C. Ndërsa në vitin 2080, temperatura mund të rritet me 2.8°C, ndërsa vlera maksimale e vlerësuar arrin shifrën 3.5°C. Në vitin 2100, temperatura mesatare vjetore parashikohet të rritet me 2.4-4.1°C.

Duke vëzhguar vlerën e rritjes së temperaturës sipas stinëve të vitit, shqetësues është fakti që rritja më e madhe e temperaturës parashikohet të ndodhë në stinën e verës, duke e kthyer atë në një stinë akoma më të nxehtë e të thatë (Figura mëposhtë). Temperaturat mesatare vjetore për skenaret e përgatitur mund të rriten me 2.1-2.8°C në vitin 2050, dhe një rritje me 4.6-6.0°C në vitin 2100, referuar temperaturavetë vitit 1990. Temperaturat mesatare vjetore, sipas skenareve të hartuara, pritet të arrijnë në 25°C në vitet 2050, dhe në 30°C në vitin 2100.

Figura 79. Skenarët e parashikimit të rritjes së temperaturës



Burimi: Ministria e Mjedisit 2016[249], Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Përveç rritjes së temperaturave në përgjithësi, parashikohet edhe shtimi i fenomeneve ekstreme të motit siç janë numri i ditëve me temperaturë >35°C pa ndërprerje, numri i ditëve me valë të nxehta, dhe numri i ditëve me temperaturë të ftohtë pa ndërprerje.

Tabela 29. Numri i fenomeneve ekstreme të parashikuara deri në vitin 2100në rajonet bregdetare në vend

Fenomeneve ekstreme të motit	Rajon	Vitet 1961-1990	Vitet			
			2030	2050	2080	2100
Nr. ditëve me Tmaks >35° C	Veri	1.7-5.8	5-10	7-14	8-20	10.0-24.0
	Qendër	6 - 4.9	2-9	2-12	3-18	4.0-21.0
	Jug	1.3	4	5	7	8
Nr. ditëve me valë të nxehta	Veri	19-27	56-60	72-80	95-98	115-120
	Qendër	16	29	36	52	60
	Jug	7	13	16	20	25
Numri i ditëve me temperaturë të ftohtë	Veri	360	550	670	840	930
	Qendër	686	780	870	980	1100
	Jug	757	860	950	1050	1160

Burimi:Ministria e Mjedisit 2016[250], Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Duke iu referuar të dhënave të mësipërme, përgjatë gjithë viteve të ardhshme deri në vitin 2100 do të kemi një rritje të ditëve më temperatura maksimale mbi 35°C, ku ng 1.7-5.8 ditë në periudhën 61-1990, në vitin 2100 do të arijnë 10-24 ditë me temperatura mbi 35°C në veri, nërsa në pjesën qëndrore dhe jugore kjo vlerë është më e ulët. Gjithashtu, ditët me valë të nxehta do të rriten përgjatë viteve të ardhshme, nga 19-27 ditë në periudhën 61-1990, në 115-120 në vitin 2100 në pjesën veriore, ndërsa në atë qëndrore dhe jugore vlerat paraqiten më të ulëta. Përsa i përket ditëve me temperaturë me të ulët se 0°C të paraqitura në tabelën e mësipërme, parashikohet një rënie drastike deri në vitin 2100, krahasuar me vitin 1990, nga 10-27 ditë në periudhën 61-1990, në vitin 2100 këto ditë nuk do të jenë aspak të pranishme në të gjithë zonën bregdetare. Gjithashtu, edhe ditët me valëtë të ftohtit nuk do të jenë të pranishme në vitet 2100.

Tabela 30. Numri i ditëve me fenomene ekstreme të motit në vit: Parashikime

Fenomeneve ekstreme të motit	Rajon	Vitet 61-1990	Vitet			
			2030	2050	2080	2100
Ditë me Tmin < 0°C	Veri	10-27	4-15	0-10	0-3	0
	Qendër	7-32	3-18	0-11	0-5	0
	Jug	3	0	0	0	0
Ditë me valë të ftohta	Veri	30-48	10-15	6-7	0-6	0
	Qendër	32-46	20-32	12-23	6-8	0
	Jug	7	0	0	0	0
Ditë me valë të ngrohta	Veri	1450	1410	1390	1350	1335
	Qendër	1530	1495	1460	1420	1390
	Jug	1168	1130	1110	1090	10702

Burimi: Ministria e Mjedisit 2016[251], Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Si pasojë e rritjes së temperaturës, dhe rritjes së numrit të ditëve me valë të nxehta, vendi do të përballet me thatësirë të konsiderueshme dhe mot të nxehtë. Ndikim të menjëhershëm

do të këtë në rritjen e mesatares vjetore të vdekshmërisë, kryesisht për moshat e treta; nëkërkesën në rritje për ujë të pastër; dhe probleme me përshtatjen e kulturave bujqësore me klimën.

Ulja e sasisë së reshjeve: Një problem i rëndësishëm, që pritet të vijë bashkë me ndryshimet klimatike, tashmë të vërtetuara shkencërisht, është ulja e sasisë së reshjeve vjetore dhe shpërndarja e tyre përgjatë vitit.

Tabela 31. Parashikimet e ndryshimit të regjimit të reshjeve (në %) për periudha të ndryshme në lidhje me vitin 1990

Vitet	2030	2050	2080	2100
Vjetor	-3.84 (-35.4 to 27.7)	-8.46 (-56.0 to 47.4)	-14.37 (-78.6 to 81.1)	-18.13 (-89.7 to 94.9)
Dimër	-5.96 (-15.9 to 4.0)	-10 (-27.9 to 7.7)	-14.3 (-44.6 to 16.1)	-18.1 (-55.8 to 19.6)
Pranverë	-2.45 (-11.9 to 7.0)	-7.26 (-25.3to 10.75)	-14.26 (-45.1to 16.6)	-17.7 (-55.3 to 19.8)
Verë	-10.4 (-12.8 to -7.9)	-19.7(-24.1 to -15.3)	-41.9 (-49.2 to -34.5)	-50.4 (-59.4 to -41.3)
Vjeshtë	0.5 (-10.1 to 11.1)	-2.5 (-21.3 to 16.3)	-6.9 (-38.1 to 25.2)	-9.5 (-48.1 to 29.1)

Burimi: Ministria e Mjedisit 2016[252], Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Në vitet e ardhshme pritet që sasia e reshjeve të ulet rreth 14.37% në vitin 2080, dhe deri në mbi 18% në vitin 2010. Në vitet e ardhshme parashikohet që periudhat e thatësirës të shtohen së tepërmi, si pasojë e uljes së sasisë mesatare të reshjeve vjetore dhe shpërndarjes së tyre përgjatë vitit. Nga të dhënat e skenareve të parashikuara të shpërndarjes së reshjeve vjetore, vihet re që stina e verës do të jetë mbi 50% më e thatë. Mungesa e reshjeve do të çojë në një verë shumë më të nxehtë dhe të thatë, duke u kthyer në problem serioz për zhvillimin e bujqësisë, dhe shumë probleme të tjera në sektorë të ndryshëm ekonomik.

Rritja e temperaturave në territorin e Bashkisë Elbasan do të ketë një sërë problemesh kryesisht në zhvillimin e bujqësisë dhe në biodiversitet. Zhvillimi bujqësor në territorin e bashkisë do të përballet më kushte klimatike më të thata, si pasojë do të ketë një rritje të kërkesës për ujë për vaditje, dhe nga ana tjetër, një ulje të sasisë së reshjeve dhe rezervave ujore të përdorshme për bujqësinë. Shtimi i dëmtuesve (parazitë, mikrobe, insekte), do të jetë një problem i qenësishëmme rritjen e temperaturës mesatare vjetore. Biodiversiteti do të preket ndjeshëm nga kohëzgjatja e periudhave të nxehta gjatë vitit dhe mungesës së reshjeve, si pasojë dhe intensifikimi i zjarreve, të cilët dëmtojnë specie dhe habitate në tërësi. Për zhvillimin sa më të qëndrueshëm të biodiversitetit duhen marrë masa në kohë sa më të hershme, për përshtatjene bujqësisë dhe gjetjen e mënyrave për plotësimin e nevojës me ujë për vaditje.

Shtimi i fenomeneve ekstreme të motit: Përgjatë viteve, fenomenet ekstreme te motit si përmbytjet, valët e të nxehtit etj. kanë qënë të pranishme në vendin tonë. Përmbytjet kanë një ndikim të madh në aspektin e jetës së njerëzve, ekonomisë, bujqësisë dhe mjedisit. Pika kulminante e përmbytjes në vitin e fundit është regjistruar në vitin 2010, në të cilën humbjet arritën në rreth 0.15% të PBB-së së vendit. Në vitet që vijnë, fenomeni i përmbytjeve, i ndihmuar nga shirat intensive, që pritet të shtohen, parashikohet të shpeshtohet. Stina e verës do të pësojë ndryshime të theksuara, duke krijuar kushte ekstreme si temperatura të

larta dhe periudha të zgjatura të thata. Ndërsa në zonat bregdetare, me rritjen e temperaturave dhe intensifikimin e reshjeve, parashikohet të formohen stuhi, të cilat do të kenë një ndikim jo të vogël në ato zona.

Në të shkuarën, pjesë të territorit tëBashkisë Elbasan janë bërë pre e përmbytjeve të vazhdueshme nga lumenjtë, kryesisht tokat bujqësore pranë brigjeve. Në vitet e fundit, ky fenomen po kthehet i përvitshëm edhe pse në shkallë të ndryshme. Në skenarët e parashikimit të ndryshimit të klimës, theksohet shtimi i fenomeneve ekstreme të motit, kryesisht shtimi i shirave itensivë, të cilët janë tepër problematike në fryrjen e menjëhershme të lumenjve, dhe si pasojë përmbytjet do të jenë më të mëdha. Zonat breglumore, apo dhe zona përreth, do të jenë tepër të prekura nga përmbytjet që parashikohen në të ardhmen, ndaj duhen marrë masa të menjëhershme për përballimin e këtij fenomeni, mbrojtjen e tokës bujqësore dhe të zonave urbane.

Rritja e nivelit të detit[253]: Niveli i detit Adriatik ka pësuar një rritje prej 15cm gjatë shekullit të kaluar, Në dekadat e ardhshme, deri në vitin 2100, niveli i detit pritet të rritet me 40cm. Rritja e konsiderueshme e nivelit të detit do të sjellë një sërë pasojash negative përgjatë vijës bregdetare, kryesisht në tokat bujqësore, habitatet bregdetare dhe zonat turistike. Si rezultat i rritjes së nivelit të detit, deri në vitin 2050, rreth 1,082.45km^2 (32% e zonës bregdetare, osë 3.76% e sipërfaqes së vendit) do të vuajë pasoja të drejtpërdrejta nga përmbytjet. Pjesë të konsiderueshme të tokës bujqësore do të konsiderohen të humbura, apo të papërdorshme, për shkak të rritjes së nivelit të detit dhe kripëzimit. Shumica e habitateve bregdetare të tilla si dunat ranore, ligatinat me ujë të njelmët, lagunat, do të pësojnë ndryshime të konsiderueshme, disa prej tyre do të kenë humbur totalisht funksionin dhe të tjera do të jenë të dëmtuara në shkallë relativisht të lartë.

- <u>Sektorët ekonomikë më të prekur nga ndryshime klimatike</u>

Bujqësia[254]**:** Sektori i bujqësisë është një nga drejtuesit kryesorë të ekonomisë shqiptare. Në vitin 2011 sektori i bujqësisë numëronte 54.6% të punësuarve, dhe kontribuonte në 20% të PBB-së. Bujqësia është shumë e ndjeshme ndaj ndryshimeve afatshkurtra të motit, luhatjeve sezonale dhe vjetore. Ndryshimi i klimës dhe rritja e temperaturës kanë ndikim të drejtëpërdrejtë në uljen e prodhimit, shtimin e dëmtuesve në bujqësi (insekteve, parazitëve) etj. Gjithashtu, ndryshimi i klimës do të sjellë ulje të sasisë së reshjeve, sidomos në periudhën e verës duke çuar në rritjetë kërkesës për ujë dhe uljen e mundësisë për të pasur ujë të mjaftueshëm për të plotësuar nevojat gjithnjë e në rritje që ka bujqësia për ujë. Me rritjen e temperaturës, kulturat bujqësore do të hasin probleme me përshtatshmërinë e tyre rajonale. Kjo nënkupton që përgjatë dhjetëvjeçarëve të ardhshëm nevojitet të përshtatim llojin e të mbjellave me lloje më rezistente ndaj thatësirës dhe varietete që kërkojnë më pak ujë. Frutat dhe perimet do të jenë më të prekura nga ndryshimet klimatike, pasi rritja e temperatures shton stresin tek këto bimë, duke ulur prodhimtarine ose duke vështirësuar rritjen e tyre.

Në territorin e Bashkisë Elbasan do të hasen jo pak ndryshime. Ndryshimet kryesore në lidhje me zhvillimin bujqësor janë rritja e temperaturës, shtimi i kohës së kultivimit, valët e të nxehtit, zgjatja i periudhës së thatë, shtimi i dëmtuesve të bujqësisë dhe mundësia e mungesës së ujit vaditës në disa zona. Rritja e temperaturës mesatare vjetore ka ndikim direkt në zhvillimin e bujqësisë, pasi kulturat aktuale, të cilat përdoren në tokat bujqësore, nuk do të përshtaten maksimalisht me temperaturat në rritje, apo disa prej tyre do ta kenë

të pamundur të përshtaten, e për pasojë do të kemi të korra më të ulëta nga bujqësia. Intensifikimi i valëve të tënxehtit dhe ulja e reshjeve në periudhen e kultivimit të bujqësisë pritet të këtë një ndikim të madh në zhvillimin e bujqësisë, pasi do të kërkojë sasi të mëdha uji për vaditje, ndërsa zona të cilat nuk kanë akses në kanalet vaditës do të reduktojnë maksimalisht sasinë e të korrave. Rritja e temperaturës dhe zvogëlimi i valëve të ftohta në dimër do të këtë një ndikim direkt në shtimin e dëmtuesve të tëmbjellave bujqësore, pasi shume prej këtyre dëmtuesve (duke mos pasur temperature të ulta në dimër) do të mund të shtohen duke rritur periudhën e riprodhimit të tyre. Kjo situatë do të çojë në rritjen e kostos së prodhimit, në sajë të përdorimit të pesticideve, nëulje të cilësisë së prodhimit dhe nërënie të rendimentit.

Burimet ujore (Energjitika, HEC-et dhe burimet ujore)[255]:Përbërësit kryesorë të ciklit hidrologjik janë avullimi, transpirimi dhe reshjet. Ndryshimi i parametrave klimatikë, rrezatimi diellor, shpejtesia e erës, temperatura dhe lagështia ndikojnë drejtpërsëdrejti në fenomenin e avullimit. Ndryshimi i avullimit dhe reshjeve do të ndikojë në bilancin ujor në vend. Reshjet mesatare vjetore në dekadat e ardhshme priten të ulen rreth 18%, ndërsa rastet e shirave intensive parashikohen të jenë më të shpeshta duke rritur shpeshtësinë e përmbytjeve. Duke patur parasysh që energjia elektrike në vend tëplotësohet nga HEC-et, rritja e temperaturës do ta shtojë mungesën e ujit,i cili do të duhet për të plotësuar nevojat përgjatë gjithë vitit për energji dhe bujqësinë. Zgjatimi i periudhës së thatë në stinën e verës, shkrirja e dëborës në male, dhe mungesa e reshjeve në periudha të caktuara të vitit do të jetë një problem madhor në plotësimin e nevojave me ujë për sektorë të ndryshëm si energji, bujqësi etj. Prodhimi i energjisë pritet të ketë vështirësi në manaxhimin e situatave, duke qënë së ndarja e sasisë së reshjeve përgjatë vitit do të ketë diferenca të konsiderueshme. Rezervuarët e HEC-eve parashikohet të tejmbushen në periudha të caktuara dhe të vuajnë mungesën e sasisë së ujit në periudhën e verës. Megjithatë, edhe në rastin më të keq, diferenca midis prodhimit dhe nevojës përujë mund të zbutet me çështje teknike dhe të politikave.

Përmbytjet nga rrjedhat e lumenjve do të jenë një problem serioz dhe me i shpeshtë në dekadat e ardhshme. Shirat e rrëmbyeshme që sjellin vërshimin maksimal të lumenjve në kohë të shkurtër parashikohet të jenë problemi kryesor i përmbytjeve në pjesën fushore të vendit. Periudha nëntor-mars kur sasia e reshjeve është më e madhe (80-85% e sasisë vjetore) parashikohet periudha më problematike për përmbytjet. Në Bashkinë Elbasan përmbytjet mund të theksohen në Zaranikë dhe Manazdere, si dhe në zonat ku bashkohen me Lumin Shkumbin.

Vlen të theksohet se rritja e temperaturës sjell edhe zgjatjen e harkut kohor brenda të cilit mund të kultivohet përgjatë vitit gjë që mund të ketë ndikime pozitive në bujqësi. Mundësia e kultivimin në një periudhë më të gjatë kohore dhe mundësia e futjes së kulturave të reja në bujqësi mund të çojë në rritjen e prodhimtarisë.

Turizmi[256]**:** Kontributi i sektorit të turizmit për PBB-në është 7.6%, referuar vitit 2009. Ndryshimi i klimës është parashikuar të ketë një ndikim jo të vogël në sektorin e turizmit në vend, pozitiv dhe negativ. Deri në vitin 2030, parashikohet që periudha tetor-maj të jetë e papërshtatshme për turizëm, ndërsa periudha tjetër do të ofrojë një rehati për zhvillimin e turizmit të diellit dhe detit. Të dhënat për vitin 2050 e përcaktojnë prillin si muaj të pranueshëm për zhvillimin e turizmit bregdetar, ndërsa maj - tetor cilësohen muaj të shkëlqyer për zhvillimin e turizmit bregdetar. Parashikimet për vitin 2080 e përcaktojnë

vetëm dhjetorin, janarin dhe shkurtin si të muaj të papërshtatshëm për turizem diellor e detar, ndërsa muajt e tjerë janë më se të përshtatshëm. Aktualisht, 80% e turistëve që hyjnë në Shqipëri janë të përqëndruar në zonën bregdetare. Me rritjen e temperaturave, ky numër pritet të rritet duke çuar kështu në rritjen e presionit ndaj mjedisit, ndotjes së zonave nga mbetjet, ndotjen e ajrit dhe ujit. Manaxhimi i mbetjeve, ujrave të ndotur urbane, si dhe siguria për ujë të pastër është një nga sfidat kryesorë me të cilat do të përballet sektori i turizmit në vend.

Popullsia: Ndryshimi i klimës parashikohet të ndikojë në shëndetin e banorëve në zonën bregdetare dhe veprimtarinë e tyre ekonomike kryesore si turizmi dhe bujqësia. Krahas kësaj, do të ketë rreziqe kërcënuese të cilat do të ndikojnë në sigurinë e jetës (përmbytjet, zjarri, rritja e mikrobeve dhe insekteve që transmetojnë sëmundje ngjitëse, ulja e rezervave të ujit të pijshëm, ushqimi, energjia, cilësia e mjedisit dhe peizazhit). Rritja e nivelit të detit dhe përmbytjet e lumenjve do të jenë një problem tepër shqetësues në zonat fushore, kënetat apo ish-kënetat, të cilat janë në disnivel nga deti (deri në 2m). Në këto zona ka ardhur në rritje numri i popullsisë që nga viti 1950, kur toka bujqësore është përfituar nga bonifikimi i kënetave dhe shkripëzimi i tokave në afërsi të vijës bregdetare.

Përveç ndikimit mbi popullsinë, një numër i konsiderueshëm i banesave të ndërtuara gjatë 24 viteve të fundit pritet të dëmtohet nga përmbytjet. Rreth 41,625 banesa, vendosur deri në 0.5 m mbi nivelin e detit, të cilat rrezikohen të përmbyten deri në vitin 2030, dhe 48,730 ndërtesa, të cilat janë ndërtuar mbi nivelin e detit, priten të preken nga përmbytjet pas vitit 2050. Lagështia e tepërt dhe përmbytjet do të kenë një ndikim të madh në popullsi pasishumica e kateve të para të banesave nuk kanë hidro-izolim. Në vitet e ardhshme priten përmbytje (si ato të 2010) dhe stuhi të cilat, krahas dëmeve materiale, mund të shkaktojnë dhe humbje në njerëz, ashtu si në shumë vende europiane dhe fqinje. Në zonat bregdetare, nga rritja e frekuences së përmbytjeve, pritet që ndikim të madh të ketë në infrastrukturë sipërfaqësore dhe nëntokësore si kanalizime, rrjet energjie, telefoni, interte etj.[257]

- **Trashëgimia Kulturore**

Krahas kështjellës të qytetit, në bashkinë e Elbasanit ndodhen dhe 57 monumente kulture të kategorisë së parë dhe 16 monumente kulture të kategorisë së dytë të cilat administrohen sipas ligjit nr. 9048, date 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore". Neni 32 i këtij ligji specifikon që për monumentet e kulturës përcaktohet një zonë mbrojtëse, në përputhje me vlerat e tyre arkitektonike dhe me përshtatshmërinë e tyre urbanistike-estetike. Përmasat e kësaj zone, ku ndalohet çdo ndërhyrje me karakter ndërtimor, janë përcaktuar nga organi që ka shpallur monumentin, sipas studimit të bërë nga Instituti i Monumenteve të Kulturës. Me Vendim të KKT nr. 1, datë 09.09.2015 janë shpallur zona të rëndësisë kombëtare në planifikim disa monumente kulturore, në Elbasan ndodhën përkatësisht Stacioni Rrugor Ad Quintum në Bradashesh, kisha e Shën Kollit në Shelçan dhe kisha e Shën Gjon Vladimirit në Shijon.

- Kalaja e Elbasanit;
- Kalaja e Gurit;
- Kalaja e Menglit;
- Kalaja e Dragotit;
- Kalaja e Valëshit;
- Kalaja e Bodinit;

- Kalaja e Malit;
- Kalaja në Llixhat e Elbasanit;
- Kalaja në Shkëmbin Mbret në fshatin Xibrakë;
- Kalaja në vendin e quajtur Kulla e Gracenit;
- Kalaja në vendin e quajtur Shkëmbi i Skënderbeut (Shen Lliut);
- Kalaja në vendin e quajtur Kulla e Komunahut në fshatin Kamunak;
- Kalaja e Malit dhe Kalaja në Majën e Shën Marisë;
- Gjurmë të Kalasë Mesjetare pranë Pallatit të Sportit;
- Kalaja e Kabashit pranë fshatit Jerenisht në Shpat, Zavalinë;
- Tumat e Fushës së Pazhokut;
- Tumat në Perëndim të fshatit Kajan;
- Kulla e Sahatit në Muret e Kalase së Elbasanit;
- Ura Antike në fshatin Muriqan;
- Këmbët e Urës Antike në Topçias;
- Ura mbi Përroin Gurra e Labinotit në fshatin Labinot;
- Gërmadhat Antike (Stacioni rrugor Ad-Quintum) në Bradashesh;
- Bezisteni i qytetit, shatervani, rrapi dhe një pjesë e kalldrëmit që përfshin këto 2 ambiente të Bezistenit;
- Kisha e Shën Gjon Vladimirit në Shnjon, godina me mbishkrimin dhe stemën e Karl Topisë bashkë me mbishkrime të tjera me një distancë me 5 metra rreth mureve;
- Kisha e Shën e Premtes në fshatin Valësh;
- Kisha e Shën Kollit në Shelcan, në Jug-Lindje të Elbasanit, godina me 5 metra distancë rreth mureve;
- Kisha Fjetja e Shën Marisë në lagjen Kala, në qytetin e Elbasanit;
- Rrënojat e Kishës në fshatin Selvias;
- Rrënojat e Kishës në fshatin Bixëllenjë;
- Rrënojat e Kishës në fshatin Mamël;
- Rrënojat e Kishës së Ungjillizimit në fshatin Mjekëz;
- Bazilika në Kodër të Tepes pranë qytetit të Elbasanit;
- Xhamia Mbret në lagjen Kala të qytetit të Elbasanit, në lagjen e Kalasë, e kufizuar në 3 anët me rrugë dhe nga veriu me oborrin;
- Xhamia e Nazireshës jashtë Qytetit, godina me një distance prej 10m rreth mureve;
- Hamami i Pazarit në vendin qoshe;
- Hamami i vjetër në lagjen Kala;
- Banesa e Qemal Stafës në qytetin e Elbasanit;
- Shkolla "Kostandin Kristoforidhi" dhe varri pranë saj në qytetin e Elbasanit;
- Burgu dhe qelitë e tij në qytetin e Elbasanit;
- Shtëpia Muze e Kostandin Kristoforidhit ;
- Banesa e Staf Papanikoll Papajanit lagja Kala, Elbasan;
- Banesa e Sul Shahinit, lagjia "Karavelija", Elbasan;
- Banesa e Hajdar Sejdinit, lagjia Alejdini në Kryqëzimin e rrugëve "11 Nëntori" dhe "Skënderbeu", në qytetin e Elbasanit;
- Banesa e Hajrie Skiles, lagjia "Sulejmanie", Elbasan;
- Banesa e Ikbale Bumcit, rr. Kristoforidhi, Elbasan;
- Banesa e Tasim Qiftjes, rr.Janaq Kilica", Elbasan;

- Banesa e Vëllezërve Kopili, rr. "Avdul Sula", Elbasan;
- Banesa e Refie Mallahollit, rruga "Brigada XV", Elbasan;
- Banesa e Elena Papajanit, lagjia "Druni Kala", Elbasan;
- Banesa e Jorgji (Lef) Kushtës në fshatin Jorenisht (shpati nr.1);
- Banesa e Toli Dedës (Dedjes) në fshatin Zavalinë (shpati 1);
- Banesa e Rahman Bodurit në fshatin Kaçivel (shpati nr.2);
- Banesa e Pali Skënderit në fshatin Zavalinë, (shpati 1);
- Dhoma me tavan dekorativ ne kopështin e femijëve nr.8, Elbasan;
- Banesa e Qefsere, Shefqet e Sabrie Duhanxhiu, Elbasan;
- Banesa e Nabise Idrizit në fshatin Shmil;
- Banesa e Sali Qafmolla (Çardaku);
- Qendra historike e Qytetit Elbasan (Kalaja, lagjia brenda Kalase, rr. "Rinia", rr. "Qemal Stafa", rr. "Janaq Kilica", rr. "Ptolene Xhuvani");
- B. K. T. rr. "Qemal Baho" ;
- Ish Muzeu i Luftës, rr. "J. Kilica";
- Ish shkolla "Ptoleme Xhuvani", rr. "Sul Misiri";
- Muzeu i qytetit (shpallet në 2008);
- Banesa e Sejdinit (shpallur me 1963);
- Ndërtesa 2 kat, rr. "Q.Bahoi", afër Bibliotekës Publike;
- Biblioteka Publike, rr. "Q.Baho";
- Ndërtesa 2 kat, rr. "Labinoti";
- Rruga "Rinia", duke filluar nga kryqëzimi me lagjen "L.Sokoli";
- Kinema "Skampa", kryqëzimi i rrugës "Rinia" ;
- Banesa e Ram Karagjozit (kasolle) në fshatin Qeret-Shmil;
- Banesa e Qamil Zhgjunit në fshatin Qafe-Shmil;
- Banesa e Ali Dishës në fshatin Lugaxhi (Shmil);
- Shtëpia e Konferencës së Labinotit;
- Bazilika Paleokristiane dhe përcaktimi i zonës mbrojtëse
- Zona Arkeologjike "A" e qytetit dhe rregullorja e administrimit

- **Vatrat e nxehta mjedisore**

Elbasani ka dy vatra të nxehta mjedisore që janë Uzina e Shkrirjes së Ferrokromit dhe Ndërmarrja e Furnizimit Industri-Miniera. Në Elbasan ndodhet edhe Uzina e Lëndëve Plasëse në Mjekës edhe pse nuk është renditur si hotspot, pasi ndikimi i saj në popullsi, në turizëm dhe në biodiversitet nuk përbën një rrezik të lartë[258].

Uzina e Shkrirjes së Ferro-kromit brenda Kombinatin Metalurgjik të Elbasanit: Është përcaktuar si një ndër 35 vatrat e nxehta mjedisore të vendit tonë[259] sepse mbart 400,000m^3 mbetje industriale të rrezikshme. Për përcaktimin e llojit të ndotjes dhe shtrirjen gjeografike të ndotjes që ky kombinat ka shkaktuar në mjedis, janë kryer shumë studime[260] të cilat kanë arritur se në Kombinatin Metalurgjik, toka në brendësi dhe përreth Kombinatit është ndotur me metale të rënda si Cd[261], Zn[262], Cu[263] etj. Nga studimi i kryer nga Tota et al. në vitin 2007, rezulton se ndotja me metale të rënda (Cd, Zn, dhe Cu) e tokës bujqësore përreth Kombinatit Metalurgjik[264] me rreze shtrirjeje 2-5km përreth Kombinatit, është e

theksuar. Toka bujqëore në Papër, Bradashesh dhe përreth Metalurgjikut është ndotur me Cr[265].

Figura 80. Kombinati Metalurgjik Elbasan



Burimi: Arkiva Co-PLAN, 2016

Një studim tjetër[266] ka monitoruar ndotjen e qytetit të Elbasanit në pika të ndryshme të qytetit për të parë largësinë, në të cilën era ka trasportuar ndotjen nëpërmjet pluhurit. Sipas këtij studimi, për metalet e rënda si Cr[267], Ni[268], dhe Pb[269], ndikimi në mjedis është më i lartë nëpërmjet ajrit, sesa tokës. Ndotja më e lartë me Cr është në zonën veri-perëndimore ku ndodhet edhe Metalurgjiku. Vlerat më të larta të Fe gjenden në pjesën jugore, afër unazës së qytetit, e cila shpjegohet me transportin e skorjeve të Fe-Ni nëpërmjet kësaj rruge. Të gjitha vlerat e Fe janë më të larta se standartet mjedisore. Toka është ndotur me Cr, Zn dhe Fe, ndërsa nëpërmjet ajrit është ndotur mjedisi me Fe[270], Mn[271], Zn, Cr, Ni dhe Pb.

Ndërmarrja e Furnizimit Industri-Miniera (NFIM): Ndodhet në Balëz. Sipas raportit të UNECE-s, në Balëz ruhen 30 ton cianur. Me VKM 843, datë 14 Dhjetor 2015, kjo ndërmarrje është shndërruar në Qendër të Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme dhe është në varësi të Ministrisë së Industrisë. Qendra ka si qëllim ofrimin e shërbimeve për identifikimin, "grumbullimin, përgatitjen për eliminimin, depozitimin dhe ruajtjen e kimikateve të rrezikshme"[272].

Sipas AKM-së, deri më tani, janë kryer studimet e Verësimit të Ndikimit në Mjedis dhe planet e veprimit për rehabilitimin afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, dhe kostot e vlerësuara për rehabilitimin dhe monitorimin e Uzinës së Shkrirjes së Ferrokromit.

Uzina e Lëndëve Plasëse:[273]Uzina nëMjekës ka shërbyer edhe për asgjësimin e lëndëve plasëse. Si rrjedhojë e këtij aktiviteti, zona përreth uzinës është ndotur me lëndë plasëse dhe metale të rënda si Pb, Cr, Cu, Mn në nivele shumë të larta.

Tabela 32. Përmbajtja e metaleve të rënda dhe e lëndëve plasëse në Uzinë

Stacioni	Pb (mg/kg)	Cr (mg/kg)	Cu (mg/kg)	Ni (mg/kg)	Cd (mg/kg)	Mn (mg/kg)	TNT (mg/kg)
ULP Mjekës	21.4	32.3	29.6	21	0.4	11.6	0

Burimi: AKM, 2014

Në Uzinë është kryer edhe matja e gazeve NO_2, CO, CO2, SO_2 , NH_3, Toluen, Vox, H_2S rreth 5m larg nga furra e djegies së fishekëve dhe predhave. Matjet janë kryer në distancë kohore 3-4 muaj larg nga njëra tjetra. Edhe pse AKM-ja ka arritur në përfundimin se çlirimi i gazeve në atmosferë është brenda niveleve të përcaktuara në VKM-të përkatëse, duhet shtuar se në uzinë nuk ka stacione të qëndrueshme, që bëjnë matjen e vazhdueshme të gazrave të mësipërme gjatë gjithë vitit.

Mbetjet ushtarake industriale që dalin nga furrat ruhen brenda territorit të godinës, në pritje të depozitimit të tyre në landfille të përshtatshme që deri më tani mungojnë në vendin tonë. Si rrjedhojë, për aq kohë sa Shqipëria nuk ka një landfill të tillë, këto mbetje do të vazhdojnë të ruhen në territorin e uzinës.

- Ndotje të tjera industriale

Fabrika e Çimentos: Ndodhet në zonën indstriale të Elbasanit dhe në të shkuarën është përcaktuar si një nga ndotësit më kryesorë të mjedisit për shkak të sasisë së madhe të pluhurave të dëmshme që çliron në atmosferë. Sipas raportimeve të SHGJSH-së, përmbajtja e tyre në dalje të oxhakut arrin në 47-70gr/m^3N[274]. Përmbajtja e pluhurit në çlirimin e gazrave nga fabrika është raportuar si e lartë (0.975 dhe 0.617 mg/m3 kundrejt përkatësisht 0.5 mg/m3 dhe 0.07mg/m3 që janë normat aktuale) edhe nga vetë industria. Pluhurat e fabrikës shpërndahen përgjatë gjithë qytetit dhe zonave bujqësore nëpërmjet erës duke i ndotur këto zona[275]. Sasia dhe përqëndrimi i elementëve ndotës, që lëshohen nëpërmjet shkarkimeve të gazta e të ngurta të këtyre uzinave, konsiderohet e lartë dhe përbën një burim të vazhdueshëm ndotës për zonën.

Sipas të dhënave të ARM Elbasan, aktualisht kjo fabrikë vazhdon aktivitetin e saj. Fabrika ka ndryshuar procesin e prodhimit dhe teknologjinë, gjë që supozon ndikim më të ulët në mjedis. Megjithatë, si rrjedhojë e mungesës së të dhënave, është e pamundur që të përcaktohet ndryshimi aktual i ndikimit në mjedis të fabrikës.

Kombinati Metalurgjik: Shtrihet në Fushën e Bradasheshit, 2-3 km në jugperëndim të qytetit të Elbasanit. Në territorin e kombinatit ndodhen të depozituara rreth 1.1 milion ton pluhura të kapura nga sistemet e pluhurkapjes (filtrat) e uzinës 12 dhe që kanë përmbajtje të lartë nikeli (Ni). Nga studimi i kryer nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar në vitet 2005-2008 mbi ndikimin mjedisor të veprimtarisë industriale në rajonin e Elbasanit, përmbajtjet e metaleve të rënda Ni, Cr, Co, Zn, Fe, Mn në zonën industriale të Kombinatit të Metalurgjisë së Hekurit rezultojnë dhjetëra herë më të larta se sfondi gjeokimik natyror, duke përbërë një burim të rëndësishëm ndotjeje[276]. Ndotja me metale të rënda e shkaktuar nga ky kombinat shtrihet deri në 30km nga burimi i ndotjes, duke përfshirë edhe zonën urbane dhe tokat bujqësore.

Shkarkimet e ngurta industriale:[277]Duke patur një ndër zonat më të industrializuara të vendit, Bashkia e Elbasanit është ndeshur edhe me problemin e depozitimit të mbetjeve të ngurta industriale gjatë kohës që industria e ferro-kromit, kombinatit metalurgjik, dhe fabrika e çimentos kanë ushtruar aktivitetin e tyre në Bashki. Si pasojë e aktivitetit të tyre ndër vite, sot në Bashki ndodhen disa vend-grumbullime të mbetjeve industriale të cilat janë renditur më poshtë[278]:

- Zona buzë lumit Shkumbin: Shtrihet përgjatë brigjeve të lumit përpara zonës industriale dhe ka një sipërfaqe rreth 1.5 ha. Sipas SHGJSH-së, në këtë zonë janë depozituar mbetjet e ngurta (skorje furrnalte, skorje çeliku të zeza e të bardha, mbeturina veshjesh zjarrduruese, mbeturina çeliku e gize, okaline etj) të furrnaltës së Uzinës së Çelikut dhe Uzinës Mekanike. Sasia e depozituar arrin derin në 1.5-2 milion tonë. Mbetjet përmbajnë metale të rënda, që përbëjnë shqetësim për ndotjen e ujërave të shkumbinit dhe zonës përreth.
- Dampa e TEC-it: Në dampë janë depozituar rreth 200-300 mijë ton hi edhe ky me përmbajtje lëndësh të dëmshme ndryshme.
- Dampa e mbeturinave të Uzinës 12 në zonën e Paprit, ku janë të depozituara sasira të mëdha koncentrati hekuri, që vlerësohet se janë rreth 500 mijë ton.
- Zona e depozitimit të skorjeve të ferrokromit: Sasia e përafërt e skorjeve të depozituara është rreth 500 mijë ton.
- Dampa e shllameve të Fe-Ni:Kjo dampë ndodhet në anën jugore të zonës industriale dhe ishte projektuar për të depozituar mbetjet teknologjike dhe skorie të kombinatit metalurgjik. Dampa është një gropë gjigante e aftë të depozitojë miliona tonë mbeturina për rreth 50 vjet.

Ndikimi i ndotjes me metale të rënda nga burimi ndotës (zona industriale) shtrihet deri në zonën urbane të qytetit të Elbasanit duke rezultuar në rritjetë përmbajtjeve të këtyre elementëve në toka. Kjo veprimtari industriale ka ndikuar edhe në ndotjen e tokave bujqësore me shtrirje deri në 30 km nga burimi ndotës[279].

Shkarkimet e lëngshme industriale: Gjatë gjithë kohës së funksionimit të zonës industriale, SHGJSH-ja raporton se të gjitha ndotjet e lëngshme janë shkarkuar dhe shkarkohen në lumin Shkumbin. Krahas aktiviteteve madhore industriale, në territorin e Bashkisë Elbasan janë identifikuar disa aktivitete më të kufizuara, të cilat ndotjen dhe mbetjen e gjeneruar e shkarkojnë në ujrat e lumit Shkumbin apo përrenjve më të afërt. Ndër to mund të përmëndim mbetjet nga furra e gëlqereve, mbetjet nga aktiviteti i përpunimit të inerteve, mbetje urbane dhe inerte të depozituara në brigje dhe shtratin e trupit ujor.

- Ndotje të tjera industriale

Fabrika e Çimentos: Ndodhet në zonën indstriale të Elbasanit dhe në të shkuarën është përcaktuar si një nga ndotësit më kryesorë të mjedisit për shkak të sasisë së madhe të pluhurave të dëmshme që çliron në atmosferë. Sipas raportimeve të SHGJSH-së, përmbajtja e tyre në dalje të oxhakut arrin në 47-70gr/m^3N[280]. Përmbajtja e pluhurit në çlirimin e gazrave nga fabrika është raportuar si e lartë (0.975 dhe 0.617 mg/m3 kundrejt përkatësisht 0.5 mg/m3 dhe 0.07mg/m3 që janë normat aktuale) edhe nga vetë industria. Pluhurat e fabrikës shpërndahen përgjatë gjithë qytetit dhe zonave bujqësore nëpërmjet erës duke i ndotur këto zona[281]. Sasia dhe përqëndrimi i elementëve ndotës, që lëshohen nëpërmjet shkarkimeve të gazta e të ngurta të këtyre uzinave, konsiderohet e lartë dhe përbën një burim të vazhdueshëm ndotës për zonën.

Sipas të dhënave të ARM Elbasan, aktualisht kjo fabrikë vazhdon aktivitetin e saj. Fabrika ka ndryshuar procesin e prodhimit dhe teknologjinë, gjë që supozon ndikim më të ulët në mjedis. Megjithatë, si rrjedhojë e mungesës së të dhënave, është e pamundur që të përcaktohet ndryshimi aktual i ndikimit në mjedis të fabrikës.

Kombinati Metalurgjik: Shtrihet në Fushën e Bradasheshit, 2-3 km në jugperëndim të qytetit të Elbasanit. Në territorin e kombinatit ndodhen të depozituara rreth 1.1 milion ton pluhura të kapura nga sistemet e pluhurkapjes (filtrat) e uzinës 12 dhe që kanë përmbajtje të lartë nikeli (Ni). Nga studimi i kryer nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar në vitet 2005-2008 mbi ndikimin mjedisor të veprimtarisë industriale në rajonin e Elbasanit, përmbajtjet e metaleve të rënda Ni, Cr, Co, Zn, Fe, Mn në zonën industriale të Kombinatit të Metalurgjisë së Hekurit rezultojnë dhjetëra herë më të larta se sfondi gjeokimik natyror, duke përbërë një burim të rëndësishëm ndotjeje[282]. Ndotja me metale të rënda e shkaktuar nga ky kombinat shtrihet deri në 30km nga burimi i ndotjes, duke përfshirë edhe zonën urbane dhe tokat bujqësore.

Shkarkimet e ngurta industriale:[283]Duke patur një ndër zonat më të industrializuara të vendit, Bashkia e Elbasanit është ndeshur edhe me problemin e depozitimit të mbetjeve të ngurta industriale gjatë kohës që industria e ferro-kromit, kombinatit metalurgjik, dhe fabrika e çimentos kanë ushtruar aktivitetin e tyre në Bashki. Si pasojë e aktivitetit të tyre ndër vite, sot në Bashki ndodhen disa vend-grumbullime të mbetjeve industriale të cilat janë renditur më poshtë[284]:

- Zona buzë lumit Shkumbin: Shtrihet përgjatë brigjeve të lumit përpara zonës industriale dhe ka një sipërfaqe rreth 1.5 ha. Sipas SHGJSH-së, në këtë zonë janë depozituar mbetjet e ngurta (skorje furrnalte, skorje çeliku të zeza e të bardha, mbeturina veshjesh zjarrduruese, mbeturina çeliku e gize, okaline etj) të furrnaltës së Uzinës së Çelikut dhe Uzinës Mekanike. Sasia e depozituar arrin derin në 1.5-2 milion tonë. Mbetjet përmbajnë metale të rënda, që përbëjnë shqetësim për ndotjen e ujërave të shkumbinit dhe zonës përreth.
- Dampa e TEC-it: Në dampë janë depozituar rreth 200-300 mijë ton hi edhe ky me përmbajtje lëndësh të dëmshme ndryshme.
- Dampa e mbeturinave të Uzinës 12 në zonën e Paprit, ku janë të depozituara sasira të mëdha koncentrati hekuri, që vlerësohet se janë rreth 500 mijë ton.
- Zona e depozitimit të skorjeve të ferrokromit: Sasia e përafërt e skorjeve të depozituara është rreth 500 mijë ton.
- Dampa e shllameve të Fe-Ni:Kjo dampë ndodhet në anën jugore të zonës industriale dhe ishte projektuar për të depozituar mbetjet teknologjike dhe skorie të kombinatit metalurgjik. Dampa është një gropë gjigante e aftë të depozitojë miliona tonë mbeturina për rreth 50 vjet.

Ndikimi i ndotjes me metale të rënda nga burimi ndotës (zona industriale) shtrihet deri në zonën urbane të qytetit të Elbasanit duke rezultuar në rritjetë përmbajtjeve të këtyre elementëve në toka. Kjo veprimtari industriale ka ndikuar edhe në ndotjen e tokave bujqësore me shtrirje deri në 30 km nga burimi ndotës[285].

Shkarkimet e lëngshme industriale: Gjatë gjithë kohës së funksionimit të zonës industriale, SHGJSH-ja raporton se të gjitha ndotjet e lëngshme janë shkarkuar dhe shkarkohen në lumin Shkumbin. Krahas aktiviteteve madhore industriale, në territorin e Bashkisë Elbasan janë identifikuar disa aktivitete më të kufizuara, të cilat ndotjen dhe mbetjen e gjeneruar e shkarkojnë në ujrat e lumit Shkumbin apo përrenjve më të afërt. Ndër to mund të përmëndim mbetjet nga furra e gëlqereve, mbetjet nga aktiviteti i përpunimit të inerteve, mbetje urbane dhe inerte të depozituara në brigje dhe shtratin e trupit ujor.

- Zona/aktivitete potenciale me ndotje të pavlerësuar:

Në këtë seksion, krahas zonave të nxehta mjedisore, të cilat janë të identifikuara dhe ndotja e tyre është adresuar dhe monitoruar, po pasqyrojmë edhe disa zona të cilat nevojitet të monitorohen me qëllim identifikimin e ndotjes së tyre në mjedis.

Venddepozitimi i vjetër i mbetjeve: Së pari duhet të identifikohet sasia e shllameve të depozituara në shtresat nëntokësore të vend-depozitimit të vjetër i cili është në proces transferimi të mbetjeve drejt dampës, ku është ndërtuar vend-depozitimi i ri i mbetjeve dhe ku do të ndërtohet inçeneratori (impianti djegës për mbetjet). Njëkohësisht nevojitet edhe vlerësimi i sasisë së gazeve metan CH_4 i grumbulluar ndër vite, në formë jastikësh, në nënshtresat e këtij vend-depozitimi dhe gazi i formuar nga procesi i kompostimit të mbetjeve urbane të Bashkisë Elbasan.

Në të njëjtën zonë ushtron aktivitetin e saj edhe një subjekt, i cili përpunon material inert në funksion të nevojave ndërtuese brenda territorit të Bashkisë e jo vetëm. Afërsia me shtratin e Shkumbinit dhe pozicionimi i tij mbi Akuiferin e Elbasanit përbën një problem me shkarkimet dhe infiltrimet e ujrave të përdorur në proceset teknologjike të këtij aktiviteti.

Në veri të vend-depozitimit dhe të subjektit të lartpërmëndur ndodhen varrezat kryesore të Bashkisë Elbasan, të cilat kanë marrë shtrirje për zgjerim në drejtim të veriut. Disa masa inxhinierike, në kuadër të disiplinimit të zgjerimit të mëtejehëm dhe kullimit të ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore të kësaj zone, duhen parashikuar për të gjithë hapsirën prej 20ha, përfshi këtu vend-depozitimin dhe subjektin privat të inertit.

Venddepozitimi i ri i mbetjeve: Përveç vend-depozitimit të vjetër, në Elbasan është ndërtuar vend-depozitimi i ri i mbetjeve në Papër, i cili ndodhet rreth 5km larg nga qendra e qytetit dhe vetëm 20m nga shtrati i Lumit Shkumbin. Ky vend-depozitim do të vihet në funksion plotësisht nëvitin 2017, duke plotësuar kushtet teknike dhe higjieno-sanitare të nevojshme, për të marrë zyrtarisht statusin e një vend-depozitimi rajonal.

Megjithëse në relacion sqarohet se ndikimi mjedisor në Akuiferin Quaternar të Elbasanit nuk do të ndodhë, dhe se ujrat sipërfaqësore janë të mbrojtura nga infrastruktura e brendshme e këtij instalimi, cilësojmë se masat infrastrukturore nuk janë masa mjedisore të mirëfillta dhe se nuk janë subjekt përdorimi si referencë në masat e marra për mbrojtjen e mjedisit. Për këtë arsye, nevojitet të adresohet në mënyrë të detajuar i gjithë procesi i trajtimit të shllameve, që prodhohen në këtë vend-depozitim rajonal (si është planifikuar të realizohet trajtimi i tyre dhe në cilat nivele do të vendoset shkarkimi i tyre në trupin ujor të Shkumbinit). Deri më sot, në këtë vend-depozitim janë prodhuar sasi të konsiderueshme shllami, të cilat janë depozituar në vaskën e ndërtuar enkas. Megjithatë, nga vizitat në terren rezulton se gjysma e vaskës është mbushur (Vaska është e hapur dhe lejon vëzhgimet pamore). Në rast se brenda një kohe të shkurtër, Bashkia nuk merr masa për trajtimin e shllamit ose gjetjen e zgjidhjes përfundimtare të depozitimit të tij në përputhje me standardet mjedisore, me kalimin e kohës, vaska mund të shndërrohet në një ndër burimet kryesore ndotëse të ujërave të Lumit Shkumbin e, si rrjedhojë, edhe e ujërave të Aquiferit Kuaternar të Elbasanit, i cili ushqehet nga Shkumbini.

Për këtë arsye, rekomandohet që Bashkia të marrë masa parandaluese që sigurojnë se elementët ndotës në përbërjen e shllamit të mos përfundojnë në ujrat sipërfaqësore të

Shkumbinit, dhe më tej në ujërat e Akuiferit Quaternar të Elbasanit, që përkon me rrjedhën e Shkumbinit në zonën Krastë-Papër.

Fabrika e pasurimit të Kromit: Është propozuar që përgjatë bregut të lumit Shkumbin, përkatësisht në Bashkinë Librazhd të nisë nga ndërtimi një fabrikë, e cila do të ketë si qëllim përpunimin dhe pasurimin e kromit. Kjo iniciativë, sado në favor të zhvillimit ekonomik apo ndikimit pozitiv në ekonominë lokale, duhet të nënvizohet se nuk është një ndërhyrje miqësore me mjedisin.

ARM-ja Elbasan thekson se ky aktivitet bart një potencial dhe një rrezikmjaft të lartë për ndotjen me metale të rënda, specifikisht mbetje të Cr, si edhe elementë të tjerë, të cilët derivojnë nga procesi i larjes, pastrimit, përpunimit dhe pasurimit të kromit. Pozicionimi i kësaj industrie në afërsi të akuiferit të lumit Shkumbin, si edhe marrja në konsideratë e rrezikut ndaj aksidenteve industriale, do të shkaktonte një ndotje të parikuperueshme mbi ujrat e lumit Shkumbin, të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë do të ndikojnë edhe në ujrat nëntokësore si pasojë e infiltrimeve në dritaret hidrogjeologjike përgjatë Shkumbinit e më specifikisht në Krastë, ku edhe ndodhen puset e ujit të pijshëm për Bashkinë Elbasan.

Vlerësohen si të arsyeshme hapat si reflektimi dhe marrja në konsideratë për zhvendosjen e këtij propozimi në një zonë më të sigurtë në aspektin mjedisor.

1.5.3 Konkluzione mbi sfidat dhe problematikat sociale

Demografia

- Sipas të dhënave të INSTAT, Bashkia e Elbasanit në 1 janar 2015 regjistroi një numër popullsie rezidente prej 144,382 banorë, prej të cilëve 72,987 meshkuj dhe 71,395 femra.
- Sipas shpërndarjes urban/rurale rreth 56% e popullatës së bashkisë klasifikohet si popullsi urbane dhe diferenca prej 46% si popullsi rurale.
- Sipas strukturës moshore rreth 69% e popullatës i përket grupmoshës (15-64) vjeç dhe 20% grupmoshës 19 vjeç. Këta tregues demonstrojnë se popullata e bashkisë ka potenciale të larta të popullsisë ekonomikisht aktive, përfshirja e të cilëve në tregun e punës do të ndikojë ndjeshëm në rritjen e performancës ekonomike dhe mirëqenien e popullatës. Struktura aktuale demografike e popullsisë rezidente si dhe mosha mesatare e saj relativisht e re tregojnë se popullsia e zonës është akoma e re.
- Por nëse iu referohemi të dhënave të gjendjes civile, vëmë re që popullsia e Bashkisë Elbasan ka pësuar rritje në të gjitha njësitë administrative. Sipas bashkisë, ky fakt mbështetet edhe nga rritja e numrit të votuesve nga viti në vit. Në ndarjen e popullsisë sipas gjinisë, raporti meshkuj femra qëndron në raporte thuajse të barabarta. Pjesa më e madhe e popullsisë është përqendruar në qytetin e Elbasanit dhe në njësitë me terren të butë dhe që kanë akses të mirë. Zonat malore kanë numër më të vogël banorësh.
- Gjithsesi, procesi i vazhdueshëm i emigrimit, ritmet e larta të migrimit të brendshëm si dhe rënia e lindshmërisë dhe vdekshmërisë kanë ndikuar jo vetëm në rënien e numrit të popullsisë por edhe në ndryshimin drastik të strukturës së saj demografike.

- Një faktor shumë i rëndësishëm në përcaktimin e stokut të popullatës së qarqeve është edhe migrimi i brendshëm i popullsisë, pra lëvizjet e popullatës nga një qark në tjetrin.
- Sipas parashikimeve të popullsisë, skenari i rritjes së mesme, popullsia e qarkut/bashkisë do të pësojë rënie, me një ritëm mesatar vjetor rreth 1% dhe si faktor kryesor mendohet të jetë migracioni i brendshëm.
- Popullsia rezidente e Bashkisë Elbasan deri në vitin 2021 do të ketë një tregues të varësisë totale të ulët, duke ruajtur të ashtuquajturin "divident demografik".Për të përfituar nga ky "divident demografik", kërkohen politika të bashkërenduara në nivel qendror e vendor për të mundësuar, arsimimin, trajnimin dhe përfshirjen në tregun e punës të kësaj kategorie të popullatës me qëllim rritjen dhe përmirësimin në vazhdimësi të mirëqenies së saj.

Arsimi

- Të ndërtohet të paktën një shkollë e mesme në çdo njësi administrative të bashkisë Elbasan që nuk e ka një të tillë, si: Bradshesh, Gracen, Gjergjan, Shushicë dhe Tregan.
- Të shqyrtohet mundësia e ndërtimit të 1 shkolle të mesme shumëfunksionale profesionale (me profile të ndryshme) në qytetin e Elbasanit, pasi shkollat e mesme ekzistuese nuk e mbulojnë plotësisht qytetin me shërbimin.
- Bashkia e Elbasanit ka një mbulim të varfër me kopshte dhe rrezja e shërbimit të kopshteve ekzistuese lë pjesë të mëdha të territorit të pambuluara si në qytetin e Elbasanit, ashtu dhe në njësitë e tjera të bashkisë. Duke marrë në konsideratë dhe raportin e vogël të edukatorëve për fëmijë, këshillohet që bashkia e Elbasanit të ndërmarri një studim më të thelluar të numrit ekzistues të fëmijëve të grupmoshës 3-5 vjeç, shpërndarjes së tyrë në gjithë territorin e bashkisë, si dhe nivelit të aksesit në kopshte.
- Të bëhet një inventarizim i hollësishëm i mjeteve didaktike ekzsistuese në kopshte dhe shkolla dhe të kryhet pajisja e tyrë sipas nevojave.
- Të përmirësohet infrastruktura fizike e institucioneve arsimore veçanërisht të kryhet rikonstruksion i plotë në shkollën 9-vjeçare të varur Bodin, në njësinë administrative Gracen; në një kopësht dhe 2 shkolla 9-vjeçare Bradashesh; në 3 shkolla 9- vjeçare në Funarë (si në shkollën Preç e poshtëme, Cerujë, Krrabë e Vogël); 2 kopshte dhe 1 shkollë fillore në Zavalinë, përkatësisht në Burrishtë dhe Kamican; 3 shkolla 9-vjeçare në Tregan (përkasisht në Kaqivel, Kaqivel i poshtëm dhe Shinavlash); 3 shkolla 9-vjeçare në Gjergjan (Gjergjan, Kodra Bujaras, Bujaras), etj. Në çdo njësi administrative të Elbasanit ka nevojë për rinkonstruksion të pjesshëm për një sërë shkollash dhe kopshtesh.

Punësimi

- Shkalla e papunësisë në bashkinë e re të Elbasanit është relativisht e lartë dhe për të përballuar kërkesat e larta për punësim, bashkia duhet të ndërmarrë politika për zhvillimin e përgjithshëm dhe me rritme të shpejta ekonomike.

- Në kushtet e territorit të ri, me disa qendërsi urbane dhe karakter të theksuar bujqësor dhe malor, rishikimi i prioriteteve të zhvillimit ekonomik lokal është një hap urgjent për t`u ndërmarrë për bashkinë e Elbasanit. Bashkia duhet të luajë një rol aktiv në mbështetje të zhvillimit rural, krahas atij urban.
- Me dobësimin e sektorëve ekonomik si industria apo ndërtimi në vitet e fundit, shumica e të punësuarëve në qytetin e Elbasanit është përqendruar në sektorin e shërbimeve. Për këtë arsye, bashkia duhet të nxisë rritjen e shpejtë të bizneseve private, duke ndjekur politika fiskale stimuluese; vënë në dispozicion të qytetarëve burime potenciale, si trashegimia historike prsh. për zhvillimin e bizneseve të reja private në këtë fushë; rritur investimevet publike nëpërmjet mekanizmave të ndryshme si përdorimi i fondeve publike, kredive, granteve apo projekte me donator të ndryshëm, etj.
- Në kushtet ku norma e papunësisë është shumë e lartë për të rinjtë e moshës 15-24 vjeç dhe me decentralizimin e procesit të menaxhimit të sektorit të arsimit parauniversitar dhe kalimin e tij si kompetencë e bashkisë së re, Bashkia Elbasan duhet me prioritet të drejtojë forcën ekonomike aktive drejt arsimit dhe formimit profesional, në shërbim të tregut lokal të punës. Prioritet duhet ti jepet kurseve dhe trajnime afatshkurtra të të rinjëve dhe forcimi i partneritetit publik-privatë në të gjitha sektorët ekonomik.

Shëndetësia

- Përgjithësisht, ambulancat dhe qendrat shëndëtësore shfaqin një infrastrukturë fizike të dobët. Nevojitet ndërhyrja e mënjëherëshme për rikonstruksionin e 4 ambaluancave jo-funksionale, 2 në Bradashesh dhe 2 në Papër. Për më tepër, nevojitet ndërhyje dhe rikonstruksion i pjesshëm në njësinë administrative Gjinar (qendra shëndetësore ka patur rikonstruksion të pjesshëm); Tregan (2 ambulanca janë në gjëndje të amortizuar fizike); në Gjergjan; Shushicë (qendra shëndetësore në Qafë është komplet e amortizuar); Zavalinë, etj.
- Kategori si gratë dhe vajzat, të rinj me probleme sociale dhe persona me aftësi të kufizuar nuk asistohen nga institucione të posaçme të shërbimit social. Megjithatë, në bashkinë Elbasan operojnë rreth 328 kujdestarë të shërbimeve sociale. Me gjithë dinamikën e zhvillimeve socio-ekonomike, këshillohet ndërtimi/forcimi i kapaciteteve të institucioneve ekzistuese për ofrimin e shërbimit përkatës social dhe ndërtimi i institucioneve të posaçme për ofrimin e këtyre shërbimeve.
- Për përmirësimin e aksesit të qytetarëve në shërbimin shëndetësor është e domosdoshmë rritja e numrit të ambulancave në mënyrë që të arrihet një tregues mesatar të paktën një ambulancë për rreth 6 mijë banorë, duke marrë në konsideratë edhe dëndësinë e banimeve.
- Për të përmirësuar raportin mjek/ banorë është prioritare rritja e numrit të mjekëve në shërbimin shëndetsor parësor, që i shërbejnë drejtpërdrejtë banorëve të bashkisë së Elbasanit.

Mirëqënia ekonomike

- Duke marrë parasysh pabarazitë mes zonës urbane dhe asaj rurale të bashkisë, është i domosdoshëm zhvillim i njëtrajtshëm ekonomik me rritme të larta rritje për të

gjithë bashkinë, por duke konsideruar karakteristikat e veçanta fizike, sociale dhe ekonomike për secilën njësi specifike.

- Rritja e punësimit dhe e trajnimi profesional i forcës punëtore shihen si masa prioritare për rritjen e mirqënies ekonomike.
- Bashkëpunimi me donatorë ndërkombëtarë dhe me specifikisht ngritja e kapaciteteve bashkiake për të aplikuar për fonde, grante dhe programe, sidomos nga programet e Bashkimit Europian për zhvillimin rural dhe rajonet më pak të zhvilluara shihet si prioritet.

1.4.4 Konkluzione

Analiza e metabolizmit të territorit

- Sasia e energjisë së konsumuar për ngrohje në Qarkun Elbasan është e lartë, ku 77% e NjFE-ve, përdorin drutë e zjarrit për t'u ngrohur, 13 % përdorin gazin dhe 7% përdorin energjinë elektrike. Nëse përdoren të gjitha burimet alternative të energjisë, do të kemi një konsum më të ulët të energjisë që përftohet nga drutë e zjarrit apo energjia elektrike. Elbasani ndodhet ndërmjet izolinave 1,450-1,550 kW/m², energji potenciale për t'u përdorur për ngrohjet e banesave. Elbasani shtrihet në zonën gjeotermale Kruja dhe ka potencial për përdorimin e energjisë gjeotermale nëpërmjet burimeve gjeotermale të Kozani-8 dhe Llixhave të Treganit. Fuqia që mund të instalohet në pusin Kozani-8 është e konsiderueshme, 2,070kË. Energjia e eksportuar në nivel kombëtar përbën vetëm 8,6% të energjisë së importuar. Ky është një tregues që përveç humbjeve në rrjet, burimet alternative të energjisë nuk shfrytëzohen.
- Sistemi i furnizimit me ujë mbulon 100% të popullsisë në qytetin e Elbasanit, por ky shërbim nuk shtrihet në të gjithë territorin e bashkisë. Sistemi i furnizimit me ujë është pjesërisht konvencional (kryesisht në zonën urbane dhe një pjesë në zonat rurale). Ky sistem duhet të shtrihet në zonat ku mbulimi me ujë është problematik (ofrohet shërbimi pjesërisht ose nuk ofrohet fare), ndërsa një pjesë (në rastet kur është e mundur) mund të përdoren puset. Kërkesa aktuale për ujë në Bashkinë Elbasan është 1,699 m³/orë, ndërkohë që sasia e ujit të prodhuar është 2,875 m³/orë, pra gati dyfishi i kërkesës. Ky është një tregues i kapaciteteve të larta prodhuese të ujit të pijshëm. Një menaxhim më i mirë i ofrimit të shërbimit do të sigurojë ujë të pijshëm në të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan. Zona ujëmbajtëse shtrihet përgjatë qytetit të Elbasanit, ku ndodhin aktivitetet më të mëdha industriale, ekonomike dhe sociale. Kjo rrit mundësinë e ndotjes së ujërave nëntokësore dhe ndotjes së tokës.
- Fluksi i ushqimit tregon që në territorin e Elbasanit produktet bujqësore që kanë prodhime të larta janë drithërat perimet, foragjerët dhe drufrutorët. Sipas Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, kulturat më të përshtatshme bujqësore janë: drithërat, perimet e serave, fasulet, duhani, foragjerët, drufrutorët (vreshta, ullinj, pjeshkë). Prodhimin më të lartë nga produktet blegtorale e ka qumështi.

Burimet ujore sipërfaqësore

- Elbasani është i pasur me burime ujore. Shkumbini është burimi kryesor ujor i cili përshkon territorin e bashkisë nga lindja në perëndim. Ndërsa nga njëra anë Elbasani ka këto burime natyrore që ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e vendit, nga ana tjetër, shumë nga këto burime kanë nevojë për mbrojtje, mirëmbajtje dhe investim. Siç edhe u theksua më sipër, monitorimi i ujërave të Shkumbinit të cilët janë të rëndësishëm për zhvillimin e bashkisë, nxorri në pah problematikat e këtij lumi, të cilat vijnë si pasojë e mungesës së politikave për mbrojtjen e burimeve natyrore dhe lumit nga aktivitetet njerëzore. Rezultatet e monitorimit treguan se ujërat e Shkumbinit janë të ndotura thellë me metale të rënda. Meqenëse ujërat e këtyre lumenjve përdoren edhe në bujqësi, është e nevojshme që ujërat e lumenjve të monitorohen më tej për të përcaktuar nëse janë të përshtatshëm për ujitje. Përdorimi i ujërave për bujqësi rrezikon shëndetin e njeriut nëpërmjet konsumit të fruta-perimeve të ndotura me ujin e lumit gjatë kultivimit. Në qoftë se nuk merren masa për uljen e ndotjes së ujërave të Shkumbinit, nga burim uji për bujqësinë, ky lumë mund të kthehet në një faktor rreziku për cilësinë e produkteve bujqësore dhe shëndetin e njeriut. *Si rrjedhojë, është e nevojshme që Bashkia dhe organet kompetente të manaxhimit të ujërave në nivel rajonal të ndërmarrin nisma për projekte që synojnë uljen e ndotjes në lumë; si projekte për parandalimin e derdhjes së ujërave të zeza në lumë, të mbetjeve industriale, të parandalimit të ndotjes së ujërave nga inputet bujqësore nëpërmjet përdorimit efiçent të tyre etj. Përveç ndotjes, është e rëndësishme që Bashkia të planifikojë projekte me përparësi për rehabilitimin e lumenjve, së bashku me projekte bashkëpunimi me bashkitë e tjera (dhe organet e nivelit qëndror) që preken nga Shkumbini, për manaxhimin e integruar të këtij lumi.*

Burimet ujore nëntokësore

- Bashkia e Elbasanit është e pasur me burime ujore sipërfaqësore e nëntokësore të cilat kanë problematikat e tyre. Rezultatet e analizave dhe studimeve të mëparshme tregojnë se ujërat e Shkumbinit nuk janë në nivelin e duhur mjedisor për përdorim në bujqësi dhe argëtim, sidomos pas kalimit të lumit në Librazhd e më tej. Kjo mund të ndikojë negativisht në përdorimin e këtij aseti të rëndësishëm për zhvillimin e bujqësisë dhe turizmit në Elbasan. Një tjetër faktor që vlen të studiohet për Shkumbinin (nga pikëpamja mjedisore dhe e zhvillimit të turizmit) është mundësia e ndërprerjes së rrjedhës së tij nga barrierat fizike, përkatësisht hidrocentralet (HEC-et) në degëzimet e tij. HEC-et që ndërpresin Shkumbinin, në prodhim, në ndërtim, ose të projektuara, ndodhen jashtë dhe brenda kufijve të bashkisë. Këto HEC-e kanë kapacitete të ndryshme nga më pak se 1MË deri mbi 50MË. Shumë prej HEC-eve të vogla janë planifikuar në degët kryesore të Shkumbinit që depërtojnë deri në burimet e tij në Shebenik-Jabllanicë (zonë e

mbrojtur) dhe në Valamarë. HEC-et mund të ndikojnë në shtimin e erozionit detar, për shkak të uljes së sasisë së sedimentit të transportuar (HEC si barrierë fizike) në grykëderdhje, zvogëlimin e inerteve të trasportuara në det, si dhe në pengimin e lëvizjes së peshqve dhe të emigrimit të faunës në rrjedhën e lumit mbas barrierës. Për më tepër, ato ndikojnë në tjetërsimin e ekosistemit (jo vetëm lumor) të zonës në të cilën ndërtohen.

- Nga pellgjet ujore nëntokësore, Akuiferi Kuaternar i Elbasanit paraqet rëndësi të veçantë për shkak se shërben si burim furnizimi me ujë për Bashkinë Elbasan dhe Bashkitë e tjera përreth. Megjithatë, duke qenë se në disa segmente në jug të qytetit Elbasan ka lidhje të drejtpërdrejta me ujërat e Shkumbinit, mbetet i ndjeshëm ndaj ndotjes.
- *Duke parë keqmanaxhimin e burimeve ujore në 20 vitet e fundit, dhe rrezikshmërinë që paraqet ndotja e burimeve ujore nëntokësore për shëndetin e popullsisë, rivlerësimi i ndërtimit të HEC-eve, dhënies së lejeve për karriera lumore, përfshirë edhe projekte për shmangien e ndotjes nga lumi (p.sh. derdhjen e ujërave të zeza dhe mbetjeve ndustriale) dhe nga burimet ujore nëntokësore apo rehabilitimin e tyre, duhet të kenë përparësi për Bashkinë. Në këto projekte, Elbasani duhet të krijojë nisma bashkëpunimi me Bashkitë e tjera që preken nga Baseni i Shkumbinit me qëllim manaxhimin e integruar të basenit të Shkumbinit dhe zonave përreth.*

Ajri

- Ndotja e ajrit në Bashkinë Elbasan shkaktohet kryesisht nga mjetet e transportit, cilësia jo e mirë e naftës, dhe aktivitete të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, si industria dhe ndërtimet. Për më tepër, ndotja theksohet edhe për shkak të mungesës së sipërfaqeve të gjelbra urbane sipas standardeve. Fatkeqësisht, në Bashki cilësia e ajrit nuk monitorohet rregullisht për shkak të mungesës së monitorimeve të vazhdueshme në kohë me pajisje fikse.
- Ndotja e ajrit në Bashkinë Elbasan ndihet kryesisht në zonat më të populluara urbane (në zonat qendrore të qytetit). Me qëllim shmangien e rrezikut që i kanoset banorëve nga ndotja e ajrit rekomandohet marrja e masave për uljen e ndotjes në ajër, veçanarisht në zonat urbane. Disa nga këto masa mund të jenë planifikimi i zhvillimit të territorit dhe sektorit të transportit, duke e bazuar lëvizjen e qytetarëve të Bashkisë në transport publik alternativ dhe këmbësor, hartimin e politikave që synojnë uljen e qarkullimit të numrit të makinave në zonat urbane, shtimin e hapësirave të gjelbëra, bashkëpunim me Inspektoriatin e Mjedisit për monitorimin e rregullt dhe rigoroz të shkarkimeve në ajër të aktiviteteve industriale të pajisura me leje mjedisore, si dhe kufizimin e ndërtimeve në qytet jashtë standardeve për mbrojtjen e cilësisë së ajrit. Njëkohësisht, rekomandohet bashkëpunim me ARM/AKM-në dhe Institutin e Shëndetit Publik për krijimin e stacioneve të

përhershme të monitorimit të cilësisë së ajrit në qytetin e Elbasanit gjatë gjithë vitit me qëllim krijimin e një pasqyre të qartë të cilësisë së ajrit dhe përcaktimin e zonave që kanënevojë për plane të cilësisë së ajrit

Pyjet dhe kullotat

- Mirëadministrimi i Pyjeve dhe Kullotave nga Bashkia Elbasan, sigurimi në realizimin e reformës së decentralizimit të kompetencave në administrimin e pyjeve dhe kullotave publike dhe dixhitalizimi i hartave të fondit pyjor nën administrim mbeten pikënisjet drejt suksesit për përmirësimin e gjendjes aktuale tw Pyjeve. Njësitë Administrative, nëpërmjet planeve të manaxhimit të pyjeve dhe kullotave mund t'i ofrojnë banorëve të tyre mundësi punësimi në periudha kur ka aktivitete të punimeve pyjore. NjA-të, nëpërmjet mbjelljes dhe rimbjelljes së drunjëve të lartë mund të përfitojnë më shumë të ardhura, mbështetje financiare në realizimin e projekteve, si dhe të ardhura të vazhdueshme e të sigurta nga shitja e kapaciteteve të lira të karbonit.

- Për ruajtjen dhe mbarështimin e fondit pyjor e kullosor në territorin e Bashkisë së Elbasanit rekomandohet të merren një sërrë masash, disa prej tw cilave mund të jenë:

  -Studim i hollësishëm për *përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë fenomenin e tharjes të llojit rrap, dushk dhe plep* në seksione të ndryshme të lumit Shkumbim dhe degëve të tij. Ruajtja e tyre paraqet një rëndësi të veçantë për ruajtjen e trupit lumor nga fenomene si erozioni dhe për mirëmbajtjen e këtyre bimëve pyjore me qëllim rritjen e minimizimin e dëmtimeve të tyre,
  -Hartimi i një *Plani Veprimi për rehabilitimitimin e sipërfaqeve të djegura* që nuk kanë mundësi të ripërtëriten në mënyrë natyrale (për shembull. sipërfaqet me pisha në afërsi të fshatit Polis i Vogël) por dhe mbjelljen e tyre me pemë të cilat kanë qënë autoktone,
  -Marrja e *masave paraprake për parandalimin e fenomeneve të zjarrit*, si: ndërgjegjësimin e komunitetit, ndërtimin e brezave mbrojtës, vënien para përgjegjësisë të të gjithë kundërvajtësve që shkaktojnë zjarret, shtrirjen e një sistemi lajmërimi zjarri (rol të rëndësishëm luajnë barinjt e zonës nw kwtw rast, etj.)
  -*Mbajtja nën kontroll e sëmundjeve dhe e dëmtuesve*, ku shkalla e prekjes është më e madhe se kufijtë kritikë të lejueshëm. Rëndësi të veçantë duhet t'i kushtohet zonave me shtrirje të mëdha bimësie dhe ruajtjes së bimëve shmëvjeçare.

Peizazhi

- Territori i Bashkisë së Elbasanit rezulton të ketë një larmishmëri peizazhistike, natyrore, ubrane, rurale, ujore, etj., duke u përkthyer kjo në një potencial të pashfrytëzuar për zhvillimin e turizmit dhe guidave turistike. Larmishmëria e peizazhit është kushtëzuar nga territori dhe përdorimi i tokës. Kryesisht, veri-perëndimore - veri-lindore mbizotëron peizazhi natyror, ndërsa në pjesën përgjat

Luginës së Lumit Shkumbin mbizotëron peizazh me tipologji rurale e bujqësore. Qyteti i Elbasanit është zona kryesore që formon tipologjinë urbane dhe industriale të peizazhit.

- Në territorin e Bashkisë mbetet problematik fragmentimi i peizazhit natyrorë, i cili është dëmtuar nga zhvillimi urban, industrial e kryesisht ai bujqësor. Zonat e ndotura, kryesisht nga aktiviteti industrial dhe nga mbetjet urbane ndikojnë në përkeqësimin e peizhazhit dhe natyrës në përgjithësi. Ndërthurja e tipologjive të ndryshme të peizazhit në territor haset me vështirësi të mëdha, pasi gjatë zhvillimeve të ndryshme në territor nuk janë marrë parasysh elementët peizazhistikë dhe rëndësia e tyre. Kjo vazhdon të jetë një pengesë për përmirësimin e peizhazhit.
- Me qëllim përmirësimin e peizhazhit dhe ndërthurjen e tipologjive të tij, duke përmirësuar aspektin pamor dhe ruajtur funksionalitetin, nevojitet të merren masa të cilat lidhen me: i) futjen e përbërësve natyrorë në brëndësi të zonave urbane dhe industriale, ii) mbjedhjen e pemëve të larta për të fshehur objektet industriale të padëshirueshme nga pikpamja vizuale/pamore, iii) ruajtjen dhe mbrojtjen e të gjithave tipologjive të peizhazhit në territorin e Bashkisë, iv) krijimin e zonave ripariane dhe korridoreve përgjatë tokave bujqësore dhe v) gjatë hartimit dhe zbatimit të planeve sektoriale, rekomandohet futja e elementit peizazhistik.

Zonat e mbrojtura

- Bashkia Elbasan është e pasur me rezervate natyrore dhe monumente natyre të shumëllojshme, të cilat përbëjnë një pasuri të konsiderueshme për zhvillimin e turizmit në Bashki. Për më tepër, në Bashki gjenden edhe llixhat e Treganit të cilat, nëse ruhen dhe mirëmbahen, mund të shndërrohen në motorrin kryesor të zhvillimit ekonomik të zonave përreth. Megjithatë, këto zona kanë pësuar dëmtime të ndryshme në vitet e shkuara, si prerje abuzive të pyjeve në territorin e tyre, zjarre, ndërtime të ndryshme, zhvillimtë aktivitetit të guroreve, mbikullotja dhe fenomene të tjera natyrore si erozioni dhe shembjet e ndryshme të dherave.
- Duke patur parasysh që zonat e mbrojtura janë të rëndësishme, jo vetëm sepse shërbejnë si habitate të një biodiversiteti të larmishëm, por edhe sepse mund të favorizojnë zhvillimin e ekonomisë në Bashki nëpërmjet turizmit, rekomandohet që organet kompetente në Bashki të tregojnë një kujdes të veçantë,përpara se ato të humbin vlerat biologjike dhe peizazhistikeqë mbartin.Më konkretisht, rekomandohet bashkëpunimi i Bashkisë Elbasan me AdZM-në Elbasan për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të planeve të manaxhimit për çdo zonë të mbrojtur dhe monument natyre, hartimin e planit të emergjencave për zjarre dhe rreziqe të tjera si dhe bashkëpunimin me universitetet të ndryshme me qëllim promovimin e vlerave

shkencore, biologjike, faunistike dhe floristike të zonave të mbrojtura dhe zhvillimin e eko-turizmit dhe aktiviteteve të tjera, që mundësojnë mbledhjen e të ardhurave financiare për manaxhimin e tyre.

Biodiversiteti

- Zona e Elbasanit ka pasuri të shumta natyrore, ku përfshihen lumenjtë, liqenet, zona e mesme dhe të larta malore, kodrat e ullinjve që rrethojnë qytetin, shkurret mesdhetare, pyjet gjethegjerë, halorët dhe përzierjet me kullota. Në të gjithë territorin e sotëm të Bashkisë së re (pas reformës territoriale), ndodhen shumë zona të mbrojtura të kategorive të ndryshme si rezervate natyrore të manaxhuara, monumente kulture, monumente të natyrës, të cilat paraqesin një pasuri natyrore me potencial të lartë për zhvillimin e turzimit malor dhe atij kulturor.
- Për fat të keq, gjatë dy dekadave të fundit, bimësia dhe bota shtazore janë dëmtuar si rezultat i ndërhyrjeve të njeriut (mosmanaxhimit të zonave natyrore, dëmtimit dhe fragmentimit të habitateve, gjuetisë dhe mbledhjes së bimëve mjekësore pa kriter etj.,) dhe faktorëve natyrorë (mungesës së masave specifike për mbrojtjen e biodiversitetit dhe mungesa e manaxhimit të zonave natyroreetj.,). Si rrjedhojë, shumë shpezë e kafshë të egra po shkojnë drejt zhdukjes.
- Me qëllim ruajtjen e biodiversitetit në këtë zonë, është e rëndësishme që të merren masa urgjente për mbrojtjen e biodiversitetit në përgjithësi, dhe të kafshëve që rrezikojnë të zhduken në veçanti. Për këtë arsye, *rekomandohet që Bashkia i) të bashkëpunojë me Ministrinë e Mjedisit dhe të Bujqësisë për ruajtjen e biodiversitetit dhe për përdorimin e qëndrueshëm të përbërësve të tij, në nivel vendor, duke zbatuar Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Biodiversitetin, ii) për hartimin e planeve të veprimit për ruajtjen e llojeve veçanërisht të mbrojtura, të regjistruara me status ruajtjeje të pafavorshëm, iii) për hartimin e planeve dhe procedurave të veprimit për manaxhimin e rasteve të papritura nga veprimtaritë njerëzore. Gjithashtu, është e rëndësishme që Bashkia të hartojë një plan menaxhimi për mbojtjen e zonave natyrore brenda territorit të saj.*

Toka bujqësore

- Bashkia e Elbasanit ka një larmi të gjerë tokash në territorin e saj (fushore, kodrinore dhe malore), të cilat përdoren për prodhimin e***drithërave*** (grurit, misrit), pemtarisë, perimeve, vreshtarisë (rrushit) dhe blegtorisë (rritja e bagetive të imta e të trasha si lopët, derri dhe dhentë). Bashkia dallohet edhe për pemtari dhe ***ullishtat,*** të cilat janë një traditë e trashëguar ndërshekuj. Kohët e fundit, Bashkia ka zhvilluar edhe ***turizmin malor*** dhe ka shtuar veprimtaritë e saj ekonomike lidhur me Llixhat në Bashkinë e Treganit. Megjithatë, Bashkia përballet edhe me nevojën e shmangies së **degradimit të tokës,** që në Elbasan është fenomen i zakonshëm për

shkak të tokave të buta dhe me pjerrësi të theksuar. Ky fenomen theksohet edhe më tej në rastet e punimit të tokave në pjerrësi nga banorët, duke shkaktuar erozion, shkarje dhe shembje të tokës. Për shkak të reshjeve dhe mungesës së manaxhimit të ujërave sipërfaqesore dhe nëntokësore, risku i shkarjeve të tokës mbetet i lartë[286]. Gjatë viteve të fundit, në Elbasan mbetet i lartë edhe rreziku i gërryerjes së tokës në brigjet e lumit Shkumbin, i cili shoqërohet edhe me depozitime të ngurta gjatë përmbytjeve[287]. Dëmtimet në brigjet e lumenjve janë rezultat i shfrytëzimit të materialeve inerte në shtretërit e lumenjve, dëmtimit të objekteve mbrojtëse dhe dëmtimit të bimësisë përgjatë shtratit të tyre. Niveli i humbjes së tokës në brigjet e lumenjve është i lartë, ndëkohë që mirëmbajtja e lumit është anashkaluar. Gjendja rëndohet sidomos në rastet kur ka reshje të shumta e të rrëmbyeshme[288]. Njëkohësisht, Bashkia haset me zvogëlimin e sipërfaqes së tokës bujqësore (përdorime konfliktuale të tokës) për shkak të kthimit të saj në truall ose tokë me përdorime të tjera. Në zona të caktuara, si zona përreth Ish-Kombinatit Metalurgjik dhe impiante të industrisë së rëndë që ka vepruar kryesisht në të shkuarën, nuk mungon edhe ndotja.

- Për të rritur prodhimin bujqësor në territorin e Bashkisë pa cënuar qëndrueshmërinë e tokave, lipset që Bashkia të ofrojë shërbimin e agronomisë nëpër fshatra bujqësore. Duke u ofruar informacionin e duhur bujqve, ky shërbim i ndihmon ata që të shtojnë prodhimin bujqësor nëpërmjet praktikave moderne bujqësore, edhe në toka kodrinore si ato të Elbasanit. Me qëllim shmangien e degradimit të mëtejshëm të tokës bujqësore dhe jo buqësore, nevojitet që Bashkia të promovojë zhvillimin rural brenda territorit dhe të garantojë zhvillimin e një bujqësie më të qëndrueshme nëpërmjet praktikave prodhuese të qëndrueshme që respektojnë mjedisin, siç është përcaktuar në Politikën e Përbashkët për Bujqësinë të BE-së[289].
- Njëkohësisht, rekomandohet që Bashkia të hartojë planin e zhvillimit territorial duke patur parasysh parimin e mbrojtjes së tokës bujqësore (shndërrimin e tokës bujqësore në truall vetëm në raste kur janë konsumuar të gjitha mundësitë e tjera). Me qëllim shmangien e rrezikut që mund t'u kanoset banorëve të Bashkisë nëpërmjet konsumit të produkteve ushqimore të kultivuara në toka të ndotura, rekomandohet që përreth dhe në brendësi të zonave të ndotura në territorin e Bashkisë, të kryhen studime që synojnë përcaktimin e nivelit dhe shtrirjes gjeografike të ndotjes dhe të merren masa të menjëhershme për rehabilitimin e tyre.

1.5 Analiza demografike dhe e mirëqenies social-ekonomike

1.5.1 Demografia

Sipas të dhënave të Bashkisë Elbasan, numri i popullsisë ka pësuar rritje nga viti në vit. Kjo rritje ka ndodhur thuajse në të gjitha njësitë administrative që bëjnë pjesë në territorin

e Bashkisë Elbasan, me përjashtim të NjA Gjinar, NjA Zavalin dhe NjA Funar, të cilat kanë pësuar ulje të numurit të popullsisë.

Tabela 33. Popullsia në Bashkinë Elbasan sipas të dhënave të gjendjeve civile, 2015

		Nr. popullsisë			
		2012	**2013**	**2014**	**2015**
1	**Elbasan**	125, 419	125, 790	126, 789	127, 420
2	**Bradashesh dhe Gracen**	15, 152	15, 383	15, 449	15, 540
3	**Labinot Fushë**	6, 479	6, 562	6, 643	6, 681
4	**Labinot Mal**	5, 670	5, 694	5, 694	5, 691
5	**Shushicë**	10, 856	10, 951	11, 069	11, 164
6	**Tregan**	4, 439	4, 447	4, 508	4, 555
7	**Gjinar dhe Zavalin**	6, 897	6, 880	6, 855	6, 858
8	**Gjergjan**	7, 736	7, 798	7, 851	7, 881
9	**Papër**	8, 990	9, 066	9, 170	9, 211
10	**Shirgjan**	10, 117	10, 127	10, 311	10, 408
11	**Funarë**	3, 105	3, 109	3, 096	3, 071
	Bashkia Elbasan	**204, 860**	**205, 807**	**207, 435**	**208, 480**

Burimi: Bashkia Elbasan, 2015

Bashkia Elbasan, është qendra me e rëndësishme nga demografike (ka përqëndrimin më të madh të popullsisë), administrative dhe ekonomike e qarkut me të njëjtin emër. Me ndarjen e re administrative, Bashkia Elbasan, përfshin nën juridiksionin e saj administrativ qytetin e Elbasanit dhe 12 njësi të tjera administrative (ish komuna), Labinot Mal, Funarë, Labinot Fushë, Bradashesh, Gracen, Shushicë, Papër, Shirgjan , Gjergjan, Gjinar, Tregan dhe Zavalin.


Nga këndvështrimi strukturor demografik në Bashkinë Elbasan banojnë rreth 48% e popullatës rezidente të Qarkut Elbasan, ndërkohë që pjesa tjetër e popullatës rreth 52% është e shpërndarë në bashkitë e tjera, Peqin, Belsh, Cërrik, Gramsh, Prrënjas, Librazhd, përkatësisht me 9%, 7%, 9%, 8%, 8%, dhe 11 % e popullatës gjithsej të qarkut. Popullata rezidente e Bashkisë Elbasan, si rrjedhoje e ndarjes së re administrative, është rritur me rreth 80% duke shënuar një numër popullsie rezidente stok në fillim të vitit 2015, prej 144,382 banorë[290].

Tabela 34. Populisia sipas ndarjes së re administrative, 2011-2015

Populisia, Qarku, NjA	Viti 2011	Viti 2015
Bashkia Elbasan	147,037	144,382
Elbasan	81,659	80,185
Labinot Mal	5,490	5,391
Funarë	2,202	2,162
Labinot Fushë	7,323	7,191
Bradashesh	11,102	10,901
Gracen	2,274	2,233
Shushicë	9,059	8,895
Papër	6,586	6,468
Shirgjan	7,581	7,445
Gjergjan	5,319	5,223
Gjinar	3,609	3,543
Tregan	3,150	3,093
Zavalin	1,683	1,653
Qarku Elbasan	**306,939**	**301,397**


Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Figura 81. Struktura e populisisë




Burimi: INSTAT dhe llogaritje të autorit, 2015

Figura 82. Shpërndarja e popullsisë në Qarkun Elbasan




Burimi: INSTAT 2011, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Figura 83. Dendësia e popullsisë në Qarkun Elbasan




Burimi: INSTAT 2011, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Figura 84. Shpërndarja e popullsisë në Bashkinë Elbasan



Burimi: INSTAT 2015, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Figura 85. Dendësia e popullsisë në Bashkinë Elbasan



Burimi: INSTAT 2015, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Populllsia rezidente e kësaj bashkie është e përqendruar kryesisht në qytetin e Elbasanit, me rreth 56%, të saj ndërkohë që pjesa tjetër e popullsisë është e shpërndarë në 12 njësi administrative. Nga këto, veçohet njësia administrative Bradashesh me rreth 8% të popullatës së bashkisë ndërkohë që shpërndarja e popullsisë në pjesën e mbetur të njësive administrative "lëviz" në intervalin (2-6)% të popullatës gjithsej të bashkisë.


Sipas të dhënave të INSTAT popullsia e Bashkisë Elbasan, krahasuar me vitin 2011, ka pësuar rënie me rreth 2700 banorë, ose me 2% me pak, rënie e cila si dukuri tashmë është e pranishme pothuaj në të gjitha njësitë vendore të vendit (përjashtuar këtu Qarkun Tiranë dhe Durrës) pas viteve '90. Shkaqet e rënies së popullsisë në Bashkinë Elbasan lidhen me faktorët *e emigrimit, uljes së ritmeve të shtesës natyrore të popullsisë si dhe ritmeve të larta të migrimit të brendshëm, duke ndjekur të njëjtin model-profil të zhvillimit demografik të popullsisë, sikundër në njësitë e tjera vendore të vendit.*

Tabela 35. Popullsia sipas gjinisë Bashkia Elbasan, për vitet 2011-2015

Popullsia, qarku, bashkia, njësia administrative	Viti 2011			Viti 2015		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Bashkia Elbasan	**147,037**	**73,977**	**73,060**	**144,382**	**72,987**	**71,395**
Elbasan	81,659	41,084	40,575	80,185	40,105	40,080
Labinot Mal	5,490	2,762	2,728	5,391	2,754	2,637
Funarë	2,202	1,108	1,094	2,162	1,080	1,082
Labinot Fushë	7,323	3,684	3,639	7,191	3,694	3,497
Bradashesh	11,102	5,586	5,516	10,901	5,658	5,244
Gracen	2,274	1,144	1,130	2,233	1,168	1,065
Shushicë	9,059	4,558	4,501	8,895	4,479	4,416
Papër	6,586	3,314	3,273	6,468	3,284	3,183
Shirgjan	7,581	3,814	3,767	7,445	3,765	3,680
Gjergjan	5,319	2,676	2,643	5,223	2,645	2,577
Gjinar	3,609	1,816	1,793	3,543	1,929	1,615
Tregan	3,150	1,585	1,565	3,093	1,568	1,525
Zavalin	1,683	847	836	1,653	858	795
Qarku Elbasan	**306,939**	**154,426**	**152,513**	**301,397**	**153,389**	**148,008**

Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, njësie administrative, llogaritje të autorit

Figura 86. Raporti Gjinor në Bashkinë Elbasan



Burimi: INSTAT 2015 dhe përpunime të autorëve

Raportit gjinor i popullsisë së Bashkisë Elbasan, ruan një diferencë të lehtë për sa i përket ndarjes së popullsisë sipas gjinisë në meshkuj e femra. Rrjedhimisht, mbështetur dhe në të dhënat e popullsisë për dy vitet 2011 dhe 2015, treguesi demografik i raportit gjinor (meshkuj /femra*100) tregon së për vitin 2015 ky raport është rritur në favor të popullatës së meshkujve, krahasuar me situatën e raportit gjinor për vitin 2011, (102 meshkuj për çdo 100 femra për vitin 2015, nga 101 në vitin 2011).

Tabela 36. Raporti gjinor për Bashkinë Elbasan, 2011-2015

Popullsia, qarku, bashkia, njësia administrative	Koeficienti gjinor në %	
	2011	2015
Bashkia Elbasan	**101**	**102**
Elbasan	101	100
Labinot Mal	101	104
Funarë	101	100
Labinot Fushë	101	106
Bradashesh	101	108
Gracen	101	110
Shushicë	101	101
Papër	101	103
Shirgjan	101	102
Gjergjan	101	103
Gjinar	101	119
Tregan	101	103
Zavalin	101	108
Qarku Elbasan	**101**	**104**

Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, njësie administrative, llogaritje të autorit

Nëse krahasojmë raportin gjinor të popullatës së bashkisë me atë të qarkut, identifikojmë vlera të ndryshme, gjithnjë në favor të popullatës së meshkujve (104) dhe kjo situatë është akoma më e theksuar në nivel ish-komunash, ku ky tregues arrin vlerën maksimale 119 (119 meshkuj për çdo 100 femra), si në rastin e njësisë administrative Gjinar. Aktualisht, për vitin 2015, struktura urbane/rurale e qarkut vlerësohet në raportin 31% : 61%, ndërkohë që vendi që prej vitit 2008 ka një strukture urbane/rurale në favor të zonave urbane dhe për vitin 2015, rreth 57% e popullatës kombëtare klasifikohet si popullate urbane. Një tjetër faktor mund të konsiderohet edhe shfaqja e fenomenit të abortit selektiv, duke favorizuar fëmijët meshkuj.


Një tjetër tregues rëndësishëm demografik, struktura moshore e popullatës dhe mosha mesatare e re, tregojnë se aktualisht popullata e Bashkisë Elbasan vazhdon të jetë akoma një popullsi e re sikundër edhe popullata shqiptare në tërësi. Për vitin 2015 struktura moshore e popullatës së bashkisë tregon së 69% e saj i takon grupmoshës (15-64) vjeç dhe 20% grupmosha (0-14) vjeç. Këto të dhëna shumë optimiste evidentojnë se bashkia/qarku ka potencial të lartë të popullsisë në moshë punë që mund të jetë ekonomikisht aktive.

Tabela 37. Popullsia rezidente, sipas grup-moshave

Popullsia, qarku, bashkia, njësia administrative	Viti 2011				Viti 2015			
	Gjithsej	0-14	15-64	65+	Gjithsej	0-14	15-64	65+
Bashkia Elbasan	**147,037**	**30,001**	**101,841**	**15,195**	**144,382**	**29,459**	**100,002**	**14,921**
Elbasan	81,659	15,235	57,621	8,804	80,185	14,959	56,581	8,645
Labinot Mal	5,490	1,473	3,466	550	5,391	1,447	3,404	540
Funarë	2,202	409	1,501	292	2,162	401	1,474	286
Labinot Fushë	7,323	1,916	4,825	582	7,191	1,882	4,738	572
Bradashesh	11,102	2,426	7,706	970	10,901	2,382	7,567	953
Gracen	2,274	529	1,494	251	2,233	520	1,467	247
Shushicë	9,059	2,214	6,024	821	8,895	2,174	5,915	806
Papër	6,586	1,490	4,466	631	6,468	1,463	4,385	619
Shirgjan	7,581	1,646	5,166	770	7,445	1,616	5,073	756
Gjergjan	5,319	988	3,789	542	5,223	970	3,721	532
Gjinar	3,609	675	2,511	422	3,543	663	2,466	415
Tregan	3,150	664	2,159	327	3,093	652	2,120	321
Zavalin	1,683	336	1,112	234	1,653	330	1,092	230
Qarku Elbasan	**306,939**	64,755	210,885	31,299	**301,397**	63,586	207,077	30,734

Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, njësie administrative, llogaritje të autorit

Figura 87. Struktura Moshore, Bashkia Elbasan 2015



Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, njësie administrative, llogaritje të autorit

Analiza e strukturës moshore të popullatës në Bashkinë Elbasan tregon se popullata e kësaj grupmoshë është e pranishme me të njëjtat nivele (66-71%) në të gjitha njësitë

administrative (urbane dhe rurale). Gjithsesi, ndërmjet tyre, ka edhe ndryshime nga të cilat duhen veçuar njësitë administrative Funar dhe Zavalin, të cilat kanë nivelin më të lartë të grupmoshës së të moshuarve (+65 vjeç) me 13-14% dhe njësinë administrative Labinot Mal nivelin më të lartë të grupmoshës së re (0-14), me 27%.

Nëpërmjet të dhënave të ndarjes së popullsisë sipas grupmoshave, llogariten treguesit e varësisë, që janë shumë të rëndësishëm në analizën socio-ekonomike. Analiza e këtyre treguesve është e rëndësishme për të vlerësuar burimet potenciale njerëzore që mund të përfshihen në tregun e punës dhe rrjedhimisht të ndikojnë përmirësimin e performancës ekonomike të zonës në studim.

Treguesit e varësisë klasifikohen në: treguesit e varësisë totale, (raporti i grupmoshave [(0-14)+ (+65)] /(15-65) ndaj popullsisë në moshë punë; treguesi varësisë së të rinjve, (raporti i gupmoshës (0-14)/(15-65); dhe treguesi i varësisë së të moshuarve (raporti i grupmoshës (+65)/(15-65). Koeficienti i varësisë totale shpreh raportin e popullsisë joaktive (në moshë jo punë) ndaj popullsisë në moshë punë, duke treguar se sa individë në moshë jo pune, "mbulohen"/përballohen nga 100 individë në moshë punë. Sa më e vogël të jetë vlera e këtij treguesi, aq më shumë mund të rritet potencialisht performanca ekonomike ndërkohë, koeficienti i varësisë së të rinjve dhe i varësisë së të moshuarve, tregojnë përkatësisht raportin e popullsisë së grupmoshave 0-14 vjeç dhe 65 vjeç e lart kundrejt popullsisë në moshën 15-64 vjeç. Gjithashtu, interpretimi ekonomik i treguesit të varësisë së të rinjve është i ngjashëm me treguesin e varësisë totale, pra një tregues i lartë shpreh optimizëm në drejtim të rritjes së numrit të popullsisë aktive në një periudhe të ardhshme, ndërkohë që rritja e treguesit të varësisë së të moshuarve është "sinjal" për ndarje fondesh e investimesh për të lehtësuar e përmirësuar jetesën dhe mirëqenien e kësaj kategorie të popullsisë.

Konkretisht, për Bashkinë Elbasan, treguesit e varësisë moshore totale, e varësisë së të rinjve dhe varësisë së të moshuarve paraqiten si më poshtë:

Tabela 38. Koeficientët e varësisë

Koeficientët e varësisë, qarku, bashkia, njësi administrative	KOEFICIENTËT E VARËSISË, 2011-2015		
	Varësia totale	Varësia e të rinjve	Varësia e të moshuarve
BASHKIA ELBASAN	**44**	**29**	**15**
Elbasan	42	26	15
Labinot mal	58	43	16
Funarë	47	27	19
Labinot Fushë	52	40	12
Bradashesh	44	31	13
Gracen	52	35	17
Shushicë	50	37	14
Papër	47	33	14
Shirgjan	47	32	15
Gjergjan	40	26	14
Gjinar	44	27	17
Tregan	46	31	15
Zavalin	51	30	21
QARKU ELBASAN	**46**	**31**	**15**

Burimi: Të dhënat për qarqet nga INSTAT, në nivel bashkie, njësie administrative, llogaritje të autorit

Mbështetur në këta tregues konstatojmë se treguesi i varësisë totale për Bashkinë e Elbasanit shënon vlerën 44 (44 banorë të moshës joaktive (0-14 vjeç dhe +65vjeç) "përballohen" nga 100 banorë të moshës aktive për punë(15-64 vjeç), ndërkohë që vlera e këtij treguesi në nivel kombëtar është 47. Viti 2011 është viti në të cilin ky tregues ka shënuar vlerën e tij më të ulët për gjithë periudhën (1979-2011) si në nivel kombëtar ashtu dhe në nivel njësie vendore, duke treguar në këtë mënyrë së bashkia ndodhet në të ashtuquajturën episod i "dividendit demografik" dhe kjo si rezultat i një numri të lartë popullsie potencialisht ekonomikisht aktive (15-65) përkundrejt një numri të ulët popullsie të re (0-14) dhe të moshuar (+65).

Nëse bashkia/qarku do të përfitojë nga ky "dividend demografik", kjo varet nga efektiviteti i politikave social ekonomike të politikëbërësit, përfshirë këtu në mënyrë të veçante edhe arsimimin dhe kualifikimin e mjaftueshëm të fuqisë punëtore për të mundësuar integrimin e saj në punë produktive të cilat më pas do të ndikojnë jo vetëm në përmirësimin e performancës ekonomike, por edhe në rritjen e mirëqenies së popullatës.

Ndërkohë që koeficienti i varësisë totale flet për ekzistencën e "dividendit demografik". Analiza e treguesve të tjerë të varësisë tregojnë një rritje të konsiderueshme të numrin të personave të moshuar 65 vjeç e lart, (nga 9% në 15%) dhe një rënie të grup-moshave të reja, (nga 60% në 29%) duke demonstruar qartazi për "shenjat" në hyrjen në një faze të re demografike të popullsisë, atë "të plakjes". Rritja e grupmoshës (+65) shoqërohet me nevojën e rritjes së investimeve për të lehtësuar e përmirësuar aspektin socio-ekonomik të kësaj kategorie të popullsisë. Këta tregues në nivel bashkie vlerësohen afërsisht të njëjtë me treguesit në nivel qarku, ndërkohë që konstatohen ndryshime të konsiderueshme në vlerat e tyre sipas njësive administrative.

Tabelat mëposhtë tregojnë numrin e popullsisë për periudhën 2011-2031, gjithmonë sipas totalit të popullsisë në nivel qarku, të përllogaritur me variantin e skenarit të rritjes së mesme*. Sipas këtyre të dhënave vlerësohet se popullsia e Bashkisë Elbasan, sikundër edhe ajo e qarkut, do të pësojë rënie të konsiderueshme, e cila si mesatare vjetore për gjatë periudhës 2015-2031 llogaritet të jetë rreth 1%, ndërkohë që rënia e popullsisë në 2031 , e krahasuar me vitin 2015, vlerësohet të jetë akoma më e madhe, rreth 17%. Parashikimi në rënie i numrit të popullsisë rezidente gjatë periudhës 2015-2031 është i pranishëm në të gjitha njësitë vendore të qarkut/bashkisë, duke ruajtur të njëjtin ritëm mesatar rënie sikundër edhe bashkia.


1.5.2 Zhvillimi dhe përfshirja sociale

- **Niveli i përgjithshëm arsimor**

Në Bashkinë Elbasan 53.9% e popullsisë ka arsim bazik përfundimtar (fillor dhe 8 ose 9-vjeçar) krahasuar me mesataren kombëtare prej 52.1% dhe atë në nivel qarku me 59.6%[291]. Shkalla e analfabetizmit në qark (3.65 %) dhe veçanërisht në bashkinë Elbasan (3.5%), edhe pse krahasueshmërisht e ngjashme me bashkitë e tjera, është relativisht më e lartë se mesatarja në rang vendi (2.8%). Përsa i përket arsimit të mesëm, 29.9% e popullsisë ka arsim të mesëm si nivel përfundimtar krahasuar me mesataren në rang kombëtar prej 31.4% (figura mëposhtë). Për më tepër, në këtë drejtim, bashkia Elbasan lihet mbrapa nga bashki të tjera të përafërta në madhësi dhe afërsi gjeografike si: Bashkia Durrës (33.62 %), Tiranë

(39.6%), Fier (32.5%), Berat (33%), etj (INSTAT, censusi 2011). E njëjta gjë mund të thuhet dhe për arsimin universitar/pas universitar. Në bashkinë Elbasan, 10.8 % e popullësisë është me arsim universitar/pasuniversitar në krahasim me 11.8 % të popullsisë në rang kombëtar. Këto shifra janë relativisht me të ulta krahasuar me njësi të tjera të ngjashme vendore si Durrësi (11.5%), Tirana (25.3%), Vlora (14.5%) etj. Kjo do të thotë që popullsia që përbën forcën e punës në këtë bashki është relativisht më pak e kualifikuar se ajo që ofrohet nga bashkitë e tjera dhe për pasojë vështirëson konkurencën në tregun e punësimit kombëtar ose të paktën në rajonin perëndimor/qëndror të Shqipërisë[292].

Figura 88. Niveli arsimit në bashkinë Elbasan, i krahasuar me qarkun dhe mesataren kombëtar



Burimi: INSTAT, Censusi 2011, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Si mund të shihet në tabelën mëposhtë, popullësia që jeton në njësitë administrative të bashkisë, (me përjashtim të qytetit të Elbasanit) zotëron arsim 8 ose 9-vjeçar përfundimtar në nivele të larta. Në përgjithësi, e gjithë popullsia në Bashkinë Elbasan zotëron arsim përfundimtar 8 ose 9-vjeçar në nivele të larta. Kjo dukuri vërehet veçanërisht në njësitë administrative me karakter rural (figura mëposhtë). Kurse nivelet më të larta të poullsisë me arsim të mesëm dhe të lartë vërehen në pjesën më urbane të bashkisë, kryesisht në qytetin e Elbasanit (figura mëposhtë).

Tabela 39. Niveli arsimor i përfunduar, Bashkia Elbasan


	Shkalla analfabetizmit (%)	Fillor dhe 8 dhe 9 vjeçar %	Arsim i mesëm %	Universitar dhe pasuniversitar %
Elbasan	2.7	40.35	38.63	16.69
Bradashesh	3.9	72.49	18.86	3.17
Papër	3.5	74.45	17.45	3.01
Gracen	7.3	78.3	10.23	2.08
Funare	5.2	73.61	16.96	2.78
Labinot-Mal	6	76.23	14.05	1.68
Labinot-Fushë	4.5	70.58	19.23	3.88
Shushicë	5.2	72.37	17.28	3.41
Shirgjan	3.3	67.7	23.58	3.37
Gjergjan	3.8	72.04	20.65	2.06

Tregan	4	76.13	15.9	2.34
Gjinar	5.2	63.18	17.4	3.22
Zavalin	5.5	62.1	22.88	6.78

Burimi: Censusi 2011, INSTAT

Elbasani është një bashki me mobilitet të lartë, ku lëvizjet e brendshme migratore nga zonat rurale në ato më urbane janë të shpeshta[293]. Të dhënat në tabelën e mësipërme dëshmojnë për një forcë punëtore, kryesisht banuese në njësitë me karakter rural brenda bashkisë (ish-komunat), që nuk ka kualifikime të mjaftueshme për të konkurruar në tregun e punës së Bashkisë së re të Elbasanit. Për më tepër, kjo dukuri e oriention forcën punëtore kryesisht drejt sektorit ekonomik bujqësor, ku kualifikimet e kërkuara janë më të vogla.

Figura 89. Niveli arsimor i përfunduar fillor dhe 8 ose 9 vjeçar, i mesëm dhe i lartë




Burimi: Censusi 2011, INSTAT; Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Shpërndarja e institucioneve arsimore në territorin e Bashkisë së Elbasanit

Aktualisht bashkia Elbasan ka 97 kopshte, 127 shkolla 9-vjeçare, dhe 23 shkolla të mesme (të përgjithshme dhe profesionale), shpërndarja e të cilave sipas secilës njësi administrative mund të shihet lehtësisht në grafikun e mëposhtëm[294].

Figura 90. Shpërndarja e institucioneve arsimore parauniversitare në bashkinë Elbasan



Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016


Për të kuptuar më shumë mbi situatën në sektorin e arsimit në bashkinë Elbasan, është analizuar edhe cilësia e këtij shërbimi të ofruar duke marrë parasysh dy indikatorë: rrezen e shërbimit dhe raportin mësues/nxënës.

Qyteti i Elbasani, zotëron numrin më të madh të institucioneve arsimore si kopshte, shkolla 9-vjeçare dhe të mesme. Kjo është edhe njësia me numrin më të madh të popullsisë dhe dendësisë së vendbanimeve. Në njësitë si, Bradashesh, Gjergjan, Gracen, Shushicë dhe Tregan nuk ka shkolla të mesme. Në njësitë e tjera administrative si Funarë, Labinot Mal, Labinot-Fushë, Papër dhe Zavalinë ekziston një shkollë e mesme për njësi, por ato janë të bashkuara me shkollat 9-vjeçare. Gjithashtu edhe në qytetin e Elbasanit, 4 shkolla të mesme janë të bashkuara me ato 9-vjeçare. Përsa i përket studimit të infrastrukturës arsimore, është e domosdoshme të analizohet *rrezja e shërbimit* arsimor, krahasuar me standartet e përcaktuar në rregulloren e planifikimit[295].

Rrezja e Shërbimit

Kopshte. Rrezja e shërbimit për kopshte, sipas standarteve të planifikimit, duhet të jetë 250-350m në zonat urbane dhe 500-600m në zonat rurale[296]. Në qytetin e Elbasanit dhe njësitë e tjera administrative si Bradashesh, Shirgjan, Gjergjan, ku dhe dëndësia e vendbanimeve është më e madhe, ka një mbulim të pjesshëm me shërbimin. Sikurse vërehet nga harta e mëposhtëme, rrezet e shërbimit të këtyre institucioneve nuk e mbulojnë mjaftueshëm të gjithë territorin[297]. Shumica e kopshteve nuk i plotësojnë standardet minimale të sipërfaqes së objektit/fëmijë dhe sheshit funksional (oborrit), siç rekomandohen në bazë të legjislacionit përkatës[298].


Figura 91. Shpërndarja e kopshteve në territorin e Bashkisë Elbasan



Burimi: Ministria e Arsimit, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Në figurën mëposhtë, vërehet më qartë rrezja e shërbimit për kopshtet në qytetin e Elbasanit. Zona me mbulim më të vogël brenda kësaj njësie është kryesisht rajoni 1 dhe 3, të cilët përbëjnë pjesën jugore dhe jugperëndimore të qytetit. Problematike shfaqet edhe rajoni 6 i njësisë administrative të Elbasanit, një zonë me përqëndrim të madh të komunitetit rom dhe banesave të reja.


Figura 92. Shpërndarja e kopshteve në territorin e qytetit të Elbasanit



Burimi: Ministria e Arsimit, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Shkollat 9-vjeçare. Sipas standarteve të planifikimit, rrezja e shërbimit për shkollat 9-vjeçare duhet të jetë 500-600m në zonat urbane dhe 1000-1500m në zonat rurale[299]. Siç vërehet nga harta e mëposhtëme, rrezet e shërbimit të këtyre institucioneve mbulojnë relativisht mirë të gjithë territorin e banuar. Megjithatë, pavarësisht se këto objekte janë të shpërndara mjaft mirë në territorin e bashkisë dhe ofrojnë shërbim lehtësisht të arritshëm nga fëmijët frekuentues, shumica e tyre nuk i plotësojnë standardet minimale të sipërfaqjes së objektit dhe sheshit funksional (oborrit), siç rekomandohen në bazë të legjislacionit përkatës. Madje, siç është përmendur dhe mësipër, shumë nga këto shkolla 9-vjeçare janë të bashkuara me shkollat e mesme dhe në disa prej tyre mësimi realizohet me turne.


Figura 93. Shpërndarja e shkollave 9-vjeçare në territorin e Bashkisë Elbasan



Burimi: Ministria e Arsimit, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Ndonëse në nivel bashkie, territori mbulohet relativisht mirë me shkolla 9-vjeçare, qyteti i Elbasanit shfaqet më problematiku në këtë drejtim. Rajonet 3, 6 dhe 1 shfaqen sërisht të pambuluara mjaftueshëm nga rrezet e shërbimit me shkolla 9-vjeçare, duke i bërë shkollat ekzistuese të mbipopulluara, ku mësimi zhvillohet me turne. Duke qënë se këto territore popullohen dëndur nga komuniteti rom dhe nga familje të ardhura nga zonat rurale është e kështillueshme që planet e reja të marrin parasysh këto mangësi, në mënyrë që të përmirësohet aksesi dhe frekuentimi i shkollës për të gjithë fëmijët.


Figura 7. Shpërndarja e shkollave 9-vjeçare në territorin e qytetit të Elbasanit



Burimi: Ministria e Arësimit, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Shkollat e mesme. Sipas standarteve të planifikimit, rrezja e shërbimit për shkollat e mesme duhet të jetë 1000-1500m në zonat urbane dhe 2000-4500m në zonat rurale[300]. Në hartën e mëposhtme, shihet se i gjithë territori i Bashkisë së re të Elbasanit nuk mbulohet mjaftueshëm nga shkolla të mesme. Rrezet e shërbimit të shkollave të mesme lënë zbuluar njësi të tëra administrative të banuara. Situata shfaqet veçnërisht problematike në njësitë si Bradashesh, Shushicë, Gracen, Labinot Fushë dhe Tregan. Në këto njësi administrative jo vetëm që nuk ekziton asnjë shkollë e mesme, por rrezet e mbulimit të shkollave të mesme të njësive ngjitur mbulojnë pak ose aspak këtë pjesë të territorit. Shumica e nxënësve që duan të vazhdojnë shkollën e mesme në këto zona duhet të udhëtojnë më shume se 10 km (vajtje-ardhje) ose të qëndrojnë ne konvikte. Por për arsye të infrastrukturës së dobët dhe mundësive të pakta financiare, shumë nxënës vendosin të mos frekuentojnë fare shkollat e mesme. Kjo shpjegon edhe nivelin e ulët të arsimit të mesëm në këto njësi administrative. Në hartimin e planit të ri për Bashkinë e Elbasanit sygjerohet të merren parasysh këto mangësi dhe të propozohet ndërtimi i shkollave të mesme, krysisht të natyrës profesionale, në mënyrë që ti shërbëjnë nevojave të tregut.

Figura 94. Shpërndarja e shkollave të mësme në territorin e Bashkisë Elbasan




Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Qyteti i Elbasanit mbulohet relativisht mirë nga shkollat e mesme, përveç rajoneve si ai 3, 6 dhe 1 (figura mëposhtë). Përqendrimi i madh i nxënësve në shkollat e mesme bën që shumica e tyre të jenë të mbipopulluara dhe mësimi të zhvillohet në dy turne. Zona periferike e qytetit mbetet kryesisht problematike me mbulimin, duke lënë nxënësit e grupeve më të prekshme si romët dhe familjet e ardhura nga zonat rurale të paekspozuara me shkolla të mesme. Duke qënë se numri i nxënëse që frekuentojnë shkollat e mesme nuk është rritur në vitet e fundit dhe mendohet se ai do të zvogëlohet në këmbim të rritjes së

numrit të nxënësve me arsim të mesëm profesional, propozohet që shkollat e reja të mesme të jenë profesionale.

Figura 95. Shpërndarja e shkollave të mesme në qytetin e Elbasanit




Burimi: Bashkia Elbasand dhe Co-PLAN, 2016

- **Gjendja e infrastrukturës së institucioneve arsimore**

Nga vlerësimi i gjendjes infrastrukturore të të gjitha institucioneve arsimore (kopshte, shkolla 9-vjeçare dhe të mesme) rezulton se ato kanë nevoja të mëdha për investime, që shkon nga rikonstruksion i plotë deri te nevojat prioritare për mirëmbajtje. Përveç institucioneve arsimore në qytetin e Elbasanit, kopshtet dhe shkollat në njësitë e tjera administrative shfaqin të paktën një kusht në rrezik (figura mëposhtë). Graceni është dhe njësia administrative më e rrezikuar nga infrastruktura fizike e amortizuar shkollave, veçanërisht shkolla 9-vjeçare e varur Bodin. Shkolla dhe kopshte të tjera në gjendje problematike janë në Bradashesh; 3 shkolla 9- vjeçare në Funarë (shkolla Preç e poshtëme, Cerujë, Krrabë e Vogël); 2 kopshte dhe 1 shkollë fillore në Zavalinë, përkatësisht në Burrishtë dhe Kamican; 3 shkolla 9-vjeçare në Tregan (përkasisht në Kaqivel, Kaqivel i poshtëm dhe Shinavlash); 3 shkolla 9-vjeçare në Gjergjan (Gjergjan, Kodra Bujaras, Bujaras), etj. Në çdo njësi administrative të Elbasanit ka nevojë për rinkonstruksion të pjesshëm për një sërë shkollash dhe kopshtesh.Për më tepër, rezulton se shumica e shkollave nuk janë të pajisura me laboratorë, duke e vështirësuar kështu mësimëdhënien. Duke marrë parasysh dhe faktorët e tjerë të sipërpërmëndur, propozohet ndërmarrja e investimeve të menjëhershme për përmisimin e kushteve të institucioneve arsimore, në mënyrë të veçantë në njësinë administrative të Gracenit.

Figura 96. Gjendja fizike e institucioneve arsimore në Bashkinë Elbasan



Burimi: Ministria e Arsimit, Përpunoi:Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Raporti nxënës/mësues

Kopshte. Raporti fëmijë/edukatorë në nivel kombëtar është 18.25 sipas strategjisë kombëtare të zhvillimit të arsimit parauniversitar në Shqipëri dhe synimi është të ulet ky raport në 18 për vitin 2017 dhe 2020[301]. Në bashkinë e Elbasanit, ky raport është më i lartë se ai në nivel kombëtar, ku 1 edukator kujdeset për më shumë se 19 fëmijw[302]. Në të gjitha njësitë administrative (me përjashtim të Treganit, Funarws, Gracenit dhe Zavalinës) raporti fëmijë/edukatorë është shumë i lartë (Taela mëposhtë). Njësi problematike mbeten kryesisht Elbasani, Labinot Fusha, Shushica dhe Shirgjani, ku numri i edukatorëve nuk është i mjaftueshëm për numrin e fëmijëve që frekuentojnë kopshtet.


Tabela 40. Numuri i fëmijëve dhe edukatoreve në Bashkinë Elbasan[303]

	Kopshte	Fëmijë	Edukatore	Raporti fëmijë/edukatorë
Elbasan	32	2966	156	**19.01**
Bradashesh	11	352	18	**19.56**
Papër	10	209	10	**20.90**
Gracen	3	46	3	15.33
Funarë	2	35	2	17.50
Labinot-Mal	5	110	6	**18.33**
Labinot-Fushë	7	194	8	**24.25**
Shushicë	6	304	13	**23.38**
Shirgjan	3	158	8	**19.75**
Gjergjan	4	94	5	**18.80**

Tregan	5	98	7	14.00
Gjinar	6	104	6	17.33
Zavalinë	3	37	3	12.33
TOTAL	97	4707	245	**19.21**

Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016


Figura 97. Harta e shpërndarjes së kopshteve sipas raporteve fëmijë/edukator në Bashkinë Elbasan[304]



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Shkolla 9-vjeçare. Sipas të dhënave të Bankës Botërore 2013, mestarja e Bashkimit Europian (BE) e raportit nxënës/mësues për shkollat fillore është afërsisht 13.4, kurse e Shqipërisë në rang kombëtar është afërsisht 19[305]. Nga të dhënat e publikuara nga Ministria Arsimit 2015, pothuajse në të gjithë bashkinë e Elbasanit ka një raport nxënës/mësues të ngjashëm më standardet Europiane dhe përgjithesisht më mirë se mesatarja kombetare Në fakt, Elbasani (në nivel rrethi-ish ndarje e vjetër administrative) ka numrin më të madh të punësuar të mësuesve, renditur pas Tiranës (20%) me 7 %[306]. Nga Tabela dhe nga harta e shpërndarjes (të paraqitura mësipër) vërehet se shumë nga njësitë administrative kanë një raport nxënës/mësues rreth 10-13, që rezulton të jetë më i ulët se mesatarja ne BE, gjë që mund të ketë implikimet e veta në uljen e cilësisë së këtij shërbimi. Njësia problematike shfaqet Elbasani, ku në disa shkolla raporti nxënës/mësues rezulton të jetë relativisht i madh, për shkak edhe të popullimit të dëndur dhe frekuentimit më të madh të shkollave.

Figura 98. Raporti nxënës/mësues për shkollat 9-vjeçare Shqipëri dhe BE




Burimi: Banka Botërore, 2014

Tabela 41. Numri i nxënësve dhe mësueseve në shkollat 9-vjeçare

	Shkolla 9-vjeçare	**Nxënës**	**Mësues**	**Raporti Nxënës/mësues**
Elbasan	26	9422	566	16.65
Bradashesh	12	1272	97	13.11
Papër	11	754	65	11.60
Gracen	10	248	32	7.75
Funare	7	223	28	7.96
Labinot-Mal	12	762	67	11.37
Labinot-Fushë	9	907	77	11.78
Shushicë	9	1203	90	13.37
Shirgjan	6	827	63	13.13
Gjergjan	5	519	48	10.81
Tregan	8	395	37	10.68
Gjinar	7	342	40	8.55
Zavalin	5	157	16	9.81
TOTAL	127	17031	1226	**13.89**

Burimi: Bashkia Elbasan, 2015


Figura 99. Harta e shpërndarjes së shkollave 9-vjeçare sipas raportit mësues/nxënës në bashkinë Elbasan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Shkollat e mesme. Për edukimin e mesëm Shqipëria në rang kombëtar ka një raport mësues/nxënës 14, kurse niveli mesatar në Bashkimin Europian është 11.8[307]. Në këtë drejtim, raporti nxënës/mësues për shkollat e mesme në Bashkinë Elbasan (17 nxënës/mësues) është shumë herë më i lartë se raporti i BE-së apo ai kombëtar.

Figura 100. Raporti nxënës mësues për shkollat e mesme Shqipëri dhe BE



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016


Shumica e shkollave të mesme në bashkinë Elbasan kanë mesatarisht një raport 20 nxënës/ mësues, por në disa njësi si Elbasani, Shirgjani, Labinot Fusha, numri i mësueve për nxënës është shumë herë i vogël.

Tabela 42. Numri i nxënësve dhe mësuesve në shkollat e mesme sipas Bashkisë Elbasan

	Shkolla të mesme	Nxënës	Mësues	Raporti nx/ms
Elbasan	15	6077	345	17.61
Bradashesh				
Papër	1	135	9	15
Gracen				
Funare	1	90	5	18
Labinot-Mal	2	185	19	9.74
Labinot-Fushë	1	123	7	17.57
Shushicë				
Shirgjan	1	317	17	18.65
Gjergjan				
Tregan				
Gjinar	1	143	10	14.3
Zavalin	1	50	5	10
TOTAL	23	7120	417	**17.07**

Burimi: Bashkia Elbasan, 2015

Figura 101. Harta e shpërndarjes së shkollave të mesme sipas raporteve mësues/nxënës në bashkinë Elbasan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

- **Punësimi**

Numri i banorëve në moshë pune, që i përket grupmoshës 15-64 vjeç përbën rreth 69 % të popullësisë së Bashkisë Elbasan. Si mund të shihet nga Tabela 44, rreth 57 % e kësaj popullsie është banuese në qytetin e Elbasanit, kurse pjesa tjetër është e shpërndarë në njësitë e tjera, përqëndruar më tepër në njësitë administrative me karakter rurale të Bradasheshit, Shushicës, Labinot Fushës, etj.


Tabela 43. Popullsia në Bashkinë Elbasan, sipas njësive administrative

	Viti 2015					
	Total		Grup-mosha			
Njësi administrative	Nr. Popullsië	Në %	0-14	**15-64**	(Në %)	65+
Elbasan	80185	56%	14959	56581	57%	8645
Bradashesh	10901	8%	2382	7567	8%	953
Funare	2162	1%	401	1474	1%	286
Gjergjan	5223	4%	970	3721	4%	532
Gjinar	3543	2%	663	2466	2%	415
Gracen	2233	2%	520	1467	1%	247
Labinot Fushe	7191	5%	1882	4738	5%	572
Labinot Mal	5391	4%	1447	3404	3%	540
Papër	6468	4%	1463	4388	4%	619
Shirgjan	7445	5%	1616	5073	5%	756
Shushice	8895	6%	2174	5915	6%	806
Tregan	3093	2%	652	2120	2%	321
Zavaline	1653	1%	330	1092	1%	230
Bashkia Elbasan	**144 382**	100%	29459 (20.40%)	**100 002 (69%)**	100%	14921 (10.40%)

Burimi: INSTAT 2015

Këto të dhëna janë optimiste pasi evidentojnë që Bashkia Elbasan ka një potencial të lartë të popullsisë në moshë punë ekonomikisht aktive, por përqëndrimi i më shumë se gjysmës së kësaj popullësie vetëm në zonën urbane të Bashkisë dëshmon se përformanca ekonomike e bashkisë së re është kushtëzuar mjaftueshëm nga zhvillimet që ndodhin në qytetin e Elbasanit.

Figura 102. Populllsia në Bashkinë Elbasan, sipas grupë-moshave



Burimi: Bashkia Elbasan, 2015

- **Punësimi sipas degëve të ekonomisë**

Për të kuptuar dinamikat në tregun e punës në Bashkinë Elbasan është e nevojshme të analizohet cilët janë sektorët ekonomikë me numrin më të madh të të punësuarve. Në zonën urbane të bashkësisë, që përbehët kryesisht nga Elbasani, numri më i madh i të punësuarëve është në sektorin e shërbimeve me 49%. Në degën e industrisë është punësuar 18,6 % e popullsisë, kurse në ndërtim punon vetëm 7.52 % e popullsisë[308]. Sipas vjetarit statistikor 2015, numri i të punësuarëve në sektorin e ndërtimit ka ardhur në ulje gjatë viteve të fundit, si pasojë e uljes së nivelit të ndërtimeve në rang qarku, por edhe në rang kombëtar[309]. Mendohet se ndryshimet në legjislacionin përkatës kanë ulur numrin e veprave të ndërtuara dhe si pasojë edhe numrin e të punësuarëve në këtë sektor.

Si mund të shihet në Tabelën 45, pjesa e popullësisë që ndodhet në pjesën më rurale të bashkisë, është punësuar kryesisht në bujqësi. Në njësitë administrative: Funarë, Gracen, Labinot Mal, Tegan, Zavalinë, etj, një pjesë shumë e vogël e popullsisë merret me tregti me shumicë dhe pakicë apo industri. Në fakt, këto njësi kanë karakter bujqësor dhe shumica e të punësuarëve fokusohen në sektorin e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit.

Tabela 44. Punësimi sipas sektorëve ekonomikë, sipas njësive Bashkia Elbasan[310]


	Bujqësi, pyje dhe peshkim	**Tregti me shumicë dhe pakicë**	**Ndërtim**	**Industri**	**Shërbime**	**E papërcaktuar**
Bradashesh	35.51 %	7.75 %	8.33 %	**14.00 %**	**18.51 %**	15.89 %
Elbasan	2.35 %	19.78 %	7.52 %	**18.60 %**	**49.19 %**	2.56 %
Funarë	**85.04 %**	**0.51 %**	3.17 %	0.76 %	7.22 %	3.30 %
Gjergjan	65.49 %	5.04 %	8.02 %	4.48 %	12.22 %	4.76 %
Gjinar	71.36 %	3.48 %	3.64 %	3.03 %	15.45 %	3.03 %

Gracen	**87.80 %**	**0.20 %**	2.36 %	1.38 %	7.28 %	0.98 %
Labinot Fushë	50.38 %	6.24 %	**10.30 %**	**10.45 %**	**19.17 %**	3.46 %
Labinot Mal	**81.02 %**	**1.00 %**	1.91 %	1.18 %	7.36 %	7.54 %
Papër	57.67 %	6.93 %	8.65 %	5.79 %	16.31 %	4.65 %
Shirgjan	49.30 %	8.42 %	**15.19 %**	7.78 %	15.32 %	3.99 %
Shushicë	63.84 %	5.34 %	**10.68 %**	3.59 %	10.81 %	5.74 %
Tregan	67.62 %	**2.01 %**	6.04 %	3.19 %	12.92 %	8.22 %
Zavalinë	**77.40 %**	**2.00 %**	2.00 %	1.20 %	15.9 %	1.40 %

Burimi: Bashkia Elbasan, 2015

Të dhënat e punësimit sipas sektorëve ekonomik për Bashkinë Elbasan konfirmojnë një trend të përgjithsëm të ngjashëm në nivelin kombëtar. Numri më i madh i të punësuarëve është në sektorin e shërbimeve me 51.4 %, më pas vjen ai i bujqësisë me 27.7 % dhe në fund ai i industrisë me 20.9 %. Në nivel qarku nuk ndodh i njëjti fenomen. Numri më i madh i të punësuarëve është në sektorin bijqësor me 47.7 %, shërbime me 37.4 % dhe më pas në industri me 14.9 %. Këto të dhëna konfirmojnë rënien e dukshme të sektorit industrial në Elbasan, i cili deri para viteve 1990 është konsideruar si një nga rajonet më të rëndësishëm industriale, me mbizotërim të industrisë së rëndë.

Figura 103. Punësimi në Bashkinë Elbasan, krahasuar me Qarkun dhe mesataren kombëtare, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Paga mesatare mujore sipas degëve të ekonomisë

Ndërsa të dhënat rreth pagës mesatare mujore sipas sektorëve ekonomik në nivel bashkie mungojnë, është e vlefshme analiza e tyre duke iu referuar sistemit kombëtar të pagave mujore për sektor, për të përfituar një tablo të përgjithshme të situatës ekonomike të të punësuarëve në Bashkinë e Re të Elbasanit.

Tabela 45. Paga mesatare mujore për një të punësuar në rang kombëtar (sektori privat dhe shtetëror), 2000-2013[311]

Aktiviteti ekonomik (2000-2013)	**lek**
Industri	37 646.42
Ndërtim	35 113.32
Transport e komunikacion	51 638.21
Tregti	31 733.86
Shërbime	34 447.18
Gjithsej	36 331.86


Burimi: Bashkia Elbasan, 2015

Paga mesatare mujore në Shqipëri në sektorin privat dhe atë shtetëror është më e ulta në rajon[312]. Sektorë të tillë si tregtia, industria dhe shërbimet ofrojnë një pagë mesatare bruto rreth 30 000-35 000 lekë/muaj[313]. Nuk ka të dhëna mbi nivelin mesatar të pagës për sektorin e bujqësisë, por paga minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimit të kujdesit shëndetësor sipas Drejtorisë së Përgjithsme të Tatimeve, për personat e vetëpunësuar në bujqësi, është 4 620 lekë [314]. Mungojnë të dhënat nëse të punësuarit/vetëpunësuarit në bujqësi marrin pagë minimale apo mesatre mujore dhe sa është vlera e tyre nivel njësie administrative apo qarku. Megjithatë në bashkinë Elbasan punësimi në bujqësi zë 27.7% të punësimit të përgjithshëm, një pjesë të konsiderueshme ndaj punësimit total, dhe nëse do të përllogariten të ardhurat minimale mujore që meren nga sektori bujqësisë, do të rezultonin më të ulëta se të ardhurat që përdoren për të përcaktuar nivelin e përgjithsëm të varfërisë.[315]

- **Punësimi sipas nivelit arsimor**

Punësimi sipas nivelit arsimor kategorizon të punësuarit sipas raportit të të punësuarëve me arsimi specifik (bazik, të mesëm apo të lartë) mbi numrin e përgjithsëm të të punësuarëve në Bashkinë e Elbasanit. Këto të dhëna na shërbejnë për të kuptuar nivelin e edukimit të forcës aktive të punësuar në bashkinë Elbasan. Kështu, 42.1% e të punësuarëve janë më arsim bazik 8-9 vjeçar, përkundrejt 38.1 % të të punësuarëve në rang kombëtar me të njejtin nivel arsimor.

Figura 104. Punësimi sipas nivelit arsimor në Bashkinë Elbasan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Në të njëjtin drejtim, numri i të punësuarëve në Bashkinë Elbasan me arsim të mesëm, profesional dhe të lartë është më i vogël se ai në rang kombëtar. Këto të dhëna dëshmojnë se forca punëtore e punësuar në Bashkinë Elbasan është më pak e kualifikuar se ajo në nivel kombëtar. Në nivel Qarku, numri i të punësuarëve me arsim të mesëm ose të lartë është edhe më i vogël. Tabela e mëposhtme pasqyron një trend domethënës për nivelin arsimor të të punësuarëve në zonat me karakter urban dhe rural në bashki. Kështu prsh. në qytetin e Elbasanit, numri i të punësuaruavë me arsim të mesëm/profesional dhe universitar/pas universitar është shumë herë më i lartë së në të gjitha njësitë e tjera. Kjo shpjegohet me faktin se njësitë administrative rurale punësojnë një numër të madh banorësh në sektorin bujqësor ekonomik, i cili nuk kërkon kualifikime të mëdha. Gjithashtu numri i shkollave të mesme në njësitë e tjera administrative të Elbasanit vijon nga 0 në 1 shkollë/njësi[316], duke ia vështirësuar aksesin në arsimin e mësëm banorëve në këto njësi. Duke qënë se Shqipëria është një vend me shkallë të lartë mobiliteti sidomos nga zonat rurale në ato më urbane, forca punëtore duhet të kualifikohet më tepër nëse do të jetë konkurruese në treg në rast lëvizjesh brënda bashkisë Elbasan, apo më gjërë në rajon. Ndërtimi i shkollave të mesme të profilizuara dhe nxitja e të rinjëve të ndjekin arsim të mesëm profesional shihen të domosdoshme për kualifikimin e mëtejshëm të fuqisë punëtore.

Tabela 46. Punësimi sipas nivelit arsimor sipas njësive administrative të Bashkisë Elbasan


	Me arsim fillor, 8 ose 9-vjeçar	Me arsim të mesëm dhe profesional	Me arsim të lartë
Bashkia Elbasan	42.10 %	35.70 %	21.10 %
Qarku Elbasan	53.60 %	31.00 %	14.30 %
Shqipëria	38.10 %	38.00 %	23.00 %
Elbasan	20.68 %	44.70 %	33.55 %
Bradashesh	65.99 %	27.23 %	5.30 %
Papër	69.60 %	24.71 %	4.90 %
Gracen	84.25 %	12.60 %	3.00 %
Funarë	78.45 %	18.00 %	2.80 %
Labinot-Mal	77.02 %	18.26 %	3.40 %
Labinot-Fushë	68.87 %	24.21 %	5.90 %
Shushicë	73.20 %	20.40 %	4.40 %
Shirgjan	62.78 %	30.38 %	5.90 %
Gjergjan	69.40 %	26.31 %	3.70 %
Tregan	74.66 %	20.30 %	4.50 %
Gjinar	58.64 %	31.82 %	7.90 %
Zavalinë	60.89 %	25.20 %	10.90 %

Burimi: Bashkia Elbasan, 2015

- **Shkalla e Papunësisë**

Në bazë të të dhënave të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë të vitit 2011, niveli i papunësisë në bashkinë Elbasan është 32.1 %, relativisht më i lartë se ai në rang kombëtar (29.3%).

Figura 105. Niveli i papunësisë



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Në Bashkinë Elbasan, femrat janë ato që e vuajnë më shumë papunësinë me 36.3 %, në krahasim me 29.6 % të meshkujve të papunë. Ky trend konfirmohet dhe në nivel qarku, edhe në nivel kombëtar. Niveli i papunësiç te të rinjtë e moshës 15-24 vjeç është 54.6 %, që tregon se më shumë se gjysma e të rinjëve në Bashkinë e Elbasanit janë të papunë.

Trendi i papunësisë në bashkinë Elbasan nuk është i njejtë për çdo njësi administrative. Njësia e Elbasanit është njësia me karakterin me urban në bashki dhe si rrjedhojë me një treg pune më dinamik dhe të lëvizshëm. Kurse njësitë e tjera administrative, me një nivel shumë të lartë të punësuarëve në sektorin bujqesor, me një treg të akomoduar pune dhe pothuaj të pandryshueshëm, karakterizohen nga një nivel shume i ulët i papunësisë.


Tabela 47. Papunësia në Bashkinë Elbasan

	Shkalla e papunësisë	**Femra**	**Meshkuj**	**Të rinj (15-24 vjeç)**
Bashkia Elbasan	32.1 %	36.3 %	29.6 %	54.6 %
Qarku Elbasan	27.1 %	29.5 %	25.6 %	48.3 %
Shqipëria	29.3 %	31.4 %	27.9 %	52.9 %
Elbasan	37.4 %	41.3 %	34.6 %	**67.5 %**
Bradashesh	29.1 %	37.0 %	25.2 %	**58.3 %**
Papër	20.7 %	21.5 %	20.4 %	32.9 %
Gracen	34.4 %	24.0 %	39.4 %	**53.0 %**
Funare	**5.60 %**	4.40 %	6.30 %	12.0 %
Labinot-Mal	**14.1 %**	17.1 %	12.8 %	27.6 %
Labinot-Fushë	31.0 %	37.2 %	29.2 %	46.0 %
Shushicë	22.3 %	27.6 %	20.0 %	40.4 %
Shirgjan	21.7 %	24.6 %	20.3 %	38.7 %
Gjergjan	22.3 %	19.8 %	23.4 %	34.2 %
Tregan	34.0 %	33.3 %	34.3 %	**54.0 %**
Gjinar	28.6 %	20.8 %	32.0 %	46.4 %
Zavalin	**14.3 %**	19.9 %	11.7 %	31.8 %

Burimi: Census 2011, INSTAT

Niveli më i madh i papunësisë në bashkinë Elbasan është në njësinë administrative të Elbasanit me 37.4 %. Disa nga njësitë administrative me nivelin më të ulët të papunësisë janë Funara me 5.6 %, Labinot-Mali me 14 % dhe Zavalina me 14.3 %. Të gjitha njësitë e tjera kanë nivel papunësie më të madh se 20 %. Shifrat reflektojnë një dukuri alarmane për punësimin e të rinjëve në këto njësi. Në njësinë e Elbasanit, 67.5% të rinj të moshave 15-24 vjeç janë të papunë. Përveç Funarës (12 %), i njejti trend konfirmohet për të gjitha njësitë e tjera.

Figura 106. Papunësia në Bashkinë Elbasan, sipas njësive administrative



Burimi: Census 2011, INSTAT

Të dhënat e mësipërme janë të dhëna të marra në bazë të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë të vitit 2011. Megjithatë papunësia llogaritet edhe sipas të dhënave administrative për numrin e të papunëve, të cilat marrin për bazë punëkërkuesit e papunë të regjistruar në zyrat e punës, dhe popullsinë e përgjithshme aktive, e cila përfshin zonën urbane dhe rurale. Zakonisht kjo papunësi është më e ulët se ajo me bazë censusin e popullsisë, pasi jo të gjithë të papunët i drejtohen administratës shtetërore për të kërkuar ndihmë që të punësohen. Në nivel bashkie të dhënat mungojnë, por në nivel qarku ato pasqyrohen në Tabelën 107.

Figura 107. Punëkërkues aktivë në nivel Qarku Elbasan, Vjetari statistikor, INSTAT 2015

Gjithësej	Femra	Të rinj	Arsim 9-vjeçar	Arsimi të mesëm të përgjithshëm	Arsimi të mesëm professional	Me arsim të lartë
16.308	7.774	2.797	9.032	5.263	1.773	241

Burimi: Census 2011, INSTAT

- **Shëndetësia**

Shpërndarja e shërbimit shëndetësor

Sektori i shërbimit shëndetësor në Bashkinë Elbasan përbëhet nga 1 spital rajonal, i cili do të zgjerohet, 1 spital kombëtar psikiatrik, 14 qendra shëndetësore dhe 81 ambulanca/qendra konsultore.

Shqipëria është një nga vëndet e Ballkanit me numrin më të vogël të stafit mjekësor, me 1.14 mjekë për 1000 banorë (WHO, 2014) ose 1 mjek për 887 banorë[317]. Kurse, mesatarja në BE është 3.4 mjekë për 1000 banorë ose 1 mjek për 295 banorë[318]. Ndërkohë, në bashkinë e Elbasanit ky raport është 4 herë më i madh, ku një mjek i shërben statistikisht 1266 banorëve[319]. Mungesa e stafit mjekësor është edhe më e theksuar në njësitë administrative (ish-komunat para reformës territoriale) të Funarës, Gjergjanit, Labinot-Fushës, Labinot Malit, Papërit, Shushicës, etj, ku raporti banorë/mjekë shkon më tepër se 2500, pothuaj 10 herë më shumë se mesatarja e BE-së. Megjithatë, kjo analizë injoron rrezen e shpërndarjes së mjekëve, e cila nëse do të konsiderohej do të pasqyronte një tablo edhe më të përkeqësuar. Kështu, sipas të dhënave të strategjisë së mëparshme t zhvillimit, një mjek mbulon mbi 13 mije banorë në qytetin e Elbasanit320 dhe lihen pothuaj të pambuluara zona të tëra banimi në njësitë rurale të Bashkisë.

Tabela 48 Treguesit e shërbimit shëndetësor në Bashkinë Elbasan[321]

Njësia	Qendra shëndetësore	Ambulanca	Raporti banorë/ambulanca	Nr. Mjekësh	Raport banorë / mjekë	Shtertër	Raporti shtretër/banorë
Elbasan	4	12	6682	86	932	400	200
Bradashesh	1	14	778	4	**2725**	13	838
Funarë	1	7	308	1	**2162**		
Gjergjan	2	6	870	2	**2611**		
Gjinar	1	6		2	1771		
Gracen	1	5	446	2	1116		
Labinot Fushe				3	**2397**		
Labinot Mal	1	6	898	2	**2695**		
Papër	1	12	539	3	**2156**		
Shirgjan				3	**2481**		
Shushicë	1	8	1111	3	**2965**		
Tregan		11	281	2	1546	13	237
Zavalinë	1			1	1653		
TOTAL	14	81	1412	114	***1266***	426	339

Burimi : Bashkia Elbasan, 2015

Sipas VKM nr. 671 një qendër shëndetësore duhet planifikuar për çdo 250 – 1500 banorë, dhe ambulancat/konsultore duhen planifikuar 1 për 1500-2000banorë[322]. Në qytetin e Elbasanit janë 4 qendra shëndetësore, për një popullësi mbi 80 mijë banorë. Njësitë e tjera adminsistrative kanë të paktën një qëndër shëndetësore për njësi, pavarsisht numrit të popullsisë apo dëndësisë së vendbanimeve. Të dhënat e kalkuluara për secilën njësi administrative të Bashkisë Elbasan, tregojnë se ambulancat mbulojnë mesatarisht 6 mijë banorë në qytetin e Elbasanit dhe variojnë nga 300 dei në 1000 për njësitë e tjera. Megjithatë, nga analiza në terren, vërehet se shpërndarja e tyre në territor nuk është e njejtë. Kështu prsh, në qytetin e Elbasanit, rajoni 3,4 dhe 5 ka vetëm një ambulancë dhe mbulon mbi 20 mijë banorë të zonës. Të dhënat e grupuara sipas rajoneve, tregojnë se në qytetin e Elbasanit ka afërsisht 1 ambulancë për 11 mijë banorë[323]. Në njësitë e tjera administrative

është zbatuar standarti i planifikimit të 1 ambulance për 250-1200 banorë, por shpërndarja dhe infrastruktura e varfër e vështirësojnë aksesin në shëbimin shëndetësor.

Përgjithësisht, ambulancat dhe qendrat shëndëtësore shfaqin një infrastrukturë fizike të dobët. Nevojitet ndërhyrja e mënjëherëshme për rikonstruksionin e 4 ambaluancave jo-funksionale, 2 në Bradashesh dhe 2 në Papër. Për më tepër, nevojitet ndërhyje dhe rikonstruksion i pjesshëm në njësitë e Gjinar (qendra shëndetësore ka patur rikonstruksion të pjesshëm); Tregan (2 ambulanca janë në gjëndje të amortizuar fizike); në Gjergjan ; Shushicë (qendra shëndetësore në Qafë është komplet e amortizuar); Zavalinë, etj.

Vdekshmëria foshnjore

Krahasuar me vendet e rajonit, Shqipëria renditet si vendi i parafundit me tregues për vdekshëmrinë foshnjore më negative në Balkan, me 7.9 foshnja të vdekura/1000 lindje krahasuar me mesataren e BE-së, e cila është 3.7/1000 lindje.[324] Për qytetin e Elbasanit ky tregues është 42 vdekje foshnjore për 3894 lindje ose 10.8 vdekje për 1000 lindje[325], një tregues shumë i lartë për një zonë urbane. Për zonat rurale dhe krysisht në njësitë e tjera administrative, vdekshmëria foshnjore është zakonisht edhe më e lartë[326]. Ky është një tregues i rendësishme i kushteve shëndetësore në lidhje me kushtet e higjenës, infrastrukturës si aksesueshmëria në qendra shëndetësore, dhe nivelit të arsimit dhe informacionit të duhur për nënat shtatëzane.

Lindshmëria dhe Vdekshmëria


Përgjithësisht, në Bashkinë Elbasan konfirmohet i njejti trend kombëtar, ku lindshmëria sa vjen dhe ulet. Në 5 vitet e fundit, në disa njësi administrative në bashkinë Elbasan si Gjinar, Shirgjan, etj. numri i lindjeve është ulur me rreth 50 %[327]. Në të gjithë bashkinë, trendet e lindshmërisë dhe vdekshmërisë vijnë duke u ulur, gjë që sygjeron të fillohet planifikimi për një popullsi në plakje. Mendohet se grupmosha aktive 15-65 vjeç do të rritet me 3 % në vitin 2030[328].

Personat me aftësi të kufizuar

Tabela 49. Personat me aftësi të kufizuar

Personat me aftësi të kufizuara:	**Bashkia Elbasan**	**Shqipëria**
Në shikim	2.3 %	2.3 %
Në dëgjim	1.7 %	1.7 %
Në kujtesë	1.8 %	1.8 %
Në kujdesin e përditshëm	1.7 %	1.8 %
Në komunikim	1.5 %	1.5 %
Në lëvizje	3.7 %	3.7 %
Personat me të paktën një aftësi të kufizuar	6.3 %	6.2 %

Figura 108. Personat me aftësi të kufizuar



Numri i personave me aftësi të kufizuar në Bashkinë Elbasan është pothuajse i njejtë me atë në nivel kombëtar. Rreth 6.3 % e popullsisë banuese në Bashkinë e Re të Elbasanit ose rreth 9100 persona kanë deklaruar se kanë të paktën një aftësi të kufizuar[329]. Numri më i madh i personave me aftësi të kufizuar i përket atyre që vuajnë nga kufizimet në lëvizje me 3.7 % në nivel bashkie. Në disa njësi administrative si Zavalinë (15.25%), Gracen (10.88), Gjinar (9.44%), ka një numër të madh personash me të paktën një aftësi të kufizuar Këto janë të dhëna shumë e rendësishme statistikore, pasi është i domosdoshëm planifikimi i ndërtimeve të reja publike dhe private, në mënyrë që të lehtësohen barrierat fizike për personat me aftësi të kufizuara.

Pavarësisht një numri të konsiderueshëm personash me aftësi të kufizuara, nuk ekziston asnjë institucion publik ose privat që të ofrojë shërbimeve sociale për këtë kategori. Në fakt, në nivel qarku shihet se ekziston vetëm 1 institucion publik që ofron shërbim social dhe ky është kryesisht për të moshuarit. Nga ana tjetër, 10 institucione jo-publike ofrojnë shërbime sociale për fëmijët dhe familjet dhe komunitetet. Kategori si gratë dhe vajzat, të rinj me probleme sociale dhe persona me aftëzi të kufizuar nuk marrin shërbim social në nivel qarku. Kuptohet që edhe në nivel bashkie, këto grupe nuk asistohen nga shërbimet sociale. Megjithatë, në bashkinë Elbasan operojnë 328 kujdestarë të shërbimeve sociale (përjashtuar qytetin e Elbasanit). Me gjithe dinamikën e zhvillimeve socio-ekonomike në Qark, kështillohet ndërtimi i kapaciteteve i institucioneve ekzistuese për ofrimin e shërbimit përkatës social dhe ndërtimi i institucioneve për të ofruar këto shërbime.

Tabela 50. Shërbimet sociale në Qarkun Elbasan[330]

Qarku Elbasan	**Publike**	**Jo publike**
Shërbime sociale për të moshuar	1	1
Shërbime sociale për gra dhe vajza	0	0
Shërbime sociale për për fëmijët	1*	7
Shërbime sociale për për familjet dhe komunitetet	0	2
Shërbime sociale për PAK	0	0

Shërbime sociale për të rinj me probleme sociale	0	0
Gjithësej	1	10

Burimi: Bashkia Elbasan, 2015


- **Mirëqënia ekonomike**

Burimi *i të ardhurave të Njësi Ekonomike Familjare (NjEF)*

Në Bashkinë Elbasan, rreth 13.5 % të familjeve marrin ndihmë sociale dhe përfitime (transferta të tjera) nga shteti në krahasim me 11.7 % të familjeve në rang vendi[331]. Në nivel qarku, ky numër shfaqet edhe më i lartë me 15.16 % të familjeve përfituese. Burimi i të ardhurave të NjEF-së nga puna e paguar ose vetëpunësimi është më i ulët në nivel bashkie dhe qarku, përkatësisht 51.8 % dhe 54.60 % krahasuar me nivelin kombëtar me 56.4 %. Burimi i të ardhurave nga të gjitha llojet e pensioneve për Bashkinë e Elbasanit është 31.7 %, pothuaj në të njejtat nivele si ato kombëtare. Nga ana tjetër, 10.1 % të familjeve të Bashkisë së Elbasanit kanë si burim të ardhurash dërgesat nga jashtë shtetit përkundrejt 8.6 % të familjeve në rang kombëtar. Ky nivel është edhe më i lartë në nivel qarku, ku 12.98 % të familjeve që jetojnë në qarkun Elbasan kanë si burim të ardhurash para të dërguara nga jashtë shtetit.

Këto të dhëna tregojnë se afërsisht gjysma e popullsisë siguron të ardhurat jo nga puna e paguar ose vetëpunësimi, por nga shteti në formën e ndihmave sociale dhe pensioneve dhe nga para të dërguara nga jashtë shtetit.

Figura 109. Burimi i të ardhurave te NJEF-së



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Në disa njësi administrative në bashkinë Elbasan, burimi i të ardhurave të NJEF-ve nga ndihma ekonomike sociale dhe përfiime të tjera është disa herë më e lartë se mesatarja kombëtare. Kështu prsh. numri i familjeve që përfitojnë ndihmë sociale në disa njësi si Graceni (20.56%), Funara (32.5%), Labinot Mal (35.76%), Gjinar (25.65%), Zavalinë (34.45%) është mesatarisht 4 ose 5 herë më i lartë se në njësitë e tjera të Bashkisë. Në njësitë Papër (4.93%), Shushicë (5.47%), Tregan (6.08%), numri i familjeve që përfitojnë ndihmë sociale është i vogël, por në këto njësi numri i familjeve që sigurojë të ardhura

nëpërmjet remitancave të dërguara nga jashtë është edhe më i larti në bashki. As gjysma e familjeve në Funarë (37.27%), Gracen (44.35%), Labinot Mal (41.33), Gjinar (48.17%) nuk sigurojnë të ardhurat nëpërmjet punës së paguar apo vetëpunësimit, gjë që dëshmon për një nivel të ulët të ardhurash në përgjithësi në këto njësi.


Tabela 51. Burimi i të ardhurave të NjEF-ës, sipas njësive administrative Elbasan

	Ndihmë sociale dhe përfitime	Punë e paguar ose vetëpunësimi	Të gjitha llojet e pensionit	**Para të dërguara nga jashtë shtetit**
Elbasan	13.4 %	50.47 %	35.42 %	7.88 %
Bradashesh	12.55 %	52.29 %	21.11 %	6.41 %
Papër	4.93 %	52.2 %	26.73 %	26 %
Gracen	**20.56 %**	44.35%	23.19 %	1.81 %
Funare	**32.5 %**	37.27%	44.77 %	10 %
Labinot-Mal	**35.76 %**	41.33 %	31.8 %	4.71 %
Labinot-Fushë	**16.75 %**	55.48 %	24.28 %	11.57 %
Shushicë	5.47 %	62.01 %	24.97 %	16.57 %
Shirgjan	9.03 %	57.73 %	21.16 %	16.79 %
Gjergjan	7.46 %	59.54 %	23.02 %	16.5 %
Tregan	6.08 %	52.52 %	29.38 %	17.8 %
Gjinar	**25.65 %**	48.17 %	36.26 %	14.14 %
Zavalinë	**34.45 %**	56.81 %	39.07 %	6.94 %

Burimi: Bashkia Elbasan, 2015

Si dhe mund të shihet nga Figura mëposhtë burimi i të ardhuravë të NJEF-së është shumë i ndryshëm brënda njësive të ndryshme të bashkisë Elbasan.

Figura 110. Burimi i të ardhurave të NJEF-së sipas njësive administrative në Bashkinë Elbasan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

- **Varfëria**

Tabela 52. Varfëria në qarkun e Elbasanit, Vjetari statistikor 2015

Treguesit e varfërisë			
	Qarku	Përqindja Ashpërsia (%)	Hendeku (%)
Elbasan	10.7	2.3	0.8
Shqipëria	14.3	2.9	1,0

Burimi: Bashkia Elbasan, 2015

Të dhënat për qarkun e Elbasanit tregojnë se përqindja e varfërisë është 10.7 % në krahasim me 14.3 % të varfërisë në nivel kombëtar[332]. Qarku Elbasan konsiderohet si një nga qarqet me shkallën më të ulët të varfërisë në vend. Hendeku i varfërisë tregon se sa larg janë individët nga linja e varfërisë. Qarku elbasanit ka një hendek varfërie 2.3 %, relativisht më të ulët se ai kombëtar me 2.9%. Ky hendek varfërie prej 2, 3 % do të thotë se shuma e përgjithshme që do t'u duhej të varfërve për të arritur nivelin e linjës së varfërisë është ebarabartë me popullsinë shumëzuar me 2.3 % të linjës së varfërisë[333]. Treguesi tjetër është ashpërsia e varfërisë, që tregon pabarazisë midis të varfërve. Qarku Elbasan me 0.8 % nivel ashpërsie shfaqet relativisht më mirë se niveli kombëtar me nivelin 1%.

1.6 Zhvillimi ekonomik urban dhe rural

1.6.1 Vlerësimi ekonomik dhe sektorët

Analiza e zhvillimit ekonomik trajton prirjet kryesore të zhvillimi të Bashkisë Elbasan në aspektin ekonomik, duke u mbështetur në të dhëna si Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB), Vlera e Shtuar Bruto (VSHB), ndërmarrjen ekonomike që operojnë territorin e bashkisë, punësimin sipas sektorëve, etj. Ndryshimi i kufirit administrative, me reformën administrative në maj 2014, edhe prirjet e zhvillimit ekonomik kanë ndryshuar. Fakti që territori i Elbasanit është rritur disa herë dhe territoret të cilat janë përfshirë kanë karakter rural, ka sjell ndryshime në vendosjen e prioriteteve për zhvillimin ekonomik.

- **Produkti i Brendshëm Bruto (PBB)**

Produkti i Brendshëm Bruto është një tregues i vlerës së tregut të të gjithë të mirave dhe shërbimeve përfundimtare të prodhuar në një vend. PBB përfshin prodhimet dhe shërbimet aktuale, të destinuara për treg dhe ato të prodhuara për konsum vetjak nga të gjitha njësitë rezidente, që veprojnë territorin e një shteti.

Referuar të dhënave të INSTAT, PPB për frymë në nivel kombëtarë është 460 mijë lekë, ndërsa në qarkun e Elbasanit 346 mijë lekë, pra rreth 25% më i ulët në raport më PPB për frymë në nivel kombëtar. Pesha që zë PBB e qarkut Elbasan në vlerën e përgjithshme të PBB-s kombëtare vlerësohet 7.9%, çka tregon për rëndësinë e Elbasanit në ekonominë kombëtare. Qarku i Elbasanit është qarku i katërt për nga rëndësia ekonomike.

Duke u mbështetur në të dhënat e mëposhtme PBB për frymë në Qarkun e Elbasanit ka ardhur duke u rritur në mënyrë graduale nga viti 2000 deri në 2008. Në vitin 2009 kemi një rritje prej 1.5%, rritja me e madhe e PBB dhe në vitin 2010 është shënuar rritja më e madh me 6.6% për periudhën 2000-2010. PBB për frymë, në vitin 2012 ka pësuar një rënie me 1.9%.

Tabela 53. PBB për frymë e Qarkut të Elbasanit në raport me nivelin kombëtar

Vendi	Struktura e PBB	PBB për frymë në lekë	Struktura e indeksit për frymë ndaj PBB-së (%)
Shqipëria	100%	460436	100
Qarku Elbasan	7.9%	346054	75.2

Burimi: INSTAT 2012

Tabela 54. Struktura e PBB ndër vite

Viti	2000	2001	2002	2003	2004	2005
PBB për frymë në lekë	128,307	143,553	150,502	169,194	188,137	211,835
Viti	2006	2007	2008	2009	2010	2012
PBB për Frymë në lekë	230,213	243,640	278,698	286,865	352,000	346,054

Burimi: INSTAT 2012

Tabela 55. PBB për frymë e Qarkut të Elbasanit ndër vite në raport me nivelin kombëtar

Viti	2008	2009	2010	2011	2012
Qarku Elbasan	68.1%	69.4%	76.1%	77.3%	75.2%

Burimi INSTAT 2012

- **Vlera e Shtuar Bruto (VSHB) dhe produktiviteti i sektorëve**

Vlera e shtuar bruto përfaqëson kontributin e aktiviteteve të ndryshme në PBB, llogaritet si diference midis prodhimit dhe konsumit të ndërmjetëm. Vlerën e Shtuar Bruto më të lartë, në qarkun e Elbasanit, e ka sektori i shërbimeve me 43.50%, ku 23.60% e zënë shërbimet e tjera dhe 16.30% tregti, hotele, restorante. Sektori i dytë me VSHB-në më të lartë është bujqësia me 34.10%, më pas renditet industria me 14.20% dhe e fundit renditet ndërtimi me 8.20%.

Tabela 56. VSHB sipas degëve të ekonomisë në Qarkun Elbasan

	Bujqësi & Peshkim	Industri total	Industri nxjerrëse	Industri përpunuese	Ndërtim	Shërbime total	Tregti, hotele, restorante	Transport	Postë dhe telekomuni kacion	Shërbime të tjera
VSHB	34.10%	14.20%	1.60%	12.60%	8.20%	43.50%	16.30%	2%	1.50%	23.60%

Burimi: INSTAT 2012

Vlera e produktivitetit llogaritet si raport i vlerës së VSHB-së të sektorit me numrin e punonjësve në atë sektor. Nga Tabela mëposhtë, produktivitetin më të lartë e ka sektori i industria me 3.72, më pas është bujqësia me produktivitet 2.8 dhe në të e fundit për nga produktiviteti renditen shërbimet me 1.68.


Tabela 57. Produktiviteti në sektorin e Industrisë dhe të Shërbimeve

Sektori	VSHB sipas sektorit	Numri i punonjësve për sektor	Produktiviteti
Industria	59818	16067	3.72
Shërbimet	68135	40328	1.68
Bujqësia	144037	51436	2.8

Burimi INSTAT 2012

Në Figurën mëposhtë paraqitet lëvizja e të punësuarve nga njëra zonë tjetrën, e cila është tregues i ndërveprimin ekonomik ndërmjet zonave. Qendrat urbane janë ofruese të infrastrukturave, shërbimeve dhe punësimit ndërsa qendrat rurale janë furnizuese me produkte bujqësore dhe me fuqinë punëtore (Raporti i Zonave Funksionale, f. 164). Ndërveprimi më i madh ndodh ndërmjet Elbasanit dhe Shirgjanit dhe Elbasanit dhe Labinot Fushës, ku lëvizja e të punësuarve është 27-40%. Ndërveprimi ekonomik është mesatar (12-26%) ndërmjet Elbasan-Gjinar, Elbasan-Zavalinë, Elbasan-Shushicë, Elbasan-Labinot Mal, Elbasan-Funarë, Papër-Bradashesh, Tregan-Elbasan. Zonat rurale si Gracen-Bradashesh, Funarë-Bradashesh, Shirgjan-Tregan, Shirgjan-Zavalinë kanë ndërveprim më të ulët ndërmjet tyre, 3-11% e të punësuarve.

Figura 111. Harta e ndërveprimit ekonomik në ZF Elbasan: Përqendrimi i bizneseve dhe drejtimi i lëvizjes për punë



Burimi: Raporti i Zonave Funksionale Ministria e Çështjeve Vendore, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Në territorin e Elbasanit ndodhen 7 pika grumbullimi, për produktet bujqësore, 6 pika grumbullimi ndodhen në Bradashesh (fshati Balëz) dhe një në Gjergjan (fshati Muriqan). Në qytetin e Elbasanit ndodhen katër tregje, dy tregje fruta perimesh (250 vende), njëri prej të cilëve është treg rajonal, një treg industrial (225 vende) dhe një treg shumice (42 vende).

- **Prirjet e ndërmarrjeve ekonomike**

Tabela 58. Ndërmarrjet sipas aktiviteti ekonomik në Qarkun Elbasan

		Të mira		
	Prodhues të mirash total	**Bujqësi, Pyje, Peshkim**	**Industria**	**Ndërtimi**
2013	1,057	90	768	199

2013	14.20%	1.20%	10.30%	2.70%
2014	1,094	107	794	193
2014	14%	1.40%	10.10%	2.50%

Shërbime

	Prodhues shërbimesh total	Tregtia	Transport, magazinim	Akomodim, shërbime sociale	Informacioni, komunikacioni	Shërbime të tjera
2013	6,385	3,172	806	1,156	156	1095
2013	85.80%	42.60%	10.80%	15.50%	2.10%	14.80%
2014	6,705	3,354	800	1,253	168	1,190
2014	86%	42.70%	10.20%	15.90%	2.10%	15.10%

Burimi: INSTAT Vjetari Statistikorë 2015

Bizneset sipas llojit të aktivitetit ndahen në prodhues të mirash dhe shërbimesh. Ndërmarrjet aktive që prodhojnë të mira përbëjnë 86% dhe prodhuesit e shërbimeve 14%. Nga viti 2013 deri në vitin 2014 ka pasur një ndryshim me 0.2 % tkurrje të prodhuesve të të mirave kundrejt prodhuesve dhe shërbimeve. Prodhuesit e të mirave ndahen në 3 kategori: a) bujqësia, b) pyjet dhe peshkimi, c) industria dhe ndërtimi. Bujqësia pyjet dhe peshkimi, që vlerësohen 1.4 %, në vitin 2014 ka pësuar një rritje me 0.2% krahasuar me vitin 2013. Sektori i Industrisë dhe i ndërtimit kanë pësuar ulje me 0.2% nga vitit 2013 në vitin 2014. Prodhuesit e shërbimeve ndahen në 5 kategori: a) tregti, b)transport, magazinim, c) akomodim, shërbime sociale, d) informacion komunikim dhe e) shërbime të tjera. Sektori më i zhvilluar në kategorinë e shërbimeve është tregtia, i cili nga 42.6% në vitin 2013 është rritur në 42.7% në vitin 2014. Sektori i transportit dhe magazinimit ka pësuar tkurrje me 0.6%, nga 10.8% në vitin 2013 në 10.2% në vitin 2014. Akomodimi dhe shërbimet sociale janë rritur nga 15.5% në vitin 2013 në 15.9% në vitin 2014. Sektori i informacionit dhe komunikimit nuk ka pësuar ndryshime, ndërsa sektori i shërbimeve të tjera janë rritur me 0.3% nga viti 2013 në vitin 2014.


Tabela 59. Ndërmarrjet ekonomike në Bashkinë Elbasan

Njësia administrative /Bashki	Bujqësia dhe Peshkimi	Industria	Ndërtimi	Tregtia	Shërbimet			Shërbime Total
					Hotele, kafe, restorante	Transporti, Komunikacioni	Shërbime Të tjera	
Elbasan	8	347	90	1788	479	425	570	1474
Bradashesh	-	67	5	97	48	35	23	106
Funarë	4	-	-	2	-	9	-	12
Gjergjan	-	7	-	21	6	13	-	22
Gjinar	-	3	-	6	4	14	4	22
Gracen	7	4	-	8	13	8	7	28
L. Fushë	-	11	-	48	25	16	6	47
L. Mal	-	-	-	-	-	12	-	16
Papër	-	13		31	27	14	5	46
Shirgjan	7	30	10	53	28	17	16	61
Shushicë	-	17	-	36	15	23	6	44
Tregan	-	-	-	9	29	10	8	47
Zavalinë	-	-	-	-	-	-	-	6
	26	499	105	2099	674	596	645	1931

Bashkia Elbasan	0.70%	10.70%	2.20%	45%	14.60%	12.90%	13.90%	41.40%

Burimi: INSTAT 2012

Figura 112. Ndërmarrjet ekonomike në Bashkinë Elbasan



Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Në Figurën më lart shohim që sektori me peshën kryesore në bashkinë Elbasan është tregtia me rreth 45 % të bizneseve, kryesisht bizneset të vogla (njësi të e vogla tregtare). Në territorin e Elbasanit ka shumë biznese të mëdha, të cilat merren me eksport dhe import mallrash të ndryshme. Shërbimet janë sektori tjetër më i zhvilluar me vlerën 41.1%, shërbimet që takohen më shumë janë hotele, bare, restorante, biznese transporti apo shërbime të tjera. Në total hotelet, baret dhe restorantet zënë 14.6% ndërsa transporti dhe komunikacioni 12.9% dhe shërbimet e tjera 13.9%. Një sektor tjetër i rëndësishëm është industria me 10.7% të bizneseve. Në këtë sektor kemi të bëjmë me biznese të mëdha siç mund të jenë fabrikat, por ka dhe biznese të vogla si punishtet industriale. Sektori i ndërtimit zë 2.2% të totalit të bizneseve, ndërsa sektori i bujqësisë zë 0.7%. Sektori i ndërtimit ka pësuar ulje vitet e fundit.

- **Prirjet e bujqësisë**

Sektori ekonomik i bujqësisë luan rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të bashkisë Elbasan. Në zonat rurale bujqësia përbën sektorin primar të ekonomisë, ku pjesa më e madhe e popullsisë janë të punësuar në këtë sektor.

Në Qarkun e Elbasanit sektori kryesor ekonomik është sektori bujqësor. Ky qark ka rreth 10.4 % të tokës bujqësore në rang kombëtar dhe 11.7 % të tokës pyjore dhe kullotave në rang kombëtarë çka dëshmon për potencialin bujqësor dhe natyror që ka.

Të ardhurat nga bujqësia në qark vlerësohen me 6.5% të të ardhurave totale të bujqësisë (në rang kombëtar) dhe të ardhurat nga blegtoria vlerësohen 9.6% të të ardhurave totale blegtorale (në rang kombëtar). Gjithashtu, të ardhurat nga produktet e ndryshme bujqësore vlerësohen me 4.1 % të totalit dhe të ardhurat nga produktet të ndryshme blegtorale vlerësohen me 20.7% të totalit. Këto të dhëna na ndihmojnë të kuptojmë se Qarku i Elbasanit ka një potencial të madh bujqësor dhe kryesisht është i orientuar drejt sektorit

blegtoral kundrejt atij bujqësor[334].

Tabela 60. Prodhimi sipas kulturave bujqësore

	Sipërfaqe ha	Rendimenti kv/ha	Prodhimi kv
Drithëra buke gjithsej	1,798.1	410.5	64,898
Perime gjithsej	650.3	19,836.5	156,133
Patate	311.0	1,975.0	48,330
Fasule direkte gjithsej	293.0	259.0	5,826
Kultura industriale	220.0	3,103.0	12,685
Duhan	220.0	3,103.0	12,685
Foragjere gjithsej	5,685.0	188.4	1,071,254

Burimi: Drejtoria e Statistikave Bashkia Elbasan, nëntor 2015

Në Tabelën e mësipërme paraqitet sasia e prodhimit të kulturave të ndryshme bujqësore në Bashkinë Elbasan. Prodhimet me sasinë me të lartë janë drithërat dhe pemëve frutore. Duke qenë se Elbasani ka sipërfaqe të konsiderueshëm natyrore, ka potencial për mbjelljen e pemëve frutore.

Tabela 61. Prodhimet blegtorale në Bashkinë Elbasan dhe në Qarkun Elbasan

	Bashkia Elbasan	Qarku Elbasan
Qumësht Total (ton)	50,212	142,000
Mish Total (ton)	2,425	17,000
Vezë (000\ kokrra)	15,340	77,600
Mjaltë prodhim (ton)	261	300

Burim: Drejtoria e Statistikave Bashkia Elbasan nëntor 2015 (të dhënat në nivel bashkie), INSTAT 2014, (të dhënat e Qarkut)

19% e prodhimeve blegtorale të Qarkut Elbasan, prodhohen në Bashkinë Elbasan. Prodhimi i qumështit është produkti me prodhimin më të lartë në Bashkinë Elbasan dhe produkti i dytë blegtoral më sasinë më të lartë të prodhimit janë vezët. Edhe prodhimi i mjalti zë peshë kryesore ndër prodhimet blegtorale, ku 87% e sasisë totale që prodhohet në qark, prodhohet në territorin e Bashkisë Elbasan.

- **Analiza e bujqësisë në Bashkinë Elbasan**

Kuadri Ligjor për bujqësinë, tokën bujqësore dhe zhvillimin rural

Sipas ligjit nr. 9817 datë 22.10. 2007 "**Për bujqësinë dhe zhvillimin rural**", objektivat e përgjithshme të qeverisë në lidhje me zbatimin e politikave bujqësore dhe zhvillimin rural lidhen me rritjen e të ardhurave për popullsinë rurale, rritjen e prodhimit të përgjithshëm kombëtar, duke garantuar cilësi dhe siguri ushqimore dhe në të njejtën kohë duke ruajtur dhe mbrojtur mjedisin. Përsa i përket rolit dhe funksioneve të qeverisë lokale në këtë drejtim, ligji nr. 139/2015, **"Për vetëqverisjes Vendore"** i ndryshuar, përmbledh funksionet e zgjeruara të bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave pas reformës administrative territoriale, duke përfshirë: administrimin e infrastrukturës vendore të ujitjes dhe kullimit, menaxhimin e pyjeve dhe kullotave vendore si dhe menaxhimin e institucioneve në shërbim të këtyre fuksioneve. Për më tepër, bashkitë kanë përgjegjësi për krijimin dhe administrimin e skemave vendore të granteve për bujqësinë dhe zhvillimit rural, të financuara nga buxheti lokal dhe/ose me bashkëfinancim

nga të tretët; dhe janë përgjegjëse për shërbimin veterinar vendor, informacionin statistikor bujqësor dhe administrimin e kadastrës së tokave bujqësore.

Përsa i përket aspektit të planifikimit, objektivat e politikave të zhvillimit bujqësor dhe rural janë të lidhura me rritjen e sipërfaqes së tokave bujqësore të shfrytëzuara, për të rritur madhësinë mesatare të fermave e në këtë mënyrë për të rritur prodhimtarinë e sektorit (**Strategjia Ndërsektoriale për Zhvilllimin Rural dhe Bujqësor, 2014-2020**). Sipas legjislacionit në fuqi dhe ligjit 9244 datë 17.06.2004 **"Për mbrojtjen e tokës bujqësore"**, i ndryshuar, specifikohet mbrojtja e tokës nga ndërtimet, mbrojtja e shtretërve dhe brigjeve të lumenjve për parandalimin e erozionit si dhe zbatimi i një praktike të mirë bujqësore. Sipas këtij ligji, kthimi i tokës bujqësore në tokë urbane, mund të propozohet vetëm përmes një dokumenti planifikimi, sipas legjislacionit të planifikimit. Ndërtimi është i ndaluar, me përjashtim të ndërtimeve të përkohshme, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën dhe që janë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral, të cilësuara në Vendimin e KM nr. 283, datë 01.04.2015 **"Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore"**. Për të gjitha objektet për qëllime bujqësore duhet të respektohen distancat nga rrugët, çdo infrastrukturë tjetër publike, nga kanalet ujitëse e kulluese, si dhe brigjet e lumenjve, me sipërfaqe dhe kritere të veçanta të përcaktuar në pikat 1-12. Leja e ndërtimit lëshohet nga njësia e qeverisjes vendore në përputhje me dokumentin e planifikimit vendor.

Ndryshimi i tokës bujqësore në kategori të tjera burimesh si në tokë urbane, pyjore, kullotë, livadh dhe tokë e pafrytshme bëhet sipas përcaktimit në ligjin nr. 8752, datë 26.03.2001 **"Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës"** i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Më specifikisht, ligji cilëson që në tokat bujqësore të kategorisë së parë, dytë, tretë dhe katërt të bonitetit mundësohet kalimi në sipërfaqe për ndërtime me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm për rastet e domosdoshme si infrastukturë (rrugore, hekurudhore, arjore, detare), hidrocentrale, varreza, si dhe raste të tjera të cituara në nenin 11/1. Shtesa e sipërfaqes nuk mund të jetë më e madhe se 3 ha dhe kërkesa për shtesë bëhet vetëm një herë. Kalimi i tokës bujqësore (boniteti V deri në X) në kategori të tokës urbane (truall), si dhe për veprimtari minerare e gjeologjike, për gurore e kariera, bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe deri në 30 ha dhe me ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 30 ha. Ndryshimi i kategorisë së resursit tokë bujqësore në kategoritë e resurseve pyll, kullotë dhe livadh, bëhet vetëm me kërkesë të pronarit të saj apo organit të qeverisjes vendore, i cili i ka në përdorim këto toka. Ndryshimi për sipërfaqet deri në 5 ha bëhet me urdhër të ministrit përkatës, kurse për sipërfaqet mbi 5 ha, me vendim të Këshillit të Ministrave. Ndërkohë miratimi i ndryshimit të kategorisë së resurseve pyll, tokë me bimësi pyjore, kullotë dhe livadh dhe kalimi i tyre në kategorinë e resursit tokë bujqësore bëhet nga komisioni që krijohet pranë bashkisë (me përfaqësues të drejtorive specifike në qark, kryetarin e bashkisë dhe juristin e bashkisë). Megjithatë, këto ndryshime si në rastet e pronësisë private, ashtu edhe në rastet e pronës publike të bashkisë, ndërmerret vetëm kur paraqiten projekte zhvillimi afatgjata të kulturave bujqësore, që përputhen me programet mbështetëse të qeverisë. Ndryshimi i tokës së pafrytshme në kategorinë e resursit tokë bujqësore miratohet nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për sipërfaqet deri në 5 ha, dhe me vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqet mbi 5 ha. Në tokat bujqësore, në të gjitha

kategoritë e bonitetit, miratimi i kalimit të sipërfaqes për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe në asnjë rast nuk lejohet ndryshimi i destinacionit të objektit ndërtimor. Sipas ligjit nr.10 263, datë 08.04.2010 **"Për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakultivuara"**, toka bujqësore konsiderohet si e pakultivuar në rastet kur autoritetet vendore kanë vërtetuar se toka nuk është kultivuar për të paktën 2 vjet rradhazi. Në këto raste, kur pronari i tokës nuk ushtron të drejtën për kultivimin e saj, bashkia ka të drejtë ta nxjerrë në ankand për ta ofruar me qera sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj.

Akte të tjera nënligjore që i shërbejnë zhvillimit të përgjithshëm bujqësor dhe rural përfshijnë VKM nr. 52, datë 21.01.2015 **"Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2015"** dhe udhëzimin e Ministrisë të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave nr. 4, datë 25.02.2015 **"Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural"**, të cilat përcaktojnë mbështetjen financiare për vitin 2015, nga Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, i cili bazohet në rajonizimin e aktiviteteve sipas hartës bujqësore të miratuar nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave. Ligje të tjera që organizojnë veprimtarinë bujqësore përfshijnë ligjin nr. 9199, datë 26.02.2004 **"Për prodhimin, përpunimin, çertifikimin dhe tregtimin e produkteve "bio"**, në mbështetje të përdorimit harmonik të kushteve të mjedisit, të kryera në përputhje me rregullat e përshkruara në këtë ligj, për prodhimin e produkteve organike dhe ligji nr. 38, datë 05.04.2012 **"Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor"**, ku shprehet përcaktimi i rregullave, kritereve dhe kushteve për themelimin e administrimin e shoqërive të bashkëpunimit bujqësor, si dhe aspekte të tjera të veprimtarisë së tyre.

Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Ruaral dhe Bujqësor dhe Plani i Përgjithshëm Kombëtar

Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Ruaral dhe Bujqësor 2014-2020, shkon në të njëjtin drejtim me perspektivën e vendit në antarësimin në BE dhe si rrjedhojë mbështetet në parimet dhe objektivat e Politikës së Përbashkët Bujqësore të BE-së (CAP) dhe politikat e paraaderimit (IPARD), duke patur në fokus edhe kushtet dhe problemet specifike të bujqësisë dhe të zonave rurale në Shqipëri. Objektivi i përgjithshëm i strategjisë është trajtimi i sfidave me të cilat përballet sektori i bujqësisë dhe agro-përpunimit në vend, si edhe zhvillimi i zonave rurale në një mënyrë të qëndrueshme ekonomike, mjedisore dhe sociale. Në lidhje me zhvillimin ekonomik, social dhe territorial, objektivi lidhet me rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit, duke mbështetur sektorët prioritarë, rritjen e sipërfaqeve bujqësore të shfrytëzuara, për të rritur madhësinë mesatare të fermës, e si rrjedhim edhe produktivitetin.

Bujqësia mbetet sektor mjaft i rëndësishëm në ekonominë e Qarkut të Elbasanit, e matur me kontributin e saj në produktin e brendshëm bruto, punësimin dhe stabilitetin makroekonomik. Sipas Vjetarit Statistikor 2012, sektori i bujqësisë është sektori i dytë me vlerën e shtuar bruto (VSHB) më të lartë në Qarkun e Elbasanit, 34, 10%. Megjithatë sektori i bujqësisë shihet me prioritet të lartë ekonomik për qarkun, në të cilin ndodhet 10.4 % e tokës totale bujqësore në vend dhe 11.7 % e sipërfaqes totale kombëtare me pyjore dhe kullota, çka dëshmon për potencialin e madh bujqësor dhe natyror që zotëron[335]. Për

qarkun e Elbasanit, të ardhurat nga bujqësia vlerësohen me 6.5% të të ardhurave totale që përftohen nga sektori i bujqësisë në rang kombëtar dhe të ardhurat nga blegtoria vlerësohen 9.6% të të ardhurave totale blegtorale kombëtare. Gjithashtu, të ardhurat nga produktet e ndryshme bujqësore vlerësohen me 4.1 % të totalit dhe të ardhurat nga produktet të ndryshme blegtorale vlerësohen me 20.7% të të ardhurave totale. Këto të dhëna tregojnë se Qarku i Elbasanit është kryesisht i orientuar drejt sektorit blegtoral kundrejt atij bujqësor, e kushtëzuar kjo nga kushtet fizike të territorit[336]. Në përgjithësi, sektori i bujqësisë ka treguar një kapacitet të lartë të përshtatjes dhe të rezistencës ndaj krizave të ndryshme, si tranzicionit të tej zgjatur nga ekonomia e centralizuar në ekonominë e tregut, si dhe ndaj krizës më të fundit ekonomike globale. Megjithatë, performanca ekonomike e sektorit bujqësor në vend është ende e pamjaftueshme për shkak të fermave të vogla dhe të fragmentuara, nivelit të ulët të teknologjisë dhe produktivitetit total të faktorëve të prodhimit krahasuar me mesataren e BE-së.

Edhe në Bashkinë Elbasan, ashtu si në të gjithë vendin, sektori bujqësor është përqëndruar konsiderueshëm rreth bujqësinë familjare, pavarësisht përpjekjeve të qeverisë për ngritjen e kooperativave dhe fermave të mëdha. Në rang kombëtar, më shumë se 90 përqind e 380,000 fermave janë nën 2 hektarë dhe llogariten të shfrytëzojnë rreth 95 për qind të tokës bujqësore, duke e bërë Shqipërinë si të vetmin vend në Evropë që mbështetet kryesisht në një shkallë të vogël, jo-intensive të prodhimit të brendshëm[337]. Në qarkun e Elbasanit, veprojnë rreth 31,326 ferma bujqësore në total[338]. Megjithatë shumica e këtyre fermave ka karakter familjar, duke i bërë kështu fermat familjare si kontribues shumë të rëndësishëm për sigurinë e ushqimit, duke prodhuar ushqimin për vetë-konsum si dhe pjesërsht për treg. Kontributi i tyre në punësim është thelbësor, duke qënë se shumica e fermave individuale shërbejë si burimi kryesor i të ardhurave për të vetë-punësuarit në këtë sektor.

Sipas regjistrimit më të fundit të popullsisë (Census 2011), numri i banorëve në zonat urbane në Bashkinë Elbasan e tejkalon numrin e banorëve në zonat rurale, një ndryshim i konsiderueshëm krahasuar me fillimin e viteve '90, kur shumica e popullsisë jetonte në zonat rurale. Momentalisht, rreth 56 % e popullsisë totale jeton në qytetin e Elbasanit, kurse 44% e popullsisë jeton në njësitë e tjera administrative të bashkisë, të cilat kanë karakter të theksuar bujqësor. Të punësuarit në sektorin e bujqësisë në qytetin e Elbasanit nuk përfshijnë më shumë se 3.2% të numrit total të të punësuarëve në qytetin e Elbasanit, kurse pjesa e popullsisë që ndodhet në njësitë e tjera administrative të bashkisë është punësuar kryesisht në bujqësi, duke e bërë kështu bujqësinë për zonat rurale sektorin primar të ekonomisë[339]. Përveç Bradasheshit, në të gjitha njësitë e tjera, në sektorin e bujqësisë janë punësuar rreth 50-90 % e numrit total të të punësuarëve. Nëse konsiderohen trendet negative për rritjen e popullsisë në vitet e ardhshme, rritmet e larta të migrimit të brendshëm, braktisjes së zonave bujqësore (sidomos ato kodrinoro-malore), shoqëruar kjo me modernizmin e sektorit dhe rritjen e produktivitetit, mendohet se numri i personave të punësuar në sektorin e bujqësisë me kohën do të ulet. Përmirësimi i përdorimit të tokës do të mundësojë punësim shtesë në të ardhmen. Megjithatë, sipas parashikimeve të qeverisë shqiptare, bujqësia do të mbetet një sektor kryesor punësimi edhe në vitin 2020[340].

Në përgjithësi, sektori bujqësor në të gjithë tërritorin shqiptar karakterizohet nga niveli i lartë i fragmentimit. E njëjta dukuri ndodh edhe në Bashkinë e Elbasanit. Fermat në bashki kanë pothuajse të njëjtën madhësi si mesatarja kombëtare dhe sektori bujqësor vazhdon të ngelet mjaft i fragmentarizuar. Për sa i përket madhësisë së parcelës, në gjithë Qarkun e

Elbasanit parcelat janë më të mëdha se mesatarja kombëtare, megjithatë në përgjithësi madhësia e parcelës konsiderohet të jetë e vogël. Rritja e madhësisë së fermës konsiderohet si një faktor i rëndësishëm për të përmirësuar efiçencën ekonomike në sektorin bujqësor dhe për tu bërë më konkurrues në treg. Aktualisht, nevojat për produkte blegtorale dhe bujqësore mbulohen nga importi i cili mbetet shumë i lartë krahasuar me exportet. Megjithatë, potencialet për rritjen e prodhimit bujqësor dhe blegtoral brënda bashkisë janë të mëdha, për shkak të burimeve të papërdorura tokësore, ku rreth 20 % e tokës bujqësore është e pashfrytëzuar dhe dëndësisë së vogël të bagëtive, ku rritja e lopës në zonën fushore mund të intesifikohet.

Plani Kombëtar

Në lidhje me sektorin e bujqësisë, plani kombëtar përqendrohet në qëllime specifike strategjike, të cilat synojnë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, vlerësimin e potencialeve, mbrojtjen e interesave publike dhe private si dhe nxitjen e planifikimit të harmonizuar të territorit. Një ndër objektivat më prioritare të Planit Kombëtar është ruajtja maksimale e fondit të tokës bujqësore, duke ndaluar çdo ndërtim që nuk i shërben sistemit bujqësor. Për më tepër, plani synon vendosjen e një rrjeti të suksesshëm të zinxhirit ekonomik bujqësor: prodhimi-grumbullim-përpunim-eksportim, si dhe investime në infrastrukturën e mirëmbajtjes, kanaleve ujitëse, vaditëse, hidrovore, etj.

Plani Kombëtar i Planifikimit të Territorit e vendos Bashkinë e Elbasanit si pjesë të Motorit Qendror të zhvillimit të rajonit ekonomik Elbasan-Pogradec-Korçë me avantazhe te larta për lidhje me rajonin Durres-Tirane duke formuar një zinxhir të rajoneve ekonomike, me një profil Turizëm-Bujqësi dhe Energji. Duke qënë se Bashkia e Elbasanit ka zona me karaktere të forta bujqësore, çdo zhvillim i ri në njësitë administrative duhet të ruajë karakterin ekzistues rural. Një rëndësi e madhe këtu duhet t'u kushtohet strukturave dhe ngritjes së infrastrukturës strategjike të përshtatshme në funksion të zhvillimit bujqësor e blegtoral. Është e rëndësishme që brënda bashkisë së Elbasanit të rezervohen hapsira që të sigurojnë masive gjelbërimi, që do të shërbejnë si "mushkria" e qytetit, sidomos në zonat urbane të Elbasanit. Plani i trajton me prioritet rajonet me karakter të theksuar bujqësor dhe për zhvillimin e metejshëm të ekonomisë rurale thekson diversifikimin e aktivitetit të fermerëve dhe rritjen e efiçencës në sektorin e ushqimit dhe bujqësisë, së bashku me peshkimin dhe pylltarinë.

Rajonizimi i kulturave dhe skemat mbështetëse për bujqësinë

Rajonet bujqësore zakonisht përcaktohen si zona me një homogjenitet të lartë në reliev, llojin e tokës, kushtet klimatike, praktikat bujqësore, kulturat e prodhuara bujqësore, dhe shoqatat bujqësore. Duke qënë se territori i Shqipërisë është relativisht i vogël dhe kushtet gjeografike përgjatë territorit nuk janë tejskajshmërisht të ndryshme, vendi jonë nuk ka një ndarje specifike në rajone bujqësore. Megjithatë, për të sjellë variacione rajonale në bujqësi, është realizuar rajonizimi i kulturave bujqësore, ku rrethe të caktuara, në bazë të kushteve specifike, si reliev, klimë e përshtatshme, lloji i tokës, traditë kultivuese, etj, janë specializuar sipas përparësisë drejt disa kulturave të veçanta.

Kështu, gruri për shëmbull, edhe pse mbillet në të gjitha zonat e Shqipërisë siguron rendiment të lartë vetëm në disa zona të vendit, në të cilat bën pjesë edhe Bashkia Elbasan. Zakonisht përfitueshmeria nga kultivimi i grurit është e ulët, duke përfaqësuar kështu një aktivitet jo shumë të leverdisshëm nëse krahasohet me kultura të tjera. Kjo situatë

kushtëzohet nga një sërë faktorësh agronomik, por nuk mund të neglizhohet edhe madhësia e vogël e fermës. Megjithatë, bima e grurit ka efektivitet ekonomik dhe mund të kultivohet duke përdorur me racionalitet burimet natyrore (tokë, ujë, vegjetacion, peisazh) në disa zona, ndaj dhe mbjellja duhet të jetë sipas përparësisë, ku bashkia Elbasan cilësohet si prioritare për kultivimin e grurit mbas Korçës dhe Fierit. Bimë të tjera që mendohen të rajonizohen në Bashkinë e Elbasanit janë si ajo e misrit, e fasules dhe perimeve të tjera. Rritja dhe kultivimi i perimeve konsiderohet të sjellë të ardhura të larta ekonomike, në nivel lokal, por edhe për shtimin e të ardhurave të fermerëve, duke qënë dhe një drejtim prioritar i prodhimit bimor, i shprehur në Strategjinë Ndërsektoriale të Bujqësisë dhe Zhvillimit rural. Me kalimin e viteve është rritur kultivimi i perimeve në serra në Bashkinë e Elbasanit, megjithatë kultivimi i perimeve nuk shihet si përparësi kryesore, por vetëm mesatare, për shkak të terrenit të theksuar malor dhe kushteve të tjera agronimike.

Tabela 62. Rajonalizimi i kulturave bujqësore në rrethin Elbasan

Ish-bashkia e vjetër Elbasan dhe komunat sipas ndarjes së vjetër administrative			
	Bimët e Arave	**Pemët frutore**	**Blegtoria**
Përparësi kryesore	Grurë, misër, fasule, perime në sera, foragjerë, duhan	Ullishtaria, Vreshtari, qershi Pjeshkë	Gjedhë, Të leshta, të dhirta
Përparësi mesatare	Perime e bostan, bimë medicinale	Arrorë, kumbulla	Bletët
Jo përparësi	Patate	Mollë, agrume	Derrat

Burimi: Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, Nëntor 2014

Pemëtaria zë një vend të rëndësishëm në prodhimin bujqësor dhe rajoni i Elbasanit ka një traditë të pasur të kultivimit të drufrutorëve. Kushtet e përshtatshme klimatike dhe tokësore i japin përparësi kryesore rajonizmit të pemëve frutore. Peshën specifike më të lartë në këtë drejtim duhet ta zerë kultivimi i pjeshkës, kajsisë, qershisë, kumbullës. etj. Analiza dhe vlerësimi i matricës së ullishtarisë, tregon se Elbasani është ndër rajonet, ku ullinjtë duhet të jenë prioritarë dhe të zenë një vend të konsiderueshëm në zhvillimin bujqësor. Zhvillimi i ullishtarisë në bashki lidhet me nivelet e treguesve ekonomikë të prodhimit, por mbi të gjitha, me përshtatshmërinë e kushteve tokësore dhe klimatike, ndaj dhe rajonizimi i tyre duhet te jetë i përhapur kudo në zonën kodrinoro-malore të Bashkisë Elbasan. Rrethi i Elbasanit, është pjesë e skemës së qeverisë për mbështetjen në kultivimin e ullirit. Duke konsideruar kushtet e përshtashme tokësore e klimatike të Bashkisë Elbasan për kultivimin e kësaj kulture, nevojat për ullinj kokërr dhe vaj ulliri, efektivitetin ekonomik që paraqet ulliri, ndikimin pozitiv në biodiversitet, zhvillimin e industrisë agropërpunuese, rezulton se bashkia është e favorizuar në zhvillimin e mëtejshëm të kësaj kulture. Agrumet kanë perhapje më të kufizuar se ajo e ullirit dhe për shkak të kërkesave të veçanta klimatike mbillen më pak në Elbasan, edhe pse skema mbështetëse e qeverisë e vitit 2014 për këtë kulturë është konsideruar e suksesshme[341]. Analiza dhe vleresimi i produktivitetit të vreshtarisë tregon se duke konsideruar përshtatshmërinë e kesaj bime me kushtet klimatik edhe tokësore, rajonizimi i saj duhet te zgjerohet në gjithë Bashkinë e Elbasanit, me prioritet zonat kodrinore-malore. Duke konsideruar kapacitetet për mbarështrimin e gjedhit (lopës), Bashkia e Elbasanit futet në grupin e parë dhe më të rëndësishmi për mbarështimin e gjedhit. Në përgjithësi, i gjithë qarku i Elbasanit vlerësohet si një ndër qarqet parësore, ku gjykohet se skema "mbështetje për viçat për mish" duhet bërë me prioritet, për shkak të shkallës më të lartë të përmirësimit racor, rendimentit më të lartë në prodhimin foragjer,

dhe aplikimin e kryqezimit me racat e mishit. E njejta gjë, vlerësohet edhe për mbarshtimin e të leshtave dhe vecanërisht të dhive. Kapacitetet kullosore dhe pyjore favorizojnë rritjen e numrit të krerëve te bagëtive të imta.

Bujqësia Organike

Në përgjithësi, kushtet e favorshme klimatike, gjeoformologjia e përshtatshme e tokës, si dhe njohuritë tradicionale të fermerëve vendas e vendosin bujqësinë organike në vendin tone në avantazhe shume të favorshme për tu zgjeruar dhe rritur më tej si nëndegë e veçantë e sektorit të bujqësise. Për shkak të zhvillimeve të vrullshme të turizmit kulinar dhe elitar, kërkesa për produktet bio-organike është e lartë në tregjet mesdhetare apo Europiane, ndaj Shqipëria duhet të fokusohet në zhvillimin e këtij sektori si një avantazh konkurrues. "Prodhime organike" janë të gjitha veprimet e përfshira për prodhimin e produkteve "Bio", në mbështetje të përdorimit harmonik të kushteve të mjedisit dhe të kryera në përputhje me rregullat e përshkruara në ligjin nr.9199, datë 26.2.2004 "**Për prodhimin, përpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve "bio"**. Një nga parimet kryesore për prodhimet organike, veç të tjerave, lidhet me sasinë totale të plehrave kimikë, e cila nuk mund t'i kalojë 170 kg azot për vit/hektarë të përdorur në një zonë bujqësore. Sipas studimit të ndërmarrë nga Ministria e Bujqësisë[342]**produktet** relativisht më të lehta për t'u prodhuar **bio** jane: ulliri dhe vaji ullirit, gështenja, bimët mjekësore; **perime** si qepa, domatja, speci, patllixhani, lakra, lulelakra, sallatrat, brokoli, spinaqi, erëzat e guzhinës, patatja; **nga frutat** hurma, shega dhe fiku; si **produkte blegtorale**, mishi i viçit në alpe, mishi qingjave dhe kecave, djathi dhisë dhe mjalti. Mbështetja e prodhimeve organike duhet të orientohet në zonat kodrinore dhe malore ku ndotjet janë më të pakta dhe mjedisi ruhet më mirë. Bashkia e Elbasanit ka një potencial të lartë për prodhimin e produkteve bio, për shkak të terrenit të përshtatshëm kodrinor-malor, gjithashtu dhe për shkak të klimës së favorshme. Megjithatë, momentalisht nuk gjenden shumë femra organike në Bashkinë e Elbasanit, ndaj sygjerohet qe të rritet mbështetja financiare dhe teknike për fermat bio dhe gradualisht të kalohet nga mbështetja e fermave individuale në grup fermerësh dhe në *eco-village* (fshatra ekologjikë).

Klima

Pjesa më e madhe e territorit të Bashkisë Elbasan përfshihet ne zonën klimatike *mesdhetare kodrinore malore*. Rajonizimi i kulturave bujqësore në bashki ndikohet thelbësisht nga kushtet e klimes (reshjet, temperaturat, ererat, etj.), së bashku me karakteristikat e vetë kulturave bujqësore si për shembull qendrueshmëria e bimëve, orientimi i afateve te mbjelljeve dhe mbarshtrimit. Një numër produktesh bujqësore, si perimet apo pemë të veçanta dëmtohen në zonat e larta, për shkak të ditëve të gjata me ngrica.

Zhvillimi i bujqësisë në vite

Të gjitha bashkitë e Qarkut të Elbasanit, të riorganizuara në vitin 2014, deri në vitin 1990 ishin të përfshira në rrethin e Elabasanit me një sipërfaqe të përgjithshme prej 1481 km², ose rrethi i katërt për nga madhësia në shkallë vendi.

Në atë periudhë sektori i bujqësisë menaxhonte 42,482 ha deri në 47, 800 ha tokë bujqësore, e organizuar në formë të 23 kooperativave dhe 4 ferma shtetërore bujqësore. Kooperativat në zonën malore ishin me madhësi mesatare 120-800 ha dhe 1200-3400 ha në zonën fushore dhe kodrinore. Ndërsa madhësia masatare e fermave shtetërore bujqësore 2500 ha.

Rreth 41 % e popullsisë banonte në qytetet Elbasan, Cërrik dhe Peqin. Ne përbërje të prodhimit bujqësor zinte rreth 15-20 % të sipërfaqes pemtaria (pemtari, ullishte dhe vreshta) dhe pjesën tjetër e zinin bimët bujqësore. Rrethi është karakterizuar nga zhvillimi prioritar industrial-bujqesor. Prodhimi industrial ishte në masën 2.5 here me i lartë se sa prodhimi bujqësor dhe burim kryesor punësimi. Në bujqësi tokat bujqësore me potenciale bujqësore shtrihen ne luginën e Peqinit. Prodhimet bujqesore ishin drithërat (gruri, misëri, perime, patate, ulliri). Duhani zinte 20-23 % të prodhimit në shkallë vendi dhe gjente kushte të përshtatshme klimatike e tokësore. Blegtria e imtë ka kushte të përshtatshme për shtimin numerik dhe prodhimin e qumeshtit dhe mishit.

Kështu, prirjet kryesore ekonomike para viteve '90 në Elbasan ishin të orientuara drejt industrisë së rëndë (Kombinati Metalurgjik, Kombinati i Përpunimit të Drurit, etj.) dhe zonat rurale, të cilat sot janë pjesë e bashkisë së re, më të orientuara drejt bujqësisë. Këto tendenca ndryshuan duke ia lënë vendin sektorit të shërbimeve dhe ndërmarrjeve të vogla e të mesme pas viteve '90-të. Në këtë mënyrë u bë një kalim i menjëhershëm nga sektori shtetëror në mbizotërimit të plotë të sektorit privat. Nga viti 1990 deri në vitin 2007 sipërfaqja e vendbanimeve në Bashkinë Elbasan është rritur me 20,2 %. Në mungesëtë infrastrukturës publike dhe zhvillimeve mbas miratimit të ligjit nr 7501 "Ligji mbi tokën bujqësore", shumë ndërtime u ngritën në toka bujqësore.

Zhvillimi i bujqësisë në Bashkinë e Elbasanit

Bujqësia është sektor ekonomik primar në të gjitha njësitë administrative të bashkisë së Elbasanit, me përjshtim të qytetit të Elbasanit. Sipërfaqja totale e tokës bujqësore është rreth 14,235 ha ose 21 % të sipërfaqes së përgjithshme të territorit, 38, 473 ha janë pyje dhe 5,547 ha kullota. Sistemi natyror që shtrihet në rreth 72 % te territorit gjithashtu është një burim i mundëshëm ekonomik, për shtimin e të ardhurave dhe diversifikimin e ekonomisë rurale ne drejtim të turizmit dhe aktivitete të tjera. Njësitë administrative të bashkisë Elbasanit, konfigurojnë shtrirjen e tokave bujqësore në shumice në lartësine deri në 600 m mbi nivelin e detit dhe një pjesë e konsiderueshme e sipërfaqes mbi 600 m dhe me pjerrësi të lartë 6-25% dhe 26-50 %. Në bashkinë e Elbasanit zhvillimi bujqësisë shtrihet më shumë në zonën kodrinore e malore dhe pjesërisht në zonën fushore. Tokat bujqësore në aspektin e vlerave agroprodhuese i përkasin klasave të bonitetit IV-VIII, me vlera mesatare dhe të ulëta. Në këto kushte nevojitet konsolidimi i sistemeve bujqësore në zonat malore. për shkak të normës së kufizuar për banor, krijimi i zinxhirit të vlerës prodhim-grumbullim dhe hapja e koridoreve të zhvillimit dhe lidhjeve nga qendrat e njësive dhe fshatrave me bashkitë e tjera (Cërrik, Belsh, Peqin). Në përdorimin e tokës bujqësore dominojnë drithërat me rreth 22 % të sipërfaqes së tokës bujqësore, foragjerët në 30% të siperfaqes, perime, patatet, ullinj (rreth 420 mijë rrënjë, nga të cilët 55-60 % në prodhim), vreshta, dhe siperfaqe të ulëta me duhan. Bazuar në analizën e metabolizmit të fluksit të ushqimit, rreth 19% e prodhimeve totale blegtorale që prodhohen në Qarkun e Elbasanit vijnë nga bashkia e Elbasanit. Qumshti është produkti me prodhimin më të lartë blegtoral në bashki, dhe pas tij vijnë vezët. Një tjetër produkt që luan peshë të rëndësishme të produkteve blegtorale është mjalti, 87% e sasisë total të qarkut, prodhohet në Bashkinë Elbasan.

Performanca e përgjithëshme e sektorit bujqësor për Bashkinë e Elbasanit mbetet e ulët, për shkak të peshës së ulët të prodhimit bujqësor, kontributit të ulët të prodhimeve blegtorale, eficencës së ulët të fermave bujqësore (ferma të vogla familjare, me madhësi

mesatare 1.4 ha), infrastrukturë të pa zhvilluar mbështetësë (sistemi ujitje-kullimit, rrugët e brendëshme të pazhvilluara), specializimi i ulët në kultivim të kulturave fitimprurëse, etj.

Disa nga treguesit bujqësor dhe blegtoral ndërmjet viteve 2003-2010 dëshmojnë se edhe pse ka patur një rritje të përgjithshme të produktivitetit bujqësor në territorin e sotëm të Bashkisë Elbasan, por disa kultura bujqësore kanë pësuar ulje. Kështu, sipërfaqja e kultivuar me drithëra dhe perime është ulur me rreth 2,000 ha nga viti 2003 në vitin 2010. Gjithashtu është ulur numri i përgjithshëm i krerëve të lopëve dhe dhive, si dhe i ngarkesës në krerë për 100 ha. Megjithatë sipërfaqja me foragjerë është rritur 2.4 herë më shumë. Për sa i përket produkteve blegtorale si qumshti, edhe pse prodhimi i tij është rritur vazhdimisht në vitet e fundit, produktiviteti total është në masën 50-60 % të prodhimit për krerë lope/dhie krahasuar me vendet e BE-së.

Toka Bujqësore

Sipas klasifikimit të *Censusi* 2011, Bashkia e Elbasanit ka Elbasanin si qendër me rëndësi kombëtare, 4 njësi vendore në periferi të aglomerateve (Bradashesh, Labinot-Fushë, Shirgjan dhe Shushicë), 3 njësi bujqësore të përziera fushore (Gjergjan, Paper e Tregan), një njësi bujqësore të përziera malore (Zavalin) dhe 4 njësi bujqësore malore (Funar, Gjinar, Labinot Mal, dhe Gracen). Sipas klasifikimit të IPARD, njësitë malore në bashkinë e Elbasanit, koniderohen si "zona më pak të avantazhuara rurale". Këto zona karakterizohen nga kufizime të mëdha lidhur me mundësitë e përdorimit të tokës dhe rritjen e kostos së produkteve bujqësore si pasojë e lartësisë mbi 600 m ne 50 % të sipërfaqes totale të tokës bujqësore dhe pjerrësisë mbi 20 %.

Të paktën 21% e popullsisë ka si aktivitet bazë bujqësinë, por shifra mund të jetë edhe më e lartë, nëse llogaritjet kryhen sipas deklarimeve të punësimit e jo klasifikimit tipologjik të bashkisë[343].

Bashkia e Elbasanit nuk ka sipërfaqe të mëdha tokash bujqësore që mund të shërbejnë për kultivimin intensiv të bimëve. Megjithatë, bashkia përfshin një larmi të gjerë tokash në territorin e saj (fushore, kodrinore dhe malore), të cilat përdoren për prodhimin e drithërave (grurit, misrit), pemëtarisë, perimeve, vreshtarisë (rrushit) dhe blegtorisë (rritja e bagëtive të imta e të trasha si lopët, derri dhe dhentë). Bashkia dallohet edhe për ullishtat të cilat janë një traditë e trashëguar ndër shekuj, sidomos në pjesën veriore dhe veri-perëndimore të qytetit, në territorin kodrinor të bashkisë, buzë përrenjve të Manazderes dhe Zaranikës. Sipas të dhënave të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave toka bujqësore në bashkinë Elbasan zë një sipërfaqe prej përafërsisht 14,235 ha, ndërsa zona natyrore, referuar analizës së përdorimit të tokës, e cila mund të përdoret për mbjelljen e pemëve frutore, zë një sipërfaqe prej 62,900 ha. Kjo tregon që bashkia Elbasan ka territor të përshtatshëm për kultivimin e pemëve frutore dhe të perimeve të ndryshme.

Në tokat bujqësore dominojne tokat kodrinore dhe malore dhe tokat e përziera fushore-kodrinore. Tipet kryesore te tokave fillojnë nga (I) Tokat e murme pyjore dhe te kafejta malore, që shtrihen në lartësinë deri në 900-1100 m në Shushicë, Labinot dhe Funar në sipërfaqe të kufizuar dhe përdorim te kufizuar bujqësor. (II) Tokat e tipit të hinjta kafe (HK) në lartësine 50-600 m dhe me kapacitet të ulët e mesatar prodhues. (III) Toka të hinjta kafe livadhore (HKL) që shtrihen rrëzë kodrave, të përshtatshme për zhvillimin e pemtarisë dhe (IV)tipi livadhore te hinjta kafe (LHK), të cilat shtrihen në fushë në pjerrësine 0-5 %, të cilat janë toka të thella dhe me vlera bujqësore. I gjithë ky grup përfshin rreth 8000 ha,

ose 56 % të tokave bujqësore. (V) Rreth 1000 ha të tipit Aluvionale, janë të shpërdara në Shushicë, Bradashesh e Papër të formuara në influencën e lumenjve dhe përrenjve, dhe janë nga tokat bujqësore më prodhuese. Tokat më potencialet më të mëdha bujqësore brënda bashkisë janë tokat e hinjta kafe livadhore me kapacitet të lartë prodhues si dhe tokat Aluvionale. Këto siperfaqe nevojiten të mbrohen a nga urbanizimi dhe shpërhapja urbane gjatë procesit të planifimimit dhe ndryshimit të tokës për përdorime të tjera.

Tokat bujqësore në aspektin e vlerave agroprodhuese dallohen për një larmi të potencialeve prodhuese, por në shumicë dominojnë tokat bujqësore të klasave IV-VII, me vlera mesatare dhe të ulëta. Në disa fshatra dominojnë tokat e klasave II-IV. Kështu, në njësinë administrative të Bradasheshit dallohet larmi e tokave bujqësore të klasave III-IX, por në shumicë dominojnë tokat në klasat III-IV me potenciale të larta prodhuese. Në njësinë administrative të Gjinarit dallohet larmi e tokave bujqësore të klasave V-VIII, por në shumicë dominojnë tokat në klasat V-VII me potenciale të ulëta e mesatare. Në njësinë administrative të Funarit dallohet larmi e tokave bujqësore të klasave V-VIII, por në shumicë dominojnë tokat në klasat VII-VIII me potenciale të larta prodhuese. Në njësinë administrative Gjergjan dallohet larmi e tokave bujqësore të klasave IV-VIII, por në shumicë dominojnë tokat në klasat VII-VIII me potenciale të ulëta prodhuese. Në njësinë administrative Gracen dallohet larmi e tokave bujqësore të klasave III-VI (vetëm disa parcela të klasës III, por në shumicë dominojnë tokat në klasat V-VI me potenciale mesatare prodhuese. Në Labinot[344] dallojnë toka bujqësore të klasave VI-VII dhe vetëm në një fshat disa parcela të klasit III-IV. Në njësinë administrative Paper, dominojnë tokat bujqësore të klasave III në 85 % të sipërfaqes me potenciale mesatare prodhuese. Në njësinë administrative Gjinar, dominojnë tokat bujqësore të klasave II-III-IV në 50 % të sipërfaqes me potenciale të larta prodhuese dhe rreth 50 % të klasave V-VII mesatare prodhuese. Në njësinë administrative Shushicë, vlerat shpërndahen në klasat III-VII dhe dominojnë tokat bujqësore të klasave VI-VII. Në njësinë administrative Zavalinë, dominojnë tokat bujqësore të klasave V-VII dhe pjesa tjetër klasa VIII (vetëm një parcelë në klasën IV). Karakteristikë në këtë bashki është se niveli agroprodhues ka dallime thelbësore midis fshatrave brenda të njëjtes njësi. Dominojnë klasat V-VII dhe më tej. Prandaj në vleresimin e zonave bujqesore dhe ruajtja e tokave, treguesit e bonitetit do të bashkërendohen me treguesit e tjerë të relievit dhe kushteve të tjera

Infrastruktura Bujqësore dhe Llojet e tokave, Bashkia Elbasan

Në pikëpamjen strukturore të prodhimit duhet të rajonizohet prodhimi sipas potencialeve të tokave dhe kërkesave të tregut. Blegtoria duhet të jetë prioritet me shtimin numerik të bagëtive të imta, pasi terreni është i përshtatshëm dhe ngarkesa numerike për cdo 100 ha eshte larg mundesive. Prioriteti i dytë mbetet zhvillimi i pemtarise vecanerisht i kultivimit të ullirit në njësitë afër Elbasanit si dhe pemeve frutore dhe vreshtit, shtimi i serave në zonën fushore dhe rikthimi në traditen e kultivimit të duhanit, që është një kulturë bujqësore me efektivitet ekonomik, që gjen kushte të përshtatshme klimatike e tokësore dhe si një prodhim që eksportohet. Porn ë këto vite prodhimi i duhanit eshtë 5 herë më ulët se në vitin 1990 dhe sipërfaqja e kultivuar në njësitë e bashkisë rreth 220 ha.

Vetëm aktivitetet bujqësore në këtë zonë, nuk mund të sigurojnë të ardhurat e mjaftueshme, mirëqenien dhe zhvillimin e qendrueshëm rural jo vetëm për siperfaqen e kufizuar të tokës bujqësore në Zavalinë, Grace dhe shumë fshatra brenda njësive, por edhe për nivelin e ulët dhe mesatar të potencialit prodhues të tokës. Prandaj duhen burime të tjera nëpërmjet

zhvillimit të aktiviteteve jashtë bujqësisë si turizmi malor, punimet në infrastrukturë, punime artistike, agroturizëm, industrinë agropërpunimit të produkteve, pyjet që zënë një sipërfaqe të konsiderueshme prej 37200 ha ha, si për kullotje dhe përdorimin e vlerave ekonomike të pyjeve.

Në Bashkinë Elbasan ndodhen 7 pika të grumbullimit të produkteve bujqësore nga të cilat 6 janë njësinë administrative Bradashesh dhe një në njësinë administrative Gjergjan. Njësitë administrative, si Shirgjani, Papëri, Tregani dhe Labinot Fusha që shtrihen përgjatë luginës së Shkumbinit dhe kanë më shumë prodhime bujqësore (si pasojë e terrenit), duhet të kenë pika të grumbullimit të produkte bujqësore.

Situata e tregjeve në Bashkinë Elbasan nuk është e mirë. Në të operojnë rreth 5 tregje me një kapacitet prej 517 vende, të cilat ndodhen vetëm në qytetin e Elbasanit. Këto tregje janë të pamjaftueshme për të furnizuar qytetin e Elbasanit me produkte. Gjithashtu vërehet mungesa e tregjeve më të vogla nëpër qendrat e njësive administrative.

Gati në të gjithëvendin, por më e theksuar kjo edhe në bashkinëElbasan, identifikohet dukshëm nevoja per të investuar në drejtim të mjediseve të magazinimit të produkteve. Ky lloj investimi vlerësohet si një mundësi për integrimin e fermerëve në tregje, duke krijuar përfitime për:

- *Më shumë të ardhura nga veprimtaria në fermë.*
- *Lidhjen e kontratave me grumbullues.*
- *Mundësi për më shumë integrim vertikal.*

Inovacione në Bujqësi

Në përgjithësi, niveli i investimeve në bujqësi dhe në sektorin agro-ushqimor në rang kombëtar apo lokal, është ende i ulët. E njejta gjë vihet re dhe për Bashkinë Elbasan, që pavarësisht skemave mbështetëse direkte/indirekte të qeverisë dhe donatorëve të huaj, inovacionet në sektorin bujqësor mbeten në nivele të pamjaftueshme. Disa nga projektet apo ndërhyrjet në përmisimin e kushteve specifike në sektorë të ndryshëm të bujqësisë në vitet e fundit përfshijnë:

- Ngritjen e tregut të parë modern bujqësor të standardeve Europiane, me mbështetjen e qeverisë shqiptare. Për të parën herë, tregu përfshin një hapësirë multifunksionale me dyqane, vende dedikuar për furgonët e produkteve të fshatit, salla ekspozitash të produkteve, megafrigoriferë për ruajtjen e produkteve për çdo stinë, ekran me afishimin e çmimeve të produkteve bujqësore e blegtorale, kafe, restorante, etj. Ky projekt konsiderohet shumë i rëndësishëm për bashkinë, pasi mungesa e tregjeve të tilla pengon zhvillimin e mëtejshëm të sektorit bujqësor. Nga ana tjetër, mendohet se ky investim ka shërbyer për punësimin e 300 personave, një risi e mirë për zhvillimin e mëtejshëm të praktikave të ngjashme, jo vetëm brënda bashkisë, por dhe në bashki të tjera.

Risi të reja në këtë fushë për të ardhmen mund të konsiderohet edhe mbështetje për të filluar aktivitete të reja (*start-up*) të prodhimeve plotësuese ose alternative, që nuk janë domosdoshmërisht pjesë e traditave disa vjeçare kultivuese si prsh: prodhimi i bimëve mjeksorë, erëzave, bimëve dekorative, kërpudhave, kërminjëve, prodhimi i produkteve bujqësore specifike për biokarburant, ect, ose aktivitete që nuk lidhen detyrimisht me

produktin bujqësor apo blegtoral, por tregtimi i tyre mund të zhvillohet në portën e fermës, agro-turizëm dhe aktivitete shoqëruese (kalërimi, peshkimi, gjuetia).

- **Turizmi në Bashkinë Elbasan**

Turizmi në Bashkinë e Elbasanit nuk është ndër sektorët kryesorë ekonomik, por mund të themi se ka potenciale të mira për zhvillimin e tij dhe të kthehet në një burim ekomomik që gjeneron të ardhura falë burimeve turistike që ka. Rreth 72% e sipërfaqes së bashkisë vlerësohet si zonë natyrore[345]. Në Elbasan ndodhen 3 rezervate strikte të menaxhuara (Sopoti, Kuturmani dhe Qaf Bushi), të cilat janë kategorizuar si rezervat strikt i menaxhuar. Kjo bashki ka edhe 12 monumente natyrore, ndër të cilat dhe Llixhat e Treganit (Llixhat e Hidrajt)[346]. Në Bashkinë Elbasan ndodhen një numër i konsiderueshëm i monumenteve të trashëgimisë kulturore, 14 nga 25 gjithsej, ndodhen në qytetin e Elbasanit, ndër të cilat 9 janë objekte kulti dhe 6 kala të epokave të ndryshme[347]. Në territorin e bashkisë ndodhen rreth 51 hotele nga të cilat 25 ndodhen në njësinë administrative të Treganit[348]. Një numër shumë i vogël i tyre ndodhen në qytetin e Elbasanit (vetëm 5)[349].

- **Klasifikimi sipas llojit të ekonomisë**

Në Tabelën 64 vërehet se në qytetin e Elbasanit 49.2% janë të punësuar në sektorin e shërbimeve, 19.8 % në tregti, 18.6 %, në sektorin e industrisë, 7.5 % në ndërtimi dhe 2.3 % në bujqësi. Në njësinë administrative të Bradasheshit 35.5 % e të punësuarve punojnë bujqësi, 18.5% në sektorin e shërbimeve, më pas është industria me 14%, ndërtimi me 8.3 % dhe tregtia me 7.8 %. Duke pasur parasysh se 15.9% e ekonomisë është e papërcaktuar raportet ndërmjet sektorëve ekonomikë mund të ndryshojnë. Në njësitë administrative Funarë, Gjergjan, Shushicë, Gracen, Tregan, Gjinar, Zavalinë, Shirgjan, Labinot-Mal, Labinot-Fushë dhe Papër, sektori me përqindjen më të lartë të të punësuarve është bujqësia, në të gjitha rastet me mbi 50 %. Në total, sektori i parë në Bashkinë Elbasan, për sa i përket punësimit, janë shërbimet me 51.4%, i dyti renditet sektori bujqësor me 27.7% dhe në fund sektori industrial me 20.9%. Në Qarkun e Elbasanit këto prirje ndryshojnë, sektori bujqësor ka 47.7% të të punësuarve, më pas vijnë shërbimet me 37.4 % dhe në fund renditet industria me 14.9%. Prirjet në nivel kombëtar janë të përafërta me ato në Bashkinë Elbasan. Sektor i parë janë shërbimet me 53.5%, më pas vjen bujqësia me 26.1 % dhe në fund industria me 20.4%.

Tabela 63. Punësimi sipas sektorëve ekonomik në Bashkisë Elbasan (në përqindje)

Njësia administrative	Total	Bujqësia	Tregtia	Ndërtim	Industri	Shërbime	E papërcaktuar
Elbasan	100	2.3	19.8	7.5	18.6	49.2	2.6
Bradashesh	100	35.5	7.8	8.3	14	18.5	15.9
Funare	100	85	0.5	3.2	0.8	7.2	3.3
Gjergjan	100	65.5	5	8	4.5	12.2	4.8
Gjinar	100	71.4	3.5	3.6	3	15.5	3
Gracen	100	87.8	0.2	2.4	1.4	7.3	1
L.Fushë	100	50.4	6.2	10.3	10.5	19.2	3.5
L.Mal	100	81	1	1.9	1.2	7.4	7.5
Papër	100	57.7	6.9	8.6	5.8	16.3	4.6
Shirgjan	100	49.3	8.4	15.2	7.8	15.3	4

Shushicë	100	63.8	5.3	10.7	3.6	10.8	5.7
Tregan	100	67.6	2	6	3.2	12.9	8.2
Zavalinë	100	77.4	2	2	1.2	15.9	1.4

Burimi: INSTAT, 2012


Tabela 64. Niveli i punësimit sipas sektorëve ekonomike

Sektori / Njësia	Bujqësi	Industri	Shërbime
Bashkia Elbasan	27.7%	20.9%	51.4%
Qarku Elbasan	47.7%	14.9%	37.4%
Shqipëria	26.1%	20.4%	53.5%

Burimi: INSTAT, 2011

Zonat ekonomike në Bashkinë Elbasan mund të ndahen në 3 kategori: zonat ekonomike industriale, zonat ekonomike të shërbimeve (zonat me përqendrim të lartë të bizneseve) dhe zonat ekonomike bujqësore.

Figura 113. Klasifikimi në ekonomi agrare ose ekonomi aglomeruese, Bashkia Elbasan



Burimi: INSTAT 2012; Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015


Zonat ekonomike të shërbimeve janë zonat ndahen në A, C, D, F dhe G. Këto zona kanë dhe përqendrimin më të madh të bizneseve. *Zona A,* është zona përgjatë rrugës nacionale Rrogozhinë-Elbasan (pjesa nga Papëri deri në Bradashesh), e cila karakterizohet nga biznese të mëdha dhe të vogla. *Zona C,* përfshin rrugën kryesore të qytetit të Elbasanit, nga hyrja (pjesa perëndimore) e deri në dalje (pjesa lindore). Veçanërisht në pjesën hyrëse dhe

dalëse të qytetit janë përqendruar biznese të mëdha, siç janë njësitë e prodhimit, punishtet ose karburantet, ndërsa në brendësi të qytetit kemi kryesisht njësi tregtare të vogla dhe të mëdha. *Zona D,* ndodhet në pjesën lindore të Bashkisë Elbasan, vazhdon përgjatë aksit rrugor nacional Elbasan-Pogradec dhe përfundon në dalje të qytetit në kufi me njësinë administrative Labinot-Fushë. Karakterizohet nga biznese prodhuese, punishte dhe njësi tregtare. *Zonat F dhe G,* në ndryshim me zonat e tjera, janë më të vogla në sipërfaqe dhe kanë karakter me rural. *Zona F* është zona shtrihet përgjatë rrugës që lidh njësinë administrative Shirgjan dhe Gjergjan, ndërsa *zona G* shtrihet përgjatë rrugës që lidh njësinë administrative Shirgjan dhe Tregan. Këto zona karakterizohen nga biznese të vogla, të cilat janë të vendosura kryesisht në akset kryesore rrugore.

Zonat ekonomike Industriale janë zonat B dhe E. Në sektorin e industrisë janë të punësuar rreth 20.9% e popullsisë. Në Bashkinë Elbasan kemi industri e rëndë përpunuese, siç është industria e përpunimit të metaleve e cila përbëhet nga disa sektorë: sektori i përpunimit dhe i prodhimit të hekurit dhe çelikut, sektori i riciklimit dhe përpunimit të metaleve të ndryshme dhe sektori pasurimit të kromit. Gjithashtu në Elbasan ndodhet edhe fabrika e prodhimit të çimentos dhe fabrika e përpunimit të drurit dhe e magazina të ndryshme. *Zona B,* ish Kombinati Metalurgjik në njësinë administrative Bradashesh, ku ndodhen industritë e përpunimit të metalit. Një ndër bizneset më të mëdha në këtë zonë është Fabrika e Përpunimit të Metalit "Kurum". *Zona E* kufizohet me qytetin e Elbasanit dhe lumin Shkumbin. Në këtë zonë industriale ndodhet industria e përpunimin e drurit dhe magazina të ndryshme.

Zonat Ekonomike bujqësore, ndodhen përgjatë luginës së lumit Shkumbin në njësitë administrative Papër, Shirgjan, Gjergjan dhe Labinot Fushë. Njësitë administrative Funarë, Gjinar, Gracen, Labinot Mal, Tregan, Shushicë, Zavalinë kanë sektor kryesor të ekonomisë bujqësinë, por sipërfaqet e tokave bujqësore janë më të vogla si pasojë e relievit kodrinor-malor.

Figura 114. Zonat ekonomike në Bashkisë Elbasan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

1.6.2 Pronat publike

- **Evidentimi i pronave publike**

Sipas ligjit Nr. 10 081 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, "E mirë publike" është pronë e paluajtshme publike e shtetit, sipas legjislacionit përkatës, si dhe të mira të tjera të natyrës publike, si: ajri, ujërat, burimet natyrore, mjedisi, në përgjithësi, trashëgimia kulturore, frekuenca dhe të tjera të kësaj natyre, sipas legjislacionit në fuqi[350].

Evidentimi i pronave publike në Bashkinë Elbasan është mbështetur në analizimin e të dhënave të Inventarit të Pronave Publike dhe nga Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave Elbasan. Kategoritë kryesore që janë përzgjedhur për tu analizuar, pas evidentimit të të dhënave, janë:

- Emri i pronës,
- Sipërfaqja totale e pronës,
- Funksioni i pronës,
- Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative,
  Institucioni / Enti përdoruës (Statusi juridik i përdorimit) etj.

Për të bërë një paraqitije sa më të mirë të gjendjes aktuale janë marr për bazë analizimi i të dhënave nga inventari dhe nga përdorimi i tokës, edhe pse duhet evidentuar se për të dhënat e inventarit nuk kemi informacion të plotë. Megjithatë informacioni i marrë nga Inventari mbetet baza për analizimin e pronave publike. Kategoritë kryesore të pronave, në Bashkinë Elbasan, sipas Inventarit të pronave publike[351] janë:

Tabela 65. Kategoritë e pronave nga Inventari i Pronave publike

Funksioni i Pronës	Sipërfaqja (m^2)	Raporti në përqindje
Administratë	257,887.5	0.91%
Shëndet parësor	10,886	0.04%
Arsim	69,265.6	0.25%
Kulturore	4,576	0.016%
Funerale	328,961.8	1.17%
Mbrojtje civile	7,490,072	26.6%
Zhvillim ekonomik	6,665	0.02%
Ujitje, kullim, depozitim uji	8,487,471.6	30.1%
Sportive	2,361	0.008%
Hapësira Publike	300,966.9	1.068%
Banim	22,937	0.081%
Pa funksion	46,004	0.16%
Pa informacion	3,234,513	11.48%
Infrastrukturë rrugore	6,920,825	24.57%
Truall	822,733.8	2.9%
Shërbim	101,904	0.36%
Zhvillim turistik	2,976	0.01%
Të tjera	49,220.8	0.26%
Totali i Pronave Publike	28,160,227	100%

Burimi: Inventari i Pronave publike; Përgatiti: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Siç mund të shihet në tabelën më lart, sipërfaqen më të madhe të pronave publike në Bashkinë Elbasan e zënë kanalet ujitëse, depozitimet uji dhe rezervuaret me 30.1% të të gjithë sipërfaqes. Kjo ndodh për arsye se Bashkia Elbasan ka pasuri të shumta ujore. Një tjetër kategori e pronave publike që zë sipërfaqe të konsiderueshme të territorit të bashkisë (26.6%) janë hapësirat që shërbejnë për mbrojtje civile, vendstrehime nëntokësore dhe mbitokësore.

- **Tokat publike pyjore**

Fondi pyjor i Bashkisë Elbasan ka një sipërfaqje prej 53.590,18 ha, ku 87.59 ha i përkasin pronësisë private. Komuna Zavalinë ka përqëndrimin më të lartë të kësaj sipërfaqjeje, saktësisht 52.00 ha sipërfaqe të tipit pyll. Ndërkohë pjesa tjetër përbëhet nga sipërfaqie me bimësi pyjore.

- **Shërbimet publike**

Sipas Inventarit të Pronave Publike kemi rreth 57 prona me funksion arsimi, ndër to kemi (55) parauniversitar dhe (2) parashkollor, 11 prona me funksion shërbim parësor shëndetësor dhe 1 pronë me shërbim spitalor. Ndërkohë nga përdorimi i tokës kemi të evidentuar 152 prona me funksion arsimor nga të cilat 36 janë arsim parashkollor, 88 janë arsim i ulët, 21 janë arsim i mesëm. 4 janë arsim i lartë dhe 3 janë terren sportive të

institucionit. Gjithashtu nga përdorimi i tokës kemi në total 76 prona me shërbim shëndetësor, nga të cilat:

Tabela 66. Pronat publike për shërbimin parësor shëndetësor nga përdorimi i tokës


Aktiviteti i pronës	Nr i njësive	Sipërfaqe në m^2
Qendër spitalore	4	5,8718.5 m^2
Farmaci	7	884.1 m^2
Qendra Shëndetësore	25	6,542.4 m^2
Ambulanca- konsultore	35	8,211.4 m^2
Shërbim dentar	3	1,153.2 m^2
Total	74	84,446.6 m^2

Përgatiti: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Sipas ligjit Nr. 139/2015 "për vetëqeverisjen Vendore", Bashkia Elbasan mban përgjegjësi[352] për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave që kanë funksion arsimi parauniversitar, duke përjashtuar këtu shkollat profesionale. Për sa i përket arsimit parashkollor, bashkia mban përgjegjësi për administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor në kopshte e çerdhe. Ndërkohë për pronësitë ku kemi aktivitet shëndetësor, përgjegjësitë e bashkisë të përcaktuara në ligj janë: ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave.

- **Krahasimi të dhëna AKIPP-Përdorimi i tokës**


Figura 115. Vendndodhja e Pronave Publike: Krahasim i të dhënave nga Inventari i Pronave Publike me Përdormin e tokës



Burimi: Inventari i Pronave Publike; Përgatiti: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Siç mund të shohim nga harta e mësipërme, mund të themi se Inventari i Pronave publike ka disa mangësi kur krahasohet me vlerat e gjeneruara nga Përdorimi i tokës. Megjithatë, për ndërtesat e arsimit, duhet të shtojmë se në Inventar janë shënuar në të njëjtën pronë njëkohësisht arsimi parashkollor dhe ai parauniversitar. Në përgjithësi në zonat rurale, kopshtet janë një ose dy klasa në ndërtesat e shkollave të arsimit të ulët. Situatë të ngjashme në Bashkinë Elbasan kemi për 36 prona që janë të kategorizuara si aktivitet parauniversitar dhe parashkollor. Kjo situatë tregon mungesën e strukturës së mjaftueshme që sipas standarteve këto funksione mund të ofrohen në objekte të veçanta.

Figura 116. Vendndodhjet e Institucioneve Arsimore: Krahasim i të dhënave nga Inventari i Pronave Publike me Përdormin e tokës




Burimi: Inventari i Pronave Publike; Përgatiti: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Nga analiza e pronave publike, kuptojmë se në Bashkinë Elbasan kemi shpërndarje të pronave publike të kategorive të ndryshme në të gjithë territorin e bashkisë. Megjithatë përqëndrimi më i madh ndodhet përgjatë shtratit të lumit Shkumbin. Kjo situatë ofron mundësi të mira për përdorimin e mëtejshëm të tyre pasi këtu kemi edhe përqëndrimin e vendbanimeve. Për më tepër, duke pasur parasysh strategjitë e zhvillimit të territorit drejt rritjes së potencialit bujqësor mund të themi se pasuria e pronave publike e përqëndruar përgjatë shtratit të lumit Shkumbin përbëjnë asete positive për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë. Zonat e ndryshme pyjore në pronësi publike të cilat shtrihen përgjatë gjithë territorit të bashkisë ofrojnë mundësi për ndërhyrje të ndryshme për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit natyrorë. Kjo vlen sidomos në zonat veri-perëndimore: ku kemi dhe përqëndrimin më të lartë të monumenteve kulturore e rezervat natyror në Labinot Mal si dhe në zonën jug-lindore ku është kombinimi i monumeteve kulturore me ato natyrore. Të dyja këto zona shërbejnë si pika interesi për banorët vendas dhe jo vetëm. Në Bashkinë Elbasan këto zona, bashkangjitur banesat, trojet për ndërtim që janë në pronësi publike, ofrojnë një potencial të madh zhvillimi të qëndrueshme në përdorim të nevojave të ndryshme turistike apo social- kulturore, pasi mund të përdoren për të shtuar funksione si hotele e restorante duke u bazuar në propozimet e strategjisë. Sëbashku me anët positive këto zona paraqesin edhe aspekte negative në territor, jo vetëm si aspekt sasior, por edhe

tek ai territorial. Pra përqendrimi i këtyre pronave paraqitet i shpërndarë në të gjithë territorin duke vështirësuar ofrimin e shërbimit përkatës.

Figura 117. Vendodhja e gjithë pronave publike në Bashkinë Elbasan



Burimi: Agjensia Kombëtare e Inventarit të Pronave Publike, Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave Elbasan; Përgatiti: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

- **Zonat konfliktuale**

Nga evidentimi i pronave publike nga të dhënat e Inventarit, mund të bëjmë edhe një krahasim me të dhënat e gjeneruara nga ortofoto për të parë nëse kemi konflike pronësie, domethenë nësë në parcelën e pronës publike ka pasur ndërhyrje të tjera. Kjo është me rëndësi për tu analizuar pasi pas viteve 1990 kemi pasur një shtim të godinave informale, që janë vendosur edhe mbi prona publike. Nga ky krahasim me ortofoton mund të themi se kemi 65 prona publike ku kemi raste konflikti. Këto prona janë në përgjithësi troje të ish magazinave apo dyqaneve, por kemi edhe raste kur kemi ndërtime në oborret e shkollave dhe qendrave shëndetësore. Këto situate paraqesin probleme për përdorimin dhe menaxhimin e të gjithë pronës publike sipas kompetencave të parashikuara në ligj. Më poshtë do të paraqesim konfliktet në 2 nga këto zona.

Figura 118. Konflikti në pronën publike me funksion administratë




Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Figura 119. Konflikti në pronën publike me funksion shesh publik



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Figura 120. Zona me konflikt në të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

1.6.3 Konkluzione

Vlerësimi ekonomik

- Prodhimi i Brendshëm Bruto për frymë në Bashkinë Elbasan vlerësohet 25% më pak sesa PBB për frymë në nivel kombëtar. Në vlera absolute PBB e Elbasanit është 7.9% e PBB kombëtare. Qarku i Elbasanit është qarku i 4-t për sa i përket kontributit në PBB kombëtare.Sektori që ka vlerën e shtuar bruto me të lartë janë shërbimet 43.5% më pas është bujqësia me 34.1% dhe industria me 14.2% ndërsa produktivitetin më të lartë e ka sektori i industrisë.
- Situata e tregjeve në Bashkinë Elbasan nuk është e mirë. Në të operojnë rreth 5 tregje me një kapacitet prej 517 vende, të cilat ndodhen vetëm në qytetin e Elbasanit. Këto tregje janë të pamjaftueshme për të furnizuar qytetin e Elbasanit me produkte. Gjithashtu vërehet mungesa e tregjeve më të vogla nëpër qendrat e njësive administrative.
- Njësitë ekonomike në Qarkun Elbasan janë të orientuar drejt shërbimeve dhe tregtisë ku 42.7% e subjekteve merren me tregti dhe 43.3% janë subjekte që kanë për bazë shërbimet e ndryshme. Situata është e përafërt dhe në Bashkinë Elbasan

ku 45% e subjekteve merren me tregti dhe 41.4 % e subjekteve kanë për bazë shërbimet, ndërsa 10.7% e subjekteve janë industriale.

- Bujqësia është një sektor me peshë në ekonominë e Bashkisë Elbasan. Zonat që kanë më shumë përparësi në zhvillimin bujqësorë janë njësitë administrative përgjatë luginës së Lumit Shkumbin si pasojë e terrenit më fushor që kanë raport me njësitë e tjera që kanë një potencial më të moderuar për zhvillim bujqësor (terren kodrinor-malor).
- Turizmin për momentin luan rol minimal në ekonominë e Elbasanit, por si sektor ka potenciale të mëdha zhvillimi. Turizmi kulturor, malor dhe natyror mund të luajnë rol kyç në ekonomi në disa zona të bashkisë.
- Për sa i përket klasifikimit të ekonomive të njësive administrative të Bashkisë Elbasan mund të themi se të gjitha njësitë administrative janë ekonomi agrare përveç qytetit të Elbasanit që është ekonomi aglomeruese.
- Në total Bashkia Elbasan është një ekonomi e orientuar drejt shërbimeve me 51.4 %, me pas bujqësia 27.7 % dhe industria me 20.9 %
- Aktivitetet kryesore ekonomike në Bashkinë e Elbasanit ndodhin përgjatë luginës së Shkumbinit. Për këtë situatë ndikon aksi kombëtar Rrogozhinë-Elbasan-Pogradec, që ndodhet në këtë luginë dhe i ofron akses të mirë këtyre zonave ekonomike.

Bujqësia

- Një nga sfidat e rëndësishme që has Bashkia e Elbasanit për zhvillimin rural dhe bujqësor lidhet me terrenin e thyer kodrinoro-malor dhe me numrin e popullsisë, qësa vjen e po ulet në zonat rurale. Momentalisht, rreth 56 % e popullsisë totale është përqendruar në qytetin e Elbasanit, kurse 44% e populllsisë jeton në njësitë e tjera administrative të bashkisë, të cilat kanë karakter të theksuar bujqësor. Të punësuarit në sektorin e bujqësisë në qytetin e Elbasanit nuk përfshijnë më shumë se 3.2% të numrit total të të punësuarëve në qytetin e Elbasanit, kurse pjesa e popullsisë që ndodhet në njësitë e tjera administrative të bashkisë është punësuar kryesisht në bujqësi, duke e bërë kështu bujqësinë për zonat rurale sektorin primar të ekonomisë[353]. Megjithatë sipas skenarëve vlerësues të projeksionit të popullsisë (2015-2031), mendohet se përveçse një rënie prej 1% të numrit të përgjithshme të popullsisë, ndërkohë që rënia e popullsisë e krahasuar me vitin 2015 vlerësohet se do të jetë në rreth 17%, numri i banorëve në zonat rurale do të pësojë rënie të vazhdueshme. Shkaku kryesor i kësaj zhvendosje mendohet të vijë si pasojë e migrimit të brëndshëm dhe ndër të tjerave, nga largimi i vazhdueshëm i të rinjve nga sektori bujqësor[354]. Kjo pirje demografike me migrim të të rinjëve ndikon negativisht në disponueshmërinë e forcës së punës në zonat rurale dhe përbën një sfidë të rëndësishme për të ardhmen e zhvillimit bujqësor dhe rural në Bashkisë e Elbasanit. Megjithatë, përmirësimi i përdorimit të tokës do mundësonte punësim shtesë në këtë sektor në vitet e ardhshme. Ruajtja e tokës bujqësore të këtij rajoni është kryefjala e zhvillimit të tij dhe aktiviteti bujqësor duhet të fuqizohet përmes aplikimit të bujqësisë organike, konsolidimit të produkteve bujqësore (në pamundësi të konsolidimit të fermave), rajonizimit të kulturave sipas territorit, ndërtimit të tregjeve rajonale dhe mbështetjes kombëtare për zhvillimin e bujqësisë dhe produktit shqiptar.

- Zhvillimin e bujqësisë në bashki, përveç klimës, terrenit dhe tokave të përshtatshme e ka favorizuar edhe rrjeti i përrenjve e lumenjve që përshkojnë territorin e bashkisë dhe më tej i bashkohen Shkumbinit. Në këtë rrjet, Shkumbini është boshti kryesor i cili përshkon territorin e bashkisë nga lindja në perëndim. Ndërsa nga njëra anë Elbasani ka këto burime natyrore që ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin e vendit, nga ana tjetër, shumë nga këto burime kanë nevojë për mbrojtje, mirëmbajtje dhe investim. Rezultat e analizave dhe studime të mëparshme tregojnë se ujërat e Shkumbinit nuk janë në nivelin e duhur mjedisor për përdorim në bujqësi, sidomos pas kalimit të lumit në Librazhd e më tej. Kjo mund të ndikojë negativisht në përdorimin e këtij aseti të rëndësishëm për zhvillimin e bujqësisë dhe produkteve cilësore ushqimore. Përdorimi i ujërave për bujqësi rrezikon shëndetin e njeriut nëpërmjet konsumit të fruta-perimeve të ndotura me ujin e lumit gjatë kultivimit. Nëse nuk merren masa për uljen e ndotjes së ujërave të Shkumbinit, nga burim uji për bujqësinë, ky lum mund të kthehen në një faktor rreziku për cilësinë e produkteve bujqësore dhe shëndetin e njeriut. Si rrjedhojë, është e nevojshme që bashkia dhe organet kompetente të menaxhimit të ujërave në nivel rajonal të ndërmarrin nisma për projekte që synojnë uljen e ndotjes në lumë si projekte për parandalimin e derdhjes së ujërave të zeza në lumë, të mbetjeve industriale, dhe të të gjitha aktiviteteve që ndikojnë ndotjen e ujërave të tij, duke përfshirë edhe parandalimin e ndotjes së ujërave nga inputet bujqësore nëpërmjet përdorimit efikas të tyre. Përveç ndotjes, është e rëndësishme që bashkia të planifikojë projekte më përparësi për rehabilitimin e lumenjve, së bashku me projekte bashkëpunimi me bashkitë e tjera (dhe organet e nivelit qendror) që preken nga Shkumbini, për menaxhimin e integruar të këtij lumi.Nëse ujërat e lumit Shkumbin, do të pësonin rritje të nivelit të tyre për shkak të ndryshime klimatike, tokat bujqësore dhe vendbanimet që shtrihen përgjatë tij do të pësonin dëmtime të shumëta. Për këtë arsye duhen marrë masa për fortifikimin e pengesave të brigjeve të lumenjve, kryesisht në zonat më problematike, të cilat janë të prekur edhe nga erozioni lumor. Gjithashtu, duhen marrë masa për përmbushjen e nevojave ushqimore në raste ekstreme, ku kulturat bujqësore dëmtohen nga përmbytjet masive dhe nga periudhat e gjata të thatësirës.
- Nga studimi i kryer nga Tota et al. në vitin 2007, rezulton se ndotja me metale të rënda (Cd, Zn, dhe Cu) e tokës bujqësore përreth Kombinatit Metalurgjik[355] me rreze shtrirjeje 2-5km përreth kombinatit është e theksuar. Toka bujqësore në Papër, Bradashesh dhe përreth Metalurgjikut është ndotur me Cr[356]. Kohët e fundit, bashkia ka zhvilluar edhe turizmin malor dhe ka shtuar veprimtaritë e saj ekonomike lidhur me Llixhat në njësinë administrative Tregan. Bashkia ka shumë fshatra të ndodhura në terren kodrinor e malor, sidomos në zonën e maleve të Kërrabës e Labinotit. Kultivimi i tokës së këtyre zonave krijon vetvetiu erozion të tokës nëse praktikat e kultivimit të saj nuk janë të qëndrueshme. Shkaqet e erozionit lidhen me: 1) kultivimin e tokave me pjerrësi të mesme e të theksuar, që rezulton në rrëshqitje, ndihmuar kjo dhe nga fenomene të motit; 2) mënyra e kultivimit të tokës, në të njëjtin drejtim me pjerrësinë dhe me zhveshje totale të tokës; 3) djegie të mbetjeve të bimëve të kultivuara, si praktikë e thjeshtë për pastrimin e saj, por që shkatërron plehun organik dhe zhvesh tokën; 4) tarracim të papërshtatshëm, me zhveshje të tokës; 5) prerje të pyjeve, etj. Si rezultat i erozionit, mungesës së

njohurisë se thelluar për tokën dhe praktikave të keqmenaxhimit, apo braktisjes, në territorin e bashkisë vihet re degradimi i tokës. Nuk ka shifra lokale, por në rang vendi, vetëm erozioni dhe degradimi i tokave kanë çuar në humbjen e 5% të prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2014 . Përveç erozionit, tokat e rajonit të Elbasanit janë të rrezikuara potencialisht nga shkarjet dhe shembjet , një formë e erozionit gjeologjik. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) identifikon si shkaqe të shkarjeve të tokës në bashki relievin e thyer, reshjet, dëmtimin e bimësisë natyrore, braktisjen e tokave bujqësore etj. Për shkak të reshjeve dhe mungesës së menaxhimit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, rrezikut i shkarjeve të tokës mbetet i lartë .

- Gjatë viteve të fundit, në Elbasan mbetet i lartë edhe rreziku i gërryerjes së tokës në brigjet e Lumit Shkumbin, i cili shoqërohet edhe me depozitime të ngurta gjatë përmbytjeve . Dëmtimet në brigjet e lumenjve janë rezultat i shfrytëzimit të materialeve inerte në shtretërit e tyre, dëmtimit të objekteve mbrojtëse dhe dëmtimit të bimësisë përgjatë shtratit të tyre. Të dhënat tregojnë se vlera mesatare e tokës së gërryer luhatet nga 0.5-0.8ton/vit për çdo metër linear të shtratit të Lumit të Shkumbinit . Përgjatë shtratit të këtij lumi është vënë re se humbet rreth 500-800 m3 tokë në vit në një hapësirë prej 1,000 metër linear. Shkaqet lidhen me devijimin e rrjedhës së ujit të këtyre lumenjve për shkak të shfrytëzimit të inerteve ose mbushjes së shtratit të tyre me mbetje urbane. Niveli i humbjes së tokës në brigjet e këtyre lumenjve është i lartë teksa mirëmbajtja e lumenjve është lënë pas dore. Gjendja rëndohet sidomos në rastet kur ka reshje të shumta e të rrëmbyeshme. *Me qëllim shmangien e degradimit të mëtejshëm të tokës bujqësore dhe jo bujqësore, nevojitet që bashkia të promovojë zhvillimin rural brenda territorit dhe të garantojë zhvillimin e një bujqësie më të qëndrueshme nëpërmjet praktikave prodhuese të qëndrueshme që respektojnë mjedisin, siç përcaktuar në Politikën e Përbashkët të BE-së për Bujqësinë .*
- Niveli i humbjes së tokës në brigjet e lumenjve është i lartë teksa mirëmbajtja e lumit është lënë pas dore. Gjendja rëndohet sidomos në rastet kur ka reshje të shumta e të rrëmbyeshme . Për të rritur prodhimin bujqësor në territorin e bashkisë pa cenuar qëndrueshmërinë e tokave, lipset që bashkia të ofrojë shërbimin e agronomisë nëpër fshatra bujqësore. Duke u ofruar informacionin e duhur bujqve, ky shërbim i ndihmon ata që të shtojnë prodhimin bujqësor nëpërmjet praktikave moderne bujqësore edhe në toka kodrinore si ato të Elbasanit.

Pronat publike

- Sipërfaqja totale e pronave publike në këtë bashki është 28,160,227 m^2 .
- Pronat me sipërfaqe më të mëdha janë rezervuare dhe kanale që përdoren për ujitje, kullim dhe depozitim uji.
- Pyjet publike në Bashkinë Elbasan kanë sipërfaqe 53,502.59ha. Megjithatë njësia administrative Zavalinë ka 52ha zona pyjore në pronësi private.
- Inventari i pronave publike ka mangësi sidomos në evidentimin e pronave me karakter shërbimi publik si arsim dhe shëndetësi. Kjo evidentohet nga diferenca e madhe prej 152 pronave që rezultojnë nga përdorimi i tokës me 57 prona të evidentuara nga Inventari. Evidentimi shërben për të kuptuar edhe mangësitë e tjera që mund të ketë Inventari në krahasim me përdorimin e tokës.

- Kemi 65 zona konfliktuale në këtë bashki, kur në pronën publike ka pasur ndërtime të tjera, shpesh pas viteve 1990. Këto zona janë të përqëndruara më shumë përgjatë rrjedhës së lumit Shkumbin, sidomos në njësinë administrative Gjergjan.

1.7 Analiza e infrastrukturave publike


1.7.1 Sistemi rrugor dhe transporti publik

Bashkia Elbasan shtrihet në një pozicion gjeografik të favorshëm për sa i përket infrastrukturave të transportit rrugor dhe hekurudhor. Territori i Bashkisë Elbasan përshkruhet nga korridore rrugore me rëndësi ndërkombëtare, kombëtare dhe rajonale. Nga infrastrukturat rrugore më të rëndësishme që kalojnë Bashkinë e Elbasanit janë:
Në bashkinë e Elbasanit kalojnë rrugët shtetërore:

- ***Rruga Shtetërore 7 (SH7)***, fillon në Rrogozhinë dhe përfundon tek rrethrrotullimi i Elbasanit.
- ***Rruga Shtetërore 3 (SH3)*** fillon në Tiranë dhe përfundon në Korçë. Kjo rrugë është 150 km e gjatë. Duhet theksuar që ky itinerar kalon nga rruga e vjetër e Elbasanit (rruga e Krrabës) ku bashkohet me rrugën ***Shtetërore 7*** në rrethrrotullimi tek Metalurgjiku. Një pjesë e këtij itinerari shkon në Ohër si pjesë e ***Korridorit VIII***, e cila quhet ***Route E852***, kurse itinerari tjetër shkon në drejtim të Korçës si pjesë e ***Route E86***. Në Bashkinë e Përrenjasit ndahet ***Route E852*** me ***Route E8***[357].
- ***A3***, Autostrada Tiranë-Elbasan ka sjellë një lidhje me optimal ndërmjet Tiranës dhe Elbasanit. Kjo autostradë do të jetë pjesë e boshtit qëndror jugor që pritet të ndërtohet[358].

Duke iu referuar materialeve të marra nga Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH), në Bashkinë e Elbasanit janë duke u rindërtuar disa rrugë, si rruga Elbasan-Banjë, e cila nis në Papër vazhdon në Cërrik dhe përfundon në Banjë. Ky itinerar ka një gjatësi prej 16,085 km. Një tjetër rrugë që është duke u rikonstruktuar është segmenti Elbasan-Cërrik me gjatësi 12,465 km. Rikonstruksioni i këtyre rrugëve si dhe vendosja e sinjalistikës horizontale dhe vertikale do të bëjë të mundur një lidhje më të mirë të Bashkisë Elbasan me Bashkinë e Cërrikut, Gramshit dhe më tej. Një tjetër investim që përmirëson lidhjen infrastrukturore në Bashkinë Elbasan është është edhe segmenti Elbasan-Gjinar, i cili ka përfundur në vitin 2015.

Figura 121. Elbasani në raport me infrastrukturën rajonale



Burimi: Autoriteti Rrugor Shqipëtar ARRSH; Përgatiti: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

- **Transporti ndërqytetas (Interurban)**

Transporti publik ndërqytetas luan një rol të rëndësishëm për mënyrën e lëvizjes (bashkëveprimit) së bashkive me njëra tjetrën. Transporti publik ndërqytetas është kopetencë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.
Transporti ndërqytetar përkufizohet si:
Transport i udhëtarëve me autobus, i cili kryhet në linjat kryesore dhe linjat ushqyese, të parashikuara në rrjetin e linjave të miratuara nga ministri. Linjat kryesore shërbejnë për të plotësuar nevojat e lëvizjes së popullsisë që lidhin bashkitë, si më poshtë:
a) bashkitë qendër të qarqeve të ndryshme;

b) një bashki qendër qarku me bashkitë jo qendër qarku të një qarku tjetër ose dy bashki jo qendër qarku të qarqeve të ndryshme[359].


Transporti në linjat kryesore kryhet pa ndalime ose me ndalime në stacionet e përcaktuara gjatë itinerarit të linjës. Linjat ushqyese lidhin dy bashki brenda një qarku, me qëndrime në stacionet e përcaktuara gjatë itinerarit të linjës, të përcaktuara në rrjetin e linjave.Transporti ndërqytetës kryhet nga persona juridikë, të organizuar në shoqëri transporti e të pajisur me licencë. Rrjeti i linjave ndërqytetëse (kryesore dhe ushqyese), stacionet e qëndrimit dhe numri i orareve për secilën linjë miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për transportin çdo tre vjet[360].

Nga analiza e transportit ndërqytetës (interurban), sipas informacioneve të marra nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, lëvizshmërinë më të shpeshtë Bashkia e

Elbasanit e ka me Tiranën dhe Lushnjen. Nga skema e paraqitur më poshtë shohim që Bashkia Elbasan ka 21 orare në ditë që shkojnë drejt Tiranës dhe 7 orare në ditë drejt Lushnjes. Kjo analizë është realizuar duke numeruar oraret e mjeteve që nisen nga Elbasani drejt vendeve të tjera të vendit. Lidhja që ka me Elbasani me Durrësin është gjithashtu një lidhje me frekuencë të lartë (6 orare në ditë).

Sipas Institutit të Transporteve, autobusët ndërqytetës nisen nga 4 sheshe: Sheshi Tre Urat në pronësi shtetërore, sheshi pranë Urës së Zaranikës në pronësi shtetërore por që nuk shfrytëzohet, sheshi i Valmit (taksive) në pronësi shtetërore si dhe sheshi tek Namazgjaja, i cili ka një kapacitet prej 35 deri 40 autobusësh dhe është në pronësi komunitetit Mysliman. Përsa i përket tarifave të transportit mbi udhëtaret, zbatohen mbi bazën e dispozitave të ligjit "për çmimet dhe tarifat". Tarifat e transportit të udhëtareve me subvension nga shteti miratohen nga Keshilli i Ministrave[361].

Figura 122. Transporti ndërqytetës (nisja nga Bashkia Elbasan)



Burimi: Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës; Përpunoi:Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Analiza e infrastrukturës rrugore bazuar tek Kodit rrugor i Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit të gjitha rrugët automobilistike në territorin e Shqipërisë klasifikohen si më poshtë:

A. Autostradë
B. Rrugë interurbane kryesore
C. Rrugë interurbane dytësore
D. Rrugë urbane kryesore
E. Rrugë urbane dytësore
F. Rrugë lokale[362]

Nga analiza së infrastrukturës rrugore në Bashkinë Elbasan ka **2663.3 km rrugë lineare**[363]. Nga Plani Rregullues i Bashkisë Elbasanit, në vitin 2006, në qytetin e Elbasanit shtriheshin **140** km rrugë lineare, pra infrastruktura rrugore është rritur dhjetra herë në krahasim më Bashkinë e Elbasanit para reformës territoriale (Maj 2014). Kjo analizë nuk përmban rrugët e parcelave të cilat shtihen në një distancë 10.7 km linear.


Figura 123. Infrastruktura rrugore e Bashkisë Elbasan sipas kodit rrugor të Republikës së Shqipërisë[364]

Gjatësia e rrugës (km)	**Ekzistuese**
Autostradë	12.9
Rruge interurbane kryesore	33.3
Rruge interurbane dytësore	94.6
Rruge urbane kryesore	29.3
Rruge urbane dytësore	591.1
Rrugë lokale	1902.1
Total	**2663.3**

Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Nga tabela e mësipërme, shohim që shtrirjen lineare më të vogël e ka autostrada me 12.9 km linear, në të cilën bën pjesë autostrada Tiranë-Elbasan. Ndërsa shtrirjen më të madhe lineare e zënë rrugët lokale, me 1902,1 km linear, të cilat shtrihen në periferi të qytetit dhe mbizotërojnë njësitë administrative me karakter rural.

Figura 124. Hierarkia e sistemit rrugor sipas Kodit Rrugor




Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

- **Profilet e infrastrukturës rrugore bazuar Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë**

Autostradë: Rrugë interurbane ose urbane me karrexhata të pavarura ose të ndara nga trafikndarës të pakapërcyeshëm, secila me të paktën dy korsi lëvizjeje, bankinë të shtruar të mundshme në të majtë dhe korsi emergjence, ose bankinë të shtruar në të djathtë, pa kryqëzime në nivel, e pajisur me rrethim dhe sisteme asistence për përdoruesin gjatë gjithë gjatësisë, e rezervuar për qarkullimin e disa kategorive mjetesh me motor dhe e dallueshme me sinjale të veçanta të fillimit dhe mbarimit. Për qëndrimin duhet të jenë parashikuar zona të caktuara me hyrje e dalje, të pajisura përkatësisht me korsi ngadalësimi dhe shpejtimi [365].


Figura 125. Profil Autostrade



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN 2016

Rruga interurbane kryesore: Rrugë me karrexhata të pavarura ose të ndara nga trafikndarës të pakapërcyeshëm, secila me të paktën dy korsi lëvizjeje dhe bankina të shtruara, pa kryqëzime në nivel, me hyrje të koordinuara për objekt anësore, e dallueshme nga sinjale të veçanta të fillimit dhe mbarimit, e rezervuar për qarkullimin e disa kategorive mjetesh me motor.


Figura 126. Profil rruge interurbane kryesore



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2016

Rrugë interurbane dytësore: Rrugë me një karrexhatë me të paktën një korsi lëvizjeje për sens dhe bankina.


Figura 127. Profil rruge interurbane kryesore



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2016

Rrugë urbane kryesore: Rrugë me karrexhata të pavarura, ose të ndara nga trafikndarës, secila me të paktën dy korsi lëvizjeje dhe një korsi e mundshme e rezervuar për mjete publike, bankina të shtruara dhe trotuare, me kryqëzime në nivel të pajisura me semafor. Për qëndrimin janë parashikuar zona ose breza anësore jashtë karrexhatës, të dyja me hyrje dhe dalje të përqendruara.


Figura 128. Profil rruge urbane kryesore



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2016

Rrugë urbane dytesorë: Rrugë me një karrexhatë me të paktën dy korsi, bankina të shtruara dhe trotuare. Për qëndrimin janë parashikuar zona të pajisura me korsi manovrimi jashtë karrexhatës.


Figura 129. Profil rruge urbane dytësore



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2016

***Rrugë lokale*:** Rrugë urbane ose interurbane, e sistemuar në mënyrë të përshtatshme sipas përkufizimeve të pikës 1 të këtij Neni, por që nuk bën pjesë në rrugët e mësipërme.

Figura 130. Profil rruge lokale



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2016

- **Analiza sipas funksionalitetit**

Në aspektin e funksionit të akseve rrugore, mbizotërojnë rrugët peisazhistike (38.5 % të totalit), si dhe rrugët bujqësore (16.6 %). Kjo dëshmon për një potencial të madh bujqësor dhe peisazhistik, që mund të integrohen nëpërmjet itinerareve të mundshme rajonale, duke krijuar një lidhje të mirë të zonave që kanë potencial të turizmit malor. Sistemi rrugor i bashkisë ka nevojë për përmirësime të shumta, si në lidhjen me rrjetin kombëtar, por akoma


më shumë në lidhjet e brendshme ku rruget e brendshme zene nje siperfaqe te konsiderueshme (18.5 %) .

Tabela 67. Shpërndarja e rrugëve sipas funksionit dhe gjatësisë përkatëse[366]

Gjatësia e rrugës (km)	Ekzistuese
Arterie	89.4
Autostradë	12.9
Bujqesore	442.8
E brendshme kryesore	155.7
E brendshme dytësore	491.8
Kolektor	252.4
Korridor shumëfunksional	12.5
Peisazhistike	1025.7
Rekreative	68.6
Shërbimi	111.5
Total	2663.3

Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Figura 131. Hierarkia e sistemit rrugor sipas funksionalitetit



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016


- **Rrugët urbane dhe rurale**

Aktualisht Bashkia Elbasan ka 983.4 ha, nga 136.7 ha në 2005, sipas Planit Rregullues të Elbasanit në 2005. Në total ***rrugët rurale (808.8 ha)*** zënë një sipërfaqe më të madhe se ***rrugët urbane (174.6 ha)***. Kjo ndodh sepse në territorin e Elbasanit ka më shumë njësi administrative që kanë karakter rural, por në vazhdim duhet t'iu jepet përparësi këtyre rrugëve.

- **Pikat potenciale të rrezikut**

Për të bërë një vlerësim të pikave të tjera potenciale të rrezikut, janë evidentuar të gjitha pikat ku autostrada, rrugët interurbane kryesore ose dytësore kryqëzohen me rrugë lokale dhe me rrugët e parcelave, të cilat lidhin kryesisht zonat ekonomike (bizneset) në mënyrë të drejtpërdrejt me infrastrukturën kombëtare (autostradë, rrugë interubane kryesore dhe dytësore). Numri i tyre është shumë i lartë: 512 pika konfliktuale nga të cilat 24 pika janë më të rrezikshme (rrugët e parcelave). Pra, duhet marrë parasysh që lëvizja në akset kryesore të Elbasanit duhet të bëhet në mënyrë të kujdesshme ndaj kthesave drejt rrugëve lokale. Rruga e cila shfaqet me problematike është aksi që lidh Elbasanin me Rrogozhinën.

Figura 132. Kryqëzimet e rrugëve lokale me audostradën, rrugët interurbane kryesore dhe dytësore




Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

- **Gjendja e infrastrukturës rrugore**

Krahas llojit dhe funksionit të akseve rrugore, kjo analizë merr në konsideratë edhe gjendjen fizike të infrastrukturës, në aspekt të cilësisë së shtrimit, pranisë së trotuareve, sinjalistikës, etj. Nga ky evidentim[367] rezulton se në Bashkinë e Elbasanit vetëm 439.2 kilometra rrugorë janë të shtruar dhe 2224.1 janë të pashtruar. Kjo ndodh për arsye se pjesa më e madhe e rrugëve janë rrugë lokale, pra rrugë në të cilat nuk janë bërë shumë investime.

Gjatë periudhës ***2005-2013*** në Bashkinë e Elbasanit, ***janë shtruan dhe rikonstruktuar 10.36 km***, nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH). Investimet janë bërë përkatësisht në: Shushicë (2 km), Elbasan (1 km), Funarë (4.6 km) dhe Tregan (2.76 km). Në qytetin e Elbasanit janë rikonstruktuar Rruga Mbretërore (0.74 km) dhe Rruga "Shefqet Daiu" (0.3 km)[368].

Figura 133. Cilësia e infrastrukturës rrugore Bashkia Elbasan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016


- **Aksidenteve në Bashkinë Elbasan 2008-2015**

Sipas infomacioneve të marra nga Instituti i Transportit për pikat e rrezikut, rezulton se në Bashkinë Elbasan ka disa pika me rrezikshmëri të lartë, të cilat shtrihen kryesisht në rrugën

interurbane kryesore (pjesë e korridorit VIII) që lidh Elbasanin me Rrogozhinën. Nga kjo analizë shihet që pikat me problematike në këtë ashki janë[369]:

- **Kryqëzimi në Papër**-kanë ndodhur 2 aksidente ku 1 ka pasur seriozitet 2 dhe 1 ka patur seriozitet 1 gjatë vitit 2013-2014.
- **Në Bradashesh**-kanë ndodhur 2 aksidente ku 1 ka pasur seriozitet 2 dhe 1 ka patur seriozitet 1 në vitin 2012.
- **Në rrugën Elbasan Qafe Krrabë (Ara Sallukut)**-kanë ndodhur 2 aksidente ku 1 ka patur seriozitet 2 dhe një ka patur seriozitet 1 gjate viteve 2011-2013.
- **Kryqëzimi tek Metlurgjiku**-kanë ndodhur 5 aksidente ku 4 kanë pasur seriozitet 1 dhe 1 ka pasur seriozitet 2 gjate viteve2012-2014.
- **Në rrugën Kajan-Belsh**-kanë ndodhur 2 aksidente me seriozitet 1 gjatë vitit 2014.
- **Në unazën jugore të qytetit** -kanë ndodhur 4 aksidente ku 1 ka pasur seriozitet 4 dhe 1 ka pasur seriozitet 1 gjatë vitit 2011-2014.
- **Në qytetin e Elbasanit (Ura e Zaranikës)**-kanë ndodhur 2 aksidente ku 1 ka pasur seriozitet 2 dhe 1 ka pasur seriozitet 1 gjatë vitit 2012-2013.
- **Në rrugën Elbasan Gjinar (Shelcan)**-kanë ndodhur 4 aksidente ku 3 kanë pasur seriozitet 1 dhe 1 ka pasur seriozitet 2 në vitin 2012.
- **Në rrugën Labinot Fushe (lapidari Xibrakë)**-kanë ndodhur 6 aksidente, ku 4 kanë pasur seriozitet 1 dhe 2 ka pasur seriozitet 2 gjatë viteve 2008-2010.
- Në rrugën Elbasan Cërrik (Gjergjan)- kanë ndodhur 2 aksidente ku 1 ka pasur seriozitet 2 dhe 1 ka pasur seriozitet 1 gjatë viteve 2011-2013.

Figura 134. Aksidentet e regjistruara në territorin e Bashkisë Elbasan për periudhën 2008-2015



Burimi: Instituti i Transportit, Bashkia Elbasan, 2014; Përgatiti: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Nga çfarë u parashtrua mund të themi se pikat më të rrezikshme janë: ***kryqëzimi në hyrje të Elbasanit (tek Metalurgjiku)*** ku kanë ndodhur 5 aksidente si dhe në drejtim të rrugës ***Labinot Fushë (lapidari Xibrakë)*** ku kanë ndodhur 6 aksidente. Këto kryqëzime do të shikohen në propozimet e infrastrukturës rrugore në mënyrë, që të ulët numri i aksidenteve në këto me rrezikshmëri të lartë.

- **Lëvizshmëria (Mobiliteti) dhe transporti publik rrethqytetas**

Të dhënat statistikore për përdorimin e automjetit apo transportit publik, (INSTAT, 2011) tregojnë se 53.4 % e banorëve të Bashkisë Elbasan shkojnë në punë në këmbë ose me biçikletë, 19 % me autobus, minibus ose taksi dhe vetëm 22.5 % me automjete personale (makina ose motoçikleta). Kjo dëshmon për një kulturë automobilistike jo të mirë.

Transporti i udhëtarëve në linjat rrethqytetëse është shërbim i rregullt transporti, i cili plotëson nevojat e lëvizjes së popullsisë ndërmjet:


a) njësive administrative përbërëse dhe qendrës së bashkisë së cilës i përkasin;
b) njësive administrative përbërëse të së njëjtës bashki;
c) fshatrave me njëri-tjetrin ose fshatrave në drejtim të qendrës së njësisë administrative së cilës i përkasin dhe/ose një njësie administrative tjetër të së njëjtës bashki;
ç) fshatrave dhe njësive administrative përbërëse, të bashkive të ndryshme, por që ndodhen në kufi me njëra-tjetrën[370].

Hartimi i rrjetit të linjave rrethqytetëse dhe ndërqytetëse bazohet mbi të dhënat demografike e gjeografike, gjendjes social-ekonomike, kërkesat për lëvizjen e popullatës, rrjetin rrugor dhe gjendjen e infrastrukturës rrugore.. Në procesin e hartimit të rrjetit të linjave rrethqytetëse merren parasysh lidhjet ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore me qendrat e njësive administrative përbërëse dhe qendrat e njësive administrative përbërëse me fshatrat dhe fshatrat ndërmjet tyre. Ky rrjet linjash transporti miratohet çdo tre vjet dhe nuk duhet të cenojë rrjetin e linjave qytetëse dhe ndërqytetëse[371].

Nivelet e diferencuara të çmimeve dhe të tarifave përcaktohen nga këshilli i bashkia brenda juridiksionit të vet (transporti rrethqytetas), në përputhje me udhëzimin e përbashkët të Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministrisë së Financave[372].


Transporti rrethqytatas në bashkinë e Elbasanit përbëhet nga 24 linja. Stacioni më i rëndësishëm nga nisen pjesa më e madhe e këtyre linjave është te Namazgjaja. Përsa i përket intenerareve që kanë fluksin më të madh mund të përmëndim linjat Tregan- Elbasan 15 orare (vajtje-ardhje) në ditë[373], linjat Papër-Elbasan- 20 orare, Elbasan-Bradashesh si dhe linja Metalurgjik – Elbasan 16 orare. Keto linja tregojnë marrëdheniet që ka qyteti i Elbasanit me ish-njësitë administrative. Ky lloj transporti shtrihet në një gjatësi 205.3 km[374] linear si dhe mbulon pjesën më të madhe të bashkisë. Pjesa veri-perëndimore shihet që nuk ka akses të mirë, gjë që do te shihet në propozimet e planit për transportit rrethqytetas në mënyrë që kjo pjesë e bashkisë të ketë akses nga ky lloj shërbimi. Duke u bazuar në informacionet e marra nga bashkia, nëse linjat ekzistuese do të lëvizin me numrin maksimal të udhëtarë atëherë në këtë bashki do të udhëtonin 18,634 persona në ditë pra afërsisht 9 % e popullsise përdorin këte lloj shërbimi. Kjo % do të rritet duke propozuar linja të reja si dhe duke menaxhuar më mirë linjat ekzistuese.

Figura 135. Linjat e transportit publik rrethqytetas, Bashkia Elbasan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Figura 136. Stacionet e Transportit publik dhe vendqëndrimi i taksive, Bashkia Elbasan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

- **Infrastruktura hekurudhore në Elbasan**

Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë ka për objekt përcaktimin dhe vendosjen e rregullave dhe parimeve të përgjithshme në fushën e transportit hekurudhor dhe të veprimtarive që lidhen me të. "Infrastrukturë hekurudhore" është tërësia e të gjitha vijave hekurudhore, e degëzimeve hekurudhore, e pajisjeve dhe e instalimeve të ndërlidhjes, të sinjalizmit dhe elektrike, të domosdoshme për qarkullimin e mjeteve hekurudhore dhe për sigurinë e trafikut. "Hekurudha Shqiptare është ndërmarrje publike, me kapital tërësisht shtetëror. Ajo organizohet dhe vepron në formën e një shoqërie anonime, në përputhje me dispozitat e ligjit "Për shoqëritë tregtare". Hekurudha Shqipetar ka për detyrë administrimin e infrastrukturës hekurudhore dhe, nëpërmjet fondeve shtetërore, realizon investime në infrastrukturë për rinovimin e modernizimin, për mirëmbajtjen e zgjerimin e saj dhe për administrimin e sistemeve të drejtimit e të sigurisë [375].


Infrastruktura hekurudhore kalon mes për mes qytetit të Elbasanit. Hekurudha në qytetin e Elbasanit vjen nga Bashkia e Rrogozhinës, kalon në Librazhd, Përrenjas dhe përfundon në Pogradec. Gjendja e hekurudhës nuk është e mirë. Në afërsi të qendrës së qytetit të Elbasanit ndodhet stacioni hekurudhor, i cili nuk është në gjendje të mirë. Në Bashkinë e Elbasan, infrastruktura hekurudhore ka gjatësi 31.4 km linear.

Kjo indrastrukturë është shumë e rëndësishme në planifikimin e territorit sepse duhet të plotësohen disa kushte për të mos pasur probleme në funksionimin normal të hekurudhës. Për të siguruar mbrojtjen e vijave hekurudhore, ndalohet:

a) derdhja e ujërave të kanaleve ujitëse e kulluese dhe e ujërave të tjera në vijën hekurudhore ose në kanalet e trasesë së saj;
b) ndërhyrja në sistemin e kullimit të ujërave nga kanalet e trasesë së hekurudhurës deri në derdhjen përfundimtare;
c) hapja më afër se 100 metra nga brezi i vijës hekurudhore i guroreve, zhavorishteve e ranishteve, gërmimi masiv i dheut dhe hapja e kanaleve.
d) Edhe për ndërtimin e këtyre objekteve, në distancë 100-200 metra nga brezi i vijës hekurudhore, merret leje nga HSH-ja;
e) kalimi i mjeteve me zinxhirë dhe i mjeteve të tjera të rënda mbi vijën hekurudhore, me përjashtim të rasteve kur HSH-ja cakton vendet e lejuara dhe rregullat për kalimin e tyre;
f) çdo lloj ndërtimi, hapja e puseve, e rezervuarëve dhe e pikave të karburantit, ngritja e përcjellësve elektrikë përgjatë vijës hekurudhore, më pranë se 25 metra nga brezi i kësaj vije, për territoret jashtë zonave urbane. Por, në këto zona, lejohet ndërtimi i ndërtesave të banimit dhe i ndërtesave të tjera, hapja e puseve, e rezervuarëve dhe e pikave të karburantit, ngritja e përcjellësve elektrikë përgjatë brezit të vijës hekurudhore, në distancë 25 - 100 metra nga ky brez.

Për ndërtimin e çdo lloj objekti, që ndodhet në zonat urbane, jashtë brezit të vijës hekurudhore, dhe në distancë deri në 25 metra nga ky brez, kërkohet leje nga HSH-ja[376].

Figura 137. Profili i hekurudhës



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2016

Duke ju referuar prioriteteve te Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës të vitit 2014 hekurudha zë një rol të vacantë ku baza kryesore në projektet në këtë infrastrukturë janë rehabilitimi i gjendjes ekzistuese. Hekurudha Shqipëtare ka në objektivat e sa një program investimesh për të rivendosur hekurudhën Shqipëtare në kushte normale në mënyrë që të konkurojë me vendet e rajonit dhe më tej në një periudhë 8 deri në 10 vjeçare.

1.7.2 Furnizimi me ujë dhe ujërat e ndotura

- **Furnizimi me ujë**

Aktualisht, sektori i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujrave të ndotura urbane operon nëpërmjet shoqërisë aksionere UK Elbasan sh.a. e cila ofron shërbimin në Bashkinë Elbasan dhe NjA-të Labinot Mal, Shushicë, Gracen, Bradashesh, Labinot Fushë, Papër, Shirgjan, Tregan, Gjergjan, Gjinar, Zavalinë ndërsa NjA Funarë mbetet e pa mbuluar nga shërbimet e kësaj ndërmarrje.

Bashkia Elbasan siguron furnizimin e popullatës me ujë për konsum publik nga akuiferi i Shkumbinit, ku UK Elbasan shfrytëzon burimet nëntokësore në pellgun ujëmbajtës të Mengel, Krastë e vogël dhe Frigorifer të cilat shtrihen në jug-lindje të Elbasanit. Akuiferi i lumit Shkumbin është burimi kryesor i sigurimit të ujit për konsum publik në Bashkinë Elbasan.

Sistemi i pompave është kompleks, ku disa janë pompa horizonale të tjera vertikale, këto në përshtatje me thellësinë dhe pozicionimin e pellgut ujëmbajtës të cilin shfrytëzojnë këto pompa. Nga këto stacione pompimi (22 St.P në total) vetëm 14 janë aktualisht në gjëndje pune të mirë pasi janë instaluar kohët e fundit ose janë rehabilituar. Kapaciteti i

përgjithshëm i këtyre pompave vlerësohet të jetë 910*l/sek*[377] ndërkohë që kapaciteti i pellgut është 1,153*l/sek.*

Tabela 68. Kapacitetet e pellgjeve ujëmbajtëse në shfrytëzim nga UK Elbasan


Burimi Ujit/ Pellgu	Kapaciteti Mesatar	
	m³/ditë	*l/s*
Mengel	38,275.2	443
Frigorifer	33,264	385
Krastë e Vogël	28,080	325
Total	99,619.2	1,153

Burimi: ValueAdd, Projekti Teknik i Ujësjellës Elbasan. Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Cilësia e ujit që përdoret për furnizimin e popullatës paraqitet mjaft e mirë, por në disa raste janë konstatuar ndotje të cilat shkaktohen kryesisht nga mungesa e zonave buferike dhe të mbrojtjes higjeno-sanitare pranë pusçpimeve. Këto ujra janë shfaqur disa herë të ndotur si pasojë e faktorëve të renditur më poshtë:

- Sharkimet të ujrave të ndotura nga banorët e NjA Labinot Fushë e pjesërisht Shushicë pranë zonës së St.P dhe rëndom mbi këtë akuifer. Gjitashtu ujrat sipërfqsorë bartin edhe ndotjen e shkarkuar nga Bashkia Librazhd dhe Përrenjas.
- Infiltrimi nga ujrat sipërfaqësore të zonës përdorur në sektorin e bujqësisë e industrisë,
- Mungesa e zonave higjeno-sanitare rreth puseve.

Figura 138. Skema e furnizmit me ujë nga U.K. Elbasan



Burimi: ValueAdd, KfW – Projekti Teknik i Ujësjellës Elbasan. Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Rezervuari i parë, i cili mbledh ujin prodhaur nga puset e pellgjeve ujëmbajtëse, është reservuari Krastës së Madhe dhe Krastës së Vogël. Kapaciteti stokues i ujit të pijshëm për popullatën e Bashkisë Elbasan është 14,530m^3 dhe paraqitet nga tabela e mëposhtme:

Figura 139. Volumi i depozitimit të ujit për konsum publik – Bashkia Elbasan

Rezervuar/Depo	Volumi (m³) për NjA
Elbasan	9,700
NjA Labinot Mal	100
NjA Bradashesh	1,200
NjA Labinot Fushë	400
NjA Papër	1,100
NjA Shirghjan	800
NjA Tregan	100
NjA Gjergjan	250
NjA Gjinar	250
NjA Shushicë	550
NjA Zavalinë	80
VOLUMI TOTAL B.ELBASAN	**14,530**

Burimi: ValueAdd, KfW – Projekti Teknik i Ujësjellës Elbasan. Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Nga konstatimet e kryera rezulton se sistemi aktual i cili po i nënshtrohet rehabilitimit dhe zgjerimit[378] ka një kapacitet stokues të ujit të pijshëm prej 14,530m^3 përjashto këtu NjA Funarë dhe Gracen të cilat nuk kanë reservuarë për ujë të pijshëm. Pra duke marrë parasysh normën ditore të konsumit të popullatës prej 120 l/banor/ditë, prej analizës na rezulton se Bashkisë Elbasan do t'i nevojiteshin të paktën 20,350m^3 kapacitet stokues, në një kohë ku aktualisht operon me 70% të kapacitetit të kërkuar.

Tabela 69. Të dhëna magjistrale mbi situatën e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm – Elbasan

NjA	Popullsia Aktuale	Kërkesa aktuale për ujë *(l/sek)*	Kërkesa aktuale për ujë *(m³/orë)*	Sasia e Ujit të prodh. *(m³/orë)*	Bilanci *(m³/orë)*	Kërkesa për rez. *(m³)*	Vol. i rez. *(m³)*	Bilanci i vol. të rez. me kërkesën
Elbasan	80,185	283	1,019	1,560	+541	12,200	9,700	-2,500
Labinot Mal	5,391 Ujësjellësi Qerret	14	51	10	-41	600	100	-500
Bradashesh	10,901 Uj. Bradashesh – Balldre Uj. Petrash	30	108	504	+396	1,300	1,200	-100
Labinot Fushë	7,191 Uj. Xibrakë Uj. Mengel – Godolesh Uj. Griqan	14	51	198	+147	600	400	-200
Papër	6,468 Uj. Vidhas Uj. Papër	22	79	403	+324	950	1,100	+150

	Uj.Balldren							
Shirgjan	7,445 Uj. Shirgjan-Lixhë-Tregan	22	79	58	-21	1,250	800	-450
Tregan	3,093 Uj. Shirgjan-Lixhë-Tregan	12	43	10	-33	200	100	-100
Gjergjan	5,223 Uj. Thanë	18	65	43	-22	800	250	-550
Gjinar	3,543 Uj. Gjinar	12	43	18	-25	500	250	-250
Shushicë	8,895 Uj. Hajdaran Uj. Shushicë	24	86	54	-32	1,050	550	-500
Zavalinë	1,653	5	18	12	-6	200	80	-120
Funarë	2,162 Zonë e bardhë	9	32	5	-27	400	0	-400
Gracen	2233	7	25	0	-25	300	0	-300
Total	**144,382**	**472**	**1,699**	**2,875**	**+1,176**	**20,350**	**14,530**	**-5,820**

Burimi: ValuAdd, KfW – Projekti Teknik i Ujësjellës Elbasan, Përgatiti: Co-PLAN 2016

Duke qënë gjithnjë në gjëndje pune, rezervuarët, stacionet e pompimit, klorifikatori dhe vetë sistemi i tubacioneve nuk i janë nënshtruar rregullisht proçeseve mirmbajtëse si pastrim-shpëlarje dhe dezinfektim. Gjithashtu agjentët atmosferikë si edhe në disa raste vegjetacioni (myshqet) kanë ndikuar negativisht në higjenën e këtyre elementëve. Siguria e tyre është një aspekt tjetër i cili nuk shfaq besueshmëri duke marrë parasysh faktin se në disa prej këtyre veprave mund të kenë akses edhe persona të paautorizuar apo kafshë të ndyshme.

Tabela 70. Shërbimi furnizimit me ujë të pijshëm për NjA dhe fshatrat në Bashkinë Elbasan

Njësitë Administrative	Fshatrat e NjA-ve	Pop. %
Elbasan	**Me Rrjet:** Qyteti Elbasan	*96*
Bradashesh	**Me Rrjet:** Balëz, Bradashesh, Karakullaku, Katund i ri, Kusarthi, Harvales, Petreshi, Shijoni	*75*
	Pa Rrjet: Fiaks, Kozani, Recani, Rila, Shemhilli, Shtemaj, Ulem, Gurabardh	
Funarë	**Me Rrjet:** Branesh, Korra	*17*
	Pa Rrjet: Bixellej, Ceruja, Krraba vogël, Mollagjeshi, Preca sipërme, Letani, Preca poshtme	
Gracen	**Me Rrjet:**	*2*
	Pa Rrjet: Bodini, Dopaj, Gracen, Gjormë, Mamël, Pajenga, Plangarica, Shengjini, Tërbaçi	

Gjinar	**Me Rrjet:** Derstila, Lukani, Maskarthi, Pashtreshi, Pobrati, Gjinari, Kaferri, Lleshan, Valesh, Xibresh	*95*
	Pa Rrjet: Stestani	
Zavalinë	**Me Rrjet:** Jeronisht, Zavalinë	*69*
	Pa Rrjet: Burrishta, Kamiçan, Nezhan, Selta	
Gjergjan	**Me Rrjet:** Bujaras, Kodër Bujaras	*21,5*
	Pa Rrjet: Gjergjan, Gjome, Kështjellas, Muriqan. Thana	
Labinot Mal	**Me Rrjet:** Labinot katund, Qerret	*27*
	Pa Rrjet: Guri zi, Labinot Mal, Lamollë, Seriçë, Benë, Lukaxhi, Qafë, Shmili	
Labinot Fushë	**Me Rrjet:** Godolesh, Griqan i poshtëm, Mengel, Xibrakë, Labinot Fushë.	*89,5*
	Pa Rrjet: Griqan i sipërm	
Papër	**Me Rrjet:** Papër Sollak, Valasi, Vidhas, Lugaj, Balldre, Jatesh, Ullishtas	*60*
	Pa Rrjet: Bizhutë, Broshka, Mamurrasi, Papri, Pajuni, Vidhas Hasgjel	
Shirgjan	**Me Rrjet:** Bathës, Bujqëz, Kuqan, Kryezjarrth, Mjekës, Shirgjan, Jagodinë	*98*
	Pa Rrjet:	
Shushicë	**Me Rrjet:** Fush Bulli, Polis i vogël, Polis Vale, Vasjani, Hajdaran, Mliza, Shushica, Vreshtasi, Shelçan	98
	Pa Rrjet:	
Tregan	**Me Rrjet:** Blerimas, Bizhadan, Kaçiveli, Trepsenishti, Tudan, Shën Vlashi, Cikalleshi, Muçani, Shilbartës, Kyçyk, Gurishtë, Tregan Llixhë.	98
	Pa Rrjet:	
Total i popullsisë së shërbyer me infrastrukturën e furnizimit me ujë për konsum publik:		**57.5**

Burimi: PLGP/ValuAdd 2015, Përpunoi: Co-PLAN, 2016

VKM nr. 102, datë 16.3.1992, "Për normat e përdorimit dhe çmimin e ujit të pijshëm në qytet dhe në fshat" përcakton që normat e përdorimit të ujit të pijshëm për efekt pagese për përdoruesit familjarë, të cilët nuk kanë matës, të jetë 120 litra ujë në ditë për frymë. Është kryer llogaritja e kërkesës për ujë në Bashkinë Elbasan dhe gjatë kësaj llogaritje janë marrë parasysh humbjet në rrjet, të cilat synohet të reduktohen deri në 35%. Norma e konsumit për popullatën ndryshon nga 90-120 litra ujë në ditë për frymë sipas kategorive (Banesa, Institucione, Biznese).

NjA në Bashkinë Elbasan kanë në territorin e tyre infrastrukturë të furnzimit me ujë të pijshëm të cilat u shërbejnë rreth 60% të popullatës, specifikisht vetëm Nj.A Tregan, Shushicë, Shirgjan dhe Elbasan i ofrojnë këtë shërbim thuajse 100% të popullatës residente.

- **Pusshpimet**

Për të përmbushur nevojat e përditshme për ujë të pijshëm dhe konsum sekondar, popullsia banuese në zonat e pashërbyera ka ndërmarrë në mënyrë të organizuar, ose individuale iniciativën për të realizuar pusshpime.

Bashki Elbasan dhe ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve, mbështetet kryesisht tek puset e Mengel – Frigorifer - Krastë për furnizimin me ujë për konsum publik të banorëve në qytet dhe fshatrat fqinj. Në të njëjtën linjë operojnë edhe NjA e tjera të cilat e kanë mbështetur shërbimin e furnizimit duke shfrytëzuar pusshpime brënda territorit të tyre dhe afër qendrave të banuara.[379].

Tabela 71. Pus-shpimet në Bashkinë Elbasan

Qyteti / NjA	Ujësjellësi	Qyteti / NjA - Fshati i furnizuar	Pusshpimet: Vendndodhja
Elbasan	U.K. Elbasan	Qyteti i Elbasan	Akuiferi Elbasan (2km në JugLindje Elbasan) StP-të në zonën e Mengel, (4 StP horizontale), Q = 432 l/s. StP-të në zonën e Frigorifeit, (3 StP horizontale dhe 6 StP Vertikale), Q = 1074 l/s StP-të në zonën e Krastës së Vogël, (4 StP horizontale dhe 3 StP Vertikaëe), Q = 624 l/s
Labinot Mal	Ujësjellësi Qerret	Labinot katund, Qerret	Pusshpim dhe STP në fshatin Qerret Q = 10.8 m^3/orë (pranë fshatit Qerret, u shërben rreth 1200 banorëve)
Bradashesh	Uj. Bradashesh – Balldre	Bradashesh, Zavalinë, Katund , Harvaleas, Shijon	2 Pusshpim dhe STP në luginën e lumit Shkumbin Q = 360m^3/orë
	Uj. Petrash	Petresh	Pusshpim dhe STP malor Q = 18 m^3/orë
Labinot Fushë	Uj. Xibrakë	Xibrakë	Pusshpim dhe STP pranë fshatit Xibrakë, Q = 36 m^3/orë
	Uj. Mengel – Godolesh	Mengel, Godolesh	Pusshpim dhe STP pranë fshatit Mengel, Q = 72 m^3/orë
	Uj. Griqan	Griqan, Labinot Fushë	Pusshpim dhe STP pranë burimit malor në Griqan, Q = 90m^3/orë
Papër	Uj. Vidhas	Vidhas	Pusshpim dhe STP pranë fshatit Vidhas, Q = 43 m^3/orë
	Uj. Papër	Papër, Ullishtas	Pusshpim dhe STP pranë fshatit Papër afër lumit Shkumbin, Q = 360m^3/orë
	Uj.Balldren	Balldre	2 Pusshpim dhe STP në luginën e lumit Shkumbin Q = 360m^3/orë
Shirgjan	Uj. Shirgjan-Lixhë-Tregan	Bathës, Bujqëz, Kuqan, Kryezjarr, Mjekës, Shirgjan	Pusshpim dhe STP në Bujqës në luginën e lumit Shkumbin Q = 72m^3/orë
Tregan	Uj. Shirgjan-Lixhë-Tregan	Tregan Llixhë	Pusshpim dhe STP në Bujqës në luginën e lumit Shkumbin Q = 72m^3/orë
Gjergjan	Uj. Thanë	Gjergjan, Gjonme, K;shtjellas, Muriqan, Thana	Pusshpim dhe STP në Muriqan, Q = 43m^3/orë
Gjinar	Uj. Gjinar	Gjinar	Burim malor dhe sistem furnizimi me gravitet, Q = 18m^3/orë
Shushicë	Uj. Hajdaran	Hajdaran, Mlizë, Vreshtan Gjinar	Pusshpim dhe STP malor në Byshek, Q = 36m^3/orë
	Uj. Shushicë	Shushicë	Burim malor në Shushicë dhe sistem furnizimi me gravitet, Q = 18m^3/orë
Zavalinë	Uj. Zavalinë	Zavalinë	Burim malor në Zavalinë dhe sistem furnizimi me gravitet, Q = 12m^3/orë
Funar	Nuk ka infrastrukturë	Nuk shërbehet	Nuk shfrytëzon burime publike
Gracen	Nuk ka infrastrukturë	Nuk shërbehet	Nuk shfrytëzon burime publike

Burimi: PLGP/ValuAdd 2015, Përpunoi: Co-PLAN 2016

Aktualisht po realizohen ndërhyrje të kufijzuara në rrejtin e furnizimit me ujë të Bashkisë Elbasan, ku po zbatohen një sërë projektesh infrastrukturore në të cilan janë parashikuar të ketë rehabilitim të sistemit dytësor dhe kryesor të furnizimit me ujë dhe të lidhjeve me shtëpitë.

- Rehabilitimi i linjës magjsitrale të transmetimit nga pusshpimet Mengel, Krastë, Frigorifer.
- Masa parandaluese për kontaminimin dhe ndotjen e puseve të lartpërmendura,
- Rrethimi zonës së parashikaur për ndërtimin e Impiantit të Trajtimit të Ujrave të Ndotura pranë dampës së Elbasanit,
- Instalimi i sahatëve matës në shkallë të gjerë si edhe pajisje të tjera,

Masa që duhen ndërmarrë për rritjen e efiçiencës së këtij sistemi kanë të bëjnë kryeshisht me kontrollin dhe monitorimin e vazhdueshëm të sasisë së ujit të pijshëm të prodhuar dhe të faturuar.

Në vlerësimin tonë nevojitet që, për të qënë sa më miqësorë me mjedisin, të kontrollohet në mënyrë dinamike sasitë e ujit të prodhuar nga pusshpimet e Konjatit dhe Çermës (përfshi edhe puset e shpërndara në NjA e Bashkisë Elbasan) në varësi të kërkesës për konsum.

Kjo realizohet me anë të sistemit SCADA[380] i cili në mënyrë automatike do të monitorojë nivelin e ujit të stokuar në depozitat e lartpërmendura të ujit të pijshëm e më pas po në mënyrë automatike do të udhëzoj pompat në Konjat e Çermë lidhur me sasinë e nevojshme të ujit për t'u pompuar nga thellësia.

Figura 140. Zonat e shërbyera nga U.K. Elbasan



Burimi: Bashkia Elbasan, ValueAdd dhe Co-PLAN, 2016

Ky sistem mbështetës kërkon një investim fillestar, por kontributi që ai jep në ruajtjen e ujrave natyrale është mjaft i rëndësishëm, duke ulur në të njëjtën kohë edhe humbjen e ujit që shkarkohet në tepërplotësat e depozitave, pasi ato janë mbushur, por nuk janë komanduar pët t'u mbyllur.

Gjithashtu një masë tjetër, e cila shkon përkrah atyre që po ndërmerr aktualisht projekti në zbatim pranë Bashkisë Elbasan për rritjen e efiçiencës së sitsemit, ka të bëjë me monitorimin e të gjithë linjës magjistrale si edhe nivelet kryesore e dytësore të rrjeti të shpërndarjes për konstatim dhe shkëputje të lidhjeve të paligjshme. Kjo masë do të ndikonte duke reduktuar ndjeshëm humbjet prej dëmtimeve në rrjet, si edhe do të ndihmojë që sasia e faturuar e ujit të jetë sa më pranë sasisë së prodhuar, duke rritur kështu edhe rentabilitetin e ndërmarrjes e duke i ulur humbjet sa më pranë nivelit të humbjeve hidraulike në projektim.

Krahas masave të lartpërmendura duhet të theksojmë se Njësitë Administrative Funar, Gracen, Labinot Mal dhe Zavalinë shfaqin mjaft probleme lidhur me mbulimin e tyre të plotë me këtë shërbim. *Objektiv duhet të mbetet zgjerimi i sistemit edhe në këto NjA gjatë 5-vjeçarit të ardhshëm.*

- **Problematikat në sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm**

Për sa i përket problematikave që hasen në sektorin e furnizimit me ujë, ato janë të llojeve të ndryshme dhe përfshijnë kryesisht:


- Shtrirja jo e plotë e sistemit të furnizimit me ujë për konsum publik në Bashkinë Elbasan.
- Në zonat ku ofrohet furnizimi me ujë: vështirësi për mbulimin e nevojave me ujë gjatë periudhës së verës, kur kërkesa për konsum rritet si pasojë edhe e përdorimit të këtyre ujrave për vaditje.
- Gjendjen jo të mirë të sistemit aktual për shkak të tubacione të vjetëruara, ose të bllokuara.
- Humbjet në sistem: aktualisht humbjet vlerësohen të jenë midis 50-65% (faktor i cili rrit kërkesën për ujë gjatë verës deri në 210-255 litra/ditë/banorë). Këto humbje në bazë të strategjisë kombëtare të furnizimit me ujë të popullatës duhet të reduktohen deri në masën 30%.
- Gjendja jo e mirë e depozitave. Mosha mesatare e këtyre depozitave vlerësohet të jetë mesatarisht 50-vjeçare.
- Monitorimi dinamik i cilësisë së ujit për konsum publik.

Tabela 72. Gjendja e tubacione të rrjetit të furnizimit me ujë

Fusha e Përdorimit	Tubacione të vjetër	Tubacione të rinj	Gjatësi Tubacioneve (m)
Rrjet Kryesor (DN 300-600)	27,523	8,887	36,410
Rrjet Dytësor (DN 50-250)	74,250	109,525	183,775
Rrjeti Terciar (DN 20-40)		53,354	53,354
Totali	**101,773**	**171,766**	**273,539**

Burimi: PLGP/ValuAdd 2015, Përpunoi: Co-PLAN

Figura 141. Shtrirja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve në Bashkinë Elbasan



Burimi: PLGP dhe ValuADD, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

- **Sistemi i ujrave të ndotura urbane, Elbasan**

Shërbimi i grumbullimit dhe kanalizimit të ujërave të ndotura urbane ofrohet i organizuar vetëm në qytetin e Elbasanit dhe thuajse aspak në NjA-të e tjera të Bashkisë. Shërbimi i orfuar është në nivele të pakënaqshme, kjo për shkak se sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura është në pjesën më të madhe i bllokuar, i dëmtuar si pasojë e vjetërsisë së tij si edhe konstruksioni i tubove materiali betoni ku lidhja midis seksioneve është kryer me llaç.

Ky sistem është i kombinuar, mbledh si shkarkimet e ujrave të ndotura gjithashtu edhe ujrat e larta. Nuk ofrohet asnjë nivel trajtimi i këtyre ujrave dhe shkarkimet ndodhin mbi trupat ujore sipërfaqësore më të afërta, konkretisht lumi Shkumbin është pritësi i këtyre ujrave të ndotura.

Kompozimi i këtij sistemi për grumbullimin e ujrave të ndotura urbane është i tillë që njëkohësisht ai grumbullon ujrat e larta si edhe shkarkime të ndryshme e të pakontrolluara që ndodhin në kolektorë, apo kanalet a hapura dedikuar këtij sistemi.

Zonat Urbane: Sot, Bashkia Elbasanmbulon me shërbimin e kanalizimit të ujërave të ndotura pjesën dërrmuese të popullsisë së qytetit të Elbasanit. Largimi i këtyre ujrave realizohet me vetërrjedhje duke u favorizuar së tepërmi nga terreni dhe relievi i zonës.

Kolektorët sekondarë të lidhur me pusetat e shërbimit Ø300 – Ø600 prej betoni të parafabrikuar, shkrakojnë në 10 kolektorët kryesorë Ø800 – Ø1000, ku 7 prej tyre shkarkojnë drejt për drejt në lumin Shkumbin e pjesa tëjetër në përroin e Zaranikës.

Në këtë sistem, siç raportohet nga vetë Bashkia Elbasan, ka mjaft seksione të dëmtuara çka ka ndikuar në përkeqësimin e situatës mjedisore në ato zona ku ndodhin këto shkarkime të pakontrolluara. Janë identifikuar mbi 19 pika shkarkimi!

Figura 142. Shtrirja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve në Elbasan qytet



Burimi: ValueAdd & Co-PLAN, 2016

Tabela 73. Gjendja e tubacione të rrjetit të kanalizimeve të ujrave të ndotura urbane në Elbasan

Elementët	Njësia	Sasia
Gjatësia totale e infrastrukturës së kanalizimeve	Km	97
Diametri i Koelktorëve Dytësor	Mm	Ø300- Ø600
Diametri i Koelktorëve Kryesor	Mm	Ø800-Ø1000
Puseta	Nr	5970
Lidhje të rregjistruara	Nr	7346

Burimi: PLGP/ValuAdd 2015, Përpunoi: Co-PLAN

Zonat Rurale: Në zonën rurale të Bashkisë Elbasan nuk ekziston ndonjë sistem i organizuar inxhinjerik i mbledhjes dhe largimit të ujrave te ndotura.

Ujrat e ndotura të çdo shtëpie largohen në gropa individuale në oborret e shtëpive të cilat nuk respektojnë standardet tekniko-sanitare të gropave septike me ose pa filtrim. Në mjaft raste largimi i tyre bëhet edhe në kanale të hapura kulluese që kalojne pranë shtepiave të

tyre e që gjithashtu janë në kundërshtim me respektimin e kushteve sanitare te largimit te tyre.

Shkarkimi dhe trajtimi i këtyre ujrave, si edhe i ujrave industriale është problemi më i madh sanitar që mund të paraqitet sot në Bashkinë Elbasan për arsye se të gjithë kolektorët i shkarkojnë ujrat e ndotura të patrajtuara në sipërfaqe ujore sipërfaqësore.[381]

Ky sistem është ndërtuar rreth viteve 1968 dhe 1980, vite këto që përkojnë me ndërtimin e banesave të reja. Pas viteve 1990, nuk është ndërhyrë më në këtë sistem. Si rrjedhojë, ndërtimet e pas-viteve 1990 janë të pakontrolluara dhe të paplanifikuara[382] në aspektin e ofrimit të infrastrukturës së furnizimit me ujë dhe kanalizime.

Figura 143. Shtrirja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve në Elbasan qytet



Burimi: PLGP dhe VALUADD, Përpunoi: Bashkia Elbasan & Co-PLAN, 2016

- **Impianti i Trajtimit te Ujrave të Përdorura**

Ujrat e përdorura të qytetit të Elbasanit derdhen në ambientin prites pa u trajtuar, dmth qyteti nuk ka një impiant trajtimi të ujrave të ndotura. Studimi i Fizibilitetit parashikon nevojen e ndërtimit te nje impianti pastrimi ne vendin e quajtur "Damba". Impianti propozohet te ndertohet me faza per nje trajtim primar te ujrave te perdorura (faza emergjente per nje investim prej 13 milion Euro) që duhet shoqëruar në një perspektivë afat mesme ose afatgjate për nje trajtim sekondar dhe terciar (me eliminim edhe te azotit e fosforit) të ujrave të perdorura për një fond investimi për ndërtimin e impiantit prej rreth 20 milion Euro.

ITUN do të perbehet nga njesia e paratrajtimit ose trajtimi primar, ne te cilin eliminohet rreth 30% e ngarkesës biologjike, i cili pasohet nga trajtimi sekondar ose biologjik në të cilin eliminohet rreth 90% e ngarkese biologjike të ujrave të ndotura. Së fundi impianti parashikon edhe trajtimin trajtimi terciar të ujrave të ndotura në të cilin realizohet eliminimi

i azotit dhe fosforit duke nxjerrë në dalje të tij ujra krejtesisht të padëmshme për ambientin prites të tij që është lumi Shkumbin.

Duke patur parasysh edhe infiltrimet e mundeshme kapaciteti maksimal i ITUN do te jete rreth 26,000 m^3/ditë për një popullsi 135,000 banore dhe norme 135 l/ditë/banorë.

1.7.3 Ndriçimi i mjediseve publike

Analiza e ndriçimit publik në Bashkinë Elbasan ka si qëllim të shqyrtoj ofrimin e shërbimit, evidentimin e zonave ku oforhet ky shërbim, evidentimin e zonave problematike duke filluar me zonat të cilat kanë sistem të amortizuar dhe duke vazhduar me zonat në të cilat nuk ofrohet. Metodologjia e përdorur për realizimin e kësaj analize është nëpërmjet vizitave në terren nga grupi i punës dhe nëpërmjet analizimit të informacioneve të mbledhura institucionet përgjegjëse.

Strategjia e Decentralizimit dhe Reforma Administrative-Territoriale në lidhje me ofrimin e shërbimimeve publike (shërbimi i ndriçimit publik)

Pas reformës administrative territoriale me rritjen e sipërfaqes, bashka do të ketë edhe sfidën e ofrimit të shërimeve në të gjithë territorin. Shërbimi i ndriçimit të mjediseve publike është shërbim i cili i përket funksioneve të veta të pushtetit vendor, ndaj si i tillë duhet të ofrohet nga bashkia.

Kuadri ligjor mbi shërbimin e ndriçimit publik nga pushteti vendor.

Ligji nr 139/2015 'Për vetëqeverisjen vendore'

Në këtë ligj, në nenin 23, pika 5, thuhet se pjesë e funksioneve të veta të bashkive është dhe ndriçimi i mjediseve publike, pra ofrimi i shërbimit të ndriçimit publik. Gjithashtu, në nenin 35, pika 5a, thuhet se Bashkia krijon të ardhura nga tarifat vendore për shërbimet publike që ofrohen. Një ndër këto shërbime publike është edhe ofrimi i shërbimit të ndriçimit publik.

Ligji nr 9632 : Për sistemin e taksave vendore i ndryshuar.

Në këtë ligj, në kreun VII për tarifat vendore dhe administrimin e tyre, në pikën 2, thuhet që tarifat vendore vendosen dhe administrohen në përputhje me ligjin nr. 139\ 2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Këshilli Bashkiak vendos për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, si dhe vendos nëse këto tarifa mblidhen nga vetë strukturat bashkiake apo nga agjentët.

Ligji nr 125/ 2013: Për Konçensionet dhe Partneritetin Publik Privat

Në këtë ligj në nenin 4 thuhet se zbatimi i konçensioneve ose i partneritetieve publike private lejohet në shërbime publike të tilla si ndriçimi publik në territorin e njësive vendore. (kjo pikë është shtuar me ligjin nr 88/ 2014 " për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr 125/2013 " Për konçensionet dhe Partenritetin Publik Privat".

Pronësia dhe Administrimi shërbimit të ndriçimit publik në Bashkinë Elbasan

Sipas strukturës organizative të Bashkisë Elbasan në vitin 2015 (infromacion i marë nga bashkia). Shërbimi i ndriçimit publik administohet nga Drejtoria e Shërbimeve Komunale e cila ndahet në disa sektore. Pjesë e kësaj drejtorie është dhe sektori i shërbimt të ndriçimit

publik. Ky sektor ka në përbërjen e tij 6 punonjës (2 inxhinier elektrik dhe 4 specialistë të fushës). Gjithashtu ka 2 mjete teknologjike me kosh hidraulik për shërbimin e ndriçimit. Drejtoria e Shërbimeve Komunale që merret me administrimin e shërbimit të ndriçimit publik minimalisht 1 herë në vit duhet të bëjë inventarizimin e infrastrukturës së ndriçimit publik në tërësi. Stafi i shërbimt të ndriçimit publik menaxhon mirëmbajtjen e rrjetit që mund të jetë ndërrimi i llambave të djegura, riparimi i shtyllave dhe kabllove të dëmtuara, sidhe riparimi i pajisjeve të tjera elektrike në funksion të ndriçimit publik.

Vendimet mbi buxhetin, strukturën e personelit apo ndryshime të nevojshme mbi administrimin e shërbimit të ndriçimit publik miratohen nga Bashkia dhe Këshilli Bashkiak Elbasan.

Ofrimi i Shërbimit të ndriçimit publik në Bashkinë Elbasan

Objekt i ndriçimit publik mund të jenë akset rrugore për makinë, rrugët e këmbësorëve, sheshet urbane, lulishtet sidhe ndërtesat e institucioneve të ndryshme publike (ndriçim i jashtëm i tyre).

Bashkia Elbasan ka në total rreth 88 km rrjet rrugor të ndriçuar, i cili është i shpërndarë në 247 akse rrugore, ku vetëm 34 akse[383] i përkasin njësive administrative dhe të tjerat qytetit të Elbasanit. Numri total i shtyllave që ndriçojnë hapësirën është 1809, ndërsa i llambave 3409. Ka rreth 28 ndërtesa të cilat ndriçohen nga shërbimi i ndriçimit public, 5 sheshe urbane dhe 4 lulishte. Vërehet që në qytetin e Elbasanit rrjeti i ndriçimit publik funksionon më mirë se në njësitë administrative (ish-komunat) të cilat ofrojnë këtë shërbim[384].

Figura 144. Rrjeti rrugorë i ndriçuar Bashkia Elbasan




Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Ofrimi i Shërbimit të ndriçimit publik në qytetin e Elbasanit

Vetëm në qytetin e Elbasanit ka rreth 70.2 km rrugë të ndriçuara, i cili shpërndahet në 213 akse rrugore. Gjthashtu kemi 28 ndërtesa, 5 sheshe dhe 4 lulishte të cilat janë të ndriçuara. Numri total i shtyllave eshte 1480 nga keto kemi 175 shtylla LED, ndersa numri i kokave te ndricimit është 3080 prej të cilave 350 janë LED. Rreth 37% e rrjetit rrugor të qytetit është i ndriçuar që është një shifër e ulët përsa i përket shtrirjes së ndriçimit në raport me rrjetin rrugorë. Megjithëse shumica e rrugëve është e ndriçuar pas viteve 90 (rreth 203 rrugë janë ndriçuar pas viteve 90 dhe 10 rrugë janë ndriçuar para viteve 90) duhet thënë se rrjeti i ndriçimit rrugor në disa pjesë të tij është tejet i amortizuar sidhe mos funksionimi i rrejtit është 10-15 %. Sistemi i ndriçimit punon rreth 4200 orë në vit që do të thotë një kohë- zgjatje prej 11.5 orësh në ditë. Problematikat kryesore të rrjetit të ndriçimit kryesisht në zonat e amortizuara kanë të bëjnë me tension të ulët sidhe ndriçimi jo i mjaftushëm i rrugëve (cilësi e ulët ndriçimi), prishje të automatëve të cilët vënë në punë në mënyrë automatike sistemin e ndriçimit, dëmtim i kabllit lidhës të sistemit elekrik sidhe djegie e llambave të ndriçimit. Ndër zonat me problematike të ndriçimit rrugore janë zonat: zona e Kalasë, zona tek Psikiatriku sidhe lagjet Partizani, Koco Brisku, Naum Panxhi, Fushë-Mbret, Shën Koll [385].

Figura 145. Rrjeti rrugorë i ndriçuar Qyteti i Elbasanit



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Ofrimi i Shërbimit të ndriçimit publik në NjA Bradashesh

Kjo njësi administrative ofron shërbimin e ndriçimit publik në tre fshatra (Kusarth, Katund i Ri dhe Bradashesh). Rrjeti i ndriçimit rrugor në NjA Bradashesh ka një gjatësi prej 7.8 km, gjatësi në të cilën vendosen 222 shtylla ndriçimi. Sistemi i ndriçimit nuk është në gjendje shumë të mirë, 25 % e shtyrllave të ndriçimit rrugor nuk punojnë, këto probleme janë më të shpeshta në rrugët dytësore dhe tretësore.

Ofrimi i Shërbimit të ndriçimit publik në NjA Papër

Në Njësinë Administrative Papër shërbimi i ndriçimt publik ofrohet vetëm në 3 fshatra (Papër, Valas dhe Broshkë) me një gjatësi prej 1.8 km, në të cilën vendosen 67 shtylla ndriçimi. Aktualisht vetëm një pjesë e vogël e këtii sistemi është në funksion si pasojë e demtimeve dhe amortizimit.

Ofrimi i Shërbimit të ndriçimit publik në NjA Tregan

Në këtë njësi shërbimi i ndriçimit publik ofrohet vetëm në fshatin Tregan në një gjatësi prej 1.5 km, në afërsi të zonës së llixhave. Në këtë segment janë të vendosura 40 shtylla, nga të cilat vetëm një pjesë janë në funksion[386].

Tabela 74. Kostot e Energjisë elektrike dhe raporti me kostot totale të ofrimit të shërbimit të ndriçimit publik

Viti	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Kostot e energjisë elektrike në 000 lekë	31,316	28,887	28,449	29,395	38,150	28,321
% e të ardhurave totale ndaj kostove të energjisë	75.59%	73.27%	71.22%	65.93%	71.50%	63.72%
Kostot totale në 000 lekë	41,428	39,424	39,948	44,586	53,356	44,447

Burimi: Bashkia Elbasan 2016

Në tabelën e mësipërme vërehen kostot e energjisë elektrike në raport me kostot totale të ofrimit të shërbimit të ndriçimit rrugor. Kostot e energjisë elektrike zënë pjesën më të madhe të kostove totale. Nga viti 2010 deri në vitin 2013 kemi një rënie gati 9.5% të raportit të kostove të energjisë elekrike me kostot totale. Në vitin 2014 kemi një rritje 5.5% dhe në vitin 2015 kemi një zbritje 7.8 %. Sa më të ulëta të jenë raportet ndërmjet kostove totale dhe kostove të energjisë aq më të larta do të jenë këto raporte ndërmjet kostove total dhe kostove të tjera siç janë kostot e mirëmbajtes. Kostot më të mëdha të mirëmbajtes do të thotë ofrim i shërbimit të ndriçimit me cilësor.

Tabela 75. Të ardhurat totale dhe raporti me kostot totale të ofrimit të shërbimit të ndriçimit publik

Viti	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Kostot totale në 000 lekë	41,428	39,424	39,948	44,586	53,356	44,447
% e të ardhurave totale në raport me kostot totale në 000 lekë	81.96%	86.38%	85.49%	76.71%	64.29%	77.41%
Të ardhurat nga tarifat e ndriçimit Total në 000 lekë	33,955	34,055	34,150	34,200	34,304	34,406

Burimi: Bashkia Elbasan, 2016

Në tabelën mësipër tregohet raporti ndërmjet të ardhurave totale dhe kostove totale për ofrimin e ndriçimit publik. Duhet theksuar se të ardhurat në asnjë vit nuk i mbulojnë totalisht kostot e ofrimit të shërbimit të ndriçimit rrugor. Kjo situatë paraqitet shqetësuese sepse bashkia për ofrimin e këtij shërbimi duhet të akordojë fonde shtesë që vijnë nga taksa ose tarifa të tjera në mënyrë që ky shërbim të ofrohet. Në vitet 2010, 2011, 2012 niveli i arkëtimit të tarifave paraqitet më i lartë ndërsa në vitet 2013, 2014, 2015 ky nivel arkëtimesh është më i ulët.

1.7.4 Mbetjet e ngurta

- **Menaxhimi i mbetjeve në Bashkinë Elbasan**

Bashkia Elbasan ofron shërbimimin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta për 77.7%[387] të popullsisë së Bashkisë Elbasan respektivishtë Nj.A Papër, Labinot Fushë, Gjinar, Gjergjan, Shirgjan & pjesërisht Nj.A Tregan shërbehen ndërsa Nj.A e tjera si Zavalinë dhe Labinot Mal mbeten jashtë skemës së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve duke gjetur zgjidhje alternative aspak miqësore me mjedisin.

Me menaxhim të mbetjeve nënkuptohet grumbullimi i mbetjeve të ngurta nga pikat e grumbullimit të mbetjeve shpërndarë në funksion të dëndësisë së popullatës dhe aktiviteteve private e shtetërore dhe, transportimi i tyre dejt venddepozitimit si edhe stokimi i tyre përfundimtar.

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta kryhet nëpërmjet një kompanie private, ky shërbim është kontraktuar subjekteve private që prej vitit 2005, subjekti aktual kryen grumbullimin, transportin dhe depozitimin përfundimtar të mbetjeve si dhe pastrimin e larje të rrugëve të qytetit.

Për të siguruar shërbimin e grumbullimit të mbetjeve, bashkia ka vendosur 572 pika grumbullimi nga të cilat 526 janë kontenierë me kapacitet 1.1 m^3 dhe 1.6 m^3, 46 pika grumbullimi prej betoni, si dhe 70 kosha me vëllim 25l për hedhjen e mbeturinave nga kalimtarët. Të gjithë kazanët janë vendosur në rrugët që lejojnë futjen e mjeteve për përpunimin e tyre. Numri i kazanëve është i pamjaftueshëm për të mbuluar volumin ditor të mbetjeve të prodhuara, ndërkohë që në disa zona të qytetit është e vështirë të përdoren kazanë, pasi rrugët janë të ngushta dhe nuk lejojnë futjen e kamionëve të mëdhej teknologjike.

Bashkia nuk ka një evidencë të saktë për sasinë e mbetjeve që hiqen çdo ditë, megjithse në mënyrë të përafërt por nga përfaqësuesit e ARM mendojnë se sipërmarrja e pastrimit evakuon rreth 105 ton në ditë. Pavarësisht nga sipërfaqja e mbulimit, cilësia e shërbimit nuk është në nivelin e duhur pasi realizohet me mjete primitive.

Për të realizuar këtë shërbim, kontraktori ka përdorur 6 mjete teknologjike: 4 mjete tip DAF me kapacitet mbajtës 7 ton secili dhe 2 mjete tip BENZ me kapacitet 7 dhe 10 ton. Gjithashtu, për zonat ku nuk mund të hyjnë mjetet teknologjike, përdoren 2 mjete me kapacitet 3.5 ton, një mjet me kapacitet 5 ton dhe një mjet me kapacitet 7 ton, si dhe 2 karroca me kuaj. Për lagien e rrugëve përdoret një bot me kapacitet 7000 litra.

Aktualisht, jo të gjitha zonat e bashkisë mbulohen nga shërbimi i pastrimit. Strategjia e Menaxhimit të Mbetjeve të bashkisë ka për qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimit në zonat që marrin shërbim, dhe ofrimi i shërbimit në zonat që nuk mbulohen.

Venddepozitimi i mbetjeve përdorur deri më sot nga Bashkia Elbasan ndodhet 75 m larg brigjeve të lumit Shkumbin në pjesën jugore të qytetit të Elbasanit, ku ka pasur një prurje ditore 105 ton/ditë dhe i shërben një popullsie prej 128,418 banorë. Ky venddepozitim është klasifikuar si jo sanitar (jashtë çdo standardi të lejuar). Mbetjet që depozitohen janë mbetje të ngurta urbane kryesisht nga zona e qytetit, ndërsa nuk përjashtohet edhe mundësia e depozitimit të mbetjeve inerte.

Aktualisht ky venddepozitim si edhe pika të tjera grumbullimi po i nënshtrohen proçesit të transferimit të mbetjeve dhe rehabilitimit pasi me përfundimin e ndërtimit të landfillit në Dampën e Elbasanit mbetjet do të kenë një destinacion final më të sigurt.

Gjatë këtyre viteve janë bërë disa përpjekje dhe studime fizibiliteti dhe projekte për përcaktimin e një territori të përshatshëm për ndërtimin e një landfilli sanitar për depozitimin e mbetjeve në Bashkinë e Elbasanit.

- **Mbetjet e ngurta urbane**


Gjatë vitit 2015, Bashkia Elbasanka prodhuar rreth 38,325 ton mbetje/vit[388], me një sasi prodhimi prej **0.4 deri në 1.4 kg/banor/ditë** *(ndryshimi midsi zonës urbane dhe asaj rurale)*. Sasia e mbetjeve të prodhuara ka ardhur duke u rritur nga viti në vit (Tabela 77). Nga një krahasim i bërë për periudhën kohore 2003-2015 rezulton se sasia e mbetjeve të prodhuara nga viti 2003 në vitin 2012 është shtuar me rreth 300% (0.076 ton/banor/vit në vitin 2003, kundrejt 0.266/ton/banor/vit në vitin 2012). Për më tepër, në vitin 2014, sasia e mbetjeve të prodhuara për banor në vit në Bashkinë Elbasanka ka tejkaluar paksa mesataren e sasisë së podhuar në rang vendi. Megjithatë, duhet theksuar së në vitin 2014 është vënë re një ndryshim tendence ku gjenerimi i mbetjeve ka ardhur duke u reduktuar, projeksion i cili vazhdon edhe në pasqyrimin e të dhënave për vitin 2015 si edhe në parashikimet për vitet që do të pasojnë.

Tabela 76. Sasia e mbetjeve urbane të prodhuara në Bashkinë Elbasan dhe në rang vëndi

Mbetjet Urbane Elbasan– Projeksion (ton/banor.vit)								
Viti	**2003**	**2006**	**2009**	**2012**	**2014**	**2015**	**2016-17**	**Viti**
Elbasan	0.076	0.199	0.21	0.266	0.28	0.17	0.08	***ton/ban***
Mesatare gjenerimi për banorë nëR.SH	0.118	0.241	0.292	0.392	0.253	0.315	0.333	***ton/ban***

Burimi: INSTAT & ARM Elbasan

Figura 146. Projeksioni i gjenerimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Elbasan



Burimi: INSTAT & ARM Elbasan

NJA Papër[389] e ofron vetë shërbimin e manaxhimit të mbetjeve për 80% të popullsisë së saj (1.5 ton/ ditë mbetje), ndërsa nuk ofron shërbimin e fshirjes dhe larjes së rrugëve. Në të gjithë territorin e NJA ku ofrohet shërbimi i mbetjeve janë të shpërndarë 60 pika grumbullimi me kazanë të hapur dhe 10 pika grumbullimi me kazanë të mbyllur. NJA deklaron së nuk ka pika të hapura për grumbullimin e mbetjeve. Gjithsej në të gjithë NJA janë të shpërndarë 70 kontenierë me kapacitet 1.1m^3. Grumbullimi i mbetjeve bëhet 3 herë në javë një mjet kompaktor, i cili i depoziton mbetjete në venddepozitimin që ndodhet në fshatin Balldren, i cili nuk i plotëson kushtet higjeno sanitare. Në këtë fushë është nje mjet eskavator i cili ndihmon në depoztimin e mbetjeve dhe ngjeshjen e tyre. Ky vend depozitim ndodhet 13km nga qendra e NJA. NJA aplikon një tarifë pastrimi për familjet prej 600 lek/vit, e cila gjatë vitit të fundit është mbledhur në masën 75%.

NJA Labinot Fushë[390] ofron shërbimin e manaxhimit të mbetjeve (0.7 ton/ ditëmbetje), por nuk jep të dhëna në lidhje me përqindjen e popullsisë së shërbyer, ndërsa nuk ofron shërbimin e fshirjes dhe larjes së rrugëve. NJA nuk deklaron në lidhje me numrin e pikave të grumbullimit të mbetjeve të shpërndarë në të gjithë territorin. Grumbullimi i mbetjeve bëhet 5 herë në javë një mjet të hapur, i cili është i papërshtatshëm për grumbullimin e mbetjeve. NJA deklaron se ka një venddepozitim të autorizuar për mbetjete dhe disa të tjera jo të autorizuara (10 mesatarisht). Venddepozitimi i autorizuar ndodhet 7km nga qendra e NJA. Sipas të dhënave të deklaruara NJA nuk aplikon tarifë pastrimi për familjarët, vetëm për bisneset, dhe gjithashtu nuk deklaron nëse ka një buxhet të dedikuar për shërbimin e mbetjeve.

NJA Gjinar[391] e ofron vetë shërbimin e manaxhimit të mbetjeve për 30% të popullsisë së saj (1 ton/ditë mbetje), ndërsa nuk ofron shërbimin e fshirjes dhe larjes së rrugëve. Në të gjithë territorin e NJA ku ofrohet shërbimi i mbetjeve janë të shpërndarë 20 pika të hapura (kazanë të hapur) grumbullimi, dhe 4 pika grumbullimi me kazanë të mbyllur. Gjithsej në të gjithë NJA janë të shpërndarë 24 Kontenierë me kapacitet 1.1m^3 dhe 6 kontenierë 0.33l. Grumbullimi i mbetjeve bëhet 2 herë në javë një mjet kompaktor 5 ton, i cili i depoziton mbetjete në venddepozitimin e NJA, i cili është jashtë kushteve higjeno sanitare. Ky

venddepozitim ndodhet 22km nga qendra e NJA. Tarifa e pastrimit që aplikohet për familjet është 100 lek/vit, e cila gjatë vitit të fundit është mbledhur në masën 70%.

NJA Zavalinë[392] deklaron se nuk e ofron shërbimin e manaxhimit të mbetjeve, fshirjes dhe larjes së rrugëve.

NJA Gjergjan[393] e ofron vetë shërbimin e manaxhimit të mbetjeve për 80% të popullsisë së saj (2 ton/ditë mbetje), ndërsa nuk ofron shërbimin e fshirjes dhe larjes së rrugëve. Në të gjithë territorin e NJA ku ofrohet shërbimi i mbetjeve janë të shpërndarë 16 pika të hapura dhe 14 pika grumbullimi me kazanë. NJA nuk deklaron të ketë një mjet për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve. Sipas të dhënave, venddepozitimi i mbetjeve për NJA Gjergjan ndodhet 7km larg qendrës së saj. Praktikisht ky shërbim nuk ofrohet sipas standardeve dhe NJA nuk ka infrastrukturën e nevojshme për ofrimin e tij.

NJA Shirgjan[394] e ofron vetë shërbimin e manaxhimit të mbetjeve për 90% të popullsisë së saj (0.8 ton/ ditë mbetje), ndërsa nuk ofron shërbimin e fshirjes dhe larjes së rrugëve. Në të gjithë territorin e NJA ku ofrohet shërbimi i mbetjeve janë të shpërndarë 60 pika grumbullimi të hapura. NJA ofron shërbimin e mbetjeve 2 herë në javë. Mbetjet merren nga pikat e grumbullimit me një mjet të hapur 3.5 ton, e cila është e papërshtashme për grumbullimin e mbetjeve. NJA deklaron se aplikon një tarifë pastrimi për familjet prej 600 lek/vit, të cilën deklaron se e ka mbledhur 53% gjatë vitit të kaluar. Venddepozitimi i mbetjeve ndodhet 7km larg qedrës së NJA. Edhe NJA Shirgjan si shumë NJA, nuk e ofrojnë shërbimin sipas standardeve të kërkuara.

NJA Tregan[395] e ofron vetë shërbimin e manaxhimit të mbetjeve për 35% të popullsisë së saj (1.5-4.5 ton/ ditë mbetje), ndërsa deklaron se ofron shërbimin e fshirjes dhe larjes së rrugëve në 8% të territorit të saj. Në të gjithë territorin e NJA ku ofrohet shërbimi i mbetjeve janë të shpërndarë 12 pika grumbullimi të hapura dhe 9 pika grumbullimi me kazanë. Gjithsej në të gjithë NJA janë të shpërndarë 10 kontenierë me kapacitet 1.1m^3. Grumbullimi i mbetjeve bëhet çdo ditë në të shumtën e rasteve, ku NJA përdor një mjet të marrë më qera, pasi nuk ka në pornësi një mjetin e saj. Mbetjet pasi grumbullohen depozitohen në venddepozitimin që ndodhet në fshatin Shilbatër-Kyçyk, 17km larg qendrës së NJA.

- **Vendepozitimi i mbetjeve**

Për sa i përket vend-depozitimit të mbetjeve, në Bashkinë Elbasan, mbetjet urbane pasi grumbullohen, depozitohen në venddepozitime të ndryshme ose në pika ilegale. Më konkretisht, mbetjet e Bashkisë Elbasan po transferohen për në landfillin e ri pranë dampës ku do të ndërtohet inçerneratori dhe impjanti trajtimit të ujrave të ndotura urbane. Landfilli **Papër-it**, i cili ndodhet rreth **5km** larg nga qendra e qytetit. Ky venddepozitim do të vihet në funksion plotësisht prej vitit 2017 duke plotësuar kushtet teknike dhe higjeno-sanitar të nevojshme për të marrë zyrtarisht statusin e një Landfilli Rajonal.

Studimi i fizibilitëtit, i financuar nga ''Agjensia Valonë e Eksportëve dhe Investimeve për të huajt", e ka projektuar si një landfilli rajonal, duke inkorporuar në projektnjë qendër seleksionimi në zonën e Papërit, e cila do ti shërbejë gjithë Qarkut Elbasan. Ky studim është përgatitur me kërkesën dhe në bashkëpunim me Bashkinë dhe Qarkun Elbasan. Nëpërmjet Ministrisë së Financave, i është bërë kërkesë ''Agjencisë Valone e Eksportëve dhe Investimeve për të huajt", për financimin e projektit për ndërtimin e këtij landfilli[396].

Më dt.27/01/2015 me vendimin Nr.1 të Këshillit Kombëtar të Territorit është miratuar Leja e Ndërtimit për këtë instalim dhe menjëherë ka nisur aktiviteti ndërtimit të tij[397].

Megjithëse në relacion sqarohet se impakti mjedisor në akuiferin e shkumbinit nuk do të ndodh dhe gjithashtu ujrat sipërfaqësor janë të mbrojtur nga infrastruktura e brëndshme e këtij instalimi, cilësojmë se masat infarstrukturore nuk janë masa mjedisore të mirfillta dhe se nuk janë subjekt përdorimi si reference në masat e marra për mbrojtjen e mjedisit.

Figura 147. Projekti i ndërtimit të landfill rajonal në Bashkinë Elbasan



Burimi: Relacioni Teknik-Albtek Energy

Hapsira totale që do të marrë ky instalim është 16'000m^2 nga ku 10'000 m^2 do të jenë sipërfaqe depozituese e landfillit dhe pjesa tjetër do të shërbej për infrastrukturën dhe ndërtimi godinave të operatorëve.

Ujrat e shiut janë evidentuar të kullohen me sistem të ndarë nga ai i kanalizimeve dhe më pare se të derdhen në shkumbin ato do ti nënshtrohen paratrajtimit.

Sa i përket ndotjes vizuale, akustike dhe të ajrit, referuesi ka ciklësuar se do të rrespektohen normat Europiane por pa përmëndur sasi të parashikuara që do të gjenerohen për secilën kategori dhe masat specifike që do ti nevojiten specifikisht asaj tip teknologjie që dë të instalohet në Papër të Elbasanit.

Sa i përket venddepozitimit të mbetjeve i cili përdorej deri para pak kohësh, paraqet probleme të mëdha për sa i përket ndotjes së mjedisit dhe rrezikimit të shëndetit të banorëve për arsye të ndryshme. Së pari, ai ndodhet buzë lumit Shkumbin, në një largësi jo më tepër se **100m nga shtrati i lumit,** duke ndotur vazhdimisht ujrat sipërfaqësor të lumit Shkumbin si edhe akufierin e Shkumbinit, kjo pasi pozicioni në të cilin ndodhet venddepozitimi i vjetër i Elbasanit është i papërshtatshëm nga ana gjeologjike për shkak se ndodhet në një territor me shtresa gjeologjike të cilat kanë koefiçent të lart të infiltrimit të ujrave nga sipërfaqja.

Duke patur referencë hartat dhe raportet e SHGJSH[398], akuiferi nga pjesa jugore e Elbasanit deri në afërsi të Cërrikut është me përbërje aluvionale (zhavorrore dhe poroze). Një terren i tillë bën të mundur depërtimin e shllamit të mbetjeve në ujërat e lumit Shkumbin dhe më tej në ujërat e akuiferit të Elbasanit, i cili përdoret për furnizimin me ujë të popullsisë Elbasan dhe të zonave përreth. Me pak fjalë, lëndët toksike që çlirohen gjatë procesit të shpërbërjes së mbetjeve në venddepozitim depërtojnë drejtpërsëdrejti në ujrat nëntokësore të akuiferit të Elbasanit duke rrezikuar shëndetin e popullsisë së zonës si dhe duke ndotur

Shkumbinin dhe tokën përreth. Ndotja është edhe më e theksuar në kohë reshjesh të cilat përshpejtojnë depërtimin e ujërave sipërfaqësore në akuiferin e Elbasanit.

Ndotje shkaktohet edhe nga çlirimi i gazrave toksike (metani CH_4) si produkt i proçesit të kompostimit të shtresave më të vjetra të mbetjeve organike dhe jo vetëm. Ky produkt kimik, në formën e tij të gaztë mund të kapej me anë të skemave të rikuperimit ku të përpunohej e të ofrohej si një LDG (Lëndë Djegëse Gaz) për të prodhuar enegji elektrike ose mekanike.

Në rastin e vend-depozitimit Elbasan, gazi metan, çlirohet i gjithi në atmosferë duke kontribuar si gaz i efektit serë gjithashtu duke ndotur me aromën e tij të fortë.

Figura 148. Ndryshimet vizuale të hapësirës së përdorur nga venddepozitimi në harkun kohor 2005-2015



Burimi: ASIG 2007 dhe ASIG 2015

Ky venddepozitim nuk ka status ligjor si landfill ndaj edhe ndërhyrjet të ciat po ndërmerren për rehabilitimin e kësaj sipërfaqeje dhe ndalimin e aktivietit të depozitimit të mbetjeve paraqitet si mjaft të nevojshme.

Gjithashtu, nëpërmjet fotove ajrore, janë vënë re ndryshime në shtrirjen dhe hapsirën që ka marrë ky venddepozitim gjatë periudhës 2005-2015. Këto ndryshime të forta në shtrirjen që ka zënë ky venddepozitim kanë ndryshuar edhe mikrotipologjinë e truallit ku ndodhet ky venddepozitim brenda një harku kohor 5-10-vjeçar. Përveç ndotjes së ujit, venddepozitimi paraqet probleme edhe në lidhje me ndotjen e ajrit për shkak të djegies së mbetjeve plastike që kryhet në këtë zonë.

Figura 149. Foto nga venddepozitimi i mbetjeve Elbasan



Burimi: Arkiva Co-PLAN


Si përfundim, mund të vlerësohet se proçesi i transferimit të mbetjeve nga venddepozitimi i vjetër në jug të Elbasanit drejt landfillit të ri i cili po ndërtohet në Papër duhet shoqëruar me një proçes rehabilitimi të të gjithë zonës në mënyrë që të mos mbartet si një vatër e nxehtë mjedisore që rrezikon shëndetin e banorëve të Elbasanit dhe ndotjen e mëtejshme të lumit Shkumbin.

- **Mbetjet inerte (mbetjet nga ndërtimi dhe shkatërrimi)**

Gjatë vitit 2015, Bashkia Elbasanka prodhuar një sasi mbetjesh prej 30,821 m^3/vit, të krijuara nga ndërtimet, rikonstruksionet si dhe prishjet e objekteve pa leje. Deri më sot, Bashkia nuk ka një venddepozitim të posaçëm për depozitimin e mbetjeve inerte.

Në vitin 2014, pjesa më e madhe e mbetjeve inerte është përdorur për të mbushur gropat e moçaleve të krijuara nga marrja e inerteve. Megjithatë, në të shumtën e rasteve, mbetjet inerte depozitohen në venddepozitimin e mbetjeve urbane, qoftë si shtresë mbuluese apo të vendosura pirg në pjesën kufijtare të tij.

Figura 150. Grafiku i gjenerimit te mbetjeve inerte në vite, Bashkia Elbasan krahasuar me mesataren në Republikën e Shqipërisë



Burimi: INSTAT, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Zonë problematike në lidhje me mbetjet urbane dhe inerte në qytetin e Elbasanit është zona përgjatë brigjeve të lumit Shkumbin si edhe përroi të Zaranikës. Bregu dhe disa pjesë të argjinaturës së lumit janë të mbuluar me mbetje inerte dhe dallohen qartësisht seksione ku shtrati i lumit është shfrytëzuar pa kriter për nxjerrje inerti[399].

Zona ripariane e anëve të lumit dikur e mbjellë me pemë dhe vegjetacion mbrojtës, sot është thuajse tërësisht e zëvendësuar nga masive inertesh ose mure mbajtëse b/a.

Këto ndërhyrje nuk e kanë ndaluar erozionin anësor të lumit, veçse e kan zhvendsur atë në seksione të tjera më të ndjeshme.

- **Mbetjet Spitalore**

Sipas të dhënave të grumbulluara nga ARM & Bashkia Elbasan, sasia totale e vlerësuar për mbetjet spitalore të prodhuara në Elbasan është rreth 22 ton/vit[400]. Mbetjet prodhohen nga 142[401] subjekte. Kjo sasi përfshin mbetjet e prodhuara nga Spitalet, qendrat shëndetësore, si dhe laboratoret stomatologjike dhe mjekësore.

Mbetjet spitalore menaxhohen nga subjekti privat Medi-Tel, të cilat i tërheqin mbetjet periodikisht sipas kontrates se lidhur me subjektet përkatëse. Kompania MediTel ofron shërbimin e sterilizimit dhe grirjes së mbetjeve spitalore dy herë në javë. Kjo mënyrë e trajtimit të këtyre mbetjeve zvogëlon vëllimin e tyre me anë të shpërbërjes mekanike, për t'i administruar më pas mbetjetet si urbane, jo të rrezikshme për komunitetin dhe mjedisin.

Nga të gjitha njësitë gjeneruese të mësipërme aktualisht MediTel trajton mbetjet e vetëm 30-35%[402] të sasisë së vlerësuar të mbetjeve të gjeneruara në total. Njësitë spitalore i trajtojnë mbetjet e prodhuara me djegie jashtë kushteve teknike dhe më pas groposen ose depozitohn në vendgrumbullimin e mbetjeve urbane. Aktualisht Qendra Shëndetësore Elbasan nuk posedon një Autzoklave[403].

Problematike mbeten edhe mbetjet farmaceutike. Rezulton se asnjëra nga farmacitë nuk ka mardhënie kontraktuale me ndonjë nga subjektet e liçensuara në fushën e trajtimit të mbetjeve spitalore. Farmacitë i menaxhojnë vetë mbetjet thjesht duke i depozituar në kazanët e mbetjeve urbane ose drejtpërdrejt në venddepozitimin kryesor të mbetjeve. Siç

mund të shihet, sa i takon menaxhimit të mbetjeve, farmacitë kryejnë aktivitetitn e tyre jashtë të gjithave kushteve ligjore.

Tabela 77. Prodhuesit e mbetjeve spitalore

Kategoria	Elbasan
Depo Farmaceutike	1
Farmaci	80
Klinikë Dentare	48
Klinikë Mjeksore	1
Laboratore	9
Qendra Shëndetësore	1
Spitale	2
Total	142

Burimi: RGJMS, 2015

- **Mbetjet Industriale**

Në Elbasan ushtrojnë aktivitetin e tyre biznese të ndryshme në fushën e ndërtimit, agro-ushqimore, industri përpunuese, etj. Sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve industriale, bizneset duhet të mbajnë regjistrin e mbetjeve të prodhuara. Situata lidhur me mbetjet industriale në Bashkinë Elbasan mbetet ende e paqartë dhe informacioni rreth këtij fluski mbetjesh nuk është lehtësisht i aksesueshem. Vlerësohet se Bashkia Elbasan prodhon në total rreth 117 ton mbetje në ditë prej të cilave paraprakisht është vlerësuar se 14% e tyre janë mbetje Industriale. Pra mund të konkludohet se Elbasani prodhon rreth 5,986 ton mbetje industriale në vit[404].

Duhet theksuar se një pjesë e këtyre aktiviteteteve prodhojnë mbetje të rrezikshme dhe si të tillë janë subjekt i trajtimit të këtyre mbetjeve nëpërmjet Ligjit 10463 dt.22.09.2011, ku cilësohet se këto mbetje duhet rigorozisht të monitorohen, regjistrohen dhe transportohen siç përshkruhet në ligj. Më poshtë paraqitet lista ekzistuese e aktiviteteve gjeneruese të këtyre mbetjeve në Bashkinë Elbasan, të cilat janë të pajisura me Leje Mjedisore.

Tabela 78. Aktivitete që prodhojnë mbetje industriale (sipas lejeve mjedisore)

AKTIVITETE GJENERESE TE MBETJEVE NE BASHKINE ELBASAN - SIPAS LEJEVE QE POSEDOJNE						
Aktiviteti	Vendndodhja	Subjekti	Kategori Katalogu	Tipi Mbetjeve te Gjeneruara	Tipi Lejes	
Karrierë Gëlqerore	Kërrabë Elbasan	**Salillari**	1	Mbetje që dalin nga kërkimet e shfrytëzimi i minierave dhe karrierave, si edhe nga trajtimet Fiziko-Kimike të Minierave.	B	
Prodhim Gëlqerori Pllakor	Elbasan	**Elbesa**	01 05	Mbetje që dalin nga kërkimet e shfrytëzimi i minierave, si edhe nga trajtimet Fiziko-Kimike të Minierave.	B	
Ranor Kuarcor	Elbasan / Gur i zi	**Alb-Doni**	01 05	Mbetje që dalin nga kërkimet e shfrytëzimi i minierave, si edhe nga trajtimet Fiziko-Kimike të Minierave.	B	
Karrierë Gëlqerore	Letan Elbasan	**Rruga Ura**	1	Mbetje që dalin nga kërkimet e shfrytëzimi i minierave dhe karrierave, si edhe nga trajtimet Fiziko-Kimike të Minierave.	B	
Karrierë Gëlqerore	Letan Elbasan	**United Quarries**	1	Mbetje që dalin nga kërkimet e shfrytëzimi i minierave dhe karrierave, si edhe nga trajtimet Fiziko-Kimike të Minierave.	B	
Karrierë Gëlqerore	Rrezlik Shelcan/ Elb	**Vëllezërit Hysa**	1	Mbetje që dalin nga kërkimet e shfrytëzimi i minierave dhe karrierave, si edhe nga trajtimet Fiziko-Kimike të Minierave.	B	
Karrierë Gëlqerore	Balldre, Elbasan	**Y.Salla**	1	Mbetje që dalin nga kërkimet e shfrytëzimi i minierave dhe karrierave, si edhe nga trajtimet Fiziko-Kimike të Minierave.	B	
Prodhim Skorje Fe-Cr	Elbasan	**Karbonike**	01 05	Mbetje që dalin nga kërkimet e shfrytëzimi i minierave, si edhe nga trajtimet Fiziko-Kimike të Minierave.	B	
Karrierë Argjilore	Elbasan	**Elbasan Cement Factory**	01 05	Mbetje që dalin nga kërkimet e shfrytëzimi i minierave, si edhe nga trajtimet Fiziko-Kimike të Minierave.	B	
Karrierë Argjilore	Elbasan	**ALBTEK Energy**	01 05	Mbetje që dalin nga kërkimet e shfrytëzimi i minierave, si edhe nga trajtimet Fiziko-Kimike të Minierave.	B	

Burimi: ARM Elbasan

Legjendë Orientuese	
Mbetje Organike	
Mbetje Inerte	
Mbetje Industriale	

Në listën e Zonave më të Nxehta Mjedisore[405] bëjnë pjesë edhe:

- Ish Uzina e shkrirjes së ferrokromit, e cila prodhonte 400,000m3 mbetje industriale
- Kompleksi Metalurgjik, i cili prodhon sasi të mëdha të metaleve të rënda dhe kimikateve toksike
- Ndërmarrja e Furnizimit Industri-Miniera në Balëz, ku prodhohen 30 ton Cianid

Në Elbasan ndodhet gjithashtu Uzina e Lëndëve Plasëse në fshatin Mjekës edhe pse nuk është renditur si hotspot, pasi ndikimi i saj në popullsi, në turizëm dhe në biodiversitet nuk përbën një rrezik të lartë[406].

Një tjetër aspekt tepër problematik407 deri në Shkurt 2016 ka qënë mënyra e trajtimit të mbetjeve industriale dhe ndotjes në ajër nga kompania KURUM. Shpesh kushtet teknike të trajtimit të mbetjeve industriale si edhe kushtet e lejes mjedisore nuk zbatoheshin duke stokuar mbetjet industriale në afërsi të lumit dhe problematike shfaqej situata dit pas dite kur, filtrat e furrës nuk ndizeshin dhe metalet e rënda flokulonin në ajër duke u shpërndarë më pas në një rreze mjaft të gjerë (kjo në varësi të trëndafilit të erës).

Kombinati Metalurgjik i Elbasanit

Uzina e Shkrirjes së Ferrokromit është përcaktuar si një ndër 35 vatrat e nxehta mjedisore të vendit tonë[408] , kjo për arësye se mbart 400,000m^3 mbetje industriale të rrezikshme. Për përcaktimin e llojit të ndotjes dhe shtrirjes gjeografike të ndotjes që ky kombinat ka shkaktuar në mjedis, janë kryer shumë studime[409], të cilat kanë arritur se përfundimin se toka në brendësi dhe përreth Kombinatit Metalurgjik është ndotur me metale të rënda si Cd[410], Zn[411], Cu[412], etj. Nga studimi i kryer nga Tota et al. në vitin 2007, rezulton se ndotja e tokës bujqësore me metale të rënda (Cd, Zn, dhe Cu) përreth Kombinatit Metalurgjik[413] ka një rreze shtrirjeje 2-5km, përreth Kombinati është më e theksuar. Toka bujqëore në Papër, Bradashesh dhe përreth Metalurgjikut është ndotur me Cr[414]. Një studim tjetër[415] ka monitoruar ndotjen në qytetin e Elbasanit në pika të ndryshme të qytetit për të parë largësinë në të cilën era ka trasportuar ndotjen nëpërmjet pluhurit. Sipas këtij studimi, për metalet e rënda si Cr[416], Ni[417], dhe Pb[418], ndikimi në mjedis është më i lartë nëpërmjet ajrit sesa tokës. Ndotja më e lartë me Cr është në zonën veri-perëndimore ku ndodhet edhe Metalurgjiku. Vlerat më të larta të Fe gjenden në pjesën jugore, afër unazës së qytetit e cila shpjegohet me transportin e skorjeve të Fe-Ni nëpërmjet kësaj rruge. Të gjitha vlerat e Fe janë më të larta se standarded mjedisore. Toka është ndotur me Cr, Zn dhe Fe ndërsa nëpërmjet ajrit është ndotur mjedisi me Fe[419], Mn[420], Zn, Cr, Ni dhe Pb.

Ndërmarrja e Furnizimit Industri-Miniera (NFIM) ndodhet në Balëz. Sipas raportit të UNECE-s, në Balëz ruhen 30 ton cianur. Me VKM 843, datë 14 Dhjetor 2015, kjo ndërmarrje është shndërruar në Qendër të Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme dhe është në varësi të ministrisë së industrisë. Qendra ka si qëllim ofrimin e shërbimeve për identifikimin, "grumbullimin, përgatitjen për eliminimin, depozitimin dhe ruajtjen e kimikateve të rrezikshme"[421].

Sipas AKM-së, deri më tani, janë kryer studimet e Verësimit të Ndikimit në Mjedis dhe planet e veprimit për rehabilitimin afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, dhe kostot e vlerësuara për rehabilitimin dhe monitorimin e Uzinës së Shkrirjes së Ferrokromit.

Uzina e Lëndëve Plasëse[422] në Mjekës ka shërbyer edhe për asgjesimin e lëndëve plasëse. Si rrjedhojë e këtij aktiviteti, zona përreth uzinës është ndotur me lëndë plasëse dhe metale të rënda si Pb, Cr, Cu, Mn në nivele shumë të larta.

Tabela 79. Përmbajtja e metaleve të rënda dhe lëndëve plasëse në Uzinë

Stacioni	Pb (mg/kg)	Cr (mg/kg)	Cu (mg/kg)	Ni (mg/kg)	Cd (mg/kg)	Mn (mg/kg)	TNT (mg/kg)
ULP Mjekës	21.4	32.3	29.6	21	0.4	11.6	0

Burimi: AKM 2014, Raporti i Gjendjes në Mjedis 2014

Sipas AKM, lëndët plasëse janë në përqëndrim shumë të lartë në llumin e kanaleve të shkarkimit të ujërave industriale edhe pse përmbajtja e tyre ulet ndjeshëm në pikën e shkarkimit[423].

Tabela 80. Shkarkimet e lëngëta industriale në Uzinën Mjekës

Stacioni	pH	NKO (mg/l)	CN (mg/l)	NO3- (mg/l)	NO2- (mg/l)	NH4+ (mg/l)	TNT (mg/l)
ULP Mjekës	6.5	46.3	0	1.18	0.36	6.735	8.7

Burimi: AKM 2014, Raporti i Gjendjes në Mjedis 2014

Në Uzinë është kryer edhe matja e gazeve NO_2, CO, CO2, SO_2 , NH3, Toluen, Vox, H_2S rreth 5m larg nga furra e djegies së fishekëve dhe predhave. Matjet janë kryer në periudha 3-4 muaj larg nga njëra tjetra. AKM ka arritur në përfundimin se çlirimi i gazeve në atmosferë është brenda niveleve të përcaktuara në VKM-të përkatëse, duhet shtuar se në uzinë nuk ka stacione të qëndrueshme që bëjnë matjen e vazhdueshme të gazrave të mësipërme gjatë gjithë vitit.

Mbetjet ushtarake industriale që dalin nga furrat ruhen brenda territorit të godinës, në pritje të depozitimit të tyre në landfille të përshtatshme që deri më tani mungojnë në vendin tonë. Si rrjedhojë, për aq kohë sa Shqipëria nuk ka një landfill të tillë, këto mbetje do të vazhdojnë të ruhen në territorin e uzinës.

Ndotje të tjera industriale

- Fabrika e çimentos.

Ndodhet në zonën indstriale të Elbasanit dhe është përcaktuar si një nga ndotësit më kryesorë të mjedisit për shkak të sasisë së madhe të pluhurave të dëmshme që çliront në atmosferë. Sipas raportimeve të Shërbimit Gjeologjik Shqipëtar (SHGJSH), përmbajtja e tyre në dalje të oxhakut arrin në 47-70gr/m^3N[424]. Përmbajtja e pluhurit në çlirimin e gazrave nga fabrika është raportuar si e lartë (0.975 dhe 0.617 mg/m^3 kundrejt përkatësisht 0.5 mg/m^3 dhe 0.07mg/m^3 që janë normat aktuale) edhe nga vetë industria. Pluhurat e fabrikës shpërndahen përgjatë gjithë qytetit dhe zonave bujqësore nëpërmjet erës duke ndotur këto zona[425]. Sasia dhe përqendrimi i elementëve ndotëse që lëshohen nëpërmjet shkarkimeve të gazta e të ngurta të këtyre uzinave konsiderohet e lartë dhe përbën një burim të vazhdueshëm ndotës për zonën. Aktualisht kjo fabrikë nuk gjeneron ndotje si pasoje e pushimit të aktivitetit të saj.

- Kombinati Metalurgjik

Shtrihet në Fushën e Bradasheshit, 2-3 km në jugperëndim të qytetit të Elbasanit. Në territorin e kombinatit ndodhen të depozituara rreth 1.1 milion ton pluhura të kapura nga sistemet e pluhurkapjes (filtrat) të uzinës 12 dhe që kanë përmbajtje të lartë nikeli (Ni). Nga studimi i kryer nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar në vitet 2005-2008 mbi ndikimin mjedisor të veprimtarisë industriale në rajonin e Elbasanit, përmbajtjet e metaleve të rënda Ni, Cr, Co, Zn, Fe, Mn në zonën industriale të Kombinatit të Metalurgjisë së hekurit rezultojnë dhjetëra herë më të larta se sfondi gjeokimik natyror duke përbërë një burim të

rëndësishëm ndotje[426]. Ndotja me metale të rënda e shkaktuar nga ky kombinat shtrihet deri në 30km nga burimi i ndotjes duke përfshirë edhe zonën urbane dhe tokat bujqësore.

- Shkarkimet e ngurta industriale[427]

Duke patur një ndër zonat më të industrializuara të vendit, Bashkia e Elbasanit është ndeshur edhe me problemin e depozitimit të mbetjeve të ngurta industriale gjatë gjithë kohës që industria e ferro-kromit, kombinatit metalurgjik, dhe fabrika e çimentos kanë ushtruar aktivitetin e tyre në bashki. Si pasojë e aktivitetit të tyre ndër vite, sot në bashki ndodhen disa vend-grumbullime të mbetjev industriale të cilat janë renditur më poshtë[428]:

a) Zona buzë lumit Shkumbin
   Shtrihet përgjatë brigjeve të lumit përpara zonës industriale dhe ka një sipërfaqe rreth 1.5 ha. Sipas SHGJSH-së, në këtë zonë janë depozituar mbetjet e ngurta (skorje furrnalte, skorje çeliku të zeza e të bardha, mbeturina veshjesh zjarrduruese, mbeturina çeliku e gize, okaline etj) të furrnaltës së Uzinës së Çelikut dhe Uzinës Mekanike. Sasia e depozituar arrin derin në 1.5-2 milion tonë. Mbetjet përmbajnë metale të rënda që përbëjnë shqetësim për ndotjen e ujërave të shkumbinit dhe zonës përreth.
b) Dampa e TEC-it
   Në dampë janë depozituar rreth 200-300 mijë ton hi edhe ky me përmbajtje lëndësh të ndryshme.
c) Dampa e mbeturinave të uzinës 12 në zonën e Paprit ku janë të depozituara sasira të mëdha koncentrati hekuri që vlerësohet se janë rreth 500 mijë ton.
d) Zona e depozitimit të skorjeve të ferrokromit sasia e përafërt e të cilave është rreth 500 mijë ton.
e) Dampa e shllameve të Fe-Ni.
   Kjo dampë ndodhet në anën jugore të zonës industriale dhe ishte projektuar për të depozituar mbetjet teknologjike dhe skorie të kombinatit metalurgjik. Dampa është një gropë gjigante e aftë të depozitojë miliona tonë mbeturina për rreth 50 vjet.

Ndikimi i ndotjes me metale të rënda nga burimi ndotës (zona industriale) shtrihet deri në zonën urbane të qytetit të Elbasanit në rritjen e përmbajtjeve të këtyre elementëve në toka. Kjo veprimtari industriale ka ndikuar edhe në ndotjen e tokave bujqësore me shtrirje deri në 30 km nga burimi ndotës[429].

- Shkarkimet e lëngëta industriale

Gjatë gjihë kohës së funksionimit të zonës industrial, SHGJSH raporton se të gjitha ndotjet e lëngëta janë shkarkuar dhe shkarkohen në lumin Shkumbin.

Bashkia Elbasan ka të rregjistruar në të gjithë Nj.A e saj rreth 710 biznese[430] prodhuese dhe shfrytëzimi të cilat indirekt janë edhe ato kontribues në gjenerimin e mbetjeve industriale të kategorive të ndryshme.

Mbetjet Elektronike

Rregullat për trajtimin dhe kasifikimin e mbejteve E.E nuk parashikojnë depozitimin e tyre në landfill. Pra aktualisht Bashkia Elbasan duke qënë se të gjitha objektet apo materialet e klasifikuara si mbetje i menaxhon duke i transportuar dhe stokuar në Venddepozitimin Elbasan, lind nevoja që të ndërtohet një qëndër për trajtimin e diferencar të kësaj rryme.

Gjenerues të këtyre mbetjeve janë si familjarët ashtu edhe bizneset private që operojnë në Bashkinë Elbasan. E vetmja mënyrë pët të arritur menaxhimi mbetjeve tek ata dhe jo mbetja tek konteineri është nëpërmjet realizimit të nj plani specifik të menaxhimit për këtë rrymë dhe aktivizimi i fushatave sensibilizuese.

Mbetje të tjera

Ndër mbetjet e tjera mund të klasifikojmë:

- Mbetjet nga gomat e përdorura,
- Mbetjet nga Karakasat e Makinave
- Mbetjet nga vjarat e përdorur. etj

Edhe këto rryma të identifikuara, siç ndodh me mbetjet EE nuk diferencohen apo të trajtohen por

grumbullohen sëbashku me mbetjet urbane dhe derdhen në vendepozitimet e përcaktuara.

Diferencimi në burim si edhe trajtimi i seleksionuar sipas parimit Redukto – Ripërdor – Riciklo është sfida më e madhe që parashtrohet në Bashkinë Elbasan, sfidë e cila vjen paralelisht me rehabilitimin e zonave të ndotura nga depozitimi jashtë kushteve teknike të mbetjeve deri më sot.

Tabela 81. Lista e aktiviteteve minerare-Elbasan[431]

Nr	Vëndndodhja	Emërtimi i objektit	Koordinatat		Nr	Vëndndodhja	Emërtimi i objektit	Koordinatat	
			x	y				x	y
1	Bradashesh	Gelq.dolomitizuar	4420962	4558907	*15*	Bradashesh	Inerte lumore	4422162	4551639
2	Labinot	Gel.pllakor	4429500	4557500	*16*	Labinot Fushë	Inerte lumore	4427178	4554418
3	Labinot	Gel.pllakor	4423950	4569000	*17*	Labinot Fushë	Inerte lumore	4434451	4558944
4	Gjinar	Gëlqerorë	4431473	4546593	*18*	Bradashesh	Zonë industriale	4417513	4551956
5	Shushicë	Gëlqerorë	4427968	4551341	*19*	Bradashesh	HOTSPOT	4416500	4550700
6	Bradashesh	Gëlqerorë	4419953	4558646	*20*	Mjekës	Uzina mjekes	4421640	4549840
7	Tregan	Gëlqerorë	4422907	4547721	*21*	Memël	Fabrika Çimentos	4415588	4561620
8	Tregan	Rëra kuarcore	4423521	4547198	*22*	Elbasan	VD.urbane	4426226	4553294
9	Shirgjan	Rëra kuarcore	4422138	4548307	*23*	Elbasan	VD.urbane MbU	4417545	4548958
10	Bradashesh	Rëra kuarcore	4416209	4552244	*24*	Memël	Dampa F. Çimentos	4459960	4552900
11	Klos	Inerte lumore	4420641	4537729	*25*	Memël	Qymyr	4450300	4535350
12	Klos	Inerte lumore	4416850	4539675	*26*	Memël	Qymyr	4414092	4560529
13	Shirgjan	Inerte lumore	4418180	4549782	*27*	Bradashesh	Dampa z. industriale	4417719	4551465
14	Shirgjan	Inerte lumore	4421323	4550354	*28*	Bradashesh	Dampa e Fe-Cr	4415753	4550292

Burimi: AKBN

Lista e mësipërme paraqet aktivitetet gjeneruese të mbetjeve inerte dhe industriale të cilatj janë gjeoreferencuar nëpërmjet koordinatave në UTM.

Në funksion të gjeneruesëve të identifikuar si edhe atyre potencial nevojitet që të merren masa për trajtimin e mbetjeve me origjinë industriale, pra mbetjeve me potencial rreziku të lartë. Duke qënë detyrim ligjor i adresuar vetë prodhuesit qoftë nga Ligji Nr. 9537, datë 18.5.2006 por edhe nga leja Mjedisore që ata posedojnë, Bashkia Elbasan mund të asistojë në përcaktimin e një pozicioni ku këto mbetje do të depozitohen dhe trajtohen të diferencuara.

- **Riciklimi**

Për sa i përket riciklimit të mbetjeve, në Bashkinë Elbasan nuk dihet sasia e saktë e ricikluar. Bashkia Elbasan raporton që komuniteti Rom dhe Egjiptioan është ndër operatorët kryesorë jo formalë për grumbullimin e mbetjeve të plastikës. Mbetjet e ricikluara janë zakonisht alumini dhe hekuri dhe vitet e fundit është rritur interesimi mbi plastikën.

Riciklimi ndodh nëpërmjet kompanive private të cila operojnë në venddepozitimin e vjetër të mbetjeve në pika të tjera grumbullimi.[432] Megjithëse një proçes kryesisht informal, riciklimi mbetet i domosdoshëm, synimi i bashkisë menjëherë pas përfundimit të landfillit në Papër duhet të jetë formalizimi dhe kontraktimi i proçesit të riciklimit në të gjithë Bashkinë Elbasan si edhe të synojë riciklimin në masën 60% kundrejt totalit të mbetjeve të riciklueshme duke reduktuar gjithnjë e më tepër sasinë e mbetjeve të riciklueshme të cilat zënë volume të mëdha në landfill-e.

Tabela 82. Lista e lëndëve që riciklohen

Loji	Përmbajtja në %
Letër	10
Tekstile	4,4
Plastikë	10
Qelq	11
Qelq e Metale	13
Metale	2
Hekur	-
Lëndë Organike	25
Lëndë Inerte	37,6
Të tjera	0,01
Total	100

Burimi: RGJM Elbasan 2015

1.7.5 Sistemi i kullimit dhe ujitjes

Infrastruktura bujqësore është tërësia e rrjetit të kanaleve vaditëse dhe kulluese sipas kategorisë sidhe të gjitha veprat inxhinerike në funksion të bujqësisë siç janë argjinaturat, rezervuaret ujitëse, digat, stacionet e pompimit dhe hidrovoret.

Metodologjia e përdorur nga grupi i punës për analizën e infrastrukturës bujqësore është mbështetur në informacionin e marr nga vizitat në terren dhe materialet punuara mëpar nga Bashkia Elbasan.

Së pari ne do të shpjegojmë mënyën e funksionimit të infrastrukturës bujqësore, më pas do të bëjmë një analizim të legjislacionit dhe kompetencave mbi administrimin e këtyre

infrastrukturave, do të bëjmë një analizim më të detajuar të rrezervuareve dhe agjinaturave të cilat ndodhen në territorin e Bashkisë Elbasan. Së fundmi do të bëjmë një analizim të gjendjes egzistuese të kanaleve vaditëse dhe kulluese sipas kategorive të tyre.

- **Mënyra e funksionimit të infrastrukturave bujësore**

Infrastruktura bujqësore kryesisht përbëhet nga rrjeti i kanaleve që janë të ndarë në kanale vaditëse dhe kulluese.

Kanalet vaditëse kanë funksion që të bëjnë shpërndarjen e ujit të domosdoshëm në parcelat bujqësore. Kanalet vaditëse i kemi të tre kategorive: kanale të parë, të dytë dhe të tretë. Kanalet e parë janë kanalet kryesorë të cilët çojnë ujin nga rrezervuarët drejt tokave të cilat do të vaditen më pas shpërnadja e ujit kalon nga kanalet e para në të dyta dhe në fund në kanalet e tretë.

Kanalet kulluese janë kanalet që bëjnë mbledhjen e ujit të tëpërt të parcelave bujqësore dhe e çojnë atë drejt lumenjve liqenve ose detit. Këto kanale janë po aq të rëndësishme sepse mbrojnë tokën bujqësore nga përmbytjet. Kanalet e treta kulluese mbledhin ujin nga parcelat e vogla dhe çojnë në kanalet sekondare ose të dyta e më pas në kanalet kryesore që çojnë ujin në lumenj ose në dete.

Argjinaturat janë një pjesë e rëndësishme e infrastrukturës bujqësore sepse bëjnë mbrojtjen e tokave bujqësore nga vërshimet e lumenjve. Gjithashtu rezervuarët janë vendepozitimet e ujit të cilat janë të lidhura kryesisht me kanalet kryesore vaditëse dhe shërbejnë si ushqyes kryesore të ujit me të cilin vaditen tokat bujqësore.

- **Korniza ligjore mbi kullimin dhe vaditjen**

Korniza ligjore mbi administrimin dhe menaxhimin e infrastrukturës bujqësore shërben për të kuptuar kompetencat e institucineve të ndryshme mbi administimin e kësaj infrastrukture. Ligji kryesor që tregon mbi administrimin dhe menaxhimin istitucional dhe percakton të gjitha direktivat ligjore mbi infrastrukturën bujqësore është ligji nr 8518 datë 30.7.1999 " Për Kullimin dhe Vaditjen".

Më zhvillimin e reformës Territoriale-Administrative edhe menaxhimi institucional i një pjese të infrastrukturës bujqësore ka ndryshuar. Këto ndryshime ligjiore mbi kompetencat institucionale i paraqesin dy VKM. VKM nr 691, datë 29.07.2015 " Për miratimin e Stategjisë për Decentalizim dhe Qeverisje Vendore 2015-2020" dhe VKM nr 1108, datë 30.12.2015 " Për Transferimin , nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave tek bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme dhe të pa luajtshme të bordeve rajonale të kullimit". Ligjet që sapo përmendëm tregojnë administrimin institucional dhe menaxhimin e infrastrukturës bujqësore si më poshtë:

- **Ligji nr. 8518 datë 30.7.1999 " Për ujitjen dhe kullimin" i ndryshuar me ligjin nr.9860 datë 21.01. 2008.** Ky ligj përcakton Mistrinë e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave si organ kryesor përgjegjës për administrimin e ujitjes dhe kullimit. Menaxhimi i skemave të kullimit dhe të vaditjes bëhet nga njësi më të vogla që janë Bordet e Kullimit të cilat ndodhen në çdo qark me perjashtim të Lushnjes që ka bord kullimi të veçuar. Në nenin 56 në pikën ç) përcaktohen distancat e ndërtimit të objekte në raport me infrastrkturën bujqësore (kanalet

vaditëse dhe kulluese). Distanca minimale që lejon ligji ne raport me kanalet kryesore është 8 metra dhe distanca minimale që lejon ligji në raport me kanalet dytësore dhe tretësore është katër metër. Bordet e kullimit janë struktura teknike të specializuara në vartësi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave.

- **Vendim i Këshillit të Ministrave nr.691, datë 29.07. 2015 "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020".** Thuhet se kjo strategji hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Për zbatimin e këtij vendimi legjislativ ngarkohen Ministri Çështjeve Vendore, ministritë, institucionet qendrore dhe njësitë e pushtitit vendor të përmendura në tekstin e kësaj strategjie. Në këtë strategji thuhët se në fushën e infrastrukturës së bujqësisë si funksion i ri , bashkive do tu shtohet administimi dhe menaxhimi i rrjetit dytësorë dhe tretsor.
- **Vendim i Këshillit të Ministrave nr.1108 ,datë 30.12.2015 "Për transferimin , nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave tek bashkitë, të infrastrukturëssë ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme dhe të pa luajtshme të bordeve rajonale të kullimit".** Në këtë vendim thuhet se bashkive i trasferohet e drejta e menaxhimit dhe administrimit të infrastrukturës bujqësore dytësore dhe tretsore, asetet të luajtshme dhe të pa luajtshme sidhe makinerive të rënda nga Bordet e Kullimit tek bashkitë në territorin e të cilave ndodhen këto infrastruktura.

- **Analiza e rezervuarëve ujitëse në Bashkinë e Elbasanit**

Tabela 83. Vëllimi dhe gjendja e teknike e rezervuarëve në Bashkinë Elbasan

Emri i Ujëmbledhësit	Vëllimi i Ujit (1000 m³)	Gjendja e trupit të Digës	Gjenda e Shkarkuesit	Gjendja e ujëlëshuesit
Balëz	120	jashtë pune	jashtë pune	bllokuar
Kryezjarrth	80	e mirë	e mirë	e mirë
Mlizë	70	e mirë	e mirë	e mirë
Shtërmen	50	pjesërisht e mirë	e mirë	e mirë
Tregan	-	e mirë	e mirë	e mirë

Burimi: Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe e Administrimit të Ujrave , 2016


Në tabelën e mësiperme renditen rezervuarët e Bashkisë Elbasan sipas gjendjes teknike dhe vellimit te ujit në m³. Rezervuari i Balëzës është më i madhi duke vazhduar me Kryezjarrin, Mlizën, Shtërmenin dhe në fund Treganin.

Tokat bujqësore në Bashkinë Elbasan ujiten kryesisht nga Lumi Shkumbin dhe nga Rezervuari i Mlizës, ndërsa rezervuarët e tjerrë kanë impakt më të vogël në zhvillimin bujqësorë sepse përdoren nga skema vaditëse më të vogla. Rezervuarët me problematikë përsa i përket gjendjes teknike janë Balëza dhe Shtërmeni.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave në Bashkinë e Elbasanit nuk kemi argjinatura. Problemi i përmbytjeve të tokave bujqësore vërehet kryesisht në tokat bujqësore përgjatë lumit Shkumbin por në përmasa të vogla.

Vlerësimi i gjendjes egzistuese të kanaleve bujqësore

Figura 151. Infrastruktura bujqësore sipas llojit të kanaleve



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Tabela 84. Infrastruktura bujqësore sipas llojit, kategorisë dhe gjendjes në Bashkinë Elbasan (km linear)

		Gjatësia (km linear)	
Kanale gjithësej		**85.7**	**100.00%**
Lloji	Kulluese	35.3	41.19%
	Vaditese	50.4	58.81%
Kategoria	Kanale të parë	53.1	61.96%
	Kanale të dytë	32.6	38.04%
Gjendja fizike	Të lirë	37.2	43.41%
	Për mirëmbajtje	36.2	42.24%
	Të bllokuar	12.3	14.35%

Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Toka bujqësore ndodhet kryesisht në pjesën qendrore të territorit të bashkisë, përgjatë luginës së Lumit Shkumbin, por informacioni që disponohet është për kanalet vaditëse dhe kulluese për NjA Shirgjan dhe Bradashesh ndërsa për njësitë e tjera nuk disponohet.

Nga të dhënat e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të ujërave, Bashkia Elbasan ka një rrejt prej 85.7 km linear kanale, 41.2 % e të cilave janë kanale vaditëse dhe 58.8% janë kanale kulluese. Rreth 62% e tyre janë kanale të para dhe 38% kanale të dyta. Rreth 43.4 % e rrjetit është në gjendje të plotë pune. 42.3 % e rrejtit ka nevojë për pastrime dhe rehabilitme të kanaleve dhe 14.3% e tyre janë plotësisht të bllokuar.

Nisur nga këto të dhëna rezulton se në 56 % të rrejtit të kanaleve bujqësore duhet të ketë ndërhyrje të menjëhershme në mënyrë që ky rrjet të jetë funksional në shërbim të sektorit bujqësor.

1.7.6 Konkluzione

Sistemi rrugor dhe transporti publik

- Bashkia Elbasan shtrihet në një pozicion strategjik të favorshëm duke parë që në këtë bashki kalon korridori VIII, i cili është një aks i rëndësishëm ndërkombëtar. Si pjesë e këtij korridori është projekti për ndërtimin e *by-pass*, i cili pritet të ndërtohet dhe do të kalojë në periferi të qyteti. Një tjetër intenerar i rëndësishëm është dhe autostrada që lidh qytetin e Elbasanit me Tiranën.
- Përsa i përket transportit ndërqytetas Bashkia e Elbasan lëvizshmërinë më të lartë e ka me qytetin e Tiranës dhe Lushnjen.
- Sipas draftit të Planit Kombëtar 2015-2030 që është duke u përgatitur nga AKPT-ja, Papër-i do të bëhet një nyje logjistike mjaft e rëndësishme sepse në këtë pikë do të fillojë boshti qëndror jugor i cili nis nga Tirana dhe përfundon në by-pass-in e Memaliajt ku bashkohet me korridorin e kaltër që vjen nga Levan-i i Fierit.
- Si pasojë e reformës territoriale, Bashkia e Elbasanit tashmë ka një shumëfishim të sipërfaqeve rrugore të cilat gjenden në territorin e saj në krahasim me ish-njësitë e vjetra administrative. Si pasojë e këtij ndryshimi edhe numri i sipërfaqeve të rrugëve ka ndryshuar, ku në këtë bashki mbizoterojnë rrugët lokale si dhe kemi kalimin nga rrugët urbane që shtrihej kjo bashki në rrugë rurale ku shtrihet sot.
- Nga analiza e infrastrukturës rrugore, një nga problemet kryesore që është evidentuar nga grupi i punës janë hyrje daljet (intersect-et) e rrugeve lokale me rrugët interurbane kryesore. Kjo analize është bërë në GIS dhe janë evidentuar 512 pika konfliktuale të cilat janë burim aksidenti për këtë bashki.

Shërbimi i ujit të pijëshëm

- Bashkia Elbasan ka aktualisht sasi të konsiderueshme që merren nga pusshpimet në Mengel, Kraste e Vogël dhe Frigoriferi për plotësimin e kërkesës aktuale për ujë duke pasur parasysh që humbjet teknike në sistem nuk janë më të mëdha se 35%.
- Në rreth 39% të popullsisë që banon në zonën rurale të Bashkisë Elbasan nuk ka sisteme të ndërtuara të furnizimit me ujë.
- Më problematike në drejtim të plotësimit të kërkesës për ujë paraqiten njësitë administrative Gjinar, Shushicë, Tregan, Shirgjan, Gjergjan, Funarë, Gracen dhe Labinot Mal.

Ujërat e ndotura

- Sistemi i largimit të ujërave të ndotur duhet rehabilituar në mjaft pjesë të tij duke përdorur teknologji të reja të materialeve dhe diametra që i përgjigjen sasisë së ujërave të zeza në funksion të numrit të popullsisë që derdhin ujërat në të.
- Të shihet maksimalisht mundësia e ndarjes së sistemit të ujërave të shiut nga ato të zeza, për të cilat duhet ndërtuar impiant i pastrimit të tyre.

- Për zonën rurale të ndërtohen gropa septike në përputhje me standardet teknike sikurse dhe në zonat që është e vështirë të ofrohet shërbimi i grumbullimit të ujërave të ndotura me sistem kanalizimesh.

Ndriçimi rrugor

- Ofrimi i shërbimit të ndriçimit publik hyn ndër funksionet e veta të pushtetit vendor sidhe bashkitë kanë të drejta eksluzimeve mbi ofrimin e këtij shërbimi në territoret e tyre. Gjithashtu Këshillat Bashkiak vendosin mbi kriteret e ofrimit të këtij shërbimi.
- Në Bashkinë e Elbasanit ofrohet në qytetin e Elbasanit, në NjA Bradashesh, në NjA Papër dhe në NjA Tregan ndërsa në NjA Labinot Mal, Labinot Fushë, Shirgjan, Gjergjan, Shushicë, Gjinar, Zavalinë, Funarë dhe Gracen nuk e ofrojnë këtë shërbim.
- Në total në Bashkinë e Elbasanit kemi 88 km rrjet rrugor të ndriçuar në rreth 247 akse rrugore me 1809 shtylla ndriçimi dhe 3409 llamba. Në këtë bashki ka gjithashtu dhe 5 sheshe dhe 4 lulishte të ndriçuara.
- Në Qytetitn e Elbasanit kemi rreth 70.2 km rrugë të ndriçuar që është e shpërndarë në 213 akse rrugore, rreth 37% e rrjetit rrugor është e ndriçuar cka është një vlerë mjaft e ulët. Qyteti gjithashtu ka 1480 shtylla dhe 3080 llamba. Investimet kryesore ndër rrugë janë bëre pas viteve 90 por gjithsesi sistemi i ndriçimit paraqet probleme të shumta që kanë të bëjnë me dëmtimin e kallbove dhe dëmtimin e ndriçusave.
- NjA Bradashesh ofron shërbimin e ndricimit publik ne 3 fshatra (Kusarth, Katund i Ri dhe Bradashesh) në një gjatësi prej 7.8 km ne 222 ndriçusa nga të cilët 25 % e tyre nuk funksionojnë. NJA Papër ofron shërbimin e ndricimit publik në 3 fshatra (Papër, Valas dhe Broshkë) në një gjatësi prej 1.8 km në 67 ndriçusa e ku një pjesë e madhe e tyre nuk janë në funksion. NJA Tregan oforon shërbimin e ndriçimit publik vetëm në Fshatin Tregan në një gjatësi prej 1.5 km ku ndodhen 40 ndriçusa.
- Përsa i përket kostove dhe nivelit të të ardhurave nga tarifat e ndriçimit duhet thënë se në asnjë vit kostot nuk janë mbuluar totalisht nga të ardhurat nga tarifat e ndriçimit kjo si pasojë e nivelit të ulët të arkëtimit të tarifave të ndriçimit.

Mbetjet e ngurta

- Fillimisht Bashkia Elbasan ka nevojë për të përditësuar Planin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane, kjo si nevojë për një studim të plotë mbi shtrirjen e infrastrukturës së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e Bashkisë[433].
- Venddepozitimi në fshatin jug të qytetit, duke u pozicionuar shumë pranë bregut të Lumit Shkumbin, e ka kthyer një një vatër të nxehtë mjedisore të gjithë zonën pranë varrezave të qytetit. Shpeshtitë e prurjeve maksimale të lumit kanë përmbytur një pjesë të tokës, e cila më ka shërbyer si venddepozitim. Përpara ndërhyrjes, venddepozitimi pati marrë shtrirje sa gjatësore aq edhe vertikale përgjatë bregut. Problematikë emergjente paraqitet situata mbi:
  a) Emetimet e gazërave CH_4 në atmosferë, NO, NH_4 si dhe dioksinat nga djeget e ndryshme.
  b) Shkarkimet e mbetjeve të ngurta mbi rrjedhën e lumit Shkumbin
  c) Infiltrimi i shllameve nga dekompozimi mbetejve në akuiferin e Elbasanit.

d) Depozitimi i mbetjeve inerte anës brigjeve të Lumit Shkumbin dhe përroit të Zaranikës si edhe në disa pjesë të argjinaturave nuk ofron një zgjidhje teknikisht të qëndrueshme dhe afatgjatë. Nevojitet një plan për menaxhimin e këtyre mbetjeve dhe mbi të gjitha një pikë grumbullimi e miratuar nga Bashkia.

- Mbetjet e klasifikuara si të rrezikshme (kryesisht spitalore & industriale) administrohen nga subjekte private në varësi të kushteve kontraktuale, monitorimi i këtyre kontratave në terren paraqet mangësi pasi janë identifikuar shkarkime industriale në zonën e Metalurgjikut, Mjekësit etj.
- Skema të ndryshme të 3R (Reduktim – Riciklim – Ripërdorim) shihen pjesërisht të zbatuara në Bashkinë Elbasan, ku vetë subjekti që ofron shërbimin e menaxhimit të mbetjeve operon edhe me riciklimin e plastikës. Po ashtu, faktor në procesin e ndarjes së mbetjeve mbetet komuniteti Rom & Egjiptian në Elbasan. Fushata dhe projekte pilot në fushën e reduktimit dhe ripërdorimit janë të pakta ndaj edhe familjarizimi i popullatës me këto teknika është i ulët. Këtu veçojmë mbetjet organike të prodhuara nga bujqësia, të cilat me anë të skemave të kompostimit mund të prodhojnë pleh aktiv, i cili të ripërdoret sërish në bujqësi.
- Projekti për ndërtimin e Landfillit rajonal në Bashkinë Elbasan paraqet një inisiativë pozitive për menaxhimin e mbetjeve në tërësi. Duke qënë i pozicionuar pranë brigjeve të Lumit Shkumbin dhe krahas masave paraprake të marra për mbrojtjen mjedisore nga impaktet që do të ketë ky impjant nevojitet që monitorimi mbi të të jetë i shpeshtë.
- Zonat me nivel të lartë ndotje, sidomos industriale, pranë qytetit të Elbasanit përbëjnë një problem serioz për mjedisin dhe shëndetin publik të banorëve. Mbetjet e trashëguara në këto zona duhet të jenë pjesë e skemës së re që duhet të adoptojë bashkia e Elbasan për menaxhimin e integruar të mbetjeve.
- Shërbimi i grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane nevojitet të shtrihet në të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan.

Sistemi i kullimit dhe ujitjes

- Përsa i përket rezervuarëve problemeatikën kryesore e përbëjnë Rezervuarët e Shtërmenit dhe të Balëzës. Rezervuari i Balëzës është totalisht jashtë funksioni ndërsa Rezervuari i Shtërmenit ka të dëmtuar në mënyrë të pjesshëm trupin e digës.
- Në aspektin e mbrojtjes së tokave bujqësore në Bashkinë Elbasan kemi probleme të përmbytjeve të përmasave të vogla në zonat e tokave përgjatë Lumit Shkumbin
- Rrjeti i kanaleve kulluese dhe vaditëse ka nevojë për rehabilitim dhe pastrim total në masën ne 14.3% të rrejtit duke qenë se është i bllokuar dhe në 42.2 % të tij ka nevojë për rehabilitim të pjeshëm.

1.8 Strehimi

Qëllimi i kësaj analize është të kuptoj gjendjen aktuale të strehimit në Bashkinë e Elbasanit, si të përcaktoj disa kritere bazë nëpërmjet të cilave do të bazohen dhe rekomandimet për zgjidhjen e nevojave përmes PPV-së. Bazuar mbi analizën e gjëndjes ekzistuese si dhe standartet orientuese të vendosura nga legjislacioni sektorial përkatës (VKM Nr.671), është

bërë dhe përcaktimi i kritereve, të cilat do të meren parasysh gjatë hartimit te rekomandimeve të çështjeve të strehimit.

Përzgjedhja e kritereve për tu vlerësuar

Për të bërë këtë analizë duhët bërë përzgjëdhja e kritereve treguese të gjëndjes ekzistuese të cilat i vijnë në ndihmë analizës së strehimit, si dhe përcaktimin e kritereve që ndikojnë në zhvillimin territorial për qëllime banimi në të ardhmen. Kritere të cilat janë përcaktuar si më poshtë:

- Popullsia për njësi administrative (ekzistuese dhe e pritshme)
- Sipërfaqe ndërtimi për qëllime banimi / banor (ekzistuese dhe e propozuar)
- Numri mesatar i kateve (ekzistuese dhe e propozuar)
- Koefiçenti i shfrytëzimit të tokës për ndërtim (ekzistuese dhe e propozuar)
- Koefiçenti i shfrytëzimit të tokës për infrastrukturë (ekzistuese dhe e propozuar)

Standartet e shërbimeve të ofruara brënda njësivë të banimit si:

- Gjelbërim (m^2 / banor)
- Zona sportive (m^2 / banor)
- Sipërfaqe parkimi (m^2 / banor)

Konkretisht nëpërmjet përcaktimit të intevaleve apo vlerave mesatare që do te ketë secili nga kriteret e cituara më sipër do të ndihmojë në parashikimin e nevojave për strehim për zonat e reja te banimit, si dhe parashikimin e shërbimeve për zonat ekzistuese të banimit.

Situata aktuale dhe përcaktimi / vlerave mesatare për secilin kriter

Bazuar në të dhënat e regjistrimit të përgjhithshëm të popullsisë si dhe në trendin që kanë pësuar treguesit demografik (si lindshmëria, vdekshmëria, emigracioni dhe popullsia), numri I popullsisë ka pësuar rritje nga viti në vit. Rritje kjo e reflektuar thuajse ne të gjitha njësitë administrative të territorit të Bashkisë Elbasan, me përjashtim të njësive administrative Gjinar, Zavalinë dhe Funar. Në të dhënat e mara nga gjendjet civile përkatëse (për vitin 2015) të çdo njësie administrative të territorit të saj administrativ popullsia e Elbasanit është 208, 480 banorë, ku rreth 56% e saj është e përqëndruar në qytetin e Elbasanit, dhe pjesa tjetër e mbetur në njësitë e tjera administrative të bashkisë. Bashkia Elbasan përbëhet nga 13 njësi administrative, prej të cilave 12 janë të karakterit rural, dhe Elbasani është plotësisht urban[434].

Tabela 85. . Sipërfaqet e Ndërtimit për qëllime banimi sipas Njësive Admninistrative të Bashkisë Elbasan

	Bashkia Elbasan			
Nr	**Emri I Njësisë Administrative**	**Sip.Ndërtimi**	**Nr.Popullsisë**	**m2/Banor**
1	Papër	501912.9603	6348	79.06631384
2	Labinot Fushë	332738.9315	7058	47.14351537
3	Labinot Mal	269150.3943	5291	50.8694754
4	Gracen	127599.1707	2192	58.21130051
5	Gjinar	269781.08	3478	77.5678781
6	Gjergjan	488918.0003	5126	95.38002347
7	Funarë	134122.3039	2122	63.20560974

8	Elbasan	3439686.631	78703	43.70464444
9	Zavalinë	96102.91634	1622	59.24964016
10	Tregan	242662.8144	3036	79.92846325
11	Shushicë	599843.6293	8731	68.70274072
12	Shirgjan	669211.4195	7307	91.58497598
13	Bradashesh	677893.1822	10700	63.35450301

Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Për sa i perket tipologjive hapësinore është e nevojshme të theksojmë se qyteti i Elbasanit ka një zhvillim urbanistik të dendur e cila përbën një sfidë për zhvillim të qëndrueshëm hapësinor, për shmangien e shpërhapjes urbane. Vendbanimet e tjera rurale janë përgjithësisht më pak të dendura, kjo për shkak te terrenit të veshtirë si dhe mungesës së infrastrukturës.

Ndërkohë lartësia e kateve në qytet varion nga 1-8 kate. Megjithatë, zona e banimit 1-3 kate është dominuese në Elbasan duke zënë rreth 80% të hapësirës së ndërtuar. Dendësia bruto ulet ndjeshëm në momentin që në llogaritje perfshihen edhe siperfaqet informale në periferi dhe jashtë vijës kufizuese të qytetit.

Ndërtimet e banimit në këto zona variojnë nga 1-3 kate dhe eficenca e perdorimit të tokës është e ulët. Kryesisht në këto zona dominon funksioni i banimit. Mundësitë për sigurimin e territoreve të reja të zhvillimit urbanistik dhe rrjedhimisht dhe atij ekonomik janë të mira pasi ekzistojnë shumë territore të lira që ende mund të shfrytezohen me anë të infrastrukturës ekzistuese.

Në një situatë mjaft ndryshe të popullimit të qytetit, një nga problemet kryesore që hasen është strehimi. Nga të dhënat rezulton se aktualisht e vetmja ofertë në tregun e strehimit është tregu privat i cili nuk është i perballueshëm për numrin më të madh të popullsisë, e cila si alternative zgjedh ndërtimin pa leje në zona informale ose zënien me forcë te ish-objekteve shteterore. Në një situatë të tillë, vec shesheve të ndërtimit të cilat do të vihen në dispozicion të Entit Kombëtar të Banesave, plani duhet të identifikojë edhe mekanizmat e nevojshëm për gjenerimin e fondeve si psh: mekanizmat e mbështetjes së tërthortë të familjeve me të ardhura më të ulëta, etj...

Nga të dhënat e mara nga Bashkia Elbasan deri më datën 08.07.2016 rezulton se numri i të pastrehëve është 2665 familje. Bashkia Elbasan sot ofron 2 skema për strehimin social:

- *Bonusin e strehimit*
- *Banesat sociale me kosto të ulët*

Konkretisht me VKM nr.67 të datës 24.06.2016 është miratuar lista për përfitimin e bonusit të strehimit për 31 familje për periudhen Korrik-Dhjetor 2016, ku për arsye të pritjes së miratimit nga Ministria e Zhvillimit urban nuk kanë filluar proçedurat e dhënies së bonusit. Ndërsa familjet të cilat kanë përfituar nga skema e përfitimit të kredive të buta me 3% interes numri shkon në 30 familje, dhe kjo për vitin 2012. Për vitet në vazhdim Bashkia nuk ka zhvillime të metejshme.

Përsa i përket infrastrukturës kreative dhe sociale si dhe është cilësuar më lart këto janë tre kriteret kryesore të cilat ndihmojnë në analizë.

- Gjelbërim (m^2 / banor)
- Zona sportive (m^2 / banor)

- Sipërfaqe parkimi (m^2 / banor)

Duke iu referuar standarteve të rekomanduara nga VKM Nr.671 si dhe gjëndjes ekzistuese të tipologjive hapësinore rekomandohet që:

Gjelbërim: Standarti i rekomanduar në qëndra mbi 10,000 banorë, për gjelbërim në rrugë, shëtitore, sheshe dhe brigje ujore sipas dispozitave ligjore është 2.5m^2/banor. Aktualisht ky standart është 1.61 m^2/banor.

Zona Sportive: Stantarti i propozuar nga VKM Nr.671 pwr struktura dhe territore në nivel territori urban më të madh se qyteti, janë 2.6 m^2/banor për kur popullsia është e barabartë me ose mbi 100,000 banorë, dhe 3.5 m^2/banor për rastet me popullsi nën 100,000 banorë, nw rastin e Bashkisw Elbasan rekomandohet 2.6 m^2/banor.

Sipërfaqe parkimi: Për parkimin publik, pavarësisht formës së zgjidhjes së tij, është 6 m^2/banor ose 1 vëndparkim prej 12 m^2 për çdo 2 banorë. Parkimi mund të jetë privat ose publik dhe format e zgjidhjes janë në rrugë, në sheshe publike, në sipërfaqe mbi ose nën tokë, në struktura me një ose disa nivele dhe në pjesë të objekteve me përdorime të ndryshme.

1.9 Përdorimi i tokës, sistemet dhe strukturimi i territorit


1.9.1 Sistemet e territorit dhe përdorimi i tokës

Metodologjia e përdorur nga grupi i punës për analizën e përdorimit të tokës është mbështetur në Vendim nr. 671, datë 29.7.2015, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", kreu III, seksioni I, neni 77. Përdorimi i tokës dhe strukturave në të ndahet në 14 kategori bazë, duke përfshirë edhe 3 kategori të tjera të cilat janë menduar të arsyeshme të shtohen në metodologji dhe janë: Banim i përzier, Shërbime i përzier dhe Miks Miks, të cilat janë rezultat i përzierjes së 2 apo më shumë kategorive bazë të parashikuara nga VKM nr. 671.

Leximi i territorit fillimisht është bërë sipas sistemeve territoriale ekzistuese, të cilat janë përcaktuar në VKM nr. 671, neni 73:


- Sistemi urban (UB);
- Sistemi natyror (N);
- Sistemi bujqësor (B);
- Sistemi ujor (U);
- Sistemi infrastrukturor (IN).

Figura 152. Sistemet territoriale në Bashkinë Elbasan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN

Figura 153. Sistemi Urban



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN

Figura 154. Sistemi infrastrukturor



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN

Figura 155. Sistemi bujqësor



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN

Figura 156. Sistemi hidrografik



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN


Figura 157. Sistemi natyror



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN

Duke u mbështetur në analizën e sistemeve territoriale, vëmë re se sipërfaqen më të madhe e zë sistemi natyror, përafërsisht 72% të territorit. Sistemi natyrorë është i përqendruar në skajet e territorit të bashkisë, duke qenë se këto zona përshkruhen nga sisteme kodrinore dhe pjesërisht malore Po ashtu, sistemi natyror ndërthuret me zonat e mbrojtura që ndodhen në territorin e bashkisë. Sistemi bujqësor renditet i dyti, duke zënë afërsisht 21% të territorit dhe ndodhet përgjatë shtratit të Lumit Shkumbin, në fushën e Elbasanit, zonë të cilën janë përqendruar zhvillimet urbane, industriale dhe ekonomike. Në pjesën jugore të territorit sistemi urban ndërthuret me sistemin natyror dhe me sistemin urban. Sistemi urban i cili zë 3.5% është përqendruar kryesisht në qytetin e Elbasanit. Ky sistem evidentohet edhe përgjatë akseve kryesore rrugore siç është rruga Elbasan-Librazhd, rruga Cërrik-Shirgjan, segmenti Papër-Bradashesh-Elbasan dhe në njësitë administrative që kanë distancë të vogël me qytetin e Elbasanit si Bradasheshi, Shirgjani dhe Labinot Fushë. Në pjesën verilindore dhe jugperëndimore të Bashkisë Elbasan sistemi urban është pikësor dhe ndërthuret me sistemin natyror dhe sistemin bujqësor.


Figura 158. Sistemet Territoriale, Bashkia Elbasan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Sipërfaqja totale e Bashkisë Elbasan është 872 km². Kategoria që zë sipërfaqen më të madhe në territor është ajo natyrore 628.6 km² dhe e dyta është kategoria bujqësore me 176,7 km². Në territorin e Elbasanit ka edhe sipërfaqe të konsiderueshme ujore që në total zënë një sipërfaqe prej 40.8 km². Kategoria e përdorimit banim zë një sipërfaqe totale 18.4 km² dhe është e përqendruar kryesisht në pjesën e qytetit ndërsa në fshatra zë më pak sipërfaqe dhe ka shpërhapje më të madhe. Kategoria industri dhe ekonomi zë 3.5 km² të të gjithë sipërfaqes së Elbasanit dhe është më e përqendruar përgjatë akseve kryesore dhe në njësinë administrative Bradashesh.


Figura 159. Përdorimi i tokës sipas kategorive kryesore (km²)



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Thuajse në të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan gjejmë mbivendosje të përdorimit të tokës. Mbivendosjet më të shpeshta janë ndërmjet kategorive banim-bujqësi, banim-natyrore, banim-industri dhe ekonomi dhe bujqësi-industri dhe ekonomi, përdorime të veçanta (zona e varrezave) me banim. Mbivendosja e banimit me zonat natyrore dhe banimit me zonat bujqësore është e pranishme thuajse në të gjithë territorin, për arsye se urbanizimi i territorit ka ndodhur si në zonat e qyteteve ashtu edhe fshatrave në mënyrë të pa kontrolluar. Në njësitë administrative Gracen dhe Zavalinë ka mbivendosje të zonave natyrore me banimi, duke qenë se këto njësi shtrihen kryesisht në territor kodrinor. Njësitë administrative Shushicë dhe Shirgjan shtrihen në terren fushor dhe kanë sipërfaqe me toka bujqësore. Në këto njësi mbivendosen banimet me tokat bujqësore. Zonat industriale dhe ekonomike mbivendosen me ato bujqësore. Ish Kombinati Metalurgjik në njësinë administrative Bradashesh është i vendosur në tokë bujqësore. Zona që ka pasur presion më të madh zhvillimi është përgjatë lumit Shkumbin, për arsye të karakterit fushor që ka kjo zonë. Pranë Lumit Shkumbin janë vendosur zona me karakter ekonomik duke krijuar mbivendosje të zonave industriale me sipërfaqet ujore.

Figura 160. Mbivendosje të përdorimit të tokës, Bashkia Elbasan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

1.9.2 Tipologjitë hapësinore

Analiza e tipologjive hapësinore evidenton mënyrat e ndërlidhjes së hapësirave në territor, kryesisht nga pikëpamja morfologjike. Për situatat komplekse të mbulesës së tokës dhe shtrirjes së vendbanimeve në Bashkinë Elbasan, një evidentim i tillë lehtëson të kuptuarit të territorit dhe procesin e përcaktimit të treguesve realistë të zhvillimit.

Duke marrë në konsideratë shtrirjen e madhe hapësinore të bashkisë në raport me territorin para reformës administrativo-territoriale[435], kjo analizë trajton 3 nivele tipologjish:


- Nivelin territorial: Mënyra si lidhen vendbanimet me njëra-tjetrën në rang bashkie
- Nivelin e vendbanimeve rurale: Shtrirjet hapësinore të fshatrave, në raport me rrugët, relievin, etj.
- Nivel zone: Ndarja e tipologjive hapësinore në përputhje me njëtrajtshmërinë e llojit dhe volumit të strukturave, mënyrës së vendosjes së tyre në njësi strukturore, skemat e rrjetit rrugor dhe hapësirave publike, si dhe lartësisë së strukturave, sipas përcaktimeve të Rregullores së Planifikimit të Territorit[436].

Bashkia Elbasan në nivel territorial

Territori i Bashkisë Elbasan është rritur me mbi 120% në periudhën pas viteve '90, duke arritur një densitet urbanizimi të mesëm, pavarësisht tipologjisë predominuese të vilave me densitet të ulët. Nga pikëpamja policentrike, 60% e sipërfaqes është pjesë e ZFU-së me qendër Elbasan[437], me vendbanime të shpërndara në mënyrë lineare dhe të çrregullt në territorin kodrinoro-malor dhe përgjatë shtretërve të lumit Shkumbin dhe përrenjve të shumtë të bashkisë.

Struktura e lidhjes mes vendbanimeve në Bashkinë Elbasan është komplekse, si rezultat i terrenit të vështirë. Hierarkia e fshatrave, përveç varësisë ndaj Elbasanit, përcaktohet kryesisht nga prezenca e lumit Shkumbin, sidomos në rrjedhën e poshtme të tij, në terren fushor. Këtu vërehet sistemi më i dendur i vendbanimeve, të lidhura në formë lineare me njëra-tjetrën, përgjatë akseve kryesore interurbane të bashkisë: Peqin-Elbasan dhe Elbasan-Cërrik. Qendra si Papër, Bradashesh, Shirgjan, Gjergjan, Labinot-Fushë, por edhe shumë fshatra të tjerë të shtrirë midis tyre, si Ullishtë, Vidhas, Mjekës, Kuqan, etj, shtrihen në pozicion të favorshëm për zgjerim urban dhe gjenden të rrethuar nga tokë bujqësore. Krahas qendrës Elbasan, këto vendbanime janë mjaft të dendura dhe përbëjnë sfidë për zhvillim të qëndrueshëm hapësinor, për shmangien e shpërhapjes urbane.

Figura 161. Skema e lidhjeve territoriale, nivel bashkie



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2016

Vendbanimet e tjera rurale janë përgjithësisht më pak të dendura. Kryesisht ato shtrihen në mënyrë lineare, përgjatë shtretërve të përrenjve që derdhen në lumin Shkumbin. Dallohen disa grupime të njëpasnjëshme vendbanimesh, si Papër-Pajun-Papër Sallak, Fikas-Petresh-Gracen, Kusarth-Karakullak-Letan-Funarë-Mollagjesh, Sericë-Labinot Mal, Shirgjan-Bathës-Tregan,Hajdaraj-Mlizë-Shelçan-Lleshan-Derstilë-Gjinar-Pashtresh-

Zavalinë, etj. Në këto tipologji dallohet një periferialitet i dukshëm i vendbanimeve që ndodhen në skaje, si Mollagjesh, Zavalinë, Tërbaç, etj, për të cilat duhet trajtuar me kujdes çështja e aksesueshmërisë. Aksi Bradashesh-Gracen përbën një rast më specific, për shkak të rëndësisë rajonale të lidhjes së dikurshme me Tiranën. Si e tillë, është e nevojshme të krijohen qendërsi të reja dhe mënyra alternative lidhjeje të vendbanimeve me territoret e tjera të Bashkisë, në kushtet e mungesës së qarkullimit të shpeshtë tranzit në këtë aks.

Së treti, një tipologji e veçantë lineare janë vendbanimet e shtrira përgjatë autostradës Tiranë-Elbasan, si Shijon, Reçan, Shtemaj, etj. Këto fshatra kanë dendësi të ulët, por presion të lartë rritjeje si rezultat i ndikimit të infrastrukturës rajonale. Pozicionimi në terren kodrinoro-malor e bën zhvillimin e tyre hapësinor akoma më sfidues.

Përveç sistemeve lineare, në territorin e Elbasanit ndodhen edhe shumë vendbanime të lidhura në mënyrë të degëzuar me vendbanime lineare. Të tillë janë Tërbaçi, Preça e Sipërme, Preça e Poshtme, Guri i Zi, Cëruja, Qafa, Shmili, Bena, Muçani, Shilbatëri, etj. Këto fshatra kanë akses shumë të dobët dhe sfidë në marrjen e shërbimeve bazë, sidomos kur pozicionohen të distancuar nga qendra e njësive administrative.

Ndërkaq, sistemi i vendbanimeve Muriqan-Jagodinë-Bujqës ndodhet në mes të dy sistemeve kryesore lineare që shtrihen përgjatë Shkumbinit, por kanë karakter më bujqësor. Këto fshatra, të ndodhur në pozicion aksesi shumë të mirë, në të njëjtën kohë zënë edhe territorin më produktiv bujqësor të gjithë Bashkisë Elbasan. Si të tilla, zhvillimi i tyre duhet kontrolluar, në favor të ruajtjes së tokës bujqësore.

Së fundmi, në distancë të ulët nga qyteti i Elbasanit gjenden dy tipologji të tjera lineare të hierarkizuara, me qendër Shushicën dhe Labinot Fushën. Këto grupe vendbanimesh kanë formë lineare të degëzuar, me qendra respektive të shtrira në aksin kryesor Peqin-Librazhd dhe Belsh-Librazhd, të lidhura gjithashtu me njëra tjetrën nëpërmjet fshatit Polis i Vogël (Librazhd). Pavarësisht se ato nuk komunikojnë me një numër të madh vendbanimesh të tjera, kanë rëndësi për pozicionin e aksesueshëm dhe relievin fushor-kodrinor që përcakton zhvillimin hapësinor të tyre.

Vendbanimet rurale të Bashkisë Elbasan përgjithësisht realizojnë lidhje lineare, me një rrugë apo shteg të dedikuar brenda territorit të bashkisë. Gjithsesi në disa raste komunikimi më i afërt i fshatrave është përmes rrugëve përtej territorit, si psh. aksesi i Zavalinës përmes fshatit Poroçan (Gramsh), apo i fshatrave të Treganit nga Gostima. Në këto raste duhet përforcuar itinerari komunikues brenda territorit të bashkisë, duke i dhënë funksione të veçanta peisazhistike, ose shërbimi.

Tipologjitë rurale


Bashkia Elbasan përbëhet nga 13 njësi administrative, prej të cilave 12 janë të karakterit rural, dhe Elbasani është plotësisht urban. Në territorin e bashkisë shtrihen 116 fshatra, të cilat kanë marrëdhënie të ndryshme të vendbanimeve brenda tyre, si dhe tipologji të ndryshme shtrirjeje përkundrejt rrjetit rrugor e terrenit.

Sa i takon mënyrës si lidhen vendbanimet brenda të njëjtit fshat, në Elbasan evidentohen 5 tipologji kryesore:

1) <u>Tipologjia qëndrore:</u> Kjo tipologji i përgjigjet fshatrave që përbëhen nga një vendbanim i vetëm, kompakt. Ky rast është mjaft i përhapur, dhe përkon me fshatra që nuk kanë presion zhvillimi dhe që shtrihen në territor kodrinoro-malor.

2) Tipologjia satelitore: Ky rast nënkupton që fshati përbëhet nga disa vendbanime të shpërndara, por të lidhura hierarkisht me një qendër dominante. Këto lidhje janë tregues të tendencës për rritje të fshatrave, si dhe terrenit të vështirë, i cili kufizon vazhdimësinë urbane. Sfida kryesore e zhvillimit e fshatrave me shtrirje satelitore është përforcimi i infrastrukturës lidhëse, si dhe shmangia e inefiçencës në furnizimin me shërbime bazë, si infrastrukturë ujësjellësi e kanalizimesh, shërbim menaxhimi mbetjesh, ndriçim publik, etj.
3) Tipologjia nukleare: Këto tipologji hasen në fshatrat me shumë vendbanime të vogla, të shpërndara në territor në mënyrë sporadike, të palidhur. Pavarësisht prezencës së një qendre ku është zhvilluar fillimisht fshati, presioni i rritjes në kohë ka çuar në shpërndarjen e vendbanimeve të reja në mënyrë të pastrukuruar, dhe abuzuese ndaj territorit. Kjo tipologji kërkon adaptimin e ndërhyrjeve ristrukturuese dhe mbushëse urbane, për të mos copëzuar më tej terrenin bujqësor apo natyror.
4) Tipologjia qëndrore e shpërhapur: Ky është një rast i veçantë i tipologjisë nukleare dhe satelitore, ku dominanca e një qendre është e dukshme, por ka shumë vendbanime të palidhura, ose të lidhura dobët me të, që janë të shpërndara në territor në mënyrë sporadike.
5) Tipologjia e shpërhapur përfaqëson dukurinë e shtrirjes së zgjeruar hapësinore të fshatrave, pa densifikim në qendër, por në formë të njëtrajtshme, jo kompakte, në truall bujqësor (ose natyror). Problematikat e inefiçencës së përdorimit të tokës dhe ofrimit të shërbimeve kërkojnë për ndërhyrje me karakter densifikues në këto raste.

Figura 162. Tipologjitë e marrëdhënieve të vendbanimeve rurale në Bashkinë Elbasan




Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Në Bashkinë Elbasan dallohet dominancë e dukshme e tipologjisë qëndrore të shpërhapur, ku 1/3 e fshatrave kanë një qendër dominuese, dhe shumë zona banimi të shpërndara pa rregullsi ose hierarki të veçantë në territor. Kjo tipologji është më e përhapur në fshatrat kodrinoro-malor të njësive Gjinar, Labinot Mal, Papër, Tregan, etj, me shtrirje të kufizuar hapësinore. Nuk përjashtohen edhe fshatra të mëdhenj, si Hajdaraj, Mollagjesh, Krrabë e

Vogël, Papër, etj. Për këto fshatra vlen të përforcohen lidhjet e qendrës me zonat përreth, si dhe të kufizohet shtrirja në tokë bujqësore apo natyrore.


Figura 163. Shembuj të tipologjisë qëndrore të shpërhapur (Hajdaraj, Mjekës)



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Ndërkaq, tipologjia satelitore është mjaft e përhapur, në 24% të vendbanimeve rurale. Kjo tipologji dallohet në zona ku kushtëzimet e terrenit nuk lejojnë që vendbanimet e një fshati të zhvillohen në mënyrë të vazhduar. Gjithsesi në kushtet e sigurimit të shërbimeve në gjithë territorin, kjo tipologji shtrirjeje është e qëndrueshme. Për zona me presion më të lartë zhvillimi, si Bradasheshi, integrimi i zonave të banuara me zonat ekonomike dhe të shërbimeve përgjatë autostradës duhet të jetë më i madh. Në çdo rast, edhe për tipologjitë satelitore, ku është e mundur, është e nevojshme të nxitet zhvillimi i konsoliduar, hierarkizimi i mëtejshëm i qendrave, si dhe shmangia e ndërtimeve në afërsi të zonave me përdorim të papërputhshëm (lumenj, industri, etj). Fshatrat me tipologji satelitore kanë dendësi, madhësi, dhe periferialitet të ndryshëm, si Bradashesh, Balëz, Fikas, Katund i Ri, Letan, Shijon, Ulën, Gjergjan, Godolesh, Valas, Vidhas, Griqan, Shushicë, etj.


Figura 164. Shembull i tipologjisë satelitore (Bradashesh, Griqan)



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Tipologjia qëndrore është e përhapur në zona me presion më të pakët zhvillimi, si dhe zona me rrjet rrugor kuadratik dhe strukturë të konsoliduar. Të tillë janë Balldreni, Graceni, Thana, Muriqani, Lukani, Bujqësi, Blerimas, etj. Ky rast është optimal në mënyrën e shfrytëzimit të terrenit dhe në eficiencën e ofrimit të shërbimeve bazë për fshatin.

Figura 165. Shembuj të tipologjisë qëndrore (Gracen, Balldren)



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Së fundmi, më pak të përhapura janë tipologjitë nukleare dhe të shpërhapura. Këto dy mënyra zhvillimi hapësinor janë më pak efiçentet sa i takon shfrytëzimit të territorit, sepse zënë territor të gjerë dhe nuk kanë lidhje të mirë mes vendbanimeve. Tipologjitë nukleare hasen në raste kur mungojnë qëndërsitë e mirë-përcaktuara, por formohen grupe të shumta vendbanimesh, me lidhje të dobët mes tyre. Të tilla janë fshatra në zona malore, si Zavalina, Kodër Bujarasi, Shingjini, Dritasi, Shmili, Griqani i Sipërm, Shinavlashi, etj. Ndërkaq, shpërhapja haset në zona ku ka presion zhvillimi në tokë bujqësore e natyrore, si Broshkë, Gurabardh, Gjinar, Kamican, Nexhan, etj. Në këto raste, në ndryshim nga tipologjia nukleare, ku nuk ka tendenca zgjerimi, është e rëndësishme të realizohet konsolidimi i zonave, sigurimi i qendrave të shërbimeve, si dhe lidhja me rrugë lokale e vendbanimeve ekzistuese, pa nxitur shpërhapje të mëtejshme.

Figura 166. Shembull i tipologjisë nukleare (Zavalinë) dhe të shpërhapur (Broshkë)



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Ndërkaq, studimi i rrjetit rrugor në brendësi të vendbanimeve rurale tregon rreth 50% e fshatrave në Bashkinë Elbasan kanë sistem organik shtrirjeje. Kjo do të thotë që vendbanimet ndjekin kryesisht format e terrenit, shtratin e lumenjve, etj, dhe nuk ka tendenca për rregullsi të brendshme në organizim urban. Tipologjia rrugore organike nuk siguron akses optimal në gjithë territorin e fshatrave. Të gjithë njësitë administrative, qofshin ato më fushore apo thellësisht malore, e kanë tipologjinë rrugore organike mbizotëruese, jo vetëm në fshatrat e largët, por shpesh edhe në qendrat e tyre. Disa vendbanime rurale me shtrirje organike janë: Petresh, Fikan (Bradashesh), Korre, Bixellë,

Krrabë e Vogël (Funar), Gjinar, Derstilë, Pobrat, Graben, Tërbaç (Gjinar), Gracen, Dopaj, Plangaricë (Gracen), Sericë, Dritas, Shmil (Labinot Mal), Griqan i Poshtëm, Griqan i Sipërm, Godolesh (Labinot Fushë), Mjekës, Bathës (Shirgjan), Hajdaraj, Vasjan (Shushicë), Blerimas, Bizhdan (Tregan), Zavalinë, Kamiçan (Zavalinë), etj.

Gjithashtu, tipologjia lineare dhe e degëzuar gjendet në rreth 40% të vendbanimeve rurale, kryesisht në fshatrat që shtrihen përgjatë rrugëve interurbane kryesore, veçanërisht në njësitë Bradashesh, Papër, Tregan. Fshatra të tillë, si Kozan, Bujaras, Stërstan, Lukan, Shingjin, Gur i Zi, Qerret, Broshkë, Lugaj, Shilbatër, Tregan, Tudan, etj. kanë tipologji lineare, ku vendbanimi kryesor shtrihet linearisht përgjatë rrugës kryesore. Ndërkaq, në fshatrat me tipologji të degëzuar, si Balëz, Karakullak, Kusarth, Shijon, Gjonme, Xibrakë, Labinot Fushë, Shushicë, Bujqës, etj, krahas aksit kryesor, vendbanimi shtrihet edhe përgjatë degëzimeve të tij, duke formuar një trajtë më të kondoliduar. Në këto raste zona urbane është më e përkufizuar, gjithsesi në varësi të shtrirjes gjatësore, mund të ketë probleme në hierarkizim, caktim të një qendre funksionale për fshatin, si dhe ofrim të shërbimeve bazë.

Figura 167. Tipologji organike (Gracen, Dërstil)



Burimi: ASIG, 2015

Figura 168. Tipologjitë lineare (Labinot Fushë) dhe të degëzuara (Balëz)



Burimi: ASIG, 2015

Së fundmi, tipologjitë rrjet dhe të tarracuara, ku niveli i ndërhyrjes në strukturën urbane të vendbanimeve është më i lartë, janë shumë pak të pranishme në territor. Tipologjia rrjet dallohet në dy raste: fshatra me morfologji të rregullt, të planifikuar për t'i shërbyer një


zone industriale ose bujqësore, ku rrugët janë të lidhura në një strukturë kuadratike të rregullt, si rasti i Balldrenit; dhe fshatra me strukturë rrjet të çrregullt, ku terreni fushor ka lejuar që të zhvillohet infrastrukturë më e mirë lidhëse mes zonave, si psh. Kuqan. Këto tipologji duhen nxitur me tepër, veçanërisht në zonën fushore anës Shkumbinit, në sistemin e vendbanimeve Muriqan, Jagodinë, Bujqas, për të shmangur zënien e tokës bujqësore në këto territore. Nërkaq, sistemi i tarracuar dallohet në rastet kur vendbanimet shtrihen në disnivel të dukshëm, dhe aksesohen nëpërmjet tarracave, me shkallë apo rampa. Këto vendbanime kanë vështirësi në sigurim shërbimesh, por përbëjnë vlerë peisazhistike të veçantë. Mund të veçohen Mollagjeshi, Shëmhilli, Shemaj, etj.

Figura 169. Tipologjia rrjet (Balldren, Kuqan)



Burimi: ASIG, 2015

Figura 170. Tipologjia e shtrirjes rrugore të vendbanimeve rurale



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Tipologjitë në nivel zone

Për Bashkinë Elbasan është realizuar ndarja e zonave tipologjike sipas kritereve të njëtrajtshmërisë të përcaktuara në Rregulloren e Planifikimit, kombinuar me kritere të

densitetit, funksionit predominues, dhe shkallës së miksimit të tipologjive ndërtimore. Këto kritere paraqiten në tabelat e mëposhtme.

Tabela 86. Kriteret e kombinimit të tipologjisë ndërtimore me densitetin

		densiteti				
		i lartë	i mesëm	i ulët	shumë i ulët	shumë i ulët në tokë bujqësore
tipologjia ndërtimore	gjatësore					
	vila					
	kulla					

Tabela 87. Kriteret e kombinimeve të mundshme të tipologjive ndërtimore mes tyre

		tipologji dytësore			
		gjatësore	vila	kulla	vila dhe kulla
tipologjia ndërtimore predominuese	gjatësore				
	vila				
	kulla				

Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2016

Nisur nga këto kritere, klasifikimi i zonave tipologjike për Bashkinë Elbasan është bërë si më poshtë:

- Ndërtesa gjatësore me densitet të lartë
- Ndërtesa gjatësore me densitet të mesëm
- Ndërtesa gjatësore me densitet të ulët
- Ndërtesa gjatësore miks me zonë vilash/kullash
- Ndërtesa gjatësore miks me vila
- Ndërtesa gjatësore miks me kulla
- Ndërtesa me kulla, densitet i mesëm
- Ndërtesa me kulla, miks me vila
- Vila miks me kulla, densitet i mesëm
- Vila me densitet të lartë
- Vila me densitet të mesme
- Vila me densitet të ulët
- Vila me densitet shumë të ulët
- Vila me densitet shumë të ulët në tokë bujqësore
- Zona jo banim (administrative, ekonomike, industriale, fetare, sera, shkolla, stadium, ushtarake, arkeologjike, etj)


Nga pikëpamja ndërtimore, tipologjitë më të përhapura në Bashkinë Elbasan janë vilat me densitet të ulët, të cilat zënë rreth 30 % të territorit të ndërtuar. Kjo dëshmon për karakterin rural dhe periferial të bashkisë, ku pjesa më e madhe e vendbanimeve janë të shpërhapura në territor, e realizojnë dendësi të ulëta. Mjaft të përhapura janë edhe zonat me vila me densitet të mesëm, ku banesat individuale janë të tipit dupleks, ose banesë individuale 2-3

katëshe. Këto zona dallohen kryesisht në qendrat e njësive administrative, si dhe në sistemin e vendbanimeve të shtrira në terren fushor.

Mjaft të përhapura janë edhe tipologjitë e vilave me densitet shumë të ulët, të cilat, së bashku, përbëjnë mbi 30% të zonave të banuara. Ky nivel i lartë i fragmentimit të territorit, si dhe presionit të ulët të zhvillimit vërehet në zonat periferike malore, kryesisht në njësitë Funarë, Gracen, Labinot Mal, Gjinar, Zavalinë dhe Tregan.

Përgjithësisht në secilin vendbanim dallohet një përhapje homogjene e tipologjisë, përveç qytetit të Elbasanit, dhe kalimit drejt vendbanimeve të tjera përreth tij, si Bradashesh, Labinot Fushë, etj, ku kalohet nga densitete të larta të vilave, në densitete të ulëta dhe shumë të ulëta.

Figura 171. Shpërndarja e tipologjive hapësinore në Bashkinë Elbasan




Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2016

Ndërkaq, dukuria e zënies së tokës bujqësore nga zona e banuar nuk është shumë e përhapur, por dallohet në disa raste të veçanta, sidomos përgjatë shtretërve të përrenjve në rrjedhën e sipërme të tyre, por edhe në brezin fushor përgjatë Shkumbinit. Kjo dukuri duhet shmangur, nëpërmjet ndërhyrjeve konsoliduese dhe ristrukturuese.

Së fundi, zonat industriale zënë një pjesë domethënëse të territorit artificial, rreth 18% të tij. Pjesa dominuese i takon Kombinatit Metalurgjik, por edhe subjekteve të tjera përpunuese në bashki. Vlen për të trajtuar me kujdes kufiri i këtyre zonave, sidomos në bashkim me përdorimet e papërputhshme, si banim, ujëra, bujqësi, etj. Përveç Kombinatit Metalurgjik, zonat e tjera industriale janë të zhvilluara linearisht përgjatë aksit Elbasan-Librazhd, si dhe në mënyrë pikësore në zona të caktuara të periferisë së qytetit dhe qendrave të tjera të rëndësishme rurale.

Figura 172. Zonimi tipologjik, Bashkia Elbasan




Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Në nivel qyteti miksimi i tipologjive është shumë i theksuar, duke kaluar nga zona qendrore me predominancë ndërtesash gjatësore, të miksuara me kulla dhe vila, në zona me ndërtesa gjatësore me strukturë të planifikuar, homogjene, e deri në periferinë me ndërthurrje zonash vilash të densitetit të lartë e të mesëm me zona industrial. Qendra administrative nuk arrin të krijojë një qendërsi të dukshme të qytet, ndërkohë që zona historike e kalasë është e rrethuar nga pjesë me miksim të theksuar tipologjish, me densitet të lartë. Marrëdhënia e zonave të banimit me zonat industriale periferike është gjithashtu problematike, për shkak të afërsisë së madhe dhe mungesës së brezave të mirëfilltë mbrojtës.

Rritja e mundshme e qytetit mund të kryhet duke zënë territorin bujqësor që ndodhet në pjesën lindore jugore të qytetit, si dhe në mënyrë lineare drejt zonave të Bradasheshit e Labinot Fushës. Densifikimi i zonave ekzistuese periferike është i vështirë, për shkak të sistemit të tyre urban relativisht të rregullt e të konsoliduar, dhe densitetit të lartë të banimit.

Figura 173. Zonimi tipologjik, Elbasan qendër




Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Pavarësisht karakterit urban të qendrës, me zona me ndërtesa gjatësore dhe kulla, sërish tipologjia e vilave zë sipërfaqen mbizotëruese në qytet. Respektivisht, vilat me densitet të mesëm dhe të lartë zënë 19% të zonës së banuar, ndjekur nga tipologjia mikse e ndërtesave gjatësore, me vila e kulla, e cila është e përhapur në mënyrë të dendur brenda unazës së qytetit. Tipologjia e tretë më e përhapur në qytet është ajo e zonave industriale, të cilat duhen trajtuar me kujdes në mënyrën si lidhen me pjesën tjetër të qytetit. Aktualisht ato pozicionohen në kufitë skajorë të zonave të banuara.

Nga pikëpamja e tipologjisë ndërtimore, në qytet evidentohen disa zona me tipologji hapësinore homogjene, si psh. zonat me ndërtesa gjatësore, ose zonat me ndërtesa kulla, të densiteteve të ndryshme. Për shkak të planifikimit të hershëm, me standarde diellëzimi dhe jetueshmërie të mirë, këto zona ofrojnë hapësira të përshtatshme, dhe në kushtet e presionit të zhvillimit, kanë qenë subjekt i plotësimit me vila, ose kulla, në pjesën qëndrore të qytetit. Kjo dukuri nuk është e pranishme në disa zona periferike, për shkak të cilësisë së dobët të infrastrukturës rrugore në to. Kështu, zonat me tipologji homogjene në skajin verior të qytetit duhen ruajtur nga presioni i zhvillimit, dhe të plotësohen me infrastrukturë të përshtatshme rrugore.

Ndërkaq, sfida për zonat mikse, në kushtet e mungesës së standardeve të përshtatshme të jetueshmërisë, është ristrukturimi, ndërhyrjet rigjeneruese, dhe tendenca për zëvendësim i gjurmëve të vilave të cilësisë së dobët me ndërtesa gjatësore ose të tipit kullë, të densitetit të mesëm, për të siguruar hapësirë dhe aksesueshmëri më të lartë në lagjet qëndrore të qytetit.

Figura 174. Shpërndarja e tipologjive hapësinore në qytetin e Elbasanit



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Së fundmi, zonat e vilave kryesisht paraqiten mjaft të rregullta, me strukturë rrugore kuadratike, ose rrjet të çrregullt, dhe sipërfaqe të gjelbërta të karakterit privat. Në këto zona, që shpesh arrijnë sipërfaqe mbi 50 ha, është e nevojshme të bëhet një plotësim me shërbime dhe funksione jorezidenciale, si dhe të shtohen hapësirat me përdorim dhe akses publik ose gjysëm-publik. Kjo do i shërbente rritjes së cilësisë së jetesës dhe shmangies së segregimit të popullsisë ndaj shërbimeve bazë.

1.9.3 Konkluzione

Sistemet e territorit dhe përdorimi i tokës

- Analiza e përdorimit të tokës evidenton përdorimin kryesor të tokës, që është kategoria natyrore dhe zë përafërsisht 72% të territorit. Toka bujqësore zë sipërfaqe të konsiderueshme duke u renditur e dyta me 21%. Por në territorin e Elbasanit janë shumë të pranishme edhe përdorimet konfliktuale siç janë banim-industri, pranë zonës së metalurgjikut, pranë Fabrikës së Çimentos apo pranë ish Fabrikës së Drurit. Konflikte të tjera janë ndërmjet kategorive bujqësi dhe industri, siç ndodhin në fushën e Elbasanit, ku vendoset metalurgjiku dhe fabrika të tjera.

Tipologjitë hapësinore

- Vendbanimet përgjatë akseve kryesore interurbane Peqin-Elbasan dhe Elbasan-Cërrik. Qendra si Papër, Bradashesh, Shirgjan, Gjergjan, Labinot-Fushë, por edhe

shumë fshatra të tjerë të shtrirë midis tyre, si Ullishtë, Vidhas, Mjekës, Kuqan, etj, lidhen në mënyrë lineare me njëra-tjetrën dhe shtrihen në pozicion të favorshëm për zgjerim urban dhe gjenden të rrethuar nga tokë bujqësore. Hierarkia e fshatrave përveç varësisë ndaj Elbasanit përcaktohet edhe nga Lumi Shkumbin. Krahas qendrës Elbasan, këto vendbanime janë mjaft të dendura dhe përbëjnë sfidë për zhvillim të qëndrueshëm hapësinor, për shmangien e shpërhapjes urbane.

- Vendbanimet e tjera rurale janë përgjithësisht më pak të dendura. Kryesisht ato shtrihen në mënyrë lineare, përgjatë shtretërve të përrenjve që derdhen në lumin Shkumbin. Dallohen disa grupime të njëpasnjëshme vendbanimesh, si Papër-Pajun-Papër Sallak, Fikas-Petresh-Gracen, Kusarth-Karakullak-Letan-Funarë-Mollagjesh, Sericë-Labinot Mal, Shirgjan-Bathës-Tregan,Hajdaraj-Mlizë-Shelçan-Lleshan-Derstilë-Gjinar-Pashtresh-Zavalinë, etj. Në këto tipologji dallohet një periferialitet i dukshëm i vendbanimeve që ndodhen në skaje, si Mollagjesh, Zavalinë, Tërbaç, etj, për të cilat duhet trajtuar me kujdes çështja e aksesueshmërisë. Aksi Bradashesh-Gracen përbën një rast më specific, për shkak të rëndësisë rajonale të lidhjes së dikurshme me Tiranën. Si e tillë, është e nevojshme të krijohen qendërsi të reja dhe mënyra alternative lidhjeje të vendbanimeve me territoret e tjera të Bashkisë, në kushtet e mungesës së qarkullimit të shpeshtë tranzit në këtë aks.
- Tipologji e veçantë lineare janë vendbanimet e shtrira përgjatë autostradës Tiranë-Elbasan, si Shijon, Reçan, Shtemaj, etj. Këto fshatra kanë dendësi të ulët, por presion të lartë rritjeje si rezultat i ndikimit të infrastrukturës rajonale.
- Shushicën dhe Labinot Fushën kanë formë lineare të degëzuar, me qendra respektive të shtrira në aksin kryesor Peqin-Librazhd dhe Belsh-Librazhd, të lidhura gjithashtu me njëra tjetrën nëpërmjet fshatit Polis i Vogël (Librazhd). Pavarësisht se ato nuk komunikojnë me një numër të madh vendbanimesh të tjera, kanë rëndësi për pozicionin e aksesueshëm dhe relievin fushor-kodrinor që përcakton zhvillimin hapësinor të tyre.
- Tipologjitë për lidhjen e vendbanimeve me njëra-tjetrën j brenda të njëjtit fshat janë: a) Tipologjia qendrore (e përhapur në zona me presion më të pakët zhvillimi, si dhe zona me rrjet rrugor kuadratik dhe strukturë të konsoliduar); b) Tipologjia Salteitore (i përhapur në 24% të vendbanimeve rurale, dallohet në zona ku kushtëzimet e terrenit nuk lejojnë që vendbanimet e një fshati të zhvillohen në mënyrë të vazhduar; c)Tipologjia Nukleare (këto dy mënyra zhvillimi hapësinor janë më pak efiçentet sa i takon shfrytëzimit të territorit, sepse zënë territor të gjerë dhe nuk kanë lidhje të mirë mes vendbanimeve); d) Tipologjia qendrore e shpërhapur (1/3 e fshatrave kanë një qendër dominuese, dhe shumë zona banimi të shpërndara pa rregullsi ose hierarki të veçantë në territor); e) Tipologjia e shëprhapur;
- Nga pikëpamja ndërtimore, tipologjitë më të përhapura në Bashkinë Elbasan janë vilat me densitet të ulët, të cilat zënë rreth 30 % të territorit të ndërtuar. Kjo dëshmon për karakterin rural dhe periferial të bashkisë, ku pjesa më e madhe e vendbanimeve janë të shpërhapura në territor, e realizojnë dendësi të ulëta. Mjaft të përhapura janë edhe zonat me vila me densitet të mesëm, ku banesat individuale janë të tipit dupleks, ose banesë individuale 2-3 katëshe. Këto zona dallohen

kryesisht në qendrat e njësive administrative, si dhe në sistemin e vendbanimeve të shtrira në terren fushor.

- Në nivel qyteti miksimi i tipologjive është shumë i theksuar, duke kaluar nga zona qendrore me predominancë ndërtesash gjatësore, të miksuara me kulla dhe vila, në zona me ndërtesa gjatësore me strukturë të planifikuar, homogjene, e deri në periferinë me ndërthurrje zonash vilash të densitetit të lartë e të mesëm me zona industrial
- Referuar zhvillimeve të deritanishme, rritja e mundshme e qytetit mund të kryhet duke zënë territorin bujqësor që ndodhet në pjesën lindore jugore të qytetit, si dhe në mënyrë lineare drejt zonave të Bradasheshit e Labinot Fushës. Densifikimi i zonave ekzistuese periferike është i vështirë, për shkak të sistemit të tyre urban relativisht të rregullt e të konsoliduar, dhe densitetit të lartë të banimit.

1.10 Rëndësia kombëtare në territor

Bashkia e Elbasanit gëzon një pozicion strategjik në territorin shqiptar, i mundësuar nga disa avantazhe ndërsektoriale. Ajo ndodhet në afërsi me zonat ekonomike të Tiranës, Lushnjes dhe Fierit, përshkohet nga akset kryesore lidhëse kombëtare dhe ndërkombëtare, siç është Korridori VIII apo Boshti Qendror, i cili është projekt prioritar i "Planit të Përgjithshëm Kombëtar, Shqipëria 2030". Territori i Elbasanit shtrihet përgjatë Lumit Shkumbin, në të cilit ka zona të mbrojtura natyrore dhe hapësira industriale që kanë potencial ekonomik për zhvillim të mëtejshëm.

- **Monumente Kulturore**

Krahas kështjellës të qytetit, në bashkinë e Elbasanit ndodhen dhe 68 monumente kulture të kategorisë së parë dhe 17 monumente kulture të kategorisë së dytë [438] të cilat administrohen sipas ligjit nr. 9048, date 07.04.2003 (i ndryshuar) "Për trashëgiminë kulturore". Qendra e qytetit të Elbasanit (zona e kalasë) është shpallur Zonë Arkeologjike A me VKM nr. 445, dt 09.06.2010. Ligji nr. 9048/2003 specifikon që për monumentet e kulturës përcaktohet një zonë mbrojtëse (në rast se ka), në përputhje me vlerat e tyre arkitektonike dhe me përshtatshmërinë e tyre urbanistike-estetike. Përmasat e kësaj zone, ku ndalohet çdo ndërhyrje me karakter ndërtimor, janë përcaktuar nga organi që ka shpallur monumentin, sipas studimit të bërë nga Instituti i Monumenteve të Kulturës. Me Vendim të KKT nr. 1, datë 09.09.2015 janë shpallur zona të rëndësisë kombëtare në planifikim disa monumente kulturore, në Elbasan janë përkatësisht: Stacioni Rrugor Ad Quintum në Bradashesh, Kisha e Shën Kollit në Shelçan dhe Kisha e Shën Gjon Vladimirit në Shijon.

- **Zona të mbrojtura natyrore**

Territori i bashkisë së Elbasanit prek dy zona të mbrojtura natyrore në kufirin lindor të tij. Kuturman-Qafë Bushi është *park kombëtar* (Zonë e mbrojtur, kategoria IV) i shpallur me Rregullore të Ministrisë së Brendshme nr.1, datë 27.7.1977 dhe gjithashtu bën pjesë në Rrjetin Emerald. Zona e Sopotit dhe Stravajit janë shpallur *rezervat natyror të menaxhuar/park natyror* (Zonë e mbrojtur, kategoria IV) me VKM nr.102 datë 15.01.1996. Këto hapësira të mbrojtura kanë një zonë buferike prej 50 m nga kufiri që kushtëzon zhvillimin.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 676 datë 20.12.2002 përcakton 23 monumente natyrore (Zonë e mbrojtur, kategoria III) të llojit të drurëve të rrallë, liqene, shkëmbinj (Gradishtë), shpella (Gracen), dhe burimet e Llixhave në Tregan.

- **Menaxhim i integruar i burimeve ujore**

Lumi i Shkumbinit shtrihet me një gjatësi rreth 37 km përgjatë territorit të bashkisë së Elbasanit. Të gjitha burimet ujore së bashku me të gjitha brigjet dhe shtretërit e trupave të ujit pa përjashtim, sipas specifikimit të Ligjit nr. 111/2012, datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", janë pronësi të shtetit dhe në administrim të organeve shtetërore. Për trupat ujorë, ky ligj përcakton largësi sigurie në dy breza në varësi të këndit të bregut më pak ose më shumë se 10%. Zona A shtrihet nga 5 m deri në 20m (përkatësisht për brigje të pjerrëta e të sheshta) dhe përdoret për qëllime publike me dispozita të veçanta. Zona B shtrihet nga 100m deri në 200m (përkatësisht për brigje të pjerrëta e të sheshta) dhe çdo veprimtari e zhvilluar përcaktohet nga organet e administrimit a menaxhimit të burimeve ujore.

Sistemet e kanalizimeve dhe kullimit për mbarëvajtjen e tokave bujqësore rregullohen nëpërmjet Ligjit nr. 8518 i datës 30.07.1999 "Për ujitjen dhe kullimin", i ndryshuar. Sistemet e kullimit që janë pronë shtetërore mund të kalojnë përdorim apo në pronësi të një federate, organizate ose bordi pa ndryshuar destinacionin vetëm me vendim të Këshillit të Ministrave (neni 9). Sipas Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore[439] dhe ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor" (draft), sistemet dytësore dhe tretësore të ujitjes dhe kullimit i kalojnë administrim bashkive si funksion i vetë.

Ligji nr. 9115, datë 24.7.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", i ndryshuar, përcakton rregullat e trajtimit mjedisor të ujërave të ndotura, duke përfshirë ujërat e ndotura urbane, ujërat e ndotura industriale, ujërat nga kullimi i tokave bujqësore dhe ujërat e ndotura të çdo lloji. Sipas VKM nr. 671, datë 29.07.2015, distancat minimale të mbrojtjes nga impiantet për trajtimin e ujërave të zeza janë 200 m për kapacitet më pak se 5,000 banorë dhe 1,000 m për kapacitet 1,000-50,000 banorë.

- **Tokat bujqësore**

Territori i Bashkisë së Elbasanit ka një sipërfaqe modeste prej rreth 176,6 km^2 tokë bujqësore. Sipas legjislacionit në fuqi dhe Ligjit nr. 9244, datë 17.06.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", i ndryshuar, specifikohet mbrojtja nga ndërtimet, mbrojtja e shtretërve dhe brigjeve të lumenjve për parandalimin e erozionit si dhe zbatimi i një praktike të mirë bujqësore. Sipas këtij ligji, kthimi i tokës bujqësore në tokë urbane mund të propozohet vetëm përmes një dokumenti planifikimi, sipas legjislacionit të planifikimit. Ndërtimi është i ndaluar përveç ndërtimeve të përkohshme, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën dhe që janë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral, të cilësuara në Vendimin e KM nr. 283, datë 1.4.2015 "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore". Në të gjitha kategoritë e bonitetit miratimi i kalimit të sipërfaqes për ndërtim bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe në asnjë rast nuk lejohet ndryshimi i destinacionit të objektit ndërtimor.

Po ashtu, Ligji nr. 8722 datë 26.03.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", i ndryshuar, cilëson që në tokat bujqësore mundësohet kalimi në sipërfaqe për ndërtime me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm për rastet e domosdoshme si infrastrukturë (rrugore, hekurudhore, ajrore, detare), hidrocentrale, varreza si dhe raste të tjera të cituara tek neni 11/1. Shtesa e sipërfaqes nuk mund të jetë më e madhe se 3 ha dhe kërkesa për shtesë bëhet vetëm një herë. Kalimi i tokës bujqësore (boniteti V deri në X) në kategori të tokës urbane (truall) bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe deri në 30 ha dhe me ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 30 ha. Ndërkohë pika 4/5 e nenit 11/1 shpreh që kalimi i tokave bujqësore në kategori të burimeve të tjera, si pyll, tokë pyjore, kullotë dhe livadh, si dhe anasjelltas bëhet me miratimin e përbashkët të ministrave përkatës, që i administrojnë këto burime për sipërfaqe deri në 5 ha dhe me miratimin e Këshillit të Ministrave për sipërfaqe mbi 5 ha.

- **Pyjet, drufrutorët dhe kullotat**

Përcaktuar në ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar, "Toka pyjore" janë sipërfaqe toke me drurë, shkurre e bimësi tjetër jopyjore, me shkallë mbulimi nga 5 deri në 30%, së bashku me sipërfaqet e tjera që sigurojnë funksionet e pyllit. Bashkia e Elbasanit ka përafërsisht 55 km^2 [440] toka pyjore me pronësi publike dhe private. Fondi pyjor publik zotërohet e administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Pyjor dhe organet e qeverisjes vendore. Pjesë e këtij fondi pyjor kombëtar mund të kërkohen nga subjekte juridike ose fizike apo nga organet e qeverisjes vendore për t'u kthyer në truall për destinacione specifike të parashikuara në ligjin e mësipërm: me miratim të ministrit për sipërfaqe deri në 1 ha; me vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe nga 1 deri në 100 ha; dhe me ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 100 ha. Sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 8722, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionet e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", i ndryshuar, pjesë të fondit pyjor kombëtar kthehen në kategorinë e burimit të tokës bujqësore vetëm për mbjelljen e këtyre sipërfaqeve me kultura të drurëve, të cilët janë pjesë e programeve dhe të politikave prioritare shtetërore afatgjata. Për të ndryshuar vëllimin e tokës pyjore nevojitet miratimi i organeve të shërbimit pyjor, ndërsa kalimi i burimit të tokës së pafrytshme, që është në pronësi private apo të organeve të qeverisje vendore, bëhet me kërkesë të pronarit apo organit të qeverisjes vendore dhe miratohet nga ministri përkatës.

Në bazë të Ligjit nr. 7929, datë 11.05.1995, "Për mbrojtjen e drufrutorëve", pemët frutore, vreshtat, agrumet dhe ullishtat, pavarësisht se në pronësi të kujt janë, janë pasuri kombëtare dhe mbrohen me ligj nga shteti. Pasuria shtetërore drufrutore e ish-ndërmarrjeve bujqësore, i është dhënë administrim organeve të pushtetit lokal me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 473 datë 14.10.1999.

Fondi kullosor i përbërë nga kullotat dhe livadhet në pronësi publike dhe private është burim natyror dhe pjesë e pasurisë kombëtare. Ai mbrohet, administrohet dhe përdoret sipas kërkesave të Ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, "Për fondin kullosor", i ndryshuar, e të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Heqja e një kullote, apo livadhi nga fondi kullosor, ose ndryshimi i destinacionit për një sipërfaqe kullote bëhet me miratimin e ministrit për sipërfaqe deri në 1 ha dhe me vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe mbi 1 ha.

- **Zonat industriale**

Në zonat e Gracen, Tregan, Shushicë, dhe Papër do të ndërtohen stacione energjetikë eolike (me fuqinë e erës) me specifikat dhe vendndodhje të përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 677, datë 16.8.2013. Sipas VKM nr. 671 datë 29.07.2015, për parqet eolike të prodhimit të energjisë, përveçse kur është përcaktuar ndryshe në legjislacionin e posaçëm, distanca minimale e kufirit të parkut nga kufiri i zonës së banuar është 500 m-2,000 m.


Zona e kombinatit të metalurgjikut është në proces likuidimi dhe privatizimi. Hapësirat e tij prej 60 ha janë ndarë me legjislacion në parcela më të vogla për lehtësi gjatë procesit të privatizim. Ky proces përfshin një fabrikë nikel-kromi, një fabrike gazi, një fabrike prodhimi druri, një TEC dhe 5 nënzona për prodhimin e çelikut[441]. Sipas VKM nr. 671 datë 29.07.2015, objektet industriale, ato të prodhimit, transmetimit e shpërndarjes së energjisë elektrike, përveçse kur është përcaktuar ndryshe në legjislacionin e posaçëm, kanë një gjerësi minimale të zonës mbrojtëse sanitare prej 50 m përgjatë gjithë vijës kufizuese të saj dhe një distancë minimale të mbrojtjes prej 200 m. Këto vlera rriten sipas llojit të objektit e teknologjisë së përdorur si dhe shkallës së ndotjes së zonës industriale gjatë projektimit të saj.

- **Të tjera**

Kullat e telekomunikacionit që janë të larta mbi 25 metra nuk lejohen të ndërtohen e të vendosen brenda zonave të përcaktuara si zona banimi. Distanca e tyre minimale nga kufizimi i pronës më të afërt të ndërtuar është 30 metra.

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 712, datë 29.10.2014, "Për miratimin e rregullores teknike 'Për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë'", territori i varrezës duhet të kufizohet nga zonat e banuara, nëpërmjet zonës së rezervuar. Në të mund të parashikohet vetëm mbjella e drurëve dhe gjelbërimit, ndërtimi i parkimeve, ose i objekteve në shërbim të varrezave. Për qendrat e banuara, me popullsi mbi 10,000 banorë, zona e rezervuar duhet të jetë jo më e vogël se 100 m linear, për qendrat e banuara me popullsi nëm 10,000 banorë, zona e rezervuar duhet të jetë jo më e vogël se 50 m linear.

Figura 175. Rëndësia Kombëtare në territor, Bashkia Elbasan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

1.11 Analiza e periferialitetit

Çfarë është periferialiteti- Pabarazitë hapësinore

Analiza e periferialitetit është mjeti që ndihmon në identifikimin e pabarazive social-ekonomike brenda territorit administrativ që po studiohet. Kjo analizë bazohet në mbivendosjen e gjetjeve të analizave social-ekonomike dhe synon të klasifikojë zona të ndryshme në qytet nga ato më të preferueshmet deri në ato më të pafavorizuarat. Ky klasifikim ndihmon bashkinë në përzgjedhjen e strategjive investuese dhe projekteve prioritare në PPV, që janë:

- largësia nga qendra e zonës së banuar;
- largësia nga qendrat e punësimit;
- lidhja me sistemin rrugor;
- furnizimi me rrjete infrastrukture dhe shërbime sociale;
- niveli më i përafërt i të ardhurave të shtresave shoqërore;
- plotësimi me funksione, sipas kategorive bazë të përdorimeve të tokës;
- niveli i kriminalitetit dhe sigurisë së jetës;
- probleme të ndryshme sociale, përfshirë përjashtimin social.

Çfarë synon

Mbivendosja e hartave që tregojnë rrezet e shërbimit të infrastrukturave arsimore, sociale, shëndetësore, rrugore e nëntokësore si dhe qendrave të punësimit dhe shërbimeve ekonomike krijon mundësinë që të identifikohen në territor zonat e favorizuara (të cilat mbulohen nga rrezet e shërbimit të infrastrukturave publike dhe gjenden në afërsi të zonave ekonomike) nga ato të pafavorizuarat, duke identifikuar kështu zonat ku ka më tepër nevojë për ndërhyrje dhe investime publike.

Kjo analizë, e mbivendosur me analizën demografike, krijon lehtësi në përllogaritjen e numrit të banorëve që banojnë në zona të pafavorizuara dhe të mangësive infrastrukturore që ato kanë, proces mbi të cilin bazohet vendimmarrja përsa i përket ndërhyrjeve prioritare në terren.

Analiza e periferialitetit ka fokus kryesor identifikimin e zonave rezidenciale periferike të Bashkisë së Elbasan dhe evidentimin e problematikave kryesore të këtij qyteti.

Metodologjia

Si fillim është paraqitur rrjeti i infrastrukturës ekzistuese rrugore, rrjeti ekzistues i ujësjellësit - kanalizimeve dhe janë identifikuar institucionet arsimore, shëndetsore në territorin administrativ të bashkisë.

Për objektet arsimore dhe shëndetësore, rrezja e mbulimit të këtij shërbimi është përcaktuar sipas standarteve të përcaktuara në VKM nr. 671. Gjithashtu evidentohen dhe të gjitha akset kryesore të lëvizjes me zonat e influences për shërbimet e ofruara sipas standarteve[442]. Skema e mëposhtme tregon mbivendosjen e këtyre elementëve qendror, si institucionet arsimore, shëndetësore dhe infrastrukturën kryesore rrugore dhe nëntokësore.

Nga mbivendosjet e të gjitha hartave që tregojnë rrezet e shërbimit të infrastrukturave arsimore, sociale, shëndetësore, rrugore e nëntokësore rezultojnë të ndërthurura zona të caktuara.

Në varësi të mbulimit të tyre nga shërbimet e infrastrukturave publike mund të klasifikohen disa kategori në lidhje me periferialitetin, nga ato më periferiket të cilat nuk mbulohen nga asnjë nga shërbimet publike, ato të cilat mbulohen nga të gjitha shërbimet publike, ato të cilat mbulohen nga vetëm tre shërbime apo ato që mbulohen nga dy shërbime ose një shërbim.

A. Arsim
S. Shëndetsi
U. Ujësjellës-Kanalizime
I. Infrastrukture rrugore

Më poshtë janë kategoritë bazë të identifikimit të periferialitetit në hartë:

- **Kategoria 1:** Zonat që mbulohen nga të gjitha shërbimet **(A+S+U+I), të shërbyera shumë mirë**
- **Kategoria 2:** Zonat që mbulohen nga tre shërbime **(ASU, AUI, ASI, SUI), të shërbyera mirë**
- **Kategoria 3:** Zonat që mbulohen nga dy shërbime **(AS, AU, AI, SU, SI, UI), problematike me shërbimet publike**

- **Kategoria 4:** Zonat që mbulohen nga një shërbim **(A, S, U, I), periferike**
- **Kategoria 5:** Zonat që nuk mbulohen nga asnjë shërbim, **shumë periferike**

Kategoritë bazë të klasifikimit të periferialitetit janë rezultat i ndërthurjeve të shërbimeve të ndryshme publike, sipas treguesve të planifikimit për infrastrukturën arsimore dhe shëndetësore[443].

Treguesit e planifikimit për infrastrukturën arsimore dhe shëndetsore janë si më poshtë:

Tabela 88. Treguesit e planifikimit për infrastrukturën arsimore

Infrastruktura arsimore	Numri i banorëve që shërbehet nga një njësi shërbimi		Rrezja e shërbimit		Standardet e projektimit	
	Zona urbane	Zona rurale	Zona urbane	Zona rurale	Për ndërtesën	Për parcelën
Çerdhe	1,000	1,000	200-300m	200-300m	25m^2-30m^2/ fëmijë	900m^2-1.500m^2
Kopësht	1,500	1,500	250-350m	500-600m	18m^2-25m^2/ fëmijë	1.000m^2-1.500m^2
Shkollë 9-	6,000	6,000	500-600m	1,000-1,500m	20m^2-25m^2/ fëmijë	1.500m^2-7.000m^2
Shkollë e	9,000	9,000	1,000-1,500m	2,000-4,500m	20m^2-30m^2/ nxënës	2.000m^2-7.000m^2


Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Tabela 89. Treguesit e planifikimit për infrastrukturën shëndetësore

Emërtimi	Sipërfaqja (m^2)	Treguesit "1 njësi/nr. Banorësh"
Qendra shëndetësore	300-400	Një për 250-1,500
Ambulanca-konsultore materniteti	400-6,000	
Ambulanca-konsultore	700-1,000	Një për 1,500-2,000
Poliklonikë	2,000-5,000	
Dispanseri	3,000	
Drejtori e Higjenës Epidemologjike	2,000-3,000	
Qendër dezinfektimi, deratizimi	2,000	

Burimi: Rregullorja e Planifikimit- VKM Nr. 671

Figura 176. Harta e analizës së periferialitetit



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Sipas kategorizimit të perfierialitetit në Bashkinë e Elbasanit, vetëm njësia administrative e Elbasanit cilësohet si zonë e shërbyer shumë mirë sepse në këtë njësi ofrohen të gjitha shërbimet - **Kategoria 1 (A+S+U+I)**. Por gjithashtu në këtë njësi administrative përfshihen dhe zona që mbulohen me të paktën tre shërbime. **(Kategoria 2, sipas periferialietit)**.


Si zona të shërbyera mirë që mbulohen nga të paktën tre shërbime. **Kategoria 2 (ASU, AUI, ASI, SUI- arsim- shëndetsësi- ujësjellës, arsim- ujësjellës- infrastrukturë, arsim- shëndetsësi- infrastrukturë, shëndetsësi- ujësjellës- infrastrukturë)** janë një pjesë e njësisë administrative Bradashesh në jug-lindje të saj, disa zona banimi në pjesën jugore të njësisë administrative të Papërit, disa zona banimi në Gracen dhe Funarë, disa zona banimi në pjesën qëndrore të njësisë administrative Labinot Mal, në lindje të saj, disa zona në Labinot Fushë në pjesën perëndimore dhe në pjesën lindore. Në njësinë administrative Gjergjan në pjesën qëndrore të saj zona është e mbuluar, në Shirgjan zona të caktuara përgjithësisht në të gjithë njësinë mbulohen nga tre shërbime të paktën , në Shushicë vetëm një pjesë që ndodhet në pjesën veriore të saj mbulohet, në Tregan disa zona të vogla banimi mbulohen, në Gjinar disa zona banimi që ndodhen në zonën lindore të njësisë administrative, e ndërsa në Zavalinë disa zona banimi të ndodhura në pjesën më qëndrore të saj.

Zonat që mbulohen nga dy shërbime **(AS, AU, AI, SU, SI, UI), problematike me shërbimet publike** janë ato të kategorisë së tretë të periferialitetit dhe përgjithësisht mbulohen të gjitha njësitë administrative të Elbasanit.

Ndërsa në Kategorinë e 4 të periferialitetit, zonat që mbulohen nga një shërbim **(A, S, U, I),** dhe që klasifikohen si **periferike** bëjnë pjesë të gjitha njësitë administrative në Elbasan, përveç njësisë Shirgjan, sepse në të nuk përfshihen qendrat shëndetësore, ndërsa të gjitha njësitë administrative të tjera mbulohen nga të paktën një shërbim.


Në kategorinë 5 të kësaj analize përfshihen ato zona të cilat nuk mbulohen nga asnjë shërbim publik, këto zona karakterizohen si shumë periferike. Këtu bëjnë pjesë disa zona banimi të vendosura në njësinë administrative Shirgjan në pjesën veriore dhe jugore të saj. Në to nuk përfshihet asnjë shërbim publik. Më poshtë përfshihen të dhënat e numrit të banorëve për secilën njësi adminstrativë të Bashkisë Elbasan sipas kategorive të periferialitetit.

Figura 177. Grafiku i periferialitetit për Bradashesh



Njësia adminstrative e **Bradasheshit** sipas klasifikimit të Kategorisë 1 të periferialitetit mbulon 3,133 banorë. Sipas Kategorisë 2 mbulohen 2,778 banorë. Sipas Kategorisë 3 mbulohen 631 banorë. Sipas Kategorisë 4 mbulohen vetem 67 banorë. Ndërsa sipas Kategorisë 5 nuk ka asnjë banorë.


Figura 178. Grafiku i periferialitetit për Elbasan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Njësia adminstrative e **Elbasanit** sipas klasifikimit të Kategorisë 1 të periferialitetit mbulon 69,984 banorë. Sipas Kategorisë 2 mbulohen 4,510 banorë. Sipas Kategorisë 3 mbulohen 133 banorë. Sipas Kategorisë 4 dhe sipas Kategorisë 5 nuk ka asnjë banorë.


Figura 179. Grafiku i periferialitetit për Funarë



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Njësia adminstrative e **Funarës** sipas klasifikimit të Kategorisë 1 të periferialitetit nuk mbulohet asnjë banorë. Sipas Kategorisë 2 mbulohen 1,331 banorë. Sipas Kategorisë 3 mbulohen 362 banorë. Sipas Kategorisë 4 mbulohen vetem 75 banorë. Ndërsa sipas Kategorisë 5 nuk ka asnjë banorë.


Figura 180. Grafiku i periferialitetit për Gjergjan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Njësia adminstrative e **Gjergjanit** sipas klasifikimit të Kategorisë 1 të periferialitetit mbulon 2,407 banorë. Sipas Kategorisë 2 mbulohen 2,418 banorë. Sipas Kategorisë 3 mbulohen 685 banorë. Sipas Kategorisë 4 mbulohen vetëm 41 banorë. Ndërsa sipas Kategorisë 5 nuk ka asnjë banorë.


Figura 181. Grafiku i periferialitetit për Gjinar



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Njësia adminstrative e **Gjinarit** sipas klasifikimit të Kategorisë 1 të periferialitetit mbulon 231 banorë. Sipas Kategorisë 2 mbulohen 1,538 banorë. Sipas Kategorisë 3 mbulohen 989 banorë. Sipas Kategorisë 4 mbulohen vetem 58 banorë. Ndërsa sipas Kategorisë 5 nuk ka asnjë banorë.


Figura 182. Grafiku i periferialitetit për Gracen



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Njësia adminstrative e **Gracenit** sipas klasifikimit të Kategorisë 1 të periferialitetit nuk mbulohet asnjë banorë. Sipas Kategorisë 2 mbulohen 767 banorë. Sipas Kategorisë 3 mbulohen 555 banorë. Sipas Kategorisë 4 mbulohen vetem 54 banorë. Ndërsa sipas Kategorisë 5 nuk ka asnjë banorë.

Figura 183. Grafiku i periferialitetit për Labinot Fushë




Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Njësia adminstrative e **Labinot-Fushës** sipas klasifikimit të Kategorisë 1 të periferialitetit mbulon 2,554 banorë. Sipas Kategorisë 2 mbulohen 2,127 banorë. Sipas Kategorisë 3

mbulohen 491 banorë. Sipas Kategorisë 4 mbulohen vetem 25 banorë. Ndërsa sipas Kategorisë 5 nuk ka asnjë banorë.


Figura 184. Grafiku i periferialitetit për Labinot Mal



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Njësia adminstrative e **Labinot-Malit** sipas klasifikimit të Kategorisë 1 të periferialitetit mbulon 318 banorë. Sipas Kategorisë 2 mbulohen 3,497 banorë. Sipas Kategorisë 3 mbulohen 1,235 banorë. Sipas Kategorisë 4 mbulohen vetem 39 banorë. Ndërsa sipas Kategorisë 5 nuk ka asnjë banorë.


Figura 185. Grafiku i periferialitetit për Papër



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Njësia adminstrative e **Papërit** sipas klasifikimit të Kategorisë 1 të periferialitetit mbulon 1,788 banorë. Sipas Kategorisë 2 mbulohen 3,029 banorë. Sipas Kategorisë 3 mbulohen 695 banorë. Sipas Kategorisë 4 mbulohen vetem 14 banorë. Ndërsa sipas Kategorisë 5 nuk ka asnjë banorë.


Figura 186. Grafiku i periferialitetit për Shirgjan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Njësia adminstrative e **Shirgjanit** sipas klasifikimit të Kategorisë 1 të periferialitetit nuk mbulon asnjë banorë. Sipas Kategorisë 2 mbulohen 4546 banorë. Sipas Kategorisë 3 mbulohen 2,172 banorë. Sipas Kategorisë 4 mbulohen vetem 497 banorë. Ndërsa sipas Kategorisë mbulohen 36 banorë.


Figura 187. Grafiku i periferialitetit për Tregan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Njësia adminstrative e **Treganit** sipas klasifikimit të Kategorisë 1 të periferialitetit mbulon 179 banorë. Sipas Kategorisë 2 mbulohen 729 banorë. Sipas Kategorisë 3 mbulohen 875 banorë. Sipas Kategorisë 4 mbulohen vetem 64 banorë. Ndërsa sipas Kategorisë 5 nuk ka asnjë banorë.


Figura 188. Grafiku i periferialitetit për Zavalinë



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Njësia adminstrative e **Zavalinë** sipas klasifikimit të Kategorisë 1 të periferialitetit mbulon 57 banorë. Sipas Kategorisë 2 mbulohen 672 banorë. Sipas Kategorisë 3 mbulohen 282 banorë. Sipas Kategorisë 4 nuk ka asnjë banorë. Ndërsa sipas Kategorisë 5 nuk ka asnjë banorë.

Figura 189. Grafiku i periferialitetit për Shushicë



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Njësia adminstrative e **Shushicës** sipas klasifikimit të Kategorisë 1 të periferialitetit mbulon 2,456 banorë. Sipas Kategorisë 2 mbulohen 2,377 banorë. Sipas Kategorisë 3 mbulohen 1,003 banorë. Sipas Kategorisë 4 mbulohen 219 banorë. Ndërsa sipas Kategorisë 5 nuk ka asnjë banorë.


Më poshtë janë të paraqitura tabela dhe grafiqe sipas sipërfaqes dhe numrit të banorëve sipas kategorive përkatëse të periferialitetit.

Tabela 90. Treguesit për sipërfaqen dhe popullsinë për periferialitetin

Kategoria	Sipërfaqja (%)	Popullsia (%)	Popullsia (Banorë)
Të Shërbyera Shumë Mirë	1.26%	66.58%	83108
Të Shërbyera Mirë	3.07%	24.29%	30322
Problematike Me Shërbimet Publike	34.52%	8.10%	10109
Periferike	60.71%	1%	1253
Shumë Periferike	0.44%	0.03%	36


Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Figura 190. Grafiku i periferialitetit për sipërfaqen e Elbasanit



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Figura 191. Grafiku për popullsinë sipas kategorive përkatëse të periferialitetin



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Mëposhtë është e paraqitur një tabelë që përfshin të gjitha të dhënat për çdo njësi administrative përsa i përket sipërfaqes sipas çdo kategorie të klasifikimit të periferialitetit dhe numrit të banorëve në çdo kategori në secilën njësi.

Tabela 91. Treguesit për sipërfaqen dhe popullsinë sipas kategorive të periferialitetit në secilën njësi administrative të Elbasanit.

Njësia Adminstrative	Kategoria e periferialitetit														
	Kategoria 1 (të shërbyera shumë mirë)			Kategoria 2 (të shërbyera mirë)			Kategoria 3 (problematike me shërbimet publike)			Kategoria 4 (periferike)			Kategoria 5 (shumë periferike)		
	popullsia(banorë)	populls ia (%)	sipërfaqja(%)	populls ia (banorë)	populls ia (%)	sipërfaqja(%)	populls ia (banorë)	populls ia (%)	sipërfaqja(%)	populls ia (banorë)	populls ia (%)	sipërfaqja(%)	populls ia (banorë)	populls ia (%)	sipërfaqja(%)
Elbasan	69,985	56.1	0.93	4,510	3.62	0.68	133	0.11	0.8	0	0	0.15	0	0	0
Bradashesh	3,133	2.51	0.07	2,778	2.23	0.62	631	0.51	2.8	67	0.05	2.9	0	0	0
Funarë	0	0	0	1,331	1.07	0.03	362	0.29	3.9	75	0.06	4.9	0	0	0
Gracen	0	0	0	768	0.62	0.02	555	0.44	2.6	54	0.04	3.9	0	0	0
Papër	1,788	1.43	0.04	3,029	2.43	0.28	695	0.56	3.9	14	0.01	7.5	0	0	0
Labinot Mal	318	0.25	0.003	3,498	2.80	0.11	1,235	0.99	5.2	39	0.03	6.9	0	0	0
Labinot Fushë	2,554	2.05	0.04	2,127	1.71	0.21	492	0.39	3.2	25	0.02	2.1	0	0	0
Gjergjan	2,407	1.93	0.09	2,419	1.94	0.23	685	0.55	1.2	41	0.03	1.7	0	0	0
Shirgjan	0	0	0	4,546	3.64	0.20	2,172	1.74	0.5	497	0.40	1.3	36	0.03	0.44
Tregan	179	0.14	0.006	729	0.58	0.05	875	0.70	1.9	64	0.05	4.7	0	0	0
Shushicë	2,456	1.97	0.06	2,377	1.23	0.31	1,003	0.80	2.8	219	0.18	9.0	0	0	0
Gjinar	231	0.19	0.007	1,538	1.23	0.14	989	0.79	3.3	58	0.05	6.8	0	0	0
Zavalinë	57	0.046	0.006	672	0.54	0.19	282	0.23	2.4	0	0	9.0	0	0	0
Total(banorë)	83,108	66.63	1.26	30,322	23.64	3.06	10,109	8.10	34.46	1153	0.92	60.7	36	0.03	0.44
Total(banorë) Elbasan	124,728														
Total(Sipërfaqe) km	872														

Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Rezulton se vetëm 36 banorë në njësinë Shirgjan përfshihen në kategorinë 5, atë më periferiken. Kjo do të thotë që vetëm disa familje janë ato më periferike që nuk kanë mbulim nga asnjë infrastrukurë publike.

1.12 Konkluzione dhe rekomandime për planin

- Sasia e energjisë së konsumuar për ngrohje në Qarkun Elbasan është e lartë, ku 77% e NjFE-ve, përdorin drutë e zjarrit për t'u ngrohur, 13 % përdorin gazin dhe 7% përdorin energjinë elektrike. Nëse përdoren të gjitha burimet alternative të energjisë, do të kemi një konsum më të ulët të energjisë që përftohet nga drutë e zjarrit apo energjia elektrike. Elbasani ndodhet ndërmjet izolinave 1,450-1,550 kW/m², energji potenciale për t'u përdorur për ngrohjet e banesave. Elbasani shtrihet në zonën gjeotermale Kruja dhe ka potencial për përdorimin e energjisë gjeotermale nëpërmjet burimeve gjeotermale të Kozani-8 dhe Llixhave të Treganit. Fuqia që mund të instalohet në pusin Kozani-8 është e konsiderueshme, 2,070kW. Energjia e eksportuar në nivel kombëtar përbën vetëm 8,6% të energjisë së importuar. Ky është një tregues që përveç humbjeve në rrjet, burimet alternative të energjisë nuk shfrytëzohen.
- Sistemi i furnizimit me ujë mbulon 100% të popullsisë në qytetin e Elbasanit, por ky shërbim nuk shtrihet në të gjithë territorin e bashkisë. Sistemi i furnizimit me ujë është pjesërisht konvencional (kryesisht në zonën urbane dhe një pjesë në zonat rurale). Ky sistem duhet të shtrihet në zonat ku mbulimi me ujë është problematik (ofrohet shërbimi pjesërisht ose nuk ofrohet fare), ndërsa një pjesë (në rastet kur është e mundur) mund të përdoren puset. Kërkesa aktuale për ujë në Bashkinë Elbasan është 1,699 m³/orë, ndërkohë që sasia e ujit të prodhuar është 2,875 m³/orë, pra gati dyfishi i kërkesës. Ky është një tregues i kapaciteteve të larta prodhuese të ujit të pijshëm. Një menaxhim më i mirë i ofrimit të shërbimit do të sigurojë ujë të pijshëm në të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan. Zona ujëmbajtëse shtrihet përgjatë qytetit të Elbasanit, ku ndodhin aktivitetet më të mëdha industriale, ekonomike dhe sociale. Kjo rrit mundësinë e ndotjes së ujërave nëntokësore dhe ndotjes së tokës.
- Fluksi i ushqimit tregon që në territorin e Elbasanit produktet bujqësore që kanë prodhime të larta janë drithërat perimet, foragjerët dhe drufrutorët. Sipas Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, kulturat më të përshtatshme bujqësore janë: drithërat, perimet e serave, fasulet, duhani, foragjerët, drufrutorët (vreshta, ullinj, pjeshkë). Prodhimin më të lartë nga produktet blegtorale e ka qumështi.
- Elbasani është i pasur me burime ujore. Shkumbini është burimi kryesor ujor i cili përshkon territorin e bashkisë nga lindja në perëndim. Ndërsa nga njëra anë Elbasani ka këto burime natyrore që ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e vendit, nga ana tjetër, shumë nga këto burime kanë nevojë për mbrojtje, mirëmbajtje dhe investim. Siç edhe u theksua më sipër, monitorimi i ujërave të Shkumbinit të cilët janë të rëndësishëm për zhvillimin e bashkisë, nxorri në pah problematikat e këtij lumi, të cilat vijnë si pasojë e mungesës së politikave për mbrojtjen e burimeve

natyrore dhe lumit nga aktivitetet njerëzore. Rezultatet e monitorimit treguan se ujërat e Shkumbinit janë të ndotura thellë me metale të rënda. Meqenëse ujërat e këtyre lumenjve përdoren edhe në bujqësi, është e nevojshme që ujërat e lumenjve të monitorohen më tej për të përcaktuar nëse janë të përshtatshëm për ujitje. Përdorimi i ujërave për bujqësi rrezikon shëndetin e njeriut nëpërmjet konsumit të fruta-perimeve të ndotura me ujin e lumit gjatë kultivimit. Në qoftë se nuk merren masa për uljen e ndotjes së ujërave të Shkumbinit, nga burim uji për bujqësinë, ky lumë mund të kthehet në një faktor rreziku për cilësinë e produkteve bujqësore dhe shëndetin e njeriut. *Si rrjedhojë, është e nevojshme që Bashkia dhe organet kompetente të manaxhimit të ujërave në nivel rajonal të ndërmarrin nisma për projekte që synojnë uljen e ndotjes në lumë; si projekte për parandalimin e derdhjes së ujërave të zeza në lumë, të mbetjeve industriale, të parandalimit të ndotjes së ujërave nga inputet bujqësore nëpërmjet përdorimit efiçent të tyre etj. Përveç ndotjes, është e rëndësishme që Bashkia të planifikojë projekte me përparësi për rehabilitimin e lumenjve, së bashku me projekte bashkëpunimi me bashkitë e tjera (dhe organet e nivelit qëndror) që preken nga Shkumbini, për manaxhimin e integruar të këtij lumi.*

- Bashkia e Elbasanit është e pasur me burime ujore sipërfaqësore e nëntokësore të cilat kanë problematikat e tyre. Rezultatet e analizave dhe studimeve të mëparshme tregojnë se ujërat e Shkumbinit nuk janë në nivelin e duhur mjedisor për përdorim në bujqësi dhe argëtim, sidomos pas kalimit të lumit në Librazhd e më tej. Kjo mund të ndikojë negativisht në përdorimin e këtij aseti të rëndësishëm për zhvillimin e bujqësisë dhe turizmit në Elbasan. Një tjetër faktor që vlen të studiohet për Shkumbinin (nga pikëpamja mjedisore dhe e zhvillimit të turizmit) është mundësia e ndërprerjes së rrjedhës së tij nga barrierat fizike, përkatësisht hidrocentralet (HEC-et) në degëzimet e tij. HEC-et që ndërpresin Shkumbinin, në prodhim, në ndërtim, ose të projektuara, ndodhen jashtë dhe brenda kufijve të bashkisë. Këto HEC-e kanë kapacitete të ndryshme nga më pak se 1MË deri mbi 50MË. Shumë prej HEC-eve të vogla janë planifikuar në degët kryesore të Shkumbinit që depërtojnë deri në burimet e tij në Shebenik-Jabllanicë (zonë e mbrojtur) dhe në Valamarë. HEC-et mund të ndikojnë në shtimin e erozionit detar, për shkak të uljes së sasisë së sedimentit të transportuar (HEC si barrierë fizike) në grykëderdhje, zvogëlimin e inerteve të trasportuara në det, si dhe në pengimin e lëvizjes së peshqve dhe të emigrimit të faunës në rrjedhën e lumit mbas barrierës. Për më tepër, ato ndikojnë në tjetërsimin e ekosistemit (jo vetëm lumor) të zonës në të cilën ndërtohen.
- Nga pellgjet ujore nëntokësore, Akuiferi Kuaternar i Elbasanit paraqet rëndësi të veçantë për shkak se shërben si burim furnizimi me ujë për Bashkinë Elbasan dhe Bashkitë e tjera përreth. Megjithatë, duke qenë se në disa segmente në jug të qytetit

Elbasan ka lidhje të drejtpërdrejta me ujërat e Shkumbinit, mbetet i ndjeshëm ndaj ndotjes.

- *Duke parë keqmanaxhimin e burimeve ujore në 20 vitet e fundit, dhe rrezikshmërinë që paraqet ndotja e burimeve ujore nëntokësore për shëndetin e popullsisë, rivlerësimi i ndërtimit të HEC-eve, dhënies së lejeve për karriera lumore, përfshirë edhe projekte për shmangien e ndotjes nga lumi (p.sh. derdhjen e ujërave të zeza dhe mbetjeve ndustriale) dhe nga burimet ujore nëntokësore apo rehabilitimin e tyre, duhet të kenë përparësi për Bashkinë. Në këto projekte, Elbasani duhet të krijojë nisma bashkëpunimi me Bashkitë e tjera që preken nga Baseni i Shkumbinit me qëllim manaxhimin e integruar të basenit të Shkumbinit dhe zonave përreth.*
- Ndotja e ajrit në Bashkinë Elbasan shkaktohet kryesisht nga mjetet e transportit, cilësia jo e mirë e naftës, dhe aktivitete të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, si industria dhe ndërtimet. Për më tepër, ndotja theksohet edhe për shkak të mungesës së sipërfaqeve të gjelbra urbane sipas standardeve. Fatkeqësisht, në Bashki cilësia e ajrit nuk monitorohet rregullisht për shkak të mungesës së monitorimeve të vazhdueshme në kohë me pajisje fikse.
- Ndotja e ajrit në Bashkinë Elbasan ndihet kryesisht në zonat më të populluara urbane (në zonat qendrore të qytetit). Me qëllim shmangien e rrezikut që i kanoset banorëve nga ndotja e ajrit rekomandohet marrja e masave për uljen e ndotjes në ajër, veçanarisht në zonat urbane. Disa nga këto masa mund të jenë planifikimi i zhvillimit të territorit dhe sektorit të transportit, duke e bazuar lëvizjen e qytetarëve të Bashkisë në transport publik alternativ dhe këmbësor, hartimin e politikave që synojnë uljen e qarkullimit të numrit të makinave në zonat urbane, shtimin e hapësirave të gjelbëra, bashkëpunim me Inspektoriatin e Mjedisit për monitorimin e rregullt dhe rigoroz të shkarkimeve në ajër të aktiviteteve industriale të pajisura me leje mjedisore, si dhe kufizimin e ndërtimeve në qytet jashtë standardeve për mbrojtjen e cilësisë së ajrit. Njëkohësisht, rekomandohet bashkëpunim me ARM/AKM-në dhe Institutin e Shëndetit Publik për krijimin e stacioneve të përhershme të monitorimit të cilësisë së ajrit në qytetin e Elbasanit gjatë gjithë vitit me qëllim krijimin e një pasqyre të qartë të cilësisë së ajrit dhe përcaktimin e zonave që kanënevojë për plane të cilësisë së ajrit
- Mirëadministrimi i Pyjeve dhe Kullotave nga Bashkia Elbasan, sigurimi në realizimin e reformës së decentralizimit të kompetencave në administrimin e pyjeve dhe kullotave publike dhe dixhitalizimi i hartave të fondit pyjor nën administrim mbeten pikënisjet drejt suksesit për përmirësimin e gjendjes aktuale tw Pyjeve. Njësitë Administrative, nëpërmjet planeve të manaxhimit të pyjeve dhe kullotave mund t'i ofrojnë banorëve të tyre mundësi punësimi në periudha kur ka aktivitete të punimeve pyjore. NjA-të, nëpërmjet mbjelljes dhe rimbjelljes së drunjëve të lartë mund të përfitojnë më shumë të ardhura, mbështetje financiare në realizimin e

projekteve, si dhe të ardhura të vazhdueshme e të sigurta nga shitja e kapaciteteve të lira të karbonit.

- Për ruajtjen dhe mbarështimin e fondit pyjor e kullosor në territorin e Bashkisë së Elbasanit rekomandohet të merren një sërrë masash, disa prej tw cilave mund të jenë:

  -Studim i hollësishëm për *përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë fenomenin e tharjes të llojit rrap, dushk dhe plep* në seksione të ndryshme të lumit Shkumbim dhe degëve të tij. Ruajtja e tyre paraqet një rëndësi të veçantë për ruajtjen e trupit lumor nga fenomene si erozioni dhe për mirëmbajtjen e këtyre bimëve pyjore me qëllim rritjen e minimizimin e dëmtimeve të tyre,
  -Hartimi i një *Plani Veprimi për rehabilitimitimin e sipërfaqeve të djegura* që nuk kanë mundësi të ripërtëriten në mënyrë natyrale (për shembull. sipërfaqet me pisha në afërsi të fshatit Polis i Vogël) por dhe mbjelljen e tyre me pemë të cilat kanë qënë autoktone,
  -Marrja e *masave paraprake për parandalimin e fenomeneve të zjarrit*, si: ndërgjegjësimin e komunitetit, ndërtimin e brezave mbrojtës, vënien para përgjegjësisë të të gjithë kundërvajtësve që shkaktojnë zjarret, shtrirjen e një sistemi lajmërimi zjarri (rol të rëndësishëm luajnë barinjt e zonës nw kwtw rast, etj.)
  -*Mbajtja nën kontroll e sëmundjeve dhe e dëmtuesve*, ku shkalla e prekjes është më e madhe se kufijtë kritikë të lejueshëm. Rëndësi të veçantë duhet t'i kushtohet zonave me shtrirje të mëdha bimësie dhe ruajtjes së bimëve shmëvjeçare.

- Territori i Bashkisë së Elbasanit rezulton të ketë një larmishmëri peizazhistike, natyrore, ubrane, rurale, ujore, etj., duke u përkthyer kjo në një potencial të pashfrytëzuar për zhvillimin e turizmit dhe guidave turistike. Larmishmëria e peizazhit është kushtëzuar nga territori dhe përdorimi i tokës. Kryesisht, veri-perëndimore - veri-lindore mbizotëron peizazhi natyror, ndërsa në pjesën përgjat Luginës së Lumit Shkumbin mbizotëron peizazh me tipologji rurale e bujqësore. Qyteti i Elbasanit është zona kryesore që formon tipologjinë urbane dhe industriale të peizazhit.

- Në territorin e Bashkisë mbetet problematik fragmentimi i peizazhit natyrorë, i cili është dëmtuar nga zhvillimi urban, industrial e kryesisht ai bujqësor. Zonat e ndotura, kryesisht nga aktiviteti industrial dhe nga mbetjet urbane ndikojnë në përkeqësimin e peizhazhit dhe natyrës në përgjithësi. Ndërthurja e tipologjive të ndryshme të peizazhit në territor haset me vështirësi të mëdha, pasi gjatë zhvillimeve të ndryshme në territor nuk janë marrë parasysh elementët peizazhistikë dhe rëndësia e tyre. Kjo vazhdon të jetë një pengesë për përmirësimin e peizhazhit.

- Me qëllim përmirësimin e peizhazhit dhe ndërthurjen e tipologjive të tij, duke përmirësuar aspektin pamor dhe ruajtur funksionalitetin, nevojitet të merren masa

të cilat lidhen me: i) futjen e përbërësve natyrorë në brëndësi të zonave urbane dhe industriale, ii) mbjedhjen e pemëve të larta për të fshehur objektet industriale të padëshirueshme nga pikpamja vizuale/pamore, iii) ruajtjen dhe mbrojtjen e të gjithave tipologjive të peizhazhit në territorin e Bashkisë, iv) krijimin e zonave ripariane dhe korridoreve përgjatë tokave bujqësore dhe v) gjatë hartimit dhe zbatimit të planeve sektoriale, rekomandohet futja e elementit peizazhistik.

- Bashkia Elbasan është e pasur me rezervate natyrore dhe monumente natyre të shumëllojshme, të cilat përbëjnë një pasuri të konsiderueshme për zhvillimin e turizmit në Bashki. Për më tepër, në Bashki gjenden edhe llixhat e Treganit të cilat, nëse ruhen dhe mirëmbahen, mund të shndërrohen në motorrin kryesor të zhvillimit ekonomik të zonave përreth. Megjithatë, këto zona kanë pësuar dëmtime të ndryshme në vitet e shkuara, si prerje abuzive të pyjeve në territorin e tyre, zjarre, ndërtime të ndryshme, zhvillimtë aktivitetit të guroreve, mbikullotja dhe fenomene të tjera natyrore si erozioni dhe shembjet e ndryshme të dherave.
- Duke patur parasysh që zonat e mbrojtura janë të rëndësishme, jo vetëm sepse shërbejnë si habitate të një biodiversiteti të larmishëm, por edhe sepse mund të favorizojnë zhvillimin e ekonomisë në Bashki nëpërmjet turizmit, rekomandohet që organet kompetente në Bashki të tregojnë një kujdes të veçantë,përpara se ato të humbin vlerat biologjike dhe peizazhistikeqë mbartin.Më konkretisht, rekomandohet bashkëpunimi i Bashkisë Elbasan me AdZM-në Elbasan për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të planeve të manaxhimit për çdo zonë të mbrojtur dhe monument natyre, hartimin e planit të emergjencave për zjarre dhe rreziqe të tjera si dhe bashkëpunimin me universitetet të ndryshme me qëllim promovimin e vlerave shkencore, biologjike, faunistike dhe floristike të zonave të mbrojtura dhe zhvillimin e eko-turizmit dhe aktiviteteve të tjera, që mundësojnë mbledhjen e të ardhurave financiare për manaxhimin e tyre.
- Zona e Elbasanit ka pasuri të shumta natyrore, ku përfshihen lumenjtë, liqenet, zona e mesme dhe të larta malore, kodrat e ullinjve që rrethojnë qytetin, shkurret mesdhetare, pyjet gjethegjerë, halorët dhe përzierjet me kullota. Në të gjithë territorin e sotëm të Bashkisë së re (pas reformës territoriale), ndodhen shumë zona të mbrojtura të kategorive të ndryshme si rezervate natyrore të manaxhuara, monumente kulture, monumente të natyrës, të cilat paraqesin një pasuri natyrore me potencial të lartë për zhvillimin e turzimit malor dhe atij kulturor.
- Për fat të keq, gjatë dy dekadave të fundit, bimësia dhe bota shtazore janë dëmtuar si rezultat i ndërhyrjeve të njeriut (mosmanaxhimit të zonave natyrore, dëmtimit dhe fragmentimit të habitateve, gjuetisë dhe mbledhjes së bimëve mjekësore pa kriter etj.,) dhe faktorëve natyrorë (mungesës së masave specifike për mbrojtjen e

biodiversitetit dhe mungesa e manaxhimit të zonave natyroreetj.,). Si rrjedhojë, shumë shpezë e kafshë të egra po shkojnë drejt zhdukjes.

- Me qëllim ruajtjen e biodiversitetit në këtë zonë, është e rëndësishme që të merren masa urgjente për mbrojtjen e biodiversitetit në përgjithësi, dhe të kafshëve që rrezikojnë të zhduken në veçanti. Për këtë arsye, *rekomandohet që Bashkia i) të bashkëpunojë me Ministrinë e Mjedisit dhe të Bujqësisë për ruajtjen e biodiversitetit dhe për përdorimin e qëndrueshëm të përbërësve të tij, në nivel vendor, duke zbatuar Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Biodiversitetin, ii) për hartimin e planeve të veprimit për ruajtjen e llojeve veçanërisht të mbrojtura, të regjistruara me status ruajtjeje të pafavorshëm, iii) për hartimin e planeve dhe procedurave të veprimit për manaxhimin e rasteve të papritura nga veprimtaritë njerëzore. Gjithashtu, është e rëndësishme që Bashkia të hartojë një plan menaxhimi për mbojtjen e zonave natyrore brenda territorit të saj.*

- Bashkia e Elbasanit ka një larmi të gjerë tokash në territorin e saj (fushore, kodrinore dhe malore), të cilat përdoren për prodhimin e***drithërave*** (grurit, misrit), pemtarisë, perimeve, vreshtarisë (rrushit) dhe blegtorisë (rritja e bagetive të imta e të trasha si lopët, derri dhe dhentë). Bashkia dallohet edhe për pemtari dhe ***ullishtat,*** të cilat janë një traditë e trashëguar ndërshekuj. Kohët e fundit, Bashkia ka zhvilluar edhe ***turizmin malor*** dhe ka shtuar veprimtaritë e saj ekonomike lidhur me Llixhat në Bashkinë e Treganit. Megjithatë, Bashkia përballet edhe me nevojën e shmangies së **degradimit të tokës,** që në Elbasan është fenomen i zakonshëm për shkak të tokave të buta dhe me pjerrësi të theksuar. Ky fenomen theksohet edhe më tej në rastet e punimit të tokave në pjerrësi nga banorët, duke shkaktuar erozion, shkarje dhe shembje të tokës. Për shkak të reshjeve dhe mungesës së manaxhimit të ujërave sipërfaqesore dhe nëntokësore, risku i shkarjeve të tokës mbetet i lartë[444]. Gjatë viteve të fundit, në Elbasan mbetet i lartë edhe rreziku i gërryerjes së tokës në brigjet e lumit Shkumbin, i cili shoqërohet edhe me depozitime të ngurta gjatë përmbytjeve[445]. Dëmtimet në brigjet e lumenjve janë rezultat i shfrytëzimit të materialeve inerte në shtretërit e lumenjve, dëmtimit të objekteve mbrojtëse dhe dëmtimit të bimësisë përgjatë shtratit të tyre. Niveli i humbjes së tokës në brigjet e lumenjve është i lartë, ndëkohë që mirëmbajtja e lumit është anashkaluar. Gjendja rëndohet sidomos në rastet kur ka reshje të shumta e të rrëmbyeshme[446]. Njëkohësisht, Bashkia haset me zvogëlimin e sipërfaqes së tokës bujqësore (përdorime konfliktuale të tokës) për shkak të kthimit të saj në truall ose tokë me përdorime të tjera. Në zona të caktuara, si zona përreth Ish-Kombinatit Metalurgjik dhe impiante të industrisë së rëndë që ka vepruar kryesisht në të shkuarën, nuk mungon edhe ndotja.

- Për të rritur prodhimin bujqësor në territorin e Bashkisë pa cënuar qëndrueshmërinë e tokave, lipset që Bashkia të ofrojë shërbimin e agronomisë nëpër fshatra bujqësore. Duke u ofruar informacionin e duhur bujqve, ky shërbim i ndihmon ata që të shtojnë prodhimin bujqësor nëpërmjet praktikave moderne bujqësore, edhe në toka kodrinore si ato të Elbasanit. Me qëllim shmangien e degradimit të mëtejshëm të tokës bujqësore dhe jo buqësore, nevojitet që Bashkia të promovojë zhvillimin rural brenda territorit dhe të garantojë zhvillimin e një bujqësie më të qëndrueshme nëpërmjet praktikave prodhuese të qëndrueshme që respektojnë mjedisin, siç është përcaktuar në Politikën e Përbashkët për Bujqësinë të BE-së[447].
- Njëkohësisht, rekomandohet që Bashkia të hartojë planin e zhvillimit territorial duke patur parasysh parimin e mbrojtjes së tokës bujqësore (shndërrimin e tokës bujqësore në truall vetëm në raste kur janë konsumuar të gjitha mundësitë e tjera). Me qëllim shmangien e rrezikut që mund t'u kanoset banorëve të Bashkisë nëpërmjet konsumit të produkteve ushqimore të kultivuara në toka të ndotura, rekomandohet që përreth dhe në brendësi të zonave të ndotura në territorin e Bashkisë, të kryhen studime që synojnë përcaktimin e nivelit dhe shtrirjes gjeografike të ndotjes dhe të merren masa të menjëhershme për rehabilitimin e tyre.
- Sipas të dhënave të INSTAT, Bashkia e Elbasanit në 1 janar 2015 regjistroi një numër popullsie rezidente prej 144,382 banorë, prej të cilëve 72,987 meshkuj dhe 71,395 femra.
- Sipas shpërndarjes urban/rurale rreth 56% e popullatës së bashkisë klasifikohet si popullsi urbane dhe diferenca prej 46% si popullsi rurale.
- Sipas strukturës moshore rreth 69% e popullatës i përket grupmoshës (15-64) vjeç dhe 20% grupmoshës 19 vjeç. Këta tregues demonstrojnë se popullata e bashkisë ka potenciale të larta të popullsisë ekonomikisht aktive, përfshirja e të cilëve në tregun e punës do të ndikojë ndjeshëm në rritjen e performancës ekonomike dhe mirëqenien e popullatës. Struktura aktuale demografike e popullsisë rezidente si dhe mosha mesatare e saj relativisht e re tregojnë se popullsia e zonës është akoma e re.
- Por nëse iu referohemi të dhënave të gjendjes civile, vëmë re që popullsia e Bashkisë Elbasan ka pësuar rritje në të gjitha njësitë administrative. Sipas bashkisë, ky fakt mbështetet edhe nga rritja e numrit të votuesve nga viti në vit. Në ndarjen e popullsisë sipas gjinisë, raporti meshkuj femra qëndron në raporte thuajse të barabarta. Pjesa më e madhe e popullsisë është përqendruar në qytetin e Elbasanit dhe në njësitë me terren të butë dhe që kanë akses të mirë. Zonat malore kanë numër më të vogël banorësh.
- Gjithsesi, procesi i vazhdueshëm i emigrimit, ritmet e larta të migrimit të brendshëm si dhe rënia e lindshmërisë dhe vdekshmërisë kanë ndikuar jo vetëm në rënien e numrit të popullsisë por edhe në ndryshimin drastik të strukturës së saj demografike.

- Një faktor shumë i rëndësishëm në përcaktimin e stokut të popullatës së qarqeve është edhe migrimi i brendshëm i popullsisë, pra lëvizjet e popullatës nga një qark në tjetrin.
- Sipas parashikimeve të popullsisë, skenari i rritjes së mesme, popullsia e qarkut/bashkisë do të pësojë rënie, me një ritëm mesatar vjetor rreth 1% dhe si faktor kryesor mendohet të jetë migracioni i brendshëm.
- Popullsia rezidente e Bashkisë Elbasan deri në vitin 2021 do të ketë një tregues të varësisë totale të ulët, duke ruajtur të ashtuquajturin "divident demografik".Për të përfituar nga ky "divident demografik", kërkohen politika të bashkërenduara në nivel qendror e vendor për të mundësuar, arsimimin, trajnimin dhe përfshirjen në tregun e punës të kësaj kategorie të popullatës me qëllim rritjen dhe përmirësimin në vazhdimësi të mirëqenies së saj.
- Të ndërtohet të paktën një shkollë e mesme në çdo njësi administrative të bashkisë Elbasan që nuk e ka një të tillë, si: Bradshesh, Gracen, Gjergjan, Shushicë dhe Tregan.
- Të shqyrtohet mundësia e ndërtimit të 1 shkolle të mesme shumëfunksionale profesionale (me profile të ndryshme) në qytetin e Elbasanit, pasi shkollat e mesme ekzistuese nuk e mbulojnë plotësisht qytetin me shërbimin.
- Bashkia e Elbasanit ka një mbulim të varfër me kopshte dhe rrezja e shërbimit të kopshteve ekzistuese lë pjesë të mëdha të territorit të pambuluara si në qytetin e Elbasanit, ashtu dhe në njësitë e tjera të bashkisë. Duke marrë në konsideratë dhe raportin e vogël të edukatorëve për fëmijë, këshillohet që bashkia e Elbasanit të ndërmarri një studim më të thelluar të numrit ekzistues të fëmijëve të grupmoshës 3-5 vjeç, shpërndarjes së tyrë në gjithë territorin e bashkisë, si dhe nivelit të aksesit në kopshte.
- Të bëhet një inventarizim i hollësishëm i mjeteve didaktike ekzsistuese në kopshte dhe shkolla dhe të kryhet pajisja e tyrë sipas nevojave.
- Të përmirësohet infrastruktura fizike e institucioneve arsimore veçanërisht të kryhet rikonstruksion i plotë në shkollën 9-vjeçare të varur Bodin, në njësinë administrative Gracen; në një kopësht dhe 2 shkolla 9-vjeçare Bradashesh; në 3 shkolla 9- vjeçare në Funarë (si në shkollën Preç e poshtëme, Cerujë, Krrabë e Vogël); 2 kopshte dhe 1 shkollë fillore në Zavalinë, përkatësisht në Burrishtë dhe Kamican; 3 shkolla 9-vjeçare në Tregan (përkasisht në Kaqivel, Kaqivel i poshtëm dhe Shinavlash); 3 shkolla 9-vjeçare në Gjergjan (Gjergjan, Kodra Bujaras, Bujaras), etj. Në çdo njësi administrative të Elbasanit ka nevojë për rinkonstruksion të pjesshëm për një sërë shkollash dhe kopshtesh.
- Shkalla e papunësisë në bashkinë e re të Elbasanit është relativisht e lartë dhe për të përballuar kërkesat e larta për punësim, bashkia duhet të ndërmarrë politika për zhvillimin e përgjithshëm dhe me rritme të shpejta ekonomike.
- Në kushtet e territorit të ri, me disa qendërsi urbane dhe karakter të theksuar bujqësor dhe malor, rishikimi i prioriteteve të zhvillimit ekonomik lokal është një

hap urgjent për t`u ndërmarrë për bashkinë e Elbasanit. Bashkia duhet të luajë një rol aktiv në mbështetje të zhvillimit rural, krahas atij urban.

- Me dobësimin e sektorëve ekonomik si industria apo ndërtimi në vitet e fundit, shumica e të punësuarëve në qytetin e Elbasanit është përqendruar në sektorin e shërbimeve. Për këtë arsye, bashkia duhet të nxisë rritjen e shpejtë të bizneseve private, duke ndjekur politika fiskale stimuluese; vënë në dispozicion të qytetarëve burime potenciale, si trashegimia historike prsh. për zhvillimin e bizneseve të reja private në këtë fushë; rritur investimevet publike nëpërmjet mekanizmave të ndryshme si përdorimi i fondeve publike, kredive, granteve apo projekte me donator të ndryshëm, etj.
- Në kushtet ku norma e papunësisë është shumë e lartë për të rinjtë e moshës 15-24 vjeç dhe me decentralizimin e procesit të menaxhimit të sektorit të arsimit parauniversitar dhe kalimin e tij si kompetencë e bashkisë së re, Bashkia Elbasan duhet me prioritet të drejtojë forcën ekonomike aktive drejt arsimit dhe formimit profesional, në shërbim të tregut lokal të punës. Prioritet duhet ti jepet kurseve dhe trajnime afatshkurtra të të rinjëve dhe forcimi i partneritetit publik-privatë në të gjitha sektorët ekonomik.
- Përgjithësisht, ambulancat dhe qendrat shëndëtësore shfaqin një infrastrukturë fizike të dobët. Nevojitet ndërhyrja e mënjëherëshme për rikonstruksionin e 4 ambaluancave jo-funksionale, 2 në Bradashesh dhe 2 në Papër. Për më tepër, nevojitet ndërhyje dhe rikonstruksion i pjesshëm në njësinë administrative Gjinar (qendra shëndetësore ka patur rikonstruksion të pjesshëm); Tregan (2 ambulanca janë në gjëndje të amortizuar fizike); në Gjergjan; Shushicë (qendra shëndetësore në Qafë është komplet e amortizuar); Zavalinë, etj.
- Kategori si gratë dhe vajzat, të rinj me probleme sociale dhe persona me aftësi të kufizuar nuk asistohen nga institucione të posaçme të shërbimit social. Megjithatë, në bashkinë Elbasan operojnë rreth 328 kujdestarë të shërbimeve sociale. Me gjithë dinamikën e zhvillimeve socio-ekonomike, kështillohet ndërtimi/forcimi i kapaciteteve të institucioneve ekzistuese për ofrimin e shërbimit përkatës social dhe ndërtimi i institucioneve të posaçme për ofrimin e këtyre shërbimeve.
- Për përmirësimin e aksesit të qytetarëve në shërbimin shëndetësor është e domosdoshmë rritja e numrit të ambulancave në mënyrë që të arrihet një tregues mesatar të paktën një ambulancë për rreth 6 mijë banorë, duke marrë në konsideratë edhe dëndësinë e banimeve.
- Për të përmirësuar raportin mjek/ banorë është prioritare rritja e numrit të mjekëve në shërbimin shëndetsor parësor, që i shërbejnë drejtpërdrejtë banorëve të bashkisë së Elbasanit.
- Duke marrë parasysh pabarazitë mes zonës urbane dhe asaj rurale të bashkisë, është i domosdoshëm zhvillim i njëtrajtshëm ekonomik me rritme të larta rritje për të gjithë bashkinë, por duke konsideruar karakteristikat e veçanta fizike, sociale dhe ekonomike për secilën njësi specifike.

- Rritja e punësimit dhe e trajnimi profesional i forcës punëtore shihen si masa prioritare për rritjen e mirqënies ekonomike.
- Bashkëpunimi me donatorë ndërkombëtarë dhe me specifikisht ngritja e kapaciteteve bashkiake për të aplikuar për fonde, grante dhe programe, sidomos nga programet e Bashkimit Europian për zhvillimin rural dhe rajonet më pak të zhvilluara shihet si prioritet.
- Prodhimi i Brendshëm Bruto për frymë në Bashkinë Elbasan vlerësohet 25% më pak sesa PBB për frymë në nivel kombëtar. Në vlera absolute PBB e Elbasanit është 7.9% e PBB kombëtare. Qarku i Elbasanit është qarku i 4-t për sa i përket kontributit në PBB kombëtare.Sektori që ka vlerën e shtuar bruto me të lartë janë shërbimet 43.5% më pas është bujqësia me 34.1% dhe industria me 14.2% ndërsa produktivitetin më të lartë e ka sektori i industrisë.
- Situata e tregjeve në Bashkinë Elbasan nuk është e mirë. Në të operojnë rreth 5 tregje me një kapacitet prej 517 vende, të cilat ndodhen vetëm në qytetin e Elbasanit. Këto tregje janë të pamjaftueshme për të furnizuar qytetin e Elbasanit me produkte. Gjithashtu vërehet mungesa e tregjeve më të vogla nëpër qendrat e njësive administrative.
- Njësitë ekonomike në Qarkun Elbasan janë të orientuar drejt shërbimeve dhe tregtisë ku 42.7% e subjekteve merren me tregti dhe 43.3% janë subjekte që kanë për bazë shërbimet e ndryshme. Situata është e përafërt dhe në Bashkinë Elbasan ku 45% e subjekteve merren me tregti dhe 41.4 % e subjekteve kanë për bazë shërbimet, ndërsa 10.7% e subjekteve janë industriale.
- Bujqësia është një sektor me peshë në ekonominë e Bashkisë Elbasan. Zonat që kanë më shumë përparësi në zhvillimin bujqësorë janë njësitë administrative përgjatë luginës së Lumit Shkumbin si pasojë e terrenit më fushor që kanë raport me njësitë e tjera që kanë një potencial më të moderuar për zhvillim bujqësor (terren kodrinor-malor).
- Turizmin për momentin luan rol minimal në ekonominë e Elbasanit, por si sektor ka potenciale të mëdha zhvillimi. Turizmi kulturor, malor dhe natyror mund të luajnë rol kyç në ekonomi në disa zona të bashkisë.
- Për sa i përket klasifikimit të ekonomive të njësive administrative të Bashkisë Elbasan mund të themi se të gjitha njësitë administrative janë ekonomi agrare përveç qytetit të Elbasanit që është ekonomi aglomeruese.
- Në total Bashkia Elbasan është një ekonomi e orientuar drejt shërbimeve me 51.4 %, me pas bujqësia 27.7 % dhe industria me 20.9 %
- Aktivitetet kryesore ekonomike në Bashkinë e Elbasanit ndodhin përgjatë luginës së Shkumbinit. Për këtë situatë ndikon aksi kombëtar Rrogozhinë-Elbasan-Pogradec, që ndodhet në këtë luginë dhe i ofron akses të mirë këtyre zonave ekonomike.
- Një nga sfidat e rëndësishme që has Bashkia e Elbasanit për zhvillimin rural dhe bujqësor lidhet me terrenin e thyer kodrinoro-malor dhe me numrin e popullsisë,

qësa vjen e po ulet në zonat rurale. Momentalisht, rreth 56 % e popullsisë totale është përqendruar në qytetin e Elbasanit, kurse 44% e popullsisë jeton në njësitë e tjera administrative të bashkisë, të cilat kanë karakter të theksuar bujqësor. Të punësuarit në sektorin e bujqësisë në qytetin e Elbasanit nuk përfshijnë më shumë se 3.2% të numrit total të të punësuarëve në qytetin e Elbasanit, kurse pjesa e popullsisë që ndodhet në njësitë e tjera administrative të bashkisë është punësuar kryesisht në bujqësi, duke e bërë kështu bujqësinë për zonat rurale sektorin primar të ekonomisë[448]. Megjithatë sipas skenarëve vlerësues të projeksionit të popullsisë (2015-2031), mendohet se përveçse një rënie prej 1% të numrit të përgjithshme të popullsisë, ndërkohë që rënia e popullsisë e krahasuar me vitin 2015 vlerësohet se do të jetë në rreth 17%, numri i banorëve në zonat rurale do të pësojë rënie të vazhdueshme. Shkaku kryesor i kësaj zhvendosje mendohet të vijë si pasojë e migrimit të brëndshëm dhe ndër të tjerave, nga largimi i vazhdueshëm i të rinjve nga sektori bujqësor[449]. Kjo pririe demografike me migrim të të rinjëve ndikon negativisht në disponueshmërinë e forcës së punës në zonat rurale dhe përbën një sfidë të rëndësishme për të ardhmen e zhvillimit bujqësor dhe rural në Bashkisë e Elbasanit. Megjithatë, përmirësimi i përdorimit të tokës do mundësonte punësim shtesë në këtë sektor në vitet e ardhshme. Ruajtja e tokës bujqësore të këtij rajoni është kryefjala e zhvillimit të tij dhe aktiviteti bujqësor duhet të fuqizohet përmes aplikimit të bujqësisë organike, konsolidimit të produkteve bujqësore (në pamundësi të konsolidimit të fermave), rajonizimit të kulturave sipas territorit, ndërtimit të tregjeve rajonale dhe mbështetjes kombëtare për zhvillimin e bujqësisë dhe produktit shqiptar.

- Zhvillimin e bujqësisë në bashki, përveç klimës, terrenit dhe tokave të përshtatshme e ka favorizuar edhe rrjeti i përrenjve e lumenjve që përshkojnë territorin e bashkisë dhe më tej i bashkohen Shkumbinit. Në këtë rrjet, Shkumbini është boshti kryesor i cili përshkon territorin e bashkisë nga lindja në perëndim. Ndërsa nga njëra anë Elbasani ka këto burime natyrore që ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin e vendit, nga ana tjetër, shumë nga këto burime kanë nevojë për mbrojtje, mirëmbajtje dhe investim. Rezultat e analizave dhe studime të mëparshme tregojnë se ujërat e Shkumbinit nuk janë në nivelin e duhur mjedisor për përdorim në bujqësi, sidomos pas kalimit të lumit në Librazhd e më tej. Kjo mund të ndikojë negativisht në përdorimin e këtij aseti të rëndësishëm për zhvillimin e bujqësisë dhe produkteve cilësore ushqimore. Përdorimi i ujërave për bujqësi rrezikon shëndetin e njeriut nëpërmjet konsumit të fruta-perimeve të ndotura me ujin e lumit gjatë kultivimit. Nëse nuk merren masa për uljen e ndotjes së ujërave të Shkumbinit, nga burim uji për bujqësinë, ky lum mund të kthehen në një faktor rreziku për cilësinë e produkteve bujqësore dhe shëndetin e njeriut. Si rrjedhojë, është e nevojshme që bashkia dhe organet kompetente të menaxhimit të ujërave në nivel rajonal të ndërmarrin nisma për projekte që synojnë uljen e ndotjes në lumë si projekte për parandalimin e derdhjes së ujërave të zeza në lumë, të mbetjeve industriale, dhe të të gjitha aktiviteteve që ndikojnë ndotjen e ujërave të tij, duke përfshirë edhe parandalimin e ndotjes së ujërave nga inputet bujqësore nëpërmjet përdorimit efikas të tyre. Përveç ndotjes, është e rëndësishme që bashkia të planifikojë projekte më përparësi për rehabilitimin e lumenjve, së bashku me projekte bashkëpunimi me bashkitë e tjera (dhe organet e nivelit qendror) që preken nga Shkumbini, për

menaxhimin e integruar të këtij lumi.Nëse ujërat e lumit Shkumbin, do të pësonin rritje të nivelit të tyre për shkak të ndryshime klimatike, tokat bujqësore dhe vendbanimet që shtrihen përgjatë tij do të pësonin dëmtime të shumëta. Për këtë arsye duhen marrë masa për fortifikimin e pengesave të brigjeve të lumenjve, kryesisht në zonat më problematike, të cilat janë të prekur edhe nga erozioni lumor. Gjithashtu, duhen marrë masa për përmbushjen e nevojave ushqimore në raste ekstreme, ku kulturat bujqësore dëmtohen nga përmbytjet masive dhe nga periudhat e gjata të thatësirës.

- Nga studimi i kryer nga Tota et al. në vitin 2007, rezulton se ndotja me metale të rënda (Cd, Zn, dhe Cu) e tokës bujqësore përreth Kombinatit Metalurgjik[450] me rreze shtrirjeje 2-5km përreth kombinatit është e theksuar. Toka bujqësore në Papër, Bradashesh dhe përreth Metalurgjikut është ndotur me Cr[451]. Kohët e fundit, bashkia ka zhvilluar edhe turizmin malor dhe ka shtuar veprimtaritë e saj ekonomike lidhur me Llixhat në njësinë administrative Tregan. Bashkia ka shumë fshatra të ndodhura në terren kodrinor e malor, sidomos në zonën e maleve të Kërrabës e Labinotit. Kultivimi i tokës së këtyre zonave krijon vetvetiu erozion të tokës nëse praktikat e kultivimit të saj nuk janë të qëndrueshme. Shkaqet e erozionit lidhen me: 1) kultivimin e tokave me pjerrësi të mesme e të theksuar, që rezulton në rrëshqitje, ndihmuar kjo dhe nga fenomene të motit; 2) mënyra e kultivimit të tokës, në të njëjtin drejtim me pjerrësinë dhe me zhveshje totale të tokës; 3) djegie të mbetjeve të bimëve të kultivuara, si praktikë e thjeshtë për pastrimin e saj, por që shkatërron plehun organik dhe zhvesh tokën; 4) tarracim të papërshtatshëm, me zhveshje të tokës; 5) prerje të pyjeve, etj. Si rezultat i erozionit, mungesës së njohurisë se thelluar për tokën dhe praktikave të keqmenaxhimit, apo braktisjes, në territorin e bashkisë vihet re degradimi i tokës. Nuk ka shifra lokale, por në rang vendi, vetëm erozioni dhe degradimi i tokave kanë çuar në humbjen e 5% të prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2014 . Përveç erozionit, tokat e rajonit të Elbasanit janë të rrezikuara potencialisht nga shkarjet dhe shembjet , një formë e erozionit gjeologjik. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) identifikon si shkaqe të shkarjeve të tokës në bashki relievin e thyer, reshjet, dëmtimin e bimësisë natyrore, braktisjen e tokave bujqësore etj. Për shkak të reshjeve dhe mungesës së menaxhimit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, rrezikut i shkarjeve të tokës mbetet i lartë .

- Gjatë viteve të fundit, në Elbasan mbetet i lartë edhe rreziku i gërryerjes së tokës në brigjet e Lumit Shkumbin, i cili shoqërohet edhe me depozitime të ngurta gjatë përmbytjeve . Dëmtimet në brigjet e lumenjve janë rezultat i shfrytëzimit të materialeve inerte në shtretërit e tyre, dëmtimit të objekteve mbrojtëse dhe dëmtimit të bimësisë përgjatë shtratit të tyre. Të dhënat tregojnë se vlera mesatare e tokës së gërryer luhatet nga 0.5-0.8ton/vit për çdo metër linear të shtratit të Lumit të Shkumbinit . Përgjatë shtratit të këtij lumi është vënë re se humbet rreth 500-800 m3 tokë në vit në një hapësirë prej 1,000 metër linear. Shkaqet lidhen me devijimin e rrjedhës së ujit të këtyre lumenjve për shkak të shfrytëzimit të inerteve ose mbushjes së shtratit të tyre me mbetje urbane. Niveli i humbjes së tokës në brigjet e këtyre lumenjve është i lartë teksa mirëmbajtja e lumenjve është lënë pas dore. Gjendja rëndohet sidomos në rastet kur ka reshje të shumta e të rrëmbyeshme. *Me*

qëllim shmangien e degradimit të mëtejshëm të tokës bujqësore dhe jo bujqësore, nevojitet që bashkia të promovojë zhvillimin rural brenda territorit dhe të garantojë zhvillimin e një bujqësie më të qëndrueshme nëpërmjet praktikave prodhuese të qëndrueshme që respektojnë mjedisin, siç përcaktuar në Politikën e Përbashkët të BE-së për Bujqësinë .

- Niveli i humbjes së tokës në brigjet e lumenjve është i lartë teksa mirëmbajtja e lumit është lënë pas dore. Gjendja rëndohet sidomos në rastet kur ka reshje të shumta e të rrëmbyeshme . Për të rritur prodhimin bujqësor në territorin e bashkisë pa cenuar qëndrueshmërinë e tokave, lipset që bashkia të ofrojë shërbimin e agronomisë nëpër fshatra bujqësore. Duke u ofruar informacionin e duhur bujqve, ky shërbim i ndihmon ata që të shtojnë prodhimin bujqësor nëpërmjet praktikave moderne bujqësore edhe në toka kodrinore si ato të Elbasanit.
- Sipërfaqja totale e pronave publike në këtë bashki është 28,160,227 m^2 .
- Pronat me sipërfaqe më të mëdha janë rezervuare dhe kanale që përdoren për ujitje, kullim dhe depozitim uji.
- Pyjet publike në Bashkinë Elbasan kanë sipërfaqe 53,502.59ha. Megjithatë njësia administrative Zavalinë ka 52ha zona pyjore në pronësi private.
- Inventari i pronave publike ka mangësi sidomos në evidentimin e pronave me karakter shërbimi publik si arsim dhe shëndetësi. Kjo evidentohet nga diferenca e madhe prej 152 pronave që rezultojnë nga përdorimi i tokës me 57 prona të evidentuara nga Inventari. Evidentimi shërben për të kuptuar edhe mangësitë e tjera që mund të ketë Inventari në krahasim me përdorimin e tokës.
- Kemi 65 zona konfliktuale në këtë bashki, kur në pronën publike ka pasur ndërtime të tjera, shpesh pas viteve 1990. Këto zona janë të përqëndruara më shumë përgjatë rrjedhës së lumit Shkumbin, sidomos në njësinë administrative Gjergjan.
- Bashkia Elbasan shtrihet në një pozicion strategjik të favorshëm duke parë që në këtë bashki kalon korridori VIII, i cili është një aks i rëndësishëm ndërkombëtar. Si pjesë e këtij korridori është projekti për ndërtimin e *by-pass*, i cili pritet të ndërtohet dhe do të kalojë në periferi të qyteti. Një tjetër intenerar i rëndësishëm është dhe autostrada që lidh qytetin e Elbasanit me Tiranën.
- Përsa i përket transportit ndërqytetas Bashkia e Elbasan lëvizshmërinë më të lartë e ka me qytetin e Tiranës dhe Lushnjen.
- Sipas draftit të Planit Kombëtar 2015-2030 që është duke u përgatitur nga AKPT-ja, Papër-i do të bëhet një nyje logjistike mjaft e rëndësishme sepse në këtë pikë do të fillojë boshti qëndror jugor i cili nis nga Tirana dhe përfundon në by-pass-in e Memaliajt ku bashkohet me korridorin e kaltër që vjen nga Levan-i i Fierit.
- Si pasojë e reformës territoriale, Bashkia e Elbasanit tashmë ka një shumëfishim të sipërfaqeve rrugore të cilat gjenden në territorin e saj në krahasim me ish-njësitë e vjetra administrative. Si pasojë e këtij ndryshimi edhe numri i sipërfaqeve të rrugëve ka ndryshuar, ku në këtë bashki mbizoterojnë rrugët lokale si dhe kemi kalimin nga rrugët urbane që shtrihej kjo bashki në rrugë rurale ku shtrihet sot.

- Nga analiza e infrastrukturës rrugore, një nga problemet kryesore që është evidentuar nga grupi i punës janë hyrje daljet (intersect-et) e rrugeve lokale me rrugët interurbane kryesore. Kjo analize është bërë në GIS dhe janë evidentuar 512 pika konfliktuale të cilat janë burim aksidenti për këtë bashki.
- Bashkia Elbasan ka aktualisht sasi të konsiderueshme që merren nga pusshpimet në Mengel, Kraste e Vogël dhe Frigoriferi për plotësimin e kërkesës aktuale për ujë duke pasur parasysh që humbjet teknike në sistem nuk janë më të mëdha se 35%.
- Në rreth 39% të popullsisë që banon në zonën rurale të Bashkisë Elbasan nuk ka sisteme të ndërtuara të furnizimit me ujë.
- Më problematike në drejtim të plotësimit të kërkesës për ujë paraqiten njësitë administrative Gjinar, Shushicë, Tregan, Shirgjan, Gjergjan, Funarë, Gracen dhe Labinot Mal.
- Sistemi i largimit të ujërave të ndotur duhet rehabilituar në mjaft pjesë të tij duke përdorur teknologji të reja të materialeve dhe diametra që i përgjigjen sasisë së ujërave të zeza në funksion të numrit të popullsisë që derdhin ujërat në të.
- Të shihet maksimalisht mundësia e ndarjes së sistemit të ujërave të shiut nga ato të zeza, për të cilat duhet ndërtuar impiant i pastrimit të tyre.
- Për zonën rurale të ndërtohen gropa septike në përputhje me standardet teknike sikurse dhe në zonat që është e vështirë të ofrohet shërbimi i grumbullimit të ujërave të ndotura me sistem kanalizimesh.
- Ofrimi i shërbimit të ndriçimit publik hyn ndër funksionet e veta të pushtetit vendor sidhe bashkitë kanë të drejta eksluzimeve mbi ofrimin e këtij shërbimi në territoret e tyre. Gjithashtu Këshillat Bashkiak vendosin mbi kriteret e ofrimit të këtij shërbimi.
- Në Bashkinë e Elbasanit ofrohet në qytetin e Elbasanit, në NjA Bradashesh, në NjA Papër dhe në NjA Tregan ndërsa në NjA Labinot Mal, Labinot Fushë, Shirgjan, Gjergjan, Shushicë, Gjinar, Zavalinë, Funarë dhe Gracen nuk e ofrojnë këtë shërbim.
- Në total në Bashkinë e Elbasanit kemi 88 km rrjet rrugor të ndriçuar në rreth 247 akse rrugore me 1809 shtylla ndriçimi dhe 3409 llamba. Në këtë bashki ka gjithashtu dhe 5 sheshe dhe 4 lulishte të ndriçuara.
- Në Qytetitn e Elbasanit kemi rreth 70.2 km rrugë të ndriçuar që është e shpërndarë në 213 akse rrugore, rreth 37% e rrjetit rrugor është e ndriçuar cka është një vlerë mjaft e ulët. Qyteti gjithashtu ka 1480 shtylla dhe 3080 llamba. Investimet kryesore ndër rrugë janë bëre pas viteve 90 por gjithsesi sistemi i ndriçimit paraqet probleme të shumta që kanë të bëjnë me dëmtimin e kallbove dhe dëmtimin e ndriçusave.
- NjA Bradashesh ofron shërbimin e ndricimit publik ne 3 fshatra (Kusarth, Katund i Ri dhe Bradashesh) në një gjatësi prej 7.8 km ne 222 ndriçusa nga të cilët 25 % e tyre nuk funksionojnë. NJA Papër ofron shërbimin e ndricimit publik në 3 fshatra (Papër, Valas dhe Broshkë) në një gjatësi prej 1.8 km në 67 ndriçusa e ku një pjesë

e madhe e tyre nuk janë në funksion. NJA Tregan oforon shërbimin e ndriçimit publik vetëm në Fshatin Tregan në një gjatësi prej 1.5 km ku ndodhen 40 ndriçusa.

- Përsa i përket kostove dhe nivelit të të ardhurave nga tarifat e ndriçimit duhet thënë se në asnjë vit kostot nuk janë mbuluar totalisht nga të ardhurat nga tarifat e ndriçimit kjo si pasojë e nivelit të ulët të arkëtimit të tarifave të ndriçimit.
- Fillimisht Bashkia Elbasan ka nevojë për të përditësuar Planin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane, kjo si nevojë për një studim të plotë mbi shtrirjen e infrastrukturës së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e Bashkisë[452].
- Venddepozitimi në fshatin jug të qytetit, duke u pozicionuar shumë pranë bregut të Lumit Shkumbin, e ka kthyer një një vatër të nxehtë mjedisore të gjithë zonën pranë varrezave të qytetit. Shpeshtitë e prurjeve maksimale të lumit kanë përmbytur një pjesë të tokës, e cila më ka shërbyer si venddepozitim. Përpara ndërhyrjes, venddepozitimi pati marrë shtrirje sa gjatësore aq edhe vertikale përgjatë bregut. Problematikë emergjente paraqitet situata mbi:
  a) Emetimet e gazërave CH_4 në atmosferë, NO, NH_4 si dhe dioksinat nga djeget e ndryshme.
  b) Shkarkimet e mbetjeve të ngurta mbi rrjedhën e lumit Shkumbin
  c) Infiltrimi i shllameve nga dekompozimi mbetejve në akuiferin e Elbasanit.
  d) Depozitimi i mbetjeve inerte anës brigjeve të Lumit Shkumbin dhe përroit të Zaranikës si edhe në disa pjesë të argjinaturave nuk ofron një zgjidhje teknikisht të qëndrueshme dhe afatgjatë. Nevojitet një plan për menaxhimin e këtyre mbetjeve dhe mbi të gjitha një pikë grumbullimi e miratuar nga Bashkia.
- Mbetjet e klasifikuara si të rrezikshme (kryesisht spitalore & industriale) administrohen nga subjekte private në varësi të kushteve kontraktuale, monitorimi i këtyre kontratave në terren paraqet mangësi pasi janë identifikuar shkarkime industriale në zonën e Metalurgjikut, Mjekësit etj.
- Skema të ndryshme të 3R (Reduktim – Riciklim – Ripërdorim) shihen pjesërisht të zbatuara në Bashkinë Elbasan, ku vetë subjekti që ofron shërbimin e menaxhimit të mbetjeve operon edhe me riciklimin e plastikës. Po ashtu, faktor në procesin e ndarjes së mbetjeve mbetet komuniteti Rom & Egjiptian në Elbasan. Fushata dhe projekte pilot në fushën e reduktimit dhe ripërdorimit janë të pakta ndaj edhe familjarizimi i popullatës me këto teknika është i ulët. Këtu veçojmë mbetjet organike të prodhuara nga bujqësia, të cilat me anë të skemave të kompostimit mund të prodhojnë pleh aktiv, i cili të ripërdoret sërish në bujqësi.
- Projekti për ndërtimin e Landfillit rajonal në Bashkinë Elbasan paraqet një inisiativë pozitive për menaxhimin e mbetjeve në tërësi. Duke qënë i pozicionuar pranë brigjeve të Lumit Shkumbin dhe krahas masave paraprake të marra për mbrojtjen mjedisore nga impaktet që do të ketë ky impjant nevojitet që monitorimi mbi të të jetë i shpeshtë.

- Zonat me nivel të lartë ndotje, sidomos industriale, pranë qytetit të Elbasanit përbëjnë një problem serioz për mjedisin dhe shëndetin publik të banorëve. Mbetjet e trashëguara në këto zona duhet të jenë pjesë e skemës së re që duhet të adoptojë bashkia e Elbasan për menaxhimin e integruar të mbetjeve.
- Shërbimi i grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane nevojitet të shtrihet në të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan.
- Përsa i përket rezervuarëve problemeatikën kryesore e përbëjnë Rezervuarët e Shtërmenit dhe të Balëzës. Rezervuari i Balëzës është totalisht jashtë funksioni ndërsa Rezervuari i Shtërmenit ka të dëmtuar në mënyrë të pjesshëm trupin e digës.
- Në aspektin e mbrojtjes së tokave bujqësore në Bashkinë Elbasan kemi probleme të përmbytjeve të përmasave të vogla në zonat e tokave përgjatë Lumit Shkumbin
- Rrjeti i kanaleve kulluese dhe vaditëse ka nevojë për rehabilitim dhe pastrim total në masën ne 14.3% të rrejtit duke qenë se është i bllokuar dhe në 42.2 % të tij ka nevojë për rehabilitim të pjeshëm.
- Analiza e përdorimit të tokës evidenton përdorimin kryesor të tokës, që është kategoria natyrore dhe zë përafërsisht 72% të territorit. Toka bujqësore zë sipërfaqe të konsiderueshme duke u renditur e dyta me 21%. Por në territorin e Elbasanit janë shumë të pranishme edhe përdorimet konfliktuale siç janë banim-industri, pranë zonës së metalurgjikut, pranë Fabrikës së Çimentos apo pranë ish Fabrikës së Drurit. Konflikte të tjera janë ndërmjet kategorive bujqësi dhe industri, siç ndodhin në fushën e Elbasanit, ku vendoset metalurgjiku dhe fabrika të tjera.
- Vendbanimet përgjatë akseve kryesore interurbane Peqin-Elbasan dhe Elbasan-Cërrik. Qendra si Papër, Bradashesh, Shirgjan, Gjergjan, Labinot-Fushë, por edhe shumë fshatra të tjerë të shtrirë midis tyre, si Ullishtë, Vidhas, Mjekës, Kuqan, etj, lidhen në mënyrë lineare me njëra-tjetrën dhe shtrihen në pozicion të favorshëm për zgjerim urban dhe gjenden të rrethuar nga tokë bujqësore. Hierarkia e fshatrave përveç varësisë ndaj Elbasanit përcaktohet edhe nga Lumi Shkumbin. Krahas qendrës Elbasan, këto vendbanime janë mjaft të dendura dhe përbëjnë sfidë për zhvillim të qëndrueshëm hapësinor, për shmangien e shpërhapjes urbane.
- Vendbanimet e tjera rurale janë përgjithësisht më pak të dendura. Kryesisht ato shtrihen në mënyrë lineare, përgjatë shtretërve të përrenjve që derdhen në lumin Shkumbin. Dallohen disa grupime të njëpasnjëshme vendbanimesh, si Papër-Pajun-Papër Sallak, Fikas-Petresh-Gracen, Kusarth-Karakullak-Letan-Funarë-Mollagjesh, Sericë-Labinot Mal, Shirgjan-Bathës-Tregan,Hajdaraj-Mlizë-Shelçan-Lleshan-Derstilë-Gjinar-Pashtresh-Zavalinë, etj. Në këto tipologji dallohet një periferialitet i dukshëm i vendbanimeve që ndodhen në skaje, si Mollagjesh, Zavalinë, Tërbaç, etj, për të cilat duhet trajtuar me kujdes çështja e aksesueshmërisë. Aksi Bradashesh-Gracen përbën një rast më specific, për shkak të rëndësisë rajonale të lidhjes së dikurshme me Tiranën. Si e tillë, është e nevojshme të krijohen qendërsi të reja dhe mënyra alternative lidhjeje të vendbanimeve me territoret e tjera të Bashkisë, në kushtet e mungesës së qarkullimit të shpeshtë tranzit në këtë aks.

- Tipologji e veçantë lineare janë vendbanimet e shtrira përgjatë autostradës Tiranë-Elbasan, si Shijon, Reçan, Shtemaj, etj. Këto fshatra kanë dendësi të ulët, por presion të lartë rritjeje si rezultat i ndikimit të infrastrukturës rajonale.
- Shushicën dhe Labinot Fushën kanë formë lineare të degëzuar, me qendra respektive të shtrira në aksin kryesor Peqin-Librazhd dhe Belsh-Librazhd, të lidhura gjithashtu me njëra tjetrën nëpërmjet fshatit Polis i Vogël (Librazhd). Pavarësisht se ato nuk komunikojnë me një numër të madh vendbanimesh të tjera, kanë rëndësi për pozicionin e aksesueshëm dhe relievin fushor-kodrinor që përcakton zhvillimin hapësinor të tyre.
- Tipologjitë për lidhjen e vendbanimeve me njëra-tjetrën j brenda të njëjtit fshat janë: a) Tipologjia qendrore (e përhapur në zona me presion më të pakët zhvillimi, si dhe zona me rrjet rrugor kuadratik dhe strukturë të konsoliduar); b) Tipologjia Salteitore (i përhapur në 24% të vendbanimeve rurale, dallohet në zona ku kushtëzimet e terrenit nuk lejojnë që vendbanimet e një fshati të zhvillohen në mënyrë të vazhduar; c)Tipologjia Nukleare (këto dy mënyra zhvillimi hapësinor janë më pak efiçentet sa i takon shfrytëzimit të territorit, sepse zënë territor të gjerë dhe nuk kanë lidhje të mirë mes vendbanimeve); d) Tipologjia qendrore e shpërhapur (1/3 e fshatrave kanë një qendër dominuese, dhe shumë zona banimi të shpërndara pa rregullsi ose hierarki të veçantë në territor); e) Tipologjia e shëprhapur;
- Nga pikëpamja ndërtimore, tipologjitë më të përhapura në Bashkinë Elbasan janë vilat me densitet të ulët, të cilat zënë rreth 30 % të territorit të ndërtuar. Kjo dëshmon për karakterin rural dhe periferial të bashkisë, ku pjesa më e madhe e vendbanimeve janë të shpërhapura në territor, e realizojnë dendësi të ulëta. Mjaft të përhapura janë edhe zonat me vila me densitet të mesëm, ku banesat individuale janë të tipit dupleks, ose banesë individuale 2-3 katëshe. Këto zona dallohen kryesisht në qendrat e njësive administrative, si dhe në sistemin e vendbanimeve të shtrira në terren fushor.
- Në nivel qyteti miksimi i tipologjive është shumë i theksuar, duke kaluar nga zona qendrore me predominancë ndërtesash gjatësore, të miksuara me kulla dhe vila, në zona me ndërtesa gjatësore me strukturë të planifikuar, homogjene, e deri në periferinë me ndërthurrje zonash vilash të densitetit të lartë e të mesëm me zona industrial
- Referuar zhvillimeve të deritanishme, rritja e mundshme e qytetit mund të kryhet duke zënë territorin bujqësor që ndodhet në pjesën lindore jugore të qytetit, si dhe në mënyrë lineare drejt zonave të Bradasheshit e Labinot Fushës. Densifikimi i zonave ekzistuese periferike është i vështirë, për shkak të sistemit të tyre urban relativisht të rregullt e të konsoliduar, dhe densitetit të lartë të banimit.

2. Plani i Zhvillimit të Territorit

2.1 Plani i Propozimeve Territoriale

2.1.1 Thellimi i vizionit territorial të zhvillimit


- **Vizioni**

Vizioni i zhvillimit të territorit për Bashkinë e Elbasanit është hartuar në mënyrë organike, si rezultat i gjetjeve të analizës së përgjithshme të territorit, diskutimeve me qytetarët, takimeve me grupe interesi dhe reflektimeve të grupit të punës gjatë studimit të kontekstit rajonal në të cilin ndodhet bashkia si dhe gjatë hartimit të konceptit rajonal të zhvillimit. Po ashtu, vizioni i Elbasanit bazohet në parashikimet e Planit të Përgjithshëm Kombëtar të territorit, sipas prezantimeve publike të realizuara nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit në dhjetor 2015. Mbi këto baza, pjesëmarrësit në diskutimet lokale, nën drejtimin e grupit të punës, kanë rënë dakord për vizionin strategjik, që do të udhëheqë zhvillimin e Bashkisë së Elbasanit gjatë 15 viteve të ardhshme, të formuluar si më poshtë:

Elbasani një qendër shumë-funksionale përgjatë Korridorit VIII dhe rrugës Egnatia, qytet me qëndrueshmëri të lartë në zhvillim ekonomik dhe social, duke ruajtur e rigjeneruar vlerat mjedisore të zonës dhe rajonit. Elbasani është një nyje e rëndësishme lidhëse ekonomike dhe infrastrukturore në rajon, në të cilën harmonizohen zhvillimi bujqësor e blegtoral dhe [eko]turistik me atë hapësinor dhe industrial. Elbasani e ndërton të ardhmen e tij dhe garanton zhvillimin e qëndrueshëm duke u mbështetur në një qeverisje të udhëhequr nga njerëzit dhe për njerëzit. Zhvillimi i territorit, urbanizimi i kontrolluar, krijimi dhe shfrytëzimi i drejtë i hapësirave publike stimulojnë një klimë të shëndetshme biznesi e konkurrence të pastër, në favor të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm. Mbrojtja dhe përdorimit efektiv i tokës [urbane dhe rurale], respektimi i mjedisit, kulturës, trashëgimisë natyrore dhe identitetit historik, janë baza për një jetesë të shëndetshme dhe aktive dhe mundësi të reja punësimi. Përmes qeverisjes së mirë dhe transparente, bashkia krijon kushte për integrim dhe ndërveprim social, duke nxitur socializimin dhe harmoninë e komunitetit për të mirën e përbashkët.


Bazuar në vizionin për zhvillimin e ardhshëm të Elbasanit, informacionit të analizuar në kapitujt paraardhës dhe prioriteteve të administratës publike dhe banorëve, janë përcaktuar objektivat strategjike të zhvillimit të territorit të bashkisë.

Figura 192. Harta e vizionit, Bashkia Elbasan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015


Figura 193. Harta e identiteteve të venbanimeve në Bashkinë Elbasan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

- **Fashat dhe qendërsitë**

Figura 194. Fashat dhe qendërsit




Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2015

Fashat janë shumatore të njësive strukturore të territorit. Në territorin e Bashkisë Elbasan lexohen në mënyrë mjaft të dukshme fashat lumore të cilat kanë një rol përcaktes në formimin e karakterit të këtij qytetit, fashat ekonomike përgjatë akseve kryesore lidhëse dhe qendërsitë e rëndësishme ekonomike siç është ish-Kombinati Metalurgjik. Elbasani nuk mund të kuptohet pa lumin Shkumbin, i cili shtrihet në pjesën jugore të qytetit, lumin Zaranikë dhe Manazdere të cilët mbështjellin qytetin në pjesën perëndimore dhe lindore.

Fasha e lumit Shkumbin
Fasha e lumit Zaranikë
Fasha e lumit Manazdere
Fasha e lumit Papër
Fasha e lumit Gostimë
Fasha e lumit Gostrimë
Qendërsia e Metalurgjikut
Qendërsia e Byshekut
Qendërsia e ish-Kombinatit të Drurit

- **Transformimet madhore në territorin e Bashkisë Elbasan**

Figura 195. Transformimet madhore në Bashkinë Elbasan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Këto transformime madhore përkojnë me projektet më prioritare të zhvillimit të bashkisë. Ato janë thelbi i suksesit të zbatimit të Planit. Janë ndërhyrje gjeneratore e katalitike që kanë aftësi transformuese zinxhir. Pra realizimi i tyre mundëson që kapitali njerëzor dhe financiar të grumbullohet vetiu rreth këtyre transformimeve e t`u japë jetë transformimeve të reja pozitive. Transformimet që paraqiten në hartën mësipër, janë listuar e shpjeguar më poshtë dhe në raste të caktuara jepen edhe ilustrime që tregojnë se çfarë nënkupton transformimi.

a) Zgjerimi i qendrës së qytetit drejt stadiumit: Qendra e qytetit do të jetë një atraksion për banorët dhe vizitorët e Elbasanit, përveçse si hapësirë shërbimesh dhe për funksione të tjera. Vlerat historike, kulturore dhe aktivitetet shumë-funksionale që do të ofrohen në këtë zonë, do të përmirësojnë zhvillimin e mëtejshëm të qytetit. Në zonën e qendrës do të rehabilitohen dhe shtohen hapësirat publike, në funksion të qytetarëve. Funksionet e propozuara do jenë të përziera – banim, shërbime, gjelbërim dhe zonë pushimi, qendër kulturore, teatër, stadium, zona historike, mjedise me funksion arsimor etj. për të ofruar larmi dhe për të fuqizuar polin qendror të Elbasanit. Këto zhvillime bazohen në planin aktual të qendrës dhe në rishikime që mund të parashikojë bashkia në nivel dizajni.

Figura 196. Trajtimi i zonës së qendrës



Burimi: Bashkia Elbasan, Co-PLAN dhe Michiel Van Driessche, 2016

b) Ripërtëritja e mushkërive të Elbasanit:

Krijimi i Parqeve Rajonale/Periferike (Bysheku, Liqenet e Funarës, Liqenet e Treganit, Gjinar, Zavalinë): Më shumë se 70% e territorit të Bashkisë Elbasan është hapësirë

natyrore dhe kjo tregon për potencialin që ka Elbasani për zhvillimin e turizmit kodrinor/malor. Skajet e bashkisë janë zonat peizazhistike me natyrë të mrekullueshme, të cilat mund të kthehen në parqe rajonale dhe të shërbejnë si zona rekreative për popullsinë e Elbasanit dhe jo vetëm. Këto zona mund të shfrytëzohen si hapësira publike me funksion ditor, ose për të kaluar fundjavat larg zonës së urbanizuar dhe pranë natyrës. Ripërtëritja e këtyre zonave ndikon në përmirësimin e cilësisë së ajrit duke ofruar një mjedis sa më të shëndetshëm për banorët.

Parku 'Rinia': Kjo zonë aktualisht është një hapësirë e gjelbër në qytet, por nuk ofron asnjë aktivitet përveç pushimit. Aktualisht, parku frekuentohet kryesisht nga të moshuarit ose prindërit me fëmijë të vegjël. Kthimi i kësaj zonë në hapësirë rekreative me larmi funksionesh për qytetin është e rëndësishme dhe shumë e nevojshme. Duke qenë se kërkesat e popullsisë për të jetuar në qytet kanë ardhur gjithmonë në rritje, vëmendja është fokusuar në krijimin e zonave të reja banimi, duke lënë jashtë vëmendjes hapësirat e përbashkëta e publike, si dhe rëndësinë që kanë ato për banorët. Pozicioni qendror i Parkut Rinia bën që kjo zonë të ketë akses shumë të mirë dhe të krijojë lehtësi për t'u frekuentuar nga banorët. Ofrimi i shërbimeve të tjera si: kënd lorash për agëtimin e fëmijëve, sipërfaqe ujore që mund të shërbejnë për t'u freskuar në periudhën e nxehtë të verës, korsi biçikletash, zona "ishullore", ku mund të lexohet në natyrë nga grupmosha të ndryshme etj. do ta transformonte parkun në një pikë gjeneratore, të frekuentuar nga banorët dhe që mund të ndikojë pozitivisht në rritjen e vlerës së tokës në zonat përreth tij. Është e nevojshme që në park të shtohen bimët autoktone të Elbasanit, ose bimë të përshtatura prej një kohe shumë të gjatë, si elemente edukative, me vlerë mjedisore dhe promovuese të kulturës vendase.

*Parku natyror i Krastës: (*aktivitete kulturore, panaire, aktivitete sportive dhe shëtitje). Parku i Krastës ka një sipërfaqe prej 170 ha dhe ndodhet buzë lumit Shkumbin. Aktualisht, kjo zonë e gjelbëruar me pisha shfrytëzohet shumë pak si hapësirë rekreative për banorët. Transformimi i Krastës së Madhe në park nënkupton ruajten e karakterit natyror dhe të të gjithë bimësisë së kodrës, por edhe ofrimin e lehtësirave në përdorimin e hapësirës së saj. Fillimisht, zonat në të cilat janë dëmtuar pemët duhet të ripyllëzohen për të shmangur erozionin dhe për të rritur cilësitë e parkut. Aksesi në park duhet të realizohet përmes shtigjeve për këmbësorë e biçikleta. Këto shtigje nuk duhet të koracohen me beton apo asfalt, por të sheshohen me materiale rrethanore, ranore e zhavorr, që lejojnë infiltrimin e ujërave në tokë dhe mbi të gjitha nuk dëmtojnë vegjetacionin. Duhet të përcaktohen zona për piknik, të pajisura me tavolina të vogla druri dhe hapësira fikse për *barbeque*, në mënyrë të tillë që të mos rrezikohet pylli nga vënia e zjarrit. Në hyrje të parkut, por jo brenda hapësirës së tij pyjore, mund të vendosen objekte të përkohshme me funksion ambulator për pije dhe ushqime të shpejta, apo suvenire me tematikën e parkut dhe të qytetit. Në çdo rast, bashkia duhet të hartojë një plan peizazhistik për parkun, në të cilin të parashikojë edhe vendosjen e shenjave të orientimit të ecjes në park, elemente sigurie në faqet e pjerrëta etj.

Parku tematik në zonën ushtarake rrëzë Krastës: Aktualisht, në këtë zonë janë vendosur objekte me funksione banimi, ushtarake apo aktivitete të ndryshme ekonomike, të cilat janë të papërshtatshme për t'u zhvilluar pranë kësaj zone. Rrëzë Krastës, ndodhen objekte me funksione ish-ushtarake, por aktualisht të papërdorshme, të cilat mund të përdoren për të krijuar hapësirë me aktivitete kulturore, sportive apo panaire që do të organizohen në periudha të ndryshme të vitit. Kthimi i kësaj zone në hapësirë publike me aktivitete të


ndryshme kulturore dhe panaire me tema të ndryshme në periudha të ndryshme të vitit e plotëson zonën periferike me aktivitete përtej atij të banimit, rrit interesin për kulturën dhe historinë, dhe vjen në përputhshmëri me parkun natyror të Krastës që ndodhet në kufit të parkut tematik.

Krijimi i lagjes-kopësht me bujtina (agrobiznese, bujqësi dhe ferma urbane ku aktiviteti bujqësor kombinohet me atë rekreativ, shërbime ushqimi dhe banim në zonën fushore poshtë Krastës.) Gjatë lëvizjes nga qyteti drejt Kodrës së Krastës, kalohet nga një karakter shumë urban në karakter disi më rural dhe natyror. Kjo lexohet nga objektet e tipit banesa individuale 1-3 katëshe me oborr, toka bujqësore të kultivuara dhe zonat natyrore në afërsi të lumit Shkumbin e kodrës së Krastës. Aktualisht, lagjia ofron vetëm banim, por mund të promovohet si një zonë ku lejohen agrobizneset e vogla dhe jo invazive ndaj tokës bujqësore apo hapësirave natyrore të mbetura në zonë. Kjo do të ndihmojë që intensitetet të mos jenë të larta në zonë, ndërkohë që banorët mund ta shfrytëzojnë këtë potencial për funksione ekonomike bujqësore.

Parku i Shkumbinit dhe ballina ujore: Lumi Shkumbin është element i rëndësishëm natyror dhe lidhet ngushtë me zhvillimin e qytetit të Elbasanit. Shkumbini është reflektimi i akuiferit të Elbasanit në sipërfaqe dhe, përgjatë qytetit, ai arrin një nga gjerësitë me të mëdha të shtratit, duke qenë nga lumenjtë më të gjerë në një zonë urbane. Për një kohë shumë të gjatë trajtimi mjedisor dhe urban i tij ka munguar. Aktualisht qyteti i ka kthyer kurrizin lumit dhe të dy funksionojnë të shkëputur. Madje, deri më tani, lumi është konsideruar si një vend për shkarkimin e ujrave të ndotura, për ndërtime informale afër ose në brigje, për kultivimin e produkteve bujqësore në atë që duhej të ishte zona ripariane e tij etj. Megjithatë, Shkumbini përbën një potencial të jashtëzakonshëm për zhvillimin e qytetit drejt jugut. Ristrukturimi dhe rehabilitimi i hapësirës së tij përgjatë qytetit ka disa vlera: së pari, lumi i rikthehet qytetit dhe kemi një integrim hapësinor teksa lëvizim nga qendra drejt periferisë jugore; së dyti, krijohen zona të reja me interes për zhvillim në të dyja anët e parkut të Shkumbinit, duke ulur kështu presionin e ndërtimit në kodrat e ullishtave në veri të qytetit; së treti, trajtimi i hapësirës së Shkumbinit mundëson lidhjen natyrore e organike të qytetit me Byshekun dhe Shushicën; po ashtu rehabilitimi i brigjeve dhe zonës ripariane si pjesë e parkut, forcon mbrojtjen e tokave bujqësore apo ndërtimeve përgjatë lumit nga vërshimet, përmbytjet dhe erozioni lumor.

Figura 197. Trajtimi i Parkut përgjatë lumit Shkumbin







Burimi: Bashkia Elbasan, Co-PLAN dhe Michiel Van Driessche, 2016

Realizimi i projektit të parkut të Krastës duhet të paraprihet nga studimi gjeologo-inxhinierik për të gjithë hapësirën që do të transformohet. Studimet aktuale të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar tregojnë se shtrati i Shkumbinit përgjatë Elbasanit shtrihet në dhera me kohezion, më konkretisht në suargjila mbi zhavorre aluviale, me trashësi 2-8 metra. Po sipas SHGJSH-së, e gjithë lugina lumore, përfshirë qytetin e Elbasanit, nuk paraqet fenomene të rrezikut gjeologjik, edhe pse qyteti është ndërtuar mbi shkëmbinj të butë. Aty ku gjithsesi mund të shfaqen rreziqe dhe duhet të merren masa paraprake, janë brigjet e lumit dhe rreziku në këtë rast lidhet me vërshimet, aluvionet dhe me mungesën e zonës riparine, bimësia e së cilës do të pengonte shembjen e brigjeve apo përmbytjen e tokave bujqësore.

Kthimi i Shkumbinit në park periferik lumor përfshin disa komponentë të rëndësishëm: përcaktimin e brigjeve sipas legjislacionit dhe përputhjen e tyre me zonën ripariane. Zona ripariane do të përbëhet nga bimësi në kate, e ulët afër ujit dhe e lartë në drejtim të tokës, dhe funksionet e saj janë: krijimi i hapësirës së gjelbër dhe peizazhit estetik natyror; mbërthimi i kimikateve ndotëse që vinë nga tokat bujqësore apo aktiviteti urban dhe që rrezikojnë të kalojnë në ujërat nëntokësore apo të përçohen nga lumi drejt detit; mbrojtja e brigjeve nga erozioni e përmbytjet; përmirësimi i infiltrimit të ujit dhe rritja e efektit filtrues të sipërfaqes së tokës. Përgjatë zonës ripariane do të krijohet korridori i gjelbër i parkut, traseja e të cilit në momente të caktuara depërton në lagjet e banimit në kufi të parkut për shkak të distancave dhe në pjesë të tjera ndodhet brenda territorit të parkut. Korridori i gjelbër shërben për shtigje ecjeje dhe biçikletash si edhe për emergjenca apo shërbime në funksion të hapësirave të vogla tematike e rekreative brenda parkut. Nëse pjesa ripariane

është ajo natyrore e parkut, pjesa tjetër ka karakter të pushimit aktiv, me hapësira sportive, kënde lojrash për fëmijë, kënde tematike etj.

Gjithashtu, si pjesë e konceptit për parkun e Shkumbinit është edhe transformimi i korridoreve lumore të Manazderes dhe Zaranikës në korridore të gjelbra dhe të integruara me Shkumbinin, ku ato derdhen. Një element i propozuar, edhe pse një ndërhyrje afatgjatë, është krijimi i vijës ujore mes për mes qytetit dhe përpara kalasë në bulevardin Qemal Stafa, nga Manazderja deri tek Zaranika. Kjo vijë ujore është rikthim i një elementi historik urbanistik dhe natyror në qytet dhe në të njëjtën kohë ndihmon sistemin ujor të riintegrohet brenda vetes, duke ndihmuar prurjet që të balancojnë njëra-tjetrën. Sigurisht, si pjesë e konceptit është edhe sistemimi i shtretërve të Manazderes dhe Zaranikës me metoda të "buta" dhe pjesërisht inxhinierike, me qëllim shmangien e rrezikut nga përmbytjet si edhe krijimin e nje hapësire publike cilësore e në përdorim të qytetarëve.

Për këtë qëllim, për Manazderen propozohet sistemimi përmes rikthimit të zonës ripariane dhe brigjeve të gjelbra, shoqëruar me pastrimin dhe mirëmbajtjen e shtratit. Për Zaranikën propozohet sistemimi i shtratit me gabione, për të cilat duhet të përzgjidhen gurë të madhësisë së përshtatshme dhe themelet duhet të garantojnë qëndrueshmërinë e shtratit në raste prurjesh të larta dhe përmbytje. Shtrati do të jetë i shkallëzuar për të ulur shpejtësinë e ujit dhe gabionet do të jenë, jo vetëm në shtrat, por edhe në brigje. Në vijim të gabioneve do të krijohet një zonë ripariane e cila ka për synim, jo vetëm të rritë cilësinë pamore të lumit, por edhe të lidhë ndërhyrjen infrastrukturore me shtratin dhe brigjet natyrore. Rekomandimi për të larguar koracimin me beton, sikurse aktualisht është Zaranika, bazohet në: i) estetikën e dobët të lumit si hapësirë publike në zonë urbane; ii) ndikimin e theksuar të betonit si sipërfaqe e papërshkueshme e me infiltrim zero në rritjen e madhe të shpejtësisë së ujërave në raste të prurjeve të larta; iii) dëmtimin që pëson sipërfaqja e betoni dhe koston e lartë e mirëmbajtjes; iv) rolin ndarës që aktualisht luan Zaranika në strukturën urbane të qytetit, ndërkohë që duhet të shërbejë si një korridor integrues; v) fragmentimin që i bën aktualisht Zaranika ekosistemit natyror prej nga vjen dhe Shkumbinit në të cilin ajo derdhet. Në çdo rast, theksojmë se çdo projekt që do të realizohet për ristrukturimin inxhinierik dhe rehabilitimin mjedisor të Zaranikës, duhet të paraprihet nga një studim i hollësishëm gjeologo-inxhinierik dhe i kushteve hidrogjeologjike, mbi bazën e të cilave do të përcaktohet metoda përfundimtare e ndërhyrjes në shtratin dhe brigjet e lumit.

Transformimi i kësaj zonë dhe kthimi në park është një ndërhyrje madhore dhe me ndikim të lartë në cilësinë e territorit të bashkisë. Kostoja për realizimin e saj është gjithashtu e lartë dhe për këtë qëllim bashkia mund të punojë në faza zbatimi, për sa kohë që projekti transformues dhe PDV-ja sipas rastit, realizohen të plota që në fillim. Kjo hapësirë publike duhet përdorur si katalizator për zhvillimet e propozuara, jo thjesht pranë lumit, por në të gjithë pjesën jugore të bashkisë dhe pas urës së Cërrikut.

c) Ndërtimi i infrastrukturave rrugore të rëndësishme rajonale dhe vendore:

Korridori VIII /bypass i qytetit të Elbasanit: Ndërtimi i kësaj infrastrukture rrugore është shumë i rëndësishëm për mënyrën se si do të zhvillohet në të ardhmen territori e bashkisë. Gjurma e Korridorit VIII është një element i fortë në formimin e karakterit të Elbasanit. Aktualisht, në Elbasan ai përfaqësohet nga rruga që vjen prej Peqinit, kalon në Papër dhe Bradashesh e më pas në Elbasan, drejt Librazhdit. Korridori nuk ka parametrat e një autostrade, por do të jetë i tillë në të ardhmen. Si pjesë e rëndësishme e këtij korridori, në

Elbasan propozohet të ndërtohet *bypass-i*, i cili kalon në pjesën jugore të qytetit. *Bypass*-i fillon në Bradashesh, në fshatin Katund i Ri, zbret në jug dhe kalon Shkumbinin deri në Shirgjan, më pas në njësinë Shushicë afër fshatit Hajdaran, por larg vendbanimeve dhe më pas gjatë Shkumbinit deri sa del në Labinot Fushë. Daljet janë në dy opsione, përkatësisht afër fshatit Labinot Fushë dhe Urës së Polisit, ose në jug të fshatit Labinot Fushë, por brenda territorit të njësisë administrative. Përzgjedhja do të bëhet në momentin e realizimit të kësaj infrastrukture më rëndësi kombëtare, mbi bazën e projektit final, kostove, qëndrueshmërisë, fizibilitetit dhe impaktit më të vogël mjedisor. *Bypass*-i forcon Korridon VIII, rrit shpejtësinë e lëvizjes drejt lindjes dhe në të njëjtën kohë largon trafikun nga qyteti.

Ndërtimi i Boshtit Qendror të Jugut: Boshti Qendror Jugor është infrastrukturë e rëndësishme kombëtare dhe kalon në afërsi të Paprit, në jug-perëndim të territorit të bashkisë, në kufi me Cërrikun. Gjurma lidhet me Korridon VIII, por nuk është tërësisht e saktë, pasi është një infrastrukturë afatgjatë edhe në prioritetet e qeverisë. Kjo gjurmë do të saktësohet nga autoritetet qendrore të rrugëve dhe të planifikimit në momentin e angazhimit të qeverisë për ndërtimin e saj. Ekzistenca e këtij korridori në Elbasan është me vlerë për aksesueshmërinë e tij dhe lidhjet rajonale e kombëtare. Elbasani, siç mund të shihet qartë edhe në ndëryrjet infrstrukturore që do të ndodhin, është nyje e rëndësishme për kryqëzimin e rrugëve me rëndësi kombëtare. Boshti i jugut do të krijojë një lidhje të afërt me pjesën jug-perëndimore të vendit dhe do të ketë ndikim të rëndësishëm edhe nga ana ekonomike në zonave në të cilat kalon.

Ndërtimi i unazës veriore dhe veri-lindore të qytetit: Unaza aktualisht është ndërtuar vetëm në pjesën jug-perëndimore dhe jugore të qytetit të Elbasanit. Plotësimi i kësaj rruge do të përmirësojë lëvishmërinë dhe do të ndikojë në integrimin e zonave informale në pjesën veri-lindore të qytetit, të cilat deri tani kanë patur një akses të dobët. Gjithashtu ndërtimi i unazës do të shmangë shkarkimin e trafikut në pjesën qendrore të qytetit, në mënyrë që zona qendrore të mund të shfrytëzohet maksimalisht për aktivitete të tjera. Plotësimi i unazës vjen në përputhje edhe me sistemin aktual rrugor, që në pjesën jugore të bashkisë është radial unazor dhe në pjesën veriore është në formën e rrjetit, dhe ngjason më tepër me atë kuadratik. Po ashtu, plotësimi i unazës zgjidh edhe çështjet e transportit urban në bashki.

Ndërtimi i një stacioni multimodal: Elbasani nuk ka një zonë ekskluzive të rezervuar vetëm për stacionimin dhe shpërndarjen e transportit publik. Momentalisht stacionet e qëndrimit të autobusëve janë të shpërndarë nëpër qytet. Stacioni i trenit është kthyer në një zonë të degraduar me objekte gjysëm të shembura, pavarësisht se linja hekurudhore vazhdon të jetë funksionale. Për të krijuar një zonë të dedikuar për transportin, mendohet që në Elbasan të ndërtohet një stacion multimodal, i cili do të ofrojë transport të kombinuar për të lidhur zonat e bashkisë me njëra tjetrën dhe bashkinë Elbasan me bashkitë fqinje. Stacioni multimodal do të jetë një lehtësi për të aksesuar edhe zonat turistike në bashki, duke krijuar lehtësira për të udhëtuar drejt destinacioneve të ndryshme. Stacioni propozohet të ndodhet në fushën e Bradasheshit, në veriperëndim të saj dhe në afërsi të përroit të Kushes.

Rehabilitimi/ krijimi i rrugëve rurale me vlera peizazhistike: Ashtu siç është përmendur disa herë edhe në analizën e thelluar të infrastrukturës, lidhja e qyteti me zonat ruale është pjesërisht e mirë (zonat që kanë terren fushor/kodrinor) dhe lidhja bëhet shumë e vështirë, ose thuajse e pamundur në zonën malore, që mbart edhe vlera peizazhisike. Që këto zona të mund të shfrytëzohen për *hiking* (ecje në natyrë), piknik apo për vëzhgim dhe çlodhje,

planifikohen lidhjet përkatëse infrastrukturore. Disa prej këtyre itinerareve, që kanë edhe peizazh natyror të zhvilluar përgjatë tyre, do të pajisen edhe me korsi biçikletash, ose përdoren edhe për këtë qëllim.

ç) Ndërtimi i pikave të transferimit të mbetjeve urbane: Ndërtimi i *landfill*-it do të mundësojë depozitimin e mbetjeve rajonale dhe të zonave të banuara të Elbasanit. Distanca e largët që kanë disa nga njësitë administrative të Elbasanit me *landfill*-in nuk favorizon transportimin ditor të mbetjeve në të, ndaj do të ndërtohen disa stacione transferimi, që do të shërbejnë për grumbullimin paraprak të mbetjeve në to, para se të transportohen në *landfill*. Këto stacione tranferimi janë propozuar të ndërtohen në NjA-në Labinot Fushë, pranë fshatit Griqan, në Gjinar dhe në Tregan.

d) Krijimi i zonave të shërbimeve dhe zonave ekonomike


Gjergjan-Shirgjan-Cërrik si një zonë ekonomike shërbimesh: Aktualisht, ky segment ka tendenca të vendosjes së shëbimeve që mbështesin sektorin bujqësor. Konsolidimi i mëtejshëm i karakterit, që ka filluar të ketë ky segment, do vazhdojë me qëllim përmirësimin e sektorit ekonomik bujqësor. Industritë e përpunimit të ushqimeve, paketimit, tregtimit me pakicë e shumicë etj. mund të vendosen dhe të operojnë përgjatë kësaj rruge, duke qenë se e gjithe kjo zonë ka karakter bujqësor.

Rehabilitim mjedisor dhe rikonceptim i zonës së ish-Metalurgjikut: Metalurgjiku është një njollë e fortë në territor, e cila ka ndikuar në ndërtimin e qyteti të Elbasanit dhe në historinë e tij pas viteve `70-të. Sot, përtej aktivitetit ekonomik që ka, ndotjet që shkakton janë shumë të larta. Ai mbart gjithashtu ndotje të trashëguara mjedisore. Rehabilitimi i kësaj zone është nevojë urgjente për banorët dhe për zhvillimin e mëtejshëm të Elbasanit. Ashtu siç ka ndodhur edhe me industri të tjera në vende të ndryshme, duhet që kjo zonë të ndryshojë karakter dhe të rikonceptohet për funksionet që do të marrë në vazhdim. Këto aktivitete do të konsistojnë në industri përpunuese, ndërtimi, paketimi etj. por që garantojnë zbutjen dhe eleminimin e niveleve ndotëse. Mbi të gjitha, bashkia dhe institucionet qendrore duhet të garantojnë një projekt madhor të pastrimit mjedisor të zonës nga mbetjet e trashëguara. Këto mbetje kërcënojnë vazhdimisht nëntokën, ajrin dhe derdhen në ujërat e Shkumbinit.

Forcimi i karakterit ekonomik të zonës përgjatë rrugës Elbasan-Labinot Fushës: Segmenti i rrugës nga Elbasani në Labinot-Fushë ka karakter ekonomik. Ajo që propozohet është konsolidimi i këtij karakteri. Bashkia mund të hartojë masterplan/plan dizajni urban për formëzimin e mëtejshëm të kësaj zone, duke ruajtur edhe aspektet e karakterit bujqësor që shfaqen në pronësi dhe segmente të caktuara të zonës. Aktivitetet ekonomike duhet të jetë jo-ndotëse për të shmangur çdo mundësi ndotjeje në ujërat e akuiferit dhe të Shkumbinit, si edhe në toka bujqësore përgjatë kësaj zone, apo në territoret urbane të saj. Ura e vjetër e Polisit mund të integrohet në zgjidhjen e masterplanit, si dhe të krijohen kopshte të bujqësisë urbane, fidanishte dhe sera me lule e fruta, në segmente të caktuara që mundësojnë lidhjen me Shkumbinin përmes korridoreve tërthore.

- **Platforma e ndërhyrjeve në territor. Platforma e masave të ndërhyrjeve në territorin e** Bashkisë Elbasan mbështetet në ndërhyrjet e përcaktuara si mëposhtë:

Figura 198. Platforma e ndërhyrjeve në territor



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

a) Rigjenerimi (ripërtëritja) i qendrave të njësive administrative dhe të fshatit Hajdaran: Zonat rurale kanë vetëm funksion banim dhe shërbime në pjesën e qendrës. Por edhe shërbimet kufizohen në shumicën e rasteve me dyqane të vogla ushqimore dhe mungojnë shërbimet e tjera. Kjo bëhet e vështirë për banorët, të cilët duhet të shkojnë në Elbasan për të marrë shërbimet e nevojshme. Rigjenerimi i qendrave të njësive administrative synon që të shtojë shërbimet në qendrat e NjA-ve dhe të ofrojë hapësira publike të gjelbëruara (parqe/lulishte), hapësira për kopshte/shkolla, apo qendra shëndetësore sipas nevojave dhe propozimeve për infrastruktura sociale etj. Në Fshatin Hajdaran propozohet të ndërtohen magazina për përpunimin e produkteve ushqimore. Rigjenerimi i qendrave të NjA-ve do të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së infrastrukturës së rrugëve dhe ndërtesave dhe jetesës së banorëve.

b) Restaurim dhe konservim i zonave historike dhe rikthimi i vlerave të këtyre zonave:

- Zona e mbrojtur e Kalasë së Elbasanit
- Stacioni rrugor Ad Quintum,
- Kisha në Gjinar (Kisha e Shën Premtes) dhe kthimi e saj në një pikë fokale për turizmin malor-kulturor.
- Kalaja në shkëmbin Mbret në fshatin Xibrak,
- Kalaja e Mengelit,
- Kalaja e Valeshit
- Llixhat e Treganit,
- Zona turisitike e Byshekut

c) Rehabilitimi mjedisor i zonave natyrore: Zonat natyrore janë shpeshherë të dëmtuara nga aktiviteti njërëzor, si dëmtim i pyjeve, ndotje e ujrave apo dëme të tjera ekologjike. Përgjatë rrjedhave ujore është propozuar të rehabilitohen ose rikrijohen zonat ripariane dhe në pjesë të caktuara të përdoren hapësirat e gjelbra për aktivitete rekreative, parqe urbane apo parqe rajonale (rastin i Liqenit të Traganit dhe liqenit të Funarës, liqeni në Mjekës dhe në Shushicë). Zona të tjera që kanë nevojë të rehabilitohen dhe të kthehen gradualisht në zona natyrore janë zona e ish-venddepozitimit të mbetjeve të ngurta urbane dhe zona të tjera të ndotura nga depozitimet e mbetjeve industriale. Ujrat e ndotura të qytetit të Elbasanit derdhen në lumin Shkumbin, dhe risistemimi i kanalizimeve do t'i dergojë këto ujëra të ndotura në impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura duke eleminuar ndotjen e mëtejshme të ujërave të lumenjve.
ç) Ristrukturimi i infrastrukturës: Është përmirësuar lidhja e zonave të banuara me njëra-tjetrën, duke ofruar lidhje infrastrukturore në pjesët që mungojnë. Sipas rastit është përmirësuar infrastruktura dhe është propozuar të rehabilitohen segmente të caktuara, për t'i risjellë në gjendje të mirë fizikisht dhe për t'i bërë të aksesueshme. Lidhjet e biçikletave janë propozuar në të gjithë territorin e bashkisë për të promovuar lëvizjen e gjelbër dhe për t'iu krijuar mundësinë vizitorëve të arrijnë zonat turistike dhe peizazhistike të Elbasanit edhe me biçikletë.

d) Konservimi dhe konsolidimi i tokës bujqësore të kultivuar:

- *Kurora e ullishteve në qytetin e Elbasanit:* Shpërhapja e ndërtimeve ka prekur edhe zonën e ullishteve të qytetit të Elbasanit. Në zona të caktuar ka ndodhur dëmtimi i pemëve, duke i prerë ato për të ndërtuar. Ky fenomen do të ndalohet dhe kurora e ullishtës do të mbrohet përmes konsolidimit dhe konservimit të zonës vetëm për bujqësi.
- *Tokat bujqësore që shtrihen përgjatë shtratit të lumit Shkumbin*: Shpeshherë tokat bujqësore shtrihen në/mbi brigjet e lumit, duke eleminuar zonën ripariane të tij, dhe duke u bërë pre e përmbytjeve nga lumi. Në raste të tjera, fenomen në dëm të tokës bujqësore është edhe shpërhapja e ndërtimeve në tokat bujqësore, si për shembull në Shushicë, Shirgjan e Gjergjan. Për të mbrojtur tokën bujqësore janë propozuar ndërhyrje ndërtimore shumë të kufizuara, sipas nivelit të fragmentimit të tokës bujqësore dhe në përputhje me legjislacionin për tokën bujqësore.

dh) Zhvillim intensiv: Do të ndodhë në pjesën e qendrës së qytetit. Për të shmangur shpërhapjet e mëtejshme në zona të papërshtatshme për të ndërtuar, si dhe për të realizuar politika orientimi të zhvillimit të tokës, është propozuar që të intensifikohen zhvillimet në

pjesën e qendrës së qytetit, sipas standardeve dhe treguesve të parashikuar. Disa nga zonat që do të intensifikohen janë: zona pas stadiumit, zonat përgjatë lumenjve të Zaranikës dhe Manazderes (segmentet që janë pjesë e unazës së qytetit) zonat përgjatë pjesës veriore të unazës, e cila në segmente të caktuara është e zhvilluar vetëm më objekte të tipit vilë 2-3 katëshe. Intensifikimi i këtyre zonve nënkupton ofrimin e shërbimeve të nevojshme, rehabilitimin dhe rigjenerimin e hapësirave të gjelbra dhe hapësirave publike.

Në mënyrë të detajuar, ndërhyrjet në territor shfaqen në hartën me kodin **N:01/11**, e cila është përgatitur për çdo njësi strukturore.

- **Objektivat Strategjike, Programet dhe Projektet**

Objektivi Strategjik 1: Zhvillimi i qëndrueshëm **ekonomik**, duke ruajtur **balancat mes sektorëve** të ndryshëm të ekonomisë në territor dhe duke rritur **konkurrencën e larminë** ndërmjet sektorëve aktivë të rajonit për të gjeneruar **punësim** të vazhdueshëm.

Programi strategjik O1P1: Mbështetje me infrastrukturën e nevojshme për përqendrimin e bizneseve të industrisë në zonën e Metalurgjikut.

Projekti_1: Pastrimi i ish-Metalurgjikut nga ndotjet e trashëguara industriale

Projekti_2: Rehabilitimi i zonës dhe kthimi i saj në zonë të përshtatshme për ndërtimin e objekteve me karakter ekonomik.

Programi strategjik O1P2: Nxitje e sipërmarrjes private dhe biznesit për të rivitalizuar me aktivitetin e tyre ish-zonat industriale/ekonomike të Elbasanit në bashkëpunim me bashkinë si negociator kryesor për të rigjeneruar edhe hapësirën publike me anë të instrumentit të menaxhimit të tokës.

Projekti_1: Pastrimi i zonave ish-industriale nga ndotjet e trashëguara.

Programi strategjik O1P3: Intensifikimi i aktivitetit urbanizues brenda qendrave ekzistuese urbane të njësive administrative

Projekti_1: Intensifikimi i qendrës së Elbasanit me banim, shërbime, zona ekonomike dhe hapësira publike.

Projekti_2: Ofrimi i shërbimeve të nevojshme për banorët në qendrat e njësive administrative.

Projekti_3: Përmirësim i fasadave në rrugët kryesore dhe 100 banesave kolektive

Programi strategjik O1P4: Mbështetje, marketim, promovim, përmirësim klime dhe aftësim i biznesit lokal në funksion të zhvillimit të ekonomisë lokale.

Projekti_1: Krijimi i pikave të grumbullimit për produktet bujqësore dhe blegtorale

Programi strategjik O1P5: Rigjenerimi dhe zhvillimi i hapësirave publike në qytetin e Elbasanit dhe qendrat urbane të Njësive Administrative, përmes instrumenteve financiare, dizajnit urban dhe PPP-ve.

Projekti_1: Rigjenerimi i qendrave të njësive administrative, duke risistemuar hapësirat publike dhe ofrimi i shërbimeve të munguara.

Projekti_2: Krijimi i parqeve urbane përgjatë lumit Shkumbin

Projekti_3: Krijimi i parkut tematik rrëzë kodrës së Krastës (ish zonë ushtarale)

Projekti_4: Kthimi i kodrës së Krastës në park urban për banorët e Elbasanit (pajisje me elemente të dizjanit urban, ndërtimi i kalimeve të këmbësorëve dhe kalimeve të biçikletave)

Projekti 5: Rikonstruksion i Pallatit të Sportit, pajisja e teatrit "Skampa" me ndriçim dhe foni dhe ndriçimi i stadiumit "Ruzhdi Bizhuta"

Projekti 6: Ofrimi i internetit falas në të gjitha njësitë administrative

Objektivi Strategjik 2: Mbrojtja dhe rigjenerimi i **burimeve natyrore** si elemente bazë të mirëqenies sociale dhe ripërtëritjes ekonomike nëpërmjet **turizmit natyror dhe kulturor**.

Programi strategjik O2P1: Mbrojtja e sistemit urban nga përmbytjet dhe dalja e vazhdueshme e lumit Shkumbin nga shtrati duke rehabilituar argjinaturat ekzistuese.

Projekti_1: Pastrimi i shtratit të lumit Shkumbin

Projekti_2: Risistemi i zonave ripariane të lumit Shkumbin

Projekti_3: Krijimi i parqeve urbane përgjatë lumit Shkumbin, në segmentin nga Krasta e Madhe deri në grykëderdhjen e lumit të Zaranikës

Projekti_4: Rigjenerimi i parkut të Krastës

Programi strategjik O2P2: Rehabilitimi i shtretërve, brigjeve lumore dhe zonave riapariane të Shkumbinit, Zaranikës, Manazderes, Paprit, Gostimës, Gostrimës dhe Kushes.

Projekti_1: Rehabilitimi dhe sistemimi i zonave ripariane të lumit Zaranika, Manazdere, Gostimë, Gostrimë, Papër dhe Kushe

Projekti_2: Pastrimi nga mbetjet urbane i lumit Kushe

Programi strategjik O2P3: Përmirësimi i infrastrukturës (nëntokësore) të ujësjellësit dhe KUZ.

Projekti_1: Ndërtimi, supervizimi dhe kolaudim i KUZ në 4 rrugët "A. Mezini, P. Dodbiba, Q. Fezo, Sh. Thanasi

Projekti_2: Risistemimi i sistemit të kanalizimeve, dhe depozitimi i ujërave të ndotura në impiantin e trajtimit të ujërave.

Projekti_3: Supervizim dhe kolaudim punimesh për ndërtimin e ujësjellësit Muriqan

Projekti_4: Vazhdimi i ndërtimit të KUZ-së në lagjen Teqe, pranë shkollës "Sulë Domi", rruga Arif Dardhaj, tek llagjja e komunitetit Rom, Rrapishtë.

Projekti_5: Ndërtimi i ujësjellësit Përroi i Mollës-Shelçan-Mlizë-Trebsenisht-Tudan-Lleshan-Kukan-Pobrat dhe ndërtimi i ujësjellësit Fushë Buall

Programi strategjik O2P4: Hartimi dhe zbatimi i planit afatmesëm për manaxhimin e pyjeve dhe kullotave lokale.

Projekti_1: Ripyllëzimi i zonave të dëmtuara nga aktiviteti njerëzor në njësitë administrative: Papër, Gracen, Labinot-Mal, Zavalinë, Gjinar, Shushicë

Projekti 2: Ndërtimi i biokorridorit mjedisor (duke ripyllëzuar dhe duke mbjellë fidanishte në zonat e dëmtuara) përgjatë gjithë vijës administrative të Elbasanit, nga zona e mbrojtur Sopot-Stavraj, deri tek zona tjetër e mbrojtur Kutërman-Qafë e Bushit

Programi strategjik O2P5: Përmirësimi i shërbimit të manaxhimit të integruar të mbetjeve urbane.

Projekti 1: Ndërtimi i pikës së transferimit në Labinot Fushë (pranë fshatit Griqan që do t'u shërbejë banorëve të Labinot-Mal, Labinot-Fushë dhe Funarë); ndërtimi i pikës së transferimit në Tregan (do t'u shërbejë banorëve të Treganit, Shirgjanit, Gjergjanit); ndërtimi i pikës së transferimit në Gjinar (do t'u shërbejë banorëve të Zavalinës, Gjinarit dhe pjesërisht Shushicës, pjesa malore në kufi me Gjinarin)

Projekt_2: Projekti i pilotimit të ndarjes së diferencuar të mbetjeve urbane

Programi Strategjik O2P6: Zbutja e efekteve mjedisore nga aktiviteti industrial.

Programi Strategjik O2P7: Hartimi dhe vënia në jetë e planit sektorial për turizmin në nivel bashkie.

Projekti_1: Krijimi i guidave informuese dhe ngritja e *pikave të informacionit* (*info point)* për turistët.

Programi Strategjik O2P8: Rrjetëzim i aseteve historike.

Projekti 1: Restaurimi i Kalasë së Elbasanit, kishës së Shën Premtes në Gjinar dhe kalasë në shkëmbin Mret në Xibrakë (Labinot Fushë)

Programi Strategjik O2P9: Mbështetja me infrastrukturat e nevojshme për zhvillimin e ekoturizmit në njësitë administrative Tregan, Gjinar, Labinot Mal, Funarë dhe Gracen.

Projekti_1: Ndërtimi i fermave ekoturistike në Tregan, Gjinar, Funarë, Gracen, dhe Labinot Mal

Objektivi Strategjik 3: Përmirësimi i **infrastrukturës së lëvizjes** me qëllim mbështetjen e mobilitetit efektiv, ndërlidhjen më të mirë të zonave dhe uljen bllokimeve nga trafiku në Bashkinë e Elbasanit.

Programi Strategjik O3P1: Rehabilitimi dhe përmirësimi i rrugëve ekzistuese për të dhe përmirësuar aksesin, pajisja me sinjalistikën rrugore dhe ndriçimi, ndërtimi i veprave të artit në rastet e nevojshme

Projekti_1: Sistemim dhe asfaltim i pjesëve të caktuara (që janë dëmtuar) të rrugës Qemal Stafa dhe pajisja e saj me sinjalistikën rrugore[453].

Projekti_2: Pajisje me ndriçues e rrugëve Qemal Stafa, Thoma Kalefi dhe Aqif Pasha.

Projekti_3: Sistemim dhe asfalti i rrugëve të brendshme të qytetit si dhe rrugëve të kalasë

Projekti_4: Rikonstruksion i urës Polis-Vale, ndërtim i këmbëve të urës Beli, Sollak, rikonstrukson i urës së Broshkës,

Programi Strategjik O3P2: Ndërtimi i infrastrukturave me rëndësi kombëtare rajonale

Projekti_1: Ndërtimi i *bypass-it*

Programi Strategjik O3P3: Konsolidimi i unazës së madhe të bashkisë Elbasan, e cila do të ndihmojë në uljen e trafikut ndërqytetës në qytet.

Projekti_1: Ndërtimi i unazës në pjesën veri-perëndimore dhe verilindore të qytetit. Unaza kalon në dy segmente të saj përgjatë lumit të Zaranikës dhe përgjatë lumit të Manzderes.

Programi Strategjik O3P4: Përmirësimi i aksesit të qendrave të njësive dhe lidhjes së këtyre qendrave me njëra-tjetrën dhe qytetin e Elbasanit

Projekti_1: Zgjerim i rrugëve rurale Elbasan-Gjinar-Zavalinë, Elbasan-Funarë (Kusarth-Balëz-Letan-Bicellë-Funarë) dhe me korsi biçikletash dhe ristrukturimi dhe ndërtimi i segmenteve rrugore që mungojnë në aksin lidhës Tregan-Blerimas-Strestan-Gjinar; ristrukturimi i rrugës Qafë Hajdaran-Byshek; Ndërtimi i rrugës nga shkëmbi i Çaprazit-Pajun; ristrukturimi i rrugëve të brendshmë në: Katund i ri, lagja Harvales, Kusarth-Karakullak

Programi Strategjik O3P5: Intensifikimi i zhvillimit në njësive administrative përreth luginës së lumit Shkumbin, si satelitë urbanë të qytetit të Elbasanit apo fasha në vazhdim të tij.

Projekti_1: Ofrimi i shërbimeve të munguara në njësitë administrative: Gjergjan, Shirgjan, Mjekës, Hajdaran, Shushicë, Labinot Fushë, Papër

Program Strategjik O3P6: Përmirësimi i transportit publik ndërqytetës, infrastrukturave të nevojshme për këtë shërbim, si dhe ngritja e stacionit multimodal dhe stacionit për transportin e mallrave.

Projekti_1: Ofrimi i transportit publik në njësitë administrative që mungon (Gracen, Labinot-Mal, Funarë, Zavalinë)

Projekti_2: Ndërtimi i stacionit për mallra në zonën ndërmjet lumit të Zaranikës dhe zonës së ish metalurgjikut

Projekti_3: Rikonstruksioni i stacionit të vjetër të trenit dhe Rapid Bus Transfer (RBT)

Projekti_4: Ndërtimi i stacionit për pasagjerë në Labinot-Fushë, përgjatë rrugës Elbasan-Librazhd.

Program Strategjik O3P7: Rregullimi i trafikut të qytetit duke rehabilituar dhe trajtuar me projekte të veçanta rregullimin e rrethrrotullimeve/kryqëzimeve kryesore në qytet.

Projekti_1: Ndërtimi i rrethrrotullimeve tek: ura e parë e Zaranikës; kryqëzimi i stacionit të trenit, kryqëzimi tek ish-Metalurgjiku, kryqëzimi pranë urës së Cërrikut, kryqëzimi i rrugës "Kadri Hoxha" me rrugën "Çerçiz Topulli".

Program Strategjik O3P8: Nxitja e investimeve publike dhe private në fushën e mobilitetit të gjelbër (*Green Mobility*) për rrjetin e këmbësorëve dhe të biçikletave, itineraret natyrore dhe rekreative dhe shërbimeve publike

Projekti_1: Ndërtimi i rrjetit të gjelbër në qytetin e Elbasanit (rrugët e përcaktuara në hartën e infrastrukturës së propozuar)

Projekti_2: Lidhja e njësive administrative (Funarë, Labinot Mal, Gjinar, Tregan Papër) që kanë potencial turistik me Elbasanin me infrastrukturë të gjelbër.

Projekti_3: Shpronësime për varreza publike.

Objektivi Strategjik 4: Nxitje e sektorit të **bujqësisë dhe blegtorisë**, si sektorë kyç për zhvillimin e ekonomisë lokale dhe rritjes së punësimit, dhe veçanërisht për fuqizimin e zhvillimit rural.

Programi Strategjik O4P1: Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrjetit kullues dhe ujitës për të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan.

Programi Strategjik O4P2: Programimi dhe hartimi i instrumenteve të manaxhimit të tokës, të cilat do të orientojnë zhvillimet që nuk i shërbejnë sektorit të bujqësisë, jashtë sipërfaqeve me Kategori Bazë të përdorimit të tokës të propozuar B. Bujqësi, me qëllim mbrojtjen e tokës bujqësore.

Projekti_1: Zbatimi i programit për Transferimin e të Drejtave të Zhvillimit

Projekti_2: Mbjellje me arrorë (shegë) në NjA-në Gjergjan.

Projekti_3: Zbatimi i intensitetit me kushte në zonat urbane qendrore.

Programi Strategjik O4P3: Nxitja e zhvillimeve të strukturave në funksion të bujqësisë (magazinë, stalla, pika grumbullimi, kooperativa, qendra informimi, tregje javore etj.) përmes shfrytëzimit të aseteve publike dhe private në skema të partneritetit publik-privat (PPP).

Projekti_1: Ndërtimi i pikave të grumbullimit dhë përpunimit të produkteve bujqësore (ish-kombinati i drurit, ish-repartet ushtarake në fshatin Hajdaran, në

rrugën "Kadri Hoxha", në lagjen "Shën Koll pranë rrugës "Baba Sherif Cani", rrëzë kodrës së Krastës në fshatin Mengel).

Projekti_2: Konsolidimi i fashës ekonomike nga kodra e Krastës në drejtim të Labinot Fushë dhe fashës ekonomike bujqësore Cërrik-Shirgjan.

Objektivi strategjik 5: Zbutja e pabarazive sociale përmes përmirësimit të sistemit arsimor dhe atij shëndetësor, si dhe politikave gjithëpërfshirëse të strehimit social.

Programi Strategjik O5P1: Përmirësimi i shërbimit spitalor përmes investimit në infrastrukturën spitalore rajonale.

Projekti_1: Zgjerimi i spitalit rajonal në qytetin e Elbasanit.

Programi Strategjik O5P2: Identifikimi dhe adresimi i nevojave për ndërhyrje rehabilituese të qendrave mjekësore/ ambulancave në të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Elbasan.

Projekti_1: Përmirësim i infrastrukturës së qendrave shëndetësore në Bradashesh (2 qendra shëndetësore) Papër (1 qendër shëndetësore), Tregan (2 qendra shëndetësore), Shushicë (1 qendër shëndetësore) dhe Zavalinë (1 qendër shëndetësore)

Programi Strategjik O5P3: Çelja e disa departamenteve të arsimit të lartë publik në Bashkinë Elbasan, kryesisht me fokus mjekësinë dhe profesionet e inxhinierisë.

Programi Strategjik O5P4: Në mbështetje të politikave kombëtare të ministrisë; nxitje për arsimin profesional, përmes investimeve në tre shkollat profesionale ekzistuese dhe një të reje në Bashkinë e Elbasanit.

Projekti_1: Çelja e programeve të arsimit të mesëm profesional në shkollat profesionale ekzistuese në Bashkinë Elbasan.

Projekti_2: Ndërtimi i një shkolle të mesme profesionale në rajonin 3 të Bashkisë Elbasan.

Programi Strategjik O5P5: Identifikimi dhe adresimi i nevojave për ndërhyrje rehabilituese të kopshteve, shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Elbasan.

Projekti_1: Rikonstruksion i plotë në shkollën 9-vjeçare të varur Bodin, në njësinë administrative Gracen; në një kopësht dhe 2 shkolla 9-vjeçare Bradashesh; në 3 shkolla 9-vjeçare në Funarë (si në shkollën Preç e Poshtëme, Cerujë, Krrabë e Vogël); 2 kopshte dhe 1 shkollë fillore në Zavalinë, përkatësisht në Burrishtë dhe Kamiçan; 3 shkolla 9-vjeçare në Tregan (përkasisht në Kaqivel, Kaqivel i poshtëm dhe Shinavlash); 3 shkolla 9-vjeçare në Gjergjan (Gjergjan, Kodra Bujaras, Bujaras) etj. Hidroizolim i tarracës së shkollës Pedagogjike.

Projekti_2: Infrastrukturë mbështetëse për shkollën 9-vjeçare 'Xhaferr Hakani'. Mbikëqyrje punimesh për ndërtimin e shkollës 9-vjeçare në Sollak.

Projekti_3: Përshtatja e konvikeve të shkollës së muzikës për ambiente zyrash. Rikonstruksion i ambienteve të konviktit të shkollës Pedagogjike.

Programi Strategjik O5P6: Mbështetje e gjithë shtresave të popullsisë për një strehim sa më të përballueshëm dhe me kushte optimale jetese në territorin e Bashkisë Elbasan.

Projekti_1: Ndërtimi i banesave sociale dhe pajisja e tyre me pompa uji dhe pajisje të tjera të nevojshme.

Projekti_2: Supervizim dhe kolaudim për rikonstruksionin e banesave të komunitetit Rom dhe Egjiptian.

- **Reflektimi i propozimeve të Planeve Kombëtare në PPV**

Tabela 92. Reflektimi i planeve kombëtare në PPV-në e Elbasani

Propozimi i Planit të Përgjithshëm Kombëtar (PPK)	Reflektim në PPV	Sqarime për mënyrën e reflektimit në PPV
Bashkia Elbasan si qendër parësore në hierarkinë e qendrave urbane.	I plotë	Bashkia Elbasan renditet si qendër parësore si në rajon ashtu edhe për nga hierarika në nivel kombëtar. Elbasani konsiderohet si zonë metropolitane duke u renditur kështu në nivelin e parë, njësoj si Tirana, Durrësi e Fieri, të cilat janë qendra urbane kryesore-parësore. Kjo është reflektuar më tej në funksionet që promovohen në Elbasan në lidhjen me infrastrukturat kombëtare dhe në e zhvillimin e mëtejshëm të bashkisë.
Ndërtimi i një shkolle të re polifunksionale në Bradashesh.	I plotë	Shkolla e re profesionale polifunksionale është propozuar të ndërtohet në Bradashesh për të mundësuar jo vetëm shpërqendrimin e funksioneve në të gjithë bashkinë, e jo vetëm në qytet, si dhe për tërritur aksesin e banorëve nga zonat rurale dhe njësitë e tjera administrative.
Përpunimi i produkteve bujqësore në polet e parashikuara për grumbullimin e këtyre produkteve, në mënyrë që këto zona të funksionojnë si zinxhir ekonomik.	I plotë	Në Elbasan janë parashikur të ndërtohen pika grumbullimi, magazinimi dhe përpunimi për produktet bujqësore, për të ndihmuar fermerët dhe për të fuqizar ekonominë bujqësore. Në segmente të caktuara (Elbasan-Cërrik) është parashikur të vendosen SME-të me fokus bujqësinë. Ndërsa në zona të tjera që njihen për prodhimet bujqësore janë parashikuar pika magazinimi dhe përpunimi për produktet bujqësore.
Masa për përmirësimin e sitemit të kanaleve kulluese dhe ujitëse.	I plotë	Janë parashikuar pastrimi, mirëmbajtja dhe përmirësimi i sistemit të kanaleve kulluese dhe ujitëse në të gjithë zonat bujqësore. Po ashtu, parashikohet ruajtja e të gjithë sistemit infrastrukturor nga ndërtimet e paligjshme mbi të.
Nxitja e fermerëve për bashkëpunim, duke krijuar korporata që mund të konkurojnë në rajon.	I plotë	Për të nxitur fermerët që të bashkëpunojnë, janë parashikuar zona për grumbullimin e produkteve të tyre. Duke ofruar facilitete të nevojshme për të rritur prodhimin dhe konsumin e produkteve të prodhuara në territorin e bashkisë.
Krijimi i tregjeve rajonale.	I plotë	Janë parashikuar tregje me kapacitet për të përballuar sasinë e prodhimeve në nivel rajonal, në perëndim të qytetit, tek ish-Kombinati i Drurit, në jug afër urës së Shkumbinit, dhe në zonën mbi Krastë. Po ashtu i gjithë aksi që lidhet me Cërrikun do të ketë biznese me karakter bujqësor ose në funksion të bujqësisë.
Via Egnatia: 1. Rivlerësimi i aksit Peqin-Elbasan-Mirakë-Qukës nisur nga fakti që përgjatë kësaj rruge kalon 'Via Egnatia'. 2. Sipas Strategjisë Sektoriale të Transportit 2008-2013, segmenti Xhyrë-Librazhd-Krastë-Mirakë-Librazhd, të ridizenjohet sipas konceptit të rrugëve "Green".	I plotë	Via Egnatia është një gjurmë e rëndësishme në territorin e Bashkisë Elbasan. Gjurma e kësaj rruge është evidentuar si pjesë e rëndësishme e trashëgimisë historike dhe kulturore e Elbasanit.
Të parashikohet rruga Funarë-Tiranë, rrugë që ka përparësi turizmin.	I plotë	Është propozuar lidhja e këtij segmenti, pra të Funarës me autostradën Tiranë-Elbasan. Kjo lidhje garanton dalje të


		shpejtë të banorëve në rrugën e shpejtë, dhe lidhje me Tiranën dhe Elbasanin. Po ashtu, mundëson depërtimin e turistëve në zonën rurale të Funarës. Për ta vizituar këtë zonë është parashikuar të ketë lidhje edhe me biçikleta.
Hekurudha: *1.* Mirëfunksionimi i stacioneve aktuale dhe modaliteteve që mund të ofrojë rrjeti hekurudhor. *2.* Kthimi i stacionit aktual të trenit në stacion multimodal.	I plotë	1. Parashikohet zgjerimi i stacionit të trenit dhe rivitalizimi i zonës duke përmirësuar transportin hekurudhor. Kjo është faza e parë e realizimit të stacionit. Në fazën e dytë dhe afatgjatë, stacioni multimodal do të vendoset në fushën e Bradasheshit dhe stacioni në qytet do të shërbejë vetëm për zonën urbane. *2.* Aktualisht stacionet e autobusëve janë të shpërndarë nëpër qytet dhe nuk kanë një pikë fikse, ku mund të grumbullohen. Zgjerimi i stacionit të trenit do të ofrojë mundësinë e kthimit të kësaj zone në stacion multimodal (faza e parë), ku mund të integrohen edhe terminalet e autobusëve.
Rjeti i biçikletave, itinerar Qendror (Shëngjergj-Qafa e Bushit-Krastë-Gjinar-Gramsh-Voskopojë) dhe itenerar Horizontal (Dardhë-Xhyrë-Tragan-Papër-Belsh).	I plotë	Në Bashkinë Elbasan është propozuar rrjeti i gjelbër i lëvizjes, dhe përveç zonave të përcaktuara në PPK janë propozuar edhe itinerare te tjera peizazhistike. Rrjeti i gjelbër përfshin lëvizjen me biçikleta, lëvizjen për këmbësorë, lëvizjen përgjatë korridoreve natyrore dhe park (i Shkumbinit, Zaranikës etj.) si dhe destinacionet që arrihen përmes këtij rrjeti si Krasta, Kalaja, parku i Shkumbinit, monumentet e kulturës etj.
Përmirësimin e infrastrukturës 'Soft' që çon në qendrat termale, për të ndihmuar lidhjen dhe për të përmirësuar ekoturizmin.	I plotë	Zona e ujërave termale (e Llixhave) në Elbasan, luan rol të rëndësishëm ekoturistik. Zona e Treganit (Ilixhat) është propozuar të rigjenerohet dhe të përmirësohet lidhja me qendrën e Elbasanit nëpërmjet aktiviteteve mbështetese ekoturistike dhe ndërhyrjeve peizazhistike.
Marrja e masave për adaptimin ndaj kushteve klimatike, në harkun kohor 15 vjeçar.	I plotë	Masat e marra për adaptimin ndaj kushteve klimatike janë parashikuar në Plan dhe në VSM. Këto masa konsistojnë në: shtimin e sipërfaqes pyjore në zonën kodrinore dhe në zonat ripariane të lumenjve, veçanërisht në lumin Shkumbin (përfshirë parkun), krijimin e korridoreve vegjetative në zona bujqësore, marrja e masave për zhvendosje të popullsisë ose pritje të popullsisë nga zona në rrezik emergjent, mirëmbajtja e sistemit të kullimit dhe vaditjes etj.
Mbrojtja e mjedisit dhe sistemi natyror: *1.* Korridoret natyrore përgjatë luginave të lumenjve të shërbejnë për të lidhur zonat e mbrojtura mjedisore, parqet kombëtare dhe rezervat natyrore masive pyjore. *2.* Vlerësimi i potencialit natyror për shfrytëzimin e energjive të rinovueshme, kryesisht përmes parqeve me fotovoltaikë. *3.* Rikualifikimi i vend-deepozitimeve ekzistuese dhe përshtatja e tyre në përputhje me normat mjedisore. Marrja e	I plotë	*1.* Elbasani ka terren kodrinor-malor me vlera pezazhistike dhe natyrore, të cilat duhet të mbrohen dhe të trajtohen për të mos humbur vlerat e tyre. Zona kodrinore-malore ndërmjet dy zonave të mbrojtura është propozuar të pyllëzohet dhe jetë një korridor natyror. Gjithashtu në zonat e tjera të bashkisë janë propozuar korridore natyrore, për të shmangur humbjen e mëtejshme të florës dhe faunës. 2. Janë marr masa në VSM dhe PPV *3.* Vend-depozitimi i mbetjeve urbane është rikualifikuar dhe janë marrë masa mbrojtëse për mjedisin për reduktimin e ndotjeve që çlirohen në mjedis, duke shkaktuar dëm në tokë, ajër, dhe ujë. *4.* Në bashkinë Elbasan, vend-depozitimi është ndërtuar në zonën fushore Elbasan-Kombinati Metalurgjik, pranë lumit Shkumbin. Për të ofruar shërbim në të gjithë territorin janë propozuar të ndërtohen pika

masave për reduktimin e sasisë së ndotjeve të çliruar në ambient. 4. Ndërtimi i një vend-depozitimi në zonën e Papërit, sipas përcaktimeve në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve 2010-2020. 5. Propozohet shtimi dhe ruajtja e zonave pyjore duke rritur sipërfaqet e ripyllëzuara		transferimi në: NjA Labinot Fushë, pranë fshatit Griqan, në NjA Tregan dhe një pikë në NjA Gracen 5. Në masat për mbrojtjen e peizazhit, biodiversitetit dhe hapësirës së gjelbër ndër të tjera është propozuar ripyllëzimi i zonave të zhveshura pyjore.
Për sistemin ujor në rajon propozohet: 1. Përcaktimin e vijës blu përgjatë lumenjve dhe degëzimeve të tyre, për të mbrojtur lumenjtë nga shfrytëzimi intensiv, efektet e vend-depozitimeve të mbetjeve urbane, të cilat janë të vendosura pranë brigjeve lumore (vend-depozitimi i vjetër Elbasan) dhe mbrojtjen e aktiviteti bujqësore dhe industrial që ndodh përgjatë shtratit të lumenjve 2. Mbrojtjen e cilësisë së ujërave të lumit Shkumbin.	I plotë	1. Përgjatë lumenjve është përcaktuar vija blu sipas përcaktimeve ligjore të ligjit nr. "Për manaxhimin e integruar të burimeve ujore"; ndalohet shfrytëzimi i mëtejshëm i shtratit të lumit (marrja e inerteve) dhe zhvillimi i aktiviteteve të tjera industriale, urbane dhe bujqësore. Po ashtu është propozuar krijimi i zonave ripariane përmes teknikave të pyllëzimit. 2. Faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në cilësinë e ujërave të lumit Shkumbin janë: derdhja e ujërave të ndotura në lumë dhe hedhja e mbetjeve të ngurta urbane. Sistemi i kanalizimeve është propozuar të risistemohet dhe të trajtohen këto ujëra në impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura. Mbetjet e ngurta urbane do të depozitohen në *landfill*-in që është ndërtuar në Elbasan.
Krijimi e parqeve natyrore përgjatë brigjeve ujore	I plotë	Është propozuar krijimi i parkut të Shkumbinit. Po ashtu, janë propozuar të ndërtohen disa parqe natyrore periferike në Elbasan, përkatesisht në Tregan, Funarë etj.
Furnizimi me ujë i popullsisë që parashikon të vendoset në Elbasan në të ardhmen	I plotë	Elbasani është i pasur me burime ujore, të cilat mund të përdoren për furnizimin e popullsisë me ujë, aktualisht furnizimi i popullsisë me ujë është relativisht i mirë. Propozohet risistemimi i sistemit konvencional në zonat më të populluara dhe përdorimi i ujit nëpërmjet puseve në zonat më të thella rurale
Ndërhyrjet në basenin e lumit Shkumbin nëpërmjet projekteve të veçanta.	I plotë	Lumi Shkumbin është trajtuar në mënyrë të veçantë. Është propozuar risistemimi i zonave ripariane dhe rehabilitimi i shtratit të lumit. Gjithashtu në segmenit Krastë-Grykëdergje e lumit Zaranikë parashikohet të trajtohet me parqe urbane, të cilat përveç se parashikojnë sistemim të zonave ripariane parashikojnë edhe zona e hapësira rekreative për banorët.

Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

2.1.2 Sistemet e territorit dhe përdorimi i tokës

Figura 199. Sistemet e propozuara te territorit



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Për të realizuar objektivat e përcaktuara në Dokumentin e Strategjisë së Bashkisë Elbasan, të cilat synojnë të shmangin shpërhapjen e mëtejshme të zhvillimeve në territor, krijimin e mjedisit të përshtatshmë për zhvillim ekonomik (zonat kryesore të zhvillimit ekonomik urban), mbrojten e mjedisit dhe krijimin e hapësirave publike e parqeve, përdorimi i tokës, e për pasojë edhe sistemet e territorit, pësojnë ndryshime sipas Planit. Këto ndryshime paraqiten fillimisht për kategoritë e përdorimit të tokës (duke reflektuar edhe zonat e zhvillimit ekonomik, harta me e më pas për pesë sistemet) Në lidhje me përdorimin e tokës, parimet kryesore janë:

i) Promovimi i përzierjes së funksioneve (miksi) dhe shmangia e zonave monofunksionale të pastra brenda qytetit dhe vendbanimeve në tërësi. Miksi është i nevojshëm jo vetëm për t'i bërë lagjet sa më të jetueshme e të pasura me shërbime, por edhe për të rritur nivelin e sigurisë, e cila do të cënohej në kushtet e ndarjeve sociale për shkak të përdorimeve monofunksionale. Miksi i përshtatet edhe dinamikave të tregut të tokës dhe në këtë mënyrë lehtëson zhvillimin dhe qarkullimin e kapitalit. Në Elbasan është gjithsesi e nevojshme të

induktohet miksi në çdo lagje banimi apo qendër fshati/njësie administrative sepse vihet re se kemi një dominim të zonave të "pastra" të banimit përkundrejt funksioneve të tjera. Dominime të tilla rrezikojnë t`u japin vendbanimeve karakterin e një "fjetoreje" dhe kjo është fatale në proceset qytetformuese. Planet, Bashkia, zhvilluesit dhe qytetarët duhet të përpiqen vazhdimisht që të sjellin energji të reja nëpër lagjet e banimit, për të rritur nivelin e "jetueshmërisë së hapësirës".

ii) Plani kujdeset gjithashtu që të shmangë vendosjen e përdorimeve të papërputhshme afër njëri-tjetrit, ose nëse kjo është e pamundur të shmanget, atëherë propozohen masa mbrojtëse. Masa të tilla, si p.sh. distancat apo brezat mbrojtës, paraqiten në rregulloren e Planit, në seksionin e përdorimeve të ndaluara dhe të kushtëzuara. Kur përdorimet janë tërësisht të papërputhshme, dhe sigurisht kanë nevojë për sipërfaqe të konsiderueshme, ato vendosen në zona specifike dhe larg atyre të banimit. Ky është rasti për disa nga zonat ekonomike.

iii) Kur përdorimet nuk janë banim, por u përkasin kategorive të tjera, zakonisht ato tentojnë të jenë monofunksionale në natyrë, ose të përfshijnë funksione shumë të ngjashme. Të tilla raste janë infrastrukturat madhore, zonat bujqësore, parqet dhe pyjet, zonat ripariane, zonat ekonomike etj. Plani garanton që këto zona të zhvillohen të pashqetësuara, por edhe të mos shqetësojnë përdorimet e tjera përreth, përfshirë ato të banimit. Kjo realizohet përmes masave mjedisore, brezave dhe distancave mbrojtëse e pyllëzimeve.

iv) Respektimi i rëndësisë kombëtare në territor dhe të gjitha kushtëzimeve sektoriale është parim kyç që ka drejtuar mënyrën se si janë bërë të gjitha propozimet e Planit. Mund të përmendim disa nga këto kushtëzime si: ligji nr.9358 "Për Pyjet dhe shërbimin pyjor" – kufizimet në konvertimin e fondit pyjor (aktualisht legjislacion i ri në proces); ligji nr.111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" – përcaktimi i brigjeve të trupave ujorë (5m – 20m dhe 100m -200m) dhe veprimtaritë e lejuara në brigje; "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" – 60 m brezi mbrojtës nga autostrada dhe distancat në zona urbane; VKM nr. 671 "Për miratimin e rregullores së planifikimit" – standarde dhe tregues planifikimi për shkolla, kopshte, qendra shëndetësore, breza mbrojtës, distanca të mbrojtjes, lartësitë, intensitetet etj.; ligji nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", i ndryshuar – kufizimet në konvertimin e tokave bujqësore në truall; ligji nr. 8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", i ndryshuar – kufizimet në konvertimin e tokave bujqësore në truall; VKM nr. 410, datë 27.06.2012, "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës" dhe VKM nr. 283, datë 1.4.2015, "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore" – kufizimet në konvertimin e tokave bujqësore në truall; ligji nr. 8906, datë 6.6.2002, "Për zonat e mbrojtura", i ndryshuar – kufizimet në zonat e mbrojtura dhe zonat buferike të tyre etj. Ilustrime të mënyrave se si këto kushtëzime ndikojnë në territor paraqiten në hartën e Rëndësisë Kombëtare në territor të përgatitur me hartimin e Strategjisë së Territorit, sikurse edhe në figurat e mëposhtme:


Kategori bazë - Banim (A): Kjo është një nga kategoritë e përdorimit të tokës që pritet të ketë më shumë ndryshime, duke iu referuar edhe rritjes së numrit të popullsisë deri në vitin 2030. Për të përllogaritur shtimin e banimeve deri në vitin 2030, është marrë parasysh rritja (natyrore e mekanike), nevojat aktuale për strehim në Bashkinë Elbasan dhe kapaciteti

mbajtës sipas sipërfaqes dhe standardit 25m^2 banim për banor. Ajo që propozohet është intensifikim i banimit në zonën e qytetit, për të shmangur shpërhapjen e mëtejshme drejt tokave bujqësore dhe natyrore dhe mbushje urbane kyresisht në njësitë administrative (ish-komuna) duke qënë se ka ende hapësira për zhvillim në zonat e ndëtuara.

Kategori bazë - Industri dhe Ekonomi (IE): Kjo kategori ka ndryshuar duke marrë në konsideratë propozimet për transformimin e zonës së ish-Metalurgjikut në një zonë ekonomike (jo më industri e rëndë), dhe propozimet për të konsoliduar zonat ekonomike (me karakter kryesisht bujqësor dhe shërbime) që shtrihen përgjatë akseve kryesore: a) Elbasan-Papër, b) Elbasan-Cërrik, c) Elbasan-Labinot Fushë. Gjithashtu janë propozuar qendra magazinimi dhe tregu në Hajdaran, industri përpunuese dhe treg ushqimor në kryqëzimin e unazës pranë kodrës së Krastës dhe në disa zona të tjera të përshtatshme në qytetin e Elbasanit. Në raste të tjera kjo kategori përdorimi është menduar të kombinohet edhe me shërbime, për të kombinuar dhe plotësuar nevojat e popullsisë me funksione të ndyshme. Gjithashtu, në rastet kur përdorimi ekzistues ishte industry, ekonomi dhe banim (zona e ish-Metalurgjikut, ish-Kombinati i drurit etj) është përshtatur përdorimi duke u konvertuar në kategori bazë ekonomi dhe shërbime e duke ruajtur distancat e nevojshme nga zonat e banuara.

Kategori bazë - Bujqësi (B): Kjo kategori është trajtuar në mënyrë të veçantë, duke patur si synim kryesor mbrojten e tokës bujqësore dhe shmangien e ndërtimit në këto toka. Janë propozuar ndërhyrje për të konservuar dhe konsoliduar tokën bujqësore përgjatë fushës së lumit Shkumbin dhe të gjitha zonat e tjera, ku ka përdorime bujqësore. Në zonat natyrore që janë kthyer në toka bujqësore, duke dëmtuar kurorën e pyjeve dhe vënë në rrezik qëndrueshmërinë e tokës, është propozuar të kryhet ripyllëzimi, duke rehabilituar vlerat natyrore. Për të kuptuar më mirë se si është përdorur deri më tani toka bujqësore nga aktiviteti urban, përveç analizës së bujqësisë është realizuar edhe harta e fragmentimit të tokës bujqësore. Propozimet për të ndërtuar ose jo në tokë bujqësore bazohen veçanërisht në këtë hartë, si edhe në kërkesat me të cilat përballet bashkia për ndërtime në zonat rurale të saj. Kështu, për ndërtesat me funksion bujqësor zbatohet legjislacioni përkatës (ligji për tokën bujqësore dhe VKM nr. 283 e vitit 2015). Për ndërtesat me funksion banim është propozuar që banorët të kenë mundësi të shtojnë së paku një kat në lartësi ose të kenë mundësi edhe për shtesa anësore. Kjo realizohet në mënyra të ndryshme në zona me fragmentim të ndryshëm të tokës bujqësore, me parimin e ruajtjes së zonave ku fragmentimi është më i ulët dhe dhënien e mundësisë për shtimin e sipërfaqes së banimit, në zonat ku fragmentimi është më i lartë. Mënyra se si ndodh kjo detajohet në rregulloren e Planit, por kufiri ndarës është fragmentimi prej 20% i tokës bujqësore. Gjithashtu, shtesat e ndërtimit ndodhin vetëm brenda parcelave truall që aktualisht kanë banorët e zonës rurale. Pra atyre u jepet mundësia për ta shfrytëzuar më mirë parcelën truall, por nuk u lejohet të ndërtojnë për banim në tokën arë.

Figura 200. Fragmentimi i tokës bujqësore



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Kategori bazë - Shërbime (S): Shërbimet janë risjellë në territor, përgjatë fashave ekonomike Elbasan-Papër, Elbasan-Cërrik dhe Elbasan-Labinot Fushë, si edhe në të gjitha qendrat e njësive administrative. Këto të fundit kanë mungesa në përballimin dhe plotësimin nevojave të popullsisë, veçanërisht për qendra shumë-funksionale, objekte arsimore e shëndetësore etj.

Kategori bazë - Përdorime të veçanta (V): Ka ndryshime të vogla në këtë kategori, të cilat vijnë në pjesën e qytetit të Elbasanit, përmes zgjerimit të zonës së varrezave. Në zonat rurale nuk ka ndërhyrje që e ndryshojnë këtë përdorim.

Kategori bazë - Ujëra (U): Nuk ka ndryshime thelbësore për kategorinë e ujrave, përveç, konceptit për të krijuar vijën ujore mespërmes qytetit, si lidhëse e Manazderes me Zaranikën. Propozimet e tjera konsistojnë në rehabilitimin e sipërfaqeve ujore, por nuk ndikojnë në zgjerimin apo zvogëlimin e tyre.

Kategori bazë - Natyrore (N): Nuk parashikohen ndryshime thelbësore në kategorinë bazë Natyrore. Në raste specifike kur tokat bujqësore apo ndërtimet janë vendosur në zonat ripariane (të cilat klasifikohen si zona natyore) të lumenjve apo sipërfaqeve të tjera ujore, është propozuar rehabilitimi dhe trajtimi pejzazhistik i këtyre zonave. Në pjesën perëndimore të bashkisë Elbasan është propozuar të krijohet një korridor biodiversiteti, i

cili rehabiliton të gjithë zonën pyjore duke minimizuar ndërprerjet e biodiversitetit që janë bërë nga ndërhyrjet artificiale. Ky korridor kalon përgjatë gjithë gjatësisë së vijës administrative perëndimore të bashkisë.

Kategori bazë - Trashëgimi dhe Monumente Kulture dhe Historike (M): Nuk ka ndryshime në përdorimin e propozuar për këtë kategori. Për trashëgiminë, monumentet e kulturës dhe ato historike janë propozuar ndërhyrje restauruese dhe mbrojtëse. Për më tepër, itineraret e krijuara për lëvizjen e banorëve dhe turistëve janë ndikuar edhe nga pozicionimet e monumenteve, për t`i sjellë ato sa më tepër në vëmendjen e njerëzve dhe për t'i bërë lehtësisht të aksesueshme nga vizitorët.

Kategori bazë - Zona Ushtarake (ZU): Nuk ka ndryshime të propozuara në këtë kategori.

Kategori bazë - Institucione (IS): Nuk ka ndryshime të propozuara për këtë kategori. Gjithsesi, zonat për rizhvillim dhe rigjenerim në qytet dhe në qendrat e njësive administrative, ofrojnë mundësinë edhe për krijimin e hapësirave të reja për institucione.

Kategori bazë - Aktivitete Sociale dhe Rekreative (AR): Sipërfaqja e kësaj kategorie rritet përmes propozimeve për të shtuar zonat rekreative dhe zonat sportive në qytet dhe në njësitë e tjera. Për shembull, propozimet për ta kthyer kodrën e Krastës në një park periferik natyror, parku tematik rrëzë kodrës së Krastës, zonat sportive rekreative pranë zonës së ish-Kombinatit të Drurit, parku i Shkumbinit, pikat turistike të Byshekut, Treganit, Gjinarit, Zavalinës, Xibrakës dhe Funarës si dhe zonave të tjera që kanë potencial për t'u përdorur për aktivitete sociale dhe rekreative, janë raste konkrete që tregojnë se si fuqizohet kjo kategori përdorimi në territor.

Kategori bazë - Arsim (AS): Ka ndryshime që ndodhin si pasojë e propozimeve për të ndërtuar objekte arsimore në zonat të pambuluara me shërbimin e arsimit. Ndryshimet e propozuara prekin thuajse të gjitha njësitë administrative të bashkisë Elbasan.

Kategori bazë - Shëndetësi (SH): Për qytetin e Elbasanit nuk ka ndryshime thelbësore të kategorisë bazë shëndetësi, por është propozuar zgjerimi i spitalit aktual për të mbuluar më mirë popullsinë. Në njësitë e tjera mbulimi me shërbim nuk mungon por ka nevojë emergjente për rehabilitimin e qenrave shëndtësore dhe konsultoreve për ti rikthyer ato në gjendjen optimale.

Kategori bazë - Infrastruktura (IN): Kjo kategori përfshin të gjitha zgjerimet e mundshme në rrjetin rrugor të mundshëm,duke përfshirë këtu edhe hapjen e akseve të reja për të akomoduar parkimin publik apo rritjen e mundshme si pasojë e parashikimit të ndërtimit të akseve të reja infrastrukturore. Ndryshimet më të mëdha ndodhin përgjatë/në zonën ku do të ndërtohet *bypass*-i, Korridori VIII dhe stacioni multimodal. Gjithashtu, infastruktura që ndikon në këtë kategori janë rrugët që lidhin Elbasanin me zonat rurale dhe zonat rurale me njëra-tjetrën, përgjatë këtyre akseve ndodhin edhe konvertimet e tokës nga bujqësore ose natyrore në infrastrukturore.

Në vijim paraqitet tabela e bilancit të përdorimit të propozuar të tokës. Kjo tabelë ndërtohet për kategoritë bazë që kombinohen në çdo njësi strukturore, përfshirë zonat ripariane, rrugët dhe ujërat. Harta përkatëse është ajo me kodin P:01/2.

Tabela 93. Bilanci i përdorimi të tokës

Nr.	Kategoria bazë	Treguesit

		Sipërfaqja (ha)
1	01.Banim	569.5
2	01.Banim 03.Bujqësi	2814.1
3	01.Banim 03.Bujqësi 04.Shërbime	16.8
4	01.Banim 03.Bujqësi 07.Natyrore	78.9
5	01.Banim 04.Shërbime	810.4
6	01.Banim 04.Shërbime 03.Bujqësi	12.9
7	01.Banim 04.Shërbime 07.Natyrore	17.5
8	01.Banim 04.Shërbime 08.Trashëgimi dhe monumente kulture dhe historike	2.6
9	01.Banim 04.Shërbime 10.Institucione	8.6
10	01.Banim 04.Shërbime 11.Aktivitete sociale dhe rekreative	10
11	01.Banim 04.Shërbime 12.Arsim	50.6
12	01.Banim 04.Shërbime 13.Shëndetësi	4.6
13	01.Banim 04.Shërbime 14.Infrastrukturë	14.5
14	01.Banim 06.Ujëra	8.9
15	01.Banim 07.Natyrore	83.3
16	01.Banim 07.Natyrore	19
17	01.Banim 07.Natyrore 06.Ujëra	14.7
18	01.Banim 11.Aktivitete sociale dhe rekreative	12.8
19	01.Banim 07.Natyrore 03.Bujqësi	5.7
20	01.Banim 12.Arsim	18.9
21	01.Banim 07.Natyrore 04.Shërbime	15.1
22	01.Banim 12.Arsim 04.Shërbime	11.4
23	01.Banim 12.Arsim 08.Trashëgimi dhe monumente kulture dhe historike	10.7
24	01.Banim 12.Arsim 10.Institucione	6.3
25	01.Banim 12.Arsim 13.Shëndetësi	7.9
26	01.Banim 13.Shëndetësi 10.Institucione	13.8
27	01.Banim 14.Infrastrukturë 04.Shërbime	405.2
28	02.Industri dhe Ekonomi	21.8
29	02.Industri dhe Ekonomi 01.Banim	43.9
30	02.Industri dhe Ekonomi 04.Shërbime	43.9
31	02.Industri dhe Ekonomi 04.Shërbime 01.Banim	6.5
32	02.Industri dhe Ekonomi 14.Infrastrukturë	11.9
33	02.Industri dhe Ekonomi 14.Infrastrukturë 04.Shërbime	68.4
34	03.Bujqësi	7437.3
35	03.Bujqësi 01.Banim	2686.8
36	03.Bujqësi 01.Banim 04.Shërbime	23.7
37	03.Bujqësi 01.Banim 06.Ujëra	3.4
38	03.Bujqësi 01.Banim 07.Natyrore	55.1
39	03.Bujqësi 04.Shërbime	98.5
40	03.Bujqësi 04.Shërbime 01.Banim	8.8

41	03.Bujqësi 04.Shërbime 14.Infrastrukturë	4.9
42	03.Bujqësi 06.Ujëra 01.Banim	4.6
43	03.Bujqësi 07.Natyrore	625.6
45	03.Bujqësi 07.Natyrore 01.Banim	142.4
46	03.Bujqësi 07.Natyrore 04.Shërbime	99.4
47	03.Bujqësi 07.Natyrore 06.Ujëra	93.5
48	03.Bujqësi 11.Aktivitete sociale dhe rekreative	18.1
49	03.Bujqësi 14.Infrastrukturë	188.9
50	04.Shërbime	102.9
51	04.Shërbime 01.Banim	187.8
52	04.Shërbime 01.Banim 03.Bujqësi	40.8
53	04.Shërbime 01.Banim 06.Ujëra	16.3
54	04.Shërbime 01.Banim 11.Aktivitete sociale dhe rekreative	13.4
55	04.Shërbime 03.Bujqësi	13.4
57	04.Shërbime 07.Natyrore	17.2
58	04.Shërbime 10.Institucione 07.Natyrore	6.7
59	04.Shërbime 11.Aktivitete sociale dhe rekreative	6.3
60	04.Shërbime 11.Aktivitete sociale dhe rekreative 01.Banim	4.9
61	04.Shërbime 14.Infrastrukturë	20.2
62	05.Përdorime të Veçanta	53.8
63	06.Ujëra 01.Banim 03.Bujqësi	12.9
64	06.Ujëra 03.Bujqësi	9.3
65	06.Ujëra 03.Bujqësi 01.Banim	10.9
66	06.Ujëra 07.Natyrore	24.2
67	07.Natyrore	25088.6
68	07.Natyrore 01.Banim	1.9
69	07.Natyrore 01.Banim 03.Bujqësi	345.8
70	07.Natyrore 03.Bujqësi	915
71	07.Natyrore 03.Bujqësi 01.Banim	22.1
72	07.Natyrore 03.Bujqësi 06.Ujëra	872
73	07.Natyrore 06.Ujëra	203.9
74	07.Natyrore 09.Zonë Ushtarake 03.Bujqësi	21.6
75	07.Natyrore 09 Zonë Ushtarake 06.Ujëra	13.2
76	07.Natyrore 01.Banim	35.1
77	07.Natyrore 01.Banim 06.Ujëra	585.6
78	07.Natyrore 03.Bujqësi	4964.8
79	07.Natyrore 03.Bujqësi 06.Ujëra	20176.7
80	07.Natyrore 04.Shërbime	859.6
81	07.Natyrore 04.Shërbime 01.Banim	146.8
82	07.Natyrore 04.Shërbime 06.Ujëra	10.2
83	07.Natyrore 06.Ujëra	11929.4
84	07.Natyrore 06.Ujëra 03.Bujqësi	3095.5
85	07.Natyrore 09.Zonë Ushtarake	8.5

86	07.Natyrore 11.Aktivitete sociale dhe rekreative	57.9
87	07.Natyrore 14.Infrastrukturë 04.Shërbime	7.4
88	08.Trashëgimi dhe monumente kulture dhe historike 01.Banim 12.Arsim	13.9
89	09.Zonë Ushtarake	50.6
90	09.Zonë Ushtarake 07.Natyrore	39.9
91	10.Institucione 01.Banim	7.4
92	10.Institucione 01.Banim 11.Aktivitete sociale dhe rekreative	4.1
93	11.Aktivitete sociale dhe rekreative	225
94	11.Aktivitete sociale dhe rekreative 01.Banim	15
95	11.Aktivitete sociale dhe rekreative 01.Banim 04.Shërbime	16.1
96	11.Aktivitete sociale dhe rekreative 04.Shërbime	6.7
97	11.Aktivitete sociale dhe rekreative 04.Shërbime 01.Banim	13.3
98	11.Aktivitete sociale dhe rekreative 04.Shërbime 05.Përdorime të Veçanta	10.9
99	11.Aktivitete sociale dhe rekreative 06.Ujëra 03.Bujqësi	5.1
100	11.Aktivitete sociale dhe rekreative 07.Natyrore	14.8
101	11.Aktivitete sociale dhe rekreative 08.Trashëgimi dhe monumente kulture dhe historike 01.Banim	6.5
102	11.Aktivitete sociale dhe rekreative 10.Institucione 01.Banim	4.7
103	11.Aktivitete sociale dhe rekreative 12.Arsim	1.4
104	13.Shëndetësi 01.Banim 04.Shërbime	13.7
105	14.Infrastrukturë	94.4
106	14.Infrastrukturë 02.Industri dhe Ekonomi 01.Banim	5.6
107	14.Infrastrukturë 04.Shërbime	29.2
108	14.Infrastrukturë 03.Bujqësi	28.1
109	14.Infrastrukturë 04.Shërbime 06.Ujëra	9.4
110	14.Infrastrukturë 07.Natyrore	13.3

Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Si rezultat i transformimeve që ndodhin në lidhje me përdorimin e tokës, ndryshon edhe harta e sistemeve territoriale. Ndryshimet e sistemeve janë të ndryshme dhe janë subjekt i legjislacionit përkatës, që të mund të realizohen. Plani i propozon ato për të arritur qëllimet e zhvillimit social-ekonomik dhe të mbrojtjes mjedisore në territor. Transformimet kryesore në nivel sistemi territorial ndodhin për shkak të infrastrukturave që propozohen të shtohen, e veçanërisht rrugët, stacioni multimodal dhe stacionet e transferimit. Po ashtu, kemi disa raste në të cilat propozohen zgjerime të zonave të banuara dhe në këtë rast toka bujqësore/natyrore propozohet të kthehet në urbane. Kemi edhe raste kur disa toka bujqësore përgjatë Shkumbinit, për shembull në zonën e Shushicës, propozohen të kthehen në natyrore, pra në zona ripariane. Janë edhe rastet e brigjeve të Shkumbinit në qytet, ku edhe pse statusi i tokë mund të jetë natyror, në realitet brigjet janë thuajse të paidentifikueshme për shkak të mungesës së bimësisë dhe ndërtimeve informale. Në këto raste, rikthimi i zonës ripariane apo parku i Shkumbinit janë mënyra për ta rikthyer tokën në sistemin natyror. Po ashtu koncepti i propozuar për të krijuar vijën ujore përmes qytetit, që lidh Manazderen me Zaranikën është edhe një propozim për të krijuar një sipërfaqe të sistemit ujor brenda sistemit urban të qytetit. Pra transformimet ndodhin sipas rastit, në

favor të sistemit urban, ose në favour të sistemit natyror e bujqësor. Rastet dhe qëllimet e transformimeve të kategorisë së resursit të tokës, shpjegohen në tabelën në vijim.

Veç këtyre transformimeve të matshme në hartë dhe si pasojë e politikave të zhvillimit të Bashkisë, ndryshime të kategorisë së resursit të tokës mund të ndodhin në vijim të zbatimit të planit në rastet kur parashikohet konsolidim i zonës së banuar në tokë bujqësore/natyrore (edhe pse në parametra shumë të ulët), ose ndërtim për qëllime bujqësore në tokë bujqësore. Këto raste nuk mund të maten, pasi do të varen nga zbatueshmëria e tyre dhe nga fakti nëse legjislacioni në fuqi do të mundësojë marrjen e lejes së ndërtimit apo jo, e për rrjedhojë edhe të drejtën për ndryshimin e kategorisë së tokës (pra sistemit).

Tabela 94. Sistemet e territorit dhe treguesit përkatës

Sistemet	Treguesit	Vlera
Sistemi urban	1. Sipërfaqja e përgjithshme (ha ose km^2)	4,185 ha
	2. Gjatësia e sistemit rrugor m/banor	6.9
	3. Popullsia ekzistuese dhe e parashikuar	Ekzistuese: 208, 480 (Gjendja Civile) dhe 144, 382 (INSTAT) E propozuar: 227, 888 (Gjendja Civile) dhe 119,893 (INSTAT)
	4. Njësi banimi të parashikuara	S_n= 1,426 ha
	5. Njësi banimi të mundshme për strehim social	Nr të pastrehësh=2,665
	6. Njësi shëndetësore	Rritja e nr. të ambulancave në mënyrë që një ambulancë të shërbejë për rreth 6 mijë banorë
	7. Njësi të arsimit 9-vjeçar	6 njësi (struktura) të propozuara
	8. Njësi të arsimit të mesëm	9 njësi (struktura) të propozuara
	9. Shërbime Administrative	36 ha
	10. Detyrime në lidhje me kërkesat fetare	79 objekte
	11. Intensiteti për m^2 për ha	3,407
	12. Nr. i linjave të transportit publik urban dhe ndërurban	3 linja të propozuara
	13. Nr. i njësive strukturore	1095
	14. Sipërfaqe e gjelbër m^2/banor	82.4

	15. Sipërfaqe e hapur publike m^2/banor (përfshirë sportive)	26.4
	16. Sipërfaqe trashëgimi kulturore (ha)	15
	17. Tregues ekonomikë (ha)	512.3
	18. Sipërfaqe pronash publike (ha) dhe % ndaj sipërfaqes së përgjithshme	3.2%
	19. Sipërfaqe që konvertohet në bujqësore (m^2 ose ha)	21.3ha
	20. Sipërfaqe që konvertohet në natyrore (m^2 ose ha)	0.5ha
	21. Sipërfaqe që konvertohet në infrastrukturore (m^2 ose ha)	2.3ha
Sistemi bujqësor	1. Sipërfaqe e përgjithshme (ha)	18,300ha
	2. Sipërfaqe kryesore (Boniteti I-IV) në ha	PA
	3. Sipërfaqe dytësore (Boniteti V-X) në ha	PA
	4. Sipërfaqe ose gjatësi e sistemit të ujitjes dhe vaditjes sipas 3 kategorive	85.7 km linear
	5. Sipërfaqe tokë pa fryt (ha)	252.7ha
	6. Sipërfaqe që konvertohet në natyrore (m^2 ose ha)	14.55ha
	7. Sipërfaqe që konvertohet në urbane (m^2 ose ha)	73.6ha
	8. Sipërfaqe që konvertohet në infrastrukturore (m^2 ose ha)	40ha (vetëm rrugë) 64ha në total
Sistemi ujor	1. Sipërfaqe ujore (ha)	2,292ha
	2. Gjatësia e lumenjve kryesorë (km),	Shkumbini 39km Zaranika 15.9km Manazdere 8.5km Papër 15.8km Gostimë 9.2km Gostrimë 18.6 Kushe 16.3km
	3. Sipërfaqe akuiferesh sipas llojeve	122km Akuifer me porozitet çarje-karst, 235km Akuifer me posozitet poro-çarje, 69.7km Akuifer me porozitet ndërkokrrizor
	4. Gjatësia e vijës bregdetare (km)	PA
	5. Sipërfaqe që konvertohen, nëse është rasti	PA

Sistemi infrastrukturor	1. Sipërfaqe ose gjatësi rrugësh sipas kategorive të kodit rrugor (km linear)	A. Autostrada 37.7, B. Rrugë interurbane kryesore 24, C. Rrugë interurbane dytësore 285.8, D. Rrugë urbane kryesore 40.8, E. Rrugë urbane dytësore 60.4, F rrugë lokale 475.2
	2. Gjatësia e hekurudhës (km)	34.1
	3. Nr. portesh	PA
	4. Nr. aeroportesh	PA
	5. Njësi energjitike (nr. ose sipërfaqe ose gjatësi)	1 njësi për shfrytëzimin e energjisë gjeotermale (pusi i Kozanit-8
	6. Landfill/ Incinerator/ Zonë për kompostim (nr. ose ha)	Landfill 1 Inçenerator 1
	7. Impiant për trajtimin e ujërave të ndotura (nr. ose ha)	1
	8. Sipërfaqe ose gjatësi që konvertohet në një sistem tjetër (specifiko, nëse rasti)	PA
Sistemi natyror	1. Sipërfaqe e përgjithshme (ha ose km^2)	161,214.4ha
	2. Sipërfaqe pyjore (ha)	37, 613
	3. Sipërfaqe kullota (ha)	5, 336
	4. Sipërfaqe të matricës natyrore sipas llojeve (ha)	Sip. djerr 158 Livadh 650 Tokë me bimësi pyjore 4, 697
	5. Zona të mbrojtura sipas legjislacionit të posaçëm (nr dhe ha)	Masivi pyjor i Gjinarit 196.7 ha
	6. Sipërfaqe që konvertohet në bujqësore (m^2 ose ha)	PA
	7. Sipërfaqe që konvertohet në urbane (m^2 ose ha)	PA
	8. Sipërfaqe që konvertohet në infrastrukturore (m^2 ose ha)	98.4ha

Tabela 95. Ndryshimi i sistemeve të territorit

Sistemi territorial në gjendjen ekzistuese	Sipërfaqja që ndryshon	Qëllimi i ndryshimit të kategorisë
Sistemi Urban	**21.3ha** Sipërfaqe konvertohet në bujqësore	Zona të caktuara, siç është pjesa e ullishteve të Elbasanit kanë pësuar ndryshime duke bërë konvertime të sistemit nga bujqësorë në urban. Gjithashtu në tokat bujqësore në NJA Gjergjan, Shushicë, Shirgjar (ku janë dhe pjesa më e madhe e tokave bujqësore) vëremë tendencën e shpërhapjes së ndërtesave në tokë bujqësore. Konvertimet që bëhen nga sistem bujqësorë në sistem urban janë zona në të cilat dominon toka bujqësore dhe nuk duhet krujuar fragmentim i saj por duhet konsoliduar.
	0.5ha Sipërfaqe që konvertohet në natyrore	Vensosja e objekteve buzë brigjeve lumore në distanca shumë të afërta me lumenjtë ka bërë shpesh herë që këto ndërtesa të jenë të rrezikuara nga përmbytjet. Për të shmangur dëmin që shkaktohet gjatë përmbytjeve duhet që ndërtesat e vendosura në mënyrë të papërshtatshme të zhvendosen në zona të tjera që janë të përshtatshme për tu zhvilluar.
	2.3ha Sipërfaqe që konvertohet në infrastrukturore	Zgjerimi i rrugëve dhe ndërtimi i rrugëve të reja ofrojnë një akses më të mirë dhe lidhin zonat e banuara me njëra-tjerën. Zonat ku ndërhyhet për të krijuar një lidhje sa më optimale të infrastrukturës prek edhe zona të cilat i përkasin sistemit urban (pra me dominancë urban).
Sistemi Ujor	Sistemi ujor nuk pëson Konvertime në sisteme të tjera	
Sistemi Infrastrukturor	Sistemi infrastrukturorë nuk pëson Konvertime në sisteme të tjera	
Sistemi Bujqësor	**14.55ha** Sipërfaqe konvertohet në natyrore	Brigjet e lumenjëve janë përdorur nga banorët për të si tokë bujqësore dhe janë përdorur për kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore.
	73.7ha Sipërfaqe konvertohet në urbane	Zona të cilat kanë filluar të kenë ndërtime dhe mund të, kryesisht përgjatë rrugëve kryesore lidhëse.
	0.087ha Sipërfaqe konvertohet në Infrastrukturore	Infrastruktura që propozohet për të lidhur NjA dhe infrastruktura të

		rëndësishme Vendore dhe Kombëtare (Siç është rasti i *bypass*)
Sistemi Natyror	**0.03ha** Sipërfaqe konvertohet në Infrastrukturore	Infrastruktura që propozohet për të lidhur NjA dhe infrastruktura të rëndësishme Vendore dhe Kombëtare (Siç është rasti i *bypass*)

Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

2.1.3 Nyjet kryesore të infrastrukturave dhe hapësirave publike

Propozimet e infrastrukturës në Bashkinë e Elbasanit janë menduar në mënyrë të tillë që të integrojnë zonat të caktuara apo të krijojnë hapësira publike, të cilat janë të palidhura me funksionet e tjera në territor. Propozimi i unazës në pjesën veriperëndimore, ndikon drejtpërdrejt në intergimin e "zonës informale". Kjo zonë është ndërtuar pas lëvizjeve demografike të vitit 1990, dhe duke qenë zhvillim informal ka akses të ulët të infrastrukturave publike, hapësirave të gjelbëra dhe institucioneve arsimore. Lidhjet infrastrukturore dhe propozimet e shërbimeve përgjatë rrugëve kryesore do të ndikojnë në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për këtë zonë.

Figura 201. Propozimi i unazës në pjesën veriperëndimore



Burimi: ASIG, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Zgjidhja e nyjes së hyrjes në qytet nëpërmjet autostradës Tiranë-Elbasan dhe lidhja me ***bypass***-in, është shumë e rëndësishme për të zgjidhur dy çështje: a) të krijojë një hyrje ekskluzive dhe sa më të shkurtër me qytetin e Elbasanit; b) të lidhë autostradën Tiranë-Durrës me korridorin VIII pa shqetësuar hyrjen në Elbasan.

Figura 202. Nyja infrastrukturore në hyrje të Elbasanit



Burimi: ASIG, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Stacioni multimodal: Ndërtimi i stacionit multimodal do të përmirësojë lëvishmërinë në të gjithë territorin, duke ofruar jo vetëm hapësirën e stacionimit, por edhe duke lehtësuar alternativat e lëvizjes me mjete të ndryshme transporti. Aktualisht, zona e propozuar për stacionin është tokë bujqësore, e kthyer pjesërisht në tokë truall. Ndërtimet janë kryesisht banim, por edhe industri, ekonomi e shërbime. Stacioni do të krijojë një pol zhvillimi në zonë, do të lidhë më mirë Elbasanin me Bradasheshin, dhe do të shërbejë si barrierë mes zonës industriale dhe asaj të banimit.

Figura 203. Stacioni multimodal



Burimi: ASIG, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Zgjerimi i stacionit të trenit: Stacioni i trenit është në gjendje të degraduar dhe nuk funksion i plotë. Rigjenerimi i tij dhe rivënia në funksion janë të rëndësishëm për lëvizshmërinë e banorëve dhe përmirësimin e aksesit, sidomos në periudhën afatshkurtër. Pozicioni i tij strategjik (në qendër të qytetit) ndikon që kjo të jetë një nyje e rëndësishme infrastrukturore dhe të mbetet e tillë edhe në periudhën afatgjatë, kur do të jetë ndërtuar stacioni multimodal. Për të ofruar një shërbim sa më të mirë për banorët duhet që përveç rizhvillimit, ky stacion të pësojë edhe një zgjerim të nevojshëm për të përballuar kërkesat për transportin e njerëzve.

Stacioni i mallrave (në Labinot Fushë): Ky stacion do të shërbejë vetëm për mallrat dhe lidhet me *bypass*-in e qytetit. Elbasani, si zonë me rëndësi ekonomike në rajon dhe si nyje lidhëse me zonën metropolitan, i ka të nevojshme investimet që ndihmojnë dhe mbështesin ekonominë lokale. Stacioni i mallrave do të ndërtohet në një zonë mjaft strategjike dhe të aksesueshme nga qyteti dhe rajoni.

Figura 204. Stacioni i mallrave, Lbinot Fushë



Burimi: ASIG, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Zonat e Gjelbra: Sipas VKM. 671, neni 86, gjelbërimi publik urban llogaritet duke përjashtuar territoret me përdorim homogjen bujqësi (B), toka natyrore (N) dhe sipërfaqe ujore (U). Zonat e gjelbëra në nivel urban përbëhen nga:

a) Gjelbërim i përgjithshëm publik: kjo kategori gjelbërimi përbëhet nga gjelbërimi masiv në parqe dhe lulishte, gjelbërimi në rrugë shëtitore, sheshe dhe brigje ujore si dhe zonat e pushimit/parqet periferike
b) Gjelbërim publik i kufizuar: përfshin të gjitha sipërfaqet e gjelbëra me përdorim publik, si dhe gjelbërimin vetjak të banesave individuale, tip vilë, pavarësisht nëse janë të bashkëngjitura apo të shkëputura. Këto zona përdoren vetëm nga përdoruesit e ndërtimit të tillë si: pacientët që përdorin hapësirën e gjelbër në një spital, klientët në një institucion, vizitorët apo banorët e ndërtesës individuale
c) Gjelbërim i veçantë: përfshin struktura dhe zona me funksione të tilla si: kopësht botanik, dhe/ose kopësht zoologjik, fidanishte dhe breza sanitarë (sipas përkufizimit në VKM nr. 671).

Tabela 96. Standardet e propozuara sipas VKM. 671, neni 86

Qendra e banuar	A) Gjelbërim i përgjithshëm publik (m²/banorë)	Gjelbërim në nivel njësie	Gjelbërim masiv në parqe & lulishte (brenda aglomeratit)	Gjelbërim në rrugë, shëtitore, sheshe, brigje ujore	Zonë pushimi/ park periferik	B) Gjelbërim publik i kufizuar (m²/banorë)	C) Gjelbërim i veçantë (m²/banorë)
Deri në 10,000 banorë	5	2.5	1	1.5	8	1/2	Standardet vlerësohen sipas manualeve të projektimit
Mbi 10,000 banorë	9	2.5	4	2.5	17	1/2	
Mbi 100,000 banorë	9	2.5	4	2.5	17	1/2	

Burimi: VKM nr. 671

Tabela 97. Bilanci i gjelbërimit publik për Bashkinë Elbasan

Zona e gjelbër	Standardi	Vlera ekzistuese		Vlera e propozuar	
	m²/banor	ha	m²/banor	ha	m²/banor
a) Gjelbërim në nivel njësie strukturore	2.5 m²/banor	1%-35%		1%-85%	
b) Gjelbërim masiv parqe e lulishte	4 m²/banor	19	1	60	3
c) Gjelbërim rrugor, sheshe, brigje ujore në zonë urbane	2.5 m²/banor	28	1.2	58	2.8
ç) a&b&c	9 m²/banor	47	2.2	118	5.8
d) Park periferik	17 m²/banor	265	12.7	441	21
dh) ç&d: Gjelbërim i Përgjithshëm Publik	26 m²/banor				
e) Fidanishte	PA	PA	PA	1800	86
ë) Zonë ripariane	PA	PA	PA	6,749	324
f) Kopësht zoologjik	PA	0	0	0	0
g) Kopësht botanik	PA	0	0	0	0
gj) Breza sanitarë, zona buferike, breza mbrojtës	PA	PA	PA	573	27
h) Pyje (pyllëzim)	PA	15,131	727	16,931	813
i) Zona të mbrojtura natyrore	PA	878	42	878	42
e-i) Gjelbërim i veçantë	PA				

Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Gjelbërimi publik i propozuar, duke marrë në konsideratë rritjen që do të pësojë popullsia deri në vititn 2030 jepet për njësi administrative sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 98. Gjelbërimi publik i llogaritur sipas rritjes së popullsisë

Qendra e banuar	Popullsia ekzistuese (2015)	Popullsia e projektuar (2030)	Popullsia e shtuar	A) Gjelbërim i përgjithshëm publik				B) Gjelbërim publik i kufizuar
				Gjelbërim në nivel njësie	Gjelbërim masiv në parqe & lulishte	Gjelbërim në rrugë, shëtitore, sheshe, brigje ujore	Zonë pushimi/park periferik	
Elbasan	127,420	137,318	9,898	343,295	549,272	343,295	2,334,406	274,636

Bradashesh	12,898	14,640	1,742	36,601	58,561	36,601	248,886	29,281
Gracen	2,642	2,999	357	7,497	2,999	4,498	23,989	2,999
Labinot Fushë	6,681	7,791	1,110	19,478	7,791	11,687	62,328	7,791
Labinot Mal	5,691	5,794	103	14,485	5,794	8,691	46,352	5,794
Shushicë	11,164	12,847	1,683	32,118	51,388	32,118	218,399	25,694
Tregan	4,555	5,177	622	12,943	5,177	7,766	41,416	5,177
Zavalinë	4,670	4,539	-131	11,348	4,539	6,809	36,312	4,539
Gjinar	2,188	6,665	4,477	16,663	6,665	9,998	53,320	6,665
Gjergjan	7,881	8,646	765	21,615	8,646	12,969	69,168	8,646
Papër	9,211	10,396	1,185	25,990	10,396	25,990	176,732	20,792
Shirgjan	10,408	11,994	1,586	29,985	47,976	29,985	203,898	23,988
Funarë	3,071	3,035	-36	7,588	3,035	4,553	24,280	3,035
BASHKIA ELBASAN	**208,480**	**227,888**	**19,408**	**569,720**	**762,239**	**534,957**	**3,539,486**	**419,036**

Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Shembuj të hapësirave të gjelbra:

Parku Rinia: Parku Rinia është një hapësirë publike me vendndodhje shumë të aksesueshme nga të banorët e qytetit dhe një nga parqet më jetëgjata në qytet. Rigjenerimi i tij dhe pajisja me elemente të ndryshme të dizanjit urban dhe peizazhistik do të përmirësojë funksionimin dhe do të ofrojë hapësirë rekreative për banorët e qytetit brenda zonës urbane.

Figura 205. Parku Rinia Elbasan



Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Parku i Krastës: Shpesh hapësirat e gjelbëra, nuk e kryejnë funksionin e tyre. Parku i Krastës është një potencial për t'u përdorur nga banorët, por në të njëjtën kohë një hapësirë natyrore që duhet të ruhet si e tillë. Parku i Krastës përcaktohet si park periferik natyror për qytetin e Elbasanit dhe gjithashtu u shërben banorëve në njësitë administrative fqinjë. Rikualifikimi i parkut brenda karakterit të tij dhe rehabilitimi mjedisor, i kthen qytetit një tregues dinjitoz të sipërfaqes së gjelbër.

Figura 206. Parku i Krastës, Elbasan



Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016


Parku i lumit Shkumbin: Lumi Shkumbin është një hapësirë shumë e rëndësishme, e cila duhet trajtuar për t'u bërë e pështatshme dhe e përdorshme si hapësirë publike e gjelbëruar.



Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Linjat e biçikletave: Transporti i gjelbërt është i rëndësishëm për t'u promovuar dhe nxitur. Ky plan parashikon shtimin e korsive të biçikletave në të gjitha akset dhe lidhjet kryesore rrugore që lidhin qytetin e Elbasanit me njësitë administrative.

Figura 207. Linjat e transportit të gjelbërt



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

2.1.4 Njësitë strukturore të territorit

Fillimisht, për të ndihmuar procesin e ndarjes së njësive strukturore, territori i bashkisë është ndarë në zona, të cilat ndjekin kufinjtë ekzistues të njësive administrative të Bashkisë Elbasan. Kjo mënyrë lehtëson manaxhimin e tyre, meqënëse zhvillimet e deritanishme kanë ndodhur në nivel bashkie dhe komunash. Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Elbasan, parashikon 13 zona: 1) Zona Elbasan; 2) Zona Bradashesh; 3) Zona Labinot Fushë; 4) Zona Labinot Mal; 5) Zona Funarë; 6) Zona Papër; 7) Zona Gracen; 8) Zona Shushicë; 9) Zona Tregan; 10) Zona Shirgjan; 11) Zona Gjergjan; 12) Zona Gjinar; 13) Zona Zavalinë.

Përcaktimi i njësive strukturore ka marrë parasysh faktin se ndarja në njësi strukturore bëhet me qëllim që të lehtësojë procedurat e zbatimit të instrumenteve të planifikimit dhe të drejtojë e kontrollojë zhvillimet që do të ndodhin në territor. Bashkia Elbasan është ndarë në 1716 njësi strukturore. Metodologjia për ndarjen e njësive strukturore është mbështetur në përcaktimet ligjore të rregullores së planifikimit të miratuar me VKM nr. 671 në vitin 2015. Referuar përcaktimeve ligjore, njësitë plotësojnë një, ose disa prej kushteve të mëposhtme:

a) Nuk kanë përdorime të papërputhshme brenda të njëjtës njësi strukturore;
b) Garantojnë kompaktësi dhe kanë njëtrajtshmëri të tipologjisë ekzistuese ose të propozuar;
c) Kanë tregues dhe kushte të njëtrajtshme të zhvillimit sipas rregullores së zhvillimit;

d) Kufizohen nga rrjet rrugor, pavarësisht nga kategoritë e rrugëve, brezat mbrojtës dhe sanitarë, linjat hekurudhore, brigjet ujore, përrenjtë, lumenjtë, apo elemente të tjera lineare e të dukshme në territor;
e) Kanë sipërfaqe jo më të vogël se 1ha;
f) Përcaktojnë zona me prioritet zhvillimi ose për realizimin e projekteve me rëndësi në nivel bashkie ose në nivel kombëtar (rasti i *bypass-it*);
g) Përcaktojnë zona me presion zhvillimi, zhvillim intensiv, zona të degraduara, zona të pazhvilluara, zona bujqësore, zona natyrore, zona historike, zona arkeologjke, zona kulturore etj. sipas rastit;

Veç këtyre kritereve janë marrë në konsideratë edhe kritere të tjera si më poshtë:

- Vijat e dukshme në hartë/fotografi ajrore të pronësisë apo të ndarjes së qartë të përdorimeve;
- Qëllimi i synuar në të ardhmen për zhvillimin në zonë;
- Ndërhyrjet përmirësuese/plotësuese infrastrukturore;
- Raporti sipërfaqe – nr. pronësish/parcelash të dukshme;
- Mënyra e ndërhyrjes në territor, e analizuar së bashku me funksionin e propozuar apo përdorimin e ardhshëm të tokës;
- Qëllimi i synuar për mbrojtjen apo konservimin e territoreve dhe elementeve territoriale të caktuara;
- Kushtëzimet ligjore sektoriale;
- Konsultat me pronarë të tokave dhe grupe të interesit në lidhje me zhvillimin e zonave të caktuara.

Llojet e ndërhyrjeve në territor janë përcaktuar për secilën njësi strukturore dhe në mjaft raste njësi gjenden më shumë se një ndërhyrje. Llojet e ndërhyrjeve bazohen në përcaktimet e ligjit të planifikimit dhe të rregullores së planifikimit (VKM nr. 671), por i përmbushin dhe tejkalojnë këto përcaktime për t`iu përshtatur sa më tepër kontekstit. Për këtë qëllim, lista e ndërhyrjeve në territor dhe përkufizimet përkatëse janë si më poshtë:

1. **Zhvillim** (*Development*): Është procesi i ndryshimit të territorit përmes ndërtimeve të reja, të shoqëruara edhe me infrastrukturat përkatëse. Në raste të veçanta, zhvillimi mund të përfshijë vetëm programin e pajisjes së zonës me infrastruktura, duke tërhequr kështu zhvilluesit për ndërtime private. Zhvillimi ka efekt në ndryshimin e çmimit të tokës dhe përgjithësisht e ngre atë.
2. **Rizhvillim** (*Redevelopment*): Është zhvillim që kryhet përsëri në një zonë e cila është zhvilluar më parë. Është procesi i ndryshimit të territorit përmes ndryshimit të ndërtimeve ekzistuese, si të formës e strukturës, ashtu edhe funksioneve dhe/ose treguesve të zhvillimit (Intensitet, Ksht, Kshr, Kshp).
3. **Rikonceptim**: Është një formë e rizhvillimit, por e fokusuar kryesisht në elemente të dizajnit urban e arkitektonik të objekteve dhe rimendim i funksioneve të objekteve ekzistuese, duke i përshtatur ato. Mund të përfshijë edhe prishje objektesh në raste të caktuara, me qëllim çlirimin e hapësirës publike, por nuk nënkupton ndërtime të reja. Mund të përmirësohen veçanërisht treguesit e rrugëve dhe të hapësirës publike. Intensiteti mund të rritet lehtësisht në ndonjë rast, si rezultat i shtesave të mundshme në lartësi, ose të mbetet i pandryshuar..


4. **Ristrukturim** (*Restructuring, Reconstruction*): Ndodh për infrastrukturat, kur janë të degraduara, dëmtuara ose shumë të vjetëruara dhe riparimi nuk është i mjaftueshëm. Veç ndërhyrjeve strukturore, mund të ndryshohen edhe parametrat e infrastrukturës në fjalë. P.sh. rruga mund të zgjerohet dhe të pajiset me elemente sigurie shtesë etj. Elementet e rrjetit të furnizimit me ujë apo të largimit të ujërave të ndotura mund të zëvendësohen dhe të ripërmasohen, si dhe i gjithë sistemi mund të zgjerohet/intensifikohet në pjesë të caktuara të tij. Kjo mënyrë ndërhyrjeje mund të përdoret për rrugët në veçanti, por edhe për zona që kanë nevojë për ndërhyrje në infrastrukturën e tyre.
5. **Rindërtim** (*Rebuild, Reconstruction*): Ndodh për ndërtesat, kur janë të degraduara, të dëmtuara, shumë të vjetëruara, ose në rastet kur pronari dëshiron të rindërtojë banesën e tij, me qëllim përmirësimin funksional e arkitektonik të saj, por pa ndryshuar treguesit e zhvillimit. Përfshin ndërhyrjet në sistemin konstruktiv.
6. **Riparim** (*Repare*): Janë punime që kanë për qëllim kthimin e një objekti në kushte të pranueshme duke bërë ripërtëritjen, zëvendësimin, apo rregullimin e pjesëve të dëmtuara ose të degraduara. Nuk përfshin ndërhyrje thelbësore në sistemin konstruktiv.
7. **Rigjenerim, Rinovim, Rijetësim, Ripërtëritje, Rivitalizim, Rikualifikim** (*Regeneration, Renewal, Revitalization, Requalification*): Është një formë rizhvillimi që ka për qëllim të risjellë në jetë apo funksion zona të caktuara të cilat e kanë humbur atë, janë degraduar fizikisht, nuk janë më tërheqëse dhe të frekuentuara, paraqesin mungesë sigurie, kanë rënie të vlerës së pronës dhe kanë nevojë për rikonceptim nga pikëpamja e dizajnit urban, arkitekturor dhe të peizazhit urban. Zona të tilla mund të jenë aktualisht në funksion, por jo cilësore dhe të vjetëruara, ose mund të jenë jashtë funksionit (si *greyfields* në qytete – p.sh. parkime apo qendra tregtare të braktisura dhe me infrastrutkurë ekzistuese, etj.). *Brownfields*, si zona industriale të braktisura apo jashtë funksionit dhe me ndotje, trajtohen përmes rehabilitimit mjedisor (si më poshtë), por paralelisht edhe me rigjenerim urban, duke pasur për qëllim rifutjen e tyre në treg dhe veprimtari të rritjes ekonomike.
8. **Rehabilitim** (*Rehabilitation*): Rehabilitimi mjedisor është rindërtimi i elementeve, apo funksioneve ekologjike, pa realizuar restaurim të plotë, kryesisht për qëllime njerëzore dhe jo natyrore. Mund të përfshijë një ose disa nga format e mëposhtme si restaurim mjedisor, rikrijime të pjesshme, reklamim dhe pastrim, zbutje efektesh ndotëse/negative etj. Është i barazvlefshëm me konceptin rigjenerim në rrafshin urban.
9. **Restaurim** (*Restoration*): Në rastin e mjedisit është manipulimi aktiv i natyrës për të rikrijuar specie të humbura. Në rastin e zonave historike, monumenteve të kulturës dhe zonave arkeologjike, është procesi i rikthimi të objektit/zonës në karakteristikat që ka pasur në të kaluarën, pra pothuajse në gjendjen origjinale, duke e riparuar, pastruar etj. – teknika të restaurimit arkitektonik dhe arkeologjik.
10. **Rikrijim** (*Recreation*): Në rastin e mjedisit janë përpjekjet për të ndërtuar një komunitet biologjik të ri, në një zonë të degraduar, ku nuk ka mbetur asgjë për të restauruar.
11. **Pastrim** *(Remediation)*: Është pastrimi i zonave nga ndotës kimikë me metoda fizike dhe biologjike me qëllim mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe krijesave të tjera.

12. **Zbutje** (*Mitigation*): Tërësia e masave të natyrave të ndryshme për të zbutur efektin negativ në mjedis dhe shëndet të një funksioni në territor.
13. **Reklamim** (*Reclamation*): Është tërësia e manipulimeve fizike, apo kimike në zona shumë të degraduara dhe të ndotura.
14. **Konsolidim, Kompaktësim** (*Consolidation*): Është një proces zhvillimi dhe rizhvillimi në të cilin konsolidohet karakteri dhe tipologjia ekzistuese e zonës (urbane ose bujqësore) dhe për këtë kryhen punime ndërtimi, rindërtimi, ristrukturimi, rigjenerimi pjesërisht, mbushjeje urbane, konservimi, pastrimi. Këto punime kombinohen në pesha të ndryshme
15. **Ngrirje** (*Development Freeze*): Është procesi i ngrirjes ose ndalimit dhe bllokimit të ndërhyrjeve zhvillimore të çdo forme në një territor të caktuar, deri në marrjen e një mase të dytë më të përshtatshme për situatën përkatëse. Kryhet në pamundësi të marrjes së masës së duhur, si rezultat i mungesës së informacionit, boshllëkut ligjor e institucional, ekzistencës së konflikteve të pazgjidhshme brenda periudhës së vendimmarrjes, proceseve të pambyllura gjyqësore, rreziqeve që mund të kanosen, të qenurit në pritje të një vendimmarrje tjetër, apo i arsyeve të tjera penguese. Në varësi të rastit, autoritetet mund të marrin masa mbrojtëse, pyllëzuese, zbutëse të rrezikut, të garantimit të mbijetesës etj., nëse popullsia apo pronat në zonë janë të rrezikuara nga ndonjë faktor specifik.
16. **Dendësim** (*Densification*): Kjo ndërhyrje propozon rritjen e dendësisë së zhvillimit të zonave urbane me dendësi të ulët, duke promovuar përdorimin më efiçient të tokës, si dhe të rrjeteve të shërbimeve dhe infrastrukturave. Dendësimi ka dy nënraste si më poshtë. Nëse të dyja nënrastet janë prezente në një zonë, atëherë përdoret thjesht termi "dendësim".
    a. **Mbushje Urbane** (*Urban Infill*): Kjo është një formë e dendësimit, ku procesi kryesor është ai i mbushjes së parcelave bosh/të pandërtuara me ndërtime të reja, me tregues zhvillimi të ngjashëm me ato që ekzistojnë në zonë. Pra treguesit në nivel zone do të rriten, por treguesit në nivel parcele mbeten të njëjtë me të parcelave që kanë ndërtime në momentin e mbushjes. Përgjithësisht ruhet karakteri apo tipologjia e ndërtimit dhe ajo urbane. Ndërhyrjet infrastrukturore janë përmirësuese, por jo thelbësore.
    b. **Intensifikim** (*Intensive development*): Kjo është një formë e dendësimit, ku procesi kryesor është ai i realizimit të ndërtimeve të larta, pra me rritje të intensitetit si në nivel zone ashtu edhe në nivel parcele, dhe/ose i rritjes së lartësisë dhe/ose gjurmës së objekteve përmes shtesave. Intenstifikimi përfshin edhe proces të mbushjes, por nuk synon të ruajë karakterin dhe tipologjinë ekzistuese në zonë. Ndryshon nga rizhvillimi, pasi nuk synon të ndryshojë funksionin e zonës dhe përgjithësisht përdoret në zona (kryesisht) banimi.
17. **Konservim, Ruajtje** (*Conservation, Preservation*): Është procesi i mbrojtjes/ruajtjes së burimeve natyrore, ekosistemeve dhe funksioneve e shërbimeve të tyre, si dhe zonave e objekteve historike/kulturore/arkeologjike, nga zhvillimet e natyrave të ndryshme dhe/ose efektet e zhvillimit në to. Procesi i konservimit/ruajtjes nuk nënkupton ngrirje, por shmangie nga aktivitete dëmtuese/ndotëse. Zonat/objektet subjekt i konservimit mund të përdoren, por në mënyrë inteligjente e duke shmangur çdo lloj aktiviteti apo ndërhyrjeje

dëmtuese/ndotëse. Masat që merren mund të përfshijnë, si vendosje të barrierave e brezave mbrojtëse, ashtu edhe disa nga mënyrat e mësipërme (së bashku ose jo), konkretisht: zbutje, rehabilitim, restaurim, reklamim, dhe riparim. Në raste të tjera, ekosistemet lihen thjesht në gjendjen natyore të tyre, duke u mbrojtur nga ndërhyrjet me karakter dëmtues/ndotës. Në rastin e zonave historike mund të përfshihen edhe procese rigjenerimi, pa ndryshuar karakterin dhe vlerat e zonës historike në përputhje me legjislacionin në fuqi.


18. **Zhvendosje** (*Relocation*): Është procesi i zhvendosjes dhe rivendosjes në një territor të ri të një funksioni të caktuar (përfshirë objektet dhe strukturat përkatëse). Zhvendosja (rialokimi) shoqërohet me prishje ose lëvizje të objekteve/strukturave dhe për rrjedhojë edhe të popullsisë që jeton në to, apo përdoruesve përkatës.
19. **Trajtim peizazhistik** (*Landscaping*): Mund të realizohet në zona urbane, natyrore dhe bujqësore. I shërben funksionit kryesor të zonës, por ka vlerë ekologjike, përpos asaj estetike. Në çdo rast, ky trajtim modifikon karakteristikat e dukshme të zonës, si paraqitjen e bimësisë dhe elementeve ujore, formave të tokës dhe trupave ujorë, efektet e motit apo mikroklimës etj. Metodat që përdoren janë: krijim i korridoreve biologjike, ripyllëzime, mbjellje bimësh në një formacion të caktuar, rehabilitim dhe restaurim mjedisor, zbutje ose eleminim i fragmentimit të matricës natyrore ose komponentëve të ekosistemit, rikrijim ose restaurim i zonave ripariane dhe brigjeve ujore në tërësi, kombinime të elementeve bimore me ato ujore dhe historike për të krijuar një mesazh apo atmosferë të caktuar etj.

Figura 208. Konsolidim (ndërhyrja e propozuar në njësi strukturore)




Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Figura 209. Dendësim, Mbushje Urbane, Intensifikim




Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Figura 210. Ristrukturim, Rizhvillim, Rehabilitim, Zhvillim, Rigjenerim



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Figura 211. Konsevrim



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Kriteret për përzgjedhjen e zonave për PDV-në janë përcaktuar në rregulloren e planifikimit të miratuar me VKM nr. 671 në vitin 2015. Këto kritere janë:

a) zhvillim dhe/ose rizhvillim, sipas parashikimeve të PPV-së;
b) ndryshim të përdorimit të tokës dhe kushteve të zhvillimit, sipas parashikimeve të PPV-së dhe drejtimeve të kësaj rregulloreje;
c) investime publike që ndikojnë në ndryshimin ose rishpërndarjen e treguesve të zhvillimit, sipas parashikimeve të PPV-së;
ç) programe të transferimit të së drejtës për zhvillim dhe të intensitetit me kushte, sipas parashikimeve të PPV-së dhe drejtimeve të neneve 30 dhe 31 të ligjit.
Veç këtyre kritereve, sipas rastit janë marrë në konsideratë edhe kriteret e mëposhtme:

- Mënyra e ndërhyrjes në territor, e analizuar së bashku me funksionin e propozuar apo përdorimin e ardhshëm të tokës;
- Raporti sipërfaqe – nr. pronësish/parcelash të dukshme;
- Lehtësia e realizimit të zhvillimit në bazë parcele përkundrejt atij në bazë zone/njësie dhe mënyra e manaxhimit të procesit;
- Prioriteti kohor i bashkisë për ndryshime/zhvillim në zonë;
- Konsultat me pronarë të tokave dhe grupe të interesit në lidhje me zhvillimin e zonave të caktuara.

Treguesit për njësitë strukturore paraqiten në Rregulloren e Planit në kapitullin 8 të saj dhe në Shtojcën 1 të saj. Treguesit e përmbledhur për zonat, përfshirë standardet minimale të planifikimit që janë përdorur gjatë hartimit të planit, paraqiten në tabelat në vijim.

Tabela 99. Treguesit sipas zonave

Zona	Elbasan Nr. 1	Labinot Fushë Nr. 2	Bradashesh Nr. 3	Labinot Mal Nr.4	Papër Nr. 5	Gracen Nr. 6	Funar Nr.7	Shushicë Nr. 8	Shirgjan Nr. 9	Gjergjan Nr.10	Tregan Nr.11	Gjinar Nr.12	Zavalin Nr.13
Sipërfaqe (ha)	2,912	4,901	5,521	10,562	10,272	5,677	7,682	10,219	1,958	2,708	5,743	8,917	10,113
Sipërfaqe banimi (ha)	567	54	141	68	82	32	31	110	124	107	41	29	40
Zona ekonomike (ha)	188	120	458	3	35	26	1	22	8	21	19	11	1
Kapaciteti mbajtës (popullsi)	220,258	32,937	72,477	27,083	32,716	12,628	12,345	43,898	49,656	42,979	16,500	11,683	16,145
Dendësi sipas kapacitetit mbajtës (banorë/ha)	75.6	6.7	13.1	2.5	3.2	2.2	1.6	4.3	25.4	15.8	2.9	1.3	1.6
Gjelbërim i zonës urbane (m^2/banor)	550,645	82,342	181,193	67,709	81,789	31,571	30,862	109,744	124,139	107,447	36,260	29,207	40,363
Parkimi maksimal i mundur (m^2)	1,321,547	197,621	434,864	162,501	19,6295	75,770	74,069	263,386	297,934	257,873	99,003	70,096	96,871
Nr. i njësive strukturore	205	130	203	98	172	67	94	195	121	99	101	153	79
Njësi banimi	56700	5400	14100	6800	8200	3200	3100	11000	12400	10700	4100	2900	4000
Dendësia njësi banimi/ha	19.5	1.1	2.5	0.6	0.8	0.6	0.4	1	6.3	1.8	0.7	0.3	0.4
Hapësira publike	53	2.6	3.8	2.4	3.2	2.6	2	2	1.4	1.4	1.8	1.4	1.2
Nr. i njësive me PDV	54	-	10	-	-	-	-	1	-	-	7	-	-
Njësi për TDZH	9	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Njësi për INK	23	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Sistem bujqësor (ha)	591.8	1095.7	3,420	1,256.4	3176.6	2,047	882.5	1,841	1,363	1815.3	1,472	1370.6	802.8
Sistem natyror (ha)	40.3	3,166.8	6,546.1	9,048.5	6,758.4	7,019.3	6,570.5	8058.7	223.6	605.2	3,974.7	12.5	8,864.8
Sistem ujor (ha)	161.2	297.3	196.8	92.9	546.8	22.5	164.5	3.4	138.2	51	68.2	49.3	104.8
Sistem urban (ha)	1,214.9	221.3	677	93.2	288.7	104.1	235.9	266.4	355.6	235.9	151.2	130.5	289
Sistem infrastruktur (ha dhe km)	210.8	123.7	180.3	82.2	218.4	83.3	64.8	148.5	82.5	79.2	73	95.6	52.3

Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Tabela 100. Standardet minimale të planifikimit për njësitë e banimit sipas VKM-së nr.671 (llogaritje sipas popullsisë që pritet të shtohet deri në vitin 2030)

Qendra e banuar	Sipërfaqe bruto banimi	Hapësirë e gjelbër	Kopësht, çerdhe, shkolla	Struktura për përdorim publik	Territor sportiv	Parkim Publik	Shërbim tregtar i kufizuar	Gjithsej
	m²\banor	m²\banor	m²\banor	m²\banor	m²\banor	m²\banor	m²\banor	m²\banor
Deri në 10,000 banorë	25	5	4	2	1.6	6	5	48.6
Mbi 10,000 banorë	25	9	4.5	2	1.6	6	5	53.1
Mbi 100,000 banorë	25	9	4.5	2	1.6	6	5	53.1

Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Tabela 101. Standarded e e zhvillimit të territorit sipas numurit të popullsisë

Qendra e banuar	Sipërfaqe bruto banimi	Hapësirë e gjelbër	Kopësht, çerdhe, shkolla	Struktura për përdorim publik	Territor sportiv	Parkim Publik	Shërbim tregtar i kufizuar	Gjithsej
	m²\banor	m²\banor	m²\banor	m²\banorë	m²\banor	m²\banor	m²\banor	m²\banor
Elbasan	3,432,950	1,235,862	617,931	274,636	219,708.8	823,908	686,590	7,291,585.8
Bradashesh dhe Gracen	440,975	158,751	79,375.5	35,278	28,222.4	105,834	88,195	936,630.9
Labinot Fushë	194,775	38,955	31,164	15,582	12,465.6	46,746	38,955	378,642.6
Labinot Mal	144,850	28,970	23,176	11,588	9,270.4	34,764	28,970	281,588.4
Shushicë	321,175	115,623	57,811.5	25,694	20,555.2	77,082	64,235	682,175.7
Tregan	129,425	25,885	20,708	10,354	8,283.2	31,062	25,885	251,602.2
Gjergjan	216,150	43,230	34,584	17,292	13,833.6	51,876	43,230	420,195.6
Gjinar dhe Zavalinë	166,625	33,325	26,660	13,330	10,664	39,990	33,325	323,919
Papër	259,900	93,564	46,782	20,792	16,633.6	62,376	51,980	552,027.6
Shirgjan	299,850	107,946	53,973	23,988	19,190.4	71,964	59,970	636,881.4
Funarë	75,875	15,175	12,140	6,070	4,856	18,210	15,175	147,501

Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN,2016

2.1.5 Parashikimi demografik dhe strehimi

- Parashikimi demografik

Bazuar mbi të dhënat e analizës së thelluar demografike, skenarët e rritjes së popullsisë paraqiten mbi bazën e popullsisë sipas INSTAT-it dhe sipas Regjistrit të Gjendjes Civile. Këto dy burime paraqesin shifra të ndryshme dhe që të dyja kanë një gradë gabimi e cila, fatkeqësisht për qëllime të planifikimit, i diferencon ndjeshëm. Në rastin e shifrave sipas INSTAT, deri në vitin 2030, rritja e popullsisë do të jetë si mëposhtë:

Shënim metodik:

Mbështetur në të dhënat e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë si dhe në "trendin" që kanë pësuar treguesit demografikë të lindshmërisë, vdekshmërisë, emigracionit dhe migracionit, INSTAT ka ndërtuar skenarët e parashikimeve për popullsinë. Bazuar në këto përllogaritje janë ndërtuar 3 skenarë të numrit të popullsisë shqiptare deri në vitin 2031, përkatësisht skenari i rritjes së ulët, (lindje të ulta, vdekshmëri e lartë, migracion i lartë) skenari i rritjes së mesme (lindshmëri, vdekshmëri dhe migracion me rritje të mesme) dhe skenari i rritjes së lartë (lindshmëri e lartë, vdekshmëri e ulët dhe migracion i ulët). Për efekt planifikimi (demografik, financiar-buxhetor) rekomandohet përdorimi i të dhënave që rezultojnë nga skenari i rritjes së mesme të popullsisë. Gjithashtu, vlen të theksohet se parashikimet për popullsinë në rastin e qarqeve janë llogaritur duke shfrytëzuar skenarin e rritjes së mesme, në periudha 5-vjeçare dhe vetëm në nivel qarku, pra nuk ka llogaritje në nivel njësie administrative. ***Mbështetur në të dhënat e popullsisë për komunat, bashkitë dhe peshën e tyre përkatëse ndaj qarkut për vitin 2011, janë përgatitur "parashikimet për popullsinë në nivel bashkie dhe njësie administrative për periudhën 2016-2031.***

Tabela 102. Popullsia e Bashkisë Elbasan sipas INSTAT, 2011-2031

Popullsia, qarku, bashkia, njësia administrative, 2011-2031	2011	2015	2016	2021	2026	2031
Bashkia Elbasan	**147,037**	**144,382**	**139,248**	**132,372**	**126,017**	**119,893**
Elbasan	81,659	80,185	77,334	73,515	69,985	66,584
Labinot Mal	5,490	5,391	5,199	4,942	4,705	4,476
Funare	2,202	2,162	2,085	1,982	1,887	1,795
Labinot Fushë	7,323	7,191	6,935	6,593	6,276	5,971
Bradashesh	11,102	10,901	10,514	9,995	9,515	9,052
Gracen	2,274	2,233	2,154	2,048	1,949	1,854
Shushicë	9,059	8,895	8,579	8,155	7,764	7,387
Papër	6,586	6,468	6,238	5,930	5,645	5,371
Shirgjan	7,581	7,445	7,180	6,825	6,498	6,182
Gjergjan	5,319	5,223	5,037	4,788	4,558	4,337
Gjinar	3,609	3,543	3,417	3,249	3,093	2,942
Tregan	3,150	3,093	2,983	2,836	2,700	2,569
Zavalin	1,683	1,653	1,594	1,515	1,442	1,372
Qarku Elbasan	**306,939**	**301,397**	**290,680**	**276,326**	**263,059**	**250,275**

Burimi: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, njësie administrative, llogaritje të autorit

Një nga faktorët që mendohet se do të vazhdojë të ndikojë në përcaktimin e stokut të numrit të popullsisë rezidente edhe në vitet e ardhshme është faktori migrim, vazhdueshmëria e të cilit për periudhën 2011-2031 argumentohet me perspektivën e një largimi të vazhdueshëm të të rinjve nga sektori bujqësor, në migrimet e studentëve që transformohen në një qëndrim

afatgjatë përtej periudhës së studimeve, si dhe në rëndësinë e normave patriarkale në krijimin e familjeve, që do të ruajë një migrim të lartë të femrave në moshë të re.

Skenarët e rritjes së popullsisë sipas Gjendjes Civile: Ndërkohë, nëse do të përllogarisim rritjen e popullsisë duke u mbështetur në të dhënat e Regjistrit të Gjendjes Civile, atëherë do të ndjekim metodologjinë e mëposhtme:

Llogarisim koefiçentin e rritjes (R) së popullsisë në Bashkinë Elbasan, duke u mbështetur në të dhënat e Gjendjes Civile:

$R=[P_n/P_0)^{1/n} -1] \times 100$ ku, R – Rritja e popullsisë
P_n – Popullsia e vitit për të cilin bëhet projeksioni
P_0 – Popullsia aktuale
n – Numri i viteve të ndërmjetme

$R_{2012\text{-}2015} = [(208{,}480/204{,}860)^{1/3} -1] \times 100$
$R_{2012\text{-}2015} = 0.6\%$
$P_{2020} = P_{2015} \times (1+R/100)^5 = 208{,}480 \times (1+0.6/100)^5 = 214{,}656$
$P_{2025} = P_{2020} \times (1+R/100)^5 = 214{,}656 \times (1+0.6/100)^5 = 221{,}173$
$P_{2030} = P_{2025} \times (1+R/100)^5 = 221{,}173 \times (1+0.6/100)^5 = 227{,}888$
$P_n=P_0 \times (1+R/100)^n$

Tabela 103. Parashikimi i popullsisë deri në vitin 2030

		Popullsia ekzistuese	Popullsia e projektuar		
		2015	2020	2025	2030
1	**Elbasan**	127,420	130,637	133,936	137,318
2	**Bradashesh**	12,898	13,453	14,034	14,641
3	**Gracen**	2,642	2,756	2,875	2,998
4	**Labinot Fushë**	6,681	7,032	7,402	7,791
5	**Labinot Mal**	5,691	5,725	5,759	5,794
6	**Shushicë**	11,164	11,700	12,260	12,847
7	**Tregan**	4,555	4,754	4,962	5,177
8	**Gjinar**	2,468	4,619	4,576	4,532
9	**Zavalin**	2,195	2,174	2,153	2,133
10	**Gjergjan**	7,881	8,128	8,383	8,646
11	**Papër**	9,211	9,590	9,985	10,396
12	**Shirgjan**	10,408	10,912	11,440	11,994
13	**Funarë**	3,071	3,059	3,047	3,035
	BASHKIA ELBASAN	**208, 480**	**214,656**	**221,173**	**227,888**

Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Llogaritjet sipas burimeve të mësipërme paraqesin tendenca shumë të ndryshme të rritjes së popullsisë. Praktikisht, sipas INSTAT, popullsia e Elbasanit do të zvogëlohet, ndërsa sipas Gjendjes Civile do të pësojë rritje. Duke pasur parasysh pasaktësitë që mbartin të dyja burimet sa i përket informacionit, sikurse edhe pasiguritë e zhvillimit në nivel kombëtar, nuk është e mundur të përzgjedhësh njërën vlerë kundrejt tjetrës. Plani hartohet duke reflektuar tendencën rritëse sipas Gjendjes Civile, por fazohet duke reflektuar tendencën zbritëse sipas INSTAT-it. Kjo mënyrë duket të jetë më realiste dhe i jep mundësi Bashkisë: i) të ketë frymëmarrje në lejimin e zhvillimit në territor; ii) të vetërregullojë politikën e saj

pas tre viteve të para dhe në vazhdim çdo tre vjet, duke rishikuar planin dhe treguesit e tij, për t'iu përshtatur realitetit. Shifra në rënie e INSTAT-it është një paralajmërim për Bashkinë që të mos synojë zhvillime shumë intensive, pasi një popullsi në rënie ndikon në rënie të tregut të tokës dhe ndërtimit. Nga ana tjetër, shifrat në rritje sipas Gjendjes Civile, sugjerojnë që Bashkia duhet të ketë njohuri të mira të kapacitetit mbajtës (popullsia maksimale që mund të shërbehet në një njësi sipas treguesve) të çdo njësie strukturore në territor, dhe të fazojë furnizimin me infrastruktura kapitale në njësitë më prioritare.

Dy çështje të tjera thelbësore që lidhen ngushtë me popullsinë janë strehimi dhe zhvendosja e popullsisë në rastet kritike të zonave ku propozohe për zhvendosje. Zhvendosja është propozuar në njësitë në të cilat janë përcaktuar si zona marrëse dhe Zonat të cilat zbatohet instrumenti i zhvillimit me kushte.

- Strehimi

Referuar informacioneve të Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës (Sektori i Strehimit), sipas disa vlerësimeve paraprake (parashikimeve), nevoja për strehim për 5-10 vjeçarin e ardhshëm rezulton se në një mesatare prej 1500-2000 familje. Këto vlerësime i referohen programeve: BSQ, BKU, Bonusit të Strehimit etj, me mbulim financiar edhe jashtë Bashkisë. Numuri i aplikuesve të pastrehë për për 5 vitet e fundit (deri në Gusht 2016) është 1757.
Aktualisht Sektori i Strehimit po zbaton programin e Banesave Sociale me Qira dhe Bonusin e Strehimit, programe të financuara nga Ministria e Zhvillimit Urban. Nga këto programe strehimi përfitojnë: [454]

- 81 përfitues nga programi Banesa Sociale me Qira
- 30 përfitues nga programi Banesa me Kosto të Ulët
- 6 përfitues nga programi Bonus Strehimi

Gjithashtu nga propozimet e mënyrave të ndërhyrjeve në territor, kapaciteti mbajtës në rritet përtej parashikimeve të popullsisë sipas INSTAT dhe Gjendjes Civile. Pasojë e kësaj rritje janë rritja e ndërtimeve për banim, pasi propozohen 159 njësi strukturore për mbushje urbane, 34 njësi strukturore për dendësim, 53 njësi strukturore për rigjenerim, 20 njësi strukturore për rizhvillim dhe 64 njësi strukturore që zhvillohen rishtazi për të akomoduar banim.

2.1.6 Instrumentet e drejtimit të zhvillimit

Përsa i përket instrumenteve të drejtimit të zhvillimit në Bashkinë Elbasan janë përdorur tre lloje instrumentash: BID, TDZH dhe INK:

BID- instrument që përdoret në zonat e zhvillimit të bizneseve; TDZH- Transferimi i të drejtës së zhvillimit; INK- Instrumenti i intensitetit të ndërtimit me kusht.

BID ose zonat e zhvillimit të Biznesit në thelb është një partneriritet publik privat me anë të të cilit pronarët e bizneseve zgjedhin të kontribuonjë financiarisht për zhvillimin mirëmbajtjen dhe promovimin e zonës. Ky instrument ndikon në mënyrë direkte në zonë si dhe rrit prerformancën ekonomike të bizneseve dhe zonës në përgjithësi.TDZH- Tranferimi i të drejtave të zhvillimit, është një teknikë e menaxhimit të përdorimit të tokës që transferon zhvillimin nga një zonë ku bashkia dëshiron të ketë më pak zhvillim tek zonat ku njësia vendore synon të ketë më shumë zhvillim , në përputhje me planin e përgjithshëm vendor të territorit (PPV)

INK-Intensiteti i ndërtimit me kushte është një instrument që i jep mundësi zhvilluesit të ndërtojë me një intesitet ndërtimi më të lartë në zona të caktuara të bashkisë me kusht që zhvilluesi të ofrojë investime publike.

Njësitë strukturore ku është caktuar që të përdoret instrumenti i BID janë njësitë e fashës ekonomike, përkatësisht fasha ekonomike përgjatë korridorit VIII (Elbasan-Papër-Rrogozhinë; Elbasan-Labinot-Fushë-Librazhd; Elbasan-Mjekës-Shirgjan-Gjergjan-Cërrik).

Njësitë strukturore ku është caktuar që të përdoret TDZH janë dy llojesh njësi strukturore marrëse dhe njësi strukturore dhënëse. Njësitë e TDZH dhënëse janë përkatësisht njësitë me kode: 1/186, 1/187, 1/66 dhe 1/114. Njësitë e TDZH marrëse janë përkatësisht njësitë me kode: 1/102, 1/92, 1/51, 1/43 dhe 1/15.

Njësitë strukturore në të cilat është vendosur të aplikohet intensiteti i ndërtimit me kusht (INK) janë njësitë me kode: 1/1, 1/58, 1/59, 1/60, 1/33, 1/38, 1/43, 1/155, 1/113, 1/27, 1/65, 1/55, 1/176, 1/50, 1/56, 1/28 kryesisht të vendosura në pjesën qëndrore të bashkisë.

2 .2 Shërbimet dhe infrastrukturat publike

2.2.1 Efektet e infrastrukturave kombëtare e rajonale

Duke iu referuar pozicioni gjeografik dhe strategjik ku shtrihet bashkia e Elbasanit, projektet Kombëtare dhe rajonale do të kenë impakt në këtë bashki. Projekti më i rëndësishëm që ka Shqipëria sipas SETTO (South- East Transport Observatory, institucion i rëndësishëm që orienton strategjitë e transportit në Ballkan, e cila unifikon prioritetet e infrastrukturës së vendeve që janë pjesë e saj në bazë të strategjive kombëtare) është Boshti Qendror Jugor.


Boshti Qendror Jugor, është një nga investimet infrastrukturore më të rëndësishme që pritet të ndërtohet në vendin tonë pas Rrugës së Kombit. Kjo infrastrukturë ndërthuret me Korridorin VIII në aksin verior me Tiranën (Autostrada A3), i cili nis nga Papëri (sipas draftit të Planit Kombëtar 2015-2030 të publikuar nga AKPT), vazhdon në drejtim të Cërrikut-Kuçovës-Beratit-Memaliajt. Në Memaliaj bëhet dhe lidhja e drejtpërdrejtë me korridorin tjetër me rëndësi ndërkombëtare, Korridori i Kaltër, i cili është një tjetër korridor ndërkombëtar që nis në Itali (Trieste) dhe vazhdon në Kroaci, Mal të Zi, në Shqipëri dhe përfundon në Kallamat të Greqisë. Boshti Qendror Jugor (Elbasan-Tepelenë) ka rëndësi të madhe sepse kjo infrastrukturë do të sjellë një lidhje më optimale ndërmjet Shqipërisë qendrore dhe jugore. Ky korridor është rreth 180 km i gjatë. Aktualisht është ndërtuar 10% dhe po planifikohet të ndërtohet edhe 15% e këtij korritori[455].

Plani i përgjithshëm kombëtar (PPK) 2015-2030 që është miratuar në Maj 2016, ka vendosur disa direktiva të rëndësishme, të cilat do të zbatohen edhe në planet e përgjithshme vendore që hartohen. Një nga elementet kryesore të Planit Kombëtar është infrastruktura dhe trasporti ne nivel kombetar dhe rajonal, që do të kenë impakt në Planin e Përgjithshëm të Bashkisë Elbasan duke parë gjurmën e Boshtit Qendror Jugor (Tiranë – Elbasan - Berat - Gjirokastër), i cili do të përforcojë lidhjen Veri – Jug të vendit. Kjo lidhje është strategjike për integrimin e Shqipërisë me korridoret europiane Qendrore. Gjithashtu do të përmirësojë lidhjet e qendrave urbane në brendësi të territorit. Për sa i përket infrastrukturës hekurudhore, PPK-ja i eshte referuar projekteve prioritare të Ministrisë së

Transportit, të cilat synojnë të rivitalizoje infrastrukturën hekurudhore ekzistuese edhe me tej, duke e lidhur vendin tonë më Maqedoninë, si edhe të lidhë portet me infrastrukturë hekurudhore.

Një tjetër investim i rëndësishëm në këtë bashki është ***Bypass-i i Elbasanit***, i cili do të jetë pjesë e korridorit VIII dhe kalon në periferinë jugore të qytetit të Elbasanit. Sipas informacioneve të marra nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, në muajin prill 2016 është nënshkruar marrëveshja, "Project Facility për studime fizibiliteti në nivel përfundimtar në sektorin e infrastrukturave", midis Ministrit dhe Ambasadorit Italian, pjesë e të cilës është studimi i fizibilitetit të *bypass*-it të Elbasanit. Plani ka konkluduar në variantin më të përshtatshëm për gjurmën e *bypass*-it, por jep disa variante për fundin e tij dhe lidhjen me rrugën ekzistuese, pasi lë Elbasanin. Studimi i fizibilitetit gjithashtu mund të ndryshojë gjurmën në varësi të përfundimeve të tij.

Figura 212. Impakti i projekteve rajonale dhe kombëtare, Bashkia Elbasan



Burimi:SEETO, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës; Përgatiti: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Transporti publik ndërqytetas (propozimi i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës): Transporti publik ndërqytetas luan një rol të rëndësishëm në mënyrën e lëvizjes (bashkëveprimit) të bashkive me njëra tjetrën. Ky lloj transporti është kompetencë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës. Në kuadër të reformës administrative-territoriale të vitit 2014, lindi nevoja për një konceptim të ri të transportit publik ndëqytetas në nivel bashkie.


Duke u bazuar në këtë reformë, rrjeti i ri i linjave është përcaktuar pasi ka kaluar procedurat e modelimit dhe të konsultimit me përfaqësuesit e bashkive respektive dhe shoqëritë që shërbejnë sot në transportin ndërqytetës. Po ashtu, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës në zbatim të ligjit të mësipërm, ka hartuar Udhëzimin "Për kriteret, rregullat

dhe dokumentacioni për lëshimin e liçencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve me autobus brenda vendit". Me udhëzimin e ri, është përcaktuar që gjithsej në të gjithë vendin do të operojnë 326 linja ndërqytetëse, nga 588 që ishin më parë[456].

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës në zbatim të ligjit nr. 10/2016, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", të ndryshuar, publikon Rrjetin e linjave ndërqytetëse, stacionet e qëndrimit dhe oraret për secilën linjë, që do të fillojnë zbatimin në 1 janar 2017. Kërkesë e rëndësishme është që bashkitë të përcaktojnë vendndodhjen e terminaleve të autobuzëve në zbatim të nenit 21/1 të ligjit nr. 10, 2016. E domosdoshme është gjithashtu që shoqëritë që do të liçencohen, të rinovojnë 20 % të flotës së tyre të autobuzëve gjatë vitit të parë liçencës, edhe gjatë 2017.

Në muajin maj të këtij viti, u prezantuan linjat e reja të transportit ndërqytetas në nivel qarku si dhe në nivel bashkie. Sipas propozimeve të bëra nga Ministria e Transporti dhe Infrastrukturës, Bashkia Elbasanit pritet të ketë lidhje të rëndësishme kryesisht me bashkitë e Tiranës, Cerrikut dhe Përrenjasit. Metodologjia e kësaj analize është bërë me anë të numrit të orareve sipas të cilëve lëviz çdo linjë në ditë . Duke u bazuar në këtë kriter, në janar të vitit 2017 pritet që në linjën Elbasan- Tiranë të nisen 24 orare në ditë. Kjo tregon rëndësinë që kanë këto dy bashki me njëra-tjetrën përsa i përket lëvizshmërisë. Bashkia e Elbasanit pritet të ketë lidhje të shpeshta edhe me bashkitë e Përrenjasit dhe të Cërrikut respektivisht nga 12 orare në ditë.

Figura 213. Transporti publik i propozuar



Burimi: Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës; Përgatiti: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Transporti publik është një nga shërbimet më të rëndësishme që ofrojnë bashkitë për të patur akses më të mirë midis vendbanimeve, sidomos me shërbimet që ndodhen në qytet e duhet të aksesohen nga të gjithë banorët e bashkisë, në një kohë të shkurtër. Ky lloj shërbimi është i rregulluar në ligjin Nr. 8308, datë 18.3.1998 , për transportet rrugore , i ndryshuar. Transporti publik rrethqytetas dhe urban është kompetencë e bashkive dhe linjat e transportit publik miratohen nga Keshilli Bashkiak me propozim të kryetarit të Bashkisë.

Përsa i përket transportit rrethqytatas, në bashkinë e Elbasanit ekzistojnë 24 linja të cilat janë të shpërndara në pjesën më të madhe të territorit. Stacioni më i rëndësishëm nga nisen pjesa më e madhe e këtyre linjave është te Namazgjaja. Ndër itineraret me më shumë fluks mund të përmendim linjat Tregan – Elbasan 15 orare (vajtje-ardhje) në ditë, linja Papër – Elbasan 20 orare si dhe Bradashesh, Metalurgjiku – Elbasan 16 orare. Ky lloj transporti shtrihet në një gjatësi 205.3 km[457] linear si dhe mbulon pjesën më të madhe të bashkisë.

Nga analizën e gjendjes ekzistuese, si dhe bazuar ne ligjin Nr.8308, për transportet rrugore, i ndryshuar, propozohet hartimi i rrjetit të linjave rrethqytetëse bazuar mbi disa kritere, si të dhënat demografike e gjeografike, gjendjen social-ekonomike, kërkesat për lëvizjen e popullatës, rrjetin rrugor dhe gjendjen e infrastrukturës rrugore. Në procesin e hartimit të rrjetit të linjave rrethqytetëse merren parasysh lidhjet ndërmjet njësive të qeverisjes vendore me qendrat e njësive administrative përbërëse dhe qendrat e njësive administrative përbërëse me fshatrat dhe fshatrat ndërmjet tyre. Ky rrjet linjash transporti miratohet çdo tre vjet dhe nuk duhet të cënojë rrjetin e linjave qytetëse dhe ndërqytetëse[458].

Në propozimet e transportit publik është bërë dhe një analizë e numrit të banorëve që përdorin transportit publik sipas INSTATit dhe projeksioneve deri në 2031. Përqindja që përdorin transportin publik është e ulët duke parë që 19 % përdorin këtë lloj shërbimi në nivel bashkie, por varion për çdo ish-njësi administrative dhe në vitet e ardhshme pritet që numri i banorëve që përdorin këtë shërbim të rritet. Në qytetin e Elbasanit pritet që transporti publik të përdoret nga mbi 40 % e banorëve të qytetit kurse në ish-njesitë administrative të variojë nga 9-39 % e popullsisë. Duke u bazuar ne linjat e transportit të propozuar supozohet që personat që do të përdorin transportin publik të rritet me 50%.

Tabela 104. Numri i banorëve që priten të përdorin transportin publik në harkun kohor 2011-2031

	Projeksioni popullsisë 2011-2031			përdomini në % sipas vitit 2011	% e propozuar për transportin publik	Nr banorëve që do të përdorin transportin publik		
	2011	2021	2031			2011	2021	2031
Bashkia Elbasan	147,037	132,372	119,893			0	0	0
Elbasan	81,659	73,515	66,584	21%	45%	17050	33082	29963
Labinot Mal	5,490	4,942	4,476	11%	16%	590	791	716
Funare	2,202	1,982	1,795	6%	9%	135	178	162
Labinot Fushë	7,323	6,593	5,971	23%	35%	1684	2308	2090
Bradashesh	11,102	9,995	9,052	18%	27%	2018	2699	2444

Gracen	2,274	2,048	1,854	4%	11%	86	225	204
Shushicë	9,059	8,155	7,387	17%	25%	1519	2039	1847
Papër	6,586	5,930	5,371	5%	10%	325	593	537
Shirgjan	7,581	6,825	6,182	26%	39%	1985	2662	2411
Gjergjan	5,319	4,788	4,337	12%	18%	636	862	781
Gjinar	3,609	3,249	2,942	5%	10%	197	325	294
Tregan	3,150	2,836	2,569	11%	16%	340	454	411
Zavalinë	1,683	1,515	1,372	14%	21%	241	318	288

Burimi: INSTAT 2011; Përgatiti: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016


Përveç bazës ligjore, një tjetër analizë e rëndësishme është hedhja e distancave të zhvillimeve nga trupi i rrugës sipas parashikimeve të Kodit Rrugor, në çdo linjë ekzistuese të transportit publik me distancë 500 m (distanca që mund të ecë një përson për në stacionin më të afërt) në mënyrë që të shihet së cilat janë zonat/vendbanimet që nuk aksesohen nga ky lloj shërbimi.

Nga analizat e kryera shihet se pjesa veri-perëndimore e Elbasanit është pak e aksesueshme (rruga e Kërrabës). Duhet theksuar që lidhja e Elbasanit me Tiranën është shumë e rëndësishme për shkak të ndërveprimit që kanë këto dy qytete më njëra tjetrën. Ndërtimi i autostradës Tiranë-Elbasan ka sjellë një lidhje akoma më të mirë midis tyre, ndërsa rrugës së Kërrabës (rruga e vjetër) i ka rënë rëndësia që ka patur përpara së të ndërtohej autostrada. Duke parë aksesin në këtë pjesë të bashkisë propozohet krijimi i një unaze e cila do të bëjë të mundur lidhjen e këtyre fshatrave me njëra-tjetrën dhe me qytetin e Elbasanit. Ndërtimi infrastrukturës rrugore përgjatë përroit të Papërit është mënyra më e mirë për t'i aksesuar këto vendbanime, duke parë relievin e vështirë ku shtrihet kjo pjesë e bashkisë. Infrastruktura rrugore që do të ndërtohet përgjatë këtij përroi do të bashkohet me rrugën nacionale të Kërrabës, ku do të formohet një unazë e cila do të sjellë akses më të mire ndërmjet vendbanimeve me njëri-tjetrin, si dhe me qytetin e Elbasanit. Në këtë unazë propozohet të ketë 4 orare në ditë që të kalojnë në përroin e Paperit sepse rruga e Kërrabës është më e rëndësishme dhe oraret që do te kalojne ne kete infrastrukture nacionale do te janë më të shpeshta.

Një tjetër itinerar i rëndësishëm që propozohet është lidhja e linjës së Mollagjeshit dhe linjës së Benës nëpërmjet vendbanimit të Cerujës. Kjo linjë e re do të krijojë një unazë që do t'i shërbejë të gjithë kësaj zone. Nga informacionet e gjendjes ekzistuese, Mollagjeshi dhe Bena kanë linja të veçanta me qytetin e Elbasanit dhe krijimi i kësaj unaze do të sjellë unifikim të linjave dhe akses më të mirë të pjesës veriore të Bashkisë. Aktualisht, linjat e Mollagjeshit dhe Benës përshkojnë një distancë 61.8, pra propozohet edhe një segment 12.5 km për të formuar unazën veriore të bashkisë. Ky itinerar do të përshkojë një distancë prej 74.3 km. Kjo është distancë e madhe, por do të ketë të paktën 10 orare për këtë unazë, nga 8 orare ekzistuese në linjat e Benës dhe Mollagjeshit.

Pjesa jugore e Bashkisë Elbasan ka akses të mirë në përgjithësi, por nga analizat e kryera, duke u bazuar në kriteret e përmendura më sipër, propozohet krijimi i lidhjes së Treganit me Shelcanin me anë të unazës e cila do te kalojë në Pobrat. Kjo unazë do të sjellë akses dhe manaxhim më efiçent të linjave që funksionojnë në këtë itinerar. Gjatësia e kësaj unaze do të jetë 40 km dhe pritet të ketë të paktën 40 orare në ditë, duke parë që linja Elbasan-Tregan ka 30 orare në ditë. Numri i lartë i orareve tregon rëndësinë që ka kjo ish-njësi administrative për Bashkinë dhe në lidhje me qytetin e Elbasanit.

Figura 214. Skema e propozuar e transportit publik në Bashkinë Elbasan



Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Transporti publik qytetas

Përsa i përket transportit qytetas propozohet që të kalojë në akset kryesore të infrastrukturës rrugore së propozuara duke u bazuar edhe në linjat e transportit rrethqytetas sepse këto linja kalojnë në qendër të qytetit dhe nuk sugjerohet që të ketë përplasje me njëra tjetrën. Një nga kriteret që duhet patur parasysh gjatë hartimit të linjave qytetase është distanca 500 m që duhet të përshkruaj në këmbë një banor i qytetit për në stacionin më të afërt. Transporti qytetas është i rëndësishëm në funksionimin normal të lëvizshmerise (mobilitetit) në qytet.

Kategoritë e kushtet teknike të sistemit rrugor sipas funksionalitetit

Seksionet e prerjeve janë bërë sipas kategorisë së funksionit të rrugës dhe jo sipas kodit rrugor. Çdo funksion i rrugë i është dhënë një kod specifik që të kuptohen nga njëri tjetri p.sh rrugë të brëndshme kanë kodin Br për tu identifikuar me seksionin e prerjeve ne cad. Ne autocad profilet janë bërë sipas rendit alfabetik p.sh Br-A ku Br është funksioni i rrugës dhe A është prerja e cila në cad gjendet me emërtimin A-A' për të treguar segmentin ku është bërë prerja. Duke parë që rendi albabetik ka nje limit shkronjash është vazhduar me dublikimin e gërmave pra Br-AA ku është po e njëjta llogjike si me lart (Br është funksioni dhe AA tregon prerjen në cad me emertimin AA-AA'). Pra seksionet e prerjeve Br-A, Br-AA dhe Br-AAA janë të ndryshme me njëra tjetrën, gjë e cila pasqyrohet në cad. Po më të njejtën llogjike janë bërë e profilet e segmenteve të tjera.

2.2.2 Lëvizja në territor

Duke iu referuar analizës së infrastrukturave publike dhe problematikave të infrastrukturës ekzistuese, në këtë seksion janë bërë propozimet e infrastrukturave, të cilat kanë për qëllim të krijojnë një skemë të plotë lëvizjeje në territorin e Bashkisë Elbasan. Infrastrukturat janë propozuar sipas funksionit që do kenë dhe standardet për ndërtimin/ rehabilitimin e tyre janë përcaktuar sipas kodit rrugor.

Sipas funksionit, rrugët e bashkisë Elbasan janë përcaktuar si më poshtë:

Bypass-i (25-26m i gjerë, por nëse do jetë bashkë me hekurudhën atëherë është 35-36m i gjerë): Për ndërtimin e bypass-it janë propozuar disa variante për arsye të impaktit që sjell kjo infrastrukturë territorin e bashkisë dhe për të shqyrtuar të gjitha variantet e mundshme të ndërtimit. *Bypass*-i do të shtrihet në pjesën jugore të lumit Shkumbin. Ky segment do të jetë pjesë e rëndësishme e korridorit VIII.

Alternativa 1: Kalon mbi landfill (me vepër arti), vazhdon më tej përgjatë lumit Shkumbin dhe nëpërmjet veprave të artit (urë) kalon në Labinot Fushë, pranë urës së Polisit.

Altërnativa 2: Kalon mbi landfill (me vepër arti), vazhdon nëpër rrugë ekzistuese deri në Mjekës, më pas ndjek topografinë duke kaluar ndërmjet dy kodrave dhe pranë rezervuarit të Kryezjarrthit duke kaluar në rrugë ekzistuese në fshatin Hajdaran. Më pas bashkohet me gjurmën e paraqitur në alternativën 1 duke vazhduar përgjatë lumit Shkumbin.

Alternativa 3: Nga rrethrrotullimi poshtë ish-Metalurgjikut, aksi kalon në krah të kombinatit metalurgjik dhe më pas vazhdon me të njëjtën gjurmë si alternativa 1.

Gjërësia e kësaj rruge shkon 22-22 m. Në rast se përgjatë këtij itenerari do të kalojë edhe hekurudha gjërësia totale mund të shkojë deri në 35m.

Unaza (12m-15m): Unaza e qytetit kalon nëpër rrugë ekzistuese dhe ndërhyrjet kryesore do të jenë zgjerim dhe rehabilitim i segmenteve të ndryshme. Gjerësia e unazës varion në 12-16 m. Për të lidhur unazën ka 2 alternativa të cilat do të realizohen në afate të ndryshme kohore. Në fazën e parë, do të realizohet segmenti rrugor që kalon përgjatë lumit të Manazderes dhe bashkohet me unazën ekzistuese. Pjesa e dytë e unazës që parashikohet të ndërtohet në një fazë të mëvonshme do të kalojë në zonën mbi shinat e trenit në krah të kodrës së Krastës së Madhe. Pavarësisht fazave të zbatimit të unazës si në këtë paragraf, në varësi të fondeve, Bashkia do të vazhdojë mirëmbajtjen në kushtet e gjerësive ekzistuese.

Rrugë kolektor (14-15m): Kjo kategori rrugësh ka për qëllim të mbledhë trafikun e qytetit dhe të krijojë një lidhje të mirë të të gjithë sistemit rrugor të bashkisë.

Rrugë ndërqytetëse: Janë infrastruktura të rëndësishme të cilat krijojnë lidhjen e qytetit të Elbasanit me zonat periferike të bashkisë dhe gjithashtu lidhin Bashiknë Elbasan me vendet e tjera të rajonit. Gjurmët që lexohen mjaft qartë në këtë skemë janë akset horizontale (lidhin Elbasanin me pjesën lindore dhe perëndimore) dhe akset Vertikale të cilat lidhin Elbasanin me Tiranën dhe Durrësin.

Rrugë kodrinore: Këto rrugë janë klasifikuar si të tilla për shkak të shtrirjes së tyre buzë kodrave të ullishteve. Qëllimi i rrugëve kodrinore është të shërbejnë si kufizuese për zhvillimet që do të ndodhin në të ardhme dhe të shmangin zhvillimet në zonat natyrore (zona e ullishteve), të cilat kanë ndodhur pjesërisht deri më sot dhe që tregojnë tendencë të rrezikshme vazhdimësie.

Akse lumore:

Aksi lumor i Zaranikës: Shtrihet përgjatë dy anëve të lumit të Zaranikës. Segmenti nga rrethrrotullimi xx deri tek lagjja xx (lagjja e Lilës) është pjesë e unazës së qytetit. Kjo rrugë do të jetë urbane kryesore, e pajisur me gjelbërim rrugor. Distancat minimale të zhvillimeve përgjatë këtij aksi, referuar kodit rrugor, duhet të jenë jo më pak se 10 m.

Aksi lumor i Manazderes: Lumi i Manazderes vazhdon ende të ketë karakter disi natyror dhe lumi gjarpëron nëpër qytet deri në bashkimin e tij me lumin Shkumbin. Projekti për rehabilitimin e këtij lumi do të ruajë natyralitetin dhe do të përmirësojë cilësinë e tij. Përgjatë gjithë lumit të Manzaderes do të kalojnë dy akse rrugore, një pjesë e të cilëve janë segment i unazës (nga rruga që vjen nga spitali deri afër kodrës së Krastës, ku bashkohet me unazën ekzistuese)

Aksi lumor i Shkumbinit (korridor këmbësorësh dhe biçikletash): Lumi Shkumbin ka shumë vlera natyrore peizazhistike të cilat mund të shfrytëzohen. Referuar propozimeve të bëra, përgjatë lumit Shkumbin do të ndërtohet infrastrukturë e nevojshme për këmbësorët dhe biçikletat, për të plotësuar këtë hapësirë publike dhe për ta bërë më të aksesueshme për banorët.

Aksi lumor i Kushes: Për të krijuar një lidhje të mirë të të gjitha vendbanimeve të vendosura përgjatë gjithë lumit Kushe, është e nevojshme të plotësohet infrastruktura dhe të përmirësohet në segmente të caktuara. Aksi përgjatë lumit Kushe është paralel me autostradën Tiranë – Elbasan. Kjo rrugë është me karakter rural dhe funksioni i saj është të lidhë fshatrat me qytetin e Elbasanit dhe të përmirësojë aksesin e banorëve ndaj shërbimeve.

Rrugë të brendshme dhe rrugë të vogla (rrugë urbane dytësore 8 m): Funksioni i këtyre rrugëve është të realizojë lidhjen e zonave urbane/rurale me rrugët kryesore. Këto rrugë 'qepin' të gjitha zonët e banuara dhe përmirësojnë lidhjen e lagjeve apo fshatrave të vegjël me njëri-tjetrin. Rrugët e brendshme dhe rrugët e vogla krijojnë akses për zona, të cilave iu mungon lidhja me rrugët kryesore dhe ndihmojnë në përmirësimin e skemës së qarkullimit.

Rrugë rurale (8 m): Këto rrugë kanë për qëllim të lidhin qytetin e Elbasanit me zonat rurale. Në raste të caktuara, kryesisht në zonat rurale që shtrihen përgjatë fushës së Shkumbinit, lidhja infrastrukturore ekziston, por në zonat më të thella malore lidhja është më e dobët dhe (rrugë të këmbësore në disa raste, të pashtruara)

Rrugë të bujqësore (4 m): Rrugët bujqësore gjenden kryesisht në zonën fushore të bashkisë. Funksioni i tyre është të krijojë akses për makinat bujqësore në tokat bujqësore të fermerëve dhe bujqëve. Këto rrugë kanë gjerësinë minimale të nevojshme për të krijuar akses nga makinat bujqësore.

Llojet e ndërhyrjeve që do të bëhen për rrugët:

a) Ndërtim i rrugës nga e para;
b) Ndërtim i segmenteve të caktuara për të bërë lidhjen e plotë të rrugës;
c) Ristrukturim dhe përmirësim i cilësisë së rrugës;
d) Zgjerim i rrugës;
e) Krijim i rrugëve për biçikleta;
f) Krijim i rrugëve për këmbësorë;
g) Mirëmbajtje e rrugëve ekzistuese

2.2.3 Furnizimi me ujë dhe ujërat e ndotura

Në këtë seksion do të trajtohen rekomandime të përgjithshme në lidhje me nevojat për rehabilitimin dhe zgjerimin e infrastrukturës e cila siguron shërbimin e furnizimit me ujë për konsum publik dhe kanalizimet e ujrave të ndotura urbane.

- **Infrastruktura e Furnizimit me Ujë**

Problemet kryesore të sektorit lidhen me mirëmenaxhimin e sistemit të furnizimit, ku zgjidhja e propozuar konsiston në instalimin e matësve individualë për çdo lidhje konsumatore. Faktor tjetër në përmirësimin e sektorit është eleminimi i të gjitha lidhjeve të paligjshme dhe të parregjistruara, kombinuar kjo me masa konkrete dhe ndërgjegjësim të popullatës mbi detyrimet financiare karshi ofrimit të këtij shërbimi.

Ngritja e një sistemi monitorimi, ku matës gjeneralë instalohen nga tubacioni kryesor të furnizimit, në dalje të rezervuarëve dhe në nënzonat e shërbimit. Kjo do t'i ofroj Ndërmarjes së Ujësjellës Kanalizime Elbasan mundësinë për të kuptuar dhe gjurmuar zonat ku uji humbet apo shpërdorohet si edhe për të adresuar përgjegjësitë.

Theksojmë se kryesore në masat që duhet të ndërmarrë Bashkia Elbasan, duhet të jetë sigurimi i linjave magjistrale, të cilat dërgojnë ujin nga pusshpimet/burimet drejt rezervuarëve e më pas drejt konsumatorëve. Në mënyrë kategorike në këto segmente nuk duhet të ketë asnjë lidhje shërbimi për klientë e konsumatorë të vegjël (*përjashtojmë rastet kur do të projektohen degëzime të cilat do të shoqërohen me projektin teknik dhe llogaritjet e detajuara hidraulike për të mos ndikuar në presionin e përgjithshëm të nevojshëm për të dërguar ujin në qëndrat kryesore të banimit*). Një objketiv tepër i rëndësishëm për ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizimeve Elbasan do të jetë ulja e humbjeve në masën e përgjithshme prej 25%, kjo mund të arrihet duke implementuar masat e sipërpërmëndura dhe si masë ndikon drejtpërdrejt në plotësimin e nevojave për një numër më të madh konsumatorësh.

Në total Bashkia Elbasan ka 17 zona të përcaktuara për furnizimin me ujë për konsum publik. Këto zona ndonëse mund të mbulojnë të gjithë shtrirjen administrative të Bashkisë, kanë mangësi lidhur me mbulimin e plotë të popullatës me shërbimin e furnizimit me ujë. Nga vrojtimi në terren dhe analizat teknike të të dhënave, në tabelën e mëposhtme konstatohet se NjA Gracen, Labinot Mal, Shushicë, Tregan, Gjinar, Zavalinë, Gjergjan, Shirgjan dhe Funarë kanë si burime edhe sitem të pamjaftueshëm për furnizimin me ujë për konsum publik. Kjo vjen si rrjedhojë e mungesës së infrastrukturës, e kombinuar edhe me disponueshmërinë ndaj burimeve ekzistuese.

Prandaj, në bazë të kërkesës për ujë, sfida në lidhje me furnizimin e zonave te planifikimit urban në Bashkinë e re dhe te zgjeruar të Elbasanit duket se ka nevojë si për burime te tjera uji njëherësh edhe për ndërhyrje për një shtimin e sitemeve dhe mire menaxhimin atyre ekzistues.

Tabela 105. Kapaciteti i burimeve të furnizmit me ujë krahasuar me kërkesën e parashikuar

Zona e furnizimit me ujë	Pop. 2015	Pop. 2030	Kapaciteti mesatar vjetor aktual i burimit te furnizimit me ujë		Kërkesa aktuale dhe e projektuar për popullsinë qe banon ne secilën zonë (m^3/ditë)		Kërkesa për ujë duke pranuar humbjet 25% (m^3/ditë)	Kërkesa ose jo për burime të reja të furnizimit me ujë (m^3/ditë)	
			l/s	m^3/ditë	2015	2030		Mjafton (+)	Munge se (-)
Elbasan	127,420	137,318	433	37,440	19,113	20,598	27,395	10,045	
Bradashesh	12,766	14,490	140	12,096	1,915	2,174	2,891	9,205	
Gracen	2,774	3,149	0	0	416	472	628		-628
LabinotFushe	6,681	7,791	55	4,752	1,002	1,169	1,554	3,198	
Labinot Mal	5,691	5,794	3	240	854	869	1,156		-916
Shushice	11,164	12,847	15	1,296	1,675	1,927	2,563		-1,267
Tregan	4,555	5,177	3	240	683	777	1,033		-793
Gjinar	4,745	4,612	5	432	712	692	920		-488
Zavalin	2,113	2,053	3	288	317	308	410		-122
Gjergjan	7,881	8,646	12	1,032	1,182	1,297	1,725		-693
Papër	9,211	10,396	112	9,672	1,382	1,559	2,074	7,598	
Shirgjan	10,408	11,994	16	1,392	1,561	1,799	2,393		-1,001
Funare	3,071	3,035	0	0	461	455	605		-605
Totali	**208,480**	**227,302**	**797**	**68,880**	**31,272**	**34,095**	**45,347**	**30,046**	**-6,513**

Burimi: PLGP/USAID dhe ValuADD 2016

Rezervuarët e ujit për konsum publik parashtrojnë një problem tjetër të përbashkët, problem i cili lidhet me mbrojtjen higjeno-sanitare e tyre. Konkretisht, të gjithë rezervuarët, krahas shpëlarjes së rregullt 2 herë në muaj duhet t'i nënshtrohen edhe mbrojtjes higjeno-santitare të udhëhequr nga Inspektoriati i Shëndetit Publik sëbashku me Ndërmarrjen UK Elbasan, ku nëpërmjet analizave dhe dezinfektimit këto rezervuarë të trajtohen dhe të çertifikohen rregullisht mbi statusin e tyre higjeno-sanitar. Në mënyrë të ngjashme duhet vepruar edhe me zonat e mbrojtjes Higjeno-Sanitare për të gjithë sitemet të cilat shfrytëzojnë pusshpime për furnizimin me ujë të pijshëm. Përkatësisht në një rreze prej 25m nga pusshpimi çdo aktivitet është i ndaluar dhe kjo do të quhet zona e mbrojtjes së rreptë. Më pas deri në një rreze prej 200m do të ndalohet aktiviteti ndërtues dhe ai bujqësor

për të eleminuar në këtë mënyrë infiltrime me potencial ndotjete të akuiferit nën shfrytëzim.

Në mënyrë të ngjashme me analizën e mësipërmeme për burimet e ujit të pijshëm, rezulton se volumet e stokimit të ujit për Elbasanin dhe NjA Bradashesh, Papër e Shirgjan janë mëse të mjaftueshme, ndërkohë që problematike shfaqet situata sërish në NjA-të Gracen, Labinot Mal, Shushicë, Tregan, Gjinar, Zavalinë, Gjergjan, Shirgjan dhe Funarë, ku kërkohet një rivlerësim për volumet e nevojshme të cilat duhet të shtohen në secilën zonë.


Tabela 106. Kërkesa për rezervuarë shtesë sipas zonave të furnizimit me ujë

Zona e furnizimit me ujë	Vëllimi aktual në zonën e furnizimit me ujë (m^3)	2030, Kërkesa ditore e projektuar për popullsinë qe banon ne secilën zone (m^3)	2030, Kërkesa mesatare ditore duke pranuar humbjet e ujit 25% (m^3)	Rregullimi "8-orësh" i vëllimit te ujit ne rezervuar (m^3)	Nevoja për rezervuare te rinj (m^3)	
					Mjafton (+)	**Mungesë (-)**
Elbasan	9,700	20,598	27,395	9,132	568	
Bradashesh	1,200	2,174	2,891	964	236	
Gracen	0	472	628	209		-209
LabinotFushe	400	1,169	1,554	518		-118
Labinot Mal	100	869	1,156	385		-285
Shushice	550	1,927	2,563	854		-304
Tregan	100	777	1,033	344		-244
Gjinar	250	692	920	307		-57
Zavaline	80	308	410	137		-57
Gjergjan	250	1,297	1,725	575		-325
Paper	1100	1,559	2,074	691	409	
Shirgjan	800	1,799	2,393	798	2	
Funare	0	455	605	202		-202
Totali	**14,530**	**34,095**	**45,347**	**15,116**	**1,216**	**-1,801**

Burimi: PLGP/USAID dhe ValuADD 2016

Sipas "Master Planit Kombëtar te Furnizimit me Ujë, Largimit dhe Trajtimit të Ujërave të Ndotur", që u miratua nga Këshilli Kombëtar i Ujit në dhjetor te vitit 2015, u bë e mundur të identifikohen projekte të veçanta që do t'u duhet të përmbushin nevojat e për furnizim me ujë në zonën e planifikimit të Bashkisë Elbasan megjithatë NjA-të Bradashesh, Gracen, Labinot Mal, Shushicë, Tregan, Gjinar, Zavalinë, Gjergjan, Shirgjan dhe Funarë nuk janë përfshirë në këtë studim ndaj kërkojnë prioritet në planifikimet që do të realizohen për këtë sektor. Mbetet detyrë e Bashkisë dhe NUK-Elbasan të studiojë situatën dhe të përpilojë kërkesat e duhura për përfshirjen e këtyre zonave në nismat e reja të hartimit të projekteve zhvillimore e infrastrukturore.

Figura 215. Harta e sistemit aktual të furnizimit me ujë dhe propozimeve të reja, Bashkia Elbasan



Burimi: PLGP/USAID dhe ValuADD 2016

Tabela 107. Përmbledhje e investimeve të nevojshme për Bashkinë Elbasan (2021-2040)

Sistemi i furnizimit me ujë	Ndërhyrja	Elementet përbërës te ndërhyrjeve me investime	Shuma	Investimi (euro)
Bogova 2 (Elbasan)	Zgjerimi i zonës së shërbimit	Rezervuar	2,896,540	2,896,540
Bogova 2 (Elbasan)	Rehabilitim	Kaptazh uji	101,440	4,939,440
		Rezervuar	1,301,850	
		Stacion pompimi	455,200	
		Matës uji me shumicë	9,570	
		Shpërndarje uji	2,365,910	
		Lidhje shërbimi te FU	705,470	
Bogova 2 (Elbasan)	Rehabilitim	Linje e transmetimit kryesor	14,746,890	14,746,890
Investimet kapitale totale				**22,582,870**

Burimi: PLGP/USAID dhe ValuADD 2016

- **Infrastruktura e Kanalizimeve të Ujrave të Ndotura Urbane**

Sot, mbi 50% e popullsisë në qytetin Elbasan është e lidhur me sistemin e grumbullimit të ujrave të ndotura urbane. Vërehet se një numër i konsiderueshëm i tubacioneve te kanalizimeve, sidomos ato që ndodhen në pjesën fundore e të sheshtë në afërsi të Lumit

Shkumbin, kanë pjerrësi të pamjaftueshme për grumbullimin dhe sidomos transportimin e duhur të ujërave të ndotur duke shkaktuar njëherësh sedimentim të ujërave të ndotur. Në rast të kushteve klimatike me shira me intensitet të konsiderueshëm, këto sedimente shkarkojnë direkt në lumë. Aktualisht sistemi i kanalizimeve funksionon mirë, pavarësisht dëmtimeve dhe pjerrësisë se pamjaftueshme të shumë tubacioneve.

Infiltrimi nëntokësor i ujërave të ndotur në zonën urbane ashtu edhe në zonën bujqësore përtej unazës jugore të qytetit paraqet rrezik serioz për ndotjen e ujërave nëntokësore. Në vijim të kësaj, kanalet e hapura përbëjnë një rrezik të konsiderueshëm për shëndetin e banoreve te këtyre zonave, godinat e banimit i kane ndërtuar pikërisht ne këto zona. Situata aktuale të kanalizimeve të Bashkisë Elbasan (në zonën e qytetit) mund të përmirësohet vetëm me anë të ndërhyrjeve themelore e shume serioze të sistemit.

Sistemi i kanalizimit te ujërave ndotur në Elbasan përbehet pjesërisht nga rrjete të kombinuara (*ujërat e kanalizimeve janë bashkë me ujërat e shiut*) dhe në disa pjesë të qytetit nga rrjete të ndara (*ujerat e kanalizimeve janë veç nga ujerat e shiut*) ku të gjitha kanalet shkarkojnë direkt në Lumin Shkumbin dhe disa në përroin e Zaranike, Mëndrakë apo përrenjt më të afërt. Sistemi është në gjendje jo të mirë, veçanërisht në ato zona ku ekzistojnë tubacione të papërfunduara si dhe aty ku për shkak të bllokimit, kanalizimet janë hapur me rrjedhje të lirë duke krijuar kështu shkarkimin e ujerave te ndotur ne sipërfaqe dhe ne disa raste duke krijuar edhe pellgje llumi shumë pranë vëndbanimeve.

Zonat e Bashkisë Elbasan të cilat nuk janë te lidhura me sistemin e kanalizimit zakonisht përdoronin gropat septike për depozitimin e ujërave te ndotura. Efekti trajtues i këtyre gropave është shume i kufizuar. Ne gropat septike një pjese e ujerave te ndotur infiltrohet duke depërtuar deri tek niveli i ujerave nëntokësore, niveli ky qe arrihet lehte përafërsisht ne thellësi 4 deri ne 5m nën nivelin e tokës sidomos në sezonin me lagështirë të konsiderueshme. Një pjese tjetër e ujerave te ndotura shkarkohen ne kanale te hapura.

Duhet parashikuar një inspektim CCTV[459] i cili do të passqyrojë gjendjen aktuale të rrjetit ekzistues të kanalizimeve. Duke analizuar kushtet e sistemit ekzistues të kanalizimit të qytetit, mund të themi se ky sistem ka nevojë për riparim apo për rindërtimin e tij nga e para. Mendohet se afërsisht 35 % e këtij sistemit ekzistues duhet ti nënshtrohet rehabilitimit. Ne rekomandojmë që të merret në studim edhe mundësia për të rindërtuar sistemin nga e para duke qënë se kostot e ndërhyrjeve për rehabilitim mund të jenë shpesh edhe më të mëdha se realizimi i një sistemi të ri. Si rezultat i relievit karakterizuar nga shpatete të pjerrëta që ka kjo Bashki, problem mbetet bllokimi nga mbetjet e ngurta të cilat shpesh bllokojnë seksionet e kryqëzimit të tubacioneve dhe në zonat e grykëderdhjeve ekzistuese.

Një nga rezultatet e masave të propozuara për zgjerimin e shërbimit në të gjithë zonat e banuara të Bashkisë Elbasan do të jetë edhe ulja e ndjeshme e numrit të gropave septike. Për rrjedhojë, kjo masë do të sjellë përmirësimin e tokës, rritjen e cilësisë se ujërave nëntokësore dhe uljen e sëmundjeve të shkaktuara si rezultat i mungesës së higjienës. Për më tepër, sistemi i ri i kanalizimeve i ndarë nga sistemi i grumbullimit të ujrave të larta do të parandalojë përmbytjet në zonat urbane dhe ato rurale si edhe do të sjell përfitime ekonomike nëse sistemi do të parashikojë rezervuarë për grumbullimin e ujrave të larta dhe përdorimin e tyre për qëllime sekondare.

Bashkia Elbasan sigurisht do duhet të ndërtojë një impiant të trajtimit të ujërave të ndotura, i cili ti shërbej pjesës më të madhe të popullsisë në qendrën urbane të Bashkisë si edhe NjA-ve të saj. Nënvizojmë se Master Plani për investimeve kombëtare për UK nuk ka parashikuar investime për ndërtimin e sistemit të grumbullimit të ujrave të ndotura dhe ndërtimin e impiantit trajtimi të ujit të ndotur për NjA-të Bradashesh-Elbasan-Labinot Fushë, Gjergjan-Papër-Shirgjan-Tregan, Shushicë, Papër, Labinot Fushë – Mal, Bradashesh, Gjergjan, Shushicë. Ndërkohë që propozimi ynë synon që Impianti i Trajtimit të Ujrave të Ndotura Urbane për Bashkinë Elbasan të synojë grumbullimin masiv të ujrave të ndotura drejt një impianti të përbashkët dhe të ndërtohet pikërisht aty ku është parashikuar, pra në zonën ku aktualisht po punohet për ndërtimin e ladnfillit të ri të Bashkisë si edhe të Incerneratorit (dampa Elbasanit). Duke qënë se kjo zonë mund të paraqesë përplasje lidhur me interesat e përdorimit të kësaj hapsire vetëm nga kompania e mbetjeve, propozojmë edhe një alternativë tjetër.

Një alternativë është mundësia për të ndërtuar ITUNU[460] është në pjesën e sipërme te grykëderdhjen se Lumit Zaranika, pranë nënstacionit elektrik. Kjo vendndodhje është larg zonës së banimit dhe nuk ka përdorim te saj për qëllime tregtare apo bujqësore. Prandaj, ky vend në dukje i përshtatshëm për ndërtimin e një impianti për trajtimin e ujërave të ndotur edhe si vendndodhje paraqitet pa disnivele me terrenin për-rreth saj. Sipërfaqja e kësaj zone të propozuar për ndërtimin e impiantit është më e vogël se ajo e zonës së parë, te sipërcituar. Duke qënë se pozicionimi gjeografik bie ndesh me dy elementë thelbësor (*distanca nga zona e banuar dhe distanca nga trupi ujor natyror) nevojitet që mbi këtë propozim të hartohet një plan i detajuar i veprimit ku të merren në konsideratë masa specifike për mbrojtjen nga shkarkimet aksidentale mbi trupin ujor, trajtimin e llumit aktiv si edhe për zbutjen e ndotjes aromatike në ajër duke pozicionuar impjantin në varësi të trëndafilit të erës si edhe uljen e efektit të ndotjes vizuale nëpërmjet krijimit të zonës buferike mbrojtëse e të veshur me vegjetacion të dëndur e të lartë).*

Deri tani Bashkia Elbasan nuk ka të përcaktuar një zonë përfundimtare të destinuar për të ndërtuar impiantin e ardhshëm në këtë Bashki.

Sigurisht do duhet të parashikohet edhe stacione të ngritjes mekanike pasi relievi nuk favorizon rrjedhje me gravitet të të gjitha zonave të Bashkisë Elbasan.

Impiantet e trajtimit i klasifikojmë kryesisht sipas nivelit të trajtimit që ofron teknologjia e instaluar.

Impianti i Trajtimi Primar: Ndryshe i quajtur si trajtim mekanik, realizon diferencimin dhe largimin e mbetjeve të ngurta të cilat pluskojnë dhe ato të cilat kanë dekantuar në fund të pondit. Kjo teknologji largon edhe llumin e formuar nga dekantimi. Megjithëse është një teknologji e cila bazohet në trajtimin mekanik, shpesh për të përshpejtuar proçesin e sedimentimit përdoren edhe kimikate.

Impiantet Mekanike reduktojnë nivelin e NBO-së[461] në ujrat e e ndotura në masën 20-30% dhe diferencojnë 50-60% të mbetjeve të ngurta në këto ujra. Kjo teknike trajtimi në përgjithësi përdoret si fazë fillestare e trajtimit të ujrave ku më pas mund të investohet për rritjen e efikasitet të trajtimit të ujrave me anë të metodave më të specializuara.


Impianti Trajtimi Dytësor (sekondar): Këto tipe impiantesh ofrojnë trajtim bilogjik të ujrave të ndotura urbane. Konkretisht ato arrijnë që nëpërmjet mikroorganizmave të

konsumojnë të gjithë lëndën organike (ndotëse) të tretur në këto ujra. Ky proçes biologjik i shoqëruar edhe me pondet e dekantimit realizon largimin e më tepër se 85% të mbetjeve inorganike ndërkohë që reduktimi i NBO do të realizohen nëpërmjet proçeseve me llum aktiv, sistemet ligatinore, filtra me pikim apo teknikave më bashkëkohore të cilat realizojnë shpërbërjen e lëndës ndotëse organike.

Impianti i Trajtimit Terciar: Në këto impiante krahas përfshirjes së dy sistemeve të mësipërme kemi integrimin e proçeseve kimike të specializuara dhe të mbyllura në të cilën realizohet pastrimi i ujrave të ndotura urbane duke larguar më tepër se 99% të masës ndotëse. Teknologjia e përdorur në këto impiante është mjaft e shtrenjtë qoftë për fazën e instalimit si edhe të mirmbajtjes së tyre, sidomos impiantet të cilat trajtojnë fosforin dhe azotin e tretur.

Vlen të theksohet se për dy tipet e fundit të impianteve, kostot e ndërtimit si edhe ato operimit janë relativisht të larta. Ndikimi në zbutjen konkrete të kostove mund të adresohet tek kostot operacionale ku në rast se sasia e përgjithshme e ujrave të ndotura që do të hyj në trajtim do të reduktohet rrjedhimisht ndikimi do të shfaqet edhe në koston e përgjithshme të trajtimit. Ndaj propozojmë që sistemi i grumbullimit të ujrave të ndotura urbane medoemos të diferencohet nga grumbullimi i ujrave të larta në mënyrë që sasia totale që do të dërgohet në impiant të reduktohet për tu reflektuar kështu edhe në kostot finale. Gjithashtu ky propozim ofron edhe përfitime të tjera duke konsideruar se ujrat e larta (të shiut) mund të depozitohen dhe të përdoren për qëllime dytësore të Bashkisë Elbasan (larje, vaditje, zjarrfikse etj.)

Figura 216. Harta e sistemit të shërbimit me kanlaizime dhe propozimeve të reja, Bashkia Elbasan



Burimi: PLGP/USAID dhe ValuADD 2016.

Propozimi konkret për Bashkinë Elbasan do të ishte që të synohet ndërtimi i një Impianti Trajtimi Dytësor, pra një teknologji trajtimi me llum aktiv. Të synohet që pjesa më e madhe e NjA të dërgojnë ujrat e ndotura në një impiant të përbashkët dhe në rast se nga studimet e detajuar kjo mundësi nuk është e favorshme për shkak të kostove ekonomike atherë referuar propozimeve në Master plani Kombëtrar i Furnizimit me Ujë dh Trjatimit të Ujrave të ndotura si edhe nga propozimet konkrete referuar nga ValueADD të përdoren pozicionet e parashikaura në dokumentin e tyre. Këto investime konkretisht do të ishin:

Tabela 108. Investimet e parashikuara për ITUNU, Bashkinë Elbasan (2016-2040)

Nr.	Njësia vendore që i shërbehet	Popullsia e shërbyer	Niveli i trajtimit	Teknologjia e trajtimit	Faza e investimit	Kosto e investimit (EUR)
1	Bradashesh, Elbasan, Labinot Fushë	100,709	Primare	Llum aktiv	Afatshkurtër	10,018,930
2	Gjergjan, Papër,	23,007	Primare	Llum aktiv	Afatmesëm	3,374,340

	Shirgjan, Tregjan					
3	Shushicë	1,943	Primare	Ponde anaerobike	Afatmesëm	445,050
4	Papër	2,638	Primare	Ponde anaerobik	Afatgjatë	298,030
5	Labinot Fushë, Labinot Mal	2,879	Primare	Ponde anaerobik	Afatgjatë	208,880
6	Bradashesh		Primare	Shtretër me filtër e bimësi	Afatgjatë	147,600
7	Gjergjan		Primare	Shtretër me filtër e bimësi	Afatgjatë	277,000
8	Shushicë		Primare	Shtretër me filtër e bimësi	Afatgjatë	135,400
Kosto totale e investimeve për impiante te trajtimit të ujërave të ndotur						**14,905,230**

Burimi: PLGP/USAID dhe ValuADD 2016

2.2.4 Ndriçimi i mjediseve publike

Siç është evidentuar edhe në analizën e ndriçimit të mjediseve publike, pas reformës territoriale bashkia ka sfidën e ofrimit të shërbimeve publike në të gjithë territorin që ka nën administrim. Sipas statistikave të llogaritura ka 247 akse rrugore të ndriçuara (88km), pjesa më e madhe e të cilave janë në qytetin e Elbasanit dhe 9 hapësira publike (ndër të cilat 5 sheshe dhe 4 lulishte). Shërbimi i ndriçimit të mjediseve publike duhet të ofrohet në të gjitha rrugët e reja që do të shtohen në bashkinë Elbasan dhe hapësirat publike (sheshe dhe lulishtet).

Rrugët që duhet të kenë ndriçim publik janë:

- *Bypass-i*, i cili do të jetë një nga rrugët kryesore lidhëse. Kjo rrugë ka një gjatësi përafërsisht 40km e cila do të jetë e ndriçuar;
- Rrugët ndërqytetëse (të cilat kanë probleme me ndriçimin publik aktualisht);
- Rrugët urbane dytësore që lidhin qytetin e Elbasanit me qendrat e njësive administrative;
- Rrugët kolektor të shtuara dhe ato ekzistuese në të cilat mungon ndriçimi aktualisht;
- Akset lumore në pjesën që propozohen të ndërtohen dhe në segmentet ku mungon ndriçimi (4 akse lumore);
- Unaza është pjesërisht e ndriçuar, por duhet plotësuar me ndriçim rrugor në pjesën që mungon dhe në segmentet që do të ndërtohen;
- Ofrimi i ndriçimit në Parkun "Rinia", i cili është një nga lulishtet më të frekuentuara të qytetit;
- Ndriçimi i parkut të Krastës, që do të kthehet në hapësirë rekreative;
- Ndriçimi i qendrës rekreative që propozohet pranë stacionit të hekurudhës;
- Ndriçimi i qendrës rekreative që propozohet ndërmjet rrugëve "Sul Misiri" dhe "28 Nëntori";
- Ndriçimi i stacionit hekurudhor, në të cilin mungon ndriçimi;

- Ofrimi i ndriçimit në qendrat tregtare/tregjet ekzistuese dhe ato që propozohen të shtohen;
- Ofrimi i ndriçimit në të gjitha qendrat e njësive administrative;
- Ndriçimi i Parkut të Shkumbinit.

2.2.5 Mbetjet e ngurta

Në mbështjetje të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011"Për Mbrojtjen e Mjedisit" si edhe ligjit nr. ligjit nr.10463, datë 22.9.2011 "Për Manaxhimin e Integruar të Mbetjeve në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), i ngarkon Bashkitë për të hartuar e më pas për të zbatuar "Planin Lokal të Manaxhimit të Mbetjeve".
Referuar Strategjisë Kombëtare të Manaxhimit të Mbetjeve dhe Planit Kombëtar të Manaxhimit të mbetjve miratuar me VKM nr. 175 datë 19.1.2011: Bashkia Elbasan, Cërrik, Belsh, Peqin, Gramsh, Librazhd, Përrenjas trajtohen si Zona 7 e Mbetjeve. Elbasani në planin kombëtar është përcaktuar si zonë strategjike e mbetjeve[462], prej nga rrjedh edhe përgjegjësia e detyrimi i arritjes së objektivave madhore të Planit Kombëtar ,si edhe i lind e drejta të hartojë planin rajonal të manaxhimit të mbetjeve[463].
Shërbimi i manaxhimit të integruar të mbetjeve në Bashkinë Elbasan duhet ta shtrijë infrastrukturën e tij në të gjithë territorin dhe të nisë me grumbullimin e diferencuar të mbetjeve që në pikat e grumbullimit. Propozohet që të hartohet një përditësim i planit lokal të manaxhimit të integruar të mbetjeve për Bashkinë Elbasan, plan i cili do të konsistojë në:

- Vlerësim të sasisë totale dhe mercologjisë së mbetjeve.
- Zbatim të skemave të Reduktimit, Riciklimit dhe Ripërdorimit të mbetjeve. Vlerësim të potencialit të riciklimit, me synim riciklim të 50% të mbetjeve të riciklueshme.
- Organizim të shërbimeve dhe operacioneve të Manaxhimit të Mbetjeve për mbulimin e të gjithë NjA-ve të Bashkisë Elbasan për një periudhë 15-20-vjeçare.
- Rehabilitim dhe ristrukturim i vend-depozitimeve ekzistuese.
- Ndërtim i një *landfill*-i rajonal si edhe mundësia e ndërtimit të një incineratori për asgjësimin e plotë të mbetjeve. Të gjitha të shoqëruara me projektin teknik dhe vlerësimin përkatës mjedisor. Të përfshihen gjithnjë dy ose më tepër alternativa ku të përzgjidhet me parimin "Opsioni më i Mirë i Zbatueshëm Mjedisor" OZM.
- Ofrim i shërbimit të riciklimit dhe rikuperimit të mbetjeve.
- Sisteme grumbullimi dhe transportimi të mbetjeve.
- Trajtim i mbetjeve.
- Organizim i *landfill*-it.
- Mbetje inerte & të rrezikshme, trajtimi i tyre.
- Mirëmbajtje.

Parashikohet që afati maksimal për ndërtimin e *landfill*-eve rajonale dhe vend-depozitimeve për mbetjet inerte dhe ato të rrezikshme (jo-urbane) të jetë fundi vitit 2020, i cili përkon edhe me afatin e vendosur për mbylljen dhe rehabilitimin e të gjithë vend-depozitimeve jashtë kushteve teknike e çdo kriteri higjieno-sanitar. Duke qenë se në Bashkinë Elbasan ndërtimi i landfillit po ecën me ritme mjaft të mira, objektivi i lartpërmendur është mëse i realizueshëm.
Ndërhyrje e menjëhershme nevojitet të parashikohet mbi rehabilitimin e vend-depozitimit të mbetjeve në zonën e varrezave pranë Lumit Shkumbin. Një plan & projekt i detajuar

inxhinierik duhet hartuar fillimisht për parandalimin e shkarkimeve të shllameve, emetimeve të gazta dhe të vetë mbetjeve të ngurta mbi trupin ujor gjatë rehabilitimit të vend-depozitimit. Sa i përket fazës aktuale ku po realizohet largimi i mbetjeve duhet të tregohet vëmendje ndaj çlirimit të gazrave të kompostit në atmosferë.

Masat konkrete:

I. Rehabilitim *in-situ* duke izoluar tabanin dhe të gjithë perimetrin e vend-depozitimit.

II. Zhvendosja e të gjitha mbetjeve të grumbulluara ndër vite për në vend-depozitimin e ri në landfill ose në një Pikë Transferimi[464] të përkohshme e më pas rehabilitimi i zonës që përdoret sot si vend-depozitim.

Duke vlerësuar distancat e largëta që kanë Nj.A Gracen, Funarë, Labinot Mal dhe Tregan me Elbasanin ku po ndërtohet *landfilli*-i rajonal, propozojmë që të ndërtohen të paktën tre Stacione Transferimi të mbetjeve urbane. Pra duhet të studiohet mundësia për të përcaktuar nga një zonë specifike për secilën Nj.A (ose pika transferimi kufitare që u shërbejnë dy NjA-ve njëherësh), e cila do të ketë funksionin e vend-depozitimit tranzitor të mbetjeve për këto Nj.A. Në përzgjedhje duhet pasur parasysh që zona të ketë impaktin më të vogël në mjedis për sa i përket karakteristikave gjeologjiko-hidrologjike dhe mjedisit biotik të asaj zone.

Zonat potenciale, të marra si alternativë për ndërtimin e Stacioneve të Transferimit janë:

I. Zona kadastrale 1785 Bashkia Elbasan NjA Labinot Fushë, (pranë fshatit Griqan) me një sipërfaqe afërsisht 0,41ha dhe rreth 760 mmnd[465]


Koordinata referuese të kësaj zone paraqiten si më poshtë:

Tabela 109. Koordinata referuese të pozicionit alternativ për ndërtimin e landfill-it rajonal

Sistemet koordinative	Easting	Northing
ETRS89	20° 6' 35.7514"	41° 9' 35.2585"
UTM Zone 34N	425324.50	4556877.73
Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4	4425425.53	4558832.28
KRGJSH 2010 / ETRS89 Transverse Mercator	509226.69	4558325.11

Burimi: ASIG Geoportal

Figura 217. Vendndodhja e Pikës së Transferimit, propozuar për t'i shërbyer NjA-së Labinot Mal



Burimi: ASIG, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Kjo zonë e përcaktuar nuk ndodhet mbi akuiferin e Elbasanit por duke vlerësuar paraprakisht topografinë e zonës, nevojitet që të projektohet një sistemi i drenimit të ujërave të larta i cili duhet të evitojë shkarkime të mundshme në këtë landfill.

I. Zona kadastrale 3633 Bashkia Elbasan NjA Tregan, me një sipërfaqe afërsisht 0.4ha dhe rreth 2140 mmnd.

Koordinata referuese të kësaj zone paraqiten si më poshtë:

Tabela 110. Koordinata referuese të pozicionit alternativ për ndërtimin e landfill rajonal

Sistemet koordinative	Easting	Northing
ETRS89	20° 4' 35.9113"	41° 1' 42.8057"
UTM Zone 34N	422377.24	4542337.78
Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4	4422477.06	4544286.40
KRGJSH 2010 / ETRS89 Transverse Mercator	506445.51	4543747.51

Burimi: ASIG Geoportal

Figura 218. Vendndodhja e Pikës së Transferimit, propozuar për t'i shërbyer NjA-së Tregan dhe Gjergjan



Burimi: ASIG 2015, Përpunoi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Pozicioni gjeografik i këtij ST ndodhet pas banjave termale të Terganit, gjithashtu duke u pozicionuar në rrëzë të kodrave prapa banjava termale nevojitet një sistem drenimi i cili të largojë ujërat e larta nga ST-ja propozuar.

I. Rruga Zavalinë – Gjinar (në Jug të NjA Gjinar), me një sipërfaqe afërsisht 3.4ha dhe rreth 868 mmnd.

Koordinata referuese të kësaj zone paraqiten si më poshtë:

Tabela 111. Koordinata referuese të pozicionit alternativ për ndërtimin e landfillit rajonal

Sistemet koordinative	Easting	Northing
ETRS89	20° 12' 29.4875"	41° 0' 24.0714"
UTM Zone 34N	433414.08	4539801.23
Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4	4433518.40	4541748.80
KRGJSH 2010 / ETRS89 Transverse Mercator	517514.42	4541336.73

Burimi: ASIG Geoportal

Tabela 112. Pika e Transferimit propozuar për t'i shërbyer NjA Zavalin dhe Gjinar



Burimi: ASIG 2015, Përpunoi: Bashkia Elbasan & Co-PLAN, 2016

Paralelisht me masat e lartpërmendura, Bashkia Elbasan në bashkëpunim me organet e Qeverisë Qenrdore të cilat veprojnë në Elbasan, duhet të përcaktojnë një zonë specifikisht të dedikuar për mbetjet e rrezikshme industriale dhe mbetjet inerte. Ndër kriteret themeltare, të cilat duhen respektuar rreptësisht në momentin që merret një vendim për shfrytëzimin e një hapësire teritoriale në funksion të grumbullimit dhe menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme, janë: distanca me zonën më të afërt të banuar, prezenca e ujërave sipërfaqësore, prezenca e akuiferëve, trëndafili i erës, shtresat gjeologjike dhe përshkueshmëria e tokës etj.

Ndërsa mbi kriteret e përcaktimit të vendgrumbullimit të mbetjeve inerte duhen patur parasysh kombinimi i tipologjisë së relievit dhe faktorëve atmosferikë si: shpejtësia dhe intensiteti erërave, prezenca e rrjedhave ujore sipërfqësore, distanca nga zonat e banuara & qendrat turistike etj.

Nevojitet që të gjitha pikat ilegale të depozitimit të mbetjeve urbane (*dhe jo vetëm*) t'u nënshtrohen një fushate për mbylljen dhe rehabilitimin e zonave që ato kanë zënë. Me asimilimin e pikave të paligjshme të depozitimit të mbetjeve, duhet të vijojë një masë shoqëruese, e cila do të konsistojë në hartimin e një plani veprimi për pastrimin e të gjithë Bashkisë Elbasan, ku nevojitet gjithëpërfshirje e shoqërisë civile, biznesit dhe administratës publike qëndrore e lokale në mënyrë që nëpërmjet një programi 2 deri në 3-mujor, i gjithë territori i Bashkisë Elbasan të jetë inspektuar dhe pastruar nga mbetjet urbane dhe inerte. Krijimi i pikave të jashtëligjshme të depozitimit të mbetjeve mund të shërbejë si indikator i nevojës për shtrirje më efiçente të pikave të grumbullimit të mbetjeve apo nevojës për Pikë Transferimi.

Duke qenë se mbetjet mund të kthehen në burim fitimi propozojmë që skema me cikël të mbyllur të manaxhimit të mbetjeve të inkorporohen si më poshtë:

- Çdo zonë bujqësore (Nj.A në bashkëpunim me banorët dhe bashkinë) të përcaktojë hapësirën e grumbullimit dhe kompostimit të mbetjeve organike, si edhe të përpunimit të plehut organik si produkt i këtij procesi.
- Fillimisht, në qytet e më pas në të gjithë bashkinë të vendosen konteinerë të dedikuar për mbetjet organike, plastike, qelq – metal. Kjo infrastrukturë i shërben

ndarjes në burim dhe funksionimi varet nga informimi i publikut mbi mënyrën e realizimit të ndarjes dhe vlerës së saj. Pra bashkia duhet të ndërmarrë një fushatë informimi dhe edukimi qytetar mbi ndarjen e mbeturinave, riciklimin dhe ripërdorimin.

- Në landfillin e ri të parashikohet njësia e dedikuar mbi kontrollin - ndarjen dhe para-riciklimin e mbetjeve, në mënyrë që sasia e dedikuar për depozitim final të jetë e identifikuar dhe sa më e reduktuar në volum.
- Propozohet që në projektimin e *landfill*-it të ri të imponohet përfshirja e skemës së kapjes dhe përpunimit të gazit metan me qëllim prodhimin e LPG-së për përfitim ekonomik.
- Në rast të vënies në funksionim të inçerneratorit duhen monitoruar vazhdimisht nivelet e emetimeve në atmosferë, si edhe të merren masa teknike për djegien e mbetjeve në temperatura mbi 780°C.


2.2.6 Infrastrukturat sociale


- **Arsimi**

Nga analiza e arsimit sipas rrezeve të shërbimit, u evidentua që nuk ka mbulim të mjaftueshëm me shërbim në zonat e banuara. Ky shërbim ka më shumë mangësi në zonat rurale. Duke iu referuar gjithashtu rritjes së popullsisë deri në vitin 2030, nevoja për të ndërtuar struktura të reja do të rritet si më poshtë:

a) Gracen, 3 objekte
b) Funarë, 3 objekte
c) Papër, 4-5 objekte (duke marrë në konsideratë faktin nëse aksesi me infrastukturë do përmirësojë lidhjen e zonave të banueshme me njëra-tjetrën)
d) Bradashesh, 2 objekte
e) Labinot Mal 2-3 objekte (duke marrë në konsideratë faktin nëse aksesi me infrastukturë do përmirësojë lidhjen e zonave të banueshme me njëra-tjetrën)
f) Labinot Fushë, Shushicë mund të shtohen 2 objekte në secilën njësi administrative
g) Gjergjan, 3 objekte
h) Gjinar, 1 objekte
i) Zavalinë, 1-2 objekte
j) Elbasan duhet të ndërtohen objekte në rajonin 3 dhe në rajonin 1 (i cili është totalisht i pambuluar me shërbim)

Figura 219. Shpërndarja e kopshteve në Bashkinë Elbasan







Burimi: Bashkia Elbasan dhe PLGP e Co-PLAN, 2016

Zonat e banuar në Bashkinë Elbasan mbulohen relativisht mirë më shërbimin e arsimit 9-vjeçar, por cilësia e infrastrukturës në një pjesë të këtyre institucioneve është problematike. Disa prej këtyre shkollave 9-vjeçare janë bashkuar me objektet e shkollave të mesme dhe mësimi zhvillohet me turne. Në këto raste duhet që të ofrohet shërbimi sipas standardeve të përcaktuara në VKM-në nr. 671. Së pari, shkollat e mesme duhet të ndahen nga ato 9-vjeçare. Së dyti, qyteti i Elbasanit duhet të sigurojë një shërbim më të mirë të arsimit 9-vjeçar. Për shembull, në rajonin 1, 3 dhe 6 duhet të ndërtohen objekte të reja, pasi vihet re qartë se ka mungesë.

Figura 220. Shpërndarja e shkollave 9- vjeçare






Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Rrezet e shërbimit të shkollave të mesme lënë të pambuluara shumë zona të banuara. Në njësitë admnistrative Bradashesh, Shushicë, Gracen, Labinot Fushë dhe Tregan situata është shumë problematike. Për të përmirësuar shërbimin e arësimit të mesëm duhet të ndërtohen shkolla të mesme në njësitë administrative të përmendura më lart, përkatësisht:

a) Bradashesh, 2 shkolla
b) Gracen, 1 shkollë
c) Tregan, 2 shkolla (njëra prej të cilave të vendoset në kufi me Shushicën në mënyrë që një pjesë e banorëve që jetojnë në Shushicë dhe nuk kanë mbulim ta marrin shërbimin në këtë objekt)
d) Shushicë, 2 shkolla
e) Labinot Fushë, 1 shkollë

Rajoni 3 i qytetit të Elbasanit është i pambuluar me shërbim, duke qenë se kërkesa për arsim profesional është rritur, propozohet që shkolla që mund të ndërtohet në rajonin 3 të jetë shkollë profesionale (degët e studimit do të përcaktohen nga Drejtoria Arsimore Elbasan duke marrë në konsideratë nevojën që ka tregu).

Figura 221. Shpërndarja e shkollave të mesme




Burimi: Bashkia Elbasan dhe PLGP e Co-PLAN, 2016


- **Shëndetësia**

Sipas rregullores së planifikimit të miratuar me VKM nr. 671 në vitin 2015, një qendër shëndetësore duhet planifikuar për çdo 250-1500 banorë, dhe ambulancat/konsultore duhen planifikuar 1 për 1,500-2,000banorë[466]. Në qytetin e Elbasanit janë 4 qendra shëndetësore, për një popullsi mbi 80 mijë banorë. Njësitë e tjera adminsistrative kanë të paktën një qendër shëndetësore për njësi, pavarësisht numrit të popullsisë apo dendësisë së vendbanimeve. Të dhënat e llogaritura për secilën njësi administrative të Bashkisë Elbasan, tregojnë se ambulancat mbulojnë mesatarisht 6 mijë banorë në qytetin e Elbasanit dhe variojnë nga 300 deri në 1,000 për njësitë e tjera (tab.12). Megjithatë, nga analiza në terren, vërehet se shpërndarja e tyre në territor nuk është e njëjtë. Kështu për shembull, në qytetin e Elbasanit, rajonet 3, 4 dhe 5 kanë vetëm një ambulancë që mbulon mbi 20 mijë banorë të zonës. Të dhënat e grupuara sipas rajoneve, tregojnë se në qytetin e Elbasanit ka afërsisht 1 ambulancë për 11 mijë banorë[467]. Në njësitë e tjera administrative është zbatuar standardi i planifikimit të 1 ambulance për 250-1,200 banorë, por shpërndarja dhe infrastruktura e varfër e vështirësojnë aksesin në shëbimin shëndetësor.

Përgjithësisht, ambulancat dhe qendrat shëndetësore shfaqin një infrastrukturë fizike të dobët. Nevojitet ndërhyrja e mënjëhershme për rikonstruksionin e 4 ambulancave jo-funksionale, 2 në Bradashesh dhe 2 në Papër. Për më tepër, nevojitet ndërhyje dhe rikonstruksion i pjesshëm në njësitë e Gjinarit (qendra shëndetësore ka patur rikonstruksion të pjesshëm); Tregan (2 ambulanca janë në gjendje të amortizuar fizike); në Gjergjan; Shushicë (qendra shëndetësore në Qafë është komplet e amortizuar); Zavalinë etj.

Figura 222. Shpërndarja e qendra shëndetësore dhe ambulancave





Burimi: Bashkia Elbasan dhe PLGP e Co-PLAN, 2016

2.2.7 Infrastrukturat të tjera publike

- Komunikimi elektronik (nuk kemi arritur të sigurojmë informacion)
- Masa për administrimin e burimeve natyrore dhe kulturore

Lumenjt dhe brigjet e tyre kanë pësuar dëmtime dhe ujërat janë të ndotura. Për mbrojtjen e tyre duhen marrë masa për të parandaluar ndotjet e mëtejshme. Përgjatë zonës ripariane do të krijohet korridori i gjelbër i parkut të Shkumbini, Korridori i gjelbër shërben për kalime këmbësorësh dhe biçikletash si edhe për emergjenca apo shërbime në funksion të hapësirave të vogla tematike e rekreative brenda parkut. Nëse pjesa ripariane është ajo natyrore e parkut, pjesa tjetër ka karakter të pushimit aktiv, me hapësira sportive, kënde lojrash për fëmijë, kënde tematike etj. Zonat ripariane do të trjatohen në të gjithë lumenjtë e territorit të Bashkisë Elbasan duke respektuar distancat e përcaktuara në ligjin 111/2012.

Masat që merren për ruajtjen e tokës bujqësore lidhen me:

Bujqësia luan rol të rëndësishëm në ekonominë e Bashkisë Elbasan dhe është e rëndësishme të investohet për mbrojtjen e saj. Për mbrojtjen e saj duhen marrë disa masa: duhet të mbrohet toka bujqësore nga ndërtimet, zhvillimet e pakondrolluar kanë sjell zaptimin e tokës bujqësore; duhen marr masa për mbrojtjen nga erozioni duke shmangur lënien e tokës pa bimësi, duke mbuluar sipërfaqen e tokës me një shtresë të hollë copash të grimcuara bimësh ose druri nëse nuk kultivohet, nëpërmjet nxitjes së fermerëve për mbjelljen e kulturave që shërbejnë edhe për mbrojtjen e tokës dhe duke stabilizuar zonat nëndikimin e erozionit në sipërfaqe të sheshta.

Masat të tjera që merren për mbrojtjen e tokës bujqësore janë: rehabilitimi i sistemit kullues, i cili është dëmtuar dhe pastrimi i zonave nga ndoja.

Objektet e kulturës, zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës. Në Elbasan ka një numur të konsiderueëshëm objektesh kulturore, zonash të mbrojtura dhe monumente natyre. Me qëllim mbrojtjen e zonave të mbrjtura duhet të merren këto masa: Ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe materiale; mbrojtja dhe zhvillimi i qëndrueshëm i këtyre zonave; promovimi i vlerave të tyre; marrja e masave ndaj prerjes së pyjeve në zonat e mbrojtura; ndalimi i aktivitetit të guroreve; kontrolli i vazhdueshëm i zbatimit të lejes për HEC-et;

Monumentet e kulturës nuk kanë trajtimin e duhur në disa raste dhe disa prej tyre kanë pësuar dëmtime. Disa nga masat që duhen marrë në lidhje me këto pbjekte janë: ; krijimi i planeve të menaxhimit për trashëgiminë kulturore; identifikimi dhe vendosja e koodrinatave të të gjitha objekteve kulturore; krijimi i muzeut arkeologjik në një prej kullave të kalasë dhe përmirësimi i situatës së restaurimit të banesave që ndodhen në kala; saktësimi i zonave të mbrojtura të objekteve që të vizitohen si pjesë e itinerareve kulturore për të evituar dëmtimet që mund të pësojnë; vendosja e sinjalistikës se nevojshme për identifikimin e këtyrë objekteve nga tristët.

Më tepër detaje në lidhje me administrimin e burimeve natyrore e kulturore, gjenden në seksionin 2.3 të planit mjedisor dhe në masat e VSM-së, në kapitullin 6 të saj.

- Mbrojtje kombëtare, civile e kundër zjarrit

Planet dhe programet për stërvitjen dhe zhvillimin janë përpiluar nga Ministria e Brendshme në përputhje me ligjin 152/2015. Për zbatimin e detyrimeve ligjore është hartuar plani vjetor i shërbimit të Mbrojtja Nga Zjarri, i cili parashikon masa, kontrolle inspektime me afat të shkurtër dhe me shtrirje më të gjatë në kohë, të kombinuara gjithashtu me detyrat e tjera të këtij sektori.

Aktualisht sektori i Mbrojtjes nga Zjarri zotëron 5 automjete: 3 zjarrfikës, 1 autoshkallë dhë 1 autobot uji 14 ton. Mjetet nuk i plotësojnë kushtet teknike dhe janë të në gjendje të amortizuar dhe kanë nevojë për rregullime ose zëvendësime. Mungesat janë edhe në pajisje të tjera të nevojshme si: uniforma përkatëse në raste zjarri dhe emergjencash të tjera, pajisje të tjera fikëse, lëndë për mbushjen e bombolave, kompresorëve dhe aparateve të tjera ndërhyrëse.


Mbrojtja nga zjarri është një shërbim që kalon tërësisht në varësi të bashkisë, pra përfshirë mjetet e asetet dhe stacionet e MZSH-së, sipas ligjit nr. 152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin". Sipas këtij ligji, bashkitë duhet të plotësojnë infrastrukturën dhe ekipet përkatëse deri në vitin 2018. Duke analizuar gjendjen aktuale dhe mbështetur në kërkesat ligjorë sipas ligjit 152/2015 për Shërmbimin e MNZ[468], për bashkinë e Elbasan, nisur nga stadardet minimale që vendos ligji për këtë infrastrukturë, duhet që të ketë të paktën 1 zjarrfikës profesionist për 1,500-2,000 banorë dhe jo më pak se 14 profesionistë zjarrfikës për një stacion MZSH. Mbështetur në këto kërkesa ligjore në stacionin ekzistues në qytet është e nevojshme të shtohet staf prej 5 punonjësish (1 shofer dhe 4 operues zjarrfikësisht). Duke u bazuar në rritjen e popullsisë sipas Gjendjes Civile (227, 888 banorë), në bashki, duhet të jenë të paktën 114-152 zjarrfikës profesionistë dhe të paktën 8-10 stacione MZSH. Sigurisht, kjo vlerë përllogaritet me popullsinë sipas Gjendjes Civile për vitin 2030, ndërkohë që bashkia duhet të përgatitë një plan pune për të

shtuar gradualisht numrin e zjarrfikësve dhe stacioneve MZSH, të cilin mund ta rishikojë çdo tre vjet, në varësi të ndryshimeve që ndodhin në popullsi. Për shkak se shërbimi është dinamik dhe numri i punonjësve ndryshon sipas popullsisë, vendndodhja e stacioneve nuk mund të përcaktohet në këtë moment kohor, por është subjekt i zbatimit të Planit në kohë. Në çdo rast, nevojitet që të paktën 2 stacione të ndodhen në qytetin e Beratit, dhe të tjerët të shpërndahen për të muluar zonat malore".

Problem tjerët që ndikon në performancë e MNZ është infrastruktura rrugore, hapësirat e nevojshme për ruajtjen e mjeteve. Stacioni i zjarrëfiksësit nuk ka lidhje të mirë me rrugët kryesore të qytetit të Elbasanit [469].

Sipërfaqja e zonave aktuale me përdorim ushtarak, sipas inventarit të pronave publike është 7, 490, 072 m^2. Bashkia i ka evidentuar këto zona, por për shkak se ato përbëjnë informacion të klasifikuar shtetëror, bashkia nuk mund të ndërhyjë në këtë lloj infrastrukture me propozime në nivel vendor. Për momentin, në dijeni të bashkisë nuk ka zhvillime të reja për zona të tilla.

Figura 223..Vendosja e objektit të zjarrfikëses



Burimi: Bashkia Elbasan, 2016


- Energjia

Shpërndarja e energjisë në Elbasan ka nevojë për përmirësime dhe mirëmbjatje në pjesë të caktuar. Si pasojë e rrejtit elektrik tejet të amortizuar, Plani i Investimeve për vitin 2017 i miratuar nga Drjetoria Qendrore synon të rrisi efiçancën e energjisë dhe cilësisnë e tensionit. Gjithashtu synon të uli humbjet teknike në rrjet.

Masat që parashikon ky plan janë:


1. Zgjerimin e Firedirt F8 Kusarth dhe J17 Fiber
   - 10 kabina tip box
   - Gjatësi linje prej 10.6 km, tension i mesëm
   - 2 kabina të reja rikonstruksioni
   - Gjatësi 15 km linje me kabëll me vetëmbajtje ABC, tension i mesëm
2. Ndërtimin e Fiderit J18 Nst. Fiber
   - Gjatësi linje 16.3 km të tensionit të mesëm 20kv
   - 16 kabina të reja të tipit box
   - 2 kabina të reja rikonstruksion
   - Gjatësi linje të tensionit të ulët prej 24 km kabëll me vetëmbajtje ABC

Figura 224. Shpërndarja e energjisë elektrike



Burimi: Bashkia Elbasan, 2016

Figura 225. Investimet në rrjetin elektrik për vitin 2017



Burimi: Bashkia Elbasan, 2016

2.3 Plani për mbrojtjen e mjedisit

Në këtë kapitull është vlerësuar ndikimi i projekteve të PPV-së gjatë fazës së zbatimit dhe afatgjatë. Në bazë të analizës së ndikimit, ka rezultuar se projektet do të kenë kryesisht ndikim të ulët në mjedis, me disa përjashtime për projekte specifike. Ndikimi, edhe pse në shkallë të ndryshme, do të jetë kryesisht në tokë, burime ujore, pyje, ajër, biodiversitet, etj. Ndikimi parashikohet të jetë specifik për çdo projekt më vete.

Marrja e masave për mbrojtjen e mjedisit gjatë zbatimit të një projekti, dhe në rastin tonë të projekteve të PPV-së së bashkisë është kompetencë e një numri të caktuar institutesh publike dhe e zhvilluesit të projektit. Institutet publike sigurohen që për çdo projekt, zhvilluesit e projekteve parashikojnë dëmtimet e mundshme të mjedisit gjatë fazës së zbatimit dhe, përpara fillimit të zbatimiti të projektit, marrin masat teknike të nevojshme për parandalimin dhe zbutjen e tyre. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet zbatimit të Ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" i cili përcakton kushtet e zbatimit të një projekti në rrespekt me mjedisin.

Sipas Ligjit nr. 10440, projektet, përpara zbatimit do t'i nënshtrohen "procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis" ose "procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis" sipas Ligjit nr. 10440, datë 7.7. 2011,. Ky ligj zbatohet për projektet e propozuara, private apo publike, të cilat mund të shkaktojnë ndikime të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, si pasojë e madhësisë, natyrës apo vendndodhjes së tyre. Sipas nenit 4 të të njëjtit ligji, vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përcaktimin,

përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore të zbatimit apo moszbatimit të projektit. Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekur në kohën e paraqitjes së raportit përkatës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projektit. *Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin vlerësimin e ndikimit të projektit gjatë fazës së zbatimit dhe gjithashtu edhe dekontaminimin /pastrimin apo rikthimin* e zonës në gjendjen e mëparshme, funksionimin normal, ashtu edhe mundësinë për aksidente. Vlerësimi i projektit përfshin, gjithashtu, edhe propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara.

Autoriteti vendimmarrës për hartimin e VSM-së është Agjencia Kombëtare e Mjedisit e cila vendos nëse një projekt i nënshtrohet VNM-së paraprake ose duhet t'i nënshtrohet edhe procedurës së thelluar të VNM-së. Hartimi i vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM-së) të një projekti mbetet detyrë e zhvilluesit të projektit (neni 11 i Ligjit nr. 10440). Hartimi i VSM-së është proces që përfshin institucionet shtetërore (Ministrinë e Mjedisit dhe AKM-në), zhvilluesisn e projektit, pushtetin lokal ku zhvillohet projekti dhe palët e tjera të interesuara si publiku dhe organizatat jofitimprurëse, etj. Zhvilluesi, për projektet që i nënshtrohen procedurës së thelluar të VNM-së, informon dhe konsultohet me publikun e interesuar për vlerësimin e ndikimit në mjedis të veprimtarisë së tij (Neni 14 i Ligjit nr. 10440).

Një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit gjatë zbatimit të një projekti luan edhe autoriteti i planifikimit ose autoritete të tjera përgjegjëse për liçencimin e veprimtarive (zbatimin e projekteve). Ligji nr. 10440 i kërkon autoriteteve në fjalë që, përpara vendimit për dhënien e lejes së zhvillimit apo licencës përkatëse për një projekt të propozuar, të sigurohet që projekti t'i jetë nënshtruar kërkesave të këtij ligji dhe, në varësi të projektit, të jetë pajisur me vendim apo deklaratë. Vendimi apo deklarata për projektin e propozuar është i vlefshëm për aq kohë sa është e vlefshme dhe leja e zhvillimit/licenca përkatëse për projektin (Neni 20 i Ligjit nr. 10440).

Mbas marrjes së lejes për zbatimin e projektit, zhvilluesi, gjatë fazës së zbatimit të projektit, i raporton ministrisë për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë (Neni 20 i Ligjit nr. 10440).

Një vëmendje të veçantë si objekt mbrojtjeje i kushtohet zonave të mbrojtura, ose zonave veçanarisht të mbrojtura (neni 21 i Ligjit nr. 10440). Në këtë rast, dispozitat e ligjit nr. 10440 zbatohen edhe në rastet kur veprimtaria e propozuar nuk ka të bëjë drejtpërdrejt apo nuk është e nevojshme për administrimin e zonave veçanërisht të mbrojtura, por që, veçmas apo në bashkëveprim me plane dhe projekte të tjera, mund të shkaktojë efekte të rëndësishme mbi atë zonë.

Kur AKM-ja apo ministria, në përfundim të procedurës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të një projekti, shprehet se veprimtaria e propozuar, veçmas apo në bashkëveprim me veprimtari ose plane dhe projekte të tjera, të realizuara apo të propozuara, mund të ketë ndikim negativ të rëndësishëm mbi integritetin e një zone veçanërisht të mbrojtur, atëherë autoriteti përgjegjës që mbulon fushën e projektit, nuk lejon zhvillimin e tij. Bëjnë përjashtim vetë rastet kur i) nuk ka zgjidhje tjetër alternative; ii) veprimtaria e propozuar duhet të zbatohet për arsye urgjente të interesave madhorë të publikut, përfshirë edhe ata

me natyrë shoqërore apo ekonomike (arsye urgjente të interesave madhorë të publikut që merren në konsideratë, kur zona veçanërisht e mbrojtur përmban lloje habitatesh natyrore prioritare dhe/ose specie prioritare, janë vetëm ato që kanë të bëjnë me shëndetin e njeriut apo sigurinë e publikut, ose që sjellin ndikime të rëndësishme pozitive për mjedisin); iii) duhen marrë të gjitha masat kompensuese për të siguruar zbatimin e kërkesave të "Natyra 2000".

Si përfundim, mund të thuhet se masat për mbrojtjen e mjedisit gjatë fazës së zbatimit të projekteve të PPV-së përcaktohen në VNM-të përkatëse të çdo projeti. Rolin kryesor të mbrojtjes së mjedisit në këtë rast e luajnë Ministria e Mjedisit me institucionet vartëse që miratojnë VNM-të e projekteve, autoriteti i planifikimit ose autoritete të tjera përgjegjëse për licencimin e veprimtarive të cilat kërkojnë që projekti të jetë pajisur me vendim apo deklaraë mjedisore, zhvilluesit e projekteve të cilët përcaktojnë masat që merren gjatë fazës së zbatimit dhe autoritetet inspektuese gjatë fazës së zbatimit. Një rol tejet të veçantë dhe të rëndësishëm pritet që të luhet nga publiku në fazën e hartimit të VSM-ve dhe për ndërgjegjësimin e qeverisë lokale (bashkisë) për rëndësinë e respektimit të ligjit nr. 10440 gjatë fazës së zbatimit të projekteve të PPV-së dhe në të ardhmen.

2.3.1 Mbrojtja e tokës

Mbrojtja e cilësisë së tokës është detyrim ligjor për Bashkinë i cili rrjedh nga Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 26, pika 1. Ky ligj ngarkon Bashkinë me përgjegjësinë për të ofruar një mjedis cilësor për qytetarët në territorin e saj.

Gjatë analizës së thelluar të gjendjes së mjedisit në territor dhe tokës, u vu re se problematikat kryesore të tokës janë erozioni, përmbytjet dhe shkarjet e shëmbjet, të shpërndara në zonat fushore,kodrinore dhe malore, si në Funar, Gjinar, Labinot-Mal, Gracen, e Zavalinë.

Përdorimi i tokës në Bashkinë Elbasan, edhe pse është i llojeve të ndryshme (industrial, bujqësor, pyjor), nuk është i zonuar. Kjo nënkupton se ka përdorim konfliktual, si për shembull tokat e kultivuara bujqësore janë të vendosura në kufi me aktivitete industriale pa krijuar asnjë masë mbrojtëse.

Me qëllim përmirësimin e cilësisë së tokës dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve të saj, Bashkia Elbasan ka parashikuar marrjen e disa masave në Planin e Përgjithshëm Vendor i cili është në fazë miratimi. Masat për uljen e ndotësve dhe shkallës së degradimit të tokës përfshijnë rihabilitimin e sistemit ujitës-kullues, luftën kundër erozionit dhe pastrimi i tokës nga ndotja (Tabela mëposhtë).

Me qëllim mbrojtjen e tokës fenomene të rrezikut gjeologjik (erozion, përmbytje, etj.) dhe nga ndërhyrjet e njeriut, rekomandehen masat e mëposhtme për Bashkinë.

- <u>Hartimin e Planit të Mbarështrimit të Pyjeve:</u> Për fenomenin e rrëshqitjes si pasojë e shpyllëzimeve pa kriter në këtë Bashki rekomandohet të merren masa në mënyrë emergjente nëpërmjet hartimit të Planit të Mbarështrimi në mënyrë të menjëhershme. Bashkia mund të marrë masa paraprake duke mbjellë pemë dhe bimë të ndryshme në këto zona. Struktura pranë Bashkisë ndjek dhe mbikqyr punën për përmirësimin e

zonave tek të cilat ka ndodhur proçesi i rrëshqitjes, detyrim ligjor i cili i vjen nga ligji për pyjet dhe shërbimin pyjor.

Rrëshitjet/rrëzimin e gurëve: Në Bashkinë Elbasan, problemet me rrëshitjet/rrëzimin e gurëve evidentohen më tepër në zonat kodrinore dhe pyjore për pasojë të shpyllëzimit, mosmenaxhimit të tokave e pyjeve dhe ndërhyrjeve të ndryshme. Me qëllim përmirësimin e gjendjes së territorit në zona ku ndodhin këto fenomene (shih hartën në analizën e thelluar të territorit) rekomandohet të merren masa mbrojtëse për të parandaluar këtë fenomen. Ndër masat kryesore përmendim:

- Merrjen e masave mbrojtëse për rrëshqitjet e dheut nëpërmjet ndërtimit të instrumentave inxhinierikë në zonën ndërmjet *Përroit të Zaranikës e Godoleshit, afër Majës së Munellës, në Pashtresh dhe në zonën Krastë-Cakuli*. Për mbrojtjen nga rrëshqitja ndërtohen mure mbrojtëse me materiale gabioni, betoni , betoni të armuar dhe prej materiali miks (gjeotekstil me dhe, beton me ankerim)

Erozionit në zonat pyjore: Sa i përket erozionit në zonat pyjore, gjëndja paraqitet problematike si pasojë e shpyllëzimit, shfrytëzimit pa kriter dhe dëmtimit të bimësisë së ulët, në veçanti në zonën e Lumasit. Rekomandohet që Bashkia të marrë masa specifike për për ruajtjen e këtyre zonave si:

- të hartojë Planet e Mbarshtrimit të Zonave Pyjore: Zonat më problemtike ndaj këtij fenomeni shfaqen në :
    - NJA Funar, Bixellenj, Prece e Poshtme, Ceruj, Mallagjesh,
    - NJA Shushicë: Shelçan, Polis i Vogël, NJA Gjinar: Probat,
    - NJA Labinot Mal: Guri i Zi, Seticë, Labinot Mal,
    - NJA Labinot Fushë: Xibraëk, Griqan, Godolesh
- Ripërtëritje e bimësisë së ulët (ripërtëritja e nënpyllit) në ekonomitë pyjore të dëmtuara me qëllim mbulimin e tabanit të tokës)
- të marrë masa për sistemimin e shtratit të lumit Shkumbin, ndërtimit të veprave inxhinierike me karakter shuarës energjie përgjatë shtratit të lumit dhe krijimin e zonave ripariane përgjatë lumenjëve të *Zaranikës, Manazderesë, Gostimës, Papërit dhe* Kushesë dhe krijojnë probleme me përmbytjet e tokave përreth.
- Disiplinimi i rrjedhës së ujërave (përrenjëve të vegjël) në pyll: Stabilizimi i zonave pyjore nën ndikimin e erozionit në të cilat ka patur gërryerje të sipërfaqes të cilat kanë çuar në krijimin e kanaleve ujore të parregullta dhe të pakontrolluara

Erozioni në zonat kodrinore:

- Trajnimi i fermerëve për futjen e praktikave të mira bujqësore për mbrojtjen e saj nga erozioni (sipas Ligjit Nr.9244 datë 17.6.2004 "Per Mbrojtjen e Tokës Bujqësore") dhe zbatimin e masave erozive. Kjo është tejet e rëndësishme në fshatrat me njësi bujqësore malore ose mikse malore si *Zavalin, Funar, Gjinar, Labinot Mal, dhe Gracen.* Disa nga këto mënyra përfshijnë terracimin e kodrave sipas specificitetit të zonës, kultimin e kodrave me drejtim përreth kodrës dhe jo nga lart-posht e anasjelltas.
- Mbështetje financiare për fermerët që përdorin parcelat e tyre të tokës për foragjere dhe pyll duke e mbrojtur atë nga erozioni. Kjo është tejet e rëndësishme në tokat kodrinore

ose malore me pjerrësi të theksuar (*Zona e Krrabës, Zavalin, Funar, Gjinar, Labinot Mal, dhe Gracen)* që në vendin tonë kultivohen si toka bujqësore duke shkaktuar erozion.

- Ndërtimi i strukturave fizike (pritave) që kanë si qëllim drejtimin dhe ngadalësimin e shpejtësisë së rrjedhës së ujërave

Erozionit në zonat fushore: Zonat fushore të Bashkisë Elbasan përshkohen nga një rrjet i dendur sistemi ujor, që nga kanalet vaditëse dhe kulluese deri tek përrenjtë dhe lumi Shkumbin duke shkaktuar përmbytje të herëpashershme të tokave përreth në rast shirash. Si një problematikë e rëndësishme rekomandohet që:

- të merren masa për përmirësimin e sistemit ujitës dhe kullues duke i pastruar dhe duke i përmirësuar si dhe duke i rehabilituar ato.
- të merren masa për përmirësimi e zonave riparane në mënyrë, që të minimizohet rreziku i përmbytjes së këtyre tokave me qëllim parandalimin e përmbytjes së tokave përreth lumenjëve vecanërisht në *Lumin e Shkumbinit, Përroin e Paperit, Kushes, Manazderes dhe Zaranikës.*
- të shmangët lënia e tokës zhveshur ose pa bimësi ndërmjet të mbjellave ose gjatë stinës së kultivimit.

Përmbytjet: Rreziku i përmbytjes me rikthim 100-vjeçar në Bashkinë e Elbasanit parashikohet të shkaktohet nga lumi Shkumbin, në Zaranikë dhe Manazdre, ndaj dhe rekomandohet që:

- të përditësojë Planin e Menaxhimit të Përmbytjeve me rikthim 50-vjeçar. Planet e sotme janë të vitit 2003 dhe nuk marrin parasysh ndryshimet e regjimit të reshjeve dhe fenomeneve të tjera klimatike në dhjetëvjeçarin e fundit.
- të hartohet një plan menaxhimi në rast përmbytjesh me rikthim 100-vjeçar. Fillimisht rekomandohet të bëhen studime për të përditësuar përmbytjet në Bashki.
- të krijohet brezi i gjelbër mbrojtës përgjatë të gjitha burimeve ujore në Bashki. Kryesorë janë *Lumi i Shkumbinit, Përroi i Paperit, Kushes, Manazderes dhe Zaranikës.* Vëmendje të veçantë i duhet kushtuar veshjes së brigjeve të këtyre lumenjve dhe përrenjve në zonat kodrinore-malore ku erozioni është edhe më i lartë për shkak të karakterit malor të përrenjëve/lumenjëve
- të merren masa të menjëhershme për rehabilitimin e lumit Shkumbin, veçanarisht në zonat më problematike që janë *Muriqan, Baltavere, Polis-Vale,* me ndërtimin e shuarësve të energjisë përgjatë tupit të lumit dhe ndërtimin e anëve të lumenjve

Masa për mbrojtjen e tokës bujqësore

Duke parë rëndësinë e veçantë që ka sektori i bujqësisë në ekonominë e Bashkisë, është e rëndësishme që Bashkia të investojë në mbrojtjen e tokën bujqësore në përgjithësi dhe tokës bujqësore në veçanti. Në këtë rast, krahas masave të propozuara në PPV-në e Bashkisë Elbasan, bashkia rekomandohet të marrë një sërë masash të tjera të cilat janë renditur më poshtë:

- **Mbrojtja dhe erozioni në toka bujqësore**: është një tjetër fenomen që prek territorin e Bashkisë Elbasan për pasojë të një sërë shkaktarësh, si përdorimi i tokës dhe shpyllëzimet. Përgjithësisht, në territorin fushor të Bashkisë vihet re keqmenaxhimi i tokës duke ndjekur praktika jo të mira për përdorimin e saj. Përdorimi i tokës nga bujqësia ka shkaktuar probleme me erozionin. Ndaj rekomandohet që Bashkia.
- **Ruajtja ose mbrojtja e tokës bujqësore nga ndërtimet**: Bashkia e Elbasanit është përgjegjëse për nxjerrjen e vendimeve të detyrueshme në funksion të ruajtjes së tokës bujqësore. Veprimtari të tilla si ndërtimi mbi tokë bujqësore ndalohen me ligj (Nenet 10 dhe 14 i Ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004 "Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore").
- **Ndalimin e çdo zënie ose përdorim të paligjshëm të tokës** në territorin e bashkisë në zbatim të Ligjit nr. 7501 "Për Tokën" i ndryshuar, Neni 21. Për këtë arsye, rekomandohet që Bashkia e Elbasanit të marrë masa për kontrollin e vazhdueshëm për parandalimin e ndërtimeve të paligjshme në tokat bujqësore.
- **Mbikqyrja e punës për përmirësimn e zonave të gërryera në tokat bujqësore**: Për problemet me erozionin në toka bujqësore, rekomandohet që Bashkia të drejtojë dhe të mbikqyrë punën për përmirësimn e zonave të gërryera në tokat bujqësore, në zbatim të Ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor, i ndryshuar" Neni 7.
- Informimin e Bujqëve për praktikat e mira bujqësore që synojnë uljen e erozionit dhe rritjen e prodhueshmërisë së tokave. Praktika të tilla përfshijnë punimin e tokës duke e trazuar atë sa më pak, ruajtjen e masës bimore të të mbjellave të mëparshme gjatë kultivimit etj.
- Investime në bujqësi me qëllim mbrojtjen e tokave bujqësore sipas standardeve të BE-së (ku synohet mbrojtja e tokave të brishta /të pjerrëta *ndaj erozionit, gërryerjes, etj.*). në shumë fshatra ose zona kodrinore, popullsia është e detyruar të kultivojë tokat në pronësi të saj për arsye ekonomike. Kultivimi kryhet edhe në rastet kur tokat janë të ndjeshme ndaj erozionit e gërryerjes (për shkak të shiut e erës). Me qëllim shmangien e degradimit të këtyre tokave nga kultivimi, rekomandohet që Bashkia të investojë në bujqësi, dhe në veçanti, të nxitë pronarët e tokave të ndjeshme që të mos i punojnë ato në këmbim të kompensimit të tyre.

Tabela 113. Projektet e planifikuara në PPV për përmirësimin e cilësisë së tokës

Qëllimi	Masa	Projektet
Masa kundër degradimit të tokës	Rihabilitimi i sistemit ujitës-kullues	- Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrjetit kullues dhe ujitës për të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan - Risistemi i zonave ripariane të lumit Shkumbin - Rehabilitimi dhe sistemimi i zonave ripariane të lumit Zaranika, Manazdere, Gostimë, Gostrimë, Papër dhe Kushe - Pastrimi i zonës nga ndotjet e trasheguara industriale dhe kthimi i saj në zonë të përshtatshme për ndërtimin e objekteve me karakter ekonnomik - Pastrimi i zonave ish-industriale nga ndotjet e trasheguara
	Lufta kundër erozionit	
	Pastrimi nga ndotja	

Burnimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

2.3.2 Mbrojtja e peizazhit, biodiversitetit dhe hapësira e gjelbër

- **Peizazhi**

Peizazhi në teritorin e Bashkisë Elbasan paraqitet i ndryshëm, në varësi të teritorit dhe zonave ku dominon aktiviteti njerëzor (Shih seksionin e Peizazhit). Problematikat kryesore që has peizazhi në teritorin e bashkisë kanë të bëjnë kryesisht me fragmentimin/copëtimin e peizazhit natyror, dhe mos futjen e elementëve të peizazhit natyror në zonat urbane dhe në zonat me aktivitet industrial. Krahas problemeve në shkallë të madhe, vlen për tu theksuar problemet me peizazhin urban e atë industrial, të cilët deri më tani nuk kanë gjetur një rrugë të përbashkët ndërthurjeje me atë natyror. Në qytet mbetet problem krijimi i një peizazhi të mirëfilltë urban, duke përfshirë të gjithë elementët e gjelbërimit, arkitektonikës, kopshteve, monumenteve kulturor dhe historik, të cilët sëbashku do të krijoni një peizazh të ndërthurur dhe të pëlqyeshëm për qytetarët. Shpesh praktikat e mira të peizazhit nuk ndiqe, apo përcaktohen si dytesore, keto praktika janë spontane, ku zonat urbane dhe industriale kanë përdorur elementë të peizazhit në mënyrë rastësore, apo duke patur një orientim të lehtë mbi cështjen e dizajnit të peizazhit. Kryesisht, rrugët dhe sheshet kanë qënë pjesë e futjes së dizajnit të pejsazhit, me mbjellje pemësh formë lineare, duke ndjekur linja strikte, në rastet dominuese duke ndjekur konturet e infrastrukturës, kjo është një mënyrë bazike, sigurisht jo universale në rregullimin dhe krijimin e peizazhit, apo përdorimit elementëve të tijë në funksion të dekorit urban e më gjerë. Studimi i peizazhit në tërësi dhe elementëve të tij kërkon studime të thelluara duke analizuar të gjithë komponentët që e formojnë atë (planifikimi, arkitektuonika, historia, kultura, kultura bujqësore, natyra, bimet lokale, e deri tek komponentet më elementar si ndryshimi i ngjyrës së pemëve përgjatë sitinëve të vitit) dhe gjetjen e rrugëve të përbashkëta për ndërthurjen e pikave që mund të kombinohen me njeri tjetrin për të krijuar një Peizazh të pëlyeshëm dhe funksional.

Me qëllim mbrojtjen e përbërësve të mjedisit e peizazhit, në Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV) i cili është në fazë miratimi, Bashkia Elbasan ka parashikuar marrjen e disa masave të cilat përqendrohen në shtimin e sipërfaqeve të gjelbra në qytetin e Elbasanit dhe në zonat industriale, krijimin e zonave ripariane përgjat lumit Shkumbin dhe degëve të tij dhe krijimin e parqeve urbane përgjatë lumit Shkumbin dhe në Kodrën e Krastës. Konkretisht për përmirësimin e peizazhit, në PPV, Bashkia ka propozuar rehabilitimin mjedisor dhe ristrukturimin e ish-zonës industriale të Elbasanit, për të siguruar cilësi të mirë jetese si dhe kthimin në hapësire të gjelbër dhe argëtuese, mbjelljen e pemëve në zonat urbane, etj. Projektet e propozuara nga Bashkia në PPV që synojnë përmirësimin e Peizazhit në territorin e Bashkisë paraqiten në figurën në vijim (Tabela mëposhtë). Krahas masave të propozuara në PPV, në territorin e Bashkisë Elbasan rekomandohen keto masa:

Peizazhi Urban: Futja dhe ndërthurja e përbërësve të peizazhit natyror në brendësi të zonave urbane (sipërfaqe të gjelbëra, peme, shkurre, sipërfaqe ujore). Kjo kërkon studime të hollësishme për zona specifike, apo dhe në shkallë qyteti (Qyteti i Elbasanit), në mënyrë që Peizazhi uban të ndëthuret me atë natyror dhe ky i fundit të mund të shërbejë, krahas të mirave mjedisore, si dekor urban. Masa specifike për përmirësimin e Peizazhit urban në teritorin e bashkisë janë:

- Ruajtja e struktures së ***pemëve përgjatë rrugëve***, pra nëse aksi rrugor karakterizohet nga pemë kumbulle të kuqe, që ka rezistuar në kohë dhe i është

përshtatur klimës dhe tokës, rekomandohet që të ruhet kjo lloj bimësie, si dhe mundësisht të së njejtës madhësi dhe distancë nga njëra-tjetra, deri në fund të aksit për të ruajtur "*formalitetin*" që karakterizon këtë peizazh. Zgavrat e bordurat ku pema qëndron duhet të jenë të së njejtës madhësi, ngjyre dhe materiali mbulese. Kjo e fundit duhet të ketë çarje të mjaftueshme për të lejuar depërtimin e ujit në rrënjë, por të mos pengojë ecjen mbi to. Gjithashtu duhet të jetë e lëvizshme për qëllime mirëmbajtjeje. Rekomandohet që të përdoren mbulesat dhe zgavrat të mos lihen të çara e me bordurë sepse, veçanërisht në rrugët me trotuare të ngushta (1-2 m) pemët kthehen në pengesë serioze për ecjen e kalimtarëve.

- Përzgjedhja e bimëve përgjat akseve rrugorë urban duhet të jetë ose të të njëjtit lloj, ose me një kombinim 2-4 llojesh por sipas një tendence të përsëritur, që krijon elementin estetik dhe të rregullsisë në dizajnin e peizazhit rrugor. Si parim, diversiteti në ngjyrë, formë dhe lloj mund të arrihet në akset e tjera, por brenda të njëjtit aks bimët, forma, distanca dhe lloji i tyre rekomandohet të qendrojnë të pa ndryshuara, ose në formacione të projektuara paraprakisht.
- Në zona park e hapsira të tjera publike ku do të mbillen pemë karakteri formal i ketij peizazhi mund të thyhet nga pemë të mbjella rresht e të të njëjtit lloj, në pemë të së njejtës familje (gjethore, halore, shkurre), por të mbjella në grupime, pra grupe me nga 3 apo 5 pemë në varësi të hapësirës. Gjithsesi, në zonat park, projektuesit e peizazhit kanë liri në përzgjedhjen e formacioneve, për sa kohë që: zgjedhin bimë vendase apo të përshtatura për një kohë shumë të gjatë në territorin e qytetit/bashkisë së Elbasanit; i vendosin në mënyrë të tillë që të garantojnë hije në verë dhe depërtim të dritës së diellit në dimër; bëjnë të mundur krijimin e zonave me bar dhe jo vetëm lule ose tokë nën hije ku nuk mund të rriten bimët; krijojnë mikroklima të ndryshme brenda parkut; sjellin shumëllojshmëri bimësh që ofron informacion shkencor bazik edhe për përdoruesit e parkut; garantojnë që bimësia e përzgjedhur përmirëson cilësinë e tokës dhe rrit aftësinë filtruese e infiltruese të saj.
- Ti kushtohet vëmendje "*Xhepave Urban*", ose thënë ndryshe hapësirat boshe, të pa trajtuara mes pallateve apo ndërtesave të ndryshme të qytetit të cilat fshehin një potencial të madh në trjtimin e peizazhit urban. Këto hapësira vërtetojnë se peizazhi nuk ka përmasë standard dhe se është vetë elementi i përdorur në të i cili nëpërmjet funksionit që ofron edhe në një hapësirë relativisht të vogël, sërisht ofron një shumëllojshmëri aktivitetesh e mjedisesh. Po si hapësirat e tjera park, edhe këto xhepa ofrojnë tipologji të ndryshme sipas vendodhjes. Pra këto xhepa mund të trajtohen sipas neovojaës së komunitetit.
- Bimët e rekomanduara për tu përdorur në teritorin e Bashkisë Elbasanit (jo të vetmet) janë: **Bliri** *(Tilia argentea)*, **Lagestromia** *(Lagerstroemia indica)*, **Kumbulla e Kuqe** (*Prunus cerasifera*), **Ulliri i egër** (*Olea europaea*), **Rrapi** (Platanus occidentalis), **Pisha e Butë** (*Pinus Pinea*), **Dafina***(Laurus Nobilis)* dhe **Ginko***(Ginkgo Biloba) të cilat janë bimë (pemë) me tipare terheqëse, rezistente ndaj ndotjes, të përshtatshme me zonën dhe kanë sjellin të mira mjedisore (filtrojnë ajrin, neutralizojnë temperaturën, etj.)*

Peizazhi industrial: Të merren masa në drejtim të uljes së ndikimit negativ visual të zonave industriale. Kjo kërkon studime specifike në mënyrë që futja e elementëve të gjelbërimit me pemë dhe shkurre të shërbejë si përmirësues i peizazhit dhe fshehjen e zonave/objekteve të cilat nuk janë të përshtatshëm nga pikëpamja vizuale. Gjatë hartimit të këtyre projekteve dhe zbatimit të tyre duhet pasur parasysh që funksionet industriale dhe gjelbërimi, apo përbërësit e Peizazhit të balancohen dhe të plotësojnë njeri-tjetrin duke krijuar një dizajnë të pëlqyeshëm dhe njëkohësisht duke garantuar ruajtjen e funksionalitetit. Masa specifike për përmirësimin e peizazhit industrial janë:

- Të shtohen sipërfaqet e pyllëzuara në zonat industriale, kryesisht në zonën e Kominatit Metalurgjik, Fabrikës së Çimentos, Uzinës së Lëndëve Plasëse etj. Pyllëzimi i këtyre zonave do të përmirësonte pamjen vizuale të zonës industriale dhe do të silltë një sërë përfitimesh mjedisore, si mbrojtja e tokës, shtimi i oksigjenit në ajër dhe zbutja e klimës, etj.
- Të mbillen pëmë të cilat, karahas rregullimit të peizazhit, përshtaten me tokën dhe që mund të zhvillohen në mjedise relativisht të ndotura. Për mbjelljen e pemëve në zonat industriale rekomandohen bimët si: **Akacia** *(Acacia),* **Plepi** *(Populus alba),* **Shelgu** *(Salix species),* **Eukalipti** *(Eucalyptus)* dhe **Lofata** *(Cercis siliquastrum).*

Peizazhi natyror: Të synohet mbrojtja dhe përmirësimi i peizazhit natyror nëpërmjet shtimit të zonave të pyllëzuara dhe uljes së fragmentimit të zonave natyrorë. Masa specifike për përmirësimin dhe mbrojtjen e peizazhit natyror mund të jenë:

- Të ruhen, ndërtohen aty ku mungojnë, zonat ripariane të lumit Shkumbin dhe degëve të tij, të cilat janë një përbërës i rëndësishëm i plotësimit të peizazhit të territorit të Bashkisë Elbasan. Ruajtja dhe përmirësimi i zonave ripariane luajnë rol të shumëfishtë, kanë funksion mbrojtës të tokës nga erozioni, njëkohësisht luajnë rolin e brezit buferik (zbutës) të ndalimit të ndotjes nga sipërfaqet bujqësore në drejtim të lumit, kanë një rol të rëndësishëm si korridor lidhës për habitatet dhe për strehimin dhe levizjen e specieve të ndryshme, gjithashtu dhe ndikimet positive në përmirësimin e cilësisë së ajrit, zbutjen e klimës, etj.
- Ripyllëzimi i zonave të shpyllëzuara dhe të degraduara nga shkaqe të ndryshme të zonave pyjore të *Shpatit, në Kollagjesh dhe Shmil* do të silltë një ndikim pozitiv në ruajtjen e njëtrajtshmërisë dhe të bashkimit të pjesëve të copëtuara të pyjeve, duke krijuar një peizazh pyjor të vazhdueshëm. Gjatë kësaj ndërhyrje duhet treguar kujdes i veçantë që pemët e përzgjedhura të të njëjtit lloj që kanë qënë më parë, ose të përshtaten pemë të tjera, gjithmonë duke përdorur pemë të cilat janë karakteristikë për zonë dhe që e kanë habitatin e tyre këtë territor.
- Të mbillen pëmë të cilat, karahas rregullimit të peizazhit, përshtaten me tokën dhe që mund të shërbejnë si mbrojtëse të tokës nga erozioni dhe që nuk përbëjnë rezik për të prishur balancat me bimët e tjera (nuk janë invazive), ndër të tjera rekomandohen: **Shelgu** *(Salix species),* **Plepi** (*Populus alba),* **Akacia** *(Acacia),* **Eukualipti***(Eucalyptus).*

Peizazhi rural: Mbrojtja e Peizazhit rural dhe përmirësimi i cilësisë së tij, duke e konsideruar si pjesë të pa ndashme të peizazhit natyror. Kjo do të arrihet nëpërmjet marrjes së masave specifike për rregullimin e elementëve të caktuar, disa prej këtyra masave mund të jenë:

- Gjatë hartimeve të planeve të zhvillimit të bujqësisë të kihen parasysh elementët e peizazhit, në mënyrë që, aty ku është e mundur, dhe sektori i bujqësisë të përshtatet me përbërësit e tjerë të Peizazhit, apo të krijojë një peizazh i cili nuk fragmenton në vijushmërinë pamore (edhe fizike aty ku është e mundur)të peizazhit.
- Ruajtja mirëmbajtja e kanaleve vaditës/kullues dhe mbjellja e brigjeve të tyre me gjelbërim, duke krijuar "damar" të gjelbër përgjat parcelave bujqësore (kryesisht bimësi e ulët, barishtore dhe shkurre te vogla).
- Të krijohen breza buferik (zbutës) me pemë të larta dhe të ulta në pjesët fundore të tokave bujqësore, me qëllim krijimin e një zonë të gjelbër dhe parandalimin e shpërdarjes së ndotësve në sipërfaqe të gjera (nëqoftëse në pjesën fundore të parcelave bujqësore ndodhet një lum, ky brez i gjelbërdo të ulte ndjeshëm depërtimin e dotesve si pasojë e shpelarjes së tokës bujëesore nga vaditja).
- Të mbillen pëmë/bimë të cilat, karahas rregullimit të peizazhit, përshtaten me tokën dhe që mund krijojnë konflikt me zhvillimin bujqësor. Për mbjelljen e pemëve në zonat industriale rekomandohen bimët si: **Plepi** *(Populus alba)*, **Shelgu** *(Salix species)*, **Eukalipti** *(Eucalyptus)* dhe **Akacia** *(Acacia)*.

Masa të përgjithshme për peizazhin, për mbrojtjen e peizazhit dhe ndërthurjen e tij me të gjithë komponentët e peizazhit në harmoni të plotë, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës dhe ndjeshmërisë emocionale të qytetarëve mund të jenë:

- **Të ruhet dhe konservohet Peizazhi natyror dhe ai artificial**: Kjo merr një rëndësi të veçantë për banorët që jetojnë, apo që kthehen në vendin e orgjinës, nga pikëpamja emocionale dhe e qetësisë që i ofron identiteti i vendlindjes/banimit të tyre.
- **Përfitime të tjera nga ruajtja e peizazhit**: Ruajtja dhe konservimi i peizazhit natyror gjithashtu ka një sërë përfitimesh mjedisore, kryesisht në mbrojtjen e tokës, uljen e ndotjes, habitatit për specie e deri tek përfitimet ekonomikte të drejtpërdrejta. Bashkia Elbasan në PPV e hartuar në 2016, ka hartuar një sërë projektesh të ndryshëm infrastrukturorë në teritorin e bashkisë duke marrë në konsideratë të gjithë komponentët e Peizazhit dhe mbrojtjes dhe përmirësimit të tyre aty ku është e mundur. **Ndaj rekomandohet që gjatë zbatimit të projekteve nga PPV të merren në konsideratë të gjithë masat që janë dhënë në të për ruajtjen e Peizazhit dhe përmirësimit të tijë.**

Tabela 114. Projektet e planifikuara në PPV që synojnë përmirësimin e Peizazhit

Qëllimi	Masa	Projekti
Përmirësimi i peizazhit në territorin e Bashkisë Elbasanit nëpërmjet shtimit të sipërfaqeve të gjelbra	Shndërrimi i zonave industriale	-Pastrimi i zonës nga ndotjet e trasheguara industriale - Rehabilitimi i zonës dhe kthimi i saj në zonë të përshtatshme për ndërtimin e objekteve me karakter ekonomik. -Pastrimi i zonave ish-industriale nga ndotjet e trasheguara. - Risistemi i zonave ripariane të lumit Shkumbin -Rehabilitimi dhe sistemimi i zonave ripariane të lumit Zaranika, Manazdere, Gostimë, Gostrimë, Papër dhe Kushe -Krijimi i parqeve urbane përgjate lumit Shkumbin - Kthimi i kodrës së Krastës në park urban
	Krijimi i zonave ripariane përgjatë lumenjve	
	Krijimi i parqeve urbane/rajonale	

Burnimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

- **Biodiversiteti**

Teritori i Bashkisë Elbasan ka një biodiversitet relativisht të pasur dhe të larmishëm (shih seksionin e biodiversitetit), si nga pikëpamja faunistike ashtu edhe floristike. Megjithatë, qëndrueshmëria e biodiversitetit has në një sërë vërshtirësish, të cilat lidhen kryesisht më problemet e shkaktuara nga aktiviteti njërëzor në territor. Zhvillimi bujqësor, industrial, urban dhe ai infrastrukturor janë problemet të cilët kanë pasur ndikim të rëndësishëm në qëndrueshmërinë e biodiversitetit. Hapja e tokave bujqësore (vitet e shkuara) ka çuar në tkurrje dhe fragmentim të habitateve natyror, zhvillimi industrial kryesisht ka patur ndikim negativ në prishjen e cilësisë së tokës dhe të ujërave duke dëmtuar biodiversitetin, zhvillimi urban dhe ai infrastrukturor ka copëtuar gjithashtu habitatet, kryesisht ai infrastrukturor (rrugë) i cili ka copëtuar konsiderueshëm habitatet, duke vështirësuar, apo penguar plotësisht vijueshmërinë e tyre. Si pasojë, shumë specie mbeten të izoluara në habitate të vogla të copëzuara.

Në këtë situatë, hartimi i PPV-së ka synuar Planifikimin e Zhvillimit të Territorit në mënyrë të tillë që të sigurojë mbrojtjen e biodiversitetit në teritorin e Bashkisë. Në PPV, Bashkia ka marrë disa masa specifike për të përmirësuar situatën e për të krijuar mundësinë për një biodiversitet sa më të qëndrueshëm. Këto masa janë përkthyer në projekte specifike të cilat renditen më poshtë:

Në funksion të ruajtjes dhe përmirësimit të mëtjeshëm të biodiversitetit, krahas masave të propozuara në PPV, në territorin e Bashkisë Elbasan rekomandohet:

- **Hartimi i Planit të Menaxhimit/Veprimit të Biodiversitetit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tij në brëndësi të territorit të bashkisë**, kryesisht për zonat të cilat shihen prioritare për ruajtjen e specieve të mbrojtura. Në këtë rast, Bashkisë i nevojitet bashkëpunimi me Ministrinë e Mjedisit dhe institucione të tjera lokale e qëndrore (AKM, ARM, etj.). Ky rekomandim vjen edhe si detyrim ligjor në zbatim të ligjit Nr.587, datë 20.7.2006 "Për Mbrojtjen e Biodiversitetit".
- **Inventarizimi i specieve dhe përditësimi i tij për territorin e bashkisë** (në bashkëpunim me Ministrine e Mjedisit dhe institucionet të tjera vendore dhe qëndrore, AKM, ARM, AKZM, ADZM). Inventarizimi dhe njohja e llojeve në territorin e Bashkisë do të shërbente në qartësimin e përcaktimit të masava efektive

për mbrojtjen e tyre, si dhe propozimin për të dhënë status mbrojtjeje zonave të cilat spikaten për larmishmëri dhe strehojnë specie të rrezikuara. Realizimi i këtyre masave do ti shërbejë Bashkisë që të ruajë dhe të mbrojë biodiversitetin nga ndërhyrjet e njeriut dhe nga element natyrorë, detyrim ky që rrjedh nga Ligji nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe VKM Nr. 84, datë 27.1.2009 "Për Caktimin e kritereve për ngriten e rrjetit të inventarizimit dhe të monitorimit të biodiversitetit".

Hartimi i Planit të Mbarështimit të Fondit Kullosor, në mënyrë që të dihet kapaciteti i teritorit për kullotje dhe të ndërmerren masa për ndalimin e kullotjes aty ku vlersohet e nevojshme.

- **Hartimi i Planit të Mbarështimit të Bimeve Medicinale dhe Aromatike,** në mënyrë që të njihet kapaciteti i lejuar i shfrytëzimit të këtyre bimeve duke ruajtur balancat e tyre (në bashkëpunim me institucionet vendore dhe qëndrore, Ministria e Mjedisit, Ministritë e linjës, ARM, AKM, etj.).
- **Bashkëpunimi me fermerët e zonës për mbarështimin dhe ruajtjen e biodiversitetit e specieve bujqësore dhe blektorale lokale dhe vendase** të cilat janë cilësuar si të rrezikuara nga lista e specieve të rrezikuara në shkallë vendi (ne bashkëpunim me ministrine e Bujqësisë dhe Ministrinë e Mjedisit).
- **Kontrolli i zbatimit të moratoriumit të ndalimit të gjuetisë dhe prerjeve të pyjeve** (duhet theksuar që për zbatimin e moratoriumit të pyjeve Bashkia është e ngarkuar drejtpërsëdrejti për kontrollin dhe zbatimin e tij, ndërsa për atë të gjuetisë bashkisë i lind detyrim nga ligji Nr.10 006, datë 23.10.2009 "Për Mbrojtjen e faunës së egër" dhe ligji Nr.9587, datë 20.7.2006 "Për Mbrojtjen e Biodiversitetit") është masa kryesore që do të përmirësonte gjendjen e biodiversitetit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tij. Kontrolli i zbatimit të moratoriumeve, gjuetise dhe pyjeve, kërkon që:

- Bashkëpunim me institucionet lokale dhe qëndrore për të kordinuar punën dhe për të kryer veprimtari të përbashkëta të cilat cilësohen më efikase në bashkëpunim ndërinstitucional (institucionet që duhet të lidhen ura bashkëpunimi janë Bashkitë fqinje, Ministria e Mjedisit, ARM, AKM, Policinë e shtetit, etj.)
- Ngritjen e sistemeve të informimit në terren, në mënyrë që të raportohen në kohë dëmet dhe të dalin para përgjegjësisë shkelësit (sistemi duhet të jetë formal, krahas punonjëve të lidhen mardhënie të mira me banorët e zonës dhe kryesisht me barinjtë).
- Hartimin e planeve të kontrollit dhe inspektimeve, në mënyrë që të gjitha kontrollet të jenë të kordinuara dhe të kenë efikasitet në veprimtarinë e tyre.
- Organizimin e fushata të ndërgjegjësimit të qytetarëve për rëndësinë që ka ndalimi i gjuetisë dhe prerjes së pyjeve për një afat të paracaktuar, përkatësisht 5 vjet për ndalimin e gjuetise dhe 10 vjet për ndalimin e shfrytëzimit të pyjeve.

Marrja e masave paraprake për uljen e ndikimeve negative në habitate nga ndërtimi/zgjerimi i infrastrukturës rrugore (kryesisht rruget lidhëse të fshatrave 6-8m gjerësi). Në pikat ku vlerësohet që ndarja e habitateve krijon probleme në biodiversitetin e

zonës, të ndërtohen ura/nënkalime ekologjikë për të lidhur habitate. Rrugët lidhese ekzistuese dhe të propozuara dhe në të gjitha zonat natyrore të Bashkisë duhet të kenë parasysh ndërtimin e urave ekologjike pasi këto rrugë kanë ndikim të konsiderueshmëm në habitate (copëzojnë habitatet).

Rehabilitimi mjedisor i fushës së grumbullimit të mbetjeve aktuale, e cila është jashtë standarteve të kërkuara. Venddepozitimi aktual i mbetjeve të ngurta urbane shkakton një sërë problemesh në mjedis, duke ulur cilësinë e elementeve përbërëse të tij, si toka, ajri, uji dhe si pasojë ndikime negative në biodiversitetin e zonës. Ky venddepozitim, duke qënë fare pranë shtratit të lumit Shkumbin vlerësohet të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e ujit të tij e, si rrjedhojë, në florën e faunën ujore.

Krijimi i koridorit lidhës natyrorë të Rrëqebullit të Ballkanit *(Lynx lynx ssp. balcanicus)*: Bazuar në dy burime kryesore informacioni (IUCN[470] dhe Planit të Veprimit për Rrëqebullin 2007) rezulton se Rrëqebulli është i pranishëm në teritorin e Bashkisë Elbasan në pjesë kufizuese me Bashkinë e Librazhdit. Sipas IUCN-së, kjo specie ka si habita zonën veri-lindore të bashkisë Librazhd, deri në afërsi të Bashkisë Elbasan (ne pjesën e Kuturmanit dhe Labinot Mal). Ndërs sipas Planit të Veprimit të Rrëqebullin, rezulton se prania e Rrëqebullit është evidentuar në territorin e Elbasanit, në zonën e NjA Zavalinë dhe Gjinar, zonë kjo e përcaktuar si strehim i përkoshëm për këtë specie. Nga vëzhgimi i teritorit, kryesisht të zonave që përdoren nga Rrëqëbulli, rezulton që prania e ti është në një fashë (koridor) që fillon nga territori i Bashkisë Korçë, prek territorin e Bashkisë Përrenja dhe Gramsh, Librazhd e Elbasan duke përfunduar në pjesë të territorit të Bashkisë Tiranë e Dibër. Kjo fashë shfaqet e fragmentuar (shkëputur) në pjesën midis Elbasanit dhe Librazhdit, ndaj rekomandohet që:

- Për mbrojtjen dhe zhvillimin e habitatit të Rrëqebullit, jo vetëm, me qëllim zhvillimin normal të specieve, të merren masa me pyllëzim nga NJA Zavalinë e Gjinar deri në Labinot Mal, duke krijuar kësht një koridor të vazhdueshmëm (pyjor) që lidh gjithë sonën që mendohet që përdoret nga Rrëqebulli dhe specie të tjera (Figura mëposhtë).
- Duke marrë parasysh që përgjatë luginës së Lumit Shkumbin kalon rruga automobilistike nacionale Rrogozhinë-Elbasan-Librazhd-Qafë Thanë, shikohet e nevojshmë që për lëvizshmërinë e specieve të mendohet ndërtimi i një ure ekologjike (mbi kalim / nën kalim), pasi Rrëqebulli, por edhe gjitarët e tjerë të mëdhenj kërkojnë habitate të gjera të pa fragmentuar. Ura ekologjike propozohet të realizohet në afërsi të NJA Labinot Fushë, ne ngushticën e luginës së Shkumbinti Tek Mali i Vazhës. Ky seksion arrinë gjerësinë rreth 200-300m, vlerësohet si një ndër pikat më të ngushta të luginës së Shkumbinit në territorit të Bashkisë Elbasan.

Figura 226. Propozimi i korridorit lidhës natyrorë në Bashkinë Elbasan



Burimi: bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

- *Rekomandime të tjera për mbrojtjen dhe zhvillimin e Rrëqebullit*

Referuar Planit të Veprimit per Rrëqebullin 2007 do të japim disa rekomandime, për ruajtjen dhe shtimin e numrit të kësaj specieje në zhdukje, si më poshtë :

- *Mbrojtja e rrëqebullit duke projektuar dhe implementuar një strategji ndërkombëtare.* Meqënëse rrëqebulli ka një habitat të kufizuar të shpërndarjes së tij midis Shqipërisë, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Kosoës rekomandohet impleentimi i një strategjie ndërkombëtare për mbrojtjen e tij. Informacioni rreth strategjive dhe planeve të veprimit për mbrojtjen e tij duhet të shtrihen gjërësisht për të rritur bshkëpunimin në zonat ndër-bashkiake dhe ndër-kufitare.
- *Mbrojtja dhe restaurimi i habitatit* nëpërmjet përcaktimit të territorit të shpërndarjes së rrëqebullit, përmirësimit të tokave pyjore dhe konvertimin e tyre në habitate të përshtatshmë për rrëqebullin, të ndalohet prerja e pyjeve në sektorët jashtë ZM me prani të përhershme ose sezonale të rrëqebullit dhe indentifikimit të zonave për ngritjen e korridoreve ekologjikë për të ndihmuar rrëqebullin me lëvizjen e tij.

- *Rehabilitimi i gjahut të rrëqebullit* si një domosdoshmëri për të mbrojtur vetë rrëqebullin. Duke mbrojtur lepurin e egër, kaprrollin, dhinë dhe derrin e egër kemi mbrojtur rrjedhimisht dhe rrëqebullin. Kjo mund të bëhet duke ndaluar gjuetinë e kafshëve pre të rrëqebullit dhe duke ju ofruar atyre një habitat të shëndetshëm.
- *Reduktimi i shkaqeve të vdekshmërisë* ku një nga shkaqet kryesore është gjuetia ilegale. Përpjekjet për të ulur gjuetinë ilegale mund të intensifikohen duke forcuar vigjilencën ndaj ngjarjeve të tilla dhe përforcimet e mekanizmave ndëshkues.
- *Edukimi dhe informimi publik* sepse gjëndja aktuale e nuk është bërë me dije për publikun e gjërë. Duhet bërë orientimi i njerëzve drejt mbrojtjes të kësaj specieje të rrezikuar.
- *Mbrojtja e zonave dhe lidhja e tyre* duke bërë implementim të menjëhershëm të masave për ruajtjen e rrëqebullit me etoda efikase dhe miqësore me mbarështimin e tyre. Për zonat me popullata të izoluara duhet të sigurohet një mbrojtje e veçantë nëpërmjet krijimit të biokorridoreve.
- *Monitorimi i vazhdueshëm dhe studimi* të jep mundësinë e njohjes reale të gjëndjes së specieve dhe marrjen e masave në kohë për ruajtjen dhe shumimin e tyre. Një informacion apo studim i përditësuar të ndihmon në implementimin e një plani efektiv të ruajtjes së llojit.

Tabela 115. Projektet e planifikuara në PPV për përmirësimin e biodiversitetit

Qëllimi	Masa	Projekti
Zhvillimi i qëndrueshëm i biodiversitetit	Përmirësimi i parqeve dhe zonave të dëmtuara	-Rigjenerimi i parkut të Krastës -Ripyllëzimi i zonave të dëmtuara nga aktiviteti njerëzor në njësitë administrative: Papër, Gracen, Labinot-Mal, Zavalinë, Gjinar, Shushicë -Mbjellje me arrorë (shegë) më NjA Gjergjan -Ndërtimi i biokorridorit mjedisor nga zona e mbrojtur Sopot-Stavraj deri tek zona tjetër e mbrojtur Kutërman-Qafë e Bushit
	Krijimi i koridoreve lidhës për habitatet	

Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

- **Pyjet dhe kullotat**

Mirëadministrimi i pyjeve dhe kullotave nga Bashkia Elbasan, sigurimi në realizimin e reformës së decentralizimit të kompetencave në administrimin e pyjeve dhe kullotave publike dhe dixhitalizimi i hartave të fondit pyjor nën administrim mbeten pikënisjet drejt suksesit për përmirësimin e gjendjes aktuale në sipërfaqen e fondit pyjor e kullosor.

Me qëllim marështimin dhe përmirësimin e zonave pyjore e kullosore dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve të saj, Bashkia Elbasan ka parashikuar marrjen e disa masave në Planin e Përgjithshëm Vendor i cili është në fazë miratimi. Masat për mbarështimin e pyjeve në territorin e Bashkisë përfshijnë (Tabela mëposhtë) krijimin e parqeve rajonale e urbane dhe rihabilitimin e zonave riparianë përgjatë gjatësive të lumenjëve në teritorin e Bashkisë.

Në funksion të mbarështimit e qëndrueshmërisë së sipërfaqeve pyjore dhe kullosore, krahas masave të propozuara në PPV, në territorin e Bashkisë Elbasan rekomandohet:

- **Inventarizimi i fondit pyjor e kullosor** në mënyrë që të dihet sipërfaqja aktuale. Siç është theksuar më parë, të dhënat zyrtare rreth fondit pyjor e kullosor janë të vitit 1984-84 kur është kryer inventari i fundit i këtij fondi.
- **Hartimi i Planit të Mbarshtimit të Pyjeve e kullotave** i cilë është detyrim ligjor për Bashkinë, që buron nga ligji nr. 9385/2005"Për pyjet dhe shërbimin pyjor". Duke qënë se në territorin e Bashkisë Elbasan nuk njihet mirë kapacitetet që kanë kullotat për t'u shfrytëzuar, lind nevoja edhe për hartimin e Planit të Mbarështimit të Kullotave, i cili do të mundësojë njohjen e kapaciteteve të kullotjes në territorin e bashkisë dhe menaxhimin e qëndrueshëm të tyre.
- **Hartimi i Planit të monitorimit & kontrollit** të pyjeve dhe kullotave me qëllim zbatimin e ligjit dhe shmangien e demtimeve në territor.
- **Përmirësimin e infrastrukturës rrugore** të pyjeve dhe kullotave (rrugë aksesi), të cilat janë jetike për ndërhyrje në rastet e rënies së zjarrit në pyje, kryesisht ne NJA-në Gjinar, Zavalinë e Tregan.
- **Zgjidhje e konflikti Pyje –Bujqësi.** Ky konflikt është theksuar vitet e fundit për shkak se pemtaria është shndërruar në sector fitimprurës për banorët. Në këtë rast rekomandohet që Bashkia, në bashkëpunim me popullsinë, të përcaktojë se deri në cilën shkallë lejohet zhvillimi i pemtarisë në dëm të sipërfaqeve pyjore.
- **Monitorimi dhe zbatimi i moratoriumit** të shfrytëzimit të pyjeve.

Tabela 116. Projektet e planifikuara në PPV për përmirësimin e pyjeve dhe kullotave

Qëllimi	Masa	Projekti
Përmirësimi i gjëndjes së pyjeve dhe kullotave në territorin e Bashkisë Elbasan	Krijimi dhe rigjenerimi i parqeve	- Krijimi i parkut tematik rrëzë kodrës së Krastës - Kthimi i kodrës së Krastës në park urban për banorët e Elbasanit - Rigjenerimi i parkut të Krastës
	Ripyllëzimi i zoave të dëmtuara	- Ripyllëzimi i zonave të dëmtuara ne NjA : Papër, Gracen, Labinot-Mal, Zavalinë, Gjinar, Shushicë
	Përmirësimi i infrastrukturës së gjelbër	- Ndërtimi i biokorridorit mjedisor (duke ripyllëzuar dhe duke mbjellë fidanishte në zonat e dëmtuara) nga zona e mbrojtur Sopot-Stavraj deri tek zona tjetër e mbrojtur Kutërman-Qafë e Bushit - Lidhja e NjA : Funarë, Labinot Mal, Gjinar, Tregan Papër me infrastrukturë të gjelbër

Burimi : Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

- **Zonat e mbrojtura**

Në territorin e Bashkisë Elbasan ka vetëm një numër të konsiderueshëm të zonave të mbrojtur. Aty numërohen 17 zona të mbrojtura ku 14 janë monumente natyrore dhe 3 rezervate të menaxhuara. Nuk duhet të lëmë pa përmendur faktin që ka zona tërheqëse, sipërfaqe pyjore e ujore dhe me vlera të larta të biodiversitetit (shih seksionin e Zonave të Mbrojtura dhe biodiversitetit), të cilat fare mirë mund të vlerësohen dhe t'u jepet një status mbrojtës. Në këtë situatë, Bashkisë i propozohet (pranë institucioneve përkatëse AKZM, AdZM) :

- Ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe materiale të AdZM Elbasan në funksion të menaxhimit të ZM Elbasan

- Bashkëpunim i Bashkisë Elbasan me AdZM Elbasan për mbrojtjen dhe zhvillimin e qendrueshëm të zonave të mbrojtura, në mënyrë të veçantë Rezervateve Natyrore të Qafë Bushit, Sopotit dhe Kuturmanit.
- Hartimi i planit të emergjencave në rast zjarri dhe rreziqesh gjeologjike në Zonat e Mbrojtura si në pyllin e Shushicës, në Kuturman, Sopot dhe Qafë Bushë (në bashkëpunim me AdZM).
- Promovimin e vlerave të zonave të mbrojtura me qëllim zhvillimin e eko-turizmit dhe aktiviteteve të tjera që mundësojnë mbledhjen e të ardhurave financiare për menaxhimin e tyre
- Marrja e masave ndaj prerjes së pyjeve brenda zonave të mbrojtura, si Polis-Stravaj, Kuturman duke zbatuar kështu dhe Moratoriumin e prerjes së pyjeve.
- Ndalimi në mënyrë përfundimtare i aktivitetit të guroreve në territorin e Bashkisë Elbasan
- Kontrrolli i vazhdueshëm i zbatimit të lejes për HEC-et të cilët kanë reduktuar ndjeshëm sasinë e ujit që duhet të rrjeshë në gjëndje të lirë
- Marrja e masave për mbrojtjen e erozionit për brigjet e lumenjve apo përrenjëve që kalojnë në ZM
- Të bëhët një studim për kapacitetin që kanë ZM për kullotjen. Nuk ka një studim të mirëfilltë për këtë fenomen i cili është prezent në çdo zonë të mbrojtur.
- Te zbatohet shkalla e mbrojtjes të zonave të mbrojtura sipas ligjit në fuqi (Të gjitha shkallët e mbrojtjes së ZM-ve në Elbasan paraqiten në tabelën në vijim).

Tabela 117. Shkalla e mbrojtjes dhe domethënia (veprimtaritë e ndaluara)

Kategoria	Emërtimi	Zona buferike (m)	Shkalla e mbrojtjes	Veprimtaritë e ndaluara
II	Shebeni - Jabllanicë	50	II	**Aktivitetet që ndalohen me ligj në këto zona:** a) shfrytëzimi i tokës me teknologji intensive, me mjete dhe mënyra që shkaktojnë ndryshime rrënjësore në biodiversitet, në strukturën dhe funksionet e ekosistemeve ose që dëmtojnë në mënyrë të pandreqshme sipërfaqen e tokës; b) neutralizimi i mbetjeve me origjinë jashtë territorit të parkut kombëtar; c) shpërndarja e kafshëve dhe e bimëve jovendase, kur ato sjellin ndryshime në biodiversitetin e zonës; ç) riprodhimi intensiv i kafshëve të gjahut, me përjashtim të riprodhimeve shpëtuese; d) ndërtimi i rrugëve, autostradave, hekurudhave, zonave urbane, linjave të tensionit të lartë dhe sistemeve të naftës dhe gazit me shtrirje të gjatë; dh) larja dhe spërkatja e rrugëve me kimikate; e) mbjellja e pyjeve monokulturë; ë) ndezja e zjarreve jashtë vendeve e pikave të caktuara; f) lëvizja e mjeteve të transportit jashtë rrugëve të caktuara; g) gjuetia me ushqime të helmuara; gj) nxjerrja e mineraleve, gurëve, torfave me përjashtim të gurëve dhe rërës për mirëmbajtjen e parkut;

				i) veprimtari masive sportive, turistike, jashtë pikave të caktuara; j) organizimi i garave me automjete e motoçikleta. **<u>Në këtë zonë mund të ushtrohen, por vetëm pasi të pajisen me leje mjedisi, veprimtaritë që synojnë:</u>** a) ndryshimin e gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe sistemeve të zonave të lagura;
III	Dushku i Lleshanit	-	I	Aktivitetet që janë të ndaluara: a)prerja e drurëve dhe e shkurreve; b)përdorimi i kimikateve dhe i plehrave kimike; c) ndërtime të çdo lloji; ç) nxjerrja e mineraleve dhe e torfave; gjuetia dhe peshkimi; dh) ndezja e zjarreve; . e) kullotja, kalimi i kafshëve shtëpiake dhe ndërtimi i objekteve për mbajtjen e tyre; ë) ngritja e objekteve çlodhëse, argëtuese dhe sportive; f) kalimi nëpër shtigje, me përjashtim të pronarit ose të përdoruesit të tokës; g) lëvizja me mjete motorike të çdo lloji, me përjashtim të makinave të administratës së ruajtjes së rezervatit dhe të zjarrfikësve; gj) vozitja me barka, kanoe dhe mjete të tjera lundrimi; h) riprodhimi intensiv i kafshëve të gjahut.
III	Pisha e Fushë Kuqes	-	I	-//-
III	Dushku i Kishës Gjinar	-	I	-//-
III	Lisat e Pashtreshit	-	I	-//-
III	Rrobulli i Zeleshnjës	-	I	-//-
III	Rrapi i Gurrës së Labinotit	-	I	-//-
III	Pylli aluvial i Shushicës	-	I	-//-
III	Rrepet e Byshe kut	-	I	-//-
III	Llixhat e Hidrajt	-	I	-//-
III	Mështekna e Zavalinës	-	I	-//-
III	Mani i Zi i Joronishtit	-	I	-//-
III	Burimi i Perroit të Kushes	-	I	-//-
V	Qafë Bushi	5	IV	**<u>Aktivitetet që ndalohen me ligj në këto zona:</u>** a) mbjellja e pyjeve monokulturë;

				b) neutralizimi i mbetjeve dhe ndezja e zjarreve jashtë vendeve e pikave të caktuara; c) shpërndarja e kafshëve dhe e bimëve jovendase; ç) gjuetia me ushqime të helmuara; d) ndërtimi i autostradave, i kanaleve lundruese dhe i zonave urbane; dh) lëvizja me mjete trasporti jashtë rrugëve dhe vendeve të caktuara. Ky rregull nuk zbatohet për automjetet dhe makineritë shtetërore, bujqësore e pyjore, të zjarrfikësve, autoambulancave, makinerive të shërbimeve veterinare dhe atyre të menaxhimit të ujërave; e) organizimi i garave me automjete, motoçikleta e biçikleta. **Veprimtaritë e lejuara me leje mjedisi** Veprimtaritë që ndryshojnë përdorimin e territorit, ndërtimet, përdorimi i kimikateve e pesticideve, trajtimi i ujërave të zeza në ferma, për zona më të mëdha se 2 ha dhe veprimtaritë e tjera, që nuk ndalohen shprehimisht nga pika 2 e këtij neni, mund të ushtrohen vetëm pasi të jenë pajisur me leje mjedisi dhe të miratohen në Këshillin e Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë.
V	Sopoti	5	IV	-//-
V	Kuturmani	5	IV	-//-

Burimi: Ligjin nr.9868, datë 4.2.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura;

2.3.3 Mbrojtja e sistemit ujor

- **Burimet ujore sipërfaqësore**

Mbrojtja e cilësisë së ujërave sipërfaqësore është detyrim ligjor për Bashkinë i cili rrjedh kryesisht nga Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i cili ngarkon Bashkinë me përgjegjësinë për ruajtjen e mjedisit dhe ofrimin e një mjedisi cilësor për qytetarët në territorin e saj si dhe Ligji nr. 111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore". Krahas tyre, detyrimet rrjedhin edhe nga ligje të tjera që synojnë mbrojtjen e mjedisit apo të përbërësve specifikë të tij.

Lumi i Shkumbinit e degët e tij kanë pësuar dëmtime të shumta brenda territorit të Bashkisë së Elbasanit, (shih seksionin e Ujërave Sipërfaqësore) në 20 vitet e fundit. Nga analiza e cilësisë së ujit në territorin e Bashkisë Elbasan ka rezultuar se ujrat e lumit Shkumbin janë të ndotur. Burimet kryesore të ndotjes kanë rezultuar fusha e depozitimit të mbetjeve të ngurta urbane në brigjet e lumit Shkumbin (Menazdere, Paper, Gostrime, Kushe, Zaranikë) që ka shkarkuar ndotjen e ujërave sipërfaqësore e nëntokësore nëpërmjet rrjedhjes së shllamit në ujërat e lumit Shkumbin dhe depërtimit të tij në shtresat e tokës deri në Akuiferin e fushës së Elbasanit. Krahas venddepozitimit të mbetjeve, ujërat e ndotura urbane dhe industriale kanë krijuar ndotje të vazhdueshme të lumit Shkumbin në mungesë të impianteve përkatëse të trajtimit të ujërave të ndotura. Aktualisht, ujërat urbane dhe ujërat e ndotura të industrisë derdhen drejtpërsëdrejti në lumin Shkumbin.

Me qëllim mbrojtjen e burimeve ujore sipërfaqësore, në Planin e Përgjithshëm Vendor i cili është në fazë miratimi, Bashkia Elbasan ka hartuar disa projekte specifike (Tabela mëposhtë) të cilat përqendrohen në *përmirësimin e hidro-morfoligjisë së lumenve të Basenit të Shkumbinit* dhe degët e tij, *mbrojten e burimeve ujore nga ndotja e shkaktuar nga keqmenaxhimi i mbetjeve* në të shkuarën si dhe *uljen e ndotjes nga industria*. Projektet janë kryesisht me fokus i) rehabilitimin mjedisor dhe kthimin në zona për argëtim të zonave ripariane të Lumit Shkumbin e degëve të tij, ii) hartimin e Planit Vendor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve sipas ligjit Nr. 10463, datë 229.2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve" Neni 12. Në plan përfshihen edhe propozime për *ndërtimin e në impianti për trajtimin e ujërave të ndotura urbane* dhe krijimin e një sistemi për mbledhjen dhe ripërdorimin e ujërave të bardha, si dhe kryerjen e një studimi të thellë rreth ndikimit të industrisë në ujëra dhe tokë ndër vite. Krahas masave të propozuara në PPV, rekomandohet edhe marrja e masave që janë:

Monitorimi i menjëhershëm i Lumit Shkumbin: gjatë fazës së monitorimit të ujërave të lumit Shkumbin, ka rezultuar se ujërat janë të ndotura me metale të rënda si Plumb (Pb), Kadmium (Cd), Nikel (Ni), Arsenik (As), Hekur (Fe), Bakër (Cu), Krom (Cr). Duke patur parasysh se ujërat e lumenjve në përgjithësi përdoren për ujitje të kulturave bujqësore, dhe herë herë edhe për peshkim, dhe se metalet e pranishme në lumin Shkumbin si Pb e Cd janë kancerogjenë, është e rëndësishme që të merren masa të menjëhershme për monitorimin e thellë të lumenjve për një kohë prej të paktën dy-vjeçare në mënyrë që të përcaktohet nëse:

- Ujërat e lumit Shkumbin mund të përdoren për ujitje pa cënuar shëndetin e banorëve dhe konsumatorëve,
- Banorët e zonave në afërsi të lumit mund të peshkojnë dhe të konsumojnë peshkun e zënë në ujërat e lumit Shkumbin pa cënuar shëndetin e tyre

Monitorimi është edhe më i rëndësishëm duke patur parasysh që ujërat e Shkumbinit ushqejnë me ujë edhe Akuiferin e Lushnjes i cili furnizon me ujë Bashkinë e Lushnjës dhe fshatra të tjera.

Ndalimi i shfrytëzimit pa kriter të inerteve lumore në Shkumbin: Lumenjtë e Basenit të Shkumbinitt janë shfrytëzuar për inerteve në rrjedhën e mesme dhe të poshtme. Me qëllim mbrojtjen e lumit, ruajtjen e cilësisë së ujërave të tij dhe mbrojtjen e cilësisë së ujërave nëntokësore rekomandohet që Bashkia, në bashkëpunim me Këshillin e Basenit Ujor të Shkumbinit:

- Të ndalojë urgjentisht shfrytëzimin e inerteve lumore, sidomos në zonat nga Fushë-Labinot deri në Papër ose nga Vidhasi-Bujqës, ku është vënë re shfrytëzim itensiv i inerteve lumore (në bashkëpunim me ABU Shkumbin, ARM Elbasan, dhe Ministrinë e Mjedisit). Gjendja paraqitet problematike në NJA Shushicë, pergjat shtratit të lumit Shkumbi, në fshatin Polis-Valë ku shfrytëzimi i inerteve ka krijuar dëmtime të shtratit dhe brigjeve, duke humbur sipërfaqe të konsiderueshmë të tokës bujqësore. Bazuar në VKM Nr.1, datë 21.6.2006 "Për Reduktimin e shfrytëzimit të zhavoreve dhe rërave në shtretërit e lumenjve", Bashkisë së Elbasanit i rekomandohet që *për shfrytëzimn e zhavorreve dhe rërave në shtretërit e lumenjve të japë leje vetëm në rastet kur ka depozitime të mjaftueshme dhe vetëm në segmente të caktuara*. Pra, Marrja e inerteve, në rastet kur është e pashmangshme

për arsye ekonomike, *të shoqërohet me studime specifike të posaçme për çdo rast* me qëllim shmangien e dëmtimit të trupit lumor. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) ka kryer studime të hollësishme rreth shfrytëzimit të inerteve të lumenjve dhe ndikimit të tyre në mjedis. Për këtë arsye, rekomandohet *bashkëpunimi me SHGJSH për shqyrtimin e çdo lejeje*,

- Të largojë menjëherë impiantet e prodhimit të inerteve nga siperfaqet e shtratit apo terracës së shtratit të Shkumbinit dhe degëve të tij në zonat që shërbejnë si dritare hidrogjeologjike,
- Të rehabilitojë shtratin e lumit Shkumbin në zonat e dëmtuara dhe degët e tij brenda territorit të Bashkisë Elbasan (Ndërtimin e pritave anësore e tërthore me qëllim shmangien e erozionit të brigjeve, mbrojtjen e urave, pastrimin e brigjeve të lumit të mbushura me inerte, krijimin e pyjeve artificiale në terracën e shtratit apo në terracën e parë me qëllim shmangien ose uljen e veprimtarisë gërryese të rrjedhës).[471]

Menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme: Bashkia Elbasan nuk ka një plan për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme. Si rrjedhojë, menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme shtëpiake që është kompetencë e bashkisë mbetet ende një sfidë. Me qëllim parandalimin dhe mbrojtjen e ujërave të lumenjve në Bashkinë Elbasan nga ndotja e shkaktuar nga mbetjet e rrezikshme, rekomandohet hartimi i një plani bashkiak për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme. Më konkretisht rekomandohet që:

- Për mbetjet e rrezikshme industriale (të krijuara nga operatorët e pajisur me leje mjedisi A dhe B): të bashkëpunojë me institucionet e linjës për menaxhimin e rrymave të ndryshme të mbetjeve të rrezikshme, të cilat ndodhen apo krijohen brenda territorit të bashkisë.
- Për mbetjet e rrezikshme shtëpiake dhe atë të krijuara nga opëratorët e pajisur me leje mjedisi të tipit C: të hartojë një Plan Vendor për Menaxhimin e Mbetjeve të Rrezikshme Shtëpiake ku të përcaktojë mënyrat e mundshme të trajtimit të tyre dhe një venddepozitim përfundimtar.
- Për mbetjet e rrezikshme spitalore: të hartojë një plan për përcaktimin dhe miratimin e venddepozitimit të mbetjeve spitalore jo të rrezikshme dhe të monitorojë administrimin e mbetjeve sipas kopetencave të saj.
- Riciklimi i mbetjeve: Të hartojë një plan për riciklimin e rrymave të ndryshme të mbetjeve të riciklueshme: Planet dhe projektet që do të hartohen / zhvillohen në funksion të menaxhimit të mbetjeve industriale, nevojitet që të marrin në konsideratë edhe mundësinë e zvogëlimit të sasisë së krijuar të mbetjeve që në burim dhe uljen e mundësisë së ndotjes së mjedisit nga industria.

Kontrolli i shkarkimeve industriale në ujë: Në këtë konteks rekomandohet që Bashkia:

- të hartojë plane për kontrollin e zbatueshmërisë së Lejeve të Mjedisit (në bashkëpunim me ARM Elbasan e AKM) për subjekete që shkarkojnë mbetje të cilat dëmtojnë cilësinë e ujit sipërfaqësor dhe nëntokësor, kryesisht subjektet e industrisë së përqëndruar në zonën industriale të qytetit të Elbasanit. Zbatimi i këtyre masave rrjedh si detyrim ligjor për Bashkinë në zbatim të ligjit nr. 139/2015 "Për

vetëqeverisjen vendore" dhe ligje të tjera për mbrojtjen e mjedisit dhe specifikisht për mbrojtjen dhe menaxhimin e ujrave.

Hartimi i një Plan Veprimi për Praktikat e Mira Bujqësore: Problem në burimet ujore përbëjnë dhe infiltrimet e kimikateve dhe pesticideve që përdoren në bujqësi. Rekomandohet që bashkia të hartojë një Plan Veprimi për Praktikat bujqësore që duhet të ndiqen në mënyrë që të minimizohen përdorimet e këtyre kimikateve.

Hartimi dhe zbatimi i programeve e planeve vendore / ndërbashkiake për menaxhimin e Basenit të lumit Shkumbin: Shkumbini është lumë që përshkon territorin e bashkive të ndryshme. Si rrjedhojë, mbrojtja e tij kërkon bashkërendimin e përpjekjeve të të gjitha bashkive përkatëse në bashkëpunim me Agjencinë e Basenit Ujor (KBU) të Shkumbinit. Bashkëpunimi mund të kryhet nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të programeve e planeve ndërbashkiake/vendore ose për hartimin e Planit të Menaxhimit të Basenit të Shkumbint. Ky plan duhet të përcaktojë angazhimet përkatëse për çdo bashki në fushat e mëposhtme:

- përdorimin e qëndrueshëm të ujërave të lumit Shkumbin nga të gjitha bashkitë (bashkëpunim në dhënien e lejeve për shfrytëzimin e ujit për qëllime të ndryshme si për pije, bujqësi, industri, etj.) pa penalizuar bashkitë në rrjedhën e mesme e të poshtme të lumit,
- kordinim për ruajtjen e mirëmbajtjen e lumit (pastrimin e shtratit të lumenjve, krijimin e fashës së gjelbërt, ndalimin e shfrytëzimit të inerteve në lumë),
- parandalimin e ndotjes së lumenjve në këto bashki (ndalimin e hedhjes së mbetjeve në lumë/burime ujore sipërfaqësore) në mënyrë që bashkitë në rrjedhën e poshtme të mos marrin të gjitha ujërat e ndotura të bashkive në rrjedhën e sipërme dhe të mesme;
- përcaktimin e pasojave dhe masave për zbutjen e tyre që ka ndërtimi i HEC-eve në degët e Shkumbinit në cilësinë e ujit të lumenjve, në prurje, biodiversitet, dhe deri në plazhe.
- pyllëzimin e pellgut ujëmbledhës të lumit Shkumbin me qëllim shmangien e përmbytjeve dhe erozionit;
- monitorimin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore të lumit Shkumbin dhe degëve të tij dhe të ujërave të Akuiferit Quaternar të Elbasanit

Ndërgjegjësimi i qytetarëve rreth mbrojtjes së mjedisit ujor: rekomandohet që Bashkia të ndërtojë një program ndërgjegjësimi të popullsisë për rëndësinë e mbrojtjes së burimeve ujore ku të vihet theksi tek mospërdorimi i lumenjve si vende të depozitimit të mbetjeve, etj.

Zgjerimi i rrjetit të monitorimit dhe i parametrave të monitoruar në varësi të aktiviteteve ekonomike (industriale, bujqësore, etj.) të pranishme në territor: Shkumbini përshkon territore të gjera me aktivitetet të ndryshme bujqësore dhe industriale. Për fat të keq, Shkumbini monitorohet nga një numër i kufizuar stacionesh monitorimi[472]. Duke parë rëndësinë që ujërat e Shkumbinit kanë për bujqësinë dhe gjithashtu edhe si burim ushqyes për Akuiferin e Elbasanit, rekomandohet:

- Monitorimin mujor ose mundësisht ditor i cilësisë së ujërave të Shkumbinit nga ARM Elbasan gjatë gjithë vitit. Monitorimi i lumenjve deri më tani kryhet nga AKM. Është e udhës që monitorime të kryhen edhe nga ARM Elbasan. Duke qenë

e pranishme në territor, ARM Elbasan arrin të monitorojë ujërat e lumenjve Shkumbin në kohën e duhur edhe në rastet kur ka derdhje të rastësishme abuzive të lëndëve të ndryshm në lumë. ARM Elbasan duhet të paktën të ketë përgjegjësinë e monitorimit të lumit të herëpashershme sipas një Plani Monitorimi Vendor të lumit si dhe të pajiset me laborator teknik të akredituar për kryerjen e analizave të ujit.

- Shtimin e stacioneve të reja të monitorimit të lumenjve në zonat më problematike (në qendër të zonave më të banuara, në zonën ku zhvilllohet industria, etj.). Me rëndësi shihet shtimi i pikave të monitorimit siç përcaktuar më poshtë:
  - Në lumin Shkumbin në të cilin shkarkojnë ujërat e ndotura urbane (7 kolektorë kryesorë) dhe në përroin e Zaranikës në të cilin shkarkojnë ujërat e ndotura (3 kolektorë kryesorë),
  - përpara dhe pas vendgrumbullimit të mbetjeve të shpërndara në bregun e lumit në Papër.
  - në afërsi të zonës ku zhvillohet aktiviteti i përpunimmit të metaleve,
  - në zonën e shkarkimit të ujërave që vijnë nga ALBKROM, ish-Uzina e ferrokromit,
  - në fshatin Mjekës ku është vendosur Uzina e Lëndëve Plasëse

  Për këtë nevojitet bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencinë Rajonale Elbasan.
- Shtimin e numrit të parametrave të monitoruara dhe përshtatja e parametrave që duhen monitoruar për ndotjen e lumenjve në varësi të aktivitetit industrial të pranishëm në territor. Në bashkitë si Elbasani ku industria e shfrytëzimit të gëlqerorëve dhe e prodhimit të metaleve është mjaft aktive, nevojitet monitorimi i treguesve/parametrave për ndotje nga kjo industri. Gjithashtu, prania e metaleve të rënda parashtron nevojën për monitorim të metaleve të ndryshëm në varësi të industrisë që zhvillohet, si parametra monitorues për industrinë e prodhimit të metaleve, të lëndëve plasëse, etj. Sot, përveç përcaktimit të ndotjes, është e rëndësishme që të përcaktohet edhe burimi i ndotjes.

Tabela 118. Projektet e planifikuara në PPV për përmirësimin e cilësisë së ujit

Qëllimi	**Masa**	**Projekti**
Përmirësime në hidro-morfoligjinë e lumit	Krijimi i zonave ripariane	-Risistemi i zonave ripariane të lumit Shkumbin - Rehabilitimi mjedisor dhe kthimi në zonë rekreative i zonave ripariane të Lumit Zaranikë, Manazdere, Gostimë, Papër dhe Kushe - Krijimi i parqeve urbane përgjatë lumit Shkumbin (Krastë e Made-grykëderdhja e Zaranikës) - Ndërtimi i këmbëve të urës Beli,Sollak - Rikonstruksioni dhe ndërtimi i urave Polis-Vale dhe Broshkës, - Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrjetit kullues dhe ujitës për të gjithë territorin në mënyrë që të minimizohet përdorimi i tyre si shkarkim për ujërat e ndotura.
	Rehabilitimi i kanaleve vaditëse-ujitëse	
Mbrojten e burimeve ujore nga ndotja nga	Menaxhimi i integruar i mbetjeve	- Hartimi i Planit pilot të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane në nivel bashkie me synim ndarjen e diferencuar të tyrë në burim - Pastrimi nga mbetjet urbane i lumit Kushe - Pastrimi i shtratit të lumit Shkumbin nga ndotja e akumuluar

mbetjet e ngurta e të lëngta		- Përmirësimi tërësor i sistemit të kanalizimeve në rrugët "A. Mezini, P. Dodbiba, Q. Fezo, Sh. Thanasi dhe në lagjen Teqe, pranë shkollës "Sulë Domi", rruga Arif Dardhaj, tek llagka e komunitetit Rom, Rrapishtë me qëllim dërgimin e tyre në impiantin e trajtimit të ujit për të eleminuar shkarkimin e drejtëpërdrejtë këtyre ujërave në lumin Shkumbin - Ndërtimi i një impianti të trajtimit të ujërave të zeza e propozuar dhe në PPV e mëparshme, - Ndërtimi i pikave të transferimit të mbetjeve në Labinot-Fushë, Tregan dhe Gjinar
Ulja e ndotjes nga zonat ish-industriale	Pastrimi dhe rehabilitimi i zonave ish-industriale	- Pastrimi i zonave nga ndotja e trashëguar industriale - Rehabilitimi i tyre me qëllim përdorimi ekonomik - Pastrimi i zonave ish-industriale nga ndotja

Burnimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

- **Burimet ujore nëntokësore**

Qarku i Elbasanit ku bëjnë pjesë dhe Bashkia e Elbasanit , Peqinit, Belshit dhe Gramshit është i pasur me burime ujore nëntokësore ndër të cilët dallojmë Akuiferin Kuaternar të Elbasanit me shtrirje përgjatë Shkumbinit dhe akuiferët në zonat karstike/gëlqerore si masivët gëlqerorë të Bërzeshtës, Polisit, brezit Mirakë-Jabllanicës (akuiferët me çarje-karts). Duke u mbështetur në studimet e kryera nga SHGJSH rreth problematikave të ndryshme të akuiferëve në Qarkun e Elbasanit[473], lind nevoja të merren disa masa të rëndësishme për mbrojtjen e tyre. Disa nga këto masa renditen më poshtë

Ndalimi i menjëhershëm i furnizimit me ujë të popullsisë nga pusshpimet Vidhas-Papër (Akuiferi i Elbasanit): ujërat nëntokësore të Akuiferit të Elbasanit janë ndikuar për një kohë të gjatë nga aktivitetet industriale në zonën e Kombinatit Metalurgjik. Për aq kohë sa nuk ka studime të thella për ndikimin e industrisë në cilësinë e ujërave të këtij akuiferi, rekomandohet me forcë që ujërat e Akuiferit të Elbasanit të marra nga pus-shimet Vidhas-Papër të mos përdoren për furnizimin me ujë të popullsisë së Bashkisë Elbasan.

Monitorimi në mënyrë urgjente i Akuiferit Quaternar të Elbasanit për ndotje nga industria që zhvillohet brenda zonës industriale të Qytetit. Monitorimi duhet të ketë si qëllim të përcaktojë llojin e përdorimit të ujërave të Akuiferit Quaternar të Elbasanit për çdo pus-shpium (nëse ujërat e këtij Akuiferi mund të përdoren për furnizim me ujë të popullsisë). Deri më sot, aktiviteti industrial në zonën e Elbasanit ka ndotur ujërat sipërfaqësore, tokën dhe ajrin,[474] si dhe disa burime ujore nëntokësore si në zonën e Vidhas-Paperit të cilët përdoren për ujë të pijshëm[475]. Zhvillimi i industrisë në qytetin e Elbasanit dhe derdhja e ujërave të përdorur industriale në lumin Shkumbin pa një trajtim paraprak sjell domosdoshmërisht nevojën e monitorimit të ujërave të Akuiferit Quaternar të Elbasanit për ndotje nga industria dhe përcaktimin e përdorimit të ujit (si ujë për industrinë, për popullsinë, për bujqësinë, etj.). Nevoja është urgjente edhe për faktin se ujërat e Akuiferit të Elbasanit përdoren për furnizimin me ujë të popullsisë në Bashkinë Elbasan.

Zbatimi dhe mbrojtja e zonave higjeno-sanitare përreth pus-shpimeve (legale/ilegale): Në Bashkinë e Elbasanit, pus-shpimet janë shpërndarë përgjatë brigjeve të Shkumbinit, nga zona Labinot-Fushë deri në Vidhas, dhe të pellgjeve të tyre ujëmbledhëse përkatëse në zona me përdorim të ndryshëm toke (bujqësor dhe industrial). Nga studimet e kryera[476], mungesa e zbatimit të zonave higjeno-sanitare përreth pus-

shpimeve është përcaktuar si një ndër shkaqet kryesore që çojnë në ndotjen e akuiferëve. Për këtë arsye, rekomandohet që Bashkia e Elbasanit:

- Të krijojë një regjistër ku të regjistrohen pus-shpimet legale dhe ilegale në territor dhe vendodhja e tyre me qëllim përcaktimin e cilësisë së këtyre ujrave dhe gjetjen e mundësisë për shmangien e konflikteve më veprimtaritë e tjera (industria, bujqësia, urbanizimi) që shkaktojnë ndotje në to. Pus-shimet duhen klasifikuar sipas nivelit të rrezikshmërisë që ato paraqesin për ndotjen e ujërave nëntokësore. Kjo ndihmon për inspektimin e tyre të tyre të herë pas hershëm.
- Të krijojë dhe mbrojë zonat higjeno-sanitare përreth të gjitha pus-shpimeve në zbatim të Ligjit 111/2012 "Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" dhe VKM nr.145, datë 26.2.1998 " Për miratimin e rregullores higjeniko-shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm". Me interes të veçantë paraqiten pus-shpimet për përdorim industrial, të vendosura në Komunën e Bradasheshit.
- të zonohet territori sipas ndjeshmërisë së akuiferëve ndaj ndotjes sipërfaqësore në rast shpimesh. Kjo ndihmon për të përcaktuar se në cilat zona lejohen shpimet sepse nuk përbëjnë rrezik ndotjeje për akuiferët dhe në cilat zona ndodh e kundërta. Në rast të kundërt, rekomandohet krijimi i një liste në të cilën pusshimet të renditen sipas nivelit të rrezikshmërisë që ato paraqesin për ndotjen e ujërave nëntokësore me qëllim ushrimin e kontrollit të tyre në mënyrë periodike.
- Të ndalohet shkarkimi i ujërave të ndotura industriale në lumin Shkumbin në mënyrë të menjëhershme

Krijimi i zonave të mbrojtura me status të veçantë (Dritaret hidrogjeologjike): Në disa zona të bashkisë, ujërat sipërfaqësorë (Labinot-Fushë deri në Vidhas) kanë lidhje të mira hidrologjike me ujërat nëntokësore. Në Akuiferin e Elbasanit, këto zona shtrihen në territorin e bashkisë Elbasan. Si rrjedhojë, lind nevoja që në ato zona ku ujërat sipërfaqësorë të lumenjve ushqejnë akuiferët, të krijohen zona të mbrojtura me status të veçantë (Dritare Hidrogjeologjike).[477] Të tilla zona janë të rëndësishme për mbrojtjen e akuiferëve nga ndotja dhe duhen konsideruar si Zona të Mbrojtura gjatë planifikimit të zhvillimit të territorit në Bashki. Në zonat me status Dritare Hidrogjeologjike rekomandohet që toka të përdoret për aktivitetet që nuk shkaktojnë ndotje në mjedis. Si hapa të parë në Bashkinë e Elbasan, rekomandohet:

- dhënia e statusit "Zonë e Mbrojtur me Status të Veçantë" për zonat që shërbejnë si Dritare Hidrogjeologjike (ato zona të territorit që ushqejnë akuiferët). Përgjatë zonës Labinot Fushë-Vidhas[478] kjo është zona ku ujërat e Shkumbinit ushqejnë Akuiferin e Elbasanit. Në luginën e lumenjve të basenit të Shkumbinit, për përcaktimin e dritareve hidrogjeologjike nevojitet bashkëpunimi me SHGJSH-në.
- Në zonat e quajtura dritare hidrogjeologjike, të ndalohet dhënia e lejeve për aktivitete ndotëse[479] ose të ndërpritet leja e aktiviteteve aktuale që shkaktojnë ndotje në mjedis. Rekomandohet që të vendosen kushte të rrepta që garantojnë mbrojtjen e ujërave nëntokësore gjatë dhënies së lejeve për aktivitete të ndryshme në këto zona.

- Në zonat me status Dritare Hidrogjeologjike rekomandohet që toka të përdoret për aktivitetet që nuk shkaktojnë ndotje në mjedis

Ndalimi i dhënies së lejeve të shfrytëzimit për inertet lumore në zona të ndjeshme ndaj ndotjes: rekomandohet ndalimi i dhënies së lejeve të shfrytëzimit të inerteve lumore në zonat e ndjeshme, sidomos në zonat nga Fushë-Labinoti deri në Papër ose nga Vidhasi – Bujqës, me qëllim ruajtjen e ekulibrave hidrodinamikë të akuiferëve, në bashkëpunim me Këshilllin dhe Agjensinë e Baseneve Ujor të Shkumbinit. Ky rekomandim vjen edhe në zbatim të VKM Nr.1, datë 21.6.2006 "Për Reduktimin e shfrytëzimit të zhavoreve dhe rërave në shtretërit e lumenjve",

Shtimi i pikave të monitorimit të ujërave nëntokësore dhe i parametrave të monitoruar në varësi të aktiviteteve ekonomike në zonë: AKM në bashkëpunim me SHGJSH monitoron gjendjen e burimeve ujore nëntokësore rregullisht me bazë vjetore[480]. Megjithatë, vihet re se numri i pikave të monitorimit për përcaktimin e cilësisë së ujërave nëntokësore në çdo basen e akuifer është i ulët, ndërkohë që zonat me ndjeshmëri të lartë ndotjeje janë të shumta, veçanërisht në akuiferin e Elbasanit. Në pikat më problematike që përkojnë me shtrirjen e lumit Shkumbin mbi akufierin e Elbasanit, veçanërisht aty ku ndodhen aktivitetet industriale me Kombinatin Metalurgjik, rekomandohet që të shtohen pikat e monitorimit të akuiferëve dhe shtimi i parametrave të monitoruar. Në Bashkinë Elbasan rekomandohet monitorimi i parametrave që tregojnë edhe ndotjen nga industria që zhvillohet aty.

Hartimi i një Plan Veprimi për Praktikat e Mira Bujqësore: Problem në burimet ujore përbëjnë dhe infiltrimet e kimikateve dhe pesticideve që përdoren në bujqësi. Rekomandohet që bashkia të hartojë një Plan Veprimi për Praktikat bujqësore që duhet të ndiqen në mënyrë që të minimizohen përdorimet e këtyre kimikateve.

- *Shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve ujore të akuiferëve*

Pajisja me një pasqyrë të rezervave vjetore të ujërave nëntokësore në akuiferë. Pasqyra të kihet parasysh gjatë dhënies së lejeve për shfrytëzimin e ujërave të akuiferëve me qëllim shfrytëzimin e qëndrueshëm të tyre.[481] Rritja e kërkesës për ujë për nevoja familjare dhe veprimtari të ndryshme ekonomike ka rritur trysninë mbi akuiferët, në veçanti mbi Akuiferin e Elbasanit, duke çuar në mbishfrytëzimin e tyre. Në periudhën me reshje të pakta në verë (Qershor-Shtator), kërkesa për ujë rritet edhe më tej nga sektori i turizmit e bujqësisë. Në këtë periudhë, akuiferët kanë nivelin më të ulët të ujit në krahasim me periudhat e tjera të vitit për shkak të mungesës së shirave. Rol kryesor në menaxhimin e akuiferëve kanë SHGJSH-ja, Agjencia e Menaxhimit të Basenit të Shkumbin (ABU Shkumbin) së bashku me Bashkinë e Elbasanit dhe bashkitë e tjera përkatëse që shfrytëzojnë akuiferët. Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve ujorë rrjedh si pasojë e zbatimit të ligjit nr.111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore"

Monitorimi i sasisë së ujit që shfrytëzohet nga akuiferët në Qarkun Elbasan e Bashkitë e tij: Sipas ligjit Nr.111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", Bashkisë së Elbasanit në bashkëpunim me AKM, ARM dhe Këshillin dhe Agjensinë e Basenit Ujor të Shkumbinit i del për detyrë të mbikqyrin dhe të detyrojnë subjektet dhe individët të instalojnë pajisje për mbajtjen nën kontrroll dhe matjen e sasisë së përdorimit të ujit në tokë private për të eleminuar lidhjet e paligjshme dhë shfrytëzimin e pakontrrolluar të akuferit ujëmbajtës. Kjo do të sillte një mirëmenaxhim të burimeve ujore

dhe, përsa i përket Akuferit të Elbasanit, Bashkia do të kishte informacion më të saktë për përdorimin e tij.

Të analizohen akuiferët në thellësi mbi 200m: deri më sot, SHGJSH ka kryer studime përreth akuiferëve të cekët (nën 200m thellësi). Duke qenë se industria në përgjithësi shfrytëzon edhe ujërat e akuiferëve në thellësi mbi 200m, kërkohet që këto akuiferë të pasqyrohen në inventarin e burimeve ujore në mënyrë që të përcaktohet ndikimi i industrisë në këto akuiferë dhe pasojat që mbishfrytëzimi i tyre mund të ketë në supërfaqe (ulje të nivelit të tokës).

Mbrojtja dhe ruajtja e ujërave termo-mineral si Llixhat e Elbasanit, pus- shpimi në Dëshiran dhe burimi i Holtës. Mbrojtja e tyre dhe hartimi i një plan menaxhimi për këto ujra do të sillte përfitime socale dhe ekonomike

Mbyllja dhe rehabilitimi i gropave septike: Në zonat rurale të bashkisë sistemi i kanalizimeve nuk e mbul të gjithë popullsinë e vendosur në këto zona. Për largimin e ujërave të ndotura nga shtëpitë e tyre popullsia ka ndërtuar gropa septike jashtë çdo standarti tekniko-sanitar duke krijuar kështu probleme në ujërat nëntokësorë dhe sipërfaqësorë. Ujërat e vendosura në këto gropa largohen nga aty nëpërmjet kanaleve të hapura kulluese duke kryer shkelje të legjislacionit në fuqi. Bashkisë i del për detyrë të :

- lokalizojë vendosjen e gropave septike jashtë standarteve tekniko-sanitare dhe të vendosë mbylljen dhe rehabilitimin e gropave ekzistuse

hartojë një plan informimi për mënyrën e ndërtimit të gropave septike.

2.3.5 Rekomandime mbi zonat e nxehta mjedisore

Në territorin e Bashkisë Elbasan ndodhen disa zona të nxehta (shih seksioni e Vatrat e Nxehta Mjedisore) mjedisore që kanë nevojë për rihabilitim sa më të shpejtë me qëllim shmangien e ndotjes së mjedisit dhe rreziqeve që i kanosen shëndetit të banorëve që jetojnë ngjitur ose përreth këtyre zonave. Zonat kryesore të nxehta mendohet se janë venddepozimi i mbetjeve urbane dhe venddepozitimet industriale.

Me qëllim përmirësimin e vatrave të nxehta mjedisore dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve të saj, Bashkia Elbasan ka parashikuar marrjen e disa masave në Planin e Përgjithshëm Vendor i cili është në fazë miratimi. Këto masa përfshijnë rehabilitimin e zona e Shkrirjes së Ferro-kromit, Ndërmarrja e Furnizimit Industri-Miniera, Uzimna e lëndëve plasëse. (Tabela mëposhtë).

Në funksion të uljes së ndikimit negativ mjedisor të vatrave të nxehta mjedisore dhe rehabilitimin e tyre, krahas masave të propozuara në PPV rekomandohen edhe masa të tjera si:

- Masa të tjera shtesë

Rekomandohet që Bashkia e Elbasanit të marrë masa të menjëhershme drejt trajtimit të zonave të nxehta mjedisore për :

- **Rihabilitimi i venddepozitimit të vjetër** me qëllim shmangien e ndotjes së tokës e ujërave nëntokësorë nëpërmjet shllamit që krijohet nga shpërbërja e mbetjeve.

- **Hartimi i një plani për venddepozitimin / trajtimin e mbetjeve të rrezikshme** që planifikohet të grumbullohen nga rihabilitimi i vatrave të nxehta (zona e Shkrirjes së Ferro-kromit, Ndërmarrja e Furnizimit Industri-Miniera, uzimna e lëndëve plasëse.). Mbetjet e depozituara në këto vatra të nxehta mjedisore janë kryesisht të rrezikshme. Rrjedhimisht, marrja e masave paraprake për trajtimin dhe depozitimin e tyre përfundimtar është e pashmangshme, në mënyrë që mos të krijohet një tjetër vatër e nxhehtë mjedisore (kjo nisëm realizohet në bashkëpunim me organet e pushtetit qendror, për arsye se mbetjet industriale nuk menaxhohen nga Bashkia).
- **Ndërtimi i një stacioni trasferimi për mbetjet industriale,** kryesisht mbetjet e krijuara nga industria e naftës, deri në një moment të dytë kur institucionet përkatëse të japin një zgjidhje përfundimtare për depozitimin e tyre përfundimtar.
- **Marrja e masave për parandalimin e ndotjes së mjedisit gjatë rehabilitimit të zonave të mbrojtura.** Më konkretisht, rekomandohet transportimi i dheut të hequr pa u depozituar fillimisht në zonat përreth duke shmangur kështu ndotjen e zonës, përdorimin e makinerive të përshtatshme, shmangien e icidenteve që mund të ndodhin nga grumbullimi i mundshëm i gazit në shtresat e poshtme të mbetjeve të depozituara, etj.

Tabela 1191. Projektet e planifikuara në PPV për trajtimin e zonave të nxehta mjedisore

Qëllimi	Masa	Projektet
Masa për trajtimin e zonave të nxehta	Pastrii dhe rehabiltimi i zonave industriale dhe ish industriale	- Pastrimi i zonës nga ndotjet e trasheguara industriale - Rehabilitimi i zonës dhe kthimi i saj në zonë të përshtatshme për ndërtimin e objekteve me karakter ekonomik - Pastrimi i zonave ish-industriale nga ndotjet e trasheguara

Burnimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

2.4 Plani i veprimeve për zbatimin e PPV-së

2.4.1 Fazat e zbatimit të planit

Ndërhyrjet e propozuara në Plan janë fazuar për të lehtësuar realizimin e tyre gjatë periudhës së zabtimit të këtij Plani. Fazimet janë realizuar duke marrë në konsideratë:

- Projektet që lidhen me nevojat emergjente të banorëve;
- Projektet prioritare që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me zhvillimin e bashkisë;
- Vështirësitë për realizimin e projekteve të caktuara me sukses ;
- Projektet madhore (që kanë ndikim jo vetëm vendor, por edhe kombëtar), të cilat kërkojnë kohë për t'u realizuar;
- Interesat për zhvillim dhe politika e territorit që bashkia dëshiron të vendosë në jetë.

Sipas VKM-së 671, neni 54, fazimi i planit është realizuar për:

- Njësitë strukturore;
- PDV-të;
- Zonat me prioritet zhvillimi;

- Rrjetit infrastrukturor dhe
- Projekteve.

Fazat e zbatimit të projekteve të këtij plani janë:

- Faza 1: faza prioritare në të cilën parashikohen projekte afatshkurtra 1-3-vjeçare;
- Faza 2: projektet janë prioritare por vështirësia e realizimit dhe kostot e tyre janë të larta. Këto janë projekte afatmesme dhe mund të nisin, sipas rastit që në vitin e parë e të zgjatin deri në 5 vite ose të nisin pas periudhës afatshkurtër 3-vjeçare;
- Faza 3: është faza afatgjatë e cila nis pas 5 viteve të para, pas miratimit të planit dhe është e pamundur të përcaktohet se si do të ndahen projektet në këtë fazë. Bashkia duhet ta rishikojë çdo 3 vite Planin e Investimeve Kapitale, dhe në këtë proces mund të renditë projektet sipas prioriteteve të kohës.

Tabela 120. Fazat e zbatimit të projekteve në Bashkinë Elbasan

Objektivat, Programet dhe projektet e Planit	Fazat e zbatimit		
O1: Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik	0-3 vite	3-5 vite	mbi 5 vite
O1P1: Mbështetje me infrastrukturën e nevojshme për përqendrimin e bizneseve të industrisë në zonën e Metalurgjikut.			
Pr1: Pastrimi i Metalurgjikut nga ndotjet e trashëguara industriale			
Pr2: Rehabilitimi i zonës dhe kthimi i saj në zonë të përshtatshme për ndërtimin e objekteve me karakter ekonomik.			
O1P2: Nxitje e sipërmarrjes private dhe biznesit për të rivitalizuar me aktivitetin e tyre ish-zonat industriale/ ekonomike të Elbasanit në bashkëpunim me Bashkinë si negociator kryesor për të rigjeneruar edhe hapësirën publike me anë të instrumentit të manaxhimit të tokës			
Pr3: Pastrimi i zonave ish-industriale nga ndotjet e trashëguara.			
O1P3: Intensifikimi i aktivitetit urbanizues brenda qendrave ekzistuese urbane të njësive administrative			
Pr4: Intensifikimi i qendrës së Elbasanit me banim, shërbime, zona ekonomike dhe hapësira publike.			
Pr5: Ofrimi i shërbimeve të nevojshme për banorët në qendrat e njësive administrative.			
Pr6: Përmirësim i fasadave në rrugët kryesore dhe ndërtimi i 100 banesave kolektive			
O1P4: Mbështetje, marketim, promovim, përmirësim klime dhe aftësim i biznesit lokal në funksion të zhvillimit të ekonomisë lokale.			
Pr7: Krijimi i pikave të grumbullimit për produktet bujqësore dhe blegtorale			
O1P5: Rigjenerimi dhe zhvillimi i hapësirave publike në qytetin e Elbasanit dhe qendrat urbane të Njësive Administrative, përmes instrumenteve financiare, dizajnit urban dhe PPP-ve			
Pr8: Rigjenerimi i qendrave të njësive administrative, duke risistemuar hapësirat publike dhe ofrimi i shërbimeve të munguara.			
Pr9: Krijimi i parqeve urbane përgjatë lumit Shkumbin			
Pr10: Krijimi i parkut tematik rrëzë kodrës së Krastës (ish-zonë ushtarake)			
Pr11: Kthimi i kodrës së Krastës në park urban për banorët e Elbasanit (pajisje me elemente të dizjanit urban, ndërtim i kalimeve të këmbësorëve dhe kalimeve të biçikletave)			
Pr12: Rikonstruksion i Pallatit të Sportit, pajisja e teatrit "Skampa" me ndriçim dhe foni dhe ndriçimi i stadiumit "Ruzhdi Bizhuta"			
Pr13: Ofrimi i internetit falas në të gjitha njësitë administrative			
O2: Mbrojtja e rigjenerimi i burimeve natyrore			

O2P1: Mbrojtja e sistemit urban nga përmbytjet dhe dalja e vazhdueshme e lumit Shkumbin nga shtrati duke rehabilituar argjinaturat ekzistuese
Pr1: Pastrimi i shtratit të lumit Shkumbin
Pr2: Risistemi i zonave ripariane të lumit Shkumbin
Pr3: Krijimi i parqeve urbane përgjatë lumit Shkumbin, në segmentin nga Krasta e Madhe deri në grykëderdhjen e lumit të Zaranikës.
Pr4: Rigjenerimi i parkut të Krastës
O2P2: Rehabilitimi i shtretërve, brigjeve lumore dhe zonave riapariane të Shkumbinit, Zaranikës, Manazderes, Papërit, Gostimës dhe Gostrimës dhe Kushes.
Pr5: Rehabilitimi dhe sistemimi i zonave ripariane të lumit Zaranika, Manazdere, Gostimë, Gostrimë, Papër dhe Kushe
Pr6: Pastrimi nga mbetjet urbane i lumit Kushe
O2P3: Përmirësimi i infrastrukturës (nëntokësore) të ujësjellësit dhe KUZ-it
Pr7: Ndërtimi, supervizimi dhe kolaudimi i KUZ-it në 4 rrugët "A. Mezini", "P. Dodbiba", "Q. Fezo", "Sh. Thanasi"
Pr8: Risistemimi i sistemit të kanalizimeve, dhe depozitimi i ujërave të ndotura në impiantin e trajtimit të ujërave
Pr9: Supervizimi dhe kolaudimi punimesh për ndërtimin e ujësjellësit Muriqan
Pr10: Vazhdimi i ndërtimit të KUZ-it në lagjen "Teqe", pranë shkollës "Sulë Domi", rruga "Arif Dardhaj", tek lagjia e komunitetit Rom, Rrapishtë
Pr11: Ndërtimi i ujësjellësit Përroi Mollës- Shelcan- Mlizë- Trebsenisht- Tudan- Lleshan- Kukan- Pobrat
O2P4: Hartimi dhe zbatimi i planit afatmesëm për manaxhimin e pyjeve dhe kullotave lokale
Pr12: Ripyllëzimi i zonave të dëmtuara nga aktiviteti njerëzor në njësitë administrative: Papër, Gracen, Labinot-Mal, Zavalinë, Gjinar, Shushicë
Pr13: Ndërtimi i biokorridorit mjedisor (duke ripyllëzuar dhe duke mbjellë fidanishte në zonat e dëmtuara) përgjatë gjithë vijës administrative të Elbasanit, nga zona e mbrojtur Sopot-Stavraj deri tek zona tjetër e mbrojtur Kutërman-Qafë e Bushit
O2P5: Përmirësimi i shërbimit të manaxhimit të integruar të mbetjeve urbane.
Pr14: Ndërtimi i pikës së Transferimit në Labinot Fushë; ndërtimi i pikës së Transferimit në Tregan; ndërtimi i pikës së Transferimit në Gjinar
Pr15: Projekti i pilotimit të ndarjes së diferencuar të mbetjeve urbane
O2P6: Zbutja e efekteve mjedisore nga aktiviteti industrial
O2P7: Hartimi dhe vënia në jetë e planit sektorial për turizmin në nivel bashkie.
Pr17: Krijimi i guidave informuese dhe ngritja e info point për turistët.
O2P8: Rrjetëzim i aseteve historike.
Pr18: Restaurimi i Kalasë së Elbasanit, kishës së Gjinarit dhe kishës në Xibrakë (Labinot Fushë)
O2P9: Infrastrukturat e nevojshme për zhvillimin e ekoturizmit
Pr19: Ndërtimi i fermave ekoturistike në Tregan, Gjinar, Funarë, Gracen, dhe Labinot Mal
O3: Zhvillimi i infrastrukturës së aksesit/lëvizjes
O3P1: Rehabilitimi dhe përmirësimi i rrugëve ekëzistuese
Pr1: Sistemim dhe asfaltim i pjesëve të caktuara të rrugës Qemal Stafa dhe pajisja e saj përfshirë pajisje me sinjalistikë rrugore (semaforë)
Pr2: Pajisje me ndriçues e rrugëve "Qemal Stafa", "Thoma Kalefi" dhe "Aqif Pasha".
Pr3: Sistemim dhe asfalti i rrugëve të brendshme të qytetit si dhe rrugëve të kalasë
Pr4: Rikonstruksion i urës Polis-Vale, ndërtim i këmbëve të urës Beli, Sollak, rikonstruksion i urës së Broshkës
O3P2: Konsolidimi i lidhjeve të qendrave kryesore urbane me qytetin e Elbasanit
Pr5: Ndërtimi i bypass-it
O3P3: Konsolidimi i unazës së madhe të bashkisë Elbasan
Pr6: Ndërtimi i unazës në pjesën veri-perëndimore dhe verilindore të qytetit. Unaza kalon në dy segmente të saj përgjatë lumit të Zaranikës dhe përgjatë lumit të Manzderes.

O3P4: Përmirësimi i aksesit të qendrave të njësive dhe lidhjes me njëra-tjetrën dhe me qytetin e Elbasanit	
Pr7: Zgjerim i rrugëve rurale Elbasan-Gjinar-Zavalinë, Elbasan-Funarë (Kusarth-Balëz-Letan-Bicellë-Funarë) dhe me korsi biçikletash dhe ristrukturimi dhe ndërtimi i segmenteve rrugore që mungojnë në aksin lidhës Tregan-Blerimas-Strestan-Gjinar; ristrukturimi i rrugës Qafë Hajdaran-Byshek; ndërtimi i rrugës nga shkëmbi i Çaprazit-Pajun; ristrukturimi i rrugëve të brendshme në: Katundin e ri, lagjen Harvales, Kusarth-Karakullak	
O3P5: Intensifikimi i zhvillimit në njësitë administrative përreth luginës së lumit Shkumbin	
Pr8: Ofrimi i shërbimeve të munguara në njësitë administrative: Gjergjan, Shirgjan, Mjekës, Hajdaran, Shushicë, Labinot Fushë, Papër	
O3P6: Përmirësimi i transportit publik ndërqytetës, infrastruktura, stacione	
Pr9: Ofrimi i transportit publik në njësitë administrative që mungon (Gracen, Labinot-Mal, Funarë, Zavalinë)	
Pr10: Ndërtimi i stacionit për mallra në zonën ndërmjet lumit të Zaranikës dhe zonës së ish-Metalurgjikut	
Pr11: Rikonstruksioni i stacionit të vjetër të trenit	
Pr12: Ndërtimi i stacionit për pasagjerë në Labinot-Fushë, përgjatë rrugës Elbasan-Librazhd.	
O3P7: Rregullimi i trafikut të qytetit	
Pr14: Ndërtimi i rrethrrotullimeve tek: ura e parë e Zaranikës; kryqëzimi i stacionit të trenit, kryqëzimi tek Metalurgjiku, kryqëzimi pranë urës së Cërrikut, kryqëzimi i rrugës "Kadri Hoxha" me rrugën "Çerçiz Topulli".	
O3P8: Nxitja e investimeve publike dhe private në fushën e mobilitetit të gjelbër dhe shërbimeve të tjera publike	
Pr15: Ndërtimi i rrjetit të gjelbër në qytetin e Elbasanit (rrugët e përcaktuara në hartën e infrastrukturës së propozuar)	
Pr16: Lidhja e njësive administrative (Funarë, Labinot Mal, Gjinar, Tregan Papër) që kanë potencial turistik me Elbasanin me infrastrukturë të gjelbër	
Pr 17: Shrponësime për varreza publike	
O4: Zhvillim bujqësor e rural	
O4P1: Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrjetit kullues dhe ujitës	
Pr1: Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrjetit kullues dhe ujitës për të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan	
Strategjik O4P2: Programimi dhe hartimi i instrumenteve të menaxhimit të tokës për bujqësinë	
Pr2: Zbatimi i programit për Transferimin e të Drejtave të Zhvillimit	
Pr3: Mbjellje me arrorë (shegë) në NjA-në Gjergjan	
Pr4: Zbatimi i intensitetit me kushte në zonat urbane qendrore	
O4P3: Nxitja e zhvillimeve të strukturave në funksion të bujqësisë përmes PPP-ve	
Pr5: Ndërtimi i pikave të grumbullimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore	
Pr6: Konsolidimi i fashës ekonomike nga kodra e Krastës në drejtim të Labinot Fushë dhe fashës ekonomike bujqësore Cërrik-Shirgjan	
O5: Zbutja e pabarazive dhe zhvillimi i infrastrukturës sociale	
O5P1: Përmirësimi i shërbimit spitalor	
Pr1: Zgjerimi i spitalit rajonal në qytetin e Elbasanit	
O5P2: Ndërhyrje rehabilituese të qendrave mjekësore/ ambulancave	
Pr2: Përmirësim i infrastrukturës së qendrave shëndetësore në Bradashesh Papër, Tregan, Shushicë dhe Zavalinë	
O5P3: Çelja e disa departamenteve të arsimit të lartë publik	
O5P4: Nxitje për arsimin profesional	
Pr4: Çelja e programeve të arsimit të mesëm profesional në shkollat profesionale ekzistuese në Bashkinë Elbasan.	
Pr5: Ndërtimi i një shkolle të mesme profesionale në rajonin 3 të Bashkisë Elbasan.	
O5P5: Ndërhyrje rehabilituese të kopshteve, shkollave 9-vjeçare dhe të mesme	

Pr6: Rikonstruksion i plotë në shkollat 9-vjeçare, kopshtet dhe shkollën pedagogjike në njësi administrative
Pr7: Supervizim punimesh dhe lidhje energjie elektrike dhe ujësjellësi në shkollën 9-vjeçare "Xhaferr Hakani". Mbikëqyrje punimesh për ndërtimin e shkollës 9-vjeçare në Sollak
Pr8: Përshtatja e konvikeve të shkollës së muzikës për ambiente zyrash; rikonstruksion i ambienteve të konviktit të shkollës Pedagogjike.
O5P6: Mbështetje e gjithë shtresave të popullsisë për një strehim sa më të përballueshëm
Pr9: Ndërtimi i banesave sociale dhe pajisja e tyre me pompa uji dhe pajisje të tjera të nevojshme
Pr10: Supervizim dhe kolaudim për rikonstruksionin e banesave të komunitetit Rom dhe Egjiptian

Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

2.4.2 Plani i Investimeve Kapitale

Ky kapitull i Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Elbsan është dokument i veçant, pjesë përbërëse e materialeve.

2.4.3 Monitorimi i zbatimit të planit dhe çështje institucionale ligjore

Në përgjithësi, propozimet e planit, përveç atyre që kanë të bëjnë specifikisht me masat mjedisore, nuk kërkojnë ndryshime në kuadrin ligjor e administrativ, së paku jo për periudhën afatshkurtër. Propozimet institucionale e ligjore për zbatimin e masave mjedisore janë trajtuar në mënyrë të zgjeruar në tekstin e VSM-së. Tabela përmbledhëse e këtyre propozimeve jepet më poshtë.

Përtej çështjeve mjedisore, sugjerimi kryesor është që PPV-ja të zbatohet për të paktën dy vite, periudhë gjatë të cilës Bashkia do të monitorojë jo vetëm zbatimin, por edhe vështirësitë e hasura. Këto do të raportohen në Raportin e Territorit. Kjo periudhë zbatimi do të ndihmojë që Bashkia të përpilojë propozime në lidhje me ndryshimet e nevojshme në bazën ligjore dhe/ose administrative për planifikimin, sektorë të tjerë, dhe sipas rastit edhe për strukturën administrative në nivel vendor. Sigurisht këto propozime mbeten sugjerime në rast të një procesi të mundshëm ndryshimi të bazës ligjore. Pra, në tërësi, për periudhën afatshkurtër nuk mendojmë se nevojiten ndryshime ligjore dhe/ose administrative në nivel kombëtar.

Megjithatë, eksperienca e hartimit të PPV-së, parashtron disa sugjerime paraprake si në vijim, një pjesë e të cilave janë të tilla që duhet të shqyrtohen nga institucionet e nivelit kombëtar (në rast rishikimi të bazës ligjore) dhe një pjesë që vetë Bashkia do të punojë për t`i realizuar gjatë zbatimit të PPV-së. Sa u përket propozimeve për nivelin vendor, ato janë brenda dhe në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar, por vijnë si procedura të mundshme që Bashkia ka të drejtë të hartojë e realizojë në kuadër të autonomisë vendore dhe pa rënë ndesh me legjislacionin në fuqi.

Sugjerime në nivel kombëtar, në rast ndryshimi të bazës ligjore:

- Gjatë zbatimit të PPV-së, mund të lindë nevoja për të ndryshuar intensitetin e ndërtimit dhe/ose koeficientin e shfrytëzimit të tokës për ndërtim (Ksht). Këta koeficientë kanë natyrë shumë teknike dhe janë shumë të rëndësishëm për procesin e zhvillimit dhe veçanërisht pronarët dhe zhvilluesit. Bashkia, mund t`i shfrytëzojë këta koeficientë në zbatimin e Intensitetit me kushte, pra për të përfituar

infrastrukturë publike. Ky proces ndryshimi kërkon fleksibilitet për të qenë efiçient dhe fitimprurës.

Për sa kohë që ndryshimi i nevojshëm/kërkuar nuk bie ndesh me propozimet e planit, me legjislacionin e posaçëm (sektorial) dhe treguesit për Kshp dhe Kshr (koefiçientë të interesit publik dhe që nuk duhet në asnjë mënyrë të zvogëlohen), sugjerohet që legjislacioni i planifikimit (në një ndryshim të mundshëm) të parashikojë ndryshim të **I** dhe **Ksht** vetëm me ndryshim të rregullores dhe miratim në Këshill Bashkiak, pa qenë i nevojshëm kalimi në KKT. Procesi duhet të jetë transparent dhe nevojitet një procedurë për ta realizuar. Këtë propozim nuk e përmban aktualisht ligji, por vjen si sugjerim për një ndryshim të mundshëm ligjor në të ardhmen.

- Po ashtu, nevojitet që legjislacioni i planifikimit dhe zhvillimit të territorit të rishikojë **dokumentacionin që dorëzohet për leje për objektet e vogla** (shiko tabelën e monitorimit në vijim) **në zona rurale**. Nevoja për të ndërtuar këto objekte mbetet shpesh peng i projektit, liçencave profesionale dhe kolaudimit e çertifikimit. Bashkia do të realizojë një procedurë të brendshme për ta lehtësuar procesin e lejes së ndërtimit për këto objekte duke zbatuar legjislacionin në fuqi, por do të ishte e udhës që ky rregullim të bëhej në VKM-në përkatëse.
- Një ndryshim ligjor që identifikohet si mjaft i nevojshëm dhe sugjerohet ka të bëjë **me ndryshimin e resursit të tokës bujqësore në urbane** (konvertimi i tokës), sipas legjislacionit aktual për bujqësinë/tokën bujqësore. Aktualisht, ky legjislacion përcakton se ndërtimet për interes bujqësor që lejohen të ndodhin në tokë bujqësore (llojet e ndërtimeve listohen në VKM nr 283, datë 01.04.2015, "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore", i ndryshuar), dhe si pjesë e procedurës së lejes së ndërtimit është ndryshimi paraprak i resursit të tokës bujqësore në urbane. Një veprim i tillë do të rezultojë në ndërtime për interes bujqësor që do të fragmentojnë tokën bujqësore duke krijuar ishuj urbanë.

  Pavarësisht se legjislacioni nuk lejon ndryshimin e përdorimit të objektit të ndërtuar, është më me vlerë që konvertimi i tokës të mos kryhet. Subjekti ndërtues/pronari i tokës mund të kërkojë të ndryshojë destinacionin e sipërfaqes së ndërtuar pas për shembull 10 apo 15 viteve, dhe kjo mund të lejohet për sa kohë që ndryshimi i destinacionit ndodh brenda listës së objekteve për interes bujqësor. Për shembull, një pronar mund të kërkojë që parcelën e zhvilluar si serë ta kthejë në stallë, apo anasjelltas. Në këtë mënyrë sigurohet fleksibilitet për ndërtimet e lejuara në tokë bujqësore dhe në të njëjtën kohë parandalohet fragmentimi i saj dhe konvertimi gradual e me leje në tokë urbane.
- Është e nevojshme që koncepti **zonë ripariane** të bëhet i detyrueshëm me ligj, dhe pa ndryshuar pronësinë. Mbjellja e zonës ripariane duhet të kryhet nga autoritetet publike, edhe nëse pronësia e tokës është private. Në këtë zonë, pronarët kufizohen në të drejtat e tyre për ndërtim dhe bujqësi dhe bashkia dhe autoritetet qendrore duhet të parashikojnë instrumente dhe masa për të kompensuar këto të drejta, e veçanërisht të drejtën për bujqësi. Kjo do të garantonte edhe zbatimin e legjislacionit të ujërave në lidhje me brigjet dhe të drejtat për përdorimin e tyre. Parashikimet e PPV-së për këto zona përballen me tre vështirësi: kosto e lartë e

mbjelljes; pronësia – për ato raste kur këto toka janë private; konvertimi i këtyre sipërfaqeve nga bujqësore në natyrore.
Për vështirësinë e parë, autoritetet vendore e qendrore duhet të parashikojnë fonde të përvitshme. Për vështirësinë e dytë, autoritetet duhet të garantojnë se pronësia është e paprekshme nëse kompensohet vetëm e drejta për bujqësi dhe/ose zhvillim dhe mund të tjetërsohet vetëm në rast të një kompensim të plotë të pronës. Për vështirësinë e tretë, theksojmë se në mjaft raste këto zona kanë qenë natyrore dhe janë kthyer në bujqësore për të rritur sipërfaqen e tokës bujqësore. Për rrjedhojë, burimi ujor ka shkaktuar përmbytje duke dëmtuar edhe më tej tokat e brigjeve. Pra nevojitet që këto sipërfaqe të rikthehen në gjendje natyrore e me bimësi të përshtatshme për ruajtjen e brigjeve ujore.

- Kodi rrugor ka bërë përcaktime që influencojnë vijën e kuqe. Vija e kuqe përcaktohet nga distanca e ndërtimeve nga trupi i rrugës. Kodi rrugor përmban shumë pak përcaktime në lidhje me këto distanca, duke mos konsideruar rastet e shumta të tipologjive urbane. Thelbi i neneve për distancat në Kodin Rrugor është distanca si një parametër teknik, por jo cilësia tërësore e hapësirës. Kjo e fundit realizohet në mënyra të ndryshme për tipologji të ndryshme dhe jo vetëm përmes distancës nga trupi i rrugës, por edhe përmes Kshp e Kshr (koefiçientët për hapësirë publike dhe rrugë). Në zona urbane ku shpejtësia e lëvizjes së automjeteve është e ulët dhe nuk prek sigurinë e qytetarëve, distancat nga trupi i rrugës mund të jenë më të vogla se sa ato të parashikuara nga Kodri Rrugor (deri në 0m), për sa kohë që trotuari ka një gjerësi të mjaftueshme. Madje në raste të tjera, situata urbane është e tillë ku ndërtimet e reja duhet të respektojnë vijën ekzistuese të ndërtimit (p.sh. zonë e konsoliduar, qendrore, historike, etj.). Këto raste përjashtimore lejohet nga VKM nr. 671/2015 (për planifikimin e territorit) dhe është PPV-ja që duhet t`i detajojë, por duhet të lejohen edhe nga Kodi Rrugor.
Po ashtu, koncepti vijë e kuqe merr në konsideratë në mënyrë të njëjtë çdo object, ndërsa Kodi Rrugor përcakton distanca të ndryshme për ndërtimet, të ndryshme për pemet dhe të ndryshme për muret rrethuese. Nëse i referohemi Kodit, përfshirë këtu edhe rastet përjashtimore si në paragrafin më sipër, atëherë vija e kuqe për një rrugë mund të pozicionohet në mënyra të ndryshme, dhe kjo varet nga konteksti lokal. Për këtë qëllim, është mirë që vija e kuqe të përcaktohet vetëm përmes rregullores, prerjeve tip të rrugëve dhe jo përmes hartës plan.

Në nivel vendor:

- Në nivel vendor nëvojitet të: i) krijohen struktura të reja për monitorim mjedisor dhe të PPV-së, ose të përmirësohen ato ekzistuese duke u shtuar në organikën lokale, në përputhje me ligjin për vetëqeverisjen vendore; ii) të rritet numri i inxhinierëve apo planifikuesve që mbulojnë njësitë administrative; iii) të shtohet stafi i drejtorisë së planifikimit për të zbatuar në kohë dhe më cilësi të gjitha projektet dhe proceset zhvillimore të parashikuara nga PPV-ja.
- Në vijim paraqiten të përmbledhura disa nga çështjet institucionale e ligjore që duhet të ndodhin në nivel vendor për zbatimin e planit të monitorimit të indikatorëve të PPV-së. Theksojmë se propozimet e tabelës së mëposhtme janë tërësisht në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe synojnë të detajojnë procedura të brendshme, në përputhje me përcaktimet ligjore, përmes të cilave lehtësohet

zbatimi i PPV-së dhe i ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Tabela 121. Rekomandime për përmirësimin e monitorimit mjedisor

Çështje ligjore, institucionale, proceduriale për monitorimin e mjedisit	**Masa**	**Instrumenti**
Mospajisja me laboratorë e institucioneve të monitorimit të mjedisit	Pajisja me laborator	Numër laboratori të çertifikuar në pronësi të institucioneve
Mungesa e laboratoreve që kanë kapacitet të monitorojnë parametra si përbërjet klorure dhe PCB si dhe pesticidet dhe PAHs	Pajisja me laboratorë të specializuar	Rritja e kapacitetit për matjen e përbërjeve klorure, PCB-ve, pesticideve dhe PAHs
Monitorimi i mjedisit bazuar në numër të kufizuar treguesish mjedisorë (parametrat)	Krijimi i bazës ligjore për shtimin e parametrave që nevojitet të maten për monitorimin e duhur të treguesve fizikë të mjedisit (ajrit, tokës, ujërave sipërfaqësore e nëntokësore, biodiversitetit, pyjeve)	Parametra /ndotës që shkarkohen nga industria e rëndë
Numri i kufizuar i pikave të monitorimit	Shtimi i pikave	Numri i pikave
Shpeshtësia e monitorimit të ujërave e pamjaftueshme	Shtimi i frekuencës	Numër i lartë matjesh/vit
Vetë-monitorimi i aktiviteteve të pajisura me leje A dhe B joreal	Kalimi i monitorimit të shkarkimeve të indsutrisë së pajisur me leje mjedisore (A dhe B) nën kompetencat e ARM-Elbasan	Monitorim mujor i parametrave
Mungesa e kompetencave të ARM-së Elbasan për monitorimin e mjedisit	Shtimi i kompetencave	Monitorimi parametrave
Mungesa e bazës ligjore/procedurave e programeve për mbrojtjen e ujërave nëntokësore	Krijimi i programeve të posaçme për mbrojtjen e akuiferëve nga industria e rëndë	Numri i programeve në mbrojtje të akuiferëve

Burimi: Bashkia Elbasan dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Tabela 122. Indikatorët për monitorimin e PPV-së dhe çështjet institucionale e ligjore përkatëse në nivel vendor

Indikatori	Vlera	Periudha e monitorimit	Çështje institucionale e ligjore
Lejet e ndërtimit të dhëna në përputhje me PPV-në	E pacaktuar	Çdo fund muaji dhe raportim final në dhjetor të çdo viti	Procedurat për lejet janë të përcaktuara ligjërisht dhe në rregulloren përkatëse të bashkisë. Me një rregullore të brendshme nevojitet të rregullohet procedura për rastet e objekteve me volum të vogël, kryesisht për bujqësi, si strehim për kafshët në bujqësi, depo për vegla bujqësore, etj.

			Bashkërendim me raportin e territorit sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, nr. 107/2014.
Deklaratat paraprake për punime	E pacaktuar	Çdo fund muaji dhe raportim final në dhjetor të çdo viti	
Ndërtime informale në territor	0	Çdo fund muaji dhe raportim final në dhjetor të çdo viti	Bashkëpunim me ALUIZNI. Në rregulloren e brendshme nevojite të rregullohet procedura e monitorimit sipas strukturës përkatëse në bashki. Bashkërendim me raportin e territorit sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, nr. 107/2014.
Projektet prioritare të zbatuara në përputhje me PPV dhe veçanërisht Planin e Investimeve Kapitale	Të paktën 50% e projekteve sipas fazimit të realizuar në PPV dhe në PIK	Çdo gjashtë muaj dhe raportim final në dhjetor të çdo viti	Bashkërendim me raportin e territorit sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, nr. 107/2014.
Numri i rasteve/njësive strukturore në të cilat zbatohet INK	Të paktën një rast në vitin e parë pas miratimit të planit; 10% e rasteve të parashikuara, në 3 vitet e para pas miratimit të planit; mbi 20% e rasteve të parashikuara, në vitet në vijim.	Çdo fund viti.	Bashkërendim me raportin e territorit sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, nr. 107/2014. Përgatitje e rregullores së programit specifik ose e procedurës për rastin përkatës.
Numri i rasteve dhe pronave që marrin pjesë në program TDZH	Të paktën një rast në 3 vitet e para pas miratimit të planit; Të paktën kërkesa nga 40% e rasteve në vitet në vijim.	Çdo fund viti.	Bashkërendim me raportin e territorit sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, nr. 107/2014. Përgatitje e rregullores së programit specifik ose e procedurës për rastin përkatës. Indikatori rishikohet pas 3 viteve të para pas miratimit të planit, pas vlerësimit të suksesit dhe mundshmërisë së zbatimit të programit. Kjo mund të kërkojë edhe ndryshim të PPV për t'iu përshtatur kushteve të reja dhe realitetit.
Mundësia për ndryshim të PPV-së	Jo më shumë se 5% e sipërfaqes brenda 2 viteve të para; Jo më shumë se 1% e njësive strukturore në lidhje me	Çdo fund viti.	Bashkërendim me raportin e territorit sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, nr. 107/2014. Dokumentim dhe publikim sipas ligjit i procedurave për ndryshim.

	intensitetin dhe/ose Ksht, brenda 2 viteve të para; 0% zvogëlim të sipërfaqes së propozuar rrugore dhe të hapësirës publike në çdo kohë.		Për dy vlerat e para (ndryshimi i sipërfaqes dhe i njësive strukturore në lidhje me Intensitetet dhe Ksht), pas dy viteve të para pas miratimit të planit duhet të propozohet një vlerë e re e indikatorit, por pa ndryshuar indikatorin. Vlera për hapësirën publike dhe sistemin rrugor nuk ndryshon gjatë jetëgjatësisë së planit, përveçse nëse rritet.

Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

3 Shtojca

3.1 Tabelat përmbledhëse të PPV

1. Të dhëna të përgjithshme për bashkinë		
Emërtimi	**Vlera dhe Njësia**	**Specifikime**
Sipërfaqja e njësisë vendore	872 km^2	Sipërfaqe truall, tokë bujqësore etj.
Numri i popullsisë ekzistuese	144,382 banorë(INSTA) 208,480 banorë (Gjendja Civile)	Popullsia në total për të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Elbasan
Zona të rëndësisë kombëtare dhe zona të mbrojtura natyrore dhe kulturore	925.8 ha	Sipas legjislacionit të posaçëm dhe ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit
Sipërfaqe e miratuar zonash informale	20.5 ha	Zonat e miratuara nga ALUIZNI
Problematika mjedisore		Venddepozitimi i mbetjeve të ngurta dhe inerte përgjatë shtratit të lumit Shkumbin, Zonat e nxehta mjedisore (Uzina e Shkrirjes së Ferro-Kromit; Ndërmarrja e Furnizimit Industri Miniera; Uzina e Lëndëve Plasëse), venddepozitimet e mbetjeve industriale, mostrajtimi i ujërave të ndotura dhe të shiut etj

2. Propozime të PPV-së		
Emërtimi	**Vlera dhe njësia**	**Specifikime**
Lloji i zhvillimit të pritshëm në 15 vitet e ardhshme		Intensifikimi i qendrave të urbanizuara, dhe mbushje urbane në zonat të cilat kanë nisur procesin e urbanizimit. Mbrojtja dhe Konservimi strikt i tokës bujqësore, zonave të mbrojtura dhe burimeve të tjera natyrore, Intensifikimi i zonave ekonomike të cilat kanë kapacitetin për të akomoduar

		bizneset e reja. Shtimi i sipërfaqeve pyjore dhe krijimi i korridoreve të gjelbërta vegjetative etj.
Përdorimet kryesore të propozuara të tokës		Banim, Bujqësi, Natyrore, Industri e lehte përpunuese (Zona mikse industriale dhe tregëtare dhe magazina industriale), Shërbime, Park Rajonal (Liqenet e Funarës), Aktivitete Sociale dhe Rekreacion, Arsim dhe Shëndetësi (zgjerimi i spitalit); Zona të mbrojtura (Pylli i Gjinarit)
Numri i popullsisë së pritshme shtesë në 15 vitet e ardhshme	19, 408banorë	Parashikimet demografike të INSTAT parashikojnë renine të popullsië, por me zhvillimet që pritet të ketë bashkia në kuadër të planit dhe duke iu referuar parashikimit të popullsisë sipas gjendjes civile parashikohet që popullsia në Elbasan të rritet.
Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit të shtuar për banim	639ha	Sipërfaqja që pritet të shtohet për banim në 15 vitet e ardhshme
Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit të shtuar jo për banim	144ha	Specifikimi i funksioneve biznes, tregti, industri etj.
Sipërfaqe e përgjithshme e zonave në mbrojtje	8, 184ha	Zonat e mbrojtura, zona për konservim etj.
Sipërfaqe e përgjithshme e banesave për strehim social	2.6ha	Referuar numurit të familjeve të pastreha anktualisht në Bashkinë Elbasan
Sipërfaqe të gjelbëra shtesë	441ha	Parqe, pyje etj.
Numri i njësive strukturore	1716	Bashkia Elbasan ndahet në 13 zona dhe 1716 njësi administrative

3. Të dhëna financiare		
Emërtimi	**Vlera dhe Njësia**	**Specifikime**
Vlera e përgjithshme e planit e investimeve kapitale	3,145,927,992 Lek	Duhet të jetë në përputhje me programin buxhetor afatmesëm
Fazat e zbatimit të zhvillimit	3 periudha përkatëse	0-3 vite-Afatshkurtër 3-5 vite Afatmesëm 5 deri në jetëgjatësinë e planit - Afatgjatë

4. Dokumenti i PPV-së për dorëzim				
Nr.	**Kapitulli/Dokumenti**	**Hartohet/Miratohet**	**Referenca ligjore**	**Check list**
1.	Strategjia territoriale	Hartohet dhe miratohet	Neni 51 pika 2 VKM. 671	+
2.	Analiza dhe vlerësimi i territorit	Hartohet dhe miratohet si pjesë e planit	Neni 53 VKM. 671	+
3.	Parashikimet e planit	Hartohet dhe miratohet si pjesë e planit	Neni 54 VKM. 671	+
4.	Vlerësimi strategjik mjedisor	Hartohet dhe miratohet	Neni 51 pika 5 VKM. 671	+
5.	Materiali hartografik	Hartohen dhe miratohen	Neni 57 VKM. 671	+
6.	Rregullorja e PPV-së	Hartohet dhe miratohet	Neni 56 VKM. 671	+
7	Plani i Investimeve Kapitale	Hartohet dhe miratohet si pjesë e planit	Neni 51 pika 3/dh VKM. 671	+

5. Hartat bashkëlidhur dokumentit të shkruar të PPV-së sipas rregullores së planifikimit					
Nr.	**Tematika e hartës**	**Lloji i hartës**	**Shkalla**	**Kodi i hartës**	**Check list**
1.	Harta bazë	Harta bazë vektoriale e njësisë vendore dhe topografia	1:60,000 1:170,000	V0	+
2.	Vizioni strategjik i zhvillimit të territorit	Drejtimet kryesore të planifikimit dhe zhvillimit të territorit; objektivat; fazat kohore të zbatimit të programeve.	1:60,000 1:170,000 1:25,000	V:1-V:4 P:02/14-P:02/15 N:01/16-N:01/17	+
2.	Elementet ekzistuese të territorit	Topografik; gjeologo-inxhinierik; hidro-gjeologjik dhe hidrografik; e makrozonimit dhe, sipas rastit, mikrozonimit sizmik; boniteti i tokave; burimet natyrore, si mjedise pyjore, kullota, sipërfaqe ujore, rezervate, miniera dhe të tjera të kësaj natyre; zonat e mbrojtura natyrore dhe të trashëgimisë kulturore dhe historike.		Në tekst	+
3.	Pozicionimi strategjik i në raport me rajonin	Kufijtë territorialë në rajon; Identiteti historik, urban, ekonomik		Në tekst	+
4.	Vlerësimi ekonomik	Pozicionimi dhe përqendrimi i burimeve dhe poleve ekonomike lokale; elementet e konkurrueshmërisë; shpërndarja e sektorëve dhe e fuqisë punësorë;		Në tekst	+

5.	Vlerësimi social	Shërbimet sociale; shkollat; shëndetësia	1:170,000 1:60,000	P:03/1- P:03/8	+
	Vlerësim demografik	Përqendrimi i popullsisë në territor; lëvizjet e popullsisë në vite; shpërndarja e popullsisë në nivel banese dhe për tipologji banesash; sipërfaqen e banimit për person sipas tipologjive të banesave; numri i banesave në një strukturë banimi sipas tipologjive në territor.		Në tekst	
6.	Analiza e planeve të mëparshme	Përdorimi i tokës; infrastrukturat; intensiteti i ndërtimit.		Në tekst	+
7.	Pronat	Përdorimi i pronave publike; problemet në marrëdhëniet e pronësisë në territor; zonat informale sipas llojeve dhe ecurisë së integrimit		Në tekst	+
8.	Rëndësia kombëtare	Zonat dhe strukturat	1:170,000 1:60,000	P:04	+
9.	Problemet mjedisore	Vendndodhja e elementeve ndotëse dhe me ndikim negativ; Shkalla e ndikimit negativ të burimeve ndotëse në territor	1:170,000 1:60,000	M:02	+
10.	Përdorimi ekzistues i tokës	Kategori bazë; nënkategoritë; funksionet dhe aktivitetet;		Në tekst dhe në hartat e Strategjisë	+
11.	Infrastrukturat	Furnizimi me ujë; ujërat e zeza; mbetjet urbane; rrugët; ndricimi; transporti; lidhja me infrastrukturat kombëtare	1:170,000 1:60,000 1:25,000	P:02- P:02/1 P:02/2 P:02/3 P:02/4 P:02/5 P:02/8 P:02/10 P:02/11 P:02/12 P:02/13	+
12.	Cilësia fizike e strukturave	Nivelet e cilësisë; rekomandime për riparim, rigjenerim, rizhvillim.	1:170,000 1:60,000 1:30,000 1:25,000 1:10,000	P:02/6- P:02/7; N:01/11- N:01/12	+
13.	Tipologjitë hapësinore	Zona sipas njëtrajtshmërisë së llojit dhe volumit të strukturave, mënyrës së vendosjes në parcelë dhe në territor, skemës rrugore dhe të hapësirave publike si dhe lartësisë së strukturave	1:170,000 1:60,000 1:25,000	N:01/13 N:01/14	+

14.	Periferaliteti	Zona sipas: largësisë nga qendra e zonës së banuar; largësisë nga qendrat e punësimit; lidhjes me sistemin rrugor; furnizimin me rrjete infrastrukture dhe shërbime sociale; nivelit të përafërt të të ardhurave të shtresave shoqërore; plotësimit me funksione sipas kategorive bazë të përdorimeve të tokës; nivelit të kriminalitetit dhe sigurisë së jetës; problemeve të ndryshme sociale përfshirë përjashtimin social.		Në tekst	+
15.	Elemente të veçanta territoriale	Objekte dhe struktura, natyrore apo artificiale, me ndikim në qytet dhe hapësirëformim		Në tekst	+
16.	VSM	Hartat përshkruese, analizuese dhe vlerësuese	1:170,000 1:60,000	M:03 M:04 M:05 M:06	+
17.	Parashikimi i përdorimit të tokës	5 sistemet; kategoritë bazë dhe nënkategoritë; funksione dhe aktivitete; qendrat, polet, korridoret kryesore të zhvillimit ekonomik; tipologjitë e parashikuara hapësinore; zonat e rëndësisë kombëtare; njësitë strukturore; zonat me prioritet zhvillimi; zonat për PDV; shpërndarja e popullsisë; plani e strehimit; të tjera;	1:170,000 1:60,000 1:25,000	P:01 P:01/1 P:01/2 P:01/3 P:01/4 P:01/5 P:01/6 N:01/1 N:01 dhe në tekst	+
18.	Shërbimet dhe infrastrukturat e propozuara	Rrjetet e infrastrukturave; Objektet e shërbimeve sociale dhe rrezet e mbulimit	1:170,000 1:60,000	P:03/1-P:03/8 dhe në tekst	+
19.	Instrumentet e drejtimit të zhvillimit	Zonat për transferim të së drejtës për zhvillim Zona për intensitet me kushte Zona për zhvillim të detyrueshëm të tokës Zonat e preferimit; Zonat e pezullimit të zhvillimit; Zonat për servitut publik;		N:01/2	+
20	Plani i veprimeve	Harta e fazimit të zhvillimit sipas njësive strukturore dhe sipas infrastrukturave; Tjetër sipas rastit		P:02/14-P:02/15; N:01/16-N:01/17	

3.2 Korrespondenca institucionale

Takimet e kryera në kuadër ta hartimit të PPV- Bashkia Elbasan			
Personat/ Institucioni/	**Data e takimit**	**Vendi i takimit**	**Qëllimi i takimit**
Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile	10/02/2016	Tiranë	Marrje informacioni mbi zonat e përmbytjes, zonat e rrezikuara nga tërmetet, zjarret etj.
Emergjencat Civile Rajonale - Elbasan	29/04/2016	Elbasan	Marrje informacioni mbi zonat e përmbytjes, zonat e rrezikuara nga tërmetet, zjarret etj.
Autoriteti Rrugor Shqipëtar (ARrSh)	26/10/2015	Tiranë	
Ministria e Bujqësisë, Drejtoria e Administrimit të Tokës Bujqësore	19/02/2016	Tiranë	Marrje informacioni dhe harta për bonitetin e tokave, kanalet ujitëse dhe vaditëse
Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB)	06/2016	Fushë-Krujë	Marrje e hartave dhe informacionit mbi bonitetin e tokave
INSTAT	03/2016	Tiranë	Të dhënat mbi popullsinë
SHGJSH	12/2015	Tiranë	Grumbullim informacioni mbi urjërat nëntokësorë dhe gjeologjinë e bashkisë
ZVRPP	05/2016	Elbasan	Marrje informacioni mbi pronat publike
ALUIZNI	05/2016	Tiranë	Marrje informacioni mbi zonat info-rmale dhe zonat në process legalizimi
Forumi i Bashkërendimit të Planeve Vendore	10/02/2016	Bashkia Elbasan	Bashkërendimi i SZHT Elbasan me bashkitë kufitare dhe AKPT
Forumi i Bashkërendimit të Planeve Vendore	19/09/2016	Bashkia Elbasan	Bashkërendimi i PPV Elbasan me bashkitë kufitare dhe AKPT
Agjensia e Zonave të Mbrojtura Elbasan-Librazhd	14/07/2016	Agjensia e Zonave të Mbrojtura Elbasan-Librazhd	Shkëmbim informacioni dhe diskutime mbi Zonat e Mbrojtura të Bashkisë Elbasan dhe porpozime mbi Bashkinë
Alb-Petrol	03/2016	Patos	Shfrytëzimi i gazit natyror dhe resurset e naftës
ARM Elbasan	14/07/2016	Agjensia Rajonale e Mjedisit, Elbasan	Shkëmbim informacioni dhe diskutime mbi VSM-në, Zonat Nxehta Mjedisore, Monitorimet, Problemet Mjedisore dhe projektet.

Korrespondenca Institucionale në kuadër ta hartimit të PPV- Bashkia Elbasan			
Institucioni	**Qëllimi i shkresës**	**Data e dërgimit/ Nr protokolli**	**Kthimi i Përgjigjes**
Bordi i Kullimit	Kërkesë për të dhëna mbi investimet e vitit 2016 të cilat pritet të financohen nga Banka Botërore		

Instituti i Monumenteve të kulturës	Të dhëna mbi vendodhjen e zonave me potencial arkeologjik	11/02/2016 Nr.Prot. 1026	15/02/2016 Nr.Prot. 51/1
Agjencia e Shërbimit Arkeologjik	Të dhëna mbi vendodhjen e zonave me potencial arkeologjik	11/02/2016 Nr. Prot. 1019	15.02.2016, Nr. 133 Prot
Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Paurive Kulturore	Marrja e listës së plotë të monumenteve të kulturës		
Drejtoria Rajonale e Mjedisit	Marrja e informacionit mbi lejet mjedisore dhe subjektet operuese për Qarkun Elbasan		
Drejtoria e Shërbimit Pyjor	Marrja e informacionit mbi sipërfaqet pyjore në pronësi të Bashkisë Elbasan		
Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARrSh)	Lista e objekteve ne ndertim (2013, 2014, 2015) + Harta e sistemit rrugor dhe hekurudhor të Shqipërisë.	11/09/205	22/12/2015
Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	Mbi lejet minerare në Bashkinë Elbasan		16/02/2016 Nr.Prot. 1897/1 Nr. Prot 1897/2
Qendra Kombëtare e Regjistrimit	Raporti Vjetor i Regjistrit Tregtar, 2015		29/03/2016 Nr.Prot. 3018
Ministria e Mjedisit	Fillimi i procedurave të procesit të VSM, për hartimin e PPV për Bashkinë Elbasan		12.12.2015 Nr. Prot. 6599
MBZHRAU	Të dhënat lidhur me aktivitetin e akuakulturës në lumenj, liqene, rezervuare dhe produktet bujqësore	11/02/2016 Nr.Prot. 1020	18.02.2016, Nr. 544/1 Prot

Burimi: Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

3.3 Procesverbalet

REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA ELBASAN

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TERRITORIT

Adresa:Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa",Tel.+355 54 400152, E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al ëeb: ëëë.elbasani.gov.al

Dëgjesa e dytë publike 27.11.2015

Z. Qazim Sejdini (Kryetari i Bashkisë): Në lidhje me popullsinë kam vërejtje, duhet të bëhet në bazë të rregjistrit themeltar të gjendejs civile. Duhet kursyer toka bujqësore dhe ngritja në katë duhet të diskutohet me kujdes. Çdo planifikim i ardhëshëm duhet të bëhët në bazë të rregjistrit të gjendjes civile.

Grupi i punës: Skenarët e rritjes së popullsisë janë mbështëtur në të dhënat zyrtare të INSTAT, kjo për arsye se analizat social ekonomike bëhen mbi bazën e treguesve të INSTAT dhe duhet të kemi të njëjtën bazë krahasimore. Projeksionet e popullsisë bëhen duke iu referuar të dhënave të INSTAT sepse kanë edhe seri kohore. Jemi në pritje të të dhënave të gjendjes civile me seri kohore që në dokumentin e planit të mund të bëjmë edhe projektsione mbi bazën e gjendjes civile e të bëjmë krahasimet me INSTAT.

Mbështëtur në propozimet e bëra, një nga qëllimet kryesore që është marrë parasysh është ruajtja e tokës bujqësore. Për më tëpër, ka legjislacion që kufizon konvertimin e tokës bujqësore në urbane, si dhe ndërtimet në tokë bujqësore dhe ky legjislacion është detyrues për Planin.

Lartësia e ndërtimit të objektëve kofiçentët e tjerë të planifikimit të Territorit, numri i katëve do të përcaktohen në vazhdim në Dokumentin e Planit të Përgjithshëm Vendo (Rregullorja), sipas përcaktimeve ligjore për planifikimin.

Ardian Kasa (Komisioni Këshillimor): Pse zë më shumë peshë industria se bujqësia?

Grupi i punës: Gjatë propozimeve të bëra për zhvillimin e Territorit të Bashkisë Elbasan një nga sektorët kryesor që është marr në konisderatë është edhe bujqësia, kjo për arësye se Elbasani ka një tërritor mjaft të favorshëm për zhvillimin e bujqësisë.

Edmond Papa (Sekretar i Dhomës së Tregëtisë). Si po punohet që Bashkia Elbasan të jetë lider në qarkun ku kjo bën pjesë?

Grupi i punës: U mor në konsideratë dhe u reflektua në analizat (Kapitulli 1) dhe gjithashtu në vizion dhe objektiva e programe zhvillimi (Kapitulli 2).

Edmond Kapllani (Sekretar i Dhomës së Tregëtisë): Elbasani ka 10 vjet që merret me këtë problem, besoj që kjo situatë duhet të ishtë kaluar. Duhet të ishtë folur më shumë për rrugët, shëndetësinë. Elbasani ka një industri të vdekur dhe bujqësi të stopuar. Elbasani duhet të kalojë në një rajon me Tiranën dhe Durrësin. Gjithashtu duhet të Flasim për Intensitetin e ndërtimit do të propozohen në këtë plan.

Grupi i punës: U mor në konsideratë sygjerimi për rrugët, shëndetësinë, industrinë dhe bujqësinë (Kapitulli 1). Këto tëma do të trajtohen gjithasht në mënyrëmë tëj tëk analiza e thelluar e Dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor në vazhdim.

Dokumenti i Strategjisë ka analizuar konceptin rajonal por nuk mund të përcaktojë nëse Elbasani duhet të kalojë më Tiranën e Durrësin apo të mbetët me Korçën. Kjo çështje del jashtë kompetëncave të këtij dokumenti dhe të bashkisë.

Intensiteti dhe koefiçentët e tjerë të zhvillimit/ndërtimit do të trajtohen tëk Rregullorja e Dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor.

Përfaqsues i NjA Funar: Rrugët ëurale duhet të shikohen më në detj dhe bujqësia si potëncial i rëndësishëm

Grupi i punës: U mor në konsideratë, janë propozuar projektë për infrastrukturën dhe për bujqësinë (Kapitulli 4)

Z. Qazim Sejtini (Kryetari i Bashkisë): Një element shumë i rëndësishëm që duhet të trajtohet gjerësisht në analizën dhe stratëgjinë e PPV, është edhe studimi për mbjetjet industriale, plerat e qytëtit tashmë të madh. Sistëmimi, përpunimi dhe pastrami i ujërave të ndotura të qytëtit.

Gjithashtu duhet të studiohen zonat ujëmbajtëse për të arritur objektivin e furnizimit të qytëtit në 24 orë pa ndërprerje.

REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA ELBASAN

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TERRITORIT

Adresa:Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa",Tel.+355 54 400152, E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al Web: gee.elbasani.gov.al

Dëgjesa e tretë publike 23.12.2015

Qytëtar: Ku do të jetë vendi i shkarkimit të ujërave të zeza?

Grupi i punës: U mor në konsideratë, Projektet prioritare për zhvillim (Kapitullin 4, Strategjia), është propozuar projekt për rehabilitimin e KUZ, ku parashikohet risitëmimi i sistëmit të kanalizimeve. Gjithashtu është propozuar impinati për trajtimin e ujërave të ndotura.

Z. Qazim Sejdini (Kryetari i Bashkisë): Ku është propozuar tërminali i autobusëve?

Grupi i punës: U mor në konsiderat dhe duke u bërë një analizë më e thelluar gjithashtu duke u konsultuar me bashkinë u përcaktua që zona më e përshtatshme për tërminalin e autobusëve është stacioni ekëzistues i trenit. (Kapitulli 4. Stratëgjia)

Ismail Ballysa: Sa qëndra stratëgjike do të ketë Elbasani?

Grupi i punës: Elbasani do të jetë një qytët dhe bashki policentrik/e, në këtë mënyrë zhvillimet që do të ndodhin në tërritor nuk janë përqëndruar vetëm në pjesën e qytëtit por në të gjitha njësitë administrative. Ky propozim do të zhvillohet më tëj në Dokumentin e Planit të Përgjithshëm Vendor.

Arjan Çala: po për varrezat ka ndonjë stratëgji?

Grupi i punës: Do të merret në konsideratë në vazhdim gjatë hartimit të Dokumentit të Planifikimit të Përgjithsëm Vendor, si një kërkesë ligjore për dokumentin e planit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA ELBASAN

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TERRITORIT

Adresa:Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa",Tel.+355 54 400152, E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al ëeb: ëëë.elbasani.gov.al

RAPORT

"Mbi takimin e pare të Forumit të Bashkerendimit ne Nivel Vendor ne Bashkine Elbasan"

Mbështëtur ligjin **107/2014**, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e Territorit", i ndryshuar me ligjin **73/2015**, datë **9.7.2015.** dhe **VKM nr 671,** datë **29.07.2015**,"Për miratimin e rregullores se planifikimit të Territorit", për hartimin e planeve të përgjitheshme vendore të financuara nga **USAID** ku Bashkia Elbasan është përfituese me datë **10.02.2016** ora **10-30** ne Bashkine Elbasan, u organizua takimi i pare i **FBPV**, i organizuar nga **AKPT** ne bashkepunim me Bashkine Elbasan, përpara marrjes se **Aktit të Përputhshmerise** nga kjo agjensi.

Mbështëtur ne Urdherin e Drejtoreshes se Përgjitheshme të AKPT Nr.09 datë 02.02.2016 është ngritur FBPV si me poshtë:

1. Zj. **Adelina Greca**, Drejtuese Forumi, Drejtore e përgjitheshme e AKPT Tirane,
2. Z. **Raimond Hazballa**, Sekretar Forumi, Drejtues e DPT Bashkia Elbasan.
3. Z. **Enver Shkurti**, Përfaqsues Planifikues i Bashkise Librazhd, si Bashki kufitare,
4. Z.**Hyqmet Karriqi**, Përfaqsues Planifikues i Bashkise Prrenjas, si Bashki kufitare
5. Z.**Ali Cohodari**, Përfaqsues Planifikues i Bashkise Gramsh, si Bashki kufitare,
6. Z. **Evis Bucja**, Përfaqsues Planifikues i Bashkise Cerrik, si Bashki kufitare,
7. Zj.**Rozina Tabaku**, Përfaqsues Planifikues i Bashkise Peqin, si Bashki kufitare
8. Zj.**Lila Karaj**, Përfaqsuese e Qarkut Elbasan,
9. Një Përfaqsues Planifikues i Bashkise Tirane, si Bashki kufitare,

Ne takim merrnin pjese përvec FBPV të mesipërm edhe Kryetari Bashkise Elbasan, z. **Qazim Sejdimi**, Drejtoresha e DPSHO, ing **Etleva Kenuti**, Drejtoresha Përgjitheshme e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, Stratëgjik, Social e Medias, z. **Diamanta Vito** dhe ftuar të tjere.

Mbledhja filloi me fjalen përshendetëse të Kryetarit të Bashkise z.**Qazim Sejdini** dhe me pas fjalen e mori Drejtoresha e Përgjitheshme e AKPT z.**Adelina Greca**, si kryetare e FBPV, foli për rendesine e PPV dhe programin e punës për ketë takim.

Sekretari i FBPV ark.**Raimond Hazballa**, beri prezantimin e draft Stratëgjise Territoriale të PPV të përmbledhur si me poshtë:

Ecuria e fazave ligjore për fillimin e punës për PVV:

1. Urdheri i Kryetarit të Bashkise për krijimin e grupit të punës për bashkepunimin me Co-PLAN për hartimin e PPV.
2. Marrja e Nismes se Kryetarit të Bashkise për hartimin e PPV
3. Miratimi i Nismes se Kryetarit ne Keshillin Bashkiak,
4. Realizimi i tre degjesave publike për Analizen dhe Stratëgjine tërriotiale të PPV,
5. Realizimi i një degjese paraprake me anëtaret e Keshillit Bashkiak

E gjithe ecuria dhe dokumentat jane transmetuar ne RIT sipas fazave, ne faqën zyrtare të Bashkise, ne mediat e shkruara dhe vizive lokale.

Prezantimi për draft Stratëgjine Tëritoriale u përqëndrua ne problematiken e meposhtë.

1. Analiza e Territorit toka, ajri, uji.
2. Pozicioni stratëgjik, koridoret e lidhjeve dhe koridoret natyrale,
3. Kufijtë administrative përfshire 6 rajone të qytëtit dhe 12 rajone (ish komunat),
4. Topografia e Territorit,
5. Mjedisi dhe analiza e metabolizmit, fluksi i ujit, fluksi i energjise, fluksi i ushqimit dhe fluksi i mbetjeve,
6. Përdorimi i tokës, sistëmet e Territorit dhe katëgoritë baze të përdorimit të tokes, Industria dhe sherbimet
7. Tëndecat e sotme ne rajon,
8. Konceptë zhvillimi rajonale,
9. Koncepti i propozuar për stratëgjine e PPV,
10. Vizioni për të ardhmen,
11. Objektivat dhe programet, zhvillimi ekonomik dhe punësimi, mbështëtje sociale (arsimi, shendetsia dhe strehimi), infrastrukktura lidhjet rajonale dhe transporti, turizmi dhe trashegimia historiko-kulturore dhe transporti, mjedisi rrjeti lumor dhe kurora e gjelbert.
12. Polet ekonomike, zhvillim, rigjenerim dhe rivitalizim,
13. Projektet prioritare ne infrastrukture, energji, ekonomi, mjedisi, arsimi, shendetsia e turizmi

Pyetje dhe diskutime:

Verejtje dhe sugjerime të dala nga diskutimet:

Kryetari i Bashkise z.Qazim Sejdini:

1. Të parashikohet vendi për ndertimin e stacionit të autobuzave për linjën Elbasan-Tirane,
2. Stacioni i trenit të spostohet ne përendim të stacionit ekzistues, prane fushes se druve dhe stacioni ekzitues të kthehet ne tërminal autobuzash.
3. Shkolla e re e Bradasheshit të kthehet ne shkolle polifunksionale profesionale.
4. Qëndra rajonale spitalore do të kthehet ne qënder universitare spitalore ne bashkepunim me Universitëtin «Zonja e Mirë».

5. Të parashikohet rruga me mbikalim ose nenkalim, që lidh shkollen «Pedagogjike», ish zonen e Kinezeve me zonen e varrezave, pasi ish fusha e plehrave do të gjelberohet dhe pyllezohet ne sherbim të qytëtareve.
6. Të parashikohet rruga Tirane-Funar.
7. Të shikohen me kujdes qëndrat e grumbullimeve të produktëve bujqësore, sipas ekspëriences që kemi sot aktualisht.
8. Ne projektet e Bashkise jane parashikuar edhe masat mbrojtëse për ndotjet e lumit «Shkumbin», sic jane grumbullimi dhe pastrimi i plehrave ne impiantin e ri që po ndertohet, grumbullimi i shkarkimeve të ujrave të ndotura dhe dergimi ne impiantin e pastrimit të tyre, prane impiantit të mesipërm të plehrave.
9. Të kihen parasysh projektet prioritare të Bashkise si me poshtë: Ura mbi lumin «Shkumbin» që lidh Elbasanin me Shushicen, rruga Tregan-Elbasan, Gjinar-Elbasan, Funar-Elbasan, Labinot Mal-Elbasan, Gjinar-Tregan dhe kryqëzimi tëk Ura e Zaranikes.

Përcaktimi i një vendi të përshtashëm për ndërtim e stacionit të autobuzëve për linjën Tiranë-Elbasan do të përcaktohet në Dokumentin e Planit të Përgjithshëm Vendor, sepse duhet një analizë e thelluar e infrastrukturës.

U mor në konsideratë spostimi i stacionit të trenit në përëndim të stacionit ekëzistues, ky do të jetë një projekt afatgjatë. Gjithashtu u mor në konsideratë kthimi i stacionit ekëzistues në tërminal autobuzësh (Kapitulli 4, Projektet Prioritare të Zhvillimit)

U mor në konsideratë që ndërtimi i nevojshëm i një shkolle në NjA Bradashesh të jetë shkollë profesionale me disa profile studimi.

U mor në konsideratë zgjerimi i qëndrës rajonale spitalore dhe do të plotësohet në vazhdim në Dokumentin e Plani të Përgjithshëm Vendor.

U mor në konsideratë përmirësimi i infrastrukturës së rrugës që lidh shkollën Pedagogjike me ish zonën e Kiezëve dhe zonën e varrezave (Kapitulli 4, Projektet Prioritare për Zhvillim, fisha për përmirësimin e infrastrukturës rrugore)

U mor në konsideratë lidhja infrastrukturore e Funarit me Tiranën (Kapitulli 4, Projektet Prioritare për Zhvillim, fisha për përmirësimin e infrastrukturës rrugore)Përcaktimi i zonave për vendosjen e pikave të grumbullimit të produktëve bujqësore do të shihet në vazhdim në Dokumentin e Planit të Përgjithshëm Vendor

U morën në konsideratë projektet që ka Bashkia Elbasan për pastrimin e shtratit të lumit Shkumbin, rehabilitimin e vendepozitimit aktual (që ndodhet shumë pranë brigjeve të lumit Shkumbin) dhe impiantipër trajtimin e ujërave të zeza. (Kapitulli 4, Projektet Prioritare për Zhvillim)

U morën në konsideratë projektet që ka Bashkia Elbasan për ndërtimin e urës mbi lumin Shkumbin që lidh Elbasanin me Shushicën, rruga Tregan-Elbasan, Gjinar-Elbasan, Funar-Elbasan, Labinot Mal-Elbasan, Gjinar-Tregan dhe kryqëzimi tëk Ura e Zaranikës. (Kapitulli 4, Projektet Prioritare për Zhvillim)

Drejtoresha e Përgjitheshme e AKPT z. Adelina Greca

1. Ndotja e që vjen nga KME duhet të jetë një nga projektet strategjike,
2. Të shihet nese për spitalet ka nevoje për zgjerime të metëjshme,

3. Ne piken për bujqësine duhen pare jo vetëm pikat e grumbullimit por edhe ato të prodhimit e përpunimit të prodhimeve.
4. Propozimi për 20 pole duhet të rishikohet pasi jane shumë.
5. Të studiohen me mirë qëndrat turistike të Elbasanit pasi ka shumë të tilla,
6. Për stacionin e autobuzave Tirane Elbasan duhet të rakordohet me Bashkine e Tiranes,

U mor në konsideratë rehabilitimi i Kombinatit Metalurgjik (Kapitulli 4, Projektet Prioritare për Zhvillim)

U mor në konsideratë zgjerimi i spitalit rajonal dhe do të plotësohet në vazhdim në Dokumentin e Plani të Përgjithshëm Vendor

U mor në konsideratë, propozimet e Dokumentit të Strategjisë përcaktojnë gjithashtu pika për përpunimin e produktëve bujqësore dhe blektorale, në vazhdim do të përcaktohen zonat ku do të vendosen këto pika përpunimi

U mor në konsideratë dhe do të plotësohet në vazhdim në Dokumentin e Planit të të Përgjithshëm VendorProgrmet për zonat turistike do të plotësohen më konkretisht në Dokumentitn e Planit të Përgjithshëm Vendor

Nga Bashkitë kufitare

1. Evis Bicaj bashkia Cerrik, për vec mbetjeve kimike ne lumejtë ka shumë mbeturina me qëse plastike.
2. Hymet Karriqi bashkia Prrenjas, mendoj që duhet pasur parasysh dhe shfrytëzimi i burimeve minerale të bashkise Prrenjas
3. Hasan Drazhi qarku Elbasan, bajpasi i Elbasanit të kaloje ne ane jugore të qytëtit për të mos demtuar ullishtat e kurores se gjelbert ne veri.
   U mor në konsideratë vendosja e gjurmës (Kapitulli 2, Vizioni i të ardhmes për Elbasanin) dhe do të përcaktohet në mënyrë më të detajuar në Dokumentin e Plani të Përgjithshëm Vendor
4. Diamanta Vito. Të parashikohet ndertimi i një shkolle multifunksionale profesionale për qytëtin.
   U mor në konsideratë dhe do të plotësohet më tëj në Dokumentin e Plani të Përgjithshëm Vendor

SEKRETARI I FBPV

Ark. RAIMOND HAZBALLA

REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA ELBASAN

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TERRITORIT

Adresa:Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa",Tël.+355 54 400152, E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al &eb: &&&.elbasani.gov.al

Dëgjesa e katërt publike 25.01.2016

Raimond Hazballa (Drejtor i Drejtorisë Planifikimit Territorit)

E bëjmë këtë dëgjesë sot për të prezantuar paraprakisht përpara Këshilltareve Draft Strategjinë Tërritoriale të PPV për Bashkinë Elbasan. Projekti mbështetët nga USAID përmes Programit për Planifikimin dhe Qëverisjen Vendore (PLGP), Co-PLAN, dhe Instituti për Zhvillimin e Habitatit që do të jene në rolin e mbështetjes teknike, me autor stafi i Bashkisë Elbasan.

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Elbasan, përbëhet prej tre dokumentëve bazë të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të Territorit:

1. Strategjia Tërritoriale,
2. Dokumenti i Planit të Përgjithshëm Vendor,
3. Rregullorja e Planit të Përgjithshëm Vendor.

Përmes këtij dokumenti, ju paraqësim Strategjinë Tërritoriale. Strategjia ravijëzon mundësitë e ardhshme strategjike të zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisor, të ndërlidhura dhe me ndikim të ndërsjellë në tërritorin e Bashkisë Elbasan e më gjerë në rajon. Matëriali do të prezantohet edhe me projeksion ne monitor.

Roland Çerepi (Anëtar i Këshillit Bashkiak): Rregulloren e keni lene në fund?

- krijimin e lidhjeve të drejtpërdrejta midis projekteve kapitale prioritare dhe prioriteteve në kryerjen e shpenzimeve nëpërmjet shpërndarjes efektive të burimeve në dispozicion;
- parashikim më të mirë buxhetor, mbështetur në objektiva dhe prioritete të vendosura për një periudhë disa vjeçare për të gjitha programet e shpenzimeve;
- përdorimin e parimit të vlerës së parasë nëpërmjet efektivitetit dhe efiçencës ekonomike në kryerjen e shpenzimeve publike;
- forcimin e disiplinës fiskale duke mundësuar që shpenzimet publike të planifikohen brenda një kuadri realist makroekonomik dhe fiskal, në linjë me programin buxhetor afatmesëm (PBA).

Hapi i parë për përgatitjen e PIK është hartimi i politikave të PIK, të cilat reflektojnë vizionin strategjik të zhvillimit të bashkisë si dhe strategjinë financiare dhe fiskale që do të ndiqet për të mundësuar realizimin e objektivave strategjike që zbërthejnë këtë vizion. Hartimi i politikës së PIK pasohet prej vlerësimit dhe identifikimit të nevojave kapitale (Figura 1. Hapat në hartimin e PIK). Hapi i tretë mundëson analizimin e kapaciteteve financiare të bashkisë, dhe prezanton një pamje të plotë të situatës dhe mundësive financiare të njësisë vendore, duke u ndalur veçanërisht në kapacitetin huamarrës të njësisë si dhe mundësinë për të reduktuar shpenzimet operative, e prezantuar instrumente të reja financiare në funksion të përmirësimit të

infrastrukturave publike. Kjo analizë pasohet prej listës së projekteve kapitale të prioritarizuara, mbi bazën e një metodologjie vlerësimi të ndarë e dakordësuar me aktorët. Mobilizimi i të ardhurave dhe fazimi i investimeve sipas nevojave dhe mundësive janë hapat që përmbyllin hartimin e dokumentit, i cili i nënshtrohet seancave të diskutimit me publikun njëlloj si PPV.

Figura 1. Hapat në hartimin e PIK



Burimi: Manuali për hartimin e planit të investimeve kapitale, Co-PLAN 2008

Dokumenti i PIK për Bashkinë Elbasan, është i organizuar në kapituj që reflektojnë hapat e ndërmarra gjatë hartimit të PIK, dhe përmbyllet me pasqyrën përmbledhëse të shpenzimeve për investimet kapitale sipas fazave të përcaktuara edhe në PPV. Për të gjithë periudhën e konsideruar në PIK, 2016 – 2030, shpenzimet parashikohen dhe prezantohen në tabelë të detajuara për çdo vit. Pjesë e dokumentit të PIK janë edhe fishat e projekteve kapitale, të cilat sjellin një informacion të përmbledhur në lidhje me investimin e parashikuar, vlerën e tij, kohëzgjatjen, mënyrën e financimit, etj.

1. Politika e hartimit të Planit të Investimeve Kapitale

Politika e hartimit të PIK adreson qasjet e ndjekura në lidhje me një sërë çështjesh, si p.sh.: (i) lloji i projekteve kapitale të përfshira; (ii) periudhën kohore që PIK mbulon; (iii) mënyrën e financimit të projekteve kapitale, apo mundësinë për të mobilizuar të ardhura; (iv) strategjinë financiare dhe atë fiskale që do të ndjekë bashkia për të mundësuar realizimin e investimeve të parashikuara; (v) procesin e përfshirjes dhe konsultimit të publikut gjatë hartimit të PIK, etj.


Në këtë dokument PIK prezantohet si një prej instrumenteve që mundësojnë zbatimin e PPV-së. Ky fakt kushtëzon dhe orienton njëkohësisht hartimin e tij. Kështu, identifikimi dhe përcaktimi i nevojave për investime kapitale në bashki, bëhet drejtpërdrejtë gjatë dhe nëpërmjet procesit të hartimit të PPV-së. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për procesin e prioritarizimit të investimeve kapitale, si dhe fazimin e tyre. PIK mbulon periudhën kohore 2016 – 2030 dhe investimet kapitale organizohen sipas tre fazave, të cilat reflektojnë edhe planin e veprimit të hartuar në SZHT të Bashkisë së Elbasanit. Për fazën e parë të PIK (2016 – 2020) jepen të detajuara në analizë të gjitha të dhënat financiare dhe fiskale si dhe mundësitë e financimit të PIK, ndërsa për fazën e dytë (2020 – 2025) dhe të tretë (2026 – 2030) parashikimet prezantohen për zërat kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve, duke reflektuar strategjinë financiare të parashikuar për financimin e investimeve kapitale.

Si pjesë e politikës së PIK, procesi është kryer në mënyrë të tillë që të ofrojë informacionin e nevojshëm edhe për vendodhjen gjeografike të investimit, duke i specifikuar investimet (sa herë është e mundur) sipas njësive administrative që përbëjnë Bashkinë e Elbasanit.

Më poshtë do të ndalemi kryesisht në detajimin e strategjisë financiare të propozuar prej Bashkisë së Elbasanit për të mundësuar realizimin e investimeve/përmirësimeve të listuara.

Burimi kyesor i vetë Bashkisë së Elbasanit për financimin e PIK është teprica operative neton (TON). TON do të përcaktohet si diferenca midis të ardhurave korente dhe shpenzimeve korente (Figura 2., Financimi i investimeve kapitale). Konvencionalisht, të ardhurat korente do të identifikohen si diferencë e të ardhurave totale me të ardhurat kapitale (të ardhura nga shitja e aseteve dhe të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë). Shpenzimet korente do të quhen të kategoritë e shpenzimeve për personel dhe për shpenzime operative. Diferenca midis këtyre dy kategorive do të japë atë që quhet tepricë operative (TO).

Figura 2. Financimi i investimeve kapitale



Burimi: Manuali për hartimin e planit të investimeve kapitale, Co-PLAN 2008

Nga ky përkufizim bëhet e qartë se niveli i TON është funksion i përformancës fiskale të bashkisë nga njëra anë – pra rritjes së të ardhurave prej taksave, tarifave dhe si dhe e mundësive të tjera alternative të financimit, dhe nga ana tjeter, përmirësimit të menaxhimit financiar, nëpërmjet reduktimit të shpenzimeve operative dhe eficientimit të stafit vendor.

Pikërisht në këto dy drejtime kryesore fokusohet edhe strategjia financiare e Bashkisë së Elbasanit për 15 vitet e ardhshme: (i) nga njëra anë përmirësimit të performancës nga ana e të ardhurave nëpërmjet mirë-menaxhimit financiar dhe eksplorimit të burimeve alternative të financimit; dhe (ii) nga ana tjetër reduktimit të shpenzimeve operative nëpërmjet eficientimit të stafit vendor.

Përmirësimi i performancës në kahun të ardhurave vendore do të mundësohet si rezultat i disa faktorëve dhe masave të parashikuara, si më poshtë:

- mirë-administrimi dhe menaxhimi i taksave vendore, dhe veçanërisht i taksës mbi pasurinë e paluajtshme (taksës mbi ndërtesën, tokën bujqësore dhe truallin);
- prezantimi i instrumenteve të rinj financiarë (si tarifat e përmirësimit të infrastrukturës vendore, bonusit të intensitetit, programet e transferimit të të drejtës së zhvillimit apo programet e financimit nëpërmjet rritjes së taksave specifike, etj.), të cilat jo vetëm do të mundësojnë mirë-menaxhimin e territorit të Bashkisë së Elbasanit, por do të ofrojnë një instrument të qenësishëm financiar për mbulimin e kostove të infrastrukturave të përmirësuara, apo zonave urbane të rivitalizuara;

- vënia në shfrytëzim e objekteve dhe pronave të Bashkisë duke mundësuar eficientimin e përdorimit të tyre nëpërmjet skemave të partneritetit publik – privat;
- eksplorimi i mëtejshëm skemave të partneriteteve me sektorin privat në ofrimin e shërbimeve publike, si transporti publik, sportet dhe qendrat rekreative, menaxhimi i mbetjeve, furnizimi me ujë, pikat e grumbullimit për produktet bujqësore, etj..

Përsa i përket rritjes së TON, nëpërmjet reduktimit të shpenzimeve operative, Bashkia e Elbasanit parashikon marrjen e një sërë masash si më poshtë:

- përmirësimin e praktikave në ofrimin e shërbimeve vendore dhe eficientimin e kostove të tyre nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit;
- riorganizimit të disa shërbimeve vendore nëpërmjet eksplorimit të mëtejshëm të skemave të partneritetit me sektorin privat;
- reduktimit të kostove administrative nëpërmjet përmirësimit/rikonstruksionit të objekteve vendore duke mundësuar eficiencën energjitike.

Së fundmi, në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve financiare të veta të bashkisë, përdorimi i instrumenteve financiare si huaja nga sistemi bankar (në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi dhe pasi të jenë qartësuar asetet në pronësi të bashkisë përdorur në kolateralizimin e kredive); fondet shtetërore nga (FZHR, FSHZH, etj.) të orientuara kryesisht në mbështetje të zhvillimit të infrastrukturës; fondet nga donatorët e huaj (Banka Botërore, USAID, KfW, WBIF, etj.) apo edhe format e partneritetit publik-privat paraqesin një mundësi reale për realizimin e investimeve kapitale. Në këtë drejtim, vlerësohet e domosdoshme rritja e kapaciteteve të bashkisë në drejtim të hartimit, menaxhimit, zbatimit dhe monitorimit të projekteve të investimeve nëpërmjet këtyre formave të financimit.

Kjo strategji financiare është prezantuar dhe diskutuar me publikun përgjatë takimeve të zgjeruara të organizuara në kuadër të hartimit të PPV-së dhe ka marrë aprovimin e tij, në funksion të realizimit të vizionit të Bashkisë së Elbasan:

"Elbasani një qendër shumë-funksionalë përgjatë Korridorit IIIV dhe rrugës Egnatia, qytet me qëndrueshmëri të lartë në zhvillim ekonomik dhe social, duke ruajtur e rigjeneruar vlerat mjedisore të zonës dhe rajonit. Elbasani është një nyje e rëndësishme lidhëse ekonomike dhe infrastrukturore në rajon, në të cilën harmonizohen zhvillimi bujqësor e blegtoral dhe [eko]turistik me atë hapësinor dhe industrial. Elbasani e ndërton të ardhmen e tij dhe garanton zhvillimin e qëndrueshëm duke u mbështetur në një qeverisje të udhëhequr nga njerëzit dhe për njerëzit. Zhvillimi i territorit, urbanizimi i kontrolluar, krijimi dhe shfrytëzimi i drejtë i hapësirave publike stimulojnë një klimë të shëndetshme biznesi e konkurrence të pastër, në favor të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm. Mbrojtja dhe përdorimit efektiv i tokës [urbane dhe rurale], respektimi i mjedisit, kulturës, trashëgimisë natyrore dhe identitetit historik, janë baza për një jetesë të shëndetshme dhe aktive dhe mundësi të reja punësimi. Përmes qeverisjes së mirë dhe transparente, bashkia krijon kushte për integrim dhe ndërveprim social, duke nxitur socializimin dhe harmoninë e komunitetit për të mirën e përbashkët."

Për hartimin e PIK është marrë në konsideratë edhe kuadri ligjor përkatës për financat vendore dhe konkretisht:

- Ligji 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore";*
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë";* ndryshuar me Ligjin nr. 114/2012;
- Ligj nr. 57/2016 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*, të ndryshuar;
- Ligji nr. 147/2015 *"Për Buxhetin e vitit 2016";*
- Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 *"Për huamarrjen e Qeverisjes Vendore";*
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 *"Për sistemin e Taksave Vendore"*;
- Ligji nr. 9764, datë 09.07.2007 *"Për disa ndryshime në ligjin 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave Vendore";*
- Ligji nr. 142/2015 *"Për ndryshime dhe amendime në ligjin nr. 9632";*
- Ligji nr. 10117, dt. 23.04.2009; ligji 10146, dt. 28.09.2009; ligji nr. 10073, 09.02.2009 *"Per disa ndryshime në ligjin nr. 9632, dt. 30.10.2006 mbi sistemin e taksave vendre.";*
- Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 *"Për proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"*;
- Ligji 9975, datë 28.07.2008 *"Për taksat kombëtare"*, i amenduar;
- Ligj nr.10 296, datë 8.7.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin";*
- Vendim i Këshillit të Ministrave (VKM) numër 671, datë 29.07.2015 *"Për miratimin e Rregullores për Planifikimin e Territorit";*
- Udhëzim nr.4, datë 29.02.2016 *"Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019";*
- Udhëzim nr. 2, datë 06.02.2012 *"Për procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit";*
- Udhëzim nr. 1, datë 04.06.2014 *"Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari";*
- Udhëzim nr. 34, datë 28.12.2015 *"Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2016";*
- Udhëzim nr. 7/1, datë 28.02.2014 *"Për përgatitjen e buxhetit vendor";*
- Udhëzim nr. 3, datë 16.01.2015 *"Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit";*
- Udhëzim nr. 7, datë 11.02.2015 *"Për procedurat standarde të përcaktimit dhe zbatimit të limitit të angazhimeve";*
- Udhëzim nr. 8, datë 29.03.2012, *"Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm".*

2. Nevoja për investimeve kapitale dhe identifikimi i projekteve

Identifikimi dhe vlerësimi i nevojës së Bashkisë së Elbasanit për investime kapitale është bërë nëpërmjet ndjekjes së hapave si më poshtë:

- Vlerësimi i kushteve ekzistuese të infrastrukturës në qytet dhe nevojës së ardhshme për shërbime (shiko Tabela 1.). Është vlerësuar gjendja e infrastrukturave dhe shërbimeve të ndryshme publike dhe është grumbulluar informacion në lidhje me moshën, gjendjen, historinë e mirëmbajtjes dhe koston e zëvendësimit të infrastrukturave/shërbimeve publike.
- Vlerësimi i nevojave të tjera për investime kapitale për përmbushjen e objektivave strategjikë të parashikuara në SZHT-në e Bashkisë: si p.sh. projektet urbane apo zhvilluese: krijimi i zonave të gjelbra, strehimi social, krijimi i zonave të reja të parkimit, etj.
- Rishikimi i projekteve të aprovuara më parë, për të mundësuar përditësimin e PIK, lidhjen e tij me dokumentet e tjera financiare (PBA dhe buxheti vjetor), dhe krijimin e një panorame sa më të plotë në lidhje me investimet kapitale në Bashki.

Tabela 1. dhe Tabela 2., sjellin një panoramë të situatës në lidhje me nevojën për infrastrukturë dhe shërbimeve publike në bashki, referuar aksesit që banorët kanë në to, për çdo njësi administrative.

Tabela 1. Inventari i infrastrukturës dhe shërbimeve publike në Bashkinë e Elbasan

	NJËSIA ADMINISTRATIVE												
	Elbasan	Bradashesh	Funarë	Gjergjan	Gjinar	Gracen	L.Fushe	L.Mal	Papër	Shirgjan	Shushicë	Tregan	Zavalinë
Popullsia	78,703	10,700	2,112	5,126	3,478	2,192	7,058	5,291	6,348	7,307	8,731	3,036	1,622
Toka e banueshme (ha)	852.2	167.87	36.27	194.23	159.58	109.24	78.38	58.29	167.85	254.14	228.52	114.46	437.59
Aksesi në infrastrukturë													
Rrugë (% e popullsisë)	100	91	86	98	92	94	-	94	83	98	69	94	78
Ujë (% e popullsisë)	-	74.9	16.6	78.4	94.8	0	89.5	27.3	58.9	100	100	100	31
Aksesi në objekte të superstrukturës													
Kopësht (425m) (%, sip. banimi e mbuluar)	56.84	41.7	15.16	34.6	17.37	9.36	43.99	0	25.56	39.11	24.91	19.54	9.04
Shkolle 9-Vjeçare (900m) (%, sip. banimi e mbuluar)	93.85	78.63	76.51	72.59	52.86	75.16	82.13	0	55.02	74.34	73.8	42.98	45.3
Shkollë e mesme (2750m) (%, sip. banimi e mbuluar)	99.35	16.2	42.35	60.76	41.23	0.7	56.01	0	41.44	93.23	23.52	3.58	69.08

Burimi: Co-PLAN dhe Bashkia Elbasan, 2016

Kësaj panorame i shtohet plani i veprimit i hartuar në kuadër të SZHT-së, në të cilin janë identifikuar projektet dhe ndërhyrjet kryesore kapitale për realizimin e objektivave strategjike, si dhe lista e investimeve kapitale prioritare të miratuar së bashku me buxhetin e vitit 2016. Mbi këtë bazë është ndërtuar tabela e projekteve kapitale e cila përmbledh informacionin në lidhje me: (i) titullin e projektit, (ii) programin dhe objektivin strategjik në të cilin kontribuon realizimi i projektit; (iii) vendndodhjen gjeografike dhe administrative; (iv) vlerën e projektit; (v) kohën e zbatimit të tij; si dhe (vi) burimin e financimit.

Tabela 2. Mbulimi i popullsisë së njësive administrative të Bashkisë së Elbasan me shërbime vendore

	NJËSIA ADMINISTRATIVE												
	Elbasan	Bradashesh	Funarë	Gjergjan	Gjinar	Gracen	L.Fushë	L.Mal	Papër	Shirgjan	Shushicë	Tregan	Zavalinë
Popullsia me shërbime të mbuluara	78,500	9,704	1,810	5,037	3,192	2,059	-	4,981	5,249	7,182	6,025	2,861	1,258
Popullsia pa shërbime të mbuluara	203	996	302	89	286	133	-	310	1099	125	2706	175	364

Burimi: Co-PLAN dhe Bashkia Elbasan, 2016

3. Kapaciteti financiar i Bashkisë Elbasan


3.1 Analiza financiare 2010-2015

Analiza e aktivitetit financiar për Bashkinë Elbasan u realizua me përdorimin e të dhënave nga Sistemi i Informacionit të Menaxhimit Financiar i Qeverisë (Sistemi i Thesarit), pranë Ministrisë së Financave. Përdorimi i këtij burimi justifikohet me faktin se arrihet të sigurohen seri kohore për periudhën 2010 – 2015 për të gjitha njësitë administrative përbërëse të Bashkisë së re Elbasan. Të dhënat financiare janë të disponueshme në nivel njësie administrative, në monedhë vendase dhe për efekte analize u konsoliduan në nivel bashkie.

3.1.1 Të ardhurat

Të ardhurat totale të Bashkisë Elbasan vlerësohet të kenë ndjekur përgjithësisht një prirje përmirësuese përgjatë periudhës 2010 – 2015. Norma mesatare vjetore e rritjes së të ardhurave gjatë kësaj periudhe rezultoi të jetë rreth 8.2%, edhe pse me luhatje të ndjeshme nga viti në vit. Në total, të ardhurat në dispozicion të Bashkisë Elbasan janë luhatur në intervalin 2.2 – 3.2 miliard lekë. Në vitin 2015, burimet financiare në dispozicion të Bashkisë Elbasan shënuan një vlerë prej 3.1 miliard lekë, në rënie të lehtë me rreth 1.9% krahasuar me një vit më parë. Megjithatë, në dy vitet e fundit të periudhës në analizë mjetet financiare në total kanë shënuar një rritje substanciale në terma nominalë.

Figura 3. Ecuria e të ardhurave totale dhe ndryshimet vjetore




Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Në linja të përgjithshme, përcaktues i kahut të zhvillimeve në të ardhurat totale për Bashkinë Elbasan rezulton të jenë të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare1. Përgjatë periudhës në analizë, të ardhurat totale u përbënë mesatarisht për rreth 77.8% nga të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare përkundrejt 22.2% nga të ardhurat vendore. Pesha e lartë e transfertave

ndërqeveritare ndaj totalit të të ardhurave bën që, ndryshime të vogla në nivel qendror në lidhje me këtë kategori të ardhurash të kenë efekt të rëndësishëm në sjelljen e të ardhurave totale të Bashkisë Elbasan, për pasojë lirshmërisë së saj në ndërmarrjen e projekteve të investimeve.

Analiza në terma kontributesh evidenton më së miri këtë prirje të financave të Bashkisë Elbasan: kontributi i të ardhurave nga transfertat ndërqeveritare ka përcaktuar më së shumti kahun e zhvillimeve në të ardhurat totale gjatë viteve 2010 – 2015.

Figura 4. Kontributi i kategorive në ndryshimin vjetor të të ardhurave totale




Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Pavarësia financiare e Bashkisë Elbasan, matur nga raporti i të ardhurave vendore ndaj totalit të të ardhurave vlerësohet relativisht e ulët përgjatë periudhës 2010 - 2015. Autonomia financiare regjistroi nivelin maksimal në vitin 2015 me rreth 26.1% dhe nivelin më të ulët në vitin 2013 me rreth 19.5%. Të ardhurat vendore në vitin 2015 shënuan një nivel prej rreth 822.1 milionë lekë, në rritje me rreth 7.2% në terma vjetorë. Kjo normë rezulton të jetë moderuar krahasuar me normën e rritjes së të ardhurave vendore prej 61.5% në vitin 2014.

Niveli i të ardhurave vendore përcaktohet na masën më të madhe nga performanca e taksave dhe tatimeve vendore. Mesatarisht, të ardhurat nga taksat dhe tatimet vendore kanë përfaqësuar rreth 49.2% të të ardhurave totale gjatë viteve 2010 – 2015. Kategoria e dytë me peshën më të lartë në përbërjen e të ardhurave vendore përfaqësohet nga të ardhurat nga tarifat vendore të cilat përfaqsojnë mesatarisht 25.0% të tyre. Të ardhurat nga asetet, ndonëse në rritje progresive dhe me potencial afatgjatë, përfaqësuan mesatarisht 7.5% të të ardhurave vendore. Kategoria e të ardhurave e tjera (të cilat përfshijnë të ardhura nga donacione, hua, të ardhura të trashëguara etj) zë një peshë të konsiderueshme (mesatarisht 18.2%) në totalin e të ardhurave vendore.


Figura 5. Të ardhurat vendore dhe ndryshimi vjetor i tyre



Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Në kategorinë e të ardhurave vendore, të ardhurat nga *taksat dhe tatimet*, ndër vite, kanë qenë përcaktuesi kryesor i zhvillime. Në vitin 2015, të ardhurat nga kjo kategori shënuan vlerën e 307.7 milionë lekëve, në rritje me rreth 19.4% në terma vjetorë. Rrijta në terma vjetorë u materializua në një kontribut pozitiv të kësaj kategorie në totalin e të ardhurave vendore. Specifikisht, vlen të evidentohet kontributi pozitiv i të ardhurave të gjeneruara nga *taksat e pronës (tokë bujqësore* dhe *ndërtesa)*, *taksa mbi biznesin e vogël (tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël)* dhe *taksa e ndikimit në infrastrukturë* nga ndërtimet e reja. Taksat e pronës (taksa mbi ndërtesat dhe ajo mbi tokën bujqësore dhe taksa e truallit[2]) shihen i taksa me kontribut potencial të lartë në rritjen e të ardhurave vendore si dhe përmirësimin e pavarësisë financare të Bashkisë Elbasan.

Figura 6. Kontributi sipas kategorive në ndryshimin vjetor të të ardhurave




Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Të ardhurat nga *tarifat vendore* kanë qenë të luhatshme ndër vite por, performanca e tyre në total udhëhiqet nga ecuria e të ardhurave nga *tarifa e pastrimit dhe higjenës*. Të ardhurat e gjeneruara nga menaxhimi i *aseteve* në dispozicion përbëjnë një element të rëndësishëm në strukturën e të ardhurave vendore, duke kontribuar pozitivisht në ecurine e të ardhurave vendore. Për më tepër, implementimi i sistemeve për menaxhimin e aseteve mund t'i transformojë ato në një burim akoma më të rëndësishëm financiar për Bashkinë Elbasan.

Kategoria të ardhurave të tjera duket të ketë fituar terren veçanërisht gjatë vitit 2014 duke dhënë kontribut përcaktues në kahun e zhvillimeve në të ardhurat totale. Kontributi pozitiv dhe në rritje është përcaktuar në masën më të madhe nga disbursimet e kredisë të kontraktuar nga Bashkia Elbansan për financimin e projekteve të investimeve.

Të ardhurat nga *transfertat ndërqeveritare* të Bashkisë Elbasan, rezultojnë të jenë një element dominues dhe përcaktues në strukturën dhe performancën e të ardhurave totale. Varësia në terma financiarë nga kjo kategori të ardhurash kushtëzon planifikimin e shpenzimeve kapitale (investimeve) të Bashkisë Elbasan. Në vitin 2015, të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare shënuan vlerën 2.3 miliard lekë, në rënie me rreth 4.7% krahasuar me një vit më parë (rënie e diktuar më shumë prej bazës krahasuese të lartë të një viti më parë). Sipas elemtëve përbërës, peshën më të madhe e zënë të ardhurat nga transferta e kushëzuar e cila në vitin 2015 përfaqësoi rreth 72.8% të të ardhurave nga transfertat ndërqeveritare (mesatarja 2010 – 2015 është 70.0%). Mesatarisht, rreth 76% e kësaj transferte vjen nga Minsitria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë në trajtën e transfertës për buxhetet familjare dhe individët në nevojë. Pas një rritje vjetore të ndjeshme me rreth 31% në vitin 2014, niveli i transfertës së pakushtëzuar për vitin 2015 shënoi rënie me rreth 6.3% krahasur me një vit më parë.

Figura 7. Të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare dhe ndryshimi vjetor i tyre



Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar përfaqësuan mesatarisht 27.6% të të ardhurave nga transferta ndërqeveritare. Teorikisht dhe në ndryshim nga transfertat e kushtëzuara, për këtë


kategori të ardhurash pushteti vendor gëzon autonomi të plotë në përdorim (përjashtuar rastet kur qeveria qendrore udhëzon ndryshe). Në praktikë, ky burim të ardhurash rezulton të jetë shumë i rëndësishëm dhe i qenësishëm në tërësinë e mjeteve financiare në dispozicion të Bashkisë Elbasan. Mesatarisht, niveli i të ardhurave nga transferta e pakushtëzuar është i krahasueshëm me totalin e të ardhurave vendore (të ardhurat nga taksat, tarifat, asetet dhe të ardhurat e tjera). Në vite të caktuara, si 2010 - 2012-2013, të ardhurat nga ky zë tejkalonte vlerën e të ardhurave vendore, duke u transformuar në një burim financiar të rëndësishëm për Bashkinë Elbasan. Mesatarisht për periudhën në analizë, transferta e pakushtëzuar ishte sa 98.6% e të ardhurave vendore (ka një tendencë ngushtuese të raportit të tyre si pasojë e rritjes së të ardhurave vendore). Të ardhurat nga taksat dhe tatimet e ndara rezultojnë në një kontribut më të ulët ndaj totalit të të ardhurave nga tranfertat ndërqeveritare dhe paraqiten të luhatshme në kohë (si pasojë e ndryshimeve legjislative të ndodhura).

3.1.2 Shpenzimet

Në përputhje me nivelin e të ardhurave totale, Bashkia Elbasan realizon shpenzime për të siguruar vijimësinë institucionale, ushtrimin dhe përmbushjen e funksioneve dhe kompencave të përcaktuara nga ligji nr. 139/2015 *"Mbi vetëqeverisjen vendore"*, në territorin në adminsitrim përcaktuar nga ligji nr. 115/2014 *"Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërsië"*.

Gjatë vitit 2015, shpenzimet totale të Bashkisë Elbasan shënuan një vlerë prej 3.2 miliard lekë, në rënie me rreth 13.0% krahasuar me shpenzimet e kryera një vit më parë. Në përgjithësi, ecuria e totale e shpenzimeve duket të ketë qenë e luhatshme ndër vite dhe rënia e shënuar në vitin 2015 të jetë rezultat i bazës së lartë krahasuese të vitit 2014 (norma vjetore e rritjes së shpenzimeve në këtë vit ishte 36.9% ose rreth 1 miliard lekë). Nisur nga fakti se viti 2015 u karakterizua nga ndryshime të mëdha, Bashkia Elbasan u përball me një situatë në të cilën, territori nën administrim dhe popullsia për tu shërbyer u rritën ndjeshëm, të gjitha këto të përkthyeshme në terma financiarë. Në këtë kontekst, nevoja për mjete financiare rezulton të jetë e lartë si për shpenzime administrative ashtu dhe për shpenzime kapitale, veçanërisht në njësitë administrative (ish-komunat) që iu bashkëngjitën Bashkisë së vjetër Elbasan.

Figura 8. Shpenzimet sipas qëllimit të përdorimit dhe ndryshimi vjetor i tyre



Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Ndër vite, struktura e shpenzimeve të Bashkisë Elbasan rezulton të jetë dominuar nga shpenzimet operative dhe ato të personelit (paga dhe sigurime). Shpenzimet operative të Bashkisë Elbasan mesatarisht përfaqësuan rreth 62.0% të shpenzimevet totale të kryera gjatë viteve 2010 - 2015. Në vitin 2015, shpenzimet operative shënuan një vlerë prej rreth 2.0 miliard lekë, në tkurrje me rreth 6.8% krahasuar me nivelin e tyre të një viti më parë.


Kategoria e dytë e shpenzimeve me peshë më të madhe ndaj totalit të shpenzimeve, ato të personelit, përfaqësuan mesatarisht rreth 16.9% ndaj totalit të shpenzimeve përgjatë periudhës 2010 – 2015. Në vitin 2015, shpenzimet për personelin rezultojnë të jenë reduktuar me rreth 1.5% në terma vjetorë, duke përfaqësuar rreth 14.0% të shpenzimeve totale të kryera në vitin 2015.

Në total, shpenzimet korente (shpenzime personeli dhe operative) përfaqësuan mesatarisht rreth 78.9% të shpenzimeve totale të ndërmarra nga Bashkia Elbasan për periudhën 2010 – 2015. Për vitin 2015, shpenzimet operative dhe të personelit përfaqësuan rreth 76.8% të shpenzimeve totale, vlerë kjo nën mesataren e periudhës së konsideruar.

Kategoria e shpenzimeve kapitale përfaqësoi mesatarisht rreth 21.1% të shpenzimeve totale të Bashkisë Elbasan përgjatë periudhës 2010-2015. Pas vitit 2013, shpenzimet kapitale të kryera nga Bashkia Elbasan u mëse dyfishuan në vitin 2014 dhe shënuan rënie me rreth 30.4% në vitin 2015.

Në përgjithësi, normat rënëse të shpenzimeve korente apo kapitale gjatë vitit 2015 janë diktuar në masë të madhe nga baza e lartë krahasuese e vitit 2014, vit në të cilin të gjithë zërat e shpenzimeve kanë shënuar një rritje substanciale.

Figura 9. Kontributi sipas kategorive në ndryshimin vjetor të shpenzimeve




Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Analiza në terma kontributesh konfirmon dominimin e shpenzimeve administrative (personel dhe operative) përgjatë periudhës së konsideruar. Ajo që vlen të theksohet është balancimi deri diku i kontributit të këtyre dy kategorive në favor të shpenzimeve kapitale. Kështu, duke filluar prej vitit 2014, vihet re një rritje e qenësishme e shpenzimeve kapitale dhe kontribut në kahe të ndryshme i tyre në shpenzimet totale.

3.1.3 Teprica operative dhe buxheti kapital

Teprica operative neto vlerësohet të ketë qenë pozitive dhe luhatshme përgjatë periudhës 2010-2015. Niveli minimial i saj u regjistrua në vitin 2013, rreth 108.2 milionë lekë, në rënie me rreth 0.3% krahasuar me vlerën e treguesit një vit më parë. Edhe pse me luhatje ndër vite, teprica operative neto për Bashkinë Elbasan ka regjistruar vlera pozitive dhe në kahun përmirësues. Në vitin 2015, teprica operative rezultoi në rreth 496.2 milionë lekë, në rritje me rreth 0.8% në terma vjetorë. Ky nivel i tepricës operative përfaqëson rreth 16.8% të të ardhurave operative të Bashkisë Elbasan në vitin 2015 dhe sinjalizon për një orientim të qartë drejt ndërmarrjes së investimeve kapitale. Për sa kohë që aksesi në burimet financiare nga grantet konkurruese, burimet ndërkombëtare dhe forndet e donatorëve paraqesin një parashikueshmëri të ulët, teprica operative (dhe teprica operative neto) përbëjnë burimin kryesor mbi bazën e të cilit të ngrihen parashikimet për financimin e projekteve kapitale.

Figura 10. Teprica operative neto (TON)




Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Buxheti kapital në dispozicion të Bashkisë Elbasan do të përcaktohet si shuma e mjeteve financiare nga teprica operative, të ardhruat kapitale nga shitja e aseteve, të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, të ardhura nga huaja, donacionet dhe të ardhura nga taksa të përmirësimit apo instrumentë të tjerë të posaçëm të zhvillimit. Të gjitha këto përbëjnë atë që gjerësisht konisderohet si buxhet kapital dhe që për Bashkinë Elbasan rezulton të ketë shënuar vlera pozitive përgjatë periudhës 2010 – 2015.

Shpenzimet kapitale të ndërmarra nga Bashkia Elbansan gjatë periudhës 2010 – 2015 kanë qenë në mënyrë konstante më të larta krahasuar me buxhetin kapital në dispozicion. Në vitin 2014 kjo gjë është edhe më evidente, ku shpenzimet kapitale rezultojnë rreth dy herë më të larta se të ardhurat kapitale. Situata në vitin 2015 rezulton deri diku më e balancuar, me shpenzimet kapitale lehtësisht më të larta se të ardhurat kapitale. Kështu, të ardhurat apo buxheti kapital për vitin 2015 rezultoi në rreth 685.2 milionë lekë përkundrejt një niveli shpenzimesh kapitale pres rreh 744.5 milionë lekësh.


Figura 11. Të ardhura dhe shpenzime kapitale



Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Shpërndarja sipas programeve buxhetore e buxhetit kapital përgjatë periudhës 2010 - 2015 pasqyron dhe orientimin strategjik të bashkisë në kohë. Në vitet 2010 – 2015, investimet kapitale ishin të përqëndruara në programin buxhetor *"çështjet ekonomike"* (pavarësisht burimit të financimit) ku përfshihen edhe investimet e lidhura me infrastrukturën rrugore. Programi buxhetor i arsimit ai i strehimit dhe komoditeteve të komunitetit gjithashtu rezultojnë të kenë qenë destinacion i një pjese të shpenzimeve kapitale të ndërmarra nga Bashkia Elbasan.

Figura 12. Shpenzimet kapitale sipas programeve buxhetore



Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

4. Përzgjedhja e projekteve kapitale prioritare

Identifikimi dhe vlerësimi i projekteve kapitale është bërë në përputhje me objektivat strategjik të SZHT-së, të reflektuar gjithashtu edhe në propozimet e PPV-së. Referuar pamundësisë së financimit të të gjithë projekteve të identifikuara në tabelën përmbledhëse të nevojave për investime kapitale, është bërë procesi i prioritarizimit dhe përzgjedhjes së projekteve të investimeve mbi bazën e një sërë kriteresh të dakordësuara me aktorët. Kriteret marrin në konsideratë tre çështje kryesore: (i) koston e investimit; (ii) jetëgjatësinë dhe kohën e përdorshme të investimit; (iii) koston e mirëmbajtjes.

Mbi bazën e këtyre tre çështjeve lista e kritereve që investimet kapitale duhet të plotësojnë në procesin e prioritarizimit të tyre është si më poshtë:

- kontributi i projektit në prioritetet strategjike: sa dhe si kontribuon projekti në arritjen e objektivave strategjik;
- natyra e projektit: a ndikon projekti në parandalimin/eleminimin e një situate urgjente/të rrezikshme;
- statusi i projektit: a është projekt në vazhdim apo projekt i ri dhe si është identifikuar;
- vendndodhja gjeografike/administrative: cila është zona e mbuluar nga projekti dhe në cilën njësi administrative kontribuaon/shtrihet ai;
- kohëzgjatja e shlyerjes së kostos së projektit: a mundet projekti të gjenerojë të ardhura në buxhetin vendor? Kur dhe për sa kohë mund të ndodhë kjo?;
- mundësia e financimit të projektit: a financohet projekti prej buxhetit vendor kapital, apo prej programeve të qeverisë qendrore (QQ)/donatorëve/etj).

5. Mundësitë e financimit dhe mobilizimi i të ardhurave

Në funksion të përmbushjes së vizionit dhe të objektivave strategjikë të përshkruar në Strategjinë e Zhvillimit për Territorin e Bashkisë Elbasan, rezulton thelbësor përkthimi në terma sasiorë (monetar) i tyre. Për këtë qëllimin, projeket e investimeve sipas programeve kuantifikohen dhe shpërndahen ndër vite (fazohen në kohë). Materializimi i projekteve të investimeve në përmbushje të vizionit të Bashkisë Elbasan varet shumë nga buxheti kapital apo mjetet financiare në dispozicion të bashkisë.

5.1 Parashikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve

Parashikimi i të zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2016 është marrë nga plan buxheti i Bashkisë së Elbasanit për vitin 2016. Për periudhën 2017 – 2019, parashikimet u morrën nga Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2017 – 2019 dhe mbi bazën e supozimeve të PBA-së seritë kohore u zgjatën deri në vitin 2020. Për periudhën 2020 – 2030, parashikimet u kryen duke konsideruar trendin e përgjithshëm të ndjekur nga zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së mëparshme, normat rritëse të parashikuara në PBA 2017 – 2019, parashikimet e përgjithshme për treguesit makroekonomikë të publikuar nga Ministria e Financave.

Parashikimet për të ardhurat dhe shpenzimet vendosen në një kontekst makroekonomik të qendrueshëm i cili karakterizohet nga:

- normë inflacioni e qëndrueshme dhe pranë objektivit të Bankës së Shqipërisë për 3%;
- kurs këmbimi me valutat kryesore (euro dhe dollar amerikan) i qendrushëm pa goditje permanente dhe të qenësishme;
- rritje e moderuar e popullsisë;
- rritje nominale dhe reale e ekonomisë pranë vlerës potenciale;
- rënie e ngadaltë por progresive e papunësisë;
- tregues fiskalë (defiçit buxhetor dhe borxh qeverie) pranë niveleve të përshkruara nga Traktati i Maastricht-it;
- qendrueshmëri e bilancit të pagesave (llogari korente dhe financiare).

Normat e rritjes së treguesve të ndryshëm për të ardhurat dhe për shërbimet do të aplikohen në mesataren rrëshqitëse të 5 viteve paraardhëse.

Tabela 3. Supozime bazë për parashikimin e të ardhurave

	2021-2025	2026-2030
Taksa dhe tatime	+10.0%	+10.0%
Tarifa vendore	+10.0%	+5.0%
Asete	+10.0%	+10.0%
Të tjera	+10.0%	+5.0%
Transferta e kushtëzuar	+7.0%	+10.0%
Transferta e pakushtëzuar	+10.0%	+10.0%

Transferta specifike	-	-
Taksa dhe tatime të ndara	+10.0%	+10.0%

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Nisur nga norma mesatare e rritjes së të ardhurave nga taksat dhe tatimet, supozimet e aplikuara për periudhën 2016-2020 dhe niveli aktual i mbledhjes së tyre vlerësohet se një normë rritjeje prej 10% në fazën e parë dhe të dytë është e përshtatshme. Përsa i përket tarifave, në fazën e parë synohet rritje me rreth 10% dhe në të dytën 5%. Të ardhurat nga asetet vlerësohen me potencial të lartë për rritjen e të adhurave të Bashkisë Elbasan dhe përmirësimi në menaxhimin e tyre do të mund të përkthehej në një rritje të të ardhurave me 10% në fazën e parë dhe të dytë. Në lidhje me transfertat ndërqeveritare, duke marrë në konsideratë ndryshimet e mundshme legjislative (ligji për financat vendore) vlerësohet që transferta e kushtëzuar të rritet me 7% në fazën e parë 2021 – 2030 dhe me rreth 10% në fazën e dytë të konsideruar. Duke filluar prej vitit 2021, transferta specifike vlerësohet të mos jetë më si instrument nisur nga fakti se në harkun e pesë viteve pas marrjes së funksioneve të reja ato të jenë përbrendësuar nga Bashkia Elbasan dhe fondet për to do të jenë të përfshira në totalin e transfertës së kushtëzuar. Ndërkohë, transferta e pakushtëzuar të rritet me 10% për të njëjtat periudha. I njëjti arsyetim vlen edhe për të ardhurat nga taksat dhe tatimet e ndara.


Tabela 4. Supozime bazë për parashikimin e shpenzimeve

	2021-2025	2026-2030
Personel	+2.0%	+3.0%
Operative	+2.0%	+1.0%
Kapitale	+5.0%	+5.0%

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016

Shpenzimet për personelin vlerësohet të rriten me rreth 2% në fazën e parë dhe me rreth 3% në fazën e dytë. Rritja e efieciencës dhe efikasitetit në menaxhimin e Bashkisë si dhe nevojat për investime, vlerësohet një rritje e moderuar me 2 dhe 1% e shpenzimeve operative të Bashkisë Elbasan. Nga ana tjetër, moderimi në shpenzime korente do të pasqyrohet në rritje të nivelit të investimeve me 5% përgjatë periudhës 2021-2015 dhe me rreth 2.5% gjatë përiudhës 2026-2030.

Figura 13. Parashikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve




Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016
*2021-2025 dhe 2026-2030 janë vlera mesatare.

Në total, vlerësohet se Bashkia Elbasan do të ketë një nivel të ardhurash të mjaftueshëm për mbulimin e shpenzimeve të parashikuara. Ky skenar mund të konsiderohet si një variant neutral, ndjekës i prirjeve historike (deri diku të moderuar) të treguesve.

5.2 Parashikimi i tepricës operative dhe buxhetit kapital

Në vijim të parashikimeve për të ardhurat dhe për shpenzimet, llogarisim tepricën operative për të gjithë periudhën e konsideruar. Për periudhën 2016-2030, vlerësohet se teprica operative e Bashkisë Elbasan do të jetë pozitive dhe në terma sasiorë e konsiderueshme. Kështu, për periudhën 2016-2020, teprica operative do të jetë pozitive duke u vlerësuar në mesatarisht rreth 17.6 % e të ardhurave korente. Më tej, në periudhën 2021-2025 teprica operative vlerësohet të tkurret disi, në mesatarisht 16.5% e të ardhurave korente. Konsolidimi i Bashkisë Elbasan si në terma insitucionalë ashtu dhe funksionalë do të materializohet në një aktivitet financiar të qëndrueshëm dhe tepricë operative pozitive, e vlerësuar në rreth 26.7% të të ardhurave korente të parashikuara për periudhën 2026-2030.


Figura 14. Parashikimi i tepricës operative neto



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016
*2021-2025 dhe 2026-2030 janë vlera mesatare.

Teprica operative së bashku me të ardhurat kapitale japin buxhetin kapital për periudhën e zgjedhur në dispozicion të Bashkisë Elbasan për të ndërmarrë dhe realizuar investimet kapitale të synuara.

Figura 15. Parashikimi i buxhetit kapital, 2016 – 2030



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Elbasan dhe Co-PLAN, 2016
*2021-2025 dhe 2026-2030 janë vlera mesatare.

Në vijim të ndarjes së re administrative-territoriale dhe ligjit të ri për vetë-qeverisjen vendore, bashkia e re e Elbasanit përballet me sfidën e menaxhimit burimeve financiare të kufizuara përkundrejt nevojave gjithmonë në rritje për shërbime dhe investime kapitale. Në këtë kontekst, planifikimi strategjik i investimeve kapitale në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike në territoret në administrim rezulton i domosdoshëm dhe një parakusht për zhvillimin ekonomik vendor. Ndaj, vlerësohet thelbësor fuqizimi dhe përmirësimi i performancës financiare në kahun e të ardhurave (veçanërisht rritja e bazës së taksueshme dhe tatim paguesve) si dhe racionalizimi në kahun e shpenzimeve (kryesisht ato administrative dhe operative).

Bazuar në të dhënat financiare historike, parashikimet e përfshira në dokumentin e PBA-së, supozimeve të ndërmarra për parashikimin e zërave kryesorë të të ardhurave dhe shpnezimeve rezulton një buxhet kapital pozitiv në dispozicion të Bashkisë Elbasan. Në terma nominalë, buxheti kapital në dispozicion për financimin e projekteve të investimeve vlerësohet të ndjekë një prirje rritëse në kohë si pasojë e përmirësimit të menaxhimit fiskal dhe financiar të Bashkisë. Megjithatë, diferencat ekzistuese në nivelin e ofrimit të shërbimeve, zhvillimit ekonomik dhe pabarazitë sociale midis njësive adminsitrative përbërëse kërkojnë një fluks të lartë investimesh për të siguruar deri diku zbutjen e tyre. Ndaj, krahas buxhetit kapital në dispozicion të bashkisë, energji të mëtejshme do të duhet të orientohen në gjetjen e burimeve financiare alternative: huatë bankare nga sistemi bankar vendas (në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi), fondet shtetërorë të ofruara në baza konkurrenciale (FZHR, FSHZH, AZHR etj.), fondet nga burime ndërkombëtare (IPA, BB) apo donatorë të ndryshëm (USAID, KfW etj).

6. Fishat e projekteve kapitale[3]

FISHË PROJEKTI 1 (O3P4 PR7)	
Titulli i Projektit	PR7: Zgjerim i rrugëve rurale Elbasan-Gjinar-Zavalinë, Elbasan-Funarë (Kusarth-Balëz-Letan-Bicellë-Funarë) dhe me korsi biçikletash dhe ristrukturimi dhe ndërtimi i segmenteve rrugore që mungojnë në aksin lidhës Tregan-Blerimas-Strestan-Gjinar; ristrukturimi i rrugës Qafë Hajdaran-Byshek; Ndërtimi i rrugës nga shkëmbi i Çaprazit-Pajun; ristrukturimi i rrugëve të brendshmë në: Katund i ri, lagja Harvales, Kusarth-Karabullak
Përshkrimi i Projektit	Një pjesë e infrastrukturës rrugore në Bashkinë Elbasan ka nevojë për rehabilitimin (zgjerim, përmirësim) e disa akseve, të cilat do të përmirësojnë qarkullimin. Projekti konsiston në ndërtim dhe rehabilitimi. Ndërhyrjet konsistojnë përmirësim të asfaltit, zgjerim rruge, pajisje me sinjalistikën e duhur rrugore, apo ndërhyrje të tjera të nevojshme. Në segmente të caktuara është e nevojshme të ndërtohen infrastruktura nëntokësore dhe mbitokësore. Segmentet rrugore që do të rehabilitohen janë: • Rruga që lidh Elbasanin me Shushicën; • Rruga që lidh Elbasanin me Treganin; • Rruga që lidh Elbasanin me Zvalinën; • Rruga që lidh Elbasanin me Labinot Malin; • Rruga nga Stacioni i Trenit deri tek Ura e Zaranikës në qytetin Elbasan • Itinerari Elbasan-Godolesh-Firas-Orpen-Qafë-Labinot Mal-Sericë-Xibrakë • Itinerari Bradashesh-Karabullak-Letan-Bixellë-Funarë-Mollagjesh-Krrabë • Rruga Funarë-Cerunjë-Orpen; Gjatësia totale e këtyre rrugëve, që kanë nevojë për t'u rehabilituar është 128 km.
Partnerët & Financues	Bashkia Elbasan, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Komuniteti lokal, Sektori privat, FZHR.
Arsyetimi i Projektit	• Rritje e aksesit ndërmjet qytetit të Elbasanit dhe Njësive Administrative; • Rritje e shpejtësisë mesatare të udhëtimit nga njëra zonë tjetrën; • Rritje e sigurisë në rrugë të udhëtarëve.
Objektivi	Objektivi O3: *"Zhvillimi i infrastrukturës së aksesit/lëvizjes"*; Programi P4: *"Përmirësimi i aksesit të qendrave të njësive dhe lidhjes me njëra tjetrën dhe me qytetin e Elbasanit".*
Veprimet Strategjike	• Analiza paraprake e akseve rrugore që kanë nevojë të rehabilitohen; • Hartimi i projekt zbatimit; • Organizimi i dëgjesave publike me grupet e interesit.
Rezultatet e pritshme	• Rritja e aksesit dhe e ndërveprimit ndërmjet Njësive Administrative të Bashkisë Elbasan; • Përmirësimi i kushteve të transportit për udhëtarët dhe mjetet e transportit.
Rreziqet	• Zbatimi i projektit kërkon fonde të konsiderueshme për ndërmarrjen e tyre
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlera	617,082,834.00 Lekë
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër – Afatmesëm

FISHË PROJEKTI 2 (O3P8_PR16)	
Titulli i Projektit	PR16_ Lidhja e njësive administrative (Funarë, Labinot Mal, Gjinar, Tregan, Papër) që kanë potencial turistik me Elbasanin me infrastrukturë të gjelbër
Përshkrimi i Projektit	Njësitë administrativë Tregan dhe Gjinar kanë potenciali turistik. Për të nxitur zhvillimin e turizmit duhet përmirësuar aksesueshmëria me këto zona, që aktualisht nuk ofrohet. Për të krijuar një akses në këto NjA është i nevojshëm ndërtimi në disa segmente dhe rehabilitim i pjesëve ekzistuese. Aksesueshmëria mund të realizohet nëpërmjet dy itinerareve Tregan-Gjinar. Projekti përfshin: • Rehabilitimin dhe ndërtimin e pjesshëm të rrugës Tregan-Trepsenisht-Shelçan; • Rehabilitimin e rrugës Çekrez-Blerimas-Stërstan-Gjinar, që kalon në pjesën jugore të luginës së Përroit të Gostimës. Këto rrugë do të jenë rrugë panoramike të cilat do të jenë funksion të zhvillimit të turizmit të zonës dhe nevojave të zonave që përfshin, gjatësia totale e të cilave është përafërsisht 24.35 km. Gjithashtu projekti përfshin dhe ndërtimin e infrastrukturës ndihmëse siç është sinjalistika dhe infrastruktura mbi dhe nëntokësore të tyre.
Partnerë & Financues	Bashkia Elbasan, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Komuniteti lokal, Sektori privat, FZHR, FSHZH.
Arsyetimi i Projektit	• Rritje e aksesit ndërmjet njësive administrative Tregan dhe Gjinar; • Rritje e numrit të turisteve si pasojë e aksesit më të mirë; • Përmirësim i transportit publik dhe mobilitetit në tërësi.
Objektivi	Objektivi O3: *"Zhvillimi i infrastrukturës së aksesit/lëvizjes"*; Programi P8: *"Nxitja e investimeve publike dhe private në fushën e mobilitetit të gjelbër dhe shërbimeve të tjera publike"*
Veprimet Strategjike	• Hartimi i detajuar i projektit teknik të rrugës Tregan-Gjinar; • Sigurimi i fondeve për ndërtimin e aksit; • Kryerja e punimeve.
Rezultatet e pritshme	• Rritja e aksesit dhe e ndërveprimit ndërmjet Njësive Administrative Tregan dhe Gjinar; • Përmirësimi i kushte të transportit për udhëtarët dhe mjetet e transportit.
Rreziqet	• Zbatimi i projektit kërkon fonde të konsiderueshme.
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlera	----
Vlerësimi i prioriteteve	Afatgjatë

FISHË PROJEKTI 3 (O3P7_PR14)	
Titulli i Projektit	PR14: Ndërtimi i rrethrrotullimeve tek: ura e parë e Zaranikës; kryqëzimi i stacionit të trenit, kryqëzimi tek metalurgjiku, kryqëzimi pranë urës së Cërrikut, kryqëzimi i rrugës Kadri Hoxha me rrugën Çerçiz Topulli.
Përshkrimi i Projektit	Situata e lëvizjes në qytetin e Elbasanit aktualisht ka bllokime të shpeshta trafiku, në disa kryqëzime kryesore. Projekti përfshin përmirësimin e kryqëzimeve, të cilat ndodhen jashtë pjesës qendrore të qytetit të Elbasanit dhe kanë probleme sigurie për banorët. Ndërhyrjet që do të realizohne do të përcaktohen sipas situatave për secilën ndërhyrje. Kryqëzimet që do të kenë ndërhyrje janë: • Kryqëzimin e Cërrikut; • Kyqëzimin e Urës së Zaranikës; • Kryqëzimin e Stacionit të Trenit; • Kryqëzimin e Metalurgjikut; • Kryqëzimi i rrugës së Shushicës (kryqëzimi ndërmjet rrugës Elbasan-Shushicë dhe hekurudhës).
Partnerë & Financues	Bashkia Elbasan, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Komuniteti lokal, Sektori privat, FZHR, FSHZH.
Arsyetimi i Projektit	• Rrija e sigurisë në rrugë duke përmirësuar kushtet e transportit rrugor; • Lehtësimi i problemeve që krijohen për qarkullimin e automjeteve; • Rritje e kapaciteteve të mbajtjes së trafikut në kryqëzime.
Objektivi	Objektivi O3: *"Zhvillimi i infrastrukturës së aksesit/lëvizjes"*; Programi P7: *"Rregullimi i trafikut të qytetit"*.
Veprimet Strategjike	• Hartimi i projekteve të detajuara në bazë të funksioneve të rrugëve që lidhin këto kryqëzime; • Aplikimi për fonde; • Blerja e tokës dhe shpronësimet si pasojë e zgjerimit të kryqëzimeve ose ndërtimit me disnivele të tyre; • Instalimi i sinjalistikës së duhur në kryqëzime; • Kryerja e punimeve.
Rezultatet e pritshme	• Lehtësim i dukshëm i trafikut në qytet dhe jashtë tij;
Rreziqet	• Bashkia e ka të vështirë të kryejë investime të tilla si pasojë e buxhetit të kufizuar që ka; • Mungesa e një studimi mbi problematikat e trafikut në rajonin e Elbasanit .
Faza e projektit	Në proces
Vlera	2,022,759.00 Lekë
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër

FISHË PROJEKTI 4 (O2P3_PR7/8/9/10/11)	
Titulli i Projektit	PR7: Ndërtimi supervizim dhe kolaudim i KUZ në 4 rrugët "A. Mezini, P. Dodbiba, Q. Fezo, Sh. Thanasi; PR8: Risistemimi i sistemit të kanalizimeve, dhe depozitimi i ujërave të ndotura në impiantin e trajtimit të ujërave; PR9: Supervizim dhe kolaudim punimesh për ndërtimin e ujësjellësit Muriqan; PR10: Vazhdimi i ndërtimit të KUZ në lagjen Teqe, praanë shkollës "Sulë Domi", rruga "Arif Dardhaj", tek lagja e komunitetit Rom, Rrapishtë; PR11: Ndërtimi i ujësjellësit Përroi Mollës- Shelcan- Mlizë- Trebsenisht- Tudan- Lleshan- Kukan- Pobrat, Fushë Buall
Përshkrimi i Projektit	Rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimeve është i amortizuar dhe në pjesë të caktuara ka nevojë për rehabilitim të tyre. Humbjet në rrjetin shpërndarës të ujësjellësit arrijnë deri në 35% për zonën e qytetit, ndërsa në zonat e tjera problem thellohet akoma më shumë. Situata me problematike paraqitet në njësitë administrative Gjinar, Shushicë, Tregan, Shirgjan, Gjergjan, Funarë, Gracen dhe Labinot Mal. Qëllimi i këtij projekti është rehabilitimin i sistemit ekzistues të ujësjellësit dhe kanalizimeve për arsye të amortizimit. Gjithashtu në zonat ku nuk ofrohet shërbimi i furnizimit me ujë duhet të shtohet sistemi i tubacioneve të ujësjellësit në zonat ku terreni e lejon. Sistemi i kanalizimeve ka nevojë për rehabilitim të tubacioneve ekzistuese dhe shtim në zonët ku mundojnë dhe terreni e lejon të vendosen.
Partnerë & Financues	Bashkia Elbasan, Ministria e Mjedisit, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Komuniteti lokal, FZHR, FSHZH
Arsyetimi i Projektit	• Përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm (në zonat ku nuk ofrohet ky shërbim si dhe rritjen e volumit të ujit në disa njësi administrativë ku ka problematika me sasinë e pamjaftueshme të ujit që i shërbehet komunitetit); • Përmirësimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza dhe të bardha.
Objektivi	Objektivi O2: *"Mbrojtja e rigjenerimi i burimeve natyrore"*; Programi P3: *"Përmirësimi i infrastrukturës (nëntokësore) të ujësjellësit dhe KUZ."*
Veprimet Strategjike	• Evidentimi i pjesëve të amortizuara dhe i problematikave (si në rrjetin e ujësjellësit dhe në atë të kanalizimeve); • Hartimi i projektit teknik për zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve të ujërave të zeza në zonat rurale dhe në zonat periferike të qytetit; • Aplikimi për fonde; • Kryerja e punimeve;
Rezultatet e pritshme	• Furnizimi me ujë të pijshëm dhe me sasi të bollshme në të gjithë Bashkinë e Elbasanit; • Rrjet i përmirësuar dhe pjesërisht i rinovuar i kanalizimeve.
Rreziqet	• Pamundësia për të financuar ndërhyrjen në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimeve të ujërave të zeza dhe të bardha;
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlera	PR7 3,163,181.00 Lekë PR8 ---------- PR9 100,000.00 Lekë PR10 22,182,622.00 Lekë PR11 180,000,000.00 Lekë
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër

FISHË PROJEKTI 5 (O2P3_PR11)	
Titulli i Projektit	PR11: Ndërtimi i ujësjellësit Përroi Mollës- Shelcan- Mlizë- Trebsenisht- Tudan- Lleshan- Kukan- Pobrat, **Fushë Buall**
Sfondi i Projektit	**Fushë Buall:** Aktualisht Bashkia Elbasan ka probleme me ofrimin e ujit të pijshëm si pasojë e mosfunksionimit të plotë të sistemit shpërndarës, por edhe si pasojë e mungesës së burimeve ujore. Ujësjellësi i qytetit megjithëse është i mjaftueshëm për sasine e ujit që shpërndan ka një kosto shume të lartë operacionale sepse është ujsjellës me ngritje mekanike. Në këtë mënyrë ky shërbim ofrohet me kosto të lartë gjë që rendon në xhepat e qytetarëve. Në këtë situatë lind nevoja për të gjetur një mundësi për ofrimin e këtij shërbimi me një kosto më të ulët që është ndërtimi i ujësjellësit të ri në Fush Buall me rrjedhje të lirë të ujit.
Përshkrimi i Projektit	Ky projekt përfshin ndërtimin e rezervuarit qendror të mbledhjes së ujit nga burimet. Ndërtimin e tubacionit nga rezervuari deri në pikën e lidhjes me sistemin shpërndarës të qytetit. Ndërtimin e një tuneli për kalimin e tubacionit.
Partnerë & Financues	Bashkia Elbasan, Ministria e Mjedisit, Ministria e Transportit, Komuniteti lokal, FZHR, FSHZH, Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime; Donatorë të ndryshëm
Justifikimi i Projektit	• Përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm për qytetin e Elbasanit dhe zonat përrreth tij; • Reduktimin e kostove të furnizimit me ujë të pijshëm në zonën ku operon.
Objektivi	Objektivi O2: *"Mbrojtja e rigjenerimi i burimeve natyrore"*; Programi P3: *Përmirësimi i infrastrukturës (nëntokësore) të ujësjellësit dhe KUZ"*
Veprimet Strategjike	• Studimi i parafizibilitetit dhe lobimi për fonde; • Hartimi i projektit të detajuar teknik; • Sigurimi i fondeve për projektin; • Organizmi i eventeve informuese mbi projektin; • Kryerja e punimeve.
Rezultate të pritura	• Furnizmi me ujë të pijshëm 24 ore në dite për të gjithe zonën e qytetit të Elbasanit dhe zonat periferike të tij; • Ofrim i shërbimit me kosto të ulët.
Rrisqet	• Duhen fonde të konsiderueshme për ndërtimin e këtij ujësjellësi bazuar kjo në veprat inxhinierike që ka projekti. • Probleme të mundshme pronësie dhe nevojë për servitut publik.
Faza e projektit	Koncept- Projekt
Vlera	180,000,000.00 Lekë
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër

FISHË PROJEKTI 6 (O3P1_PR4)	
Titulli i Projektit	PR4: Rikosntruksion i urës Polis-Vale, ndërtim i këmbëve të urës Beli, Sollak, rikonstrukson i urës së Broshkës, urës së Byshekut, Urës së Zezë.
Përshkrimi i Projektit	Aktualisht në Bashkinë Elbasan në kuadër të rehabilitimit të infrastrukturës rrugore është e rëndësishme ndërhyhet në përmirësimin e infrastrukturës së disa urave dhe ndërtimin e Urës së Byshekut. Ky projekt do të koordinohet me projektet e tjera që janë për përmirësimin e infrastrukturës rrugore. Gjithashtu projekti përfshin dhe vendosjen e sinjalistikës dhe mirëmbajtjen e këtyre veprave infrastrukturore.
Partnerë & Financues	Bashkia Elbasan, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Komuniteti lokal, Sektori privat, FZHR, FSHZH.
Arsyetimi i Projektit	• Gjendje e jo e mirë fizike e urave (amortizim i tyre); • Nevojë për ndërtimin e urave të reja; • Përmirësim i kushteve të transportit në Elbasan.
Objektivi	Objektivi O3: *"Zhvillimi i infrastrukturës së aksesit/lëvizjes"*; Programi P1: *"Rehabilitimi dhe përmirësimi i rrugëve ekzistuese"*
Veprimet Strategjike	• Hartimi i projekteve të detajuara të urave në funksion të parametrave të rrugëve që lidhin; • Sigurimi i fondeve nga partnerët e projektit; • Koordinimi për ndërmarrjen e projektit me institucionet e specializuara (Ministria e Transportit)
Rezultatet e pritshme	• Përmirësimi i kushteve të transportit në akset ku përfshihen këto ura;
Rreziqet	• Mungese fondesh për realizimin e veprave infrastrukturore.
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlera	25,544,283.00 Lekë [përfshin rikonstruksionin e urës Polis-Vale; ndërtim këmbët e urës Beli; rikonstruksion ora e Broshkës]
Prioriteti	Afatshkurtër

FISHË PROJEKTI 7 (O3P6_PR11/12)	
Titulli i Projektit	PR11: Rikonstruksioni i stacionit të vjetër të trenit dhe Rapid Bus Transit (RBT) PR12: Ndërtimi i stacionit për pasagjerë në Labinot-Fushë, përgjatë rrugës Elbasan-Librazhd. [Investime nga Qeveria Qendrore].
Përshkrimi i Projektit	Elbasani nuk ka një terminal të mirëfilltë të transportit (ka vend-parkime të tyre në disa sheshe të vogla të cilat janë të pamjaftueshme dhe nuk e kryejnë mirë funksionin) kjo sjell ngarkesë trafiku. Gjithashtu nuk ka një pikë kryesore, që ndihmon transportin e udhëtarëve. Projekti përfshin zgjerimin e terminalit në stacionin e vjetër të trenit. Kjo do të jetë një qendërsi zhvillimi në qytet e orientuar drejt transportit të udhëtarëve me linja rreth qytetëse dhe ndërqytetëse e gjithashtu me linjat e transportit publik. Gjithashtu do të ketë edhe disa funksione të reja si: bare, dyqane, restorante, vende për taksi sidhe zyra për administratën për ta. Ndërsa në një fazë të mëvonshme mund të konsiderohet ndërtimi i një stacioni intermodal që do të shërbeje për mallrat dhe për njërëzit në zonën ndërmjet ish kombinatit Metalurgjik dhe qytetit të Elbasanit.
Partnerë & Financues	Bashkia Elbasan, Ministria e Transportit, Komuniteti lokal, sektori privat, FZHR, FSHZH, donatorë të ndryshëm
Arsyetimi i Projektit	• Ky projekt krijon një shërbim me efikas të transportit në përgjithësi; • Lehtëson trafikun duke mbledhur në një pikë linjat e transportit ndërqytetës, rrethqytetës; • Rrit ndërveprimin ndërmjet Elbasanit dhe qyteteve të tjera dhe njësive të tjera administrative të Bashkisë Elbasan.
Objektivi	Objektivi O3: *"Zhvillimi i infrastrukturës së aksesit/lëvizjes"*; Programi P6: *"Përmirësimi i transportit publik ndërqytetës, infrastruktura, stacione"*
Veprimet Strategjike	• Hartimi i studimit të fizibilitetit; • Sigurimi fondeve për të investuar; • Promovimi i projektit në sektorin privat të transportit dhe atij të ndërmarrjeve dhe bizneseve; • Krijimi i PPP-ve të mundshme; • Nxitja e bizneseve për të investuar në këto zonë; • Kryerja e punimeve.
Rezultatet e pritshme	• Rritje e ndërveprimit të Elbasanit në raport me qendrat e tjera të banuara; • Përmirësimi i situatës së transportit ndërqytetës, rrethqytetës në Bashkinë Elbasan.
Rreziqet	• Projekti ka nevojë për mbështetje nga shumë aktorë që të realizohet në mënyrë të suksesshme; • Një pjesë e banesave të ndërtuara përreth zonës së stacionit të vjetër do të duhet të shpronësohen pë zgjerimin e tij;
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlera	-----
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër (PR11) Afatmesëm – Afatgjatë (PR12)

FISHË PROJEKTI 8 (O3P6_PR11)	
Titulli i Projektit	PR11: Rikonstruksioni i stacionit të vjetër të trenit dhe Rapid Bus Transit (RBT)
Përshkrimi i Projektit	Lidhja ndërmjet qyteti të Elbasanit dhe Njësisë Administrative Labinot Fushë është e rëndësishme për shkak të ndërveprimit ekonomik. Rëndësia e këtij segmenti është gjithashtu për faktin se ndodhet në pjesën e aksit nacional Elbasan-Pogradec. Projekti përfshin: • Rikonstruksionin e stacionit ekzistues të trenit dhe përshtatjen për stacion të RBT (*Rapid Bus Trasit*) • Ndërtimin e një stacioni për RBT në Labinot Fushë. • Rehabilitimin dhe përshtatjen e linjës hekurudhore ekzistuese në linjë për lëvizjen e RBT në segmentin Stacion i Trenit-Labinot Fushë
Partnerë & Financues	Bashkia Elbasan, Ministria e Transportit, Komuniteti lokal, Sektori privat, FZHR, FSHZH, donatorë të ndryshëm PPP
Arsyetimi i Projektit	• Ky projekt përmirëson ndjeshëm transportin dhe ndërveprimin e zonave (linja e RBT Stacioni i Trenit-Labinot Fushë) • Nxit zhvillimin e bizneseve në segmentin Stacion i Trenit-Labinot Fushë
Objektivi	Objektivi O3: *"Zhvillimi i infrastrukturës së aksesit/lëvizjes"*; Programi P6: *"Përmirësimi i transportit publik ndërqytetës, infrastruktura, stacione"*
Veprimet Strategjike	• Studimi i parafizibilitetit dhe lobimi për fonde. • Hartimi projekt zbatimit dhe sigurimi i fondeve. • Promovimi i projektit në sektorin privat të transportit dhe atij të ndërmarrjeve dhe bizneseve. • Krijimi i skemave të mundshme për PPP dhe financimi përmes instrumenteve financiare për zhvillimin e tokës (rasti i zhvillimit të përbashkët-*joint development*) • Marketimi dhe informimi. • Kryerja e punimeve.
Rezultatet e pritshme	• Rritja, integrimi dhe përmirësimi i mobilitetit në qytet dhe në raport me NJA Labinot-Fushë • Zhvillimi i njësive ekonomike të vogla dhe të mëdha përgjatë zonës Stacion i Trenit-Labinot Fushë
Rreziqet	• Koordinimi i projektit me aktorët e interesuar privatë. • Mungesa e nismave të tilla të mëparshme dhe e përvojës në nivel vendor. • Vështirësia për të organizuar PPP të suksesshme.
Faza e projektit	Koncept
Vlera	------
Vlerësimi i prioriteteve	Afatgjatë

FISHË PROJEKTI 9 (O3P6_PR10)	
Titulli i Projektit	PR10: Ndërtimi i stacionit për mallra në zonën ndërmjet lumit të Zaranikës dhe zonës së ish metalurgjikut
Përshkrimi i Projektit	Elbasani është një pikë strategjike e sistemit hekurudhorë kombëtarë dhe rajonal sepse është pjesë e linjës hekurudhore Durrës-Pogradec. Me kalimin e viteve si në të gjithë sistemin hekurudhor dhe në Elbasan nuk ka pasur investime si dhe ka pasur amortizime të shumta në rrjet dhe në stacionin e trenit të Elbasanit. Kjo ka bërë që Elbasani të humbë rëndësinë e tij strategjike në lidhje me këtë rrjet. Projekti përfshin: • Transferimin e stacionit të trenit për mallrat në zonën mes metalurgjikut dhe qytetit të Elbasanit (në anën perëndimore të qytetit). • Ndërtimin e një linje hekurudhore të dedikuar për mallrat në pjesën jugore të Lumit Shkumbin nga stacioni i trenit të mallrave deri në Labinot -Fushë Ky projekt gjithashtu përfshin ndërtimin e ambienteve ndihmëse për stacionin e mallrave siç mund të jenë magazinat e ndryshme për produktet, vendparkime, ambiente çlodhëse sidhe zyra për administratën.
Partnerë & Financues	Bashkia Elbasan, Ministria e Transportit, Hekurudha Shqiptare, Komuniteti vendor, Sektori privat, FZHR, FSHZH, donatorë të tjerë.
Arsyetimi i Projektit	• Ky projekt në përgjithësi forcon pozicionin e Elbasanit si pikë strategjike e rrjetit hekurudhor kombëtarë dhe rajonal; • Ky projekt zhvillon dhe nxit rritjen e transportit të mallrave duke ulur në mënyrë të ndjeshme trafikun (transferimi i stacionit të mallrave më në perëndim dhe ndërtimi i linjës së dedikuar për mallrat, lehtësojnë trafikun në zonën e stacionit ekzistues të trenit); • Projekti promovon iniciativat për transportin e mallrave pa shkaktuar ndotje në ambient0
Objektivi	Objektivi O3: *"Zhvillimi i infrastrukturës së aksesit/lëvizjes"*; Programi P6: *"Përmirësimi i transportit publik ndërqytetës, infrastruktura, stacione"*
Veprimet Strategjike	• Hartimi i projektit teknik si për ndërtimin e Stacionit të Trenit ashtu dhe për ndërtimin e linjës hekurudhore; • Aplikimi për fonde dhe angazhimi për të krijuar PPP për financim; • Organizmi i dëgjesave publike me aktorët e interesuar sidhe me publikun; • Shpronësimi i pronave private dhe kompensimi i tyre; • Kryerja e punimeve.
Rezultatet e pritshme	• Integrim me i mirë i Elbasanit si një pikë kyçe e rrjetit hekurudhor kombëtarë. • Zhvillimi i bizneseve dhe hapja e vendeve të reja të punës në zone.
Rreziqet	• Projekti ka investime të shumta të cilat duhet të sigurohen nga partnerë të fuqishëm financiarisht; • Mungesë zhvillimesh në përgjithësi në sektorin e transportit hekurudhor; • Mungesë përvoje në PPP për financim të transportit përmes zhvillimit të tokës.
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlera	-------
Vlerësimi i prioriteteve	Afatgjatë

FISHË PROJEKTI 10 (O2P5 PR14/15)	
Titulli i Projektit	PR14: Ndërtimi i pikës së transferimit të mbetje në Labinot Fushë; në Tregan; në Gjinar; PR15: Projekti i pilotimit të ndarjes së diferencuar të mbetjeve urbane
Përshkrimi i Projektit	Me ndryshimin e kufijve administrativë të Elbasanit lindin dhe sfida të reja mbi menaxhimin e shumë shërbimeve që ofron pushteti vendor. Një ndër këto sfida është edhe ofrimi i shërbimit të mbetjeve urbane në një territor më të gjerë. Në këtë situatë nevojitet një program i posaçëm për menaxhimin e integruar të mbetjeve, që synon përmirësimin e ofrimit të shërbimit të mbetjeve urbane të ngurta urbane në Bashkinë e Elbasanit. Programi për menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë e Elbasanit përfshin: (i) hartimin e një plani lokal për menaxhimi e mbetjeve të ngurta urbane në Bashkinë Elbasan dhe (ii) ndërtimin potencialisht i të paktën 3 stacioneve transferimi për mbetjet urbane në njësitë administrative rurale (ish-komunat). Sipas analizës së infrastrukturës, distancat më të largëta, janë me njësitë administrative Zavalinë, Gracen, Funarë, Labinot Mal, Gjinar. Zonat më të përshtatshme për ndërtimin e ST-ve (stacione transferimi) janë në: 1) njësia administrative Gracen në kufi me njësitë administrative Papër dhe pjesërisht Bradashesh, 2) në Labinot Mal, në kufi me Funarën dhe Labinot Fushën dhe 3) në Gjinar, e cila do të shërbejë për mbetjet e njësive administrative Zavalinë, Gjinar dhe pjesërisht Tregan.
Partnerë & Financues	Bashkia Elbasan, Ministria e Mjedisit, komuniteti, OJF mjedisore, Bizneset e zonës, Donatorë të ndryshëm (WBIK, Banka Botërore).
Arsyetimi i Projektit	• Projekti do ndikojë në përmirësimin e ofrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në territorin e ri të Bashkisë; • Projekti do të ndikojë në përmirësimin e skemës së grumbullimit të mbetjeve duke ulur kostot (ndërtimi i 3 ST për mbetjet); • Projekti do të ndikojë rritjen e nivelit të pastërtisë në mjedis; • Projekti do ndikojë në uljen e rreziqeve që i kanosen shëndetit të njeriut nga rrjedhja e lëndëve toksike të mbetjeve në ujin e lumit Shkumbin i cili përdoret edhe për ujitje në bujqësi; • Projekti do ndikojë në shmangien e ndotjes së mjedisit nga mbetjet, dhe mbi të gjitha, në mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja, të cilat shërbejnë si burim për furnizimin e popullsisë me ujë; • Projekti do të ndikojë në rritjen e sensibilizimit të komunitetit për trajtim në burim të mbetjeve urbane.
Objektivi	Objektivi O2: *"Mbrojtja e rigjenerimi i burimeve natyrore"*; Programi P5: *"Përmirësimi i shërbimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane"*
Veprimet Strategjike	• Analizimi dhe evidentimi i problematikave të menaxhimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Elbasan; • Propozimi i skemave të përshtatshme për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane në Bashkinë Elbasan; • Planifikimi për ndërtimit të impianteve të ndërmjetme për trajtimin e mbetjeve, siç janë stacionet e transferimit;
Rezultatet e pritshme	• Bashkia Elbasan ofron një shërbim të përmirësuar të menaxhimit të mbetjeve në territorin e saj; • Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve dhe skemat e ofrimit të shërbimit janë të pasqyruara në një plan, i cili është i miratuar në nivel bashkiak dhe është udhërrëfyesi i ofrimit të shërbimit; • Vend depozitimet ilegale në të gjitha njësitë administrative do të mbyllen • Në bashki do të fillojë trajtimi i ndërmjetëm i mbetjeve me anë të stacioneve të transferimit.
Rreziqet	• Aksesi i dobët në disa zona të thella e bën të vështirë ofrimin e shërbimit të mbetjeve në këto zona.
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlera	28,733,000.00 Lekë
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër - Afatmesëm

FISHË PROJEKTI 11 (O3P8_PR15)	
Titulli i Projektit	PR15: Ndërtimi i rrjetit të gjelbër në qytetin e Elbasanit (rrugët e përcaktuara në hartën e infrastrukturës së propozuar) dhe nxitja e përdorimit të energjive të rinovueshme
Përshkrimi i Projektit	Përdorimi i energjisë së rinovueshme, energjia gjeotermale Kozani 8: Territori i Elbasanit shtrihet në zonën gjeotermale Kruja, zonë e cila ka potencial për prodhimin e energjisë gjeotermale. Në zonën e Elbasanit kjo energji mund të shfrytëzohet nëpërmjet burimeve gjeotermale. Fuqia që mund të instalohet në pusin Kozani 8 është 2070 kW, energji e mjaftueshme për prodhimin e energjisë elektrike. Qëllimi i këtij projekti është përdorimi i energjisë gjeotermale për prodhimin e energjisë elektrike dhe ngrohjen e banesave. Ngrohja e banesave mund të realizohet nëpërmjet lidhjes së banesave me burimin gjeotermal me tubacione, ndërsa përftimi i energjisë elektrike nëpërmjet centtraleve elektrike gjeotermale. Ekzistojnë 3 lloje centralesh elektrikë gjeotermal: *Dry Steam Power Plant* (avulli i nxehtë ngjitet direkt nga rezervuarët gjeotermalë në gjeneratorët e termocentralit, avulli rrotullon turbinat, të cilat gjenerojnë automatikisht energjinë elektrike); *Flash steam plants* (uji me temperaturë 148 – 3371^{0}C, nxirret nëpërmjet një rezervuari. Një pjesë e ujit shëndërrohet në avull, i cili vë në punë turbinat, në momentit e ftohjes avulli kthehet sërish në ujë duke u rikthyer në tokë); *Binary cycle plants* (uji gjeotermal i moderuar kalon nëpër një shkëmbyes ngrohje, nxehtësia e të cilit i përçohet likuidit (të tilla si izobutani) që ka temperaturë vlimi më të ulët se uji, kur uji vlon kthehet në avull duke vënë në ujë turbinën, nëpërmjet të cilës prodhohet energji elektrike).
Partnerë & Financues	Bashkia Elbasan, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, AKBN, Sektori Privat
Justifikimi i Projektit	• Përdorimi i energjive alternative për të shmangur dëmtimin e mëtejshëm të pyjeve • Ndikon në rritjen e efiçiencës energjitike dhe përmirësimi i shërbimit të ofrimit të energjisë elektrike
Objektivi	Objektivi O3: *"Zhvillimi i infrastrukturës së aksesit/lëvizjes"*; Programi P8: *"Nxitja e investimeve publike dhe private në fushën e mobilitetit të gjelbër dhe shërbimeve të tjera publike"*.
Veprimet Strategjike	• Promovimi i përdorimit të energjive të rinovueshme • Prezantimi i potencialeve energjitike tek palët e interesuara • Gjetja e fondeve për të financimin e projektit • Instalimi i pajisjeve të nevojshme në zonën e zbatimit të projektit • Realizimi i projektit
Rezultate të pritura	• Rritja e efiçiencës energjitike • Zhvillimi i qëndrueshëm (shmangia e prerjes së drurëve që përdoren për ngrohje) • Krijimi i një modeli për përdorimin e energjisë gjotermale në Shqipëri
Rrisqet	• Burimet gjeotermale në vendin tonë nuk janë përdorur më parë për prodhimin e energjisë • Tërheqja e investitorëve për realizimin e projektit
Faza e projektit	Koncept – Projekt
Vlera	------
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër

FISHË PROJEKTI 12 (O3P8_PR15)	
Titulli i Projektit	PR15: Ndërtimi i rrjetit të gjelbër në qytetin e Elbasanit (rrugët e përcaktuara në hartën e infrastrukturës së propozuar) dhe nxitja e përdorimit të energjive të rinovueshme
Përshkrimi i Projektit	Studim fizibiliteti për instalimin e paneleve fotovoltaike për prodhimin e energjisë elektrike, në Bashkinë Elbasan: Shqipëria është një vend me rrezatim mesatar diellor 4kWh/m². Bashkia Elbasan shtrihet ndërmjet izolinjave 1450-1550 kW/m², që tregon për kushtet e favorshme të territorit për përdorimin e energjisë diellore. Një nga mënyrat e prodhimit të energjisë diellore është nëpërmjet instalimit të paneleve fotovoltaike. Studimi i fizibilitetit mund të përcaktojë nëse instalimin e paneleve ndihmon në përmbushjen e kërkesës për energji elektrike në Bashkinë Elbasan dhe përcakton një zonë të përshtatshme për instalimin e paneleve diellore. Qëllimi i këtij projekti është të përcaktojë si mund të përdoret energjia diellore për të rritur efiçencën e prodhimit të energjisë elektrike dhe për të përmirësuar ofrimin e këtij shërbimi.
Partnerë & Financues	Bashkia Elbasan, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, AKBN, Sektori Privat, FZHR
Arsyetimi i Projektit	• Niveli i lartë i konsumit të burimeve për prodhimin e energjisë si: uji, hidrokarburet dhe drutë e zjarrit që përdoren për ngrohje; • Furnizimi me energji elektrike, pa ndërprerje; • Hapësirë e mjaftueshme toke për të instaluar panele fotovoltaike.
Objektivi	Objektivi O3: *"Zhvillimi i infrastrukturës së aksesit/lëvizjes"*; Programi P8: *"Nxitja e investimeve publike dhe private në fushën e mobilitetit të gjelbër dhe shërbimeve të tjera publike".*
Veprimet Strategjike	• Studimi i fizibilitetit për përdorimin e energjisë diellore në Bashkinë Elbasan; • Përthithja e investitorëve për financimin e projektit; • Ndërmarrja e e hapave për të nevojshëm për hartimin e një projekti për përdorimin e energjisë diellore.
Rezultatet e pritshme	• Rritja e efiçencës së energjisë; • Zhvillim i qëndrueshëm (shmangia e përdorimit të drurëve për ngrohje).
Rreziqet	• Zënia e hapësirave të konsiderueshme për instalimin e paneleve fotovoltaike; • Mungesa e fondeve për të investuar për hartimin e një projekti për prodhimin e energjive diellore.
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlera	------
Vlerësimi i prioriteteve	Afatmesëm

FISHË PROJEKTI 13 (O1P4_PR7)	
Titulli i Projektit	PR7: Krijimi i pikave të grumbullimit për produktet bujqësore dhe blegtorale
Përshkrimi i Projektit	Elbasani zotëron një territor të përshtatshëm për prodhimet bujqësore dhe blektorale. Sipërfaqja e konsiderueshme e tokës natyrore e favorizon në kultivimin e drufrutorëve. Gjithashtu Elbasani ka potencial për prodhimi e drithërave dhe perimeve. Ndërtimi i tregjeve dhe pikave për grumbullimin dhe magazinimin e produkteve bujqësore dhe blektorale do të ndikojë pozitivisht në ekonominë e Bashkisë Elbasan dhe do krijoj mundësisnë e tregëtimit dhe përpunimit të produkteve për fermerët e zonë. Mund të ndërtohen 8 tregje dhe pika magazinimi (për përpunimin dhe grumbullimin e produkteve buqësore dhe blektorale) në të gjithë territorin e Elbasanit. Zonat ku mund të ndërtohen janë: qëndërsia 3, qëndërsia 8, qëndërsia 9, qëndërsia 10, qëndërsia 11, qëndërsia 12, qëndërsia 15, qëndërsia 17 (harta e fashave dhe qëndërsive të zhvillimit)
Partnerë & Financues	Bashkia Elbasan, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes, Shoqata e Fermerëve, FZHR, FSHZH dhe donatorë të ndryshëm.
Arsyetimi i Projektit	• Bashkia Elbasan ka kapacitete prodhuese për produktet bujqësore dhe blektorale të larta dhe duhet krijuar mundësia e përpunimit dhe tregëtimit të tyre brenda territorit të bashkisë • Tregëtimi dhe përpunimi i produkteve bujqësore në Bashkinë Elbasan ndikon në rritjen ekonomike të të bashkisë
Objektivi	Objektivi O1: *"Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik"*; Programi P4: *"Mbështetje, marketim, promovim, përmirësim klime dhe aftësim i biznesit lokal në funksion të zhvillimit të ekonomisë lokale."*
Veprimet Strategjike	• Sigurimi i fondeve për hartimin e projekteve për ndërtimin e tregjeve dhe pikave të magazinimit; • Ndërtimi i tregjeve dhe pikave të grumbullimit dhe magazinimit.
Rezultatet e pritshme	• Rritja e nivelit të punësimit, duke hapur vende të reja pune për banorët në sektorin e bujqësisë dhe shërbimeve; • Rritja e të ardhurave të bashkisë, nga tregëtimi i produkteve bujqsore dhe blektorale në tregjet lokalë.
Rreziqet	• Dëmtimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale për shkak të mungesës së infrastrukturës mbështetëse; • Zgjedhja e zonave të përshtatshme për ndërtimin e tregjeve dhe pikave të grumbullimit dhe magazinimit të produkteve bujqësore e blegtorale.
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlera	----------
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër - Afatmesëm

FISHË PROJEKTI 14 (O1P1_PR1/2)	
Titulli i Projektit	PR1: Pastrimi i Metalurgjikut nga ndotjet e trashëguara industriale; PR2: Rehabilitimi i zonës dhe kthimi i saj në zonë të përshtatshme për ndërtimin e objekteve me karakter ekonomik.
Përshkrimi i Projektit	Zona industriale (metalurgjiku) dhe zona e ish-fabrikës së konservimit janë zona të cilat duhet të rehbilitohen dhe më pas t'iu jepen funksione të reja për t'u zhvilluar. Kjo mund të realizohet nëpërmjet investimeve të ndryshme. Ky është një projekt fizibiliteti, i cili përcaktojë si mund të zhvillohen këto zona pasi të rehabilitohen, duke qenë se në këto zona ka pasur zhvillim të mëparshëm industrial. Projekti përfshin: • Rehabilitimin e zonave industriale • Rigjenerim urban të ish-fabrikës së konservimit, dhënies së funksioneve të reja që do të përcaktohen nga studimi i projektit
Partnerë & Financues	Bashkia Elbasan, Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Zhvillimit Ekonomik Turizmit Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Komuniteti lokal, Aktorët e interesuar, Donatorë të ndryshëm (Banka Botërore)
Arsyetimi i Projektit	• Projekti do të ndikojë në uljen e ndotjes nga mbetjet industriale; • Projekti do të ndikojë në rizhvillimin e zonave dhe pasurimin e tyre me funksione të ndryshme; • Krijimi i zonave të reja për banim dhe për zhvillim ekonomik.
Objektivi	Objektivi O1: *"Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik"*; Programi P1: *"Mbështetje me infrastrukturën e nevojshme për përqendrimin e bizneseve të industrisë në zonën e Metalurgjikut."*
Veprimet Strategjike	• Hartimi i studimeve të fizibilitetit të zonave; • Koordinimi i projektit me aktorët e interesuar dhe nxitja e investimeve; • Përcaktimi i prioriteteve për zhvillimin e zonave ish industriale.
Rezultatet e pritshme	• Ulja e nivelit të ndotjes që shkaktohet nga mbetjet industriale të ish-fabrikave; • Rizhvillimi i ish zonave industriale nëpërmjet dhënies së funksioneve të reja; • Përmirësimi i cilësisë së jetesës së banorëve të Bashkisë Elbasan.
Rreziqet	• Mungesë eksperience mbi koordinimin dhe nxitjen e aktorëve për pjesëmarrje në projekte të tilla; • Projekti kërkon fonde të konsiderueshme për zbatim dhe kjo mund të ulë interesin e qeverisë dhe bashkisë për t'u investuar në një iniciativë të tillë.
Faza e projektit	Koncept- Projekt
Vlera	----------
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër - Afatmesëm

FISHË PROJEKTI 15 (O4P3_PR6)	
Titulli i Projektit	PR6: Konsolidimi i fashës ekonomike nga kodra e Krastës në drejtim të Labinot Fushë dhe fashës ekonomike bujqësore Cërrik-Shirgjan
Përshkrimi i Projektit	Segmenti Cërrik-Shirgjan ka tendenca për zhvillimin ekonomik bujqësor. Për të pasur zhvillim të mëtejshëm ekonomik është e nevojshme që kjo fashë të konsolidohet dhe të nxiten bizneset e vogla dhe të mesme, që kanë profil ekonomik-bujqësor, për të investuar në këtë zonë. Konsolidimi i fashës ekonomike do të ndikojë në uljen e nivelit të papunësisë, që aktualisht është relativisht i lartë.
Partnerë & Financues	Bashkia Elbasan, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Donatorë të ndryshëm
Arsyetimi i Projektit	• Nevoja për të krijuar vende pune për banorët e Bashkisë Elbasan • Nxitja e fermerëve për rritjen e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale • Krijimi i mundësisë për tregtimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në territorin e bashkisë
Objektivi	Objektivi O4: *"Zhvillim bujqësor e rural"*; Programi P3: *"Nxitja e zhvillimeve të strukturave në funksion të bujqësisë përmes PPP-ve"*.
Veprimet Strategjike	• Informimi i bizneseve të vogla dhe të mesme me karakter bujqësor për potencialet e zhvillimit ekonomik në këtë zonë; • Nxitja e bizneseve për të investuar në këtë zonë.
Rezultatet e pritshme	• Rritja e nivelit të punësimit në Bashkinë Elbasan; • Rritja e rendimentit të prodhimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale; • Zhvillim ekonomik i bashkisë dhe rritja e nivelit të të ardhurave.
Rreziqet	• Zhvillimi i fragmentuar dhe i pakonsoliduar; • Rendiment i ulët i prodhimeve bujqësore dhe blegtorale.
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlera	----------
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër - Afatmesëm

FISHË PROJEKTI 16 (O2P1_PR1/2)	
Titulli i Projektit	PR1: Pastrimi i shtratit të lumit Shkumbin; PR2: Risistemi i zonave ripariane të lumit Shkumbin;
Përshkrimi i Projektit	Qëllimi i këtij projekti është të rehabilitojë një pjesë të shtratit të lumit nëpërmjet pastrimit të shtratit të tij dhe marrjes së masave për shmangien e hedhjes së mbetjeve të ngurta urbane dhe industriale dhe derdhjen e ujërave të zeza në lumë. Zona e këtij projekti fillon pranë parkut të Krastës deri në zonën e grykëderdhjes së Lumit Zaranika. Kjo zonë shtrihet përgjatë qytetit dhe grumbullon ndotjen që shkaktohet nga hedhja e mbetjeve të ngurta urbane dhe derdhja e ujërave të zeza në lumë. Nëpërmjet këtij projekti synohet kthimi i kësaj zonë argëtimi dhe çlodhëse për banorët. Kjo mund të realizohet nëpërmjet ndërhyrjes me dizajn urban dhe sistemim gjelbërimi.
Partnerë & Financues	Bashkia Elbasan, Ministria e Mjedisit, ARM Elbasan, Sektori privat, Komuniteti Lokal, Donatorë të ndryshëm
Arsyetimi i Projektit	• Shmangia e përmbytjeve nëpërmjet pastrimit të shtratit të lumit • Shmangia e erozionit të brigjeve të lumit dhe si rrjedhojë mbrojtja dhe ruajtja e brigjeve të lumit • Shmangia e ndotjes së mëtejshme të lumit • Rikthimi i lumit banorëve të qytetit nëpërmjet krijimit të hapësirave çlodhëse për banorët
Objektivi	Objektivi O2: *"Mbrojtja e rigjenerimi i burimeve natyrore"*; Programi P1: *"Mbrojtja e sistemit urban nga përmbytjet dhe dalja e vazhdueshme e lumit Shkumbin nga shtrati duke rehabilituar argjinaturat ekzistuese"*.
Veprimet Strategjike	• Analizimi dhe evidentimi i problematikave lidhur me rehabilitimin e lumit dhe përcaktimi i mënyrës më të mirë të rehabilitimit të tij nëpërmjet pjesëmarrjes së banorëve në projekt; • Sigurimi i fondeve për hartimin e projektit; • Zbatimi i projektit.
Rezultatet e pritshme	• Shmangia e përmbytjeve nga lumi gjatë shirave të rrëmbyeshëm; • Shmangia e erozionit në brigjet e lumit; • Ulja e nivelit të ndotjes në lumë; • Rritja e cilësisë së jetesës së qytetarëve nëpërmjet krijimit të zonave rekreative.
Rreziqet	• Mungesa e fondeve për realizimin e projektit; • Mospërfshirja e grupeve të interesuara/aktorëve në projekt.
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlera	---------
Vlerësimi i prioriteteve	PR1 Afatshkurtër PR2 Afatmesëm - Afatgjatë

FISHË PROJEKTI 17 (O2P2_PR5/6)	
Titulli i Projektit	PR5: Rehabilitimi dhe sistemimi i zonave ripariane të lumit Zaranika, Manazdere, Gostimë, Gostrimë, Papër dhe Kushe; PR6: Pastrimi nga mbetjet urbane i lumit Kushe
Përshkrimi i Projektit	Qëllimi i këtij projekti është të rehabilitojë një pjesë të shtratit të lumenjve Zaranika, Papër, Manazdere, Gostrimë dhe Gostimë nëpërmjet pastrimit të shtratit të tyre, vendosjes së argjinaturave dhe marrjes së masave për shmangien e hedhjes së mbetjeve të ngurta urbane dhe industriale, të cilat pengojnë rrjedhën e tyre normale. Zaranika dhe Manazdere përshkojnë qytetin e Elbasanit në zona të populluara dendësisht. Në rast shirash të bollshme, shtëpitë e ndodhura në afërsi të brigjeve të këtyre lumenjve rrezikojnë përmbytjen (siç ndodhi në këto ditë reshjesh në janar 2016). Lumi i Manazderes thuajse gjithmonë sezonin e dimrit del nga shtrati duke përmbytur shtëpitë e ndërtuara shumë pranë shtratit të tij. Lumenjtë Papër, Gostimë dhe Gostrimë kalojnë zona më rurale por duhet të merren masa që në këto lumenj të mos hidhen më mbetje të ngurta urbane. Zona e këtij projekti fillon: • Lumi Zaranika • Lumi i Manazderës • Lumi Papër • Lumi Gostimë • Lumi Gostrimë Qëllimi i këtij projekti është të shmangë rreziqet që i kanosen banorëve të bashkisë nga përmbytjet e lumenjve në fjalë dhe nga erozioni i brigjeve të tyre. Kjo mund të realizohet nëpërmjet ndërhyrjeve për ndërtimin e argjinaturave dhe me ndërhyrje të tjera për rehabilitim të shtratit dhe me sistem gjelbërimi. Mund të hartohen plane veprimi që të synojnë ndalimin e menjëhershëm të hedhjes së mbetjeve të ngurta dhe ujërave të ndotura në lumenj.
Partnerë & Financues	Bashkia Elbasan, Ministria e Mjedisit, ARM Elbasan, Sektori privat, Komuniteti lokal, Donatorë të ndryshëm (USAID, Banka Botërore)
Arsyetimi i Projektit	• Mbrojtja e ndërtimeve përgjatë shtratit të lumit nga përmbytjet dhe erozioni i brigjeve të lumenjve; • Rehabilitimi i lumenjve do të mbrojë pasurinë e patundshme të qytetarëve që banojnë përgjatë brigjeve të lumenjve, do të ruajë tokat bujqësore si dhe do të ruajë pasuritë e patundshme publike.
Objektivi	Objektivi O2: *"Mbrojtja e rigjenerimi i burimeve natyrore"* Programi P2: *Rehabilitimi i shtretërve, brigjeve lumore dhe zonave riapariane të Shkumbinit, Zaranikës, Manazderes, Papërit, Gostimës dhe Gostrimës dhe Kushe."*
Veprimet Strategjike	• Përthithja e fondeve; • Marrëveshja ndërmjet Bashkisë Elbasan dhe Ministrisë së Mjedisi; • Hartimi i projektit teknik; • Zhvendosja e banesave të rrezikuara në zona të caktuara nga Bashkia; • Zbatimi i projektit.
Rezultatet e pritshme	• Rreziku i përmbytjeve të shtëpive të ndërtuara përgjatë brigjeve të lumenjve i shmangur; • Shmangia e problemit të erozionit në brigjet e lumenjve; • Rehabilitimi i lumenjve do të mbrojë pasurinë e patundshme të qytetarëve që banojnë përgjatë brigjeve të lumenjve, do të ruajë tokat bujqësore si dhe do të ruajë pasuritë e patundshme publike.
Rreziqet	• Zbatimi i projektit realizohet në faza të ndryshme dhe kërkon kohë; • Kërkon burime njerëzore të kualifikuar dhe fonde për realizim; • Rehabilitimi i zonës do të ketë nevojë për përfshirjen e disa aktorëve, përfshirë këtu edhe pronarët e ndërtimeve apo tokës përgjatë fashës lumore; • Në këtë zonë janë të vendosur grupe të margjinalizuara si komuniteti rom për të cilët duhet siguruar strehim në rast se do jetë e nevojshme të shpërngulen nga kjo zonë.
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlera	---------
Vlerësimi i prioriteteve	Afatmesëm - Afatgjatë

FISHË PROJEKTI 18 (O2P1_PR4)	
Titulli i Projektit	PR4: Rigjenerimi i parkut të Krastës
Përshkrimi i Projektit	Krasta është parku më i madh natyror që ndodhet shumë pranë qytetit të Elbasanit. Sipërfaqja që zë ky park është 2,3 km². Ofrimi i hapësirave të gjelbëruara në bashkinë Elbasan është nevojë e cilësuar nga qytetarët. Krijimi i hapësirave çlodhëse për qytetarët sjellin nevojën e rehabilitimit të këtij parku. Rehabilitimi i parkut konsiston në pajisjen me hapësira të përshtatshme për të pushuar, krijimin e infrastrukturave të nevojshme për ecje, piknik, risistemim të gjelbërimit dhe ripyllëzime sipas nevojës, apo ndërhyrje të tjera që sipas nevojës mund të dalin gjatë procesit të projektimit.
Partnerë & Financues	Bashkia Elbasan, Ministria e Mjedisit, ARM Elbasan, sektori privat, Komuniteti lokal, Donatorë të ndryshëm
Arsyetimi i Projektit	• Nevoja për të përmirësuar infrastrukturën e parkut të Krastës, duke krijuar zona të përshtatshme pushimi; • Sipërfaqe e gjelbëruar në Bashkinë Elbasan sipas nevojës së përcaktuar në raport me numrin e banorëve; • Risistemimi i gjelbërimit në zonën e parkut të Krastë, mbrojtja e pemëve të këtij parku nga dëmtimet e mundshme.
Objektivi	Objektivi O2: *"Mbrojtja e rigjenerimi i burimeve natyrore"*; Programi P1: *"Mbrojtja e sistemit urban nga përmbytjet dhe dalja e vazhdueshme e lumit Shkumbin nga shtrati duke rehabilituar argjinaturat ekzistuese"*
Veprimet Strategjike	• Përgatitja e projektit të peizazhit dhe lobimi për fonde • Aplikimi për fonde • Realizmi me sukses i projektit duke e bërë këtë park një zonë çlodhëse për banorët dhe të frekuentuar
Rezultatet e pritshme	• Përmirësimi i infrastrukturës së parkut të Krastës • Krijimi i hapësirave çlodhëse për banorët e Bashkisë Elbasan
Rreziqet	• Gjetja e fondeve për financimin e projektit
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlera	----------
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër - Afatgjatë

FISHË PROJEKTI 19 (O5P5_PR6)	
Titulli i Projektit	PR6: Rikonstruksion i plotë në shkollën 9-vjeçare Bodin, një kopësht dhe 2 shkolla 9-vjeçare Bradashesh; 3 shkolla 9- vjeçare në Funarë; 2 kopshte dhe 1 fillore në Zavalinë; 3 shkolla 9-vjeçare në Tregan; 3 shkolla 9-vjeçare në Gjergjan etj; Ndërtimi i shkollave të mesme (Bradashesh, Gracen, Gjergjan, Shushicë, Tregan), ndërtimi i një shkolle shumëprofesionale në qytetin e Elbasanit dhe ndërtimi i dy shkollave 9-vjeçare në qytetin e Elbasanit
Përshkrimi i Projektit	Ky projekt ka për qëllim rikonstruksionin e strukturave të arsimit parashkollor dhe 9-vjeçar të cilat kanë probleme infrastrukturore, ku në raste të caktuara kthehet në problem për zhvillimin e mësimit. Ky projekt do të ndikojë në përmirësimin e kushteve të objekteve arsimore, rritjen e ofrimit shërbimit arsimor në të gjithë territorin e Bashkisë. Gjithashtu, është e nevojshme të ndërtohen shkolla të mesme në njësitë administrative Bradashesh, Gracen, Gjergjan, Shushicë dhe Tregan, ndërtimin i një shkolle shumëprofesionale në qytetin të Elbasanit dhe dy shkolla 9-vjeçare në rajonin 1 dhe 3 të qytetit të Elbasanit. Mungesa e ofrimit të shërbimit për arsimin është me e theksuar në zonat rurale. Për të rritur nivelin e arsimit në bashkinë Elbasan është e nevojshme të kemi ofrim të mirë të shërbimit, gjë e cila do të ndikojë edhe në kualifikimin e të punësuarve.
Partnerë & Financues	Bashkia Elbasan, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria Arsimore Rajonale Elbasan (DAR), Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Fondi i Zhvillimit Rajonal, Komuniteti lokal
Arsyetimi i Projektit	• Kushte fizike të papërshtatshme për zhvillimin e mësimit; • Numri i lartë i nxënësve të shpërndarë nëpër klasa; • Ndërhyrjet infrastrukturore ndikojnë në cilësinë e mësimdhënies; • Përmbushja e standardit të planifikimit për objektet arsimore në lidhje me sipërfaqen e nevojshme për nxënës.
Objektivi	Objektivi O5: *"Zbutja e pabarazive e zhvillimi i infrastrukturës sociale"*; Programi P5: *"Ndërhyrje rehabilituese të kopshteve dhe çerdheve, shkollave 9-vjeçare dhe të mesme"*
Veprimet Strategjike	• Përgatitja e projekteve teknike/arkitektonike dhe lobimi për fonde; • Gjetja e donatorëve të mundshëm për financimin e rikonstruksionit të shkollave 9-vjeçare që kanë nevojë për përmirësimin e infrastrukturës; • Prokurimi publik; • Rikonstruksioni i shkollave brenda afateve të përcaktuara, për të rritur cilësinë e arsimit në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Elbasan.
Rezultatet e pritshme	• Rritja e numrit të personave të arsimuar, me arsim 9-vjeçar dhe të mesëm në bashkinë Elbasan; • Rritja e cilësisë së arsimit në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Elbasan, duke ulur numrin e nxënësve në klasa; • Përmirësimi i infrastrukturës fizike të objekteve arsimore të përcaktuara në projekt.
Rreziqet	• Mungesa e fondeve për të investuar në rikonstruksionin e shkollave; • Mbyllja e shkollave gjatë kohës së rikonstruksionet, rrezikon uljen e nxënësve që do të ndjekin shkollën gjatë kësaj periudhe.
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlera	498,278,025.00 Lekë
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër - Afatmesëm

FISHË PROJEKTI 20 (O5P5_PR7)	
Titulli i Projektit	PR7: Infrastrukturë mbështetëse për shkollën 9-vjeçare 'Xhaferr Hakani' dhe pajisja e kopshteve dhe shkollave me mjete didaktike
Përshkrimi i Projektit	Ky projekt ka synim të realizojë pajisjen me mjete didaktike të kopshteve dhe shkollave të Bashkisë Elbasan. Për të realizuar një mësimdhënie sa më të mirë është e nevojshme të ndërtohen laboratorët për lëndët përkatëse në shkollat ku mungojnë dhe pajisja me mjetet që mungojnë sipas rastit. Gjithashtu pajisja e kopshteve me mjetet e nevojshme është domosdoshmëri për zhvillimin korrekt të procesit edukativ.
Partnerë & Financues	Bashkia Elbasan, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria Arsimore Rajonale Elbasan (DAR), Fondi Shqiptar i Zhvillimit, FZHR, Komuniteti lokal
Arsyetimi i Projektit	• Përmbushja e standardeve të nevojshme për zhvillimin e plotë të mësimit • Nevoja për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe edukimin në shkolla dhe kopshte
Objektivi	Objektivi O5: *"Zbutja e pabarazive e zhvillimi i infrastrukturës sociale"*; Programi P5: *"Ndërhyrje rehabilituese të kopshteve dhe çerdheve, shkollave 9-vjeçare dhe të mesme"*
Veprimet Strategjike	• Përcaktimi i kopshteve dhe shkollave, që e kanë emergjente pajisjen me mjete didaktike; • Përgatitja e projekteve teknike përkatëse në rastet e krijimit të laboratorëve apo hapësirave të reja; • Gjetja e donatorëve për të financuar në pajisjen e kopshteve dhe shkollave me mjete didaktike; • Pajisja e të gjitha kopshteve dhe shkollave me mjete didaktike dhe kryerja e punimeve sipas rastit.
Rezultatet e pritshme	• Përmirësimi i cilësisë së kopshteve dhe shkollave në procesin mësimor; • Aftësimi më i thelluar i fëmijëve dhe nxënësve.
Rreziqet	• Mungesa e fondeve për zbatimin e projektit; • Zbatimi i projektit edhe në zonat e thella, me akses të ulët në arsim
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlera	1,5266,686.00 Lekë
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër - Afatmesëm

FISHË PROJEKTI 21 (O5P2_PR2)	
Titulli i Projektit	PR2: Përmirësim i infrastrukturës së qendrave shëndetësore në Bradashesh Papër, Tregan, Shushicë dhe Zavalinë
Përshkrimi i Projektit	Në Bashkinë Elbasan ndodhen gjithsej 14 qendrat shëndetësore që ofrojnë shërbim. Gjithashtu raporti mjek-banorë është shumë i lartë, ku 1 mjek i shërben 1266 banorëve. Bazuar në të dhënat e mësipërme, ndërhyrjet në infrastrukturën e qendrave shëndetësore është emergjente. Përkatësisht është e nevojshme të rikonstruktohen dhe pajisen me mjetet e nevojshme: 2 qendra shëndetësore në Bradashesh, 1 në Gracen, 2 në Tregan, 1 në Shushicë dhe 1 në Zavalinë.
Partnerë & Financues	Bashkia Elbasan, Ministria e Shëndetësisë, FSHZH, FZHR, Donatorë të tjerë
Arsyetimi i Projektit	• Nevoja për të përmirësuar infrastrukturën e qendrave shëndetësore për të ofruar një shërbim shëndetësor sa më të mirë • Nevoja për të ofruar shërbimin e nevojshëm shëndetësor për të gjithë popullsinë të gjitha njësitë administrative
Objektivi	Objektivi O5: *"Zbutja e pabarazive e zhvillimi i infrastrukturës sociale"*, Programi P2: *"Ndërhyrje rehabilituese të qendrave mjekësore/ ambulancave"*
Veprimet Strategjike	• Përcaktimi i qendrave që kanë nevoja emergjente ndërhyrje; • Promovimi i projekt-idesë dhe lobimi për fonde; • Gjetja e donatorëve të mundshëm për financimin e projektit për përmirësimin e infrastrukturës së qendrave shëndetësore; • Hartimi i projekteve teknike dhe sipas rastit aplikimi për fonde; • Prokurimi publik dhe kryerja e punimeve.
Rezultatet e pritshme	• Përmirësimi i shërbimit shëndetësor në të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan; • Ulja e raportit mjek-banorë në standardet e lejuara, për të ofruar shërbimin e nevojshëm për të gjithë popullsinë.
Rreziqet	• Mungesa e financimit për të përmirësuar shërbimin shëndetësor
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlera	----------
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër - Afatmesëm

FISHË PROJEKTI 22 (O1P5_PR8)	
Titulli i Projektit	PR8: Rigjenerimi i qendrave të njësive administrative, duke risistemuar hapësirat publike dhe ofrimi i shërbimeve të munguara
Përshkrimi i Projektit	Qëllimi i këtij projekti është përmirësimi/ndryshimin fizik i infrastrukturës dhe/apo objekteve e shërbimeve publike në njësitë administrative me karakter rural. Aktualisht në këto qendra (qendrat e ish-komunave) janë realizuar pak investime, pjesa më e madhe e të cilave konsistojnë ndërhyrje të infrastrukturës rrugore. Realizimi i këtij projekti ka ndikim social e kulturorë në njësitë administrative të Bashkisë Elbasan dhe krijon mundësi të reja për zhvillimin ekonomik. Rigjenerimi dhe rivitalizimi i qendrave të njësive administrative është i rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të territorit.
Partnerë & Financues	Bashkia Elbasan, Ministria e Zhvillimit Urban, AKPT, Sektori Privat, Komuniteti Lokal, FZHR, FSHZH, Donatorë të ndryshëm.
Arsyetimi i Projektit	• Nevoja për përmirësimin e cilësisë së infrastrukturave dhe hapësirave publike në qendrat e njësive administrative; • Zhvillimi ekonomik dhe territorial i mëtejshëm i të gjithë territorit të bashkisë.
Objektivi	Objektivi O1: *"Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik"*; Programi P5: *"Rigjenerimi dhe zhvillimi i hapësirave publike në qytetin e Elbasanit dhe qendrat urbane të Njësive Administrative, përmes instrumenteve financiare, dizajnit urban dhe PPP-ve"*
Veprimet Strategjike	• Promovimi i projekt-idesë dhe lobimi për sigurim të fondeve; • Hartimi i projekteve të dizajnit me konkurrim të hapur ose nga bashkia; • Hartimi i projekteve të zbatimit dhe aplikimi për fonde, sipas rastit; • Prioritizimi i ndërhyrjeve emergjente për infrastrukturat që e kanë të nevojshme; • Kryerja e punimeve të zbatimit.
Rezultatet e pritshme	• Rigjenerimi urban i qendrave të të gjitha njësive administrative dhe krijimi i një hapësire publike ftuese për aktivitete biznesi; • Rritja e cilësisë së infrastrukturave (rrugore, objekte, shërbime publike) dhe përmirësimi i cilësisë së jetesës së banorëve.
Rreziqet	• Pamundësia për të financuar projektin; • Rritja e papunësisë në nivel bashkie; • Zhvendosja e popullsisë nga zonat rurale drejt zonave urbane; • Ulja e cilësisë së jetesës.
Faza e projektit	Koncept-Projekt
Vlera	473,721,440.00 Lekë
Vlerësimi i prioriteteve	Afatshkurtër - Afatmesëm

7. Shtojcat

Shtojca 1. Të ardhura Bashkia Elbasan, 2010 – 2015

TE ARDHURAT ANALITIKE (000/Lekë)		2010	2011	2012	2013	2014	2015
A	Taksa vendore	268,381	318,464	243,590	214,563	257,734	307,686
1	Taksa mbi Pasurinë	86,481	77,352	83,058	71,601	120,119	108,019
1.1	*Taksa mbi ndërtesat*	73,051	65,324	69,656	59,342	104,731	90,056
1.2	*Taksa mbi tokën bujqësore*	13,430	12,028	13,402	12,260	15,388	17,963
2	Taksa mbi biznesin e vogël	93,481	79,523	83,851	67,476	75,218	87,002
3	Taksë tabele	1,560	1,250	977	989	846	764
4	Taksë reklame	8,490	7,129	6,211	5,903	6,590	5,959
5	Taksa e regjistrimit të biznesit	2,504	2,501	2,262	2,352	796	
6	Taksë zënie hapësire cublike	12,985	13,923	15,187	10,314	18,043	13,225
7	Taksa e ndikimit në infrastrukturë	56,510	124,963	38,376	44,562	17,840	81,873
8	Taksa e kalimit të pronësisë	4,140	10,076	11,685	9,258	16,668	8,615
9	Taksë fjetje në hotel	2,230	1,746	1,984	2,108	1,615	2,229
B	Tarifat vendore	123,069	118,001	137,959	159,229	164,033	105,826
1	Tarifë pastrimi	41,602	39,632	49,391	48,950	64,762	74,935
2	Tarifë ndriçimi						16,038
3	Licenca, leje, autorizime (transport,etj)	3,114	3,384	2,412	2,134	3,344	-
